

**ENVER HOXHA**

**DITAR**

**PËR ÇËSHTJE NDËRKOMBËTARE**

**(Korrik 1978 — Dhjetor 1978)**

**11**

**TIRANË, 1984**

DURRËS, E HËNË

3 KORRIK 1978

### NE MBROJMË KURDOHERË TË DREJTËN

Artikulli ynë në mbrojtje të Vietnamit ka bërë një efekt të madh jashtë<sup>1</sup>. Njerëzit kudo mburrin kurajën dhe guximin e Partisë së Punës të Shqipërisë që mbron kurdoherë të drejtën. Vietnamezët janë veçanërisht të gëzuar, kurse kinezët nxijnë nga inati. Gjithë ambasadorët vietnamezë, kudo ku janë me radhë, falënderojnë nxehtësisht ambasadorët tanë për ndihmën dhe përkrahjen që i japim Vietnamit në këto momente të vështira, të cilat ia ka krijuar Kina për ta dëmtuar atë në ndërtimin e socializmit.

---

1 «Jashtë duart e imperialistëve nga Vietnami».

### OPORTUNISTË TË PAQËNDRUESHËM

Me rastin e Kongresit të 11-të të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë, Partia Komuniste e Kinës e shpalli hapur akordin e saj të plotë me vijën politike, ideologjike, organizative dhe ushtarake të Jugosllavisë.

Pritej kongresi për ta bërë një gjë të tillë! Por realiteti ka treguar se, edhe më përpara, me ardhjen në fuqi të Hua Kuo Fenit dhe të Ten Hsiao Pinit, kjo miqësi do të trashej dhe do të merrte rrugën e një «nënshtrimi» politik-ideologjik të partisë revizioniste kineze ndaj titizmit.

Titoja dhe titizmi shiheshin me sy të mirë nga Partia Komuniste e Kinës që në kohën e Mao Ce Dunit. Ky i fundit nuk ka qenë dakord me qëndrimet e drejta marksiste-leniniste të Bashkimit Sovjetik të udhëhequr nga Stalini, të Partisë sonë e të partive të tjera komuniste ndaj titizmit. Ai nuk e konsideronte Titon si renegat, as Partinë Komuniste të Jugosllavisë si një parti revizioniste.

Në shumë raste Mao Ce Duni e ka shprehur hapur idenë e pajtimit me revizionistët jugosllavë. Kur bëhet analiza e strategjive dhe e taktikave të ndryshme të Partisë Komuniste të Kinës, shihet qartë se kjo parti është përputhur në shumë çështje me PK të Jugosllavisë.

Natyrisht, Kina ka ruajtur aparenat, por, megjithatë do të vinte koha, sikundër erdhi, që në pikat kryesore të strategjisë të bashkohej hapur me Titon. **Antisovjetizmi**

kinez ka koïnciduar kurdoherë me strategjinë titiste, me një ndryshim, që Titoja është treguar më diplomat, vërtet oportunist, por i është përmbajtur rrugës së tij oportuniste, kurse udhëheqësit kinezë kanë kaluar edhe nga një ekstrem në tjetrin ndaj superfuqive. Kështu, Titoja ka luajtur politikën e kërcimit mbi litar dhe ka mbajtur ekuilibrin, duke anuar herë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, herë nga Bashkimi Sovjetik, por me një anim të përmbajtur në dukje. Kurse kthesat e Kinës në strategji ishin 180 gradëshe. Kështu nga pozitat kundër imperializmit amerikan ajo u kthye në pozita kundër hrushovianëve dhe, nga ato kundër hrushovianëve, u kthye pro imperializmit amerikan.

Në këtë rrugë, pra, në kthimin drejt Shteteve të Bashkuara të Amerikës, u bashkua strategjia e politikës së jashtme të Kinës me strategjinë e Jugosllavisë titiste. Në fakt, kjo strategji e Kinës është rrjedhim i një vije antimarksiste, i një qëndrimi prej renegati ndaj marksizëm-leninizmit, është një kundërshtim i socializmit shkençor dhe i ndërtimit të socializmit në Kinë, është ruajtje e kapitalizmit pak a shumë të zhvilluar, me një brendi që nuk është socialiste, por që vishet me disa tipare të jashtme socialiste. Ndryshe nuk mund të gënjehej populli e të ecej në kundërshtim me të, me masat e varfra, të cilat kryen revolucionin, një revolucion për të marrë fuqinë dhe për të ndërtuar socializmin e jo për të mbajtur në fuqi kapitalizmin dhe borgjezinë ose për të rehabilituar kapitalizmin, që Kina të bëhej një superfuqi. Pra push-teti në Kinë s'ishte një pushtet i diktaturës së proletariatit, por një pushtet i shumë partive, siç e ka theksuar vetë Mao Ce Duni. Me kalimin e kohës kjo vijë antimarksiste i dha rezultatet e veta. Në Kinë erdhi ekipi i Hua Kuo Fenit dhe i Ten Hsiao Pinit, i cili s'mund të mos ishte plotësisht dakord me Titon në politikën e jashtme dhe në organizimin e brendshëm të shtetit, në zhvillimin e ekonomisë dhe të ushtrisë.

**Vija e përgjithshme e politikës kineze ka qenë miqësia me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, nëpërmjet të cilave do të hapeshin rrugët për lidhje dhe unitet edhe me vendet e tjera kapitaliste të botës, me përjashtim të Bashkimit Sovjetik, të cilin Kina e kishte deklaruar si armikun kryesor jo vetëm të saj, por të të gjithë njerëzimit. Për sa i përket anës ideologjike, Partia Komuniste e Kinës do të binte dakord, sikurse ra, me të gjithë revizionistët modernë, me ata jugosllavë në radhë të parë, pastaj me të gjitha partitë e tjera revizioniste të botës, bile do të binte dakord dhe do të futej në tratativa, sikundër u fut, edhe me partitë e tjera të borgjezisë, me partitë socialiste, socialdemokrate, demokristiane, deri edhe me partitë e monarkisë e të fashizmit.**

Pra, në këtë drejtim, në këtë rrugë ku ishte futur, Kina puqej me Jugosllavinë dhe kishte nevojë për mbështetjen e saj, sepse Titoja është një proksenet i këtyre çështjeve dhe me gjithë dëshirë do të jepte të kuptonte se ai është një frymëzues jo vetëm i vendeve të vogla gjoja të paangazhuara, por edhe i Kinës së madhe. Prandaj **vajtja e Titos në Kinë përbënte një sukses të madh për të dhe një disfatë të turpshme për Kinën. Kjo vizitë e diskrediton edhe më shumë Kinën.**

Telegrami që iu dërgua Kongresit të 11-të të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë nga Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Kinës ishte i gjatë dhe i ngrohtë. Udhëheqësit kinezë e nxjerrin aty Titon si një udhëheqës botëror dhe socializmin në Jugosllavi, si një «socializëm të vërtetë», ekonominë e Jugosllavisë si një «ekonomi të përparuar» dhe vijën e saj si një «vijë të drejtë», që i ka zgjidhur të gjitha problemet ashtu si duhet në interesin e popujve të Jugosllavisë, e cila, sipas tyre, është një faktor me rëndësi për paqen dhe solidaritetin ndërkombëtar.

Mirëpo me gjithë unitetin që ata kanë, strategjia kineze për unitet të «tri botëve», domethënë të «botës së

parë» (pjesa amerikane) me «botën e dytë» dhe me «botën e tretë», në luftë kundër socialimperializmit sovjetik nuk i përgjigjet politikës së Titos të sistemit të tij të «mosangazhimit». Bile Titoja e kupton fare qartë strategjinë kineze në lidhje me «botën e tretë». Ai e kupton se kjo është manovër e një fuqie të madhe që po ngrihet dhe që kërkon të krijojë tregje e koloni të reja për veten e saj. Kjo strategji nuk është as në interesin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, padronit të Titos, dhe as në interesin e vetë Jugosllavisë, e cila ka pretendime të hiqet si lider-shipi i këtyre të ashtuquajturave vende të paangazhuara ose sistemit të «mosangazhimit». Dalja në dritë e një lider-shipi të një grupimi tjetër të quajtur «bota e tretë» nuk i vjen për hosh Titos, prandaj ai e kundërshton këtë, natyrisht, në mënyrën e tij diplomatike, por e kundërshton. Miniçi, ish-ministër i Jashtëm i Jugosllavisë, nuk mungoi të thotë se i cilëson si iluzione përpjekjet për të shpallur ndonjë fuqi të madhe apo bllok aleat «të natyrshëm» kundër një tjetri, si dhe përpjekjet për të cilësuar automatikisht si kundërshtar ose armik çdo fuqi të madhe ose grup vendesh që përfshihen në një bllok.

Pra, nëpërmjet Miniçit, me këto fjalë Titoja i thotë Kinës se nuk është dakord me pikëpamjen që duhet të vihen kundër njëri-tjetrit blloku amerikan me bllokun e Traktatit të Varshavës. Titoja do marrëveshje paqësore në mes këtyre dy blloqeve. Ai nuk është dakord që të mbështeten ose të konsiderohen një aleat i natyrshëm Shtetet e Bashkuara të Amerikës për të luftuar kundër Bashkimit Sovjetik dhe anasjelltas. Prandaj këtu revizionistët jugosllavë nuk puqen me ata kinezë.

Bile Miniçi shkoi edhe më tutje, duke u shprehur se përpjekjet e disave për të klasifikuar «vendet e paangazhuara» si «të moderuara» apo radikale, sipas kriterit të tyre prej fuqie të madhe, nuk kanë kuptim tjetër veçse për të përçarë «të paangazhuarit». Kurse përpjekjet e re-

vizionistëve jugosllavë qëndrojnë në atë që lëvizja e «mos-angazhimit» të jetë, sikurse është, pra ata janë për një statukuo, dhe kështu u shërbejnë shteteve kapitaliste të fuqishme për t'i shfrytëzuar këto vende të ashtuquajtura të paangazhuara dhe, nga një politikë e tillë, të përfitojë edhe vetë Jugosllavia titiste. Mirëpo statukuoja kineze ka ndryshim, sepse «bota e tretë» konsiderohet nga kinezët si një entitet ideologjik dhe Kina si epiqendër e unitetit luftarak të këtyre «botëve» kundër Bashkimit Sovjetik. **Këtu, pra, fshihet hegjemonizmi i kinezëve, të cilin as Shtetet e Bashkuara të Amerikës, as Titoja nuk e pranojnë, kështu që Titoja luan në dy tablo, edhe në tablonë amerikane, edhe në tablonë sovjetike.** Nga ana tjetër ai i thotë kinezit se «ti je në rrugë të drejtë», por për sa i përket teorisë së «tri botëve», tërthorazi i thotë se «kjo teori s'ka asnjë vlerë për mua, prandaj unë, Titoja, e konsideroj këtë teori kineze si një teori që kërkon të çajë lëvizjen e të paangazhuarve». Natyrisht, nga kjo gjë, sipas titistëve, rezultojnë të gjitha ato konsekuenca që gjoja mund t'i shkaktohen njerëzimit, por që në fakt ekzistojnë, për arsye se lëvizja e «të paangazhuarve» është diçka fiktive, iluzore.

Natyrisht, Miniçi në fjalimin e tij sulmon indirekt edhe Kubën, duke e quajtur qëndrimin e saj gjoja si qëndrim radikal, i cili, siç u shpreh ai, «çon në mënyrë të pashmangshme në dominimin e huaj dhe është në favor të atyre që luftojnë për interesat e fuqive të mëdha». Si konkluzion, Miniçi thotë se rrjedhimisht lëvizja e «mos-angazhimit» nuk mund të bashkohet, siç mund të dëshirojnë disa, me ndonjë palë, dhe të jetë aleate e natyrshme e saj, duke u bërë kështu në fakt rezervë e saj. Me fjalë të tjera, ai kërkon të thotë që, «ti, Kinë, ke synime të bëhesh një superfuqi, por nuk të lë kush të bëhesh e tillë, për arsye se ti je një vend i prapambetur dhe, për të realizuar synimet e tua, po nder dorën nga të katër anët,

nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe nga vendet e tjera të zhvilluara, duke kërkuar kredi për modernizimin e ekonomisë. Prandaj çështjet teorike, që gjoja ti i ke ngritur në plan të parë dhe i ke konkretizuar në njëfarë teorie të botës së tretë, nuk mund të gënjejnë kurrkënd dhe vendet e paangazhuara nuk duhet ta aprovojnë këtë gjë».

Ç'qëndrim do të mbajë Kina ndaj Jugosllavisë titiste për këtë çështje kardinale të politikës e të strategjisë së saj? Mendoj se Kina do të vazhdojë rrugën e vet, ajo ka synime imperialiste, dëshiron të bëhet superfuqi, prandaj do të bëjë zigzage dhe manovrime.

Pas fjalimit të Miniçit dhe raportit të Titos unë lexova në buletin e lajmeve që Gën Biaoja nga Pakistani shkoi në Sri-Lanka<sup>1</sup> dhe në një fjalim që mbajti atje, fill pas Kongresit të 11-të të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë, ky foli për lëvizjen e «të paangazhuarve» dhe u bëri thirrje kombeve që ta forcojnë këtë lëvizje, pra nuk e zuri në gojë «botën e tretë». Duket qartë se kinezët, si kurdoherë, janë oportunistë të paqëndrueshëm në pikëpamjet e tyre dhe vetëm me fjalë herë mbrojnë «botën e tretë» ose nuk e zënë në gojë fare, herë përmendin lëvizjen e «të paangazhuarve» ose përdorin termin «vende në zhvillim». Nuk u prish punë kjo kinezëve, ajo që u prish punë është gjendja e brendshme, e cila paraqitet e turbullt.

Nga informacionet që marrim, konstatojmë se në Kinë edhe në ushtri ka kundërshtime të mëdha. Fakt është se në konferencën ushtarake që u bë, u mbajtën katër referate, që binin në kundërshtim me njëri-tjetrin. Kjo tregon se, të paktën në ushtri, ka katër vija që kundërshtojnë njëra-tjetrën. Pra, nuk ishte vetëm Hua Kuo Feni që foli, por folën edhe Ten Hsiao Pini, Jeh Çien Jini dhe

<sup>1</sup> Më 21-25 qershor 1978.

një tjetër. Unë një sy të përciptë u hodha fjalimeve të tyre, por, po t'i lexosh me kujdes, shihet që ka kontradikta në mes grupimeve dhe qëllimeve të tyre. Këto kontradikta duken në mos në qëllimet strategjike, në ato taktike.

Për sa u përket organizimit dhe zhvillimit të ekonomisë, Kina po ndjek rrugën e vetadministrimit jugosllav. Pra, «ndërtimi i socializmit» në Kinë do të ketë tiparet e «socializmit vetadministrues» pa u quajtur i tillë, pavarësisht se nga përmbajtja do të jetë njëlloj me të. Kështu sigurohen kapitalistët amerikanë dhe ata të Evropës Perëndimore e të Japonisë për investimet që do të bëjnë në Kinë. Ky është mjeti më i mirë për degjenerimin politik dhe ideologjik të Kinës. Në këtë mënyrë imperialistët e ndryshëm do të hedhin si duhet kthetrat mbi pasuritë e mëdha të këtij vendi dhe do të drejtojnë ekonominë kinëze sipas interesave të fuqive të mëdha kapitaliste.

Natyrisht, kjo nuk do të bëhet lehtë e shpejt, për arsye se imperialistët amerikanë dhe kapitalistët e vendeve të tjera vërtet janë të interesuar të investojnë kapitalin e tyre në Kinë, sepse të ardhurat që do të sigurojnë, do të jenë të mëdha, por kurdoherë ata do të kenë parasysh që Kina nuk duhet të bëhet rrezik për ta, por për Bashkimin Sovjetik. Pra, Kina në strategjinë e saj kërkon të bëhet superfuqi, të përfitojë nga njëra superfuqi imperialiste dhe nga shtete të tjera kapitaliste për t'i bërë ballë superfuqisë sovjetike, e cila aktualisht ka tendenca ta zhdukë Kinën, përpiket të mbajë një dialog pak a shumë paqësor me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe me vendet e tjera kapitaliste të zhvilluara, sepse andej merr kredi të shumta për investime, për modernizimin e industrisë së saj.

Edhe Partia e Punës e Koresë i dërgoi telegram Kongresit të 11-të të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë. Kim Ir Seni, sikurse Hua Kuo Feni, e lavdëroi shumë Ti-

ton, sepse është në një rrugë me të. Teoria «çuçe» e Kim Ir Senit është në kundërshtim të hapët flagrant me marksizëm-leninizmin. Kjo teori tash zyrtarisht quhet «kimirsenzizëm» dhe kohët e fundit ka dalë një libër me titull «Kimirsenzizmi në teori dhe në praktikë». Pra, një tjetër kaposh revizionist kërkon të përhapë njëfarë teorie të tijën, speciale, edhe kjo kapitaliste e veshur me petka të grisura socialiste. Por edhe Kim Ir Seni, edhe Titoja janë krejtësisht të falimentuar në politikë, në ideologji dhe në ekonomi. Sikurse Titoja, edhe Kim Ir Seni, të dy duart i nder nga Bashkimi Sovjetik, nga Kina e nga vendet e tjera kapitaliste. Ai dëshiron të futet, në mos qoftë futur, në bisedime edhe me Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Problemi i bashkimit të Koresë së Veriut me atë të Jugut është një dada, një mbulesë, siç është edhe Tajvani për Kinën. Çështja e Tajvanit nuk e pengoi Kinën të vendoste dhe të zhvillonte marrëdhëniet e mira me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Po kështu edhe Kim Ir Seni, në mos sot, nesër, me siguri do të bjerë në ujdi, do të gjejë një *modus vivendi* që Koreja e Jugut të qëndrojë ajo që është ose kjo ta thithë edhe Korenë e Veriut nën sundimin e saj dhe gjithë Koreja të bëhet kështu një fushë shfrytëzimi e imperializmit amerikan. Në këtë mënyrë do të krijohet një bllok, këtë e do edhe Kina, me Shtetet e Bashkuara të Amerikës në krye, në të cilin këto të fundit të kenë në dominimin e tyre edhe Japoninë, edhe Kinën, edhe Korenë e, me duart e të tjerëve, t'i kundërvihen socialimperializmit sovjetik, domethënë ta dobësojnë këtë me një luftë botërore, por të kufizuar në Azi, pra, me një luftë ndërmjet Bashkimit Sovjetik nga njëra anë dhe Kinës, Japonisë, nga ana tjetër, kurse vetë Shtetet e Bashkuara të jenë prapavijat e këtyre dy fuqive imperialiste.

DURRËS, E PREMTE

7 KORRIK 1978

## PËRFUNDIM LOGJIK I TRADHTISË KINEZE

Sonte mora një radiogram që dërgonte ambasadori ynë nga Pekini. Ky njofton shkurtimisht se është thirrur në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Kinës dhe Y Xhani i ka dhënë një notë prej tetë faqesh. Me këtë notë, thotë ambasadori, **qeveria kineze pret të gjitha kreditë që i ka dhënë Shqipërisë në vitin 1975 në bazë të marrëveshjeve e të kontratave, pret, gjithashtu, të gjitha ato ndihma, të cilat nuk janë realizuar gjatë ndërtimit të objekteve si dhe ndihmat ushtarake, në bazë të marrëveshjes e të protokolleve që janë nënshkruar dhe tërheq të gjithë specialistët kinezë civilë dhe ushtarakë.** Tekstin e notës ambasada do të na e dërgojë nesër me avion.

Ky është konkluzioni i asaj armiqësie të madhe që ekziston në udhëheqjen revizioniste, renegate, tradhtarë, antishqiptarë kineze, është përfundimi logjik i veprimeve armiqësore të bandës fashiste të Hua Kuo Fenit dhe të Ten Hsiao Pinit. Prandaj **nuk është tash që ata deklarojnë se presin marrëdhëniet ekonomike me ne, pse udhëheqja kineze ka kohë, vite me radhë, që përdor taktikën e ngadalësimit të ndërtimit të objekteve në bazë të detyrimeve.** Këto vitet e fundit kinezët na kanë nxjerrë pengesa të mëdha në dërgimin e makinerive, të pajisjeve e të materialeve. Bile edhe në çështjet tregtare, përveç pengesave të mëdha që na kanë nxjerrë, ne jemi me ta me një saldo aktive prej shumë milionësh. Kinezët nuk i përgjigjen

dërgimit të materialeve të tregtisë që duhet t'i kishin sjellë me kohë dhe në këtë drejtim na kanë sabotuar ekonominë.

Çdo gjë do të ndjekë rrugën e saj. **Kjo çështje nuk i gjen në befasi Shqipërinë socialiste dhe Partinë e saj të Punës.** Asnjëherë ne nuk jemi gjendur në befasi, pse vigjilenca e Partisë sonë ka qenë dhe është e madhe. Partia jonë të gjitha problemet i ka parë kurdoherë në prizmin e marksizëm-leninizmit.

Ne kemi qenë të durueshëm dhe shumë të matur me Partinë Komuniste të Kinës e me udhëheqësit e saj dhe kemi bërë çmos që këto mosmarrëveshje, që e kanë buri-min në politikën antimarksiste, kundërrevolucionare dhe antishqiptare të udhëheqjes kineze, të rregulloheshin me bisedime. Natyrisht, udhëheqësit kinezë kanë refuzuar çdo bisedim me ne, për arsye se e merrnin me mend që nga këto bisedime nuk do të dilnin dot kollaj, ata nuk mund të na bindnin dot që të binim në ujdi me pikëpamjet e tyre, antimarksiste proamerikane dhe revizioniste. Sidoqoftë, ata do të diskreditohen. Nesër do të marrim tekstin e plotë të notës dhe do ta studiojmë. **Ne e parashikojmë se ç'përmban kjo notë, por detyra jonë do të jetë që ta studiojmë imtësisht dhe t'u japim kinezëve përgjigjen e merituar.** Natyrisht, përgjigja e merituar do t'u jepet me një notë, por është e qartë se pas saj do të vijjnë qëndrime të tjera të drejta marksiste-leniniste që do të demaskojnë gjithë vijën revizioniste tradhtarë proamerikane dhe kapitaliste të udhëheqjes kineze.

## ASGJË S'NA KA TREMBUR E NUK DO TË NA TREMBË

Pasi mora radiogramin e ambasadës sonë në Pekin, me të cilin na njoftohej përmbajtja e shkurtër e notës kineze mbi prerjen e të gjitha kredive dhe ndihmave për Shqipërinë, sot u ktheva në Tiranë nga Durrësi, ku isha me pushime, dhe bisedova me shokun Ramiz e shokë të Qeverisë, të cilëve u dhashë udhëzime se si duhet të vep-rojnë në kushtet aktuale. Ramizit i thashë që të mos priste sa të mblidhemi, por të vërë shkurtime në korent shokët e udhëheqjes së Partisë për gjendjen aktuale dhe që të jenë vigjilentë. Për sa u përket specialistëve kinezë, ne duhet të mbajmë një qëndrim normal si deri tash, të jemi korrektë me ta, por t'i kemi sytë hapur, se në këto kohë të fundit të qëndrimit të tyre në Shqipëri mund të na bëjnë edhe sabotime të papritura në ndonjë nyjë të rëndësishme të veprave tona industriale.

Nga ana jonë duhet të merren masa, gjithashtu, që, gjatë kohës që do të largohen specialistët kinezë, reciprokisht të kthehen edhe studentët dhe kursantët tanë që ndodhen në Kinë. Këta janë gjithsej rreth 150 veta.

Sa të jetë e mundur, pa riskuar çështjen, kjo punë të zhvillohet në rregull, në mënyrë që specialistët kinezë të kuptojnë se fajin nuk e kanë as udhëheqja shqiptare, as punonjësit shqiptarë, por udhëheqja e tyre. Shokët tanë t'u thonë specialistëve kinezë që do të largohen, se udhë-heqja e tyre, qeveria kineze, po bën një gabim të madh, fatal, për veten e saj. Shqipërinë, natyrisht, ajo synon ta

dëmtojë ekonomikisht, por Shqipëria është një vend so-cialist dhe do t'i ndërtojë me forcat e veta të gjitha ato që ju i latë në mes. Me prerjen e kredive për veprat, për të cilat udhëheqja juaj shkeli marrëveshjet e nënshkruara e të njohura botërisht, ajo bën një krim të madh kundër Shqipërisë e është përgjegjëse dhe, në fakt, qeveria ki-neze është përgjegjëse për këtë. Kaq t'u thonë dhe të nda-hen me ta si shokë pune që kanë qenë.

Gjatë kësaj bisede që bëra sot, u propozova shokëve që më 11 korrik të bëjmë mbledhjen e Byrosë Politike, të cilën ta vëmë në dijeni për këtë situatë që u krijua nga qeveria revizioniste kineze dhe të marrim vendimet e duhura, kundër armiqësisë së udhëheqjes kineze. Ne du-het të marrim, gjithashtu, masa të forta që të realizohet me sukses plani aktual pesëvjeçar dhe të punohet me perspektivë që edhe plani i ardhshëm pesëvjeçar të har-tohet në mënyrë të tillë që ta çojë ekonominë tonë gjith-një e më përpara, duke u mbështetur krejtësisht në for-cat tona.

Ne kemi një eksperiencë të madhe në luftën kundër armiqve. Është e treta herë që ndeshemi me armiq të tillë: së pari me revizionistët jugosllavë, pastaj me hru-shovianët dhe aktualisht me revizionistët kinezë. Të tria situatat e vështira që i janë krijuar dhe po i krijohen Shqipërisë nga armiqtë ne jo vetëm i kemi kapërcyer dhe do t'i kapërcejmë me sukses, po ato na kanë kalitur, na kanë pjekur akoma më shumë në luftën tonë të pamë-shirshme kundër imperializmit dhe agjentëve të tyre. Këto luftëra kanë forcuar Partinë e popullin tonë dhe kanë krijuar mundësi që te ne të ndërtohet socializmi në një shtet sovran të diktaturës së proletariatit, të ndërto-het jeta e re. Prandaj në këtë çështje duhet si kurdoherë gjakftohtësi, rregull, disiplinë, punë politike dhe ideolo-gjike e rrënjosur thellë dhe e studiuar mirë, që populli, me në krye Partinë, t'i kuptojë drejt situatat dhe të mo-

bilizohet totalisht në punë, të jetë kurdoherë i gatshëm, vigjilent dhe të mposhtë çdo vështirësi e çdo armiqësi nga çdo anë që mund t'i vijë, nga brenda ose nga jashtë.

Ne jemi të sigurt sepse Partinë e kemi të fortë si çeliku, uniteti i saj me popullin është shembullor, mbrojtja e ndërtimi i ekonomisë sonë janë të forta dhe ecin e do të ecin kurdoherë përpara. Asgjë s'na ka trembur deri tash dhe asgjë s'do të na trembë edhe në të ardhmen. Prandaj me këtë që bënë revizionistët kinezë, për ne s'ka rrugë tjetër veçse të dalim hapur kundër tyre, pse është fakt që deri në fund kemi dashur dhe jemi përpjekur t'i zgjidhim këto probleme me Kinën nëpërmjet bisedimeve, por gjithë bota po shikon se Kina ka marrë rrugën kapitaliste, rrugën imperialiste.

Pra, bisedimet e Kinës dhe të Partisë Komuniste të saj me Shqipërinë socialiste dhe me Partinë e Punës të Shqipërisë kanë qenë false, një iluzion. Ne nuk jemi nga ata që kemi iluzione, por, si marksistë që jemi, kemi dashur që këto çështje të zgjidheshin me bisedime, në rrugë miqësore dhe pa bërë asnjë lëshim në parime. Ne e dinim se udhëheqësit kinezë do të vazhdonin në rrugën armiqësore kundër nesh, për arsye se ata po bashkohen me imperializmin amerikan dhe me gjithë kapitalizmin botëror. Megjithatë ne nuk hoqëm dorë nga bisedimet me ta.

Tash kinezët morën vendim dhe i prenë marrëdhëniet ekonomike me ne. Kjo ca më keq për ta dhe ca më mirë për ne. Ne i kemi duart të lira, pse i kemi bërë të gjitha përpjekjet, prandaj do ta bëjmë punën tonë hapur. Këtej e tutje do të bëjmë një punë të gjerë demaskuese, politike dhe ideologjike. Dhe revizionistët e rinj kinezë do të demaskohen keq pse lufta jonë ideologjike ka qenë e është e bazuar kurdoherë në teorinë marksiste-leniniste, që mbron interesat e revolucionit, të proletariatit dhe të diktaturës së proletariatit që është vendosur në vendin tonë.

E MARTË

11 KORRIK 1978

## KËTË SITUATË DO TA KAPËRCEJMË!

Sot bëmë një mbledhje të jashtëzakonshme të Byrosë Politike dhe morëm në shqyrtim notën e 7 korrikut 1978 që qeveria kineze i ka drejtuar Qeverisë sonë dhe në të cilën njofton për prerjen e të gjitha kredive, ndihmave ekonomike e ushtarake dhe për tërheqjen e të gjithë specialistëve.

Rreth kësaj note, situatës që krijohet si pasojë e saj, qëndrimin të vendosur që do të mbajmë ne, folën të gjithë anëtarët dhe kandidatët e Byrosë Politike me gjakftohtësi, me ndjenjë të lartë përgjegjësie e me frymë revolucionare, me besim të patundur në vijën e drejtë marksiste-leniniste të Partisë sonë. Ata folën me optimizëm të madh rreth forcës dhe mundësive kolosale që gjenden në gjirin e popullit tonë heroik dhe në ekonominë e shëndoshë socialiste të vendit tonë për të kaluar çdo lloj vështirësie që mund e që do të na krijohet nga veprimi armiqësor i revizionistëve kinezë. Shokët, të gjithë dënuan me indignatë veprimin e poshtër të udhëheqësve kinezë, shfaqën mendime e sugjerime të shumta rreth përgjigjes që u duhet dhënë revizionistëve kinezë dhe shprehën solidaritetin e tyre të plotë me qëndrimin që do të mbahet.

Në mbledhje fola edhe unë.

Në këtë mbledhje nuk mori pjesë shoku Hysni, sepse është i sëmurë dhe i detyruar të qëndrojë në shtëpi. Por ai më dërgoi një letër në të cilën, midis të tjerave,

shkruante: «E prita me gjakftohtësi këtë akt armiqësor të kinezëve ndaj Partisë, popullit dhe vendit tonë. Edhe shpifjet dhe akuzat, sa të poshtra, aq edhe monstruoze që bëjnë kinezët kundër nesh për të na ngarkuar përgjegjësinë për këtë situatë të krijuar midis dy vendeve, duke numëruar një për një ndihmat që na kanë dhënë, i prita me gjakftohtësi, sepse Partia dhe Ju na keni mësuar që armiqtë dhe tradhtarët e marksizëm-leninizmit t'i njohim mirë ashtu siç janë, të mos presim asnjë gjë të mirë prej tyre, të qëndrojmë të patundur në vijën marksiste-leniniste të Partisë sonë, të mbrojmë me besnikëri marksizëm-leninizmin, të luftojmë pa mëshirë kundër armiqve të Partisë dhe të popullit tonë, për demaskimin dhe shpartallimin e tyre». Duke shprehur solidaritetin e tij të plotë me qëndrimin e Byrosë Politike ai vazhdon: «...e ndiej veten shumë të fortë dhe me besim të patundur te Partia jonë e dashur e të mësimet e saj, te Ju personalisht dhe të mësimet Tuaja, që na armatosin çdo ditë e më shumë për të punuar dhe për të luftuar për popullin dhe atdheun tonë, për Partinë dhe çështjen e saj të madhe, për mbrojtjen dhe triumfin e marksizëm-leninizmit, për demaskimin e shpartallimin e gjithë armiqve të popullit dhe të vendit tonë, të gjithë armiqve të marksizëm-leninizmit, imperialistë, revizionistë, renegatë e tradhtarë të çdo ngjyre, duke përfshirë edhe tradhtarët kinezë».

Njëzëri vendosëm t'i përgjigjemi fort dhe me argumente bindëse; në frymë të shëndoshë e marksiste-leniniste të hedhim poshtë përmbajtjen shpifarake e shoviniste të notës kineze dhe, meqenëse tendenca e tyre është që ta mbajnë të fshehtë përmbajtjen e kësaj note, vendosëm, gjithashtu, që opinionin tonë të brendshëm dhe atë ndërkombëtar ta vëmë menjëherë në dijeni me një njoftim të Agjencisë Telegrafike Shqiptare, pastaj të botojmë edhe notën. Vendosëm, gjithashtu, që për veprimin anti-

shqiptar të kinezëve të njoftohet Partia me një letër koncize, megjithëse ajo është në dijeni të këtyre çështjeve.

Të gjithë, njëzëri, shprehën bindjen e tyre të thellë e të vendosur se do ta kapërcejmë këtë situatë të vështirë që na krijuan revizionistët kinezë. Isha plotësisht dakord me shokët dhe u thashë se ne kemi kapërcyer situatën të tjera edhe më të vështira, kur akoma kemi qenë më të dobët në të gjitha drejtimet, kurse tani jemi shumë më të fortë, Partinë në radhë të parë e kemi të fortë dhe në unitet të çeliktë me popullin, se jemi vigjilentë dhe mbrojtja jonë vjen e forcohet gjithnjë e më shumë, ekonomia jonë ka ecur përpara dhe do të ecë edhe më mirë akoma në të ardhmen.

Pasi mbaruam me këtë pikë, u thashë shokëve se do të vazhdoja pushimet e mia dhe i porosita që edhe ata, të gjithë me radhë, të marrin pushimet ashtu sikurse është planifikuar.

## DURRËS, E MËRKURË

12 KORRIK 1978

### NOTE KINEZE E EGËR, SHPIFËSE E SHOVINISTE

**AFP-ja, Rojteri dhe agjenci të tjera po japin lajme nga Pekini, në lidhje me prerjen nga ana e Kinës të kredive dhe tërheqjen e specialistëve nga Shqipëria.** Natyrisht, këto lajme jepen si të marra nga «burime të mirinformuara» ose nga «burime shqiptare në Pekin» etj. Agjencitë në fjalë përpiqen të krijojnë konfuzion; herë thonë që janë shqiptarët ata që kanë kërkuar të tërhiqen specialistët kinezë nga Shqipëria, herë thonë se janë kinezët që e kërkojnë një gjë të tillë. Kështu që ne, për ta bërë të njohur të vërtetën, përgatitëm një njoftim të ATSH-së.

Unë e pashë sot tekstin e këtij njoftimi, bëra korrigjimet e duhura dhe që sonte do të jepet në radio e në televizion, duke vënë mirë në dukje, shkurt, marrjen e notës nga Kina, përmbajtjen kryesore të saj dhe arsyet pse Kina e mori këtë vendim ndaj Shqipërisë socialiste. Në këtë njoftim të ATSH-së do të thuhet, gjithashtu, se Qeveria Shqiptare do t'i përgjigjet notës kineze dhe, me qëllim që opinioni botëror të mund të informohet drejt dhe të gjykojë fajet e rënda të palës kineze, do të vërë në dukje se si qëndrojnë në të vërtetë punët në lidhje me marrëdhëniet Kinë-Shqipëri.

Nota kineze është e egër, hakmarrëse, e përgatitur nga një udhëheqje e frymëzuar me ndjenjat shoviniste të një shteti të madh, e cila kërkon t'i imponojë pikëpamjet

e veta politike dhe ideologjike revizioniste, antimarksiste, imperialiste një vendi, siç është Shqipëria socialiste.

Prerja e kredive civile dhe ushtarake nga ana e Kinës tregon jo vetëm brutalitetin e udhëheqjes kineze, por edhe karakterin jointernacionalist të saj në dhënien e këtyre ndihmave vendit tonë. Një veprim i tillë nga ana e udhëheqësve kinezë demaskon qëllimin e vërtetë të tyre, tregon sheshit përse i jepeshin këto ndihma Shqipërisë. Natyrisht, nota kineze hesht për arsyet e vërteta që e shtynë qeverinë kineze dhe Komitetin Qendror të Partisë Komuniste të Kinës që të merrte këtë vendim brutal politik dhe ideologjik ndaj nesh.

Megjithatë, nga burime të brendshme kineze kemi informata se atje është mbajtur Plenumi i 3-të i Komitetit Qendror të Partisë, i cili ka marrë në studim edhe çështjen e Shqipërisë. Në plenum është thënë se Partia e Punës e Shqipërisë dhe Enver Hoxha kanë sulmuar rëndë Partinë Komuniste të Kinës dhe udhëheqjen kineze, se gjoja ne paskemi qenë me «katërshen» dhe paskemi menduar që kjo, «katërshja», të merrte fuqinë, se sulmet kundër Kinës filluan më 7 korrik 1977, por, natyrisht, edhe më parë, në Kongresin e 7-të të Partisë së Punës të Shqipërisë në lidhje me teorinë e «tri botëve». Udhëheqësit kinezë kanë thënë, gjithashtu, se ne, shqiptarët, jemi dogmatikë dhe nuk kuptojmë zhvillimin e ngjarjeve, nuk e kuptojmë drejtësinë e ndarjes së botës në tri pjesë dhe pikëpamja jonë, gjoja e ndarjes së botës, më dy, qenka një pikëpamje metafizike dhe statike, kurse pikëpamja e tyre qenka dialektike, dinamike dhe marksiste-leniniste.

Në këtë mbledhje është thënë se gjoja ne kemi përpunuar Jao Ven Juanin, i cili ka ardhur me një delegacion partie dhe qeverie në Tiranë dhe ky «përpunim ideologjik» nga ana jonë paska zënë vend te ky njeri. Këtëj, revizionistët kinezë nxjerrin «konkluzione» se gjoja ne

ishim me «katërshen», kurse ne nuk dinim gjë fare që ekzistonte kjo «katërshë». Është fakt që ne as e kemi mbrojtur «katërshen», as e kemi dënuar. Natyrisht, revizionistët kinezë këto gjëra duan t'i lidhin sipas qejfit të tyre, por kjo neve s'na prish asnjë punë.

Udhëheqja kineze në këtë mbledhje të plenumit ka shtruar edhe çështjen se ne i kemi bërë një luftë të ashpër Ten Hsiao Pinit. Kjo është e vërtetë, sepse Ten Hsiao Pini është një renegat, që është dënuar dy-tri herë edhe nga Mao Ce Duni. Ne nuk kemi thënë gjë tjetër kundër tij veçse ato ç'janë thënë nga Mao Ce Duni, nga udhëheqja e Partisë Komuniste të Kinës dhe nga vetë Ten Hsiao Pini në «autokritikën» e tij. Këtu ata nuk gabohen. **Ten Hsiao Pini për ne është një armik i marksizëm-leninizmit, i Shqipërisë dhe i revolucionit.**

Në Plenumin e 3-të të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kinës është thënë, gjithashtu, se vdekja e tre udhëheqësve të partisë dhe të qeverisë kineze e ka bërë udhëheqjen shqiptare të mendojë se ka ardhur koha e përshtatshme për ta spostuar Kinën nga roli i saj në lëvizjen komuniste marksiste-leniniste botërore, për të rritur në këtë mënyrë famën e Shqipërisë.

Qëndrimin tonë marksist-leninist kundër titizmit jugosllav udhëheqësit kinezë e kanë quajtur një qëndrim antimarksist dhe mosmarrëveshjet tona me Jugosllavinë, sipas «të zgjuarve» kinezë, nuk qenkan politike dhe ideologjike, por vetëm çështje kontradiktash nacionale, për arsye se çështjet për pakicat shqiptare në Jugosllavi i shikojmë nga pozitë e një nacionalizmi të ngushtë! Këtu është arritur në konkluzionin se udhëheqja shqiptare i bën këto për t'u konsideruar si udhëheqja e vërtetë dhe e vetme e socializmit në Evropë!

Po ashtu udhëheqësit kinezë thonë se neve nuk na ka pëlqyer ardhja e Hua Kuo Fenit në krye të partisë dhe të qeverisë kineze. Kjo është shumë e vërtetë. Këtu

i kanë rënë pikës, por ky qëndrim nga ne nuk ka të bëjë me atë që pretendojnë ata, se ne donim ose s'donim të merrte fuqinë «katërshja». Jo. **Ne nuk donim asnjë antimarksist dhe revizionist të dilte në krye të partisë dhe të popullit kinez. Kjo është e vërteta e madhe.**

Në këtë plenum është thënë, gjithashtu, një e vërtetë tjetër, që ne kemi qenë në kundërshtim dhe nuk kemi qenë dakord për lidhjet e Kinës me Shtetet e Bashkuara të Amerikës në ato forma, në atë mënyrë dhe për ato qëllime siç i bënte Kina. Këtë qëndrim tonin të drejtë marksist-leninist në arenën ndërkombëtare, revizionistët kinezë e quajnë dogmatik, metafizik, aventurizëm të majtë në formë dhe të djathtë në përmbajtje.

Udhëheqësit kinezë pretendojnë se politika e Shqipërisë është mbyllje në guaskën e saj, kur e vërteta është se jemi ne që e kemi këshilluar Kinën të hapej dhe të lidhte marrëdhënie me shtetet e ndryshme në interes të lëvizjes komuniste botërore, se Shqipëria ka pasur dhe ka marrëdhënie me një numër të madh shtetesh të botës me orientime të ndryshme politike. Pra, ne nuk jemi aspak të mbyllur në guaskën tonë. Marrëdhënie nuk kemi me vende të tilla si Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Anglia, Bashkimi Sovjetik, dhe me ato vende ku janë vendosur regjime fashiste, por udhëheqësit kinezë na quajnë dogmatikë, siç duket, se nuk puqemi me ta, me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me Pinoçetin, me Frankon dhe shokët e tyre.

Ata, që në kohën e Mao Ce Dunit, kanë dashur që ne të mos i përgjigjeshim me vendosmëri dhe në mënyrë të prerë vendimit të Bashkimit Sovjetik hrushovian për të prerë marrëdhëniet me ne. Ky është një fakt i njohur nga ana jonë. Udhëheqësit kinezë kanë bërë çmos që të mos e bënim një gjë të tillë, kur dihet që ishte vetë Hrushovi ai që i preu marrëdhëniet me Shqipërinë.

Në këtë mbledhje të Plenumit të 3-të të Komitetit Qe-

ndror të Partisë Komuniste të Kinës ne akuzohemi se nuk jemi për frontin unik, domethënë për një front të përbashkët me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me kapitalizmin botëror, për të përballuar socialimperializmin sovjetik, dhe këtej kanë dalë në konkluzionin se ne, shqiptarët, me dashje ose pa dashje bëmë lojën e social-imperializmit!

Po këtu është thënë se ne jemi kundër një mbledhjeje apo konference paqeje në Ballkan, nën drejtimin e Jugosllavisë dhe të Rumanisë. Ky është gjoja një gabim i madh nga ana jonë, sepse një gjë e tillë qenka në favor të forcimit të rezistencës së vendeve të Ballkanit kundër hegjemonizmit sovjetik. Pra, kinezët në këtë mbledhje kanë ngritur çështjen që ne të bashkohemi me Jugosllavinë titiste, e cila është e shitur tek imperialistët, dhe me Rumaninë, partneren e saj, që është një agjenturë e sovjetikëve. Kjo s'na çudit aspak, sepse ata me kohë ia kishin këshilluar një gjë të tillë Beqir Ballukut, i cili përgatiti edhe puçin, që dështoi.

Gjithë ky trajtim i problemit të Shqipërisë, siç mësojmë, është bërë nga Gën Biaoja në raportin që ai ka mbajtur në këtë plenum dhe në komisionin e jashtëm të Asamblesë së Përgjithshme. **Sipas Gën Biaos, amaneti i Çu En Lait për sa i përket Shqipërisë ishte: Çu En Lai e kishte parashikuar me kohë se Shqipëria dhe Partia e Punës e Shqipërisë ishin aleatet e përkohshme të Kinës, prandaj ai kishte thënë se me Shqipërinë duheshin përdorur taktika, sepse shqiptarët kanë kokën e tyre, pra të mos dalim hapur me emër kundër Shqipërisë, gjithmonë goditja t'i jepet armikut tonë kryesor, Bashkimit Sovjetik, duke bërë aluzion njëkohësisht edhe për përkrahësit e tij. Dhe, sipas Çu En Lait, në radhët e përkrahësve të sovjetikëve hyn edhe Shqipëria!**

Sigurisht, këto qëllime të ish-kryeministrit kinez i shpjegon fare qartë edhe përgatitja e komplotit dhe e

puçit me armiqtë tanë të brendshëm, me Beqir Ballukun e Abdyl Këllezin. Çu En Lai gjoja kishte thënë se duhej të plotësoheshin kontratat e firmosura midis Kinës dhe Shqipërisë në fushën ekonomike, kulturore e tekniko-shkencore, kurse të tjerat duheshin shikuar. Por, kinezët këtë amanet të Çu En Lait nuk e mbajtën. Në të vërtetë Çu En Lai kishte lënë amanet që të uleshin në maksimum ndihmat që Kina i jepte Shqipërisë, që kjo, me fjalë të tjera, «të merrte vesh, sa i vlen lekura».

Si konkluzion grupi aktual fashist, që udhëheq partinë dhe popullin kinez, shkoi edhe më tej nga ç'predikonin këshillat «prudente» revizioniste e antishqiptare të Çu En Lait dhe ia preu të gjitha kreditë civile e ushtarake Shqipërisë, tërhoqi në të njëjtën kohë specialistët, duke lënë të papërfunduara një numër veprash dhe ndërpreu dërgimin e pajisjeve për të cilat kishte kontrata. Tash këto në duhet t'i plotësojmë vetë.

Me fjalë të tjera, **udhëheqësit aktualë kinezë shkelën jo vetëm «miqësinë», por edhe marrëveshjet ndërkombëtare, që kanë një karakter të rëndësishëm ndërkombëtar dhe që ishin firmosur nga të dyja palët, nga Kina dhe nga Shqipëria.**

Në Plenumin e 3-të të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kinës janë bërë diskutime dhe janë marrë vendime edhe mbi qëndrimin ndaj Jugosllavisë. Jugosllavia në këtë mbledhje të plenumit është cilësuar si vendi ku Bashkimit Sovjetik i ka ngecur sharra në gozhdë, domethënë te Titoja dhe te titizmi ai ka gjetur një kundërshtar të rreptë, kundërshtar të vërtetë.

Kinezët janë plotësisht me pikëpamjen se në Jugosllavi ndërtohet socializmi i vërtetë, i pavarur dhe që kjo zhvillohet në rrugën marksiste-leniniste. Në lidhje me këtë pikëpamje «parimore» në këtë plenum janë shtruar këto detyra: të zhvillohen, të forcohen e të konsolidohen akoma më shumë në të ardhmen lidhjet e mëtejshme

midis Kinës e Jugosllavisë dhe bashkëpunimi i përgjithshëm me të në të gjitha fushat politike, ideologjike, kulturore, ekonomike, shkencore etj. Të ecë, gjithashtu, me ritme më të shpejta shkëmbimi i eksperiencës në fushën e drejtimit e të administrimit shtetëror dhe ekonomik të vendit dhe realizimi nga pala kineze i studimeve të posaçme në këtë drejtim, duke pasur ndihmën e palës jugosllave, ndihmë, për të cilën edhe Titoja është zotuar që t'ua japë.

Për sa i përket forcimit të lidhjeve midis Kinës dhe Jugosllavisë është caktuar programi për bashkëpunimin e mëtejshëm, është bërë edhe një bashkërenditje e mirë e veprimeve ndërmjet të dyja palëve në fushën ndërkombëtare, sidomos në drejtim të veprimtarisë së grupeve të «botës së paangazhuar» dhe «botës së tretë». Po ashtu është vendosur që të përsosen bashkërenditja dhe rakordimi i veprimeve e i qëndrimeve në fushën ndërkombëtare dhe me organizatat e tjera të kësaj natyre.

Në plenum u shtrua edhe çështja e propagandimit dhe e ndihmës në drejtim të njohjes reciproke të mëtejshme të të dy vendeve dhe të të dy popujve. Këtij qëllimi do t'i shërbejnë shkëmbimi i materialeve politike, përkujtimi reciprok i ngjarjeve dhe i datave historike, duke përdorur të gjitha mjetet e propagandës, të cilat do të zgjerohen në një shkallë më të madhe. Po këtu është marrë vendim që krahas përmirësimit të marrëdhënieve midis partive, të cilat konsiderohen të mira, bile edhe më të mira se me Rumaninë, të rritet më tej edhe bashkëpunimi në fushën ushtarake. Në këtë drejtim Jugosllavia do ta furnizojë Kinën me disa tipa raketash, prodhim amerikan, dhe me pajisje për industrinë ushtarake, prodhim gjermanoperëndimor.

Të gjitha këto detyra, që u shtruan në plenum për këtë problem, do të konkretizohen akoma më mirë me vajtjen e Hua Kuo Fenit në Jugosllavi dhe do të konfir-

mohen në një komunikatë politike të përbashkët, të nënshkruar nga të dyja palët. Mund të arrihet edhe në nënshkrimin e një traktati miqësie e bashkëpunimi midis Kinës dhe Jugosllavisë.

Po ashtu në plenumin dhe në komisionin e jashtëm të Asamblesë së Përgjithshme është theksuar se në vitin 1948 vendet socialiste, Kina dhe Jugosllavia, përpara kërcënimeve dhe presioneve të Stalinit, kanë qenë të detyruara të ndaheshin dhe të luftonin kundër njëra-tjetrës, por kjo gjë dështoi, si rezultat i ecjes së Jugosllavisë në rrugën e vet kombëtare, pa ndërhyrje dhe instruktazhe nga jashtë. Kinezët, gjithashtu, kanë theksuar se pikëpamjet e Jugosllavisë dhe pikëpamjet e Kinës kanë qenë kurdoherë të njëjlojta, por lufta midis tyre ndodhi, natyrisht, për faj të Bashkimit Sovjetik, të Stalinit, që u bëri presion. Me këto fjalë u fshi gjithë ajo periudhë e luftës kundër titizmit që zhvilloi Kina, kur jetonte Mao Ce Duni.

Për ne të gjitha pikëpamjet e udhëheqjes revizioniste kineze janë të qarta, ato prej kohësh kanë qenë të qarta, por tash me këto që janë diskutuar në këtë mbledhje të Plenumit të 3-të të KQ të Partisë Komuniste të Kinës vërtetohen katërcipërisht pikëpamjet antimarksisiste, antishqiptare, kundërrevolucionare të udhëheqjes kineze. Edhe pa pasur këtë informacion të sigurt që kemi, vetë faktet dhe gjithë puna e udhëheqësve kinezë tregojnë fytyrën e vërtetë të këtyre tradhtarëve të marksizëm-leninizmit.

Nota që Kina i dërgoi Shqipërisë, është një akt fatal për të, pse, përgjigjja që do t'i japim ne kësaj note dhe botimi i një numri tjetër materialesh therëse nga ana jonë, do ta demaskojnë plotësisht rrugën kundërrevolucionare, kapitaliste, shoviniste imperialiste, ku po ecën Kina.

**DURRËS, E ENJTE**

**13 KORRIK 1978**

**NË MARRËDHËNIET TREGTARE ME JASHTË  
NË ASNJË MËNYRË NUK DUHET TË CENOHET  
AUTORITETI I MADH I PARTISË  
DHE I SHTETIT TONË**

Mehmet Shehu më tha se nesër, më 14 korrik, do të ketë për drekë Ernst Austin, kryetar i Partisë Komuniste të Gjermanisë (marksiste-leniniste). Në mes të tjerave më tha se mendonte t'i propozonte Austit që partia e tij të na rekomandonte ose të na lidhte me tregtarë të ndryshëm të Gjermanisë Perëndimore për të bërë tregti dhe për të shkëmbyer mallra.

I thashë të mos e bëjë një gjë të tillë, së pari për arsye se nuk shkon që kryeministri t'i bëjë një propozim të tillë kryetarit të një partie motër. Së dyti, është çështja që ne nuk duhet të ndjekim atë praktikë që ka ndjekur Partia Komuniste revizioniste e Bashkimit Sovjetik, e cila, nëpërmjet Partisë Komuniste Franceze, Italiane etj., lidhej me firmat kapitaliste dhe u linte atyre nga një përqindje në kontratat që bëheshin. Ne e konsiderojmë Partinë Komuniste të Gjermanisë (marksiste-leniniste) dhe çdo parti tjetër marksiste-leniniste si një partnere politike, ideologjike, revolucionare, luftëtare, prandaj të mos mendojmë aspak që me to të përpiqemi të na gjejnë myshterinj të mallrave tona. Këtë punë ne duhet ta bëjmë nëpërmjet atashëve tanë tregtarë që kemi jashtë shtetit.

Partitë motra marksiste-leniniste janë të ngarkuara deri në grykë në vështirësi të mëdha e në luftë me reaksionin më të egër, ato gjenden përballë një armiku që duhet luftuar. Prandaj ne në asnjë mënyrë nuk duhet t'i tërheqim ato në një preokupacion të tillë. Shokët e partive motra mund të mos na e refuzojnë këtë propozim, por mund edhe të na thonë që nuk bëhet.

Në lidhje me çështjet e tregtisë përsëri theksova që Qeveria nuk duhet të shpejtohet për kërkesa e oferta nga të gjitha vendet kapitaliste e revizioniste për objekte industriale, për të cilat ne do të kemi nevojë, qoftë për të përfunduar me sukses planin aktual, qoftë planin e ardhshëm.

Ne, natyrisht, nuk marrim dhe kurrë nuk do të marrim kredi nga këto vende, çdo gjë do të blihet në to me para në dorë, me klering ose me devizë, por duhet të kemi parasysh se në këto kohë që po kalojmë, në këtë periudhë kur ka filluar lufta e hapët me Kinën, çdo hap i pamatur nga ana jonë do të shfrytëzohet nga propaganda kineze dhe prokineze sikur ne po lidhemi qoftë me Perëndimin, qoftë me Moskën. Një gjë të tillë, natyrisht, ne nuk e bëjmë, por i thashë se reaksioni edhe go-marin mashkull e bën me barrë, bile që tash ai ka filluar të thotë dhe të presë se nga ç'anë do të drejtohet Shqipëria, nga Perëndimi, apo do të shkojë drejt Lindjes.

Me qëndrimet tona në marrëdhëniet me jashtë ne duhet t'i japim të kuptojë mirë Perëndimit, Lindjes dhe Lindjes së Largme se qëndrimet e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë nuk ndryshojnë, se ajo është në luftë me imperializmin, me socialimperializmin dhe me gjithë borgjezinë reaksionare, se ajo do të bëjë tregti me vendet e ndryshme dhe kjo tregti duhet të bëhet e matur, si kurdoherë e balancuar.

Në tregtinë tonë me jashtë, për kontraktimin e disa objekteve ekonomike, ne duhet të preferojmë, natyrisht,

ato shtete të cilat nuk janë me tendenca të theksuara imperialiste ekspansioniste. Për shembull, mund të preferojmë që një termocentral ose një turbinë ta kontraktojmë me devizë, me para në dorë, ose me klering në Austri, në Çekosllovakia, ose në një vend tjetër të vogël, por kurdoherë më pak në Gjermaninë Perëndimore, në Francë, ose në vendet skandinave. Këtë do ta bëjmë jo vetëm për arsyet që thashë, por edhe se në këto vende që përmenda (në drejtim të të cilave Mehmet Shehu kishte tendencë që në to ne mund të tatojmë), i kanë mallrat shumë të shtrenjta dhe në fakt vetë ai më tha se çmimet atje i kanë gati dyfish më shumë. Prandaj edhe nga kjo anë neve nuk na intereson të kontraktojmë me këto shtete, sidomos me shtetet e mëdha imperialiste, siç janë Gjermania Perëndimore, Franca etj. Ne mund të kontraktonim makineri e pajisje me Zvicrën, por, po të ishin mallrat e saj të lira. Mirëpo në Zvicër ato janë shumë të shtrenjta. Mundet me Italinë diçka të bëjmë, mundet edhe me Austrinë, por duhet të bëjmë tregti edhe me vendet revizioniste si me Çekosllovakinë dhe me Poloninë, me të cilat nuk i kemi prerë marrëdhëniet tregtare. Ne kemi prerë me to marrëdhëniet shtetërore në drejtimin e ambasadave dhe, megjithëse kemi vazhduar luftën politiko-ideologjike me to, lidhjet tregtare ne nuk i kemi prerë, as ato nuk i kanë prerë me ne, dhe kjo tregti ka vazhduar kështu të zhvillohet me ritme të rregullta. Prandaj blerja në Çekosllovakia e një, e dy turbinave, ose e ndonjë makinerie ose aparature tjetër që do të na nevojitet për industrinë tonë nuk është ndonjë gjë e jashtëzakonshme. Një gjë e tillë nuk mund të shfrytëzohet për propagandë dhe shpifje kundër nesh. Gjithashtu, duhet të tentojmë edhe nga ana e Greqisë, domethënë edhe me të mund të kontraktojmë diçka, në qoftë se atje ka mundësi. Ne duhet ta vazhdojmë tregtinë me Jugosllavinë në atë mënyrë që e lypin interesat e për-

bashkët dhe interesat politikë që kemi me këtë ose me vende të tjera të kontinenteve të ndryshme, por që nuk kanë karakterin e vendeve imperialiste, të cilat kërkojnë të hedhin kthetrat në Shqipëri. Me të tilla shtete duhet t'i kemi marrëdhëniet shumë, shumë të kufizuara, pavarësisht se çmimet mund të jenë disi edhe më të ulëta. Ne të preferojmë një çmim edhe një çikë më të shtrenjtë sesa t'i marrim nga shtete të tilla që njihen në botë si shtete që zhvillojnë neokolonializmin dhe që bëjnë tregti me tendenca invadimi ekonomik dhe politik.

Në radhë të parë duhet të marrim masa të ndërtojmë ato objekte industriale që na kanë mbetur në mes, të marrim masa që të zhvillojmë tregtinë, të shesim mallrat tona dhe të krijojmë fondet e duhura për të përballuar nevojat aktuale, por sidomos nevojat e planit të ardhshëm pesëvjeçar, i cili afërsisht, në qoftë se s'gabohem, do të ketë një kërkesë prej 500 milionë dollarësh. Këta 500 milionë dollarë ne, natyrisht, kemi mundësi të mëdha që t'i krijojmë për blerje fabrikash ose centralesh që do të na duhen, por duhet të prodhojmë mirë dhe këtyre prodhimeve duhet t'u gjejmë treg të qëndrueshëm. Ky duhet të jetë objektivi ynë ekonomik.

Në tratativat me jashtë nuk duhet harruar asnjë minutë momenti politik i jashtëm i vendit tonë. Në asnjë mënyrë ne nuk duhet të veprojmë në mënyrë të shpejtuar që të cenohet autoriteti i madh i Partisë sonë dhe i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, prandaj në asnjë rast nuk duhet të ngutemi, por të ecim të matur, çdo gjë ta realizojmë, por me kujdes.

Kjo çështje ka rëndësi, pse, siç më raportoi Mehmet Shehu, kanë dërguar një numër të madh grupe njerëzish jashtë vendit në të katër anët për të parë. Kjo edhe mund të bëhet, por edhe përshtypje nuk duhet të japim që ja tash, shikoni, ne po dërgojmë njerëz nga të katër anët. Ne po kritikojmë Kinën për një gjë të tillë, prandaj

të dërgojmë grupe njerëzish, po atje ku duhet dhe sa duhet, pra me shumë kujdes. Pastaj nuk duhet t'i dërgojmë ata për të parë një teknologji që e njohim, si për shembull teknologjinë bituminoze, prandaj nuk është nevoja që të vejë një grup njerëzish nga ana jonë deri në Kanada. Shokët tanë që merren me këtë punë kanë vendosur të dërgojnë dhe le të dërgojnë, por derisa ne po i shfrytëzojmë aktualisht rërat bituminoze, s'kemi ndonjë interes të madh imediat që të na nxitë dhe që s'bëjmë dot pa vajtur atje për të parë. Kanadaja mund të ketë impiante të mëdha për këtë çështje, kurse tonat këtu janë të vogla dhe këto ne kemi filluar t'i ndërtojmë dhe t'i shfrytëzojmë me to rërat bituminoze, prandaj të dërgojmë jashtë ekipe, por t'i dërgojmë me mend, atje ku duhet dhe për probleme që janë medoemos të nevojshme.

**DURRËS, E ENJTE**  
**13 KORRIK 1978**

### **LE TË HAPIM DEFTERËT!**

Lidhur me përgjigjen që po përgatitim për t'u dhënë kinezëve për ndërprerjen prej tyre të ndihmës ekonomike dhe ushtarake, të pagesës së ndihmave dhe tërheqjen e specialistëve ekonomikë e ushtarakë, Ramizi erdhi sot dhe më lexoi tezat e shtjelluara në bazë të orientimeve që i dhashë unë më 8 korrik 1978, të diskutimit që zhvillova në mbledhjen e jashtëzakonshme të Byrosë Politike më 11 korrik 1978 e të sugjerimeve që bënë në këtë mbledhje edhe anëtarët e tjerë të Byrosë Politike.

Pasi diskutuam rreth këtyre tezave, e porosita që në hartimin e tekstit të përgjigjes të ketë parasysh edhe sa vijon:

Atje ku flitet për luftën kundër revizionizmit, të vihet theksi që lufta jonë kundër revizionizmit modern filloi që pas vdekjes së Stalinit dhe shkoi duke u ngjitur, duke kundërshtuar veprimet antimarksiste e revizioniste të Hrushovit dhe të bandës së tij, si në politikën e jashtme, ashtu edhe në marrëdhëniet me partitë, veçanërisht me Partinë tonë.

Të vëmë në dukje se Hrushovi bëri kauzë të përbashkët me renegatët titistë. Për këtë Partia e Punës e Shqipërisë jo vetëm nuk ishte dakord, por edhe e luftoi vijën e Hrushovit. Dokumentet vërtetojnë se edhe Partia Komuniste e Kinës në atë kohë, pa qenë e ndikuar

nga askush, e dënoi rehabilitimin e Titos dhe të bandës së tij nga ana e Hrushovit.

Pastaj erdhi mbledhja e Bukureshtit. Atje u vërtetua edhe një herë e më mirë vija tradhtare e Hrushovit dhe e hrushovianëve. Ata jo vetëm sulmuan marksizëm-leninizmin dhe Partinë e Punës të Shqipërisë, por filluan sulmin edhe kundër Partisë Komuniste të Kinës. Partia e Punës e Shqipërisë menjëherë i erdhi në ndihmë Partisë Komuniste të Kinës, e mbrojti atë deri në fund, duke menduar dhe duke qenë e bindur se mbronte kështu marksizëm-leninizmin dhe Kinën socialiste.

Partia jonë, në vitin 1960, kur luftonte dhëmb për dhëmb me hrushovianët, konstatoi se udhëheqja kineze nuk ishte në pozita të vendosura antihrushoviane dhe tregonte lëkundje. Udhëheqja kineze ecte drejt pajtimit dhe shuarjes së polemikës me hrushovianët. Qenia dakord me Shqipërinë për këtë problem duket që ishte e sipërfaqshme. Këtë e vërteton fjalimi i Çu En Lait në Kongresin e 22-të të PK (b) të BS ku ai nuk mbrojti Partinë tonë, por bëri thirrje për shuarjen e polemikës. Kjo u quajt nga udhëheqja kineze si një ndihmë për Shqipërinë, kur në fakt me këtë ajo kërkonte, shuarjen e polemikës me revizionistët hrushovianë.

Ky qëndrim vinte nga disa qëllime dhe objektiva që synonte të arrinte politika kineze ndaj hrushovianëve, me të cilët pas vdekjes së Stalinit kishte ardhur në ujdi. Kjo politikë e ujdisë dokumentohet nga mbledhjet ndërkombëtare të partive marksiste-leniniste që janë mbajtur, ku ka asistuar personalisht Mao Ce Duni. (Porosita që këto fakte të vihen në dukje qartë, duke evituar frazat e tepërta.)

Pas kësaj ideje të vihen shënimet nga materialet e përgatitura që kanë të bëjnë me kontradiktat që lindën midis dy partive tona në vitin 1962 në Pekin, ku ishin Hysniu dhe Ramizi.

Në korrik 1962 shoku Hysni dhe shoku Ramiz u dërguan në Kinë për bisedime me Komitetin Qendror të Partisë Komuniste të Kinës. Atje këta u ndeshën me udhëheqësit kinezë për një çështje themelore. Liu Shao Çia, Çu En Lai dhe Ten Hsiao Pini shtruan me forcë nevojën e krijimit të një fronti unik bashkë me revizionistët hrushovianë kundër imperializmit amerikan. Pra ata donim të pajtoheshin me sovjetikët. Ten Hsiao Pini hapur na tha: «Është e pamundur që Hrushovi ta ndryshojë veten e të bëhet si Titoja... Bashkimi Sovjetik kurrë nuk mund të ndryshojë si vend socialist».

Edhe Çu En Lai deklaroi: «Bashkimi Sovjetik nuk mund të kthehet në kapitalizëm në rrugë paqësore».

Duke zbatuar direktivat e Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, shokët Hysni e Ramiz kundërshtuan këto pikëpamje të kinezëve, argumentuan qëndrimin parimor të Partisë sonë, që si moto kishte idenë e Leninit, se nuk mund të luftohet me sukses imperializmi pa luftuar në të njëjtën kohë edhe oportunizmin, i cili atëherë përfaqësohej nga klikat hrushoviane e titiste.

Duhet thënë se për t'ia imponuar Partisë sonë këtë vijë antimarksiste Çu En Lai përdori dhe presionet ekonomike. Por nuk patën sukses. Komiteti Qendror i Partisë sonë qëndroi i patundur në pozitat e tij të drejta marksiste-leniniste.

Më vonë, kur strategjia e udhëheqjes kineze për afrim me hrushovianët, për shumë arsye që dihen, si mosmarrëveshjet për bombën atomike etj., dhe për të cilat do të kemi rast të flasim më vonë, nuk jepte më rezultate, udhëheqja kineze hyri në rrugën e antihrushovizmit dhe u puq me luftën e vendosur, konsekuente e të palëkundur të Partisë së Punës të Shqipërisë. (Këtu mund të futen citatet e Maos që më lexoi Ramizi lidhur me ndihmën që i ka dhënë Shqipëria Kinës.)

Ne duhet të themi në këtë material se lufta politike

dhe ideologjike e Partisë Komuniste të Kinës në akord me luftën e pandërprerë kundër hrushovianëve nga Partia e Punës e Shqipërisë nuk ishte në baza të shëndosha të mbrojtjes së marksizëm-leninizmit dhe të revolucionit. Kjo u duk në ndryshimin rrënjësor të strategjisë dhe të taktikave të Partisë Komuniste të Kinës dhe të qeverisë kineze në arenën ndërkombëtare. Ky ndryshim u bë në kuadrin e një lufte të brendshme në gjirin e Partisë Komuniste të Kinës, ku ekzistonin kontradikta të thella dhe «lulëzonin njëqind lule» e «konkurronin njëqind shkolla» dhe në udhëheqje ekzistonin, gjithashtu, si elementë prohrushovianë, ashtu edhe proamerikanë e më së fundi edhe revolucionarë.

Ne e mbështetëm Revolucionin Kulturor kinez me kërkesën e Mao Ce Dunit, i cili konkretisht i njoftoi Partisë sonë se Kina gjendej përpara një rreziku kolosal, kur nuk dihej se kush do të fitonte, socializmi apo kapitalizmi. Partia e Punës e Shqipërisë e ndihmoi Kinën dhe mbështeti vijën e përgjithshme të Revolucionit Kulturor, pavarësisht se nuk ishte dakord me shumë çështje parimore dhe me metodat që u përdorën dhe udhëhoqën këtë revolucion. Duke e mbështetur Revolucionin Kulturor Partia jonë kishte shpresë se ky do të ishte një luftë e vërtetë revolucionare e udhëhequr nga proletaria-ti kinez dhe nga pararoja e tij, Partia Komuniste marksiste-leniniste. Por ne konstatuam se ky Revolucion Kulturor përfundoi me vendosjen në Kinë të një pushteti reaksionar, antimarksist dhe antisocialist.

Partia jonë nuk ka ndërhyrë kurrë në çështjet e brendshme të Kinës, kurse udhëheqja kineze në disa momente të caktuara, që në kohën e duhur ne do t'i nxjerrim haptazi në dritën e diellit, ka ndërhyrë në mënyrë kriminale në punët e brendshme të Shqipërisë. Po të realizoheshin këto veprime të dënueshme në bashkëpunim dhe me tradhtarët shqiptarë, do të likuidohej me

siguri Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë, pavarësia dhe sovraniteti i saj.

Ne, nga ana jonë, as nuk i kemi mbrojtur, as nuk i kemi sharë gjithë ato personalitete që kanë vepruar gjatë gjithë kësaj periudhe të turbullt që ka ekzistuar në Kinë. Udhëheqja kineze nuk mund të sjellë asnjë argument të kundërt me sa thamë më lart. Ne kemi pasur dhe kemi mendimet tona, por për interes të popullit kinez ato ne nuk i kemi shprehur publikisht. Kurdoherë ne kemi ruajtur gjakftohtësinë që të mos ndërhyjmë në punët e brendshme të Kinës, por çështjet e saj të zgjidheshin nga vetë populli kinez dhe Partia Komuniste e Kinës në rru-gën e revolucionit të vërtetë proletar.

Një nga arsyet e mëdha politike dhe ideologjike të papohuara, por që e kanë shtyrë udhëheqjen kineze t'i presë ndihmën Shqipërisë, është se ajo ka dashur që ne të mbështetnim veprimtarinë e saj ilegale, jo në rrugë marksiste, por në rrugë puçiste, të mbështetnim veprimet që ajo ndërmori. Ne as nuk ia përmbushëm dhe as nuk do t'ia përmbushim udhëheqjes kineze këtë dëshirë, por mendimet tona, në kohën e duhur, do t'i shfaqim. Edhe kjo, i thashë Ramizit, është një ide që duhet të vihet në materialin që do të përgatitim.

Theksova se duhet të flasim pak edhe për çështjen e kufijve. Duhet të theksojmë se ne e kritikua qëndrimin e Maos për çështjen e kufijve, për arsye se rishikimi i kufijve pas Luftës së Dytë Botërore kishte karakter shovinist të shtetit të madh, të nacionalizmit borgjez dhe të nxitjes së luftërave në Evropë, për ndryshimin e kufijve të vendosur pas fitores së koalicionit të madh antifashist të popujve mbi fashizmin. Ky ishte njëkohësisht edhe një sulm kundër Josif Visarionoviç Stalinit, sulm që puqej plotësisht me pikëpamjet e Titos që mbështeste akuzat kundër Stalinit për «sferat e influencës», por që ai vetë dhe klika e tij u treguan se ishin me të

vërtetë elementë antimarksistë, njerëz me ndjenja të theksuara shoviniste e ekspansioniste mbi popujt e tjerë. (Këtë ta themi si ide, se të tëra këto nuk do të vihen në notën tonë, por t'i themi si mendim që mund të ngjallin interesim te të tjerët.) Maoja ka folur edhe për kufijtë e disa vendeve të Evropës.

Të përmendim edhe çështjen e rënies së Hrushovit. Të flasim për armikun e përbashkët dhe ky armik ishin Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të vihen në material arsyetimet e Çu En Lait lidhur me këtë problem. Pastaj të flitet për vizitën e Niksonit në Kinë.

Kur të flasim për ndihmat në të kaluarën, të vëmë në dukje se ne kemi luftuar kaq vjet me radhë kundër të gjithëve, kundër imperializmit amerikan dhe reaksionit për pranimin e Kinës në OKB dhe ia arritëm qëllimit.

Kur të flasim për çështjen e «tri botëve», duhet të shtrohet se si Partia jonë, ashtu edhe Partia Komuniste e Kinës, kanë pasur si parim të tyre dhe janë shprehur se nuk ekziston parti mëmë dhe parti bijë, se çdo parti ka të drejtën të ketë pikëpamjet e saj për të gjitha problemet, se një parti quhet me të vërtetë marksiste-leniniste, kur këto probleme i shikon në prizmin e marksizëm-leninizmit. Ne kemi konstatuar se gjykimet e çështjeve ndërkombëtare nga ana e Partisë Komuniste të Kinës dhe e qeverisë së Kinës në shumicën e rasteve nuk janë parë në prizmin e marksizëm-leninizmit, në interes të revolucionit dhe të luftërave nacionalçlirimtare të popujve.

Politika kineze ka qenë një politikë pragmatiste, prandaj nuk ka se si të ishte ndryshe edhe strategjia dhe taktika kineze. Për këtë arsye ne shikojmë dhe do të shikojmë edhe në të ardhmen ndryshimin prej 180 gradësh në strategjinë kineze. Këto kthesa gjoja kanë qenë marksiste-leniniste, por në realitet janë kthesa që i shërbejnë interesit të shtetit të madh kinez në kërkim të ale-

ancave me imperializmin amerikan, me socialimperializmin dhe me kapitalin botëror për krijimin e ngritjen e Kinës si një fuqi e madhe.

Të marrim çështjen e teorisë së «tri botëve». Nga ana e udhëheqjes, e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kinës, afirmohet se është Mao Ce Duni ai që e ka nxjerrë këtë teori nga një analizë gjoja objektive e situatave ndërkombëtare. Por gjithë bota e di, dhe Partia e Punës e Shqipërisë po ashtu e di, se teoria e «tri botëve», ose siç quhet teoria e «*tiers monde*», është një teori e krijuar nga reaksioni botëror. Këtë teori të «botës së tretë» Partia e Punës e Shqipërisë dhe Qeveria Shqiptare e kanë demaskuar dhe e kanë luftuar në arenën ndërkombëtare dhe nëpër mbledhje ndërkombëtare si një teori borgjezo-kapitaliste, neokolonialiste dhe raciste, që ka për qëllim të shtypë popujt që kërkojnë liri dhe pavarësi. Pra nuk është Partia e Punës e Shqipërisë që sulmon shpikësit ose mbrojtësit e këtyre teorive, por janë pikërisht këta që e kanë sulmuar më parë Partinë e Punës të Shqipërisë dhe luftën e saj kundër teorisë së reaksionit botëror.

Çështja tjetër është se as Partia e Punës e Shqipërisë, as Partia Komuniste e Kinës nuk mund të marrin urdhra dhe direktiva nga kurrkush se çfarë do të shtrojnë dhe si do t'i shtrojnë pikëpamjet e tyre në kongreset që bëjnë. Këtë bëri edhe Partia e Punës e Shqipërisë në Kongresin e saj të 7-të. Kjo ishte një rrugë logjike marksiste-leniniste, absolutisht e domosdoshme, sepse teoricienët e «tri botëve» luftojnë revolucionin, zhdukin luftën e klasave etj., etj. (Kjo duhet thënë sa për ta konkretizuar.)

Kina bën gabimin e madh që sajton pajtimin e kësaj «bote» me imperializmin. Këtë teori të tyre e dënojnë të gjithë, domethënë kinezët nuk zbuluan gjë të re, përkundrazi, sajuan akoma më keq aleancën e kësaj bote me imperializmin amerikan, për të ndjellë ndihmën e impe-

rializmit amerikan dhe për t'u bërë një fuqi e madhe kapitaliste. (Këtu duhen gjetur terma e argumente dhe të mos tjerrim fraza, por të japim disa mendime. Kështu bën përshtypje më të mirë edhe në opinionin publik botëror.)

Edhe për Titon të theksojmë që bashkimi juaj aktual me të, përmban në vetvete një rrezikshmëri të madhe për popujt e Ballkanit, për popujt jugosllavë, për popullin shqiptar, grek dhe atë turk. Kësaj çështjeje mund të shënojmë, ne do t'i rikthehemi më vonë. Kështu që ua lëmë edhe këtë në derë se për çështje të tilla do të shkruajmë artikuj të veçantë, bile edhe Titoja do të thotë: Çfarë na bëtë, tani, shqiptarët do të ngrenë buritë për aleancat që kurdism në Ballkan...

Duhet gjetur, gjithashtu, një vend ku të flitet edhe për Tregun e Përbashkët Evropian, edhe për NATO-n etj.

Mund të thuhet edhe kjo ide: Ju treguat shumë mirë se duke i prerë ndihmat Shqipërisë, do të thotë se nuk jeni dakord ideologjikisht me Shqipërinë, por, duke marrë ndihma dhe kredi të shumta nga imperializmi amerikan, nga kapitalizmi botëror dhe duke u akorduar ndihma agjentëve të tyre, si Mobutu me shokë, po vërtetoni se jeni dakord me ta, kundër një vendi socialist dhe kundër të gjitha vendeve e popujve që kërkojnë çlirim pikërisht nga imperializmi dhe nga socialimperializmi.

Në notën kineze ka një aluzion se ne, shqiptarët, veprojmë kundër Kinës për interesat e politikës sonë të brendshme dhe të jashtme.

Ne duhet të themi se një gjë e tillë tregon shpirtin intrigant të udhëheqjes kineze dhe dëshirën e saj që ta shikojë Shqipërinë të robëruar politikisht, ideologjikisht dhe ekonomikisht nga socialimperializmi sovjetik ose imperializmi amerikan dhe borgjezia reaksionare. Ju flitni kështu se mendoni që Shqipëria qenka e izoluar, që ajo merre frymë dhe rronte në sajë të ndihmës suaj dhe

tani paska mbetur në mes të rrugës e do të bjerë si një gjah në pritën e imperialistëve dhe të socialimperialistëve. Ju kujtojmë me këtë rast se çfarë kanë thënë dikur Hrushovi dhe Mikojaqi që ne do të shiteshim për «tridhjetë aspra», që ne «do të vdisnim për bukë», pas 15 ditësh, pa ndihmat sovjetike.

Por jeta tregoi se Shqipëria eci përpara me sukses të madh në ndërtimin e socializmit. Dhe kjo u bë jo në sajë të ndihmës suaj, të cilën e njohim, por në sajë të punës dhe të luftës së madhe të popullit tonë. Ndihma juaj në gjithë investimet e ekonomisë sonë përfaqëson vetëm një përqindje fare të vogël. Ne ju themi juve dhe gjithë botës se Shqipëria kurrë nuk dorëzohet te kurrkush, se ajo do të qëndrojë deri në fund armike e betuar e imperializmit, e socialimperializmit dhe e borgjezisë reaksionare botërore. As kurrizin, as kokën nuk i ka ulur kurrë Shqipëria, as në të kaluarën, as sot dhe as në të ardhmen nuk do t'i ulë. Ne ju themi se ju do të dështoni si në predikimet, ashtu edhe në intrigat tuaja, se do të dështoni, si ju, ashtu edhe të gjithë armiqtë tanë. Populli shqiptar dhe Partia e Punës e Shqipërisë do t'u tregojnë miqve dhe popujve forcën e marksizëm-leninizmit, forcën e socializmit, forcën e revolucionit.

Në luftën tonë ne do të kemi ndihmën e popujve, prandaj nuk jemi aspak të izoluar dhe do të ndërtojmë të gjitha çfarë kemi vendosur, bile edhe më tepër do të bëjmë, sepse kemi ndihmën internacionaliste të revolucionarëve të vërtetë dhe të popujve liridashës. (Në këtë pjesë duhet të jetë edhe kjo ide.)

Për ndihmat do të themi se ju paraqitni shifra, por këto janë për të impresionuar opinionin e brendshëm kinez dhe atë ndërkombëtar, se gjoja i keni akorduar Shqipërisë një ndihmë të madhe dhe, pra, Shqipëria është mosmirënjohëse për një gjë të tillë. Por këta miliardë juanë, që ju i shënoni në notë, janë llogaritur në

mënyrë të njëanshme dhe sipas dëshirës suaj. Të përdoret i tërë citati që më lexoi Ramizi për çmimet në marrëveshjen e qershorit të vitit 1968, të nënshkruar midis dy vendeve. Pasi të shkruhet ai të thuhet që ata miliarda janë që Kina i ka akorduar Shqipërisë gjatë një çerek shekulli dhe kanë nevojë të shqyrtohen. Ne themi se ju jeni shpejtuar që e keni vënë atë shifër për t'u shërbyer qëllimeve tuaja të mësipërme. E vërteta mbi këto shifra do të dalë më vonë dhe do të bëhet publike me arsyetimet tona të bazuara në çmimet ndërkombëtare.

Nga ana tjetër t'u vihet në dukje se ju thoni që na keni dërguar në Shqipëri 6 000 specialistë. Këta 6 000 specialistë, do të theksojmë ne, janë dërguar për 25 vjet. Edhe paraqitja e kësaj shifre ndjek disa qëllime të dënueshme.

E para, numri i specialistëve nuk është ekzakt, por ai numër mund të arrihet në rast se do të futim edhe pjesëmarrësit në skuadrat e futbollit, apo edhe të ping-pongut që kanë ardhur nga Kina në Shqipëri. (I them këto si ide, pastaj t'i shikojmë nëse do t'i vëmë, apo jo.)

E dyta, kjo bëhet për të thënë se gjoja shqiptarët ishin krejtësisht në mëshirën e këtyre 6 000 specialistëve kinezë, kurse në ndërtimin e veprave kanë punuar kaq e kaq specialistë dhe inxhinierë shqiptarë dhe me dhjetëra mijë teknikë të mesëm pa punën e të cilëve nuk mund të ndërtoheshin këto vepra.

Për sa u përket specialistëve të bujqësisë, kinezët nuk kanë dërguar asnjë të tillë në vendin tonë.

E treta, ju harroni të thoni se këta specialistë janë paguar për punën e tyre në mënyrë të kënaqshme me djersën e popullit shqiptar, gjë që ju nuk e përmendni, por nuk mungoni të përmendni se keni harxhuar 100 milionë juanë për të bërë eksperimente për hekurin shqiptar.

Këto ndihma, janë kredi të dhëna në bazë të rregullave, të marrëveshjeve e të detyrimeve të dyanshme,

pasi të bëhen llogaritë, ç'ju kemi dhe ç'na keni, do të paguhen. (Kjo të jetë ideja.) Pra nuk kemi të bëjmë me lëmosha të dhëna si mëshirë kristiane, por me një ndihmë me kredi që ne mendonim se na jepej në frymë internacionaliste nga një shtet socialist. Sigurisht, llogaritë do të bëhen duke pasur parasysh edhe humbjet e mëdha që i kanë shkaktuar kinezët ekonomisë sonë, duke mos i realizuar detyrimet e tyre në kohën e caktuar në marrëveshje, duke lënë një pjesë të rëndësishme të objekteve në mes, duke dërguar edhe pajisje të vjetra të përdorura për objekte të ndryshme. Pasi të llogariten të gjitha këto, atëherë do të shohim se kush në të vërtetë i ka borxhe njëri-tjetrit.

Unë mendoj se nuk kemi çfarë t'u themi tjetër hëpërhë, puna është se si të gjejmë formën e rrjedhshme e të përshtatshme për t'i shprehur gjithë këto ide që thamë.

As fraza, as propagandë të mos ketë në notën tonë, ato që do të vendosim të themi, të jenë të hidhura për revizionistët kinezë, të jenë demaskuese për ta dhe shpresëdhënëse për popujt revolucionarë. Me këtë notë që do t'i përgjigjemi udhëheqjes kineze, ne vetëm sa hapim defterin, këto që do të themi tani do të jenë titujt e kapitujve që do të shkruajmë më vonë.

Ne duhet t'i hedhim poshtë në bllok «argumentet» ekonomike të tyre; ato që vini ju në notë, për të ilustruar prerjen e ndihmave, t'u themi, janë pa baza, se nuk gjeni arsye tjetër, ose nuk guxoni t'u futeni arsyeve të vërteta. Kurse e vërteta është ndryshe dhe ne në momentin e duhur do të botojmë të gjitha dokumentet që ju kemi dorëzuar për këto çështje. Midis dy partnerëve, midis dy shteteve, diskutime për çështje konkrete ekonomike mund të lindin dhe duhet të bëhen, bile është e nevojshme që të bëhen. Ndërsa ju nuk e ndienit të nevojshme ta bënit këtë për arsye se donit të na impononit mendimet tuaja. Ju si shtet i madh, kërkesën për diskutime e konsideroni

si ultimatium. (Duhet të marrim ca gjëra si këto nga nota e tyre.)

Mua më duket se nota jonë udhëheqjes kineze duhet t'i vejë nga Komiteti Qendror i Partisë dhe nga Qeveria, se ne nuk mund të flasim për këto probleme që diskutuam duke e bërë notën vetëm në rrugën qeveritare. Ne do të themi që ju i keni drejtuar Qeverisë sonë nëpërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme një notë, në të cilën ju jeni përpjekur të kufizoheni në probleme ekonomike, sepse dëshironi të fshihni të vërtetën që përbëhet nga arsye të mëdha politike dhe ideologjike. Prandaj Komiteti Qendror i Partisë sonë dhe Qeveria jonë i drejtojnë notën e mëposhtme Komitetit Qendror të Partisë dhe qeverisë suaj. Ky dokument të mos vishet me etiketa diplomatike, por të jetë me përmbajtje të thellë dhe i drejtpërdrejtë.

DURRËS, E PREMTE

14 KORRIK 1978

### **TË JEMI KURDOHERË ME KOKË TË FTOHTË E ME ZEMËR TË ZJARRTË**

Sot pasdreke erdhi këtu, në Durrës, shoku Ramiz dhe më solli një projekt lidhur me mendimet që shkëmbyem bashkë 5-6 ditë më parë, për hartimin e përgjigjes për notën kineze, me të cilën na u komunikua prerja e të gjitha kredive civile e ushtarake dhe tërheqja e specialistëve. Këtë projekt do ta studioj përsëri me kujdes, kur të shkoj në Pogradec dhe, në qoftë se do të bëj ndonjë shtojcë ose shënim, do t'ia dërgoj përsëri Ramizit që t'i ketë parasysh kur të punojë.

Megjithatë, Ramizin e këshillova që të vazhdojë hedhjen në letër të vijës së përgjithshme të përgjigjes që do t'i japim Kinës. Përgjigjen tonë mendoj të mos e quajmë notë, por «Letër e Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe e Qeverisë së Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë drejtuar Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kinës dhe qeverisë kineze».

Ramizin e porosita që letra jonë të përpunohet me kujdes, pa ngutje. Me këtë, vura në dukje, nuk dua të them që hartimi i saj të zgjatet pa mbarim, por jo edhe me ngutje të madhe, sikur medoemos duhet të bëhet brenda dy-tri ditëve. Nuk ka rëndësi shumë nëse kjo punë bëhet pesë ditë më shpejt apo pesë ditë më vonë. Rëndësi për ne ka që ky dokument të jetë një sintezë teoriko-politike e rëndësishme, të jetë një dokument me argu-

mente dhe therës për revizionistët kinezë dhe një pasqyrë e qartë për opinionin e brendshëm dhe atë botëror mbi veprimtarinë antimarksiste të Partisë Komuniste të Kinës. Kjo ka rëndësi dhe jo të punuarit e kësaj letre me shpejtësi të madhe.

Letra, si edhe çdo punë tjetër, veçanërisht në momentet e vështira, duhet të bëhen duke ruajtur gjakftohtësinë, duke qenë me nerva të qetë, se vetëm kur je i qetë, truri punon si duhet, zbulon të gjitha shkaqet e problemet dhe bën sintezën e vërtetë të gjërave. Të nxituarit, të nxehurit, nervozizmi nuk të nxjerrin në rrugë të drejtë, përkundrazi, këto nuk tregojnë pjekuri. Mendime për një problem mund të vijnë si lumë, por ato duhet t'i shqyrtosh me gjakftohtësi dhe të zgjedhësh më racionalët prej tyre, pikërisht ato që i shërbejnë kauzës, qoftë një kauze të veçantë, qoftë një kauze të përgjithshme.

Patjetër, mendimet që na vijnë për këtë çështje, të cilat janë rezultat i refleksioneve të mëdha mbi veprimet e egra armiqësore, revizioniste të kinezëve, i thashë Ramizit, janë të tilla që të nxehin, të nevrifikosin, por në luftë asnjëherë nuk duhet të jemi nervozë. Ne duhet të jemi gjakftohtë në këtë punë, se trimëria në veprime, por edhe trimëria në mendime, kërkon gjakftohtësi, durim, reflektim të thellë, racional. Kur të gjitha këto mbahen parasysh, atëherë edhe veprimi del i përsosur, del ashtu siç duhet, i plotë, dhe sukcesi është i garantuar e i madh.

**Të jesh gjakftohtë s'do të thotë të mos jesh veprues.** Përkundrazi, gjakftohtësia të jep mundësi për një krijim racional, të shëndoshë, qoftë për një punë mendore, qoftë për një veprim praktik. Prandaj, në çdo punë, komunistët duhet të jenë të pjekur.

Në çdo gjë, neve na duhet të korrim sukseste, **të mos i lejojmë armikut as gjënë më të vogël që ai të mund ta përdorë kundër nesh.** Me këtë rast i përmenda Ramizit veprimin me mendjehetësi të Ministrisë sonë të Punëve

të Jashtme dhe të ambasadës sonë në Pekin që nuk pranuan, disa kohë më parë, notën për këto çështje të dorëzuar nga ana e Ministrisë së Jashtme të Kinës, notë që në realitet nuk ishte gjë tjetër veçse shpifje dhe sharje kundër nesh. Por, mospranimin e saj kinezët përnjëherë e përdorën sikur jemi ne fajtorë që ata veprojnë në këtë mënyrë ndaj Partisë dhe vendit tonë, sepse gjoja ata me atë notë kërkonin që të bisedonim për t'i zgjidhur të gjitha mosmarrëveshjet që kishin lindur midis nesh. Në fakt kjo notë nuk përmbante asnjë gjë të tillë, për arsye se ata (udhëheqësit kinezë), çdo marrëveshje e kishin prerë me ne, por meqenëse ne këtë notë nuk e pranuan, pra, dokumentin nuk e kemi në dorë, ata kur të duash mund të sajojnë një dokument të tillë që ta paraqesin aktin e tyre, ashtu siç ua do qejfi. Prandaj duhet vepruar me kujdes, me gjakftohtësi e pjekuri se të shpejtuarit, të nxehurit dhe nervozizmi nuk sjellin gjëra të pëlqyeshme.

Ne, udhëheqësit kryesorë veçanërisht, por edhe të gjithë të tjerët, për çdo veprim duhet të mendojmë kurdoherë me kokë të ftohtë e me zemër të zjarrtë. Po të mendojmë kështu, atëherë do të vëmë në veprim si duhet dhe shokët në punët e tyre, që edhe ata, nën shembullin tonë, të jenë të matur, t'i gjykojnë çështjet thellë, të marrin vendime jo të shpejtuara, por të drejta e të menduara mirë. Me njëri-tjetrin duhet të sillen jo me nervozizëm, por, nën shembullin tonë, edhe ata të sillen shoqërisht me vartësit, t'ua kërkojnë në mënyrë shoqërore mendimet, t'ua kërkojnë se shërbejnë për zhvillimin e situatave në mënyrë pozitive dhe ndihmojnë udhëheqjen dhe vetë vartësit dhe jo për të mos ua marrë parasysh. Kjo gjë ka rëndësi të veçantë në marrëdhëniet midis udhëheqësve, shokëve dhe vartësve. Në qoftë se mendimet e të tjerëve ne i dëgjojmë veresie ose i presim me këmbët e para apo me mendjemadhësi, atëherë bëjmë një gabim të madh parimor dhe praktik dhe arrijmë në një rrugë

pa krye, në një rrugë ku do të dominojnë mendjemadhësia e arroganca, që nuk i shërbejnë, por e dëmtojnë shumë çështjen tonë. E kam theksuar vazhdimisht, se kjo mënyrë mendimi dhe veprimi te kushdo e në çdo moment që të shfaqet, duhet të shpjegohet me gjakftohtësi.

Veprimeve si ato që përmenda më lart, t'u pritet hovi, të mos kihet frikë për t'i kritikuar ato, se veprimet, qoftë tonat, pra të udhëheqjes kryesore, qoftë të shokëve të tjerë, janë të gjitha në shërbim të socializmit dhe për të mirën e socializmit. Prandaj kur problemet studiohen mirë, kur sjelljet janë të mira, kur qëndrimet janë të përshtatshme, edhe rezultatet patjetër do të jenë të mira, të përshtatshme, me vend, edukuese dhe frytdhënëse.

M'u desh t'i theksoja këto këshilla me qëllim që Ramizi dhe shokët e tjerë t'i kenë parasysh në punën dhe në sjelljet e tyre, se sidomos në momente si këto që po kalojmë, duhet kurdoherë të ruajmë gjakftohtësinë, pse kjo na ka bërë të ecim gjithmonë në rrugë të drejtë, të mos gabojmë asnjëherë si në planin e brendshëm, ashtu dhe në atë të jashtëm. Me gjakftohtësinë tonë ne nuk duam të tregojmë një situatë false. Ne jemi të qetë, pse jemi në të drejtën tonë, se problemet i kuptojmë dhe i zgjidhim drejt, se veprimet antimarksiste dhe antishqiptare të udhëheqjes kineze i kishim parashikuar, bile, për ta përballuar këtë situatë, ne që më përpara kemi marrë masa, të brendshme dhe të jashtme. Opinioni ynë i brendshëm dhe ai ndërkombëtar janë në korent të qëndrimeve tona politike, të pikëpamjeve tona ideologjike, të kundërshtimeve tona ideopolitike ndaj udhëheqjes së Partisë Komuniste të Kinës, teorive të saj kundërrevolucionare, antimarksiste.

Revizionistët kinezë, në fakt, tash na i prenë kreditë, por ne kemi kohë që e kemi parashikuar se do të bëhej një veprim i tillë nga ana e tyre, se shikonim qëndrimet e tyre antimarksiste dhe parashikonim që kjo

rrugë do t'i çonte Partinë Komuniste të Kinës dhe qeverinë kineze, në mos sot, nesër, në një situatë që nuk do të duronin dot të vazhdonin ta ndihmonin Shqipërinë socialiste me kreditë që ia kishin caktuar zyrtarisht.

Pra, asgjë të papritur nuk kishte për ne, prandaj me gjakftohtësi dhe me bindje të plotë kemi vepruar dhe do të veprojmë, se gjithmonë vija jonë ka qenë e drejtë. Asnjë arsye nuk ka që të krijohet përshtypja sikur ne jemi në ethe, në tension për këtë veprim të palës kineze kundër Shqipërisë. Temperatura jonë është normale dhe me një temperaturë të tillë ne ecim përpara e ndërtojmë vetë socializmin.

Prerja e të gjitha ndihmave Shqipërisë nga Kina dhe tërheqja e specialistëve nga vendi ynë vërtetojnë tezat tona të drejta teoriko-politike dhe demaskojnë pikëpamjet kineze të «botës së tretë» e të «botës së paangazhuar». Ç'tregon ky akt arbitrar, brutal i Kinës kundër Shqipërisë? Ky tregon se ideja e vendeve të «botës së tretë» dhe e «vendeve të paangazhuara» nga ana e udhëheqësve kinezë është një blufë, se ata nuk pranojnë që një vend të ketë politikën e vet, të ketë pikëpamjet e veta. Kina nëpërmjet ndihmave është orvatur që ne të na bënte të varur prej saj dhe të vepronim siç donte ajo. Pra, ideja e «pavarësisë», e «mosangazhimit» të vendeve që pretendojnë me të madhe kinezët dhe miku i tyre Tito është një falsitet. Vetë ata me veprimet e tyre i demaskojnë këto ide të rreme të teorisë së «botës së tretë» dhe të «vendeve të paangazhuara».

Fakt është se Kina me këtë veprim u armiqësua me popullin shqiptar dhe nuk krijoi atë unitet, që ajo pretendon të ketë «bota e tretë» kundër socialimperializmit sovjetik. **Kina me këtë akt kundër Shqipërisë tregoi se donte të na bënte të varur nga ajo, që ne të bënim pjesë në «botën e tretë», domethënë të vareshim nga ky vend që ka bërë të tijën teorinë e «tri botëve».**

Prerja e ndihmave vendit tonë nga ana e Kinës, si dhe tërheqja e specialistëve, vërtetojnë katërcipërisht të gjitha mendimet e drejta e parashikimet e Partisë sonë dhe demaskojnë vetë falsitetin e pikëpamjeve të Partisë Komuniste të Kinës në veçanti dhe të revizionizmit modern në përgjithësi. Ky akt antimarksist i udhëheqësve kinezë vërteton gënjeshtrenë e tyre, qëllimet e ulëta të tyre në dhënien e ndihmave vendeve e popujve të ndryshëm. Ata nëpërmjet atyre pak ndihmave që japin, kanë për qëllim t'i bëjnë popujt të varur prej tyre, t'i bëjnë skllëvër të ideologjisë së tyre reaksionare, për t'i çuar këta popuj në veprime antinjerëzore, antipopullore, kundër interesave të vendeve të veta.

Një gjë të tillë Partia jonë dhe ne, ushtarët e saj, e kemi të qartë.

POGRADEC, E HËNE

17 KORRIK 1978

### OPINIONI BOTËROR ËSHTË NË FAVORIN TONË

Siç kam shkruar, ne jemi duke përgatitur letrën e përgjigjes për notën që na dërguan kinezët. Ajo do të jetë therëse për ta dhe do të ketë jehonë shumë të madhe. Opinioni botëror do të na përkrahë. Kam këtë bindje se vetëm me njoftimin që u dha, në emër të ATSH-së<sup>1</sup>, ku theksohej veprimtaria prej shovinizmi e fuqisë së madhe, arroganca e qeverisë kineze, opinioni i diplomatëve nga të katër anët e botës, i shprehur në bisedime me diplomatët tanë, është në favorin tonë. **Të gjithë e dënojnë qëndrimin armiqësor të Kinës ndaj nesh. Politika e Kinës cilësohet si një nga më absurdet që mund të ketë. Historia ka njohur raste që një shtet i madh kapitalist të ketë mbajtur një qëndrim të tillë ndaj një shteti të vogël, por jo ndaj një shteti që vite të tëra e ka mbrojtur atë fuqimisht, kur gjithë bota e kishte izoluar.**

Pra, opinioni botëror është në favorin tonë dhe e dënon Kinën, kur ne akoma nuk e kemi botuar letrën tonë në përgjigje të notës kineze. Por, kur të botohet kjo letër me argumentime të shëndosha, me dokumente dhe me fakte të pakundërshtueshme, me të vërtetën mbi marrëdhëniet midis Kinës dhe Shqipërisë, atëherë opinioni botëror akoma më shumë dhe më me rreptësi do ta dënojë

<sup>1</sup> Ky njoftim u botua në gazetën «Zëri i popullit» më 13 korrik 1978.

politikën fashiste, imperialiste të Kinës. Të gjithë popujt e botës do ta dënojnë me forcë këtë politikë, por veçanërisht do ta dënojnë popujt e vegjël, popujt e së ashtuquajturës botë e tretë, të cilën Kina e ka marrë nën shtetull gjoja që ta drejtojë, por në fakt që ta manipulojë për interesat e saj. Këta popuj do të egërsohen e nuk do të kenë as besimin më të vogël të fjalët e Kinës, të politika e saj, dhe atë pak ndihmë që Kina do t'u japë atyre, do ta shikojnë me një mosbesim të madh, sepse kur ajo i preu ndihmat Shqipërisë, që me dekada e ka mbrojtur atë fuqimisht, ndërsa të tjerët e kishin izoluar, atëherë ç'mund të bëjë Kina me Somalinë, me Togon, me iksin apo me ipsilonin? Kështu që me këtë rast, me botimin e letrës sonë drejtuar Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kinës dhe qeverisë kineze pas veprimit armiqësor të tyre ndaj vendit tonë, gjithë popujt do të mësojnë të vërtetën deri në palcë të qëllimeve imperialiste të shtetit të madh kinez dhe do të përfitojnë shumë nga qëndrimi burrëror, marksist-leninist i Partisë së Punës të Shqipërisë dhe i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë.

Puna jonë, politika jonë, qëndrimet tona ideologjike dhe rezultatet ekonomike aktuale edhe në të ardhmen do t'i vërtetojnë botës se socializmi jo vetëm nuk është zhdukur, se marksizëm-leninizmi jo vetëm nuk është vjetruar, por një vend socialist i vogël, si Shqipëria, që udhëhiqet nga marksizëm-leninizmi, të cilit i qëndron besnik deri në fund, po e ndërton socializmin me forcat e veta, pa marrë kredi nga kurrkush. Izolimi i pretenduar i popullit shqiptar mbështetet në atë ide false, që asnjë shtet në botë, sipas borgjezisë reaksionare, nuk mund të jetojë pa marrë kredi dhe pa u bërë skllav i një fuqie të madhe. Kurse popujt e botës që luftojnë për liri, për pavarësi, për sovranitet, dhe këta popuj janë shumica, gjithë revolucionarët, kudo që ndodhen, janë kundër pikëpamjeve skllavëruese të kapitalizmit botëror ndaj Shqipërisë

socialiste. Përkrahja e popujve të botës për vendin dhe Partinë tonë na bëjnë që të mos jemi, ashtu si nuk kemi qenë kurrë, të izoluar. Përkundrazi, kjo përkrahje na fuqizon gjithnjë e më shumë në luftën tonë për t'u bërë ballë pikërisht ideve regresive, reaksionare, shtypëse, kolonialiste dhe veprimeve praktike të kolonialistëve të vjetër e të rinj.

Shqipëria socialiste dhe Partia e saj e Punës jo vetëm që nuk do të dëmtohen nga ky akt armiqësor e fashist i Kinës, por përkundrazi, do të forcohen e do të rrezatojnë në botë idenë e forcës së madhe të marksizëm-leninizmit dhe të socializmit, që përfaqësohet nga një Parti e vogël dhe nga një shtet i vogël, por që shquhet dhe reziston kundër kësaj rryme të egër të një shteti të madh.

Për këtë arsye vendi ynë dhe Partia e Punës e Shqipërisë do të jenë e do të qëndrojnë kurdoherë një fener i socializmit në botë, që do t'u ndriçojë rrugën popujve, të cilët do të kuptojnë me fakte forcën e socializmit, forcën e marksizëm-leninizmit dhe forcën e një populli që ka vendosur të rrojë i lirë, i pavarur e sovran, të një populli që dëshiron miqësi me popujt e tjerë, të një populli që ndihmon luftërat e popujve për çlirim nga zgjedha e kapitalit botëror e nga intrigat e pseudosocialistëve dhe të pseudomarksistëve, siç janë revizionistët modernë sovjetikë, titistë, kinezë, eurokomunistë etj.

Të gjithë këta kanë bërë aleanca pseudomarksiste, të veshura me rroba marksiste, marksiste specifike, siç thohet. Prandaj lufta e popullit shqiptar dhe e Partisë së Punës të Shqipërisë është një luftë gjigante, mund të them, se drejtohet jo vetëm kundër kapitalizmit e ideologjisë së tij, por gjithashtu edhe kundër një mashtrimi të madh të ri, kundër revizionizmit modern hrushovian, titist, kinez, eurokomunist etj., që janë ngritur për të shuar revolucionin proletar e për të shkatërruar marksizëm-leninizmin.

POGRADEC, E HËNE

17 KORRIK 1978

### KONFLIKTE TË SHËMTUARA

Konflikti midis vietnamezëve, nga njëra anë, dhe kamboxhianëve e kinezëve, nga ana tjetër, po merr përpjesëtime të mëdha. Nga lajmet e agjencive zyrtare vietnameze, kamboxhiane dhe nga ato të HSINHUA-së del qartë se ky konflikt nuk është vetëm politiko-ideologjik, por ka arritur në shkallën e një goditjeje të armatosur. Në fakt, në kufirin vietnamezo-kamboxhian ka përlëshje me armë, me topa, atje vriten njerëz dhe digjen fshatra.

Ky konflikt, në qoftë se nuk gabohet, ka më tepër se një vit që po zhvillohet. Ne nuk i kemi pasur të qarta arsyet e këtij konflikti, por dinim se udhëheqja e Kamboxhias, Pol Pot-Jeng Sari me ardhjen në fuqi, mori një varg masash të atilla që linte të kuptohej se nga ana e saj do të zhvilloheshin veprime të papjekura, skandaloze e të rrezikshme kundër vendeve fqinje.

Përveç kësaj, midis Kamboxhias dhe Vietnamit janë zhvilluar përpjekje në kufi për pretendime territoriale, si nga njëra anë, ashtu edhe nga ana tjetër; kamboxhianët, nga ana e tyre, hidhnin komunikata sikur të zhvillonin një luftë kundër hitlerianëve. Në këto komunikata raportohej se vriteshin me mijëra kamboxhianë nga vietnamezët, kurse vietnamezët pretendonin se sulmet e kamboxhianëve u shkaktonin atyre vrasje në njerëz dhe dëgjie fshatrash.

Natyrisht, në këto situata ne nuk mund të mbanim

qëndrim, por mirë nuk na erdhi dhe shkruam një artikull ku thoshim që mosmarrëveshjet midis këtyre dy vendeve duhej të zgjidheshin në mënyrë paqësore. Ne e dinim që artikulli ynë nuk do të kishte ndonjë efekt në këtë konflikt, i cili ka rrënjë të thella, por, Partia jonë, si një parti marksiste-leniniste në fuqi dhe vendi ynë, si një vend socialist, e kanë për detyrë të thonë mendimin e tyre për një konflikt të tillë të armatosur, ku vriten popuj vëllezër, që luftuan kundër të njëjtit armik, imperializmit amerikan.

**Në këtë konflikt duket qartë se prapa vietnamezëve janë revizionistët sovjetikë, nga ana tjetër janë kinezët që shtyjnë urët te kamboxhianët.** Kina, pra, e mbështet fort Kamboxhian në luftën kundër Vietnamit.

Revizionistët e Pekinit po e provokojnë haptazi Vietnamin dhe ky provokim bëhet nëpërmjet pakicave kineze, që quhen «hoa» të cilat ndodhen prej kohësh në Vietnam.

Siç e kam thënë në shkrimet e mia të mëparshme, vietnamezët kanë bërë disa reforma për konfiskimin e pasurive të personave që janë majmur me gjakun e popullit dhe me ndihmën e imperialistëve amerikanë. Këto reforma kanë prekur edhe tregtarë «hoa». Ky ishte një shkak që gjetën kinezët për të acaruar gjendjen me Vietnamin dhe për ta ndihmuar haptazi Kamboxhian në konfliktin me të.

Aktualisht çështja, siç i thonë një fjale, ka ardhur në thikë e në pikë nga ana politike dhe nga propaganda që zhvillohet nga të dyja anët, qoftë nga Pekini, qoftë nga Vietnamit, sikur të dy këto vende të ishin plotësisht në luftë. Dhe në fakt ato janë në luftë, se Kina në kufirin vietnamez ka grumbulluar ushtarë, po ashtu dhe Vietnamit ka mobilizuar forcat e tij në kufirin me Kinën dhe tash po bëhen tratativa për tërheqjen e kinezëve «hoa» nga Vietnamit. Për këtë qëllim në Vietnam kanë vajtur dy

vaporë nga Kina. Këta vaporë qëndrojnë në radë, se delegacionet vietnameze duhet të merren vesh me ato të dërguara nga Pekini për transportimin e këtyre emigrantëve.

Këtë gjë, që do të them më poshtë, e lexova në një artikull të «Zhenminzhibaos», ku jepej një arsye absurde që shkaktoi mosmarrëveshje sa arriti puna deri në tërheqjen e atyre kinezëve, që banojnë në Vietnam. Vietnamezët pretendojnë se janë bërë 20 mbledhje pa fryt, se janë gati të çojnë me vaporët kinezë të gjithë ata nënshetas vietnamezë ose jovietnamezë me origjinë kineze që dëshirojnë të shkojnë në Kinë. Kurse kinezët nga ana e tyre pretendojnë në mënyrë absurde se Vietnamit duhet të pranojë se i dëbon këta vietnamezë ose jovietnamezë me origjinë kineze nga Vietnamit. Këtë gjë, natyrisht, vietnamezët nuk e bëjnë dhe prandaj vazhdon konflikti.

Ky është një pretekst, se **Kina ka tendenca të theksuara të shtetit të madh, të një shteti që kërkon t'i imponojë vullnetin, politikën dhe demagogjinë e tij fashiste gjithë Azisë Juglindore.** Domethënë Kina do që të ketë influencë në gjithë Vietnamin dhe në të gjitha vendet e tjera aziatike, si në Filipine, në Tajlandë, në Birmani etj., deri edhe në Zelandën e Re. Dhe të gjithë popujt e këtyre vendeve që nuk dëshirojnë dhe nuk pranojnë në asnjë mënyrë të jenë nën influencën e diktatit të Kinës, quhen dhe konsiderohen nga kjo e fundit si agjentë të sovjetikëve. Pra, për hegjemonistët kinezë, cilido që kundërshton pikëpamjet e tyre politike, ideologjike, është me revizionistët sovjetikë. Kjo është një taktikë absurde dhe nga më të poshtrat që mund të përdoret nga një vend.

Ne nuk ekskludojmë faktin që udhëheqja vietnameze të ketë prirje dhe simpati për udhëheqjen revizioniste sovjetike dhe unë mendoj se ka, por, që të arrihet deri atje ku venë kinezët, saqë të grumbullojnë forca në kufi për të trembur Vietnamin, «se i nënshtrohet politikës

hegjemoniste sovjetike», kjo është e papranueshme. Them është e papranueshme edhe për arsyen se konstatojmë që akuza të tilla armiqësore fashiste Kina i bën edhe kundër nesh, ku nuk ka as pakica të saj, as mosmarrëveshje me të për shkak të pakicave.

Prandaj politika e Kinës kundër Vietnamit, kundër nesh, dhe nesër edhe kundër popujve të tjerë që nuk do t'u binden pikëpamjeve dhe diktatit të saj, e demaskon atë katërcipërisht në opinionin botëror. Në fakt opinionin botëror i dënon të gjitha këto veprime, gjithë këtë politikë shoviniste të shtetit të madh dhe e ka të qartë se Kina përpiqet me mjetet më të ndyra e kundërrevolucionare që të bëhet një superfuqi. Partia jonë nuk u gabua kur parashikoi se Kina për t'u bërë superfuqi u mbështet fuqimisht tek imperializmi amerikan dhe te gjithë reaksioni botëror.

Aktualisht imperializmi amerikan i jep Kinës teknologji të re dhe kredi të panumërta për ta armatosur. Këto kredi ai ia jep Kinës jo për sytë e bukur të Hua Kuo Fenit e të Ten Hsiao Pinit, po sepse nga kapitalet që do të investojnë Shtetet e Bashkuara të Amerikës në Kinë, imperializmi amerikan do të nxjerrë fitime kolosale për veten e vet dhe do ta nxitë Kinën kundër Bashkimit Sovjetik. Domethënë **imperializmi amerikan punon që midis Kinës dhe Bashkimit Sovjetik të krijohet një situatë e tillë e nderë, e cila mund të arrijë edhe në shpërthimin e një konflikti të armatosur.** Kjo politikë që ndjekin imperializmi amerikan dhe reaksioni botëror ndaj Kinës është e qartë.

Tash imperializmi amerikan dhe reaksioni botëror e kanë vënë Kinën të ecë në këtë brazdë. Kina nuk mund të dalë dot nga një situatë e tillë veçse po të ngjasë një kthesë rrënjësore 180 gradëshe, duke shtypur këta kundërrevolucionarë fashistë që kanë ardhur në fuqi në krye të partisë dhe të popullit kinez. Por, një gjë e tillë nuk

do të ngjasë menjëherë. Midis fraksioneve reaksionare fashiste, që ekzistojnë sot në Kinë mund të krijohen kontradikta të thella, të cilat do të rezultojnë në puçe të reja, por përsëri ai puç që do të fitojë, do të ketë po këtë orientim që ka sot grupi udhëheqës. Duhet të ngrihet në këmbë një forcë e madhe popullore revolucionare që ta likuidojë këtë situatë në Kinë.

Për sa na përket neve, tani jemi duke përgatitur përgjigjen e letrës që do t'i drejtojmë udhëheqjes kineze mbi prerjen e kredive e të ndihmave dhe tërheqjen e specialistëve nga Shqipëria.

POGRADEÇ, E MËRKURË

19 KORRIK 1978

## BISEDË E NJË ZYRTARI VIETNAMEZ ME AMBASADORIN TONË

**Mosmarrëveshjet midis Kinës dhe Vietnamit po thellohen çdo ditë e më shumë.** Revizionistët e Pekinit po vjellin vrer kundër popullit heroik vietnamez, e provokojnë atë, e akuzojnë se bën lojën e socialimperializmit sovjetik dhe se shtyp minoritetin kinez në Vietnam. Kina, gjithashtu, e kërcënon Vietnamin me forcat ushtarake që ka grumbulluar në kufirin me të, shkel hapësirën ajrore dhe nxit Kamboxhian në luftën kundër tij, duke pretenduar se Vietnam i lufton për hegjemoni në Azinë Juglindore, domethënë se Vietnam i kërkon të bashkojë nën drejtimin e tij gjithë vendet e Azisë Juglindore, si: Kamboxhian, Laosin, Tajlandën e, kushedi, edhe më tutje.

Pra, kësaj «hegjemonie» të Vietnamit, Kina i kundërvë hegjemoninë e saj. Është e qartë se Kina të gjitha këto i bën për arsye se Vietnam i nuk dëshiron t'i nënshtrohet diktatit kinez. **Kina kërkon që t'i imponojë vullnetin e fuqisë së madhe një popull që ka luftuar heroikisht për lirinë, pavarësinë dhe sovranitetin e tij, t'i imponojë atij politikën e saj të aleancës me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe me gjithë reaksionin botëror, gjoja kundër socialimperializmit sovjetik.**

Aktualisht, kur Kina po mban një qëndrim kaq të

poshtë ndaj Vietnamit dhe i ka acaruar në kulm marrëdhëniet me të, ne shkruam dhe botuam artikullin me titull: «Jashtë duart e imperialistëve nga Vietnamit», artikull që bëri një jehonë të madhe në botë. Qëndrimi ynë i drejtë, i shprehur, si kurdoherë, hapur edhe në këtë artikull, për konfliktin vietnamezo-kamboxhian, i acaroi kinezët kundër nesh dhe afroi me ne vietnamezët. Më parë vietnamezët mbanin një qëndrim të vakët ndaj nesh, për të mos thënë të ftohtë, për arsye se udhëheqja vietnameze ka prirje drejt miqësisë me udhëheqjen sovjetike. Sa është thelluar kjo miqësi dhe sa i është nënshtruar udhëheqja vietnameze diktatit sovjetik, këtë nuk e dimë, por mund të themi se udhëheqja sovjetike nuk mungon të influencojë mbi udhëheqjen vietnameze, veçse në këtë drejtim ne kemi një rezervë. Duke ditur që Vietnamit luftoi me aq heroizëm dhe ashpërsi për çlirimin e tij, që ky të bëhej i pavarur dhe sovran nga imperializmi amerikan, nuk na e merr mendja që po ai Vietnam të bëhet Bullgaria e Azisë Juglindore ndaj udhëheqjes socialimperialiste të Krëmlinit.

Sidoqoftë, situata është kjo, që pas këtij qëndrimi të drejtë që mbajtëm ne ndaj Vietnamit, ndërhyrjeve kineze dhe luftës agresive të Kamboxhias të mbështetur nga kinezët kundër Vietnamit, porta e udhëheqjes vietnameze u hap disi për ne dhe filluan konfidencat zyrtare.

Ambasadori ynë në Vietnam është thirrur shumë herë në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Vietnamit dhe është yënë në korent për situatat që po zhvillohen midis Kinës, Vietnamit dhe Kamboxhias, por këtë herë, para dy ditësh, këto informacione ishin më të plota dhe kishin për objekt të tregonin lidhjet e mëparshme të Vietnamit me Kinën e të na vinin në dijeni për mbrapshtitë e politikës kineze, veçanërisht gjatë luftës vietnamezo-amerikane, gjatë asaj periudhe të vështirë nëpër të cilën kalonte populli vietnamez.

Gjithashtu ambasadori ynë na informon se zëvendës-drejtori i Drejtorisë së Jashtme të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Vietnamit i ka thënë këtij se kinezët po bëjnë presione të mëdha ndaj tyre. Kinezët ai i cilësoi feudalë dhe këta feudalë po e sulmojnë Vietnamin. Ata e kanë sulmuar edhe shumë herë më përpara këtë vend, prandaj në masat e popullit vietnamez ka urrejtje për ta. Megjithatë ne, — vazhdoi ai, — i kemi edukuar kurdoherë kuadrot tanë që ta ruajnë miqësinë me Partinë Komuniste të Kinës dhe me popullin kinez. Këto, — i theksoi ai ambasadorit tonë, — janë parime internacionaliste proletare që ne i mbrojmë dhe i zhvillojmë. Ne, — ka thënë më poshtë ai, — në çështjen e ruajtjes dhe të zbatimit të parimit të internacionalizmit proletar ndjekim mësimet e Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit.

Populli kinez dhe shumë anëtarë të Partisë Komuniste të Kinës kanë një vlerësim të lartë për Vietnamin, i tha funksionari vietnamez ambasadorit tonë, prandaj vietnamezëve u vjen keq që në Kinë ekzistojnë personalitete udhëheqëse të partisë dhe të shtetit që mendojnë ndryshe, domethënë që kanë ndjenja armiçësore ndaj Vietnamit. Ai vuri në dukje, në bisedë me shokun tonë, se në vitin 1954 disa personalitete kineze (të cilave nuk ua zuri emrin në gojë, por ne i dimë që këto janë personalitetet kryesore, që nga Mao Ce Duni e Çu En Lai), na detyruan të firmosnim marrëveshjen e Gjenevës. (Dihet se në Gjenevë në korrik të vitit 1954, ku kishin shkuar përfaqësues nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Anglia, Franca, Bashkimi Sovjetik dhe Kina, u vendos armëpushimi, ndërprerja e luftës në Indokinë, konkretisht në Vietnam. Nga Kina atje shkoi vetë Çu En Lai, kurse nga Bashkimi Sovjetik shkuan Hrushovi tok me Bulganinin.) Në atë kohë, — i tha zëvendës-drejtori ambasadorit tonë, — në luftën kundër imperialistëve francezë ne

kishim korrur fitoren e Dien Bien Fusë dhe ishim në gjendje të çlironim gjithë Vietnamin, por me marrëveshjen e Gjenevës Vietnami u ndal në rrugën e tij.

Edhe revolucioni në Kamboxhia hasi në të njëjtën vështirësi, sepse personalitetet kineze, — u shpreh diplomati vietnamez, — ishin me vijën e Hrushovit dhe kishin frikë nga imperializmi amerikan. Ne, gjithashtu, kishim kërkuar që të dërgonim disa divizione për të ndihmuar shokët kamboxhianë, se kinezët nuk ndihmonin, por këta na e ndaluan, — vazhdoi zëvendës drejtori i Drejtorisë së Jashtme të KQ të Partisë Komuniste të Vietnamit, — dhe ne akuzoheshim nga kamboxhianët se nuk i ndihmonim ata në luftën e tyre kundër imperializmit amerikan. Ne s'kishim si të mos u thoshim atyre që janë kinezët që na ndalojnë t'ju ndihmojmë.

Në vitin 1962 dhe më 1965 në takimet me Çu En Lain, vietnamezët i kanë thënë atij se udhëheqja kineze e kishte penguar luftën e tyre kundër francezëve në vitin 1954 dhe i kishte detyruar të firmosnin marrëveshjen e Gjenevës, duke e dëmtuar në këtë mënyrë rëndë Vietnamin. Çu En Lai e pranoi këtë kritikë dhe bëri njëfarë autokritike, iu tha ambasadorit tonë. Ne gjithashtu, — vazhdoi shoku vietnamez, — i propozuam Çu En Lait që t'u shpjegonte shokëve kamboxhianë arsyet pse nuk dërguam ndihma për ta. Në vitin 1959, — vazhdoi ai, — Plenumi i 15-të i Komitetit Qendror të Partisë së Punonjësve të Vietnamit aprovoi rezolutën për të zhvilluar luftën e armatosur kundër regjimit reaksionar të Ngo Din Diemit. Pas kësaj rezolute, ne, — vuri në dukje vietnamezi, — filluam luftën në Jug, duke ngritur frontin për çlirimin e Jugut. Mao Ce Duni nuk ishte dakord me këtë, — theksoi ai, — dhe na tha me urrejtje se shokët vietnamezë, duke vepruar kështu, po na shtynjë ne në një pozitë të vështirë dhe po na hedhin në pasivitet. Mao Ce Duni, i tregoi më poshtë funksionari vietnamez ambasa-

dorit tonë, na këshilloi që ne nuk duhet të bëjmë luftë të madhe, jo luftë nacionalçlirimtare, por vetëm luftë me grupe të vogla.

Kjo është teoria e famshme e Mao Ce Dunit, e luftës me guerilje dhe jo e luftës frontale. Kjo është «strategjia e madhe» e tij që thotë: Lëre qenin të futet brenda në shtëpi, pastaj merr shkopin dhe rrihe, domethënë tërhiq, tërhiq, tërhiq. Këtë taktikë dhe këtë strategji Çu En Lai ia propozoi edhe Beqir Ballukut, i cili fshehurazi nga ne hartoi planin strategjik të tërheqjes në male, në rast të një sulmi nga jashtë kundër vendit tonë dhe të bashkoheshim kështu me Jugosllavinë. Pra, thëniet e zëvendës drejtorit të Drejtorisë së Jashtme të KQ të Partisë Komuniste të Vietnamit kanë një vërtetësi të plotë, se strategjia dhe taktikat kineze janë të njëjta.

Kinezët, — vazhdoi t'i tregonte ai ambasadorit tonë, — na këshilluan, gjithashtu, që të mos dërgonim forca ushtarake në Jug të vendit dhe po kështu na ndaluan që të ndihmonim Laosin e Kamboxhian në luftën e tyre. Ne ndjekim parimin se, ku ka armiq, atje duhet bërë luftë; imperializmi amerikan është i fortë, por ne nuk e kemi frikë. Ndihma për Laosin dhe Kamboxhian, — vuri në dukje ai, — ishte për ne një detyrë internacionale që duhej ta kryenim, por kinezët na ndaluan të luftonim kundër imperializmit amerikan deri edhe për çlirimin e Vietnamit të Jugut.

Pra, nga të gjitha këto që mësojmë, vërtetohen parashikimet dhe pikëpamjet e Partisë sonë se **kinezët ndiqnin rrugën e miqësisë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe, në këtë rast, nuk donin që vietnamezët të zhvillonin një luftë frontale kundër imperialistëve amerikanë, por vetëm të hidhnin disa pushkë kaçakçe kundër tyre.**

Kinezët, — vazhdoi vietnamezi, — kishin frikë nga lufta jonë kundër imperializmit amerikan dhe klikave në fuqi, kishin frikë se revolucioni në vendet e Indokinës

ishte i fortë. Në vitin 1964, — shtoi ai, — ndodhi incidenti i Tonkin. Në këtë kohë një grup gjeneralësh kinezë erdhën për vizitë në Vietnam dhe na thanë se imperialistët amerikanë do të sulmojnë Vietnamin e Veriut dhe se Kina do të na ndihmojë me avionët e saj. Por, kur delegacioni u kthye në Kinë, Mao Ce Duni tha: Mos veproni kështu! Kështu që, kur imperialistët amerikanë filluan bombardimet në Veri të vendit tonë, kinezët qëndruan në heshtje, bile Mao Ce Duni deklaroi: Ata që do të prekin Kinën, edhe ne do t'i prekim. Kjo donte të thoshte: Në qoftë se imperializmi amerikan prekte Vietnamin, por jo Kinën, kinezët do të heshtnin. Me fjalë të tjera, Kina nuk do ta ndihmonte Vietnamin në këtë drejtim.

Zëvendës drejtori vietnamez gjatë bisedës me ambasadorin tonë tha, gjithashtu, se në vitet 1965-1966 kinezët dërguan disa punëtorë gjoja për riparimin e rrugëve në zonën e veriut. Qëllimi i vërtetë i tyre ishte që të dërgonin më vonë trupa ushtarake në këtë zonë. Në fund të vitit 1966 ata i tërhoqën punëtorët që kishin dërguar në Vietnam për të marrë pjesë në luftë kundër njëri-tjetrit gjatë Revolucionit Kulturor. Në janar të vitit 1971, shtoi ai, Çu En Lai erdhi vetë në Vietnam dhe në shkurt të po këtij viti në Pekin vajti Kisingeri, kurse në korrik, po të vitit 1971, vajti Niksoni. Çu En Lai na tha se mund t'i çonim të gjitha trupat ushtarake në Jug, ndërsa në Veri do të qëndronin trupat kineze. Duket qartë, theksoi funksionari vietnamez, që kinezët donin ta bënin Vietnamin vatrë shkëmbimi. Ne iu përgjigjëm Çu En Lait se ishim aq të fortë sa që të luftonim vetë kundër amerikanëve dhe trupat kineze nuk duhet të vinin në Veri. Ne i thamë, gjithashtu, atij se ju do të bisedoni me Niksonin, por çështjen e Vietnamit nuk duhet ta prekni. Kështu u përcuall Çu En Lai nga ana jonë për t'u kthyer në Kinë.

Komunikata e Shangait, — tha zëvendës drejtori, — e nënshkruar nga udhëheqësit kinezë me Niksonin, është

një kompromis midis Kinës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Në këtë komunikatë thuhet se normalizimi i marrëdhënieve midis Kinës dhe Shteteve të Bashkuara varet nga zhvillimi i gjendjes në Azinë Juglindore, gjë që do të thotë se kinezët përdornin, si monedhë shkëmbimi në pazarllëk, revolucionin dhe pozitën e Azisë Juglindore.

Në kohën e bisedimeve të Parisit, në mars të vitit 1968, ne, — vazhdoi ai, — mendonim se kryesore ishte lufta me pushkë dhe jo rruga diplomatike. Ai shtoi më tej se ne vajtëm në ato bisedime për të demaskuar fytyrën e vërtetë të imperializmit amerikan. Unë, — theksoi vietnamezi, — isha anëtar i delegacionit së bashku me shokun Huan Tri, sekretar i Komitetit Qendror dhe drejtor i Drejtorisë së Jashtme të Komitetit Qendror të Partisë sonë. Delegacioni ynë kaloi nga Pekini. Këtu kinezët jo vetëm nuk na pritën, por na lanë edhe dy ditë pa bukë. Në vitin 1975, kur u nënshkrua marrëveshja, Mao Ce Duni tha: «Tani mos ndërmerrni asgjë të fortë, qëndroni këtu, në marrëveshjen e Parisit». Domethënë, sipas tij, ne nuk duhej të sulmonim qeverinë kukull të Sajgonit. Ne aty nuk i thamë gjë Mao Ce Dunit, megjithëse mendonim ndryshe, por si komunistë dhe revolucionarë mendonim se revolucioni duhet të jetë gjithmonë në sulm.

Kinezët, — vazhdoi ai, — ishin kundër kryengritjes së përgjithshme që zhvilluam ne më 1965, edhe kundër ofensivës së pranverës të vitit 1975. Bile, edhe kur ne ishim në portat e Sajgonit, kinezët na thanë që të ndalonim aty, të mos e çlironim Sajgonin. Këtë, — informoi vietnamezi, — na e tha Jeh Çien Jini.

Kinezët, — vazhdoi ai t'i fliste ambasadorit tonë, — tani që Vietnam i Jugut u çlirua, po nxjerrin në shesh fytyrën e tyre të vërtetë. Kina qysh në vitin 1966 ka mbajtur marrëdhënie të forta me Pol Potin dhe Jeng Sarin dhe, pas vizitës së Pol Potit në Kinë më 1976, Par-

tia Komuniste e Kamboxhias nxori një rezolutë ku thuhet se baza ideologjike e Partisë Komuniste të Kamboxhias është maocedunideja. Natyrisht, Pol Poti nuk mund të bënte asnjë ndryshim nga të gjitha partitë lëvere, që ndoqën rrugën e maocedunidesë.

Zëvendës drejtori i Drejtorisë së Jashtme të KQ të Partisë Komuniste të Vietnamit i tha ambasadorit tonë, gjithashtu, se Pol Poti dhe Jeng Sari janë me origjinë kineze. Pas çlirimit të Kamboxhias në vitin 1975 e deri tani, specialistët ushtarakë kinezë vazhduan të qëndronin në Kamboxhia. Më shumë se 10 mijë këshilltarë ushtarakë kinezë, që janë baras me dy divizione, ndodhen në Kamboxhia. Ushtria kamboxhiane është pajisur me armatime kineze, me aeroplanë, tanke, anije ushtarake etj., etj., të tipit të viteve 1976-1977. Po kështu, — tha zëvendës drejtori vietnamez, — Kamboxhia është furnizuar me llojet e fundit të minave nga Kina dhe, gjatë viteve 1977-1978, ajo ka hedhur në lumin e Mekongut mina lundruese për të shkatërruar anijet tona të transportit.

Ne, — vazhdoi ai, — kemi kërkuar të bisedojmë me palën kamboxhiane, por ata nuk kanë pranuar. Tani kamboxhianët kanë nxjerrë një qarkore të re, ku thonë se çdo kamboxhian duhet të vrasë 30 vietnamezë dhe se 2 milionë kamboxhianë duhet të vrasin 30 ose 50 milionë vietnamezë. Kuptohet se pa ndihmën ushtarake të Kinës Kamboxhia nuk është në gjendje ta vazhdojë luftën. Ne, — i tha vietnamezi ambasadorit tonë, — kemi përqendruar 200 mijë ushtarë në kufi, shumë avionë ushtarakë janë vendosur në aeroportet kineze që janë 100 deri 150 kilometra larg kufirit vietnamez. Kina ka hyrë dhe ka cenuar kufirin tonë. Në fund të vitit 1977 dhe më vonë, ne kemi dërguar në Kinë një zëvendës ministër të Punëve të Jashtme, për të biseduar për problemin e kufirit, por kinezët nuk kanë pranuar. Kinezët, gjithashtu, tani po përpiqen që të përçajjnë udhëheqjen e partisë so-

në. Këta thonë se shokët e partisë ndjekin dhe duhet të ndjekin vijën e Ho Shi Minit, i cili ishte për miqësinë me Kinën. Ata kanë bërë përpjekje për të ndërhyrë në punët e brendshme të partisë sonë, por përpjekjet e tyre nuk kanë pasur sukses. Për një kohë të gjatë kinezët na kanë dëmtuar dhe na kanë penguar në punën tonë, por ne nuk kemi folur, kurse tani që veprimet e tyre janë shumë të egra, jemi të detyruar të flasim për këto veprime ndaj nesh gjatë gjithë kohës. Këto që po jua themi juve, — vuri në dukje ai, — nuk ua kemi thënë partive të tjera.

E gjithë kjo situatë që na paraqet zëvendës drejtori i Drejtorisë së Jashtme të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Vietnamit është plotësisht e vërtetë. Vietnamezët nuk ekzagjerojnë gjë në këtë mes. Të gjitha këto i kanë bërë kinezët, të gjitha ndërhyrjet jemi të bindur se janë bërë nga ana e tyre, të gjitha pengesat i janë krijuar Vietnamit për arsyet që thashë më lart.

Ne aktualisht konstatojmë se Kina me aktet e shëmtuara që ndërmori kundër Vietnamit dhe Shqipërisë pësoi një disfatë të madhe politike në botë. **Gjithë opinioni publik i dënoi veprimet arbitrare, arrogante dhe provokuese të shtetit të madh kinez kundër dy miqve të saj më të ngushtë, Shqipërisë dhe Vietnamit.**

Udhëheqja kineze, megjithëse është fashiste e tërbuar dhe e egërsuar, tatoi pulsën në botë dhe, këto ditë e fundit, shohim që Kina t'i ketë propozuar Vietnamit dërgimin e një zëvendës ministri të Punëve të Jashtme «për të zhvilluar bisedimet dhe për të sheshuar mosmarrëveshjet». Natyrisht, kjo është një tërheqje politike, për arsye se kinezët më parë nuk kanë pranuar bisedime, por tash, të detyruar nga opinioni botëror, pranojnë të bisedojnë. Vietnamezët mund t'i përgjigjen pozitivisht propozimit kinez, por rezultatet do të jenë negative, për arsye se udhëheqja kineze është hakmarrëse, është e ligë, dhe nuk dëshiron që midis Kinës dhe Vietnamit të ven-

dosen marrëdhënie të mira miqësore, internacionaliste. Kjo nuk do të bëhet, gjithashtu, edhe për arsye se udhëheqja kineze nuk është një udhëheqje marksiste-leniniste, ajo është një udhëheqje reaksionare, kapitaliste, shoviniste, prandaj kërkon që t'u imponojë politikën dhe vullnetin e saj vietnamezëve. Por këta nuk do ta pranojnë këtë gjë. Edhe në qoftë se do të arrihet në ndonjë marrëveshje, kjo do të jetë formale, pa baza të shëndosha, do të jetë një marrëveshje e sipërfaqshme.

POGRADEČ, E HËNE  
24 KORRIK 1978

POGRADEČ, E HËNE  
24 KORRIK 1978

## SHËNIM

Sot në mbrëmje erdhi në Pogradec shoku Ramiz për të rishikuar së toku përfundimisht notën, ose më mirë letrën që Komiteti Qendror dhe Qeveria jonë do t'i drejtojnë Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kinës dhe Këshillit të Shtetit të Republikës Popullore të Kinës në lidhje me prerjen e kredive dhe tërheqjen e specialistëve nga vendi ynë.

Letrën, brendinë dhe format e së cilës i diskutuam tok me Ramizin në Durrës, e ristudiova gjatë kësaj kohe dhe bëra disa përcaktime të tjera të reja. Në përgjithësi ky dokument ka dalë shumë mirë dhe përfundimisht nesër në mëngjes në orën 10<sup>00</sup> do ta diskutojmë përsëri.

## MOMENT HISTORIK NË MARRËDHËNIET ME KINËN

Sot në mëngjes, në studion time në Pogradec, bashkë me Ramizin shqyrtuam përmbajtjen e letrës që do t'i drejtojmë Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kinës dhe Këshillit të Shtetit të Republikës Popullore të Kinës. Punuam gjatë gjithë paradites dhe i dhamë dorën e fundit këtij materiali. Gjithashtu përcaktuam edhe mënyrën e masat për botimin dhe për dorëzimin e letrës ambasadorit kinez në Tiranë. E pranon ose nuk e pranon ai këtë letër që ne do t'i dorëzojmë në përgjigje të notës së tyre të datës 7 korrik të këtij viti, kjo është punë e tij, por ne do ta botojmë që të nesërmen në shtypin tonë.

Me këtë rast, dhashë porosi që pas mbledhjes së Byrosë Politike, të thërresim Plenumin e KQ të PPSH dhe Qeverinë për ta lexuar këtë letër e për të marrë edhe mendimin e shokëve.

Mund të them se ky është një moment historik dhe një veprim me rëndësi që ndërmerr Komiteti Qendror dhe Qeveria jonë për sa u përket marrëdhënieve me Kinën. Ne kishim bërë përpjekje që ato marrëdhënie të mira e të kënaqshme midis Partisë Komuniste të Kinës, qeverisë kineze dhe Partisë e Qeverisë sonë, pavarësisht nga kontradiktat e shumta parimore që ekzistonin në mes nesh, të ruheshin, por udhëheqja kineze e ndërpreu këtë kurs. Dhe ishte e natyrshme që ajo ta ndërpriste në mënyrë brutale dhe arrogante këtë kurs të marrëdhë-

nieve midis dy partive dhe vendeve tona, për arsye se gjatë gjithë kohës, që nga krijimi i tyre, Partia Komuniste e Kinës dhe Republika Popullore e Kinës nuk ecnin në rrugën e vërtetë marksiste-leniniste. Rruga e tyre ishte jomarksiste. Ato ruanin vetëm disa forma të jashtme marksiste. Pas çlirimit të plotë të Kinës u morën disa masa që kishin tiparet e një pune për hedhjen e themeleve të socializmit, por kjo ishte në formë e jo në përmbajtje. Në realitet, edhe në brendi rruga që u ndoq në Kinë ishte me shumë zigzage, ajo e pengonte ndërtimin e socializmit, krijimin e një partie të vërtetë marksiste-leniniste, hedhjen e themeleve të shëndosha të socializmit dhe marshimin përpara drejt ndërtimit të plotë të socializmit e më vonë të komunizmit në Kinë.

Rol të dorës së parë ka luajtur fakti që Partia Komuniste e Kinës nuk ishte një parti marksiste-leniniste, por një parti që e hiqte veten marksiste. Parimet që e udhëhiqnin atë ishin më tepër parime demokratike revolucionare, por në fakt oportuniste. Pra, në Kinë partia nuk kishte një bosht të vërtetë marksist-leninist, që ta udhëhiqte atë drejt rrugës socialiste, sigurisht në aleancë me elementë demokratikë.

Nga analizat që po i bëj kësaj çështjeje, mund të them se edhe parimet kryesore të një revolucioni demokratiko-borgjez në të ashtuquajturit komunistë kinezë e, në radhë të parë, në mendimet e Mao Ce Dunit, nuk kanë qenë të kristalizuara. Edhe veprimet e tij në luftën për çlirimin e vendit dhe në zbatimin e reformave të mëvonshme, të atyre reformave që i përkasin stadi të demokracisë borgjeze, nuk kanë qenë koherente.

Maoja ishte një ëndërrimtar i mbrujtur me filozofinë e vjetër konfuciane. Kjo ideologji, organizimi i vjetër kinez, kultura e mbrujtur me këtë ideologji që në kohët e vjetra e më vonë, i kishin frymëzuar Maon dhe shokët e tij me ide jo plotësisht demokratike borgjeze. Maoizmi

dhe konfucizmi kishin krijuar te «komunistët» kinezë mendimin se çdo gjë në Kinë duhej të zhvillohej ndryshe nga kudo dhe se Kina ishte një shtet me një popullsi të madhe, me karakteristikat e traditat e saj, nga të cilat duhej të frymëzoheshin ata në veprimet e tyre. Çdo gjë e huaj, mund të themi, deri në njëfarë shkalle, shikohej prej tyre nga pozitat e ksenofobizmit, kurse çdo gjë e tyre e brendshme ishte edhe e mirë edhe e keqe. Por kësaj eksperience të mirë dhe të keqe të brendshme ata nuk ditën t'i bënëin atë shoshitje që do të nxirrte në dritë më të mirën nga të mirat dhe të luftonin të keqen, jo-progresiven e, në të njëjtën kohë, të hidhnin sytë edhe pak rreth e rrotull tyre që të ishin në korent të zhvillimit të ngjarjeve në botë dhe të ideove që avanconin me zhvillimin e materializmit historik e me zhvillimin kulturor të popujve.

Për kinezët gjithçka ka qenë Kina dhe gjithçka duhej të ishte për Kinën. Natyrisht, një pikëpamje e tillë ishte një minus i madh që, pa dyshim, do të kishte pasojat e rënda në të ardhmen. Kështu, fitorja e revolucionit demokratiko-borgjez në Kinë, megjithëse u arrit vërtet pas një lufte të armatosur kundër japonezëve dhe reaksionit të madh me Çan Kai Shinë dhe borgjezinë kompradore në krye, flet për atë që udhëheqja e kësaj lufte nga komunistët gjatë gjithë periudhës bazohej në pikëpamje jo të kristalizuara.

**Lufta që bënë kinezët, të udhëhequr gjoja nga Partia Komuniste e Kinës, ishte një luftë kapedanësh ose e «zotërve të luftës».** Natyrisht, këta nuk kishin pikëpamje plotësisht të njëjta me ato të «zotërve të luftës» që mbretëronin dhe bënë ligjin në provincat, por këta zotër të rinj të luftës kishin mjaft ambicie, mjaft pikëpamje të padrejta dhe sidomos ata nuk e ndienin atë dorë të hekurt dhe të drejtë që ta udhëhiqte revolucionin në mënyrë të organizuar. Me fjalë të tjera, atyre u mun-

gonte ajo parti marksiste-leniniste e proletariatit, me atë ideologji marksiste-leniniste të luftës revolucionare, me ato lidhje, me atë forcë e me atë disiplinë, që duhej të udhëhiqte këtë luftë të madhe.

Armatat kineze nën drejtimin e Partisë Komuniste ishin pothuajse të pavarura dhe vepronin në mënyrë të pavarur. Kjo u shkaktoi atyre edhe disfata që rridhnin pikërisht nga mungesa e një kohezioni të hekurt në luftë. Këtë kohezion të hekurt mund ta krijojë vetëm një parti marksiste-leniniste me një ideologji marksiste-leniniste. Dhe pikërisht një parti e udhëhequr nga një e tillë ideologji revolucionare u mungonte kinezëve.

**Marshimi i Madh i Mao Ce Dunit, që ka hyrë në histori si akti i një strategjie të madhe, mua më duket se nuk është i tillë. Sipas mendimit tim ky «marshim» flet për një tërheqje të madhe dhe të çrregullt.** Në luftime ka edhe tërheqje, por kjo tërheqje e madhe e ushtrisë së Mao Ce Dunit, që konsiderohet si një «marshim heroik», për mendimin tim nuk mund të konsiderohet si fitore.

Marshimi i Madh u pagua shtrenjtë: nga 300 000 veta, që e nisën atë, e përfunduan vetëm 30 000; ushtria humbi 90 për qind të territorit të saj, bazat mbështetëse të ushtrisë u shkatërruan krejt, mjaft kundërmësymje të saj dështuan. Gjatë kësaj periudhe u likuiduan shumë kadro partie.

Duke iu referuar realitetit mund të dalim në konkluzionin se Marshimi i Madh tregon që Partia Komuniste e Kinës, megjithëse predikonte se mbështetej të fshatarësia, forca kryesore e saj, nuk kishte punuar që të krijonte baza të shëndosha lufte as të fshatarësia masive e mjeruar e Kinës. Kështu që ushtria e reaksionit të madh, e Guomindanit, e Çan Kai Shisë, me terror, me vrasje, e likuidoi edhe atë bazë të fshatarësisë që kishte partia.

**Ne shohim qartë se Mao Ce Duni nuk ka qenë për**

**hegemoninë e proletariatit në revolucion. Ai nuk kishte parasysh mësimin e Leninit mbi pozitën e lëkundshme të fshatarësisë dhe të borgjezisë së vogël.** Në fshatarësinë kineze nuk ishte ndier dora e proletariatit, pavarësisht se ky ishte shumë i vogël në numër në krahasim me të. Këtu nuk ishte ndier sidomos ideologjia e proletariatit nëpërmjet partisë së tij. Prandaj armatat kineze, dhe veçanërisht armata e Mao Ce Dunit dhe e Çu Desë, u tërhoqën, pastaj u kthyen përsëri dhe u tërhoqën për t'u riorganizuar, se patën humbje kolosale. Këtu duhet ndaluar e duhet parë se çfarë edukimi iu dha kësaj partie dhe kësaj ushtrie.

Nga sa dimë dhe nga sa kemi parë në shkrimet e Mao Ce Dunit, në kohën e tërheqjes së armatave kineze dhe sidomos kur këto armata u vendosën në provincat veriperëndimore të Kinës, filloi edukimi gjoja marksist-leninist. Parimet mbi problemin e organizimit e të edukimit të partisë gjatë luftës ne i gjejmë të shprehura në katër vëllimet e Mao Ce Dunit, që janë gjoja referate teoriko-ushtarake. Mirëpo në këto referate të ashtuquajtura teoriko-ushtarake jepen parime me karakter të përgjithshëm, të cilat në letër duken si të drejta, por në to nuk shohim atë ideologji të vërtetë dhe atë mësim konkret që duhet ta forconin organizativisht partinë, e cila të udhëhiqte këtë ushtri në beteja, domethënë në fillimin e sulmit.

Nga ana tjetër, ne dimë se në shtabin e Mao Ce Dunit në ato kohë të vështira e të rëndësishme për fatet e Kinës, rronin në miqësi të ngushtë, në afinitet të madh me ushtarët e komunistët kinezë agjentë imperialistë amerikanë, nga të cilët më kryesori ka qenë Edgar Snou. Për këtë unë kam folur edhe në shkrimet e mëparshme. Mao Ce Duni me Edgar Snoun kanë pasur bisedime të gjata dhe bile nga Departamenti i Shtetit Amerikan është shkruajtur edhe një «Libër i bardhë», ku vihen në dukje

pikëpamjet demokratiko-liberale të Mao Ce Dunit në lidhje me luftën, me aleancat e me të ardhmen e Kinës. Në atë libër jepen pikëpamje të Mao Ce Dunit për shumë çështje, të njohura dhe të panjohura nga ne, që vërtetojnë këto eklettizma antimarksiste të atij vetë dhe të shokëve të tij, të cilat u mbuluan të gjitha me fitoren kundër Japonisë dhe me shpartallimin e ushtrisë së Çan Kai Shisë. Natyrisht, Mao Ce Duni dhe kinezët këtë fitore ia dedikojnë vetëm vetes së tyre, kurse objektivisht nuk është ashtu. Thyerja e Japonisë, që solli si rrjedhim edhe shpartallimin e Çan Kai Shisë e të ushtrisë së tij, ishte rezultat i Luftës së Madhe Patriotike të Bashkimit Sovjetik, të udhëhequr nga Stalini i madh, si dhe i luftës së koalicionit midis Bashkimit Sovjetik, Anglisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Këta faktorë të jashtëm, por që kanë luajtur një rol të madh në çështjen e çlirimit të Kinës, Mao Ce Duni dhe shokët e tij i errësojnë, për të mos thënë se i zhdukin krejt dhe tek ata kurdoherë sundon pikëpamja që çdo gjë e kanë bërë vetë me forcat e tyre, çdo gjë e ka bërë Kina për Kinën.

Natyrisht, triumfi i ushtrisë kineze, të udhëhequr nga Mao Ce Duni dhe gjeneralët e tjerë, çlirimi i Kinës dhe shpallja e Republikës Popullore në vitin 1949 e ngritën lart prestigjin e Partisë Komuniste të Kinës dhe, veçanërisht, të Mao Ce Dunit. Kjo fitore dhe vendosja e «demokracisë së re» u pompuan si një fazë e ndërtimit të socializmit, nën drejtimin e Partisë Komuniste të Kinës.

Për këtë fitore të popullit të madh kinez gjithë revolucionarët dhe bota përparimtare u gëzuan, kurse armiku u hidhërua, por shpresat nuk i humbi. Ai punonte, se e njihte mirë gjithë të kaluarën e Kinës, dinte, gjithashtu, se cilët ishin faktorët që sollën çlirimin e saj dhe shpalljen e Republikës Popullore në këtë vend.

Unë nuk do të zgjatem për të vënë në dukje ato ide

që kam përsëritur shumë herë në shkrimet e mia për Kinën, por dua të them diçka se si filloi të ndërtohet «socializmi» ose si u hodhën «bazat e socializmit» në Kinë. Ç'rugë morën punët në fushën politike, në ideologji, në ndërtimin e ekonomisë, në luftën e klasave, në luftën për aleanca në Kinën e çliruar? Mund të them me bindje se të gjitha këto u zhvilluan në mënyrë kaotike, jo të përcaktuara qartë. Në Kinë nuk kishte një bosht marksist-leninist të vërtetë që, me përpjekje, nëpërmjet luftës së klasave, ta drejtonte fitoren e çlirimit drejt fitores së socializmit. Përkundrazi, ato pikëpamje të paraluftës në Kinën e re u zhvilluan nën maskën e demokracisë së re, siç e quajti Mao Ce Duni. Kështu që gjatë kësaj periudhe, që nga viti 1949 dhe deri tash, ne shohim se idetë që udhëhoqën ndërtimin e socializmit në Kinë nuk ishin ide racionale marksiste-leniniste. Pas çlirimit, në Kinë ekzistonte një luftë idesh zyrtare të pranuar nga Partia Komuniste mbi zhvillimin e «njëqind luleve» e të «njëqind shkollave».

Me fjalë të tjera, **Partia Komuniste e Kinës, që s'kishte një bosht marksist-leninist, pranoi që në gjirin e saj të ekzistonin fraksione të ndryshme, të cilat luftonin jo për kohezion, por për pushtet.** Ato fraksione luftonin gjoja për forma më revolucionare, tamam ashtu siç luftonin «zotërit e luftës», ashtu siç luftojnë, në vendet borgjezo-kapitaliste rrymat e ndryshme, që përfaqësojnë interesat e veçantë të grupeve të ndryshme.

Partia Komuniste e Kinës, siç e dimë, lejoi fraksionet në gjirin e saj dhe pranoi ekzistencën e partive të ndryshme në pushtet me po ato prerogativa si të Partisë Komuniste. Në më të shumtat e rasteve edhe në sistemin ekonomik u ruajt pronat private kapitaliste, si në qytet edhe në fshat, ushtria kineze u la të ruante ato karakteristika bashibozuke të komanduara nga «zotërit e luftës», të cilët në realitet nuk u bindeshin Komitetit Qe-

ndror dhe qeverisë. Në fakt, të gjithë ngrinin flamurin e Mao Ce Dunit, po ishte pikërisht ky flamur i Mao Ce Dunit që e lejonte këtë drejtim të decentralizuar jo vetëm në ushtri, por edhe në ekonomi, edhe në organizimin e shtetit.

Në organizimin e shtetit të demokracisë së re në Kinë nuk shohim që Partia Komuniste të adaptojë teorinë e Marksit e të Leninit dhe eksperiencën e madhe bolshevike të Bashkimit Sovjetik në krijimin e aparateve të diktaturës së proletarietit, nuk shohim krijimin e pushtetit të vërtetë të diktaturës së proletarietit. Këtu ka diletantizëm të lejuar posaçërisht, për arsye të mentalitetit jomarksist të udhëheqjes së Partisë Komuniste të Kinës, se gjoja krijimi i këtij pushteti në Kinë ishte specifik për këtë vend.

Natyrisht, Kina do të bënte edhe një politikë të jashtme. Në fillim, për këtë ajo u orientua nga Bashkimi Sovjetik, megjithëse duhet thënë se Bashkimi Sovjetik leninist-stalinian nuk është parë kurrë me sy të mirë, marksist-leninist revolucionar nga vetë Mao Ce Duni dhe nga gjithë «marksistët» e tjerë kinezë. Ata as Komunën e Parisit, as sovjetët nuk i konsideronin si një shembull i asaj forme të vërtetë të pushtetit të diktaturës së proletarietit, por adaptuan komunën popullore. **Komuna popullore në Kinë mund të tingëllojë si Komuna e Parisit, por në realitet nuk zhvillohej në atë rrugë. Kjo ishte një komunë e veçantë kineze, e cila do të kishte konsekuenca të rrezikshme në të ardhmen, për arsye të decentralizimit të pushtetit, të ekonomisë, të fuqisë ushtarake.** Si rrjedhim, komuna popullore në Kinë do të krijonte pozita të shëndosha për klanet e ndryshme, që luftonin për pushtet, gjë që do ta dobësonte në fakt organizimin e partisë dhe frymëzimin e saj me ideologjinë e Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit. Gjithë ky organizim i veçantë kinez i dedikohet, dhe kjo është e vër-

tetë, Mao Ce Dunit, idetë e të cilit nuk ishin marksiste, pavarësisht se u quajtën të tilla.

Megjithatë Kina u orientua nga Bashkimi Sovjetik duke mos qenë dakord as me vendimet e Kominternit, as me këshillat që mori nga vendi i parë socialist, por e ndiente veten, si të thuash, solidare me të në divergjencë, të cilat, natyrisht, u dukën haptazi pas vdekjes së Stalinit, kur në fuqi erdhi tradhtari Hrushov, kur ky hodi baltë mbi leninizmin, mbi Stalinin, mbi bolshevizmin. **Bashkimi Sovjetik hrushovian i pëlqeu Maos, se u afrohej më tepër pikëpamjeve të tij kaotike antimarksiste.** Është pikërisht për këto arsye që Mao Ce Duni e mbrojti me zell të madh ardhjen e Hrushovit në fuqi dhe luftën e tij kundër grupit të ashtuquajtur antiparti në gjirin e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik. **Maoja e mbrojti Hrushovin dhe «luftën» e tij me ato kritika të ndyra që i bëri Stalinit, duke shpresuar shumë që ai të bëhej një nxënës i tij ose Bashkimi Sovjetik të bëhej një aleat i dobët i Kinës dhe së toku të bënin ligjin.** Ligji do të bëhej gjoja për të luftuar imperializmin amerikan.

Por si Maoja, edhe Hrushovi, veç e veç dhe së bashku, kishin për qëllim të dominonin dhe të rindanin botën, se që të dy kishin pikëpamje shoviniste të shtetit të madh. Hrushovi e lehtëtoi Maon derisa i forcoi pozitën e veta, pastaj mendonte se me Kinën e Mao Ce Dunit mund të shkonte, mund të lidhej në aleancë, por kjo aleancë duhej të ishte nën drejtimin e tij dhe, që të realizohej një gjë e tillë, Hrushovi hapi politikën e vet drejt imperializmit amerikan. Kjo, natyrisht, ishte një disfatë për politikën e Maos, prandaj ky bëri çmos që ta pengonte Hrushovin të lidhej me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, pse edhe vetë kishte që më parë tendencë pro-amerikane. Por, kur Maoja pa se Hrushovi e hodhi hapin më përpara drejt imperializmit amerikan, atëherë filloi luftën kundër Hrushovit. Domethënë, Partia Komuniste

e Kinës, e kryesuar nga Mao Ce Duni, erdhi, si të thuash, me zor dhe përkohësisht në vijën e Partisë sonë për çështje taktike, se pastaj përsëri ajo ndërroi strategji dhe u kthye në strategjinë e Maos. Lufta brenda partisë, midis fraksioneve në Kinë, po thellohej. Këto fraksione kërkonin si e si të merrnin fuqinë dhe të dominonin në vend. U arrit kështu në Revolucionin Kulturor dhe më në fund në marrjen e fuqisë nga revizionistët dhe tradhtarët e marksizëm-leninizmit, Hua Kuo Feni dhe Ten Hsiao Pini.

Pra, në gjithë këtë situatë, në vija të përgjithshme, mund të konstatojmë që **Partia Komuniste e Kinës nuk ka qenë në pozita marksiste-leniniste. Ajo doli në rrugën e revizionizmit, në rrugën e një Kine që aspiron dhe lufton të bëhet superfuqi socialimperialiste në bashkëpunim dhe në aleancë me imperialistët amerikanë, me reaksionin botëror kundër revolucionit, kundër luftës së popujve dhe kundër fuqisë tjetër të madhe imperialiste, Bashkimit Sovjetik, që lufton dhe aspiron gjithashtu për dominimin botëror.**

Situatat plot zigzage të brendshme e të jashtme në të cilat ka kaluar Partia Komuniste e Kinës, Partia jonë i ka ndjekur hap pas hapi dhe të gjitha janë gjykuar me gjakftohtësi nga ana e saj. Ajo ka bërë përpjekje që sa të ishte e mundur të influenconte me vijën e saj të drejtë, me ndonjë këshillë dhe me ndonjë kritikë, që Kina të ndiqte një vijë marksiste-leniniste, të mos merrte këtë rrugë armiqësore kundër revolucionit. **Ne e kemi ndër-gjegjen të qetë se i bëmë të gjitha përpjekjet që udhëheqësit kinezë të ndërrojnë rrugë.** Tash dolën haptazi kundër nesh. Lufta e tyre armiqësore kundër Shqipërisë socialiste dhe Partisë së Punës të Shqipërisë është konsekuencë e luftës antimarksiste, e qenies së Kinës një shtet josocialist dhe e ekzistencës së maocedunidesë, të kësaj teorie kapitaliste, socialimperialiste dhe antimarksiste.

Vendimet tona janë të matura, janë të drejta dhe neve na vjen shumë keq që ndodhi kështu për popullin kinez, i cili është një popull punëtor, që e do dhe do ta dojë popullin shqiptar. Miqësia shqiptaro-kineze nga ana jonë ka qenë e sigurtë, ajo ka qenë një miqësi e pastër, prandaj do të influencojë dhe do të zhvillohet edhe nën këtë diktaturë të egër fashiste që sundon sot mbi popullin kinez.

Në Kinë ka shpresa të mëdha për fitoren e marksizëm-leninizmit. Atje ka një përlëshje të madhe idesh, ka një përlëshje të madhe forcash që kundërshtojnë njëra-tjetrën, që kërkojnë të dominojnë dhe të eliminojnë kundërshtarët e tyre. **Midis këtyre forcave që luftojnë është vështirë të mos ekzistojë një bërthamë e shëndoshë marksiste-leniniste, e cila ka qenë penguar edhe nga vetë Mao Ce Duni, sepse ai nuk ishte marksist-leninist, por vetëquhej marksist-leninist.** Kjo bërthamë marksiste-leniniste do të luftojë, por mendoj se lufta e saj nuk duhet të bëhet më nën flamurin e Mao Ce Dunit. Ky është një problem crucial për Kinën.

**Në qoftë se marksist-leninistët kinezë vazhdojnë të mbajnë si flamur të luftës së tyre maocedunidenë, ata jo vetëm që nuk do të fitojnë dhe nuk do ta gjejnë rrugën e vërtetë të revolucionit, por do të zhyten në luftë fraksionesh dhe, natyrisht, në këtë rast do të kenë kurdoherë vendin e fundit në Kinë, sepse fraksionet reaksionare janë të forta.** Por në qoftë se kjo bërthamë proletare mbështetet si duhet në ideologjinë marksiste-leniniste dhe në mësimet e Stalinit, në qoftë se kjo e quan klasën punëtorë si klasë hegjemone dhe krijon një parti me të vërtetë të klasës punëtore, atëherë do t'i ngjitë shkallët, sigurisht me zor, me luftë, me përpjekje, por do t'i ngjitë. Në Kinë ekzistojnë forca të mëdha revolucionare, të cilat kanë hyrë në një rrugë politike, por nuk gjejnë orientimin e duhur dhe borgjezia me fraksionet e saj të ndryshme

përpiqet t'i çojë në kanal in e vet, veçanërisht fshatarësinë. Prandaj komunistët e vërtetë kinezë duhet ta rikujtojnë gjithë vijën e tyre dhe të ndërtojnë një parti me një vijë të drejtë, me të vërtetë marksiste-leniniste.

Ne mendojmë se, duke vepruar kështu siç veprojmë, e ndihmojmë këtë situatë që duhet të krijojë proletariati kinez në aleancë me fshatarësinë punonjëse, për të formuar partinë e vërtetë marksiste-leniniste. Fashistët kinezë me siguri do të na atakojnë ne dhe këtë do ta bëjnë duke ngritur flamurin e Maos dhe të Çu En Lait. Dome thënë, ata do të shfrytëzojnë sentimentalizmin e popullit kinez, duke i thënë se Partia e Punës e Shqipërisë dhe Shqipëria socialiste mosmirënjohëse, antimarksiste, fashiste e të tjera e të tjera epitete si këto, është shitur te Bashkimi Sovjetik dhe po lufton, po diskrediton Mao Ce Dunit e Çu En Lait, që janë heronjtë dhe marksist-leninistët e vërtetë në botë. Këtë gjë ata do ta bëjnë dhe, deri në njëfarë shkalle, edhe në gjerësi. Në periudhën e parë, sidomos, kjo propagandë e tyre e gënjeshtërt, por që iu duhet, do të ketë sukses, veçse me kalimin e kohës vetë krerët kundërrevolucionarë kinezë do të na ndihmojnë neve në këtë drejtim. Revolucionarët e vërtetë marksist-leninistë dhe populli kinez me proletariatin do të kuptojnë se sa e drejtë ka qenë vija jonë, sa e drejtë ka qenë lufta jonë kundër eklektizmit kinez, ndaj Partisë Komuniste të Kinës, që nuk ishte në pozita marksiste-leniniste dhe ndaj Mao Ce Dunit e udhëheqësve të tjerë, që e çuan Kinën në një katastrofë të tillë.

Në këtë drejtim mund të themi se aktualisht kundër veprimtarisë antimarksiste të udhëheqjes kineze ne fillojmë një luftë të hapët, që do të vazhdojë seriozisht me dokumente, se deri tashti nuk kemi folur hapur. Ky është një moment tjetër historik për Partinë dhe vendin tonë, është një nga momentet e rëndësishme nëpër të cilat ka kaluar Partia jonë marksiste-leniniste gjatë gjithë jetës

së saj, në luftë kundër imperializmit, kundër reaksionit botëror dhe kundër revizionizmit modern, duke filluar që nga titistët, hrushovianët, eurokomunistët dhe deri te kinezët.

Njëkohësisht ky është edhe një moment i rëndësishëm në luftën e në lëvizjen komuniste botërore, se hap sytë e elementit të shëndoshë marksist-leninist të shohë më qartë dhe të shpërndajë mjegullën që ka përhapur teoria e Mao Ce Dunit, teori që është ndihmuar nga imperializmi dhe kapitalizmi, të cilët shihnin te Kina jo një kundërshtar, por një aleate të mundshme. Dhe një gjë e tillë atyre iu vërtetua. Për këtë arsye imperializmi dhe kapitalizmi do ta mbrojnë Kinën aktuale dhe do të na luftojnë ne, por ne nuk përkulemi, se jemi me të drejtën. Ne jemi të fortë brenda vendit dhe do të forcohemi akoma më shumë, por, në të njëjtën kohë, kemi forca të mëdha edhe jashtë, se opinionin përparimtar botëror dhe marksist-leninistët që luftojnë nga të katër anët e botës do të ndihmojnë kauzën e vërtetë të revolucionit, pastërtinë e marksizëm-leninizmit dhe Partinë e Punës të Shqipërisë, që i mbron këto me besnikëri e trimëri.

POGRADEÇ, E DIEL

30 KORRIK 1978

## KINEZËVE IU DHA PËRGJIGJJA QË MERITONIN

Sot i dërgova një letër Hysniut<sup>1</sup> ku i shpreha gëzimin tim të madh që u bë mirë. I shkrova me këtë rast edhe për Letrën e hapur që i dërguam KQ të PK të Kinës dhe qeverisë kineze për veprimin e tyre të pabesë e armiqësor kundrejt vendit tonë. Kinezët, i shkruajta midis të tjerave Hysniut, e morën përgjigjen që meritonin. Partia jonë dhe udhëheqja e saj vepruan shumë drejt, në rrugën marksiste-leniniste. Ato demaskuan me fakte një armik tjetër të madh, revizionizmin kinez, që fshihej për caq kohë nën maskën e marksizëm-leninizmit.

Lufta tash është shpallur dhe ne do ta bëjmë të ashpër, pa kompromis dhe do të fitojmë. Për Partinë tonë këto janë momente historike të një rëndësie ndërkombëtare, pse asaj i ra barra historike ta udhëheqë këtë luftë sa të vështirë, aq edhe të lavdishme për të mbrojtur Shqipërinë socialiste dhe pastërtinë e marksizëm-leninizmit nga shtrembërimet, deviacionet dhe sofizmat, për të fuqizuar revolucionin proletar botëror dhe luftërat nacionalçlirimtare të popujve kundër imperializmit amerikan, socialimperializmit sovjetik dhe atij kinez maoist.

<sup>1</sup> Në përgjigje të letrës së tij të datës 28 korrik 1978 me anë të së cilës shoku Hysni njoftonte qenien e tij plotësisht dakord me projektletërën që do t'i dërgohej KQ të PK të Kinës dhe qeverisë kineze e që do të aprovohej nga Byroja Politike.

Pjekuria, vendosmëria në rrugën e socializmit shkencor, guximi dhe trimëria e Partisë dhe e popullit tonë, do të ndihmojnë edhe shokët e miqtë kudo në botë, që na duan dhe i duam, që na ndihmojnë dhe i ndihmojmë, pse bëjmë një luftë të përbashkët për përparimin, për lumturinë e njerëzve dhe të popujve. Forcat e bashkuara tonat janë shumë të forta dhe ato u shkaktojnë dëme të pariparueshme armiqve.

POGRADEC, E DIEL

30 KORRIK 1978

### FILLOI JEHONA E LETRËS SONË

Sot të gjitha gazetat e kryeqytetit botuan «Letrën e Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe të Qeverisë së Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë drejtuar Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kinës dhe qeverisë kineze», në përgjigje të notës që na drejtuan, me të cilën njoftuan prerjen brutale të ndihmave e të kredive dhe tërheqjen e specialistëve të tyre nga Shqipëria. Këtë gjest armiqësor e arrogant të një shteti të madh revizionistët kinezë përpiquen ta arsyetojnë se gjoja ne, shqiptarët, nuk jemi mirënjohës ndaj ndihmës kineze, nuk po krijojmë situata të mira për punën e specialistëve kinezë në vendin tonë, e të tilla absurditete, shpifje dhe trillime të tjera pa baza.

Kjo letër u transmetua edhe nga televizioni e nga radioja jonë. ATSH-ja, gjithashtu, e transmetoi atë shumë herë në gjuhë të huaja. Përveç kësaj, përfaqësive tona jashtë iu dërgua, me kohë kjo letër në gjuhët frëngjisht, anglisht, spanjisht e italisht dhe po sot, në datën 30 korrik, filluan të flasin menjëherë agjencitë e lajmeve. Fle-shet e para u dhanë nga Rojteri dhe disa agjenci të tjera.

Këto ishin, si të thuash, «mezeja», kurse «gjella» e vërtetë, e plotë, medoemos do të vijë më vonë. Çdo ditë do të lexojmë shtypin dhe do të dëgjojmë radiot e botës, për arsye se letra jonë përmban argumente dhe fakte të shumta e të shëndosha jo vetëm për marrëdhëniet thjesht

ekonomike midis dy vendeve tona, por ajo përmban edhe gështje të rëndësishme ideologjike dhe politike, që nuk u interesojnë vetëm dy popujve tanë, por opinionit botëror, sepse veprimet tradhtare antishqiptare të kinezëve, që janë kurdisur me intriga e me komplete, kanë pasur karakter të gjerë, që vinin në rrezik Shqipërinë, gjendjen aktuale në Ballkan e në botë.

**Letra jonë drejtuar KQ të Partisë dhe qeverisë së Kinës duhet dhe do të bëhet objekt i studiuesve dhe i kancelarive botërore.** Gjithë opinioni dhe shtypi botëror, gjithë marksistë-leninistët dhe armiqtë e marksizëm-leninizmit, do të shohin sa të drejta kanë qenë veprimet dhe qëndrimet marksiste-leniniste të Partisë së Punës të Shqipërisë ndaj Kinës, sa dashamirëse kanë qenë lidhjet tona me të, sa e sinqertë ka qenë miqësia jonë me popullin kinez, të cilën e errësuan revizionistët dhe fashistët që erdhën aktualisht në fuqi në Kinë.

Studiuesit, kancelaritë e partitë e ndryshme në botë do ta studiojnë letrën tonë, jo se nuk kanë fakte dhe dokumente të tjera, bile këto i kanë të shumta, mbi veprimet dhe qëllimet e Kinës, por sepse, duke e studiuar atë, do të bëjnë krahasime dhe do të nxjerrin konkluzionet e duhura. Unë mendoj se arsyetimet e argumentimet e dokumentuara të letrës së Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe të Qeverisë sonë do t'i afrojnë jo vetëm shokët e miqtë, por edhe njerëz të ndershëm, politikanë e studiues realistë. **Ata që na duan, do të gëzohen, ata që s'na duan do të hidhërohen,** për arsye se veprimet e Kinës janë të gabuara, kurse veprimet e Partisë së Punës të Shqipërisë dhe të pushtetit socialist në Shqipëri, janë të drejta.

Akti i prerjes së marrëdhënieve ekonomike, i ndihmave civile dhe ushtarake Shqipërisë socialiste nga ana e Kinës, bëhet njëkohësisht me të njëjtat qëndrime armiqësore që udhëheqja kineze mban ndaj Vietnamit.

Udhëheqja aktuale kineze jo vetëm që i preu ndihmat Vietnamit, por tash ka filluar t'i kërkojë këtij edhe shpenzimet që ka bërë duke e ndihmuar gjatë luftës kundër imperializmit amerikan! Ky është një akt marrëzie i padëgjuar, ky është një akt barbar i një imperializmi që spekulon mbi gjakun e popujve. Janë pikërisht udhëheqësit kinezë, me Mao Ce Dunin në krye, që kanë thënë disa herë se «Kina është prapavija e luftës së Vietnamit, ajo e ndihmon Vietnamin në luftën e tij çlirimtare kundër barbarëve amerikanë dhe lufta e Vietnamit ndihmon Kinën nga një invadim i imperializmit amerikan, ndihmon, pra, ruajtjen e lirisë e të pavarësisë së popullit kinez dhe socializmin në Kinë». Këto janë fjalët e udhëheqjes kineze në atë kohë, por, siç duket, vija e saj, në bazë të të gjithë veprimtarisë së maskuar me demagogji dhe që tash ka dalë hapur në dritën e diellit, ka qenë një vijë që kërkonte të përfitonte nga gjaku i derdhur prej popujve të tjerë. **Politika e Partisë së ashtuquajtur Komuniste të Kinës nuk ka qenë dhe nuk është veçse një politikë imperialiste që lufton për dominim, duke bërë të tjerët të vriten dhe pastaj të kërkojë fitime nga gjaku i derdhur.**

Këtë gjë bëri imperializmi amerikan pas Luftës së Dytë Botërore. Shtetet e Bashkuara të Amerikës u dhanë ndihma ushtarake dhe ekonomike aleatëve të tyre të afërt, Anglisë, Francës etj., por i dhanë edhe Bashkimit Sovjetik nëpërmjet ligjit «hua dhe qira» dhe, pasi u derdh gjithë ai gjak, pasi u mposht nazizmi gjerman, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të pasuruara nga kjo luftë, arritën deri atje sa kërkuan që aleatët e tyre, duke përfshirë edhe Bashkimin Sovjetik, t'u kthenin borxhet. **Atëherë ç'ndryshim ka në këtë mes midis politikës së imperializmit amerikan ndaj aleatëve të tij dhe politikës së kinezëve ndaj Vietnamit? Asnjë ndryshim, qëndrimi është i njëjlojtë: qëndrim imperialist.**

Kështu që letra e KQ të Partisë dhe e Qeverisë sonë drejtuar partisë dhe qeverisë kineze do të bëjë jehonë në botë, te popujt revolucionarë, te marksistë-leninistët, sepse ata do të shohin të dokumentuara me fakte drejtësinë e vijës sonë, qëndrimet tona të drejta dhe dashamirëse ndaj Kinës «socialiste», ndaj udhëheqjes së Partisë Komuniste të Kinës. Ata do të shohin se Partia e Punës e Shqipërisë dhe populli shqiptar kanë qenë shumë të durueshëm ndaj akteve të mbrapshta dhe të panumërta të udhëheqjes kineze, duke filluar që nga Mao Ce Duni e deri te Ten Hsiao Pini me shokë.

**Letra jonë drejtuar udhëheqjes kineze do të ndihmojë popujt në botë, veçanërisht popujt e Afrikës, të Azisë dhe të Amerikës Latine për të kuptuar se kush janë në të vërtetë Kina dhe Mao Ce Duni.** Këta popuj do të jenë më vigjilentë ndaj buzëqeshjeve hipokrite kineze, ndaj ndihmave që gjoja do t'u japë ajo, ndaj përkëdhelive dhe pseudondihmës në arenën ndërkombëtare. Ata do të shohin se në realitet Kina ka qëllime të tjera nga ato që shpreh me fjalë. Ajo dëshiron të krijojë perandorinë e saj, të krijojë zonat e influencës, të hapë tregje në botë, të bëhet një superfuqi dhe të nxitë luftërat lokale, të arrijë deri edhe në një luftë botërore. Këto janë qëllimet e vërteta të Kinës që ndjek një vijë antimarksiste, reaksionare, ekspansioniste. Me veprimet e saj për dominim në botë, me pikëpamjet e shtetit të madh, me mendjemadhësinë e arrogancën prej superfuqie Kina do të krijojë kontradikta të mëdha midis aleatëve amerikanë dhe imperialistëve të tjerë, ose aleatëve të ardhshëm të saj, socialimperialistëve sovjetikë. Përpjekjet e saj për realizimin e këtyre qëllimeve patjetër do të krijojnë fërkime dhe kontradikta edhe me shtetet e vogla mbi të cilat ajo do të kërkojë të dominojë dhe ku do të nxitë luftërat lokale.

Demaskimi që po i bën Partia jonë udhëheqjes ki-

neze është një fitore e madhe për forcat përparimtare revolucionare, për luftën e tyre kundër imperializmit amerikan, socialimperializmit sovjetik, borgjezisë reaksionare dhe veprimeve që po ndërmerr Kina socialimperialiste.

**Veprimet politike, ideologjike dhe shtetërore të Kinës janë aq të çmendura, saqë ato mund të krahasohen me veprimet hitleriane.** Ashtu si veproi Hitleri në kohën e tij që, siç shprehet populli ynë, thoshte «më jep atë që s'më ke», po vepron edhe Kina, me po ata terma, me po atë agresivitet ndaj popujve të tjerë. Disa duken të habitur dhe thonë: Si është e mundur që ajo «pjekuri» kineze, ai «durim» kinez, ajo «politesë» kineze të arrijnë deri në veprime të tilla?! Veprimet aktuale të Kinës po zbulojnë një gënjeshtëri të madhe të krijuar dhe të pompuar prej kohësh, se, në fakt, veprime të tilla nuk mund të lindin në mënyrë spontane. Ato janë rezultat i një formimi ideologjik dhe politik, janë mbeturina të theksuara të filozofisë së vjetër feudale që ka dominuar dhe është shprehur me pikëpamjet borgjeze kapitaliste të një legjioni të tërë udhëheqësish, të një shtrese të tërë mandarinësh dhe intelektualësh që kanë udhëhequr dhe po e udhëheqin Kinën.

Këta bij mandarinësh, feudalësh, tregtarësh kompradorë ose spekulatorë, bile dhe bij të fshatarësisë e të punëtorisë, por që gradualisht degjeneruan, në situatat aktuale nuk kanë gjetur rrugë tjetër veç asaj hitleriane ose rrugën e Mikados e të samurajve japonezë. **Është interesante të krahasohen veprimet aktuale të udhëheqjes kineze me veprimet e samurajve, veprime reaksionare, feudale, shtypëse, dominuese, aziatike të veshura me hipokrizinë e fituar gjatë okupacionit të vendeve të tyre.** Por kjo hipokrizi dhe kjo «politesë» tregonte jo revoltën e vërtetë të një populli, por mënyrat «de courtoisie» siç thotë francezi të një borgjezie të degjeneruar, që tash ka

ardhur në fuqi, e frymëzuar nga një hakmarrje e egër, po aq e egër, në mos edhe më shumë, sa ajo e imperialistëve dhe e kolonizatorëve, që kanë pasë shfrytëzuar gjakun e popullit kinez në kohët e kaluara.

Tash udhëheqja kineze, e fortë vetëm se sundon mbi një popull prej 800-900 milionë banorësh, po e bën Kinën në arenën ndërkombëtare një shtet fashist arrogant, që nuk merr parasysh as norma ndërkombëtare dhe që ka hedhur tej maskat demokratike, marksiste-leniniste, me anën e të cilave udhëheqja e Mao Ce Dunit fshihte pikërisht tendencat e dominimit të Kinës së madhe.

Thuhet se është ky Mao Ce Dun që e ka quajtur marksizëm-leninizmin si një dogmë. Është e besueshme që Mao Ce Duni t'i ketë thënë gjëra të tilla, se lidhjet dhe prirjet e tij kanë qenë drejt një miqësie me imperializmin dhe me kapitalizmin botëror. Thuhet, gjithashtu, se Mao Ce Duni, kur e kanë pyetur pse maskohej me etiketën socialiste, është përgjigjur: **Pse, a mendoni ju vallë që imperialistët do të më lejojnë të bëhem një fuqi e madhe, duke e quajtur veten shtet imperialist?** Me fjallë të tjera, këto thënie të Maos, që nuk janë shkruar në dokumente kineze, por që të huajt i kanë shkruar, duke parë vijën aktuale të Kinës, mund t'i besosh që janë të vërteta. Mao Ce Duni, nën petkun e marksizëm-leninizmit vepronte i maskuar për t'ia arritur këtij qëllimi. Po pse e nxjerrim ne këtë konkluzion? Sepse shohim që **gjatë gjithë jetës Maoja ka bërë politikën e perandorit, ka bërë politikën e kultit të personit të tij dhe të dominimit të pikëpamjeve të tij.** Kur shikonte se pikëpamjet e tij rrezikoheshin nga të tjerët, ai i eliminonte ata, ca i vriste, ca i skartonte, «i edukonte», siç thoshte vetë.

E gjithë politika e Kinës me Bashkimin Sovjetik e me vendet e tjera synonte që Kina, e dalë nga lufta, të mëkëmbej dhe të arrinte në ditët e sotme, kur fuqinë e kanë marrë në dorë fashistët më të hapur, më të vendo-

sur, të cilët bëjnë një politikë dominuese, ekspansioniste, shoviniste.

Aktualisht neve na vihet detyrë që populli ynë ta kuptojë thellë këtë situatë. Që populli ynë do ta kuptojë thellë ideologjikisht dhe politikisht situatën e krijuar, nuk ka as më të voglin dyshim, se ai është i ngritur politikisht e ideologjikisht dhe ka qenë objekt i të gjithë imperialistëve në botë. **Po t'i hedhim një sy historisë së vendit tonë, do të shohim se kjo ka qenë një histori rezistence heroike nga populli ynë dhe shtypjeje e shfrytëzimi nga të huajt.** Na kanë pushtuar otomanët, serbët, grekët, dy herë na kanë sulmuar italianët, kundër nesh kanë qenë Shtetet e Bashkuara të Amerikës, që kërkonin të vepronin me agjentët e tyre e t'i impononin vendit tonë të çliruar pikëpamjet e tyre, «demokracinë» e vet. Anglia po ashtu veproi si fuqitë e tjera ndaj nesh, ajo rrëmbeu arin tonë, të cilin s'na e jep; Gjermania hitleriane na dogji dhe ne luftuam e fituam mbi të, por sot, kur Gjermania e Bonit ua ka paguar të gjithëve reparacionet për dëmet e luftës, neve s'na ka kthyer asnjë markë. Bashkimi Sovjetik na goditi, vendet e ish-demokracisë popullore na sulmuan, Kina, gjithashtu, na sulmoi, por në asnjë nga këto momente të vështira të historisë populli shqiptar nuk uli as kokën, as kurrizin. Të gjithë këta i kemi luftuar e po i luftojmë dhe gjithmonë kemi dalë e do të dalim me sukses në luftën kundër tyre. Në shekuj është kalitur karakteri burror i popullit shqiptar, është rrënjësuar ndjenja e drejtësisë dhe e mbrojtjes së drejtësisë, ndjenja e luftës për liri, pavarësi, dashuria për truallin e vet dhe dëshira për të jetuar me djersën e ballit e për të mos lënë të tjerët që t'i rrëmbejnë frytet e kësaj djerse.

**Karakterit i popullit shqiptar është tepër i çeliktë, i një çeliku të rrallë, që të tjerët nuk mund ta kuptojnë dot, s'mund ta kuptojnë veçanërisht ata që nuk janë**

**revolucionarë, reaksioni botëror.** Ka në botë edhe njerëz që thonë: Kjo që bën Shqipëria është një marrëzi. Si është e mundur që të rrojë ajo pa marrë ndihma e kredi nga askush? Ne u themi atyre se kjo s'është marrëzi, por një luftë për jetë, është një luftë e drejtë. Marrëzi bëjnë ata që shesin vendin e tyre, që e kthejnë atdheun në një vend për baza atomike. Të marrë janë ata që shesin ndërrin, që e futin popullin e tyre nën zgjedhë, janë ata që ndërrojnë çdo ditë politikë, që u nënshtrohen parasë, kapitalit vendës dhe të huaj, dhe jo ne që jemi njerëz të ndershëm, me logjikë të fortë, me kokë në vend dhe këmbë mbi dhe, mbi truallin e atdheut tonë të dashur, që e kemi mbrojtur, e mbrojmë e do ta mbrojmë kurdoherë dhe do të dalim fitimtarë në luftë kundër cilitdo që do të guxojë të na sulmojë.

Për ne, e theksoj edhe një herë, vihet detyra që populli ynë të kuptojë si gjithmonë mirë momentet që po kalojmë dhe t'i përvishet punës me energji akoma më të shumëfishuara. Ne duhet t'i realizojmë e t'i tejkalojmë planet në çdo degë dhe në çdo sektor, të krijojmë një situatë të shëndoshë ekonomike në vend për gjithë popullin, të krijojmë atë bollëk që na duhet për të forcuar mbrojtjen e atdheut dhe politikën tonë të drejtë, që na udhëheq në të gjitha aktivitetet e jetës.

Pra, në qoftë se organizimi ynë ka qenë i shëndoshë, tash e tutje ai duhet të dhjetëfishohet, në qoftë se ndërgjegjja e popullit dhe e Partisë sonë ka qenë e lartë, ajo duhet të lartësohet akoma më shumë, të mbruhet e të kalitet akoma më mirë. Në qoftë se kemi pasur sukses në bujqësi, duke ngritur rendimentet, duhet të punojmë akoma më tepër, në mënyrë shkencore, në mënyrë të organizuar e të derdhim djersë që këto rendimente të shkojnë kurdoherë në ngjitje. Të shfrytëzojmë në maksimum dhe në mënyrë të kulturuar, në mënyrë ekonomike, në mënyrë të drejtuar e të centralizuar minierat tona, naftën

tonë, qymyret, kromin, bakrin, të kërkojmë minerale të tjera të dobishme në vendin tonë dhe të ndërtojmë miniera. Industrinë tonë mekanike ta përdorim si duhet për të ndërtuar fabrika të reja, traktorë, makina, vegla ndërrimi dhe, sa të jetë e mundur, të eksportojmë më shumë e të importojmë më pak.

Në këto drejtime ne duhet ta forcojmë punën që Partia dhe populli t'i kuptojnë situatat dhe të mobilizohen totalisht për kryerjen e të gjitha detyrave. Kjo është një detyrë imperative që na shtrohet përpara në këto situata.

**Ne i demaskuam revizionistët kinezë politikisht, ideologjikisht, por, gjithashtu, duhet t'u tregojmë atyre dhe gjithë botës se jemi në gjendje të ecim përpara me forcat tona në ndërtimin e shoqërisë sonë socialiste.** T'i tregojmë njerëzimit se mund të jetohej duke u mbështetur në forcat e veta, se socializmi mund të ndërtohet me forcat e veta, se një popull, edhe i vogël po të jetë, nuk ka nevojë për kreditë e ndihmat e spekulatorëve e të shfrytëzuesve, por me djersën e ballit ai ka mundësi të krijojë ato të mira materiale që i nevojiten dhe të kalitë atë ndërgjegje të lartë marksiste-leniniste që e bën atë të papërkulshëm.

Këtë gjë duhet dhe do ta bëjmë, se na udhëheq Partia jonë marksiste-leniniste, na udhëheq ideologjia jonë, e cila na ka frymëzuar e na frymëzon përherë. **Të mendojmë dhe të realizojmë, të realizojmë duke u organizuar fort, të organizojmë dhe të punojmë me disiplinë proletare, të mendojmë si proletarë e të udhëhiqemi kurdoherë nga idetë e pavdekshme të proletariatit.** Këto ide do të triumfojnë patjetër mbi idetë kapitaliste, fashiste, revizioniste dhe Shqipëria do të jetë një rreze drite e fuqishme për popujt, për revolucionarët. Në këto momente historike na ngarkohet një mision i rëndë, të cilin do ta kryejmë me heroizëm, duke kapërcyer të gjitha vësh-

tirësitë, të brendshme e të jashtme. Me të tilla vështirësi ne jemi ndeshur edhe në të kaluarën dhe kjo na ka mësuar shumë gjëra, na ka mësuar t'i kuptojmë drejt vështirësitë e krijuara, të organizojmë mirë punën për t'i kapërcyer e për t'i likuiduar ato. Vështirësitë na kanë mësuar të nxjerrim nga duart tona një punë të pastër, na kanë mprehur mendjen që të mendojmë drejt.

POGRADEÇ, E HËNE

31 KORRIK 1978

## **BUROKRACIA KINEZE**

Duke studiuar zhvillimin e ngjarjeve në Bashkimin Sovjetik pas vdekjes së Stalinit, del qartë se atje, burokratizmi ka luajtur një rol vendimtar në goditjen e diktaturës së proletariatit dhe të parimeve marksiste-leniniste. Lidhur me këtë mund të bëjmë edhe ndonjë krahasim me atë çka ngjau në Kinë.

**Është e vërtetë se në Bashkimin Sovjetik, me Revolucionin e Tetorit dhe vendosjen e diktaturës së proletariatit, u likuidua burokracia si sistem, por aparatçikët e zhvillonin atë nën parullat e bolshevizmit. Ndryshe ndodhi në Kinë, ku pushteti politik nuk u shndërrua asnjëherë në diktaturë të proletariatit, pra, nuk u zhduk as burokracia, përkundrazi, ajo vazhdoi të zhvillohet, sepse nuk ekzistonte një parti marksiste-leniniste, sepse nuk u vendosën norma në bazë të teorisë shkencore të Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit. Prandaj ne shohim se katastrofa që ndodhi në Bashkimin Sovjetik dhe ajo që ndodhi në Kinë edhe kanë ngjashmëri, por edhe nuk kanë.**

Në Bashkimin Sovjetik hrushovianët u treguan intrigantë të shkathët, konspiratorë të mëdhenj, prandaj atje burokracia që ishte krijuar dalngadalë, u ruajt e mbuluar me parullat e socializmit, nën prestigjin e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik të Leninit dhe të Stalinit, u mbështet në fitoret e Bashkimit Sovjetik dhe e maskoi veprimarinë e saj minuese ndaj shtetit socialist, ndaj dik-

taturës së proletariatit vetëm duke goditur «kultin e personit».

Goditja e «kultit të personit» për hrushovianët do të thoshte luftë kundër Stalinit. Sipas tyre, nga drejtuesit e Komitetit Qendror të Partisë Bolshevike ka pasë gabuar vetëm Stalini, kurse realiteti në Bashkimin Sovjetik tregoi se aparatçikët dhe vetë hrushovianët, të maskuar dhe që vepronin nën emrin e Stalinit e me parullat e komunizmit, ishin ata që sollën katastrofën. **Në Kinë burokracia ka qenë e evidente gjatë gjithë kohës, që prej krijimit të Partisë Komuniste e këtej.** Ajo ishte vazhdimësia pa ndërprerje e burokracisë së mëparshme të Pe-randorisë Kineze, të «zotërve të luftës», të administratës kineze, të filozofisë kineze. Kjo burokraci, natyrisht, mori forma të reja, por qëndroi kurdoherë e plotfuqishme në aparatet shtetëror, e plotfuqishme në ushtri dhe e plotfuqishme në atë parti pseudomarksiste.

E ashtuquajtura parti marksiste-leniniste e Kinës nuk ka pasur fare tipare të një partie të tillë. Busulla e kësaj partie nuk ishte marksizëm-leninizmi, por formulimet eklektike të Mao Ce Dunit. Me veprimtarinë e saj ajo nuk ndikonte në asnjë mënyrë për të luftuar dhe për të zhdukur burokracinë, përkundrazi, e mbështeste atë, e ushqente politikisht dhe ideologjikisht. **E ashtuquajtura Partia Komuniste e Kinës me sloganet e saj bënte që komunistët dhe populli kinez të adaptonin një formë mendimi shumë arkaike, të zbatonin pa diskutim urdhrat dhe direktivat e «timonierit të madh» dhe të «kurtizanëve» të tij, duke punuar në një formë jorevolucionare, por të organizuar në mënyrë të tillë që krijonin përshtypjen se gjoja ndërtohej socializmi, që në realitet nuk ndërtohej.**

Nuk mund të gënjehet opinioni me atë që në Kinë pati disa përmirësime në jetën e popullit. Është fakt që Kina e pasrevolucionit pati disa përmirësime, domethënë pas vitit 1949 nuk është më ajo Kinë që ishte përpara.

Fshatari i varfër, për shembull, mori diçka si kompensim të luftës dhe të gjakut të derdhur, ai mori një pëllëmbë tokë dhe gjoja u organizua në një punë kolektive në komunat. Pikërisht kjo e solli atë ndryshim, që mund të themi se ishte njëfarë ndryshimi nga realiteti në Indi, ku me qindra mijë dhe me miliona njerëz vuajnë nga uria dhe vdesin prej saj. Por këto ndryshime që ndodhën në Kinë nuk mund të identifikohen me ndërtimin e socializmit, sepse vija që ndiqte Partia Komuniste e Kinës nuk ishte një vijë e vërtetë marksiste-leniniste. Si rrjedhim, masat e marra mbetën në mes të rrugës, hapat që u hodhën ishin të çala, për arsye se në fushën e ekonomisë, të ideologjisë dhe të politikës kineze u ruajtën të theksuara forcat dhe pikëpamjet e borgjezisë vendëse. Deri në njëfarë shkalle u ruajt pushteti ekonomik i borgjezisë së madhe dhe i borgjezisë së mesme. **Në këtë mënyrë, në Kinë burokracia me të gjitha të këqijat e saj nuk u zhduk, përkundrazi ajo ka luajtur dhe luan një rol vendimtar regresiv.**

Në vendin tonë, burokracia u zhduk bashkë me aparatet e pushtetit të vjetër feudo-borgjez, por lufta kundër burokratizmit vazhdon. Prandaj **Partia jonë, siç e kam theksuar vazhdimisht, duhet t'i bëjë pa pushim një luftë të ashpër e të gjithanshme burokratizmit, që shfaqet në aparatet administrative, por që shfaqet, gjithashtu, e bëhet shumë i rrezikshëm sidomos në aparatet e Partisë.** Në qoftë se ne nuk zhvillojmë një luftë të ashpër propagandistike kundër burokratizmit, në qoftë se nuk shpjegojmë rrezikshmërinë e këtij burokratizmi dhe të bartësve të tij, në qoftë se nuk sqarojmë cilët janë faktorët objektivë e subjektivë që e ushqejnë, që e fuqizojnë dhe ia imponojnë atë një shteti socialist e proletar, si dhe në qoftë se nuk marrim masa praktike në luftë kundër tij, atëherë socializmi në Shqipëri do të gjejë vështirësi të panumërta dhe do të rrezikohet.

POGRADEC, E MARTE

1 GUSHT 1978

## ZËRI I SHQIPËRISË SOCIALISTE TË JETË NJË KËMBANË E MADHE PËR PROLETARIATIN E POPUJT E BOTËS

Po ndjek çdo ditë jehonën e Letrës së Komitetit Qendror të Partisë dhe të Qeverisë sonë drejtuar Partisë Komuniste të Kinës dhe qeverisë kineze. Jehona është e madhe dhe e gjitha në favorin tonë.

Shumica e agjencive të lajmeve e kanë dhënë lajmin për Letrën tonë. Atë ditë që u transmetua dhe u botua në Tiranë, pra më 30 korrik, po atë ditë, ambasadorët në vende të ndryshme të botës, e kanë marrë broshurën në gjuhë të huaja. Ata e quajnë këtë Letër një dokument me rëndësi të madhe ndërkombëtare, dokument që përmban shumë probleme dhe sqaron shumë çështje, të cilat opinioni botëror i dinte, por jo të gjitha dhe jo se ç'vend zinin.

Ky sqarim, që Letra jonë i bën diplomacisë botërore, është shprehur qysh në kontaktet e para, në pritje të ndryshme të ambasadorëve tanë me ambasadorë të vendeve të tjera. Ambasadorët e huaj kanë përkrahur vendosmërisht qëndrimin e drejtë të Partisë së Punës të Shqipërisë e të shtetit shqiptar dhe kanë dënuar si tradhti, si një veprim arrogant, të paparë në historinë e marrëdhënieve ndërkombëtare aktuale, gjestin e ulët që bëri Kina kundër një vendi të vogël, siç është Shqipëria socialiste.

Miqtë e Shqipërisë nga të katër anët e botës kanë filluar të dërgojnë mesazhe të nxehta urimi e mbështetjeje, dashurie e respekti për Partinë e Punës të Shqipërisë dhe për vijën e saj marksiste-leniniste. Këto mesazhe përkrahjeje vijnë nga shoqatat e miqësisë të vendeve të ndryshme me Shqipërinë, si nga Franca, Italia, Kanadaja etj., vijnë nga individë të huaj, miq të Shqipërisë, vijnë nga shkencëtarë, nga deputetë të vendeve të ndryshme, kuptohet, nga deputetë demokratë që e kanë ndjekur zhvillimin e Shqipërisë, që e kanë simpatizuar këtë zhvillim, sepse kanë parë që politika e Shqipërisë është një politikë e drejtë.

Disa gazeta të huaja e kanë botuar Letrën tonë drejtuar udhëheqjes kineze dhe ka të tjera që kanë botuar sidomos të gjitha ato pjesë të Letrës ku bëhet fjalë për problemet e mëdha ndërkombëtare dhe që vënë në dukje fajësinë e Kinës dhe dëmet që ajo po i sjell Shqipërisë duke ndërmarrë një veprim të tillë të pabesë e armiqësor ndaj nesh.

Por, nga ana tjetër, edhe armiqtë punojnë kundër nesh. Ka gazeta, si në Francë, e sidomos në Itali, që thonë se «aktualisht ekziston një vakuum në Shqipëri dhe këtë vakuum prej 10 miliardë juanësh, sipas notës kineze, nuk mund ta plotësojë asnjë vend perëndimor, prandaj diplomacia amerikane duhet të vihet në lëvizje». Domethënë, këto gazeta të borgjezisë reaksionare thonë që tash Shqipërisë t'i vijë në ndihmë imperializmi amerikan, me të cilin shteti ynë socialist, qëkurse ka lindur, është në luftë të ashpër, të hapët dhe të pamëshirshme.

Shqipëria do ta ndërtojë me sukses socializmin me forcat e veta dhe nuk do të kërkojë ndihmë nga kurrkush, as nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, as nga Bashkimi Sovjetik dhe as nga ndonjë vend tjetër imperialist, socialimperialist e borgjez. **Socializmin në Shqipëri, ashtu si gjer më sot, do të vazhdojmë ta ndërtojmë**

**me sukses me forcat tona.** Shqipëria do të bëjë tregti me interes reciprok me të gjitha ato vende që dëshirojnë të bëjnë tregti me të, me përjashtim të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Bashkimit Sovjetik, Izraelit dhe disa shteteve të tjera ku sundojnë fashistët dhe racistët. Këtë ne e kemi deklaruar hapur dhe e dinë të gjithë. Por, duke hedhur këtë balonë prove, zyrtarë të Departamentit të Shtetit kanë deklaruar se Shtetet e Bashkuara të Amerikës që prej 5 vjetësh kanë bërë përcapje për të lidhur marrëdhënie me Shqipërinë. Kjo është e vërtetë, ata disa herë kanë kërkuar që të vendosen marrëdhënie diplomatike midis Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, por ne zyrtarisht, hapur, me fjalime, e kemi deklaruar se nuk do të vendosim kurrë marrëdhënie diplomatike me imperialistët amerikanë.

**E bukura në këtë mes është se HSINHUA-ja, për të na diskredituar, mbledh ku janë e ku s'janë të tilla balona prove të reaksionit dhe i boton në gazetën «Zhenminzhibao», duke dashur të thotë se po bëhen orvatje, qoftë nga Uashingtoni, qoftë nga vende të tjera reaksionare, për t'i ardhur në «ndihmë» Shqipërisë, e cila, sipas gazetës kineze, paska mbetur e mjeruar në mes të katër rrugëve! Deri këtu ka arritur politika reaksionare dhe dritëshkurtër e imperializmit kinez, i cili shikon ëndrra me sy hapur!**

Natyrisht, vendet perëndimore dhe imperializmi amerikan gjykojnë sipas kokës së tyre, prandaj ata mendojnë se është e pamundur që një vend i vogël si Shqipëria të rrojë i pavarur e sovran dhe të mos kërkojë më ndihmë nga kurrkush. Nga ana tjetër perëndimorët kanë frikë, dhe kjo është në mentalitetin e tyre, se Shqipëria, si vend i vogël që është, ka mundësi të bashkohet me Bashkimin Sovjetik revizionist dhe, për pasojë, të prishet gjithë ekuilibri strategjik luftarak i NATO-s në Mesdhe dhe në Adriatik.

Të gjitha këto janë ëndrra e shqetësime të borgjezisë, që ne do t'i demaskojmë, siç i kemi demaskuar, dhe ata do të mbeten me gisht në gojë. Ne do të shpjegojmë se të gjitha sajimet e tyre nuk kanë asnjë bazë të vërtetë. **Shqipëria do të qëndrojë e fortë, sovrane dhe e pavarur nga askush ekonomikisht, politikisht dhe ideologjikisht.** Shqipëria socialiste, që udhëhiqet nga Partia e lavdishme e Punës dhe nga ideologjia marksiste-leniniste, në luftën e saj do të ketë mbështetjen e gjithë botës përparimtare. Ky është një fakt real dhe një ndihmë internacionaliste. Shqipëria do të ketë mbështetjen e marksistë-leninistëve dhe të partive marksiste-leniniste të vërteta. Ky është, gjithashtu, një fakt dhe një e vërtetë. Ne do ta ushqejmë, do ta forcojmë dhe do ta kalitim këtë miqësi me popujt përparimtarë, me demokratët dhe, në radhë të parë, me proletariatin botëror e me komunistët marksistë-leninistë.

Ne do ta zhvillojmë me konsekuencë luftën e ashpër kundër imperializmit amerikan, socialimperializmit sovjetik e imperializmit kinez, kundër borgjezisë reaksionare, revizionizmit modern dhe të gjitha partive paçavure. Ne do të mbrojmë revolucionin dhe luftën nacionalçlirimtare të popujve, kudo që zhvillohet, do të mbrojmë interesat e proletarëve e të popujve kudo në botë. Zëri ynë kurrë nuk do të pushojë, por do të ngrihet akoma më lart në mbrojtje të vëllezërve tanë, në të katër anët e botës, që vuajnë nga shtypja dhe nga shfrytëzimi kapitalisto-imperialisto-revizionist. Ne do të demaskojmë intrigat, gënjeshttrat, falsitetet dhe teoritë e kalbura të kapitalizmit e të imperializmit që po jep shpirt. Ne do të fuqizojmë propagandën tonë me të gjitha mjetet që kemi, që zëri i Shqipërisë së vogël të jetë një këmbanë e madhe, një këmbanë zgjimi për proletariatin e popujt dhe një ndihmë për ngritjen e ndërgjegjes dhe të luftës së tyre kundër shtypjes dhe skllavërimit.

Gazetat tona duhet t'i bëjnë jehonë kësaj mbrojtjeje të madhe të Shqipërisë nga partitë marksiste-leniniste, nga shoqatat e miqësisë, nga miqtë në botë, nga individë, shkencëtarë, gazetarë, diplomatë e të tjerë. Duhet t'i bëhet jehonë e fuqishme kësaj mbështetjeje të çeliktë që po ndien nga të gjitha anët populli ynë për luftën e tij të vendosur kundër armiqve revizionistë kinezë dhe kundër të gjithë armiqve të Shqipërisë.

Me të vërtetë botimi i Letrës ka krijuar një interesim dhe hov të madh revolucionar në popullin tonë dhe më thonë se të dielën nëpër qoshkat ku shiteshin gazetat, kishte një grumbullim kaq të madh saqë njerëzit shtyheshin kush e kush të merrte një gazetë. Kjo tregon interesimin e madh dhe ngritjen politike të popullit, mbështetjen e tij të fortë në vijën e Partisë dhe solidaritetin me Partinë në çdo betejë dhe në çdo luftë që kjo ka ndërmarrë kundër armiqve të Shqipërisë socialiste dhe udhëheqjes së saj, Partisë së Punës.

**Te kjo mbështetje popullore qëndron forca e madhe e Partisë sonë, që do të bëjë të dështojnë të gjitha përpjekjet e armiqve dhe do t'u tregojë miqve dhe shokëve kudo në botë se në Shqipërinë socialiste, pavarësisht se është e vogël, qëndrojnë lart dhe të papërkulura idetë e mëdha të marksizëm-leninizmit, që janë të sajat dhe të tyre.**

POGRADEC, E MËRKURE

2 GUSHT 1978

## INTERESIM I JASHTËZAKONSHËM PËR LETRËN TONË

Lexoj vazhdimisht radiogramet e ambasadorëve tanë nga vende të ndryshme, si dhe lajmet e agjencive të ndryshme. Diplomatët dhe kancelaritë e vendeve të huaja si dhe shtypi botëror, po flasin gjerësisht për Letrën e Komitetit Qendror të Partisë dhe të Qeverisë sonë drejtuar Kinës. Kjo Letër, nga të gjithë konsiderohet si një dokument me rëndësi të madhe historike dhe kudo shfaqin mendime shumë të favorshme, mbrojnë Shqipërinë se i gjejnë të dokumentuara e të faktuara çka kemi thënë ne në adresë të partisë dhe të qeverisë kineze. E rëndësishme është se ato që themi ne në këtë Letër nuk janë vetëm çështje që kanë të bëjnë thjesht me marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe Kinës, por janë çështje që i interesojnë edhe politikës ndërkombëtare. Kjo ndodh për arsye se Kina është një shtet i madh që aspirojnë të bëhet një superfuqi, kurse Shqipëria është një vend i vogël, por një vend socialist i vërtetë, që mbron një ide të madhe, revolucionin dhe marksizëm-leninizmin, që lufton imperialistët, revizionistët dhe borgjezinë reaksionare.

Këtu qëndron interesimi i madh që ka ngjallur lufta e «Davidit me Goliatin», siç e kanë cilësuar disa agjenci të shtypit. Deri tash nuk kam dëgjuar që ndonjë ambasador, flas për ambasadorët e vendeve kapitalisto-revizioniste, të mos ketë thënë fjalë të mira për qëndrimin

burrëror, të palëkundur, të pavarur, të Shqipërisë socialiste. Kjo ka rëndësi të madhe për ne, jo se përfaqësuesit e borgjezisë e duan këtë qëndrim të vendosur të Shqipërisë socialiste, përkundrazi, por sepse ky qëndrim i Shqipërisë së vogël socialiste është aq i fortë, aq i qartë, sa që as përfaqësuesit e vendeve borgjezo-revizioniste nuk mund të gjejnë fakte dhe argumente që ta kundërshtojnë. Prandaj, duan s'duan, e thonë mendimin e tyre dhe ky mendim, pa qenë, si të thuash, dashamir në thelb, është realist ndaj Shqipërisë. **Në këto mendime që ata shprehin në favor të Shqipërisë luajnë rol, gjithashtu, edhe kontradiktat e mëdha që ekzistojnë midis imperialistëve, qofshin ato midis imperialistëve amerikanë, francezë, japonezë, anglezë, gjermanoperëndimorë e të tjerë, qofshin në mes vendeve kapitaliste të mëdha, të mesme e të vogla me fuqitë e mëdha, qofshin edhe ato midis popujve që janë në anën tonë dhe udhëheqësve të tyre. Këto mendime shprehen në një mënyrë ose në një tjetër, pavarësisht se ambasadori që i thotë ato, është përfaqësues i këtij apo i atij shteti, i këtij apo i atij regjimi.**

Arsyeja tjetër që këta ambasadorë flasin në favor të politikës sonë, është se politika kapitaliste e Kinës, kthesa e politikës së saj në një mënyrë të tillë kaq të hapët e skandaloze, i ka çuditur shtetet e ndryshme të botës dhe ka krijuar në to, qofshin të mëdha, ose të vogla, dyshime për politikën vazhdimisht të lëkundshme të shtetit kinez.

**Aktualisht ata shohin se Kina e Hua Kuo Fenit dhe e Ten Hsiao Pinit po ecën drejt bashkimit me imperializmin amerikan dhe me borgjezinë kapitaliste perëndimore. Është e kuptueshme që një politikë e tillë është në interes të imperialistëve. Këta përfitojnë nga kjo politikë, se Kina është një treg i madh ku ata mund të bëjnë investime e të nxjerrin fitime përrallore, por, në të njëjtën kohë, kanë edhe frikë, edhe dyshim, se një politikë e tillë**

pragmatiste e Kinës, që mund të kthehet në çdo qoshe rruge, mund që një mëngjes të drejtohet pro Bashkimit Sovjetik dhe kundër aleancës aktuale që ajo po ngre me botën kapitaliste perëndimore.

**Pikërisht qëndrimi i Shqipërisë socialiste, politika e saj gjithmonë konsekuente, analiza e shëndoshë, e bazuar, e argumentuar dhe bindëse që u bën ngjarjeve në botë, përbëjnë një nga faktorët objektivë që i detyron kancelaritë e shteteve të ndryshme dhe, në radhë të parë, të gjithë ata elementë progresistë nga populli që marrin kontakt me njerëzit tanë dhe lexojnë e studiojnë materialet politike dhe ideologjike të Partisë sonë, të shprehin respekt dhe admirim për politikën tonë.**

Këtu qëndron simpatia e madhe që ka krijuar Partia e Punës e Shqipërisë me qëndrimet e saj të drejta të palëkundshme marksiste-leniniste dhe, veçanërisht, qëndrimi i drejtë ndaj veprimit armiqësor e të pabesë, antimarksist e shovinist të shtetit të madh kinez ndaj Shqipërisë. Ata i prenë kësaj kreditë, duke i lënë një numër veprash ekonomike në mes të rrugës, të papërfunduara, dhe duke zbuluar sekretet ushtarake.

Akti armiqësor i Kinës ndaj Shqipërisë e ka demaskuar dhe e demaskon atë përpara popujve të vegjël, ku ajo, me teoritë e saj gjoja marksiste-leniniste dhe me famën që i ka dalë se gjoja është një vend socialist, ka mundur të krijojë njëfarë autoriteti. Tash Kina po demaskohet dhe po shtohet mosbesimi i këtyre popujve ndaj të ashtuquajturave ndihma kineze ose përkrahje politike nga ana e saj. **Këta popuj po e kuptojnë se ndihma kineze është një falsitet e ka për qëllim nënshkrimin e tyre politiko-ideologjik ndaj saj dhe njëkohësisht shfrytëzimin e tyre, tamam ashtu siç kanë bërë dhe po bëjnë gjithë imperialistët dhe kapitalistët e tjerë.**

Pra ky gjest i Kinës ndaj Shqipërisë, ndaj një vendi të vogël, por që e ka mbështetur Kinën në ditë të vë-

shtira, ka bërë që ajo të humbasë në të gjitha drejtimet. Me qëndrimet e saj kundër Vietnamit ajo po tregohet një vend agresiv dhe me veprimet që ndërmori, gjithashtu, kundër Shqipërisë, tregohet një fuqi e madhe imperialiste, kapitaliste, ekspansioniste. Është fakt që ky qëndrim i Kinës na dha neve shkas që të flasim më hapur për kontradiktat e mëdha politiko-ideologjike dhe ekonomike, që kishim hasur gjatë gjithë periudhës së bashkëpunimit me partinë dhe me qeverinë kineze.

Nga ana jonë, siç e dimë dhe siç e kemi bërë të qartë në materialet tona, janë mbajtur kurdoherë qëndrimet e drejta dashamire dhe marksiste-leniniste ndaj Partisë Komuniste të Kinës dhe qeverisë kineze. Me këtë dua të them se ne, në mënyrë shoqërore, ia kemi vënë në dukje veprimet e gabuara udhëheqjes kineze, si dhe pikëpamjet tona për probleme të ndryshme që s'kemi qenë dakord me të. Ne kemi konstatuar se mendimet tona ose kritikrat që i kemi bërë asaj kanë rënë në vesh të shurdhër. Megjithatë, siç e kemi theksuar, ne kemi vazhduar rrugën tonë, domethënë kemi mbajtur qëndrime të drejta marksiste-leniniste, të cilat binin në kundërshtim të hapët me politikën dhe me qëndrimet e Kinës. Por, siç e kam shpjeguar edhe më parë, këto divergjenca nuk i bëjnë publike. Duhet të themi se, deri në njëfarë shkalle, ekipi Mao Ce Dun-Çu En Lai evitonte përplasjen me ne në mënyrë të hapët. Ai na vuri përpara tezën: «Ne nuk duam të bëjmë polemikë me ju» kurse ne i vumë përpara tezën tonë: «Partia e Punës e Shqipërisë mbron dhe shpall haptazi vijën e saj për të gjitha problemet botërore, pavarësisht se ndokujt nuk i pëlqen një qëndrim i tillë».

Kështu që në praktikë me kohë ka pasur divergjenca për shumë çështje parimore në mes nesh dhe udhëheqjes kineze, gjë që e ka vënë re edhe opinioni botëror. Kapitalizmit dhe revizionizmit modern nuk u interesonte që

të bënin fjalë për një gjë të tillë, prandaj këta e paraqitnin Shqipërinë si një «zëdhënëse» të politikës kineze. **Ky qëndrim u interesonte edhe atyre, edhe kinezëve. Reaksioni botëror e pomonte Kinën sikur ne ishim «gramafoni» i saj, por edhe Kinës i vinte mirë nga një paraqitje e tillë dhe, pavarësisht nga kontradiktat e mëdha që shfaqeshin në vijën tonë të përbashkët, ata i linin përshypjen opinionit botëror sikur ishin në unitet të plotë me ne. Për këtë gjë dhe në funksion të kësaj paraqitjeje, kinezët reklamnin ndihmat e kreditë që na akordonin neve. Për kinezët këto ndihma e kredi shprehnin unitet mendimesh dhe pikëpamjesh filozofike, politike dhe ideologjike midis tyre dhe nesh. Por kjo gjë nuk ishte e vërtetë.**

Ne nuk e kemi mohuar asnjëherë ndihmën që na ka dhënë Kina për zhvillimin ekonomik të vendit, por këto ndihma ekonomike ose kredi mendonim se i jepeshin shtetit tonë socialist nga një vend mik. Për akordimin e këtyre ndihmave e kredive ne kemi luftuar, bile kemi luftuar shumë dhe kemi hasur në kundërshtime parimore me Çu En Lain e me njerëzit e tij të aparatit burokratik shtetëror. Çu En Lai nuk ka dashur që ne të zhvillojmë industrinë, sidomos industrinë e rëndë dhe, «për ta argumentuar» këtë vijë të gabuar dhe antimarksiste të tij, ai nxirrte vetëm një arsye: «Ju nuk keni forca që ta ndërtoni këtë industri të rëndë, ju nuk keni përcaktuar akoma si duhet rezervat e kësaj industrie të rëndë dhe, për ta ndërtuar këtë degë të industrisë, do të dobësoni fshatin, duke tërhequr fshatarësinë në qytete dhe, si rrjedhim, do të mbeteni pa bukë».

Kjo pikëpamje është shprehje e teorisë revizioniste e antimarksiste të Mao Ce Dunit e të Çu En Lait, të cilët vazhdimisht kanë predikuar se në revolucionin proletar dhe në ndërtimin e socializmit rolin vendimtar e luan fshatarësia. Pra, sipas tyre, në radhë të parë duhet të

zhvillohet bujqësia, pastaj industria, dhe, më në fund, industria e rëndë. Por ne, vazhdimisht ua kemi kundërshtuar këtë pikëpamje antimarksiste Çu En Lait dhe Li Hsien Nienit, dy zëdhënësve kryesorë të kësaj «teorie» të Maos. Nga diskutimet parimore dhe konkrete në takimet e bisedat me ta ne kemi dalë fitimtarë.

Pra, për kreditë që na janë akorduar neve nga ana e Kinës kemi hasur vazhdimisht në dy kundërshtime: së pari, në kundërshtimin parimor se në vendin tonë, sipas kinezëve, nuk duhej ndërtuar një industri e rëndë dhe, së dyti, se ne nuk qenkemi në gjendje ta ndërtojmë këtë industri të rëndë, se do të dobësojmë fshatin me forcat që do të tërheqim andej për në qytet. Dhe konkretisht, si rezultat i këtyre kundërshtimeve, nga ana e tyre ndihmat nuk kanë qenë të mjaftueshme. Kjo jo se donim ne të ishin të tilla, as sepse Kina nuk kishte mundësi të na i jepte, por sepse pengonin pikëpamjet e revizionistëve kinezë me të cilat ne ndesheshim vazhdimisht gjatë bashkëpunimit.

POGRADEÇ, E ENJTE  
3 GUSHT 1978

## **SHQIPËRIA DO TË QËNDROJË KURDOHERË E LIRË, E PAVARUR DHE SOVRANE**

Udhëzova të thërritet ambasadori ynë në Vjenë për ta thelluar disi me të çështjen e korrespondentit gjerman, që i kishte folur atasheut tonë atje në lidhje me dëmshpërblimet. Kam lajme se edhe një atashe i Republikës Federale të Gjermanisë në Berlin më duket i ka folur, bile drejtpërdrejt atasheut tonë në lidhje me çështjen se qeveria e Bonit nuk është kundër që t'i japë Shqipërisë dëmshpërblimet e luftës, sidomos në këto situata, kur edhe Kina ia preu kreditë, por çështja pengohet vetëm nga mosmarrëveshjet që ka ajo me partinë e Shtrausit.

Ambasadori ynë duhet të ketë shumë kujdes në këtë çështje, ta vërtetojë thënien e korrespondentit dhe t'i lërë atij të kuptojë se Republika Federale e Gjermanisë duhet t'i paguajë Shqipërisë dëmet e luftës, domethënë reparacionet; t'i lërë të kuptojë se për këtë çështje Qeveria Shqiptare nuk bën përgjegjëse qeverinë aktuale të Gjermanisë Perëndimore, por qeverinë e Hitlerit.

Ai duhet t'i theksojë gjermanit se pagimi i dëmshpërblimeve është i domosdoshëm dhe i nevojshëm përpara çdo hapi tjetër, pse vendi ynë është djegur. Vetëm pasi të përcaktojmë dëmshpërblimet, mund të bëhet fjalë për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike. Ambasadori ynë t'i theksojë, gjithashtu, mirë këtij personi se është fjala vetëm për dëmshpërblime për djegiet, vrasjet dhe

shkatërrimet që na bëri Gjermania naziste dhe nuk do të kenë në asnjë mënyrë karakterin e një kredie «pa interes» ose të një ndihme pa kthim, apo ndonjë formulë tjetër të këtyllë, që aktualisht po përdorin imperialistët.

Shokët tanë duhet të jenë shumë të kujdesshëm në këto çështje, pse ka mundësi që reaksioni të përpiqet t'i futë ata në kurth dhe të bëjë bujë rreth saj. Me fjalë të tjera ata duan të mos dalë asgjë mbi ujë, vetëm sa të bëhet zhurmë, se gjoja Shqipëria po lidhet me Gjermaninë Perëndimore.

Shokët më njoftuan se e paskan thirrur ambasadorin tonë në Vjenë, ia paskan vënë mirë në dukje këtë çështje dhe se presin ç'do të rezultojë nga kjo përçapje.

Natyrisht, imperializmi gjerman dhe imperialistët e tjerë perëndimorë, qoftë edhe sikur vetëm tre-katër për qind të ecin në rrugën e dhënies së dëmshpërblimeve vendit tonë, do të përpiqen ta propagandojnë këtë punë, sikur ne u lidhëm me perëndimorët. Por kërkesa për dëmshpërblime është një e drejtë e popullit tonë. Ato ne i kemi kërkuar prej kohësh, sepse na i ka borxh shteti gjerman, sepse Hitleri dhe të dërguarit e tij luftuan kundër popullit shqiptar, janë përgjegjës për shkatërrimet dhe për krimet që bënë në kurriz të popullit tonë, prandaj duhet t'i paguajnë dëmet e mëdha që i kanë bërë vendit tonë. Dëmshpërblime Republika Federale e Gjermanisë u ka paguar të tjerëve. Vetëm Shqipërisë, më të voglit vend, nuk ia ka paguar ende, ndërsa të mëdhenjtë i kanë marrë ato prej kohësh dhe deri më një. Prandaj kjo është e drejta jonë dhe ne do të dimë mirë ta vëmë në dukje se këto janë dëmshpërblime të detyrueshme nga ana e qeverisë federale të Bonit dhe marrja e tyre nuk e bën asnjë grimë Shqipërinë socialiste të lëvizë nga qëndrimi i saj parimor për ruajtjen e pavarësisë, të lirisë dhe të sovranitetit të vendit të vet. Politika e Shqipërisë nuk ka ndryshuar. Kjo politikë ka qëndruar

dhe do të vazhdojë si kurdoherë të qëndrojë e pavarur e në luftë me imperializmin amerikan, me gjithë reaksionin botëror, me socialimperializmin sovjetik dhe me socialimperializmin e ri kinez. Ne nuk ia kemi nderur dhe as do t'ia nderim kurrkujt dorën. Ne nuk do të marrim ndihma nga kurrkush, por do ta ndërtojmë atdheun tonë socialist me forcat tona dhe jemi plotësisht në gjendje ta bëjmë këtë gjë.

Çështja e marrëdhënieve tregtare është tjetër gjë. Me përjashtim të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Sovjetik ne do të bëjmë tregti me të gjitha shtetet që kanë interes, siç kemi dhe ne vetë interes. Shkëmbimet tregtare nuk do ta lidhin Shqipërinë me kurrkënd. Tregtia me çdo vend që do të bëjmë, do të jetë një tregti me leverdi reciproke, në interes të për-bashkët, më jep, të të jap. Ajo që të intereson të marrësh nga ne, merre dhe unë do të marr atë që më intereson, do të kërkoj atë që më intereson. Në qoftë se dëshiron të ma japësh me para në dorë ose me klering, ma jep, në qoftë se nuk do, kurrë mos e dhënç. Kështu ngjet dhe do të ngjasë edhe për mallrat që ne do të eksportojmë. Pra, tregtia është e lejueshme për ne dhe do t'i bëjmë popujt që edhe në këtë sferë të shohin se Shqipëria nuk e konfondon tregtinë me marrjen e ndihmave ose të kredive. Këto janë dy gjëra të ndara. Në botën aktuale kreditë dhe ndihmat konfondonen me marrëdhëniet tregtare. Por qëndrimi i pushtetit tonë popullor do t'u tregojë të gjithëve si në praktikë, ashtu edhe në teori, se tregtia nuk ka lidhje me ndihmat ose me kreditë që japin e marrin shtetet borgjeze kapitaliste dhe revizioniste në mes njëri-tjetrit. Tregtia i lë duart të lira shtetit shqiptar të veprojë e të vendosë ashtu si dëshiron vetë, të thotë fjalën e vet ashtu siç e mendon, të ndërtojë vendin e vet me forcat e tij ashtu siç dëshiron. Këtë gjë ne do t'ua bëjmë vazhdimisht të

ditur dhe të qartë gjithë sharlatanëve, gazetarëve dhe atyre burrave shteti që do të përpiqen t'i ngatërrojnë këto dy çështje dhe të gënjejnë opinionin sikur Shqipëria tash «që mbeti në mes të rrugëve», u lidh me njërin dhe me tjetrin. Me askurrkënd Shqipëria nuk lidhet, ajo do të qëndrojë kurdoherë e lirë, e pavarur dhe sovrane.

POGRADEC, E ENJTE

3 GUSHT 1978

## POLITIKA E KINËS NË BALLKAN

Ekipi Mao Ce Dun-Çu En Lai ka luajtur një rol të madh dhe vendimtar në gjithë historinë moderne të Kinës, që nga lufta nacionalçlirimtare dhe deri sot. Vija e këtij ekipi është bërë lajtmotivi i politikës së Kinës, i asaj politike jomarksiste, por kapitaliste e imperialiste që kanë ndjekur partia dhe shteti kinez. Mao Ce Duni ishte ëndërruesi, vizioneri i një politike feudale, i një politike që e kishte burimin te pikëpamjet mbi Perandorinë e Mesit. Natyrisht, kjo politikë e Maos merrte parasysh ndryshimet e kohës, por në esencë ajo dhe mendimet filozofike të tij kishin për qëllim që Kina të kthehej në një fuqi të madhe për të dominuar botën ideologjikisht, politikisht dhe ekonomikisht.

Për sa i përket dominimit ideologjik gjatë gjithë periudhës që ishin në fuqi, të dy këta njerëz kryesorë të ekipit udhëheqës kinez, ndërtuan një filozofi të tyren, të cilën e vetëquanin marksiste-leniniste, por që në thelb në teori dhe në praktikë, nuk ishte marksiste-leniniste. Teoria e Mao Ce Dunit dhe e Çu En Lait ishte një lëmsh teorish idealiste e teorish të reja të kapitalizmit botëror, të pleksura me ca formulime marksiste-leniniste, të përziera edhe me formulime menshevike, socialdemokrate, sindikaliste e anarkiste, të cilat ata i kishin adaptuar. Që të gjitha këto teori të reja antimarksiste ishin radhitur rreth boshtit të teorisë së vjetër konfuciane dhe «dialek-

tika» që ngriti në sistem Mao Ce Duni, ishte teoria e daoizmit, një «teori» e të kundërtave, e reduktuar në një banalitet të pakufishëm.

Pra Maoja ishte ëndërruesi, ishte hija e madhe, kurse Çuja ishte njeriu që shkonte andej-këtej, që gënjente, komplotonte, bisedonte e diskutonte kurdoherë për t'ia arritur qëllimit të tij të caktuar, për ta bërë Kinën një fuqi të madhe.

Çu En Lai ishte një organizator me rëndësi dhe në vijën e tij, mund të themi, ishte shumë i zgjuar. Të gjithë atyre që u interesonte, zgjuarsinë e tij kanë ditur ta vinin në dukje, bile edhe ta fetishizonin, kurdoherë nën hijen e Maos. Maoja ishte perëndia, Çuja i biri. Çdo gjë që bënte Çuja ishte gjoja zhvillimi i mendimit të «timonierit të madh». Por në realitet, po të shohim jetën dhe veprimtarinë e Çu En Lait, do të konstatojmë se ky ka qenë një kameleon i dorës së parë, ka qenë me të gjithë dhe kundër të gjithëve, derisa arriti në një stabilitet për të qenë ekzekutuesi i «timonierit të madh», por një ekzekutues realist, që e linte ëndërruesin të ëndërronte dhe të grinte përralla dhe këto Çuja i kanalizonte në pikëpamjet e veta pragmatiste dhe konkrete.

Gjatë gjithë jetës së Partisë Komuniste të Kinës ky kameleon ka qëndruar mbi ujë. Ka ndodhur kështu sepse ai ka qenë me të gjitha fraksionet që kanë dalë dhe, kur ato luftonin njëra-tjetrën, ky dinte të zgjidhte fraksionin e fuqishëm, dinte, gjithashtu, që ta linte në baltë fraksionin që do të humbiste dhe kthente fytyrën drejt fraksionit që do të merrte fuqinë. Kështu që në historinë e Partisë Komuniste të Kinës Çu En Lai ka luajtur një rol djallëzor, të shumëllojtë, të një njeriu ose diplomati pa parim, por zgjuarsia e tij, përpikaseteti dhe busulla e ambicies së tij të madhe për vetveten dhe për Kinën e bënin atë që në çdo kthesë të historisë së Kinës të qëndronte kurdoherë si njeriu i dëshiruar dhe i nevojshëm

për mbajtjen e timonit. Të gjithë ngriheshin, uleshin, merrnin fuqinë, hidheshin tej, që nga Van Mini dhe deri te Mao Ce Duni, kurse Çu En Lai kurdoherë qëndronte në këmbë, dhe, si të thuash, ishte ai që rregullonte hesapet.

Kështu ka vepruar Çu En Lai edhe me Kominternin. Kominterni ka pasur te Çu En Lai herë mbështetësin e pikëpamjeve të tij të drejta, por në të shumtat e rasteve kundërshtarin e direktivave të tij të drejta. Veçse ky kundërshtim i Çusë ka qenë i kamufluuar, që edhe i zbatonte disa direktiva të Kominternit, por nga ana tjetër edhe i luftonte.

Kur u thye Ushtria e Kuqe e Mao Ce Dunit dhe filloi Marshimi i Madh, i cili hyri në histori si një ngjarje e shquar, por që në realitet ishte një tërheqje jo si çdo tërheqje, Çu En Lai u bashkua me Mao Ce Dunit dhe, pasi likuiduan Komitetin Qendror të drejtuar prej Van Minit, caktuan një komitet të ri qendror. Them që e caktuan ata Komitetin Qendror sepse nuk ishte partia dhe kongresi i saj që e bënë këtë, por, si kurdoherë, udhëheqjet e partisë në Kinë kanë qenë dhe janë produkt i klaneve që marrin fuqinë dhe krijojnë një udhëheqje të sajuar me emrin «Komiteti Qendror i Partisë».

Pra që në atë kohë Çu En Lai ishte faktotumi i «timonierit të madh» dhe ne e shohim atë të lëvrijë si një ngjalë në të gjitha situatat, të marrë kontakte me Çan Kai Shinë, që gjoja luftonte me japonezët, ta lirojë Çan Kai Shinë, kur u zu rob nga ushtria ose nga një pjesë e Ushtrisë së Kuqe (kjo formohej nga turma njerëzish me armë dhe pa armë që quheshin ushtri e kuqe). Çuja lëvrinte në mes oficerëve të lartë anglezë dhe amerikanë, të cilët ndihmonin efektivisht Çan Kai Shinë, por, kur e panë se vapori i këtij po mbytej, i drejtuan sytë më seriozisht nga Mao Ce Duni dhe Çu En Lai.

Nga raportet e agjenturës amerikane, që kanë dalë

në dritë me botimin e «Librit të bardhë» për Kinën ose nëpërmjet veprave të Edgar Snout e të të tjerëve, mësojmë se dëshirat dhe aspiratat ideologjike dhe politike të Maos dhe të Çusë, që gjatë viteve 40-të, afroheshin shumë me demokracinë amerikane dhe largoheshin nga Bashkimi Sovjetik, të cilin nuk e dheksnin, nuk e pranonin. Ndodhte kjo për arsye se Bashkimi Sovjetik i Leninit dhe i Stalinit ishte shteti i proletarëve, i diktaturës së proletariatit, ishte qendra e revolucionit botëror, kurse strategjia e grupit Mao-Çu ishte që Kina të bëhej qendra e botës dhe ideologjia e tij të përfaqësonte atë ideologji botërore që të mund ta dominonte dhe ta përpunonte një-rëzimin sipas një teorie të re, të cilën e quajtën maoce-dunide dhe që i përshtatej kohës. Cilës kohë? Kuptohet, kohës së vazhimit të jetës së kapitalizmit botëror dhe të kërkimit të disa formave organizative dhe politike re-formative, për t'ua lehtësuar sadopak popujve shtypjen dhe skllavërimin që u bëhej.

Me fjalë të tjera, Mao Ce Duni dhe Çu En Lai e ushqenin me këmbëngulje të madhe këtë vijë dhe shkrimet e Mao Ce Dunit, që deri diku i zbatonte Çu En Lai, ishin të maskuara me formulime të ndryshme, siç e thashë më parë, formulime të gjitha të kohës, por që në epiqendër, kishin filozofinë e vjetër konfuciane të Perandorisë së Mesit dhe organizimin e Kinës sipas parimeve të Konfucit, natyrisht, duke i përshtatur ato me kohën moderne.

Mao Ce Duni dhe Çu En Lai, së toku me ekipin e tyre, kanë qenë të bindur se kjo «filozofi» do të krijonte simpatinë dhe admirimin e gjithë popujve të botës dhe në këtë mënyrë ata do të realizonin ëndrrat e tyre hyjnore.

Me Shqipërinë dhe me Partinë e Punës të Shqipërisë Çu En Lai ka zhvilluar kurdoherë një politikë specifike. Ai ka dashur që Shqipërinë socialiste, Partinë e Punës të Shqipërisë, të cilat i përballuan me sukses vështirësitë

e panumërta që u nxorën përpara fashistët italianë, hitlerianët, anglo-amerikanët, titistët, monarko-fashistët grekë, revizionistët sovjetikë e të tjerë, me këtë autoritet të madh që kishin fituar nga lufta e tyre e vendosur dhe e drejtë, t'i shfrytëzonte në interes të strategjisë së tij. Dhe duhet thënë se Çu En Lai për këtë përdori gjithë dinakërinë, gjithë diplomacinë e tij, por këto nuk i shkuan, pse Partia jonë dhe udhëheqja e saj kishin fituar një eksperiencë të madhe dhe e kuptonin esencën e politikës dhe të ideologjisë së Çu En Lait, u rezistonin djallëzive të tij dhe i vinin atij përpara qëllimin e drejtë të politikës marksiste-leniniste të një vendi socialist dhe të një partie që ndjek me besnikëri socializmin shkencor.

Çu En Lai e nënvleftësonte forcën e Shqipërisë së vogël, të cilën synonte ta nënshtronte. Ai u përpoq drejtpërdrejt të na godiste me teorinë e tij pragmatiste, me arsyetimet e tij pa baza, se, siç e thashë më lart, ne «s'duhej të ndërtonim industrinë e rëndë», «s'duhej të linim pas dore fshatin» dhe arriti deri atje sa të thoshte se «ju, shqiptarët, nuk bëni luftë klase!» **Por në qoftë se ekzistonte një parti që kishte bërë dhe bënte luftë klase të vërtetë në shoqëri dhe në gjirin e partisë edhe në periudhën e ndërtimit të socializmit, kjo ishte Partia jonë, kurse ata vetë bënë të kundërtën.**

Kur Çu En Lai pa se nuk mundi ta lëvizte dot nga rruga dhe vija e drejtë këtë shkëmb graniti, ai u përpoq të na merrte krahët. Këtë mendoi që të na e bënte ashtu siç mendojnë dhe siç veprojnë gjithë imperialistët duke e marrë kalanë nga brenda, duke përfitur nga miqësia midis dy vendeve tona që nga ne ishte e sinqertë. Çu En Lai dhe njerëzit e tij përpiqeshin e punonin të krijonin një grup të fortë brenda në vendin tonë, sidomos ushtarak, por edhe ekonomik, që të mund ta hidhte kalanë tonë në erë. Me kohë Çu En Lai ka qenë partizan i këtij komploti, i cili mori fund me shkatërrimin e tradhtarëve Beqir

Balluku, Petrit Dume, Hito Çako, Abdyl Këllezi, Koço Theodhosi dhe Kiço Ngjela.

Karakteristikë e këtij komploti, të kryesuar nga tradhtarët që përmenda, ishte se ai kishte po ato karakteristika që kanë mbizotëruar gjatë gjithë veprimtarisë së Partisë Komuniste të Kinës dhe të grupit Mao-Çu. Dome thënë, ata donin që me anë të ushtrisë të vendosnin në Shqipëri njerëzit e tyre dhe vendin tonë ta kthenin ekonomikisht në një administratë të largme të Kinës, me forma vetadministruese. **Për të realizuar këto qëllime Çuja dhe shokët e tij luanin edhe me kartën e tregtisë, nëpërmjet Kiço Ngjelës, edhe me kartën e investimeve, nëpërmjet Abdyl Këllezit, kurse puçin ushtarak e kishin organizuar me grupin e Beqir Ballukut dhe ishin të sigurt që do të ndihmoheshin nga ata për arritjen e qëllimeve të tyre djallëzore.** Udhëheqësit kinezë, e konkretisht Çu En Lai, arritën deri aty sa të propozonin edhe nënshkrimin e një aleance ushtarake midis Shqipërisë, Jugosllavisë dhe Rumanisë, me qëllim që dominimi i Kinës mbi Evropë të merrte proporcione më të gjera. Në këtë drejtim punohej në mënyrë të hapët me udhëheqjen revizioniste rumune me Çausheksun në krye, e cila nuk ishte veçse një udhëheqje e shitur, një agjente e dyfishtë dhe e trefishtë e sovjetikëve dhe e kinezëve e njëkohësisht edhe e amerikanëve. Megjithatë kinezët, nën maskën e grupit të Çausheksut, që gjoja kundërshton social-imperializmin sovjetik, i zhvilluan haptazi lidhjet me Rumaninë. Për këtë ata patën kundërshtim nga ne, jo se donim t'i pengonim, por sepse ne i demaskuam udhëheqësit rumunë për politikën e tyre prej lavireje, për politikën e tyre oportuniste revizioniste dhe si një agjunkturë e revizionistëve sovjetikë.

**Ne ishim të bindur se kinezët luanin edhe tablonë e amerikanëve, por edhe tablonë e sovjetikëve: në rast se nuk u dilte gjë nga njëra anë, ktheheshin nga ana tjetër.**

Për sa u përket lidhjeve me Jugosllavinë, ata i zhvilluan ato në heshtje, por me titistët ishin dakord. Kinezët, për Titon, për titizmin, si zakonisht kishin ndryshuar pikëpamjet e asaj kohe kur Titon e quanin një renegat të poshtër, një tradhtar dhe titizmin një agjunkturë të imperializmit. Tash ata, në heshtje kishin ardhur në akord, se Titoja na qenkej një «marksist-leninist i madh», që «i rezistoi me sukses Stalinit» dhe se në Jugosllavi «ndërtohet socializmi»!

**Këto rezultate, që politika kineze e ekipit Mao-Çu kishte arritur në Ballkan, i ishin bërë me siguri të qarta grupit të Beqir Ballukut, prandaj ky në heshtje përgatiti planin e tij «të rrëshqitjes», «të të dalit në mal», «të teorisë së luftës partizane» dhe të unitetit me Jugosllavinë dhe me Rumaninë.**

**Pra, komploti i Çu En Lai me Beqir Ballukun, Petrit Dumen, Hito Çakon, Abdyl Këllezin, Koço Theodhosi e Kiço Ngjelën mbështetej në këto tri drejtime: në puçin ushtarak, në vetadministrimin jugosllav e në sabotimin e ekonomisë dhe në veprimin e përbashkët, në një kohë kur uniteti kino-amerikan po bëhej një realitet. Çu En Lai, pra, kishte në plan që ta rrëzonte udhëheqjen tonë, të shkatërronte ndërtimin e socializmit në vendin tonë, të ndryshonte orientimin politik, ideologjik, ekonomik e ushtarak dhe, në rast se sovjetikët do të na sulmonin nga deti, Beqir Balluku me planin e tij operativ tradhtar, që shkonte në kundërshtim me planin strategjik që kishim vendosur ne për të mbrojtur pëllëmbë për pëllëmbë tokën tonë, veçanërisht bregdetin, por edhe gjithë kufijtë e Shqipërisë, t'ia linte portat hapur flotës sovjetike. Këtu Çu En Lai synonte të realizonte dy qëllime:**

**Qëllimi i parë ishte që të largonte zjarrin socialimperialist nga Kina, se pavarësisht nga mburrjet dhe nga predikimet se Bashkimi Sovjetik gjoja do të sulmonte Evropën dhe vetëm Evropën, mbasi Kinën «nuk e sul-**

monte dot», udhëheqësit kinezë i trembeshin një gjëje të tillë. Çuja komplotonte që ta fuste Evropën në zjarr, se ishte e qartë që hyrja e flotës sovjetike në Shqipëri ose lufta jonë për ta penguar hyrjen e saj në vendin tonë do të krijonin turbullira të mëdha në Evropë, gjë që do të shkaktonte një luftë botërore. Ndryshe prishej i tërë plani strategjik i Mao Ce Dunit.

**Qëllimi i dytë ishte Ballkani, i organizuar nga «mençuria» e taktikës së Çu En Lait.** Sipas tij, në rast se Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk futeshin në orbitën e qëllimeve dhe të dëshirave të Kinës, Ballkani të bëhej një pikë nevralgjike e rrezikshme. Domethënë Çuja, si intrigant që ishte, kërkonte t'i përdorte Shqipërinë dhe Ballkanin si një mollë sherri për të ndezur një luftë të tretë botërore, një luftë midis socialimperializmit sovjetik dhe imperializmit amerikan, midis NATO-s e Traktatit të Varshavës, të shpëtonte Kinën nga kjo luftë dhe në këtë mënyrë të ndihmonte strategjinë e ekipit Mao Ce Dun-Çu En Lai, që Kina të dilte fitimtare dhe të dominonte botën politikisht, ideologjikisht dhe ekonomikisht, gjoja si një vend i madh e i fuqishëm «socialist marksist-leninist», si një fuqi e madhe që të shkaktonte shkatërrimin e dy superfuqive, të vendoste supremacinë e saj botërore. Kjo ishte «taktika» e zgjuar e këtij pehlivani, pragmatisti e antimarksisti, që quhej Çu En Lai.

Natyrisht, tash diplomacia botërore i studion këto çështje, po thellohet dhe shikon në to qëllimet e revizionistëve kinezë. Ajo shikon se plani i Çu En Lait mbi Shqipërinë, Jugosllavinë dhe Rumaninë ishte një intrigë shumë e rrezikshme për të gjithë popujt e Ballkanit dhe për gjithë popujt e botës. **Pikërisht Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë luajti një rol vendimtar duke penguar realizimin e planeve të luftënxitësve grabitqarë, duke shkatërruar përgatitjet e një lufte botërore imperialiste. Kjo luftë botërore që predikojnë e përgatitin**

**kinezët, në të cilën Ballkani do të luante lojën e fuçisë së barutit, hynte në kategorinë e luftërave imperialiste, të cilat Lenini i quante krim kundër popujve.**

Prandaj demaskimi që u bëri Partia e Punës e Shqipërisë gjithë politikës e strategjisë kineze në Letrën e KQ të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe të Qeverisë së RPS të Shqipërisë drejtuar KQ të Partisë Komuniste të Kinës dhe qeverisë kineze, është një provë e madhe e një politike konsekuente revolucionare në interes të mbarrë njerëzimit. Kjo politikë krijon dhe thellon pikërisht ato kontradikta që ekzistonin dhe ekzistojnë midis superfuqive imperialiste, midis vendeve kapitaliste dhe këtyre superfuqive, si dhe midis popujve dhe klikave të tyre udhëheqëse kapitaliste.

Por analiza që bëra më lart prek vetëm një pjesë të politikës djallëzore të grupit Mao-Çu-Ten. Do të përpiqem të gjej kohë dhe të studioj më thellë qëndrimet politike, ideologjike dhe diplomatike të udhëheqjes kineze që nga formimi i PKK, por duhet dhe do të gjej kohë të studioj sidomos filozofinë e mendimtarëve idealistë të kohëve të perandorisë Cin, të perandorisë Han e të perandoreshave, pse, siç thashë më lart, shohim që në të gjitha shkrimet teorike, politike dhe organizative të udhëheqësve kinezë të çdo kohe të përzihen pikërisht historia dhe filozofia e lashtë kineze, nga të cilat u mbars edhe Revolucioni i Madh Kulturor, megjithëse u manovrua sikur ky revolucion drejtohej edhe kundër filozofisë së vjetër të Konfucit e të Mencit.

Ky Revolucioni i Madh Kulturor ka me të vërtetë kuptimin që i është vënë me emërtimin që iu dha prej Maos dhe jo kuptimin e një revolucioni proletar ose «vazhdimin e një revolucioni brenda në revolucionin proletar» siç thoshte shpesh propaganda kineze. Jo, kjo ishte një gënjeshtëri, sepse revolucioni që zhvillohej në Kinë, nuk ishte një revolucion proletar, por një ngritje

turmash pa parime, të udhëhequra nga Mao Ce Duni, për të rrëzuar një klan që kishte marrë fuqinë dhe për të vendosur klanin e tij. Dhe kur ky revolucion u quajt Revolucion Kulturor, Maoja filloi t'i referohej gjerësisht literaturës së kohës së perandorisë, sepse në fakt gjithë literatura e zhvilluar edhe pas çlirimit në Kinë, mbështetej në heronjtë pozitivë ose negativë të literaturës idealiste e pragmatiste të perandorëve të Kinës, ose të filozofëve të vjetër kinezë. Pra edhe lufta klasore e Mao Ce Dunit që gjoja zhvillohej në Kinë bëhej me sponde dhe të duhej të imagjinoje se ku e kishte qëllimin ky ose ai artikull që fliste për perandoreshën Cisi, për perandorin që ngriti Murin e Madh ose për Konfucin e të tjerë, e të tjerë.

Të gjitha këto veprime të Maos janë në atë vijë që zhvillohej jo vetëm literatura e lashtë, por edhe teatri i lashtë kinez, i cili ishte i kuptueshëm vetëm për kinezët. Ky teatër nuk kishte dialogë, por vetëm gjeste formale prej të cilave mund të kuptohej përmbajtja e një pjese, kishte edhe një muzikë shurdhuese. Të gjitha këto përbënin, siç pretendonin Maoja dhe Çuja, atë «kulturë të madhe» me të cilën duhej të merrej Revolucioni Kulturor.

## PËRSE SHKON HUA KUO FENI NË RUMANI DHE NË JUGOSLLAVI?

Agjencia kineze HSINHUA dhe agjencitë e ndryshme perëndimore të lajmeve kanë njoftuar se gjatë këtij muaji Hua Kuo Feni, me një suitë të madhe nga pas, do të shkojë për vizitë zyrtare dhe miqësore në Rumani dhe në Jugosllavi. Kjo vizitë e kreut të socialimperialistëve kinezë në Ballkan ka një rëndësi të veçantë për ne shqiptarët, për Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë dhe për Partinë e Punës të Shqipërisë.

**Vizita e Hua Kuo Fenit në Rumani dhe në Jugosllavi nuk ka për qëllim vetëm shtimin e veprimtarisë armiqësore ose komplotuese kundër Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, por ka dhe karakterin e një intrige dhe të një komploti ndërkombëtar.**

Të marrim, në radhë të parë, çështjen e shtimit të armiqësisë dhe të veprimtarisë antimarksiste kineze, jugosllave e rumune kundër vendit tonë. Siç dihet, Kina tradhtoi marksizëm-leninizmin ose, po të shprehemi më drejt, ajo e përcaktoi më mirë rrugën e saj kapitalisto-imperialiste, se në fakt asnjëherë nuk ka qenë një vend socialist, asnjëherë nuk është udhëhequr nga ideologjia marksiste-leniniste. Kina e ashtuquajtur socialiste maskohej, hiqej si një vend socialist i udhëhequr nga një parti gjoja marksiste, por këtë maskë asaj ia çori Partia e Punës e Shqipërisë. Partia jonë zbuloi kalbësirën e

Kinë, vuri në dukje politikën dhe ideologjinë antimarksisiste që e ka udhëhequr dhe e udhëheq atë, vuri në dukje qëllimet e aleancave të kaluara dhe të sotme të Kinës me shtetet imperialiste, kapitaliste dhe revizioniste. Për këtë arsye Partia e Punës e Shqipërisë dhe Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë u shpallën si armiket më të mëdha të Kinës.

Armiq të Shqipërisë, shumë më parë se revizionistët kinezë, kanë qenë titistët jugosllavë. Ata e tradhtuan marksizëm-leninizmin dhe me plot gojën mund t'i quajmë, siç i kemi quajtur, renegatë. Pas prishjes më 1948 të Jugosllavisë me Bashkimin Sovjetik, me vendet e tjera ish-socialiste dhe me Shqipërinë, u duk qartë qëllimi i devianionit të Titos, i cili konsistonte në realizimin e gjithë kësaj veprimtarie kapitaliste që lulëzon aktualisht në Jugosllavi. Titistët, veçanërisht, synonin që Shqipëria socialiste, e porsadalë nga lufta, t'i aneksohej Jugosllavisë, të bëhej një republikë e 7-të e saj, por këtij qëllimi nuk ia arritën dhe Partia jonë vazhdimisht ka zhvilluar një luftë konsekuente dhëmb për dhëmb me antimarksisistët jugosllavë.

Partia e Punës e Shqipërisë e demaskoi dhe vazhdon ta demaskojë ideologjinë pseudomarksisiste të titistëve në të gjithë zhvillimin, në të gjitha fazat e saj deri në fazën aktuale të vetadministrimit titist, që është një sistem me strukturë dhe superstrukturë antimarksisiste.

**Hua Kuo Feni, që vjen në Jugosllavi, natyrisht, nuk ka ç't'i shesë Titos, veçse të blejë shumë gjëra nga ai dhe nga titizmi.** Në radhë të parë, Hua Kuo Feni vjen në Jugosllavi për të blerë mendimin «filozofik» të titizmit dhe për të mësuar zbatimin e këtij mendimi në Kinë, sipas kushteve të këtij vendi.

Filozofia e Titos, në qoftë se mund ta quajmë këtë një filozofi, është filozofi e një strukture kapitaliste të deformuar, e një strukture anarkiste të maskuar që gjoja

drejtohet nga vetë punëtorët e punonjësit, të cilët kanë «demokraci të plotë» dhe këtë «demokraci» e zbatojnë plotësisht sipas qejfit të tyre. Por në realitet Titoja me filozofinë e tij ka vënë në plan të parë lirinë individuale, që dominon mbi kolektivin, i cili, sigurisht, ka një rol dhe një detyrë të madhe, por ky kolektiv gjoja udhëhiqet në mendime, në veprime, në realizime, në ndarjen e të ardhurave dhe në bashkësinë vetadministruese të mjeteve të prodhimit nga «të drejtat e plota» të njeriut.

E gjithë kjo teori false e bën Titon që ta ketë zhdukur nga fjalori i tij fjalën revolucion. Ai nuk flet më për revolucionin, nën pretekstin se e ka bërë atë, se «i ka kapërcyer» të gjitha etapat, qoftë atë të revolucionit demokratiko-borgjez me luftën nacionalçlirimtare, qoftë revolucionin socialist. Tash ai ka shkuar në një shoqëri «shumë më të përparuar» nga shoqëria socialiste, në një shoqëri «speciale», «specifike», e cila për të është e vetmja shoqëri e së ardhmes!

Për këtë arsye Titoja nuk sheh ndonjë ndryshim në të ardhmen e shoqërisë jugosllave dhe të vendeve të tjera, veçse thotë që «vetadministrimi do të përmirësohet, do të plotësohet e do të korrigjohet nga eksperiencia e shoqërisë». Me fjalë të tjera, Titoja ka një urrejtje të madhe për revolucionin, sepse është bërë një autokrat, një mbret e perandor i vërtetë me administratën dhe burokracinë që ka ndërtuar në format e vetadministrimit. Kjo teori e tij u afrohet, ose më mirë të themi u ngjet ëndrrës dhe objektivave të teorisë së Mao Ce Dunit, i cili në fakt krijoi një filozofi, si të thuash, të një monarkie individuale ose kolektive. Kjo filozofi e Maos i ka rrënjët te perandoritë e vjetra kineze, ruan bazat e filozofisë së vjetër kineze, thelbin e kësaj doktrine, mënyrën e drejtimit e të administrimit të vjetër kinez, por, natyrisht, tash paraqitet e veshur me petkat moderne të shoqërisë kontemporane dhe të zhvillimit kontemporan të shoqërisë.

Po në ndryshim nga Jugosllavia, dhe në kundërshtim me çka po bëhet në fakt në Kinë dhe në Jugosllavi, në Kinë flitet shumë për «revolucionin», për «revolucionin socialist», për kontradiktat, për tezat dhe për antitezat. Të gjitha këto i ka pasë zhvilluar Mao Ce Duni në «filozofinë» e tij dhe i ka ngritur në një teori specifike që t'i përshtatej strukturës që ëndërronte të ndërtonte në Kinë. Kjo «filozofi» e tij nuk ka asgjë të përbashkët me filozofinë materialiste të Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit. Ai ka adaptuar disa forma dhe disa ide, por si brendia, edhe frazeologjia përfaqësojnë në të vërtetë një filozofi idealiste.

Mao Ce Duni është një dishepull i vërtetë i Ernëst Hekelit<sup>1</sup>, një idealisti gjerman që paraqitej me një filozofi gjoja materialiste. Revolucionin e Mao Ce Dunit nuk është revolucion proletar, nuk është revolucion për krijimin e një shoqërie pa klasa antagonistë, për zhdukjen e klasës borgjeze dhe për krijimin e shoqërisë socialiste. Jo, Mao Ce Duni është për një «revolucion të vazhdueshëm» për të mos thënë, siç thoshte Trocki, për një «revolucion permanent».

Ne i njohim pikëpamjet e Trockit mbi revolucionin, qëllimet, falsitetin e tij dhe shohim se filozofia e Mao Ce Dunit mbi revolucionin konsiston në atë që ky revolucion nuk do të ketë kurrë as qëllime, as mbarim. Ai vetë ka pohuar shumë herë se «pas një revolucioni duhet të vijë një kundërrivolucion, pas një kundërrivolucioni një revolucion, e kështu me radhë për dhjetëra e mijëra vjet». Maoja ka arritur deri atje, sa që filozofinë idealiste të tij ta kthejë në një dogmë fetare, kur thotë se revolucionin do të mbarojë me shuarjen e diellit, pra, me zhdukjen e jetës në planetin tonë.

Kur e studion këtë teori filozofike të Mao Ce Dunit,

<sup>1</sup> Ernst Haeckel — 1834-1919.

të kujtohet vepra «Materializmi dhe empiriokriticizmi», në kapitullin e fundit të së cilës Lenini, duke njohur pikëpamjet materialiste të filozofit gjerman Hekel, e quan këtë një atù fetare, që kërkon të krijojë një filozofi materialiste, por në të vërtetë ajo është krejt fetare.

Ç'thoshte Hekeli? Ai thoshte pikërisht atë që pohon Maoja dhe është ky që e ka kopjuar gati tekstualisht Hekelin. Ndërsa Hekeli thoshte që bota do të zhvillohet sipas teorisë së Darvinit dhe do të jetë në lëvizje ose, si të thuash, në evolucion të përhershëm të paqëndrueshëm, Maoja thotë se një revolucion do të kalojë nga një etapë në tjetrën, në një kundërrivolucion, nga një kundërrivolucion në një revolucion dhe kështu me radhë deri në fund. Pra për Hekelin, si edhe për Maon, revolucionin nuk ka një qëllim, kurse për ne, marksistë-leninistët, revolucionin ka një qëllim: zhdukjen e borgjezisë, pra, zhdukjen e klasave shfrytëzuese, shpronësimin e mjeteve të tyre të prodhimit, krijimin e shoqërisë së përbashkët mbi pronësinë e mjeteve të prodhimit, krijimin e shoqërisë socialiste, zhvillimin e luftës së klasave dhe kalimin në një shoqëri pa klasa, në komunizëm. Teoria e Mao Ce Dunit nuk ka këtë qëllim, por ka pikërisht një qëllim të kundërt, prandaj ajo nuk mund të quhet teori revolucionare, por kundërrivolucionare, antisocialiste.

Në qoftë se do të shkruaja në mënyrë figurative, do të thosha që Mao Ce Duni e konsideronte teorinë revolucionare në këtë formë vulgare: përpara kemi një katarakt nga i cili rrjedhin ujëra të bollshme në një fushë të gjerë dhe, pasi bëjnë zhurmë të madhe, duke marrë me vete ç'gjejnë përpara, përhapen në fushë dhe formojnë një kënetë ku rrojnë bretkosa dhe mushkonja. Në një moment tjetër ky ujë i ndenjtur has në një kaskadë të re dhe krijon përsëri një shtrëngatë. Uji rrjedh teposhtë me forcë, me bujë, dhe përsëri përhapet në një fushë, ku formon moçale si më parë, e kështu me radhë. Dhe Mao Ce Duni

në këtë rënie, pra në këtë kaskadë uji, nuk ndërton turbina për elektrifikimin që të bonifikojë fushën e të mos e lërë më atë vend me ujë të qelbur, për bretkosa, mushkonja, zvarranikë e kafshë të tjera. Maoja s'e bën këtë gjë. Ai e kupton revolucionin në formën dhe në mënyrën që thashë më lart, pra, si një përsëritje në vetvete.

**Kurse Hua Kuo Feni dhe Ten Hsiao Pini nuk janë për këtë filozofi idealiste, as për këtë pseudorevolucion të Mao Ce Dunit. Hua Kuo Feni do të vijë në Jugosllavi të mësojë nga Titoja se si ka mundur ky të hedhë poshtë teorinë marksiste-leniniste të revolucionit dhe të stabilizojë vetadministrimin.** Domethënë, udhëheqësit e partisë dhe të shtetit kinez vijnë në Jugosllavi që të marrin eksperiencë mbi ndërtimin e një shoqërie hibride, kapitalisto-anarkiste, të përshtatshme për situatat e krijuara në vendin e tyre, sepse në fakt një regjim i tillë si ai i Jugosllavisë, natyrisht në vija të përgjithshme, ka filluar dhe do të realizohet në Kinë. Veçse këtu duhet thënë se mentaliteti i kinezëve është shumë më prapa në krahasim me mentalitetin e jugosllavëve. Pra zhvillimi kulturor i jugosllavëve, për sa u përket kulturës botërore në përgjithësi dhe filozofive të ndryshme botërore, është shumë më përpara sesa mentaliteti kinez, që është një mentalitet konservator dhe i konformohet asaj filozofie të vjetër kineze, që udhëheqësit e këtij vendi e ruajnë dhe mbështeten në të.

Udhëheqësve kinezë, për të ndërtuar kapitalizmin në vendin e tyre, do t'u duhet të bëjnë edhe transformime të thella në pikëpamjet retrograde të popullit. Populli kinez është një popull i zgjuar, por i mbajtur në errësirë, atë e kanë mënjanuar nga zhvillimi i kulturës botërore. Edhe pas çlirimit ai është ushqyer vazhdimisht me një filozofi, me një ideologji dhe kulturë të shartuar shumë keq ose me një kulturë të vjetër kineze me disa retushe të perceptipta të kulturës botërore. **Kështu që udhë-**

**heqjes kineze, i duhet të bredhë të gjitha kontinentet e globit, të gjitha shtetet kapitaliste dhe të marrë, për regjimin aktual kapitalist kinez, eksperiencë në çdo gjë, për çdo gjë, në çfarëdo sferë, në sferën materiale dhe në sferën shpirtërore, në kulturë, në ideologji dhe në ndërtimin e një superstrukture të re kapitaliste.**

Kjo është arsyeja që tash shohim një dyndje të jashtëzakonshme, të paparë ndonjëherë, të ekipeve të panumërta, të përbëra nga qindra e qindra kinezë, që shkojnë nga të gjitha anët e botës për të marrë kredi, për të marrë eksperiencë. Gjithë kjo dyndje e kinezëve në vende të huaja bëhet me qëllim që në Kinë të ndërtohet një shoqëri e tillë që t'u përshtatet situatave aktuale, investimeve të investitorëve kapitalistë e gustove të këtyre investitorëve, të cilët pa dyshim do ta ndihmojnë Kinën në këtë drejtim.

**Ne do të shohim të ekzistojë në Kinë, për një periudhë shumë të gjatë, një kaos i madh mendimesh dhe veprimesh.** Kjo periudhë e gjatë do të përmbajë zigzage shumë të theksuara, bile dhe përpjekje të shtresave të ndryshme të popullsisë së këtij vendi. Ne, gjithashtu, do të shohim grupime revolucionarësh, të cilët, pas këtyre vuajtjeve që po pësojnë, me kalimin e kohës do të kuptojnë se i vetmi shpëtim i tyre dhe i Kinës është zbatimi me përpikëri i teorisë shkencore të marksizëm-leninizmit, sipas kushteve konkrete të këtij vendi dhe kështu do të hedhin poshtë e do të demaskojnë teorinë false marksiste-leniniste të Mao Ce Dunit, teorinë idealiste dhe kontradiktat ose dialektikën pseudomaterialiste të tij.

Hua Kuo Feni nuk është i pari që vjen në Jugosllavi për të mësuar teorinë e Titos, sepse për këtë qëllim ai ka dërguar me kohë dhe vazhdon të dërgojë filozofë dhe organizatorë, njerëz të kulturës, punonjës të bujqësisë, të financave, inxhinierë, teknikë etj. Këta janë

dërguar atje për të marrë konkretisht eksperiencën e strukturës kapitaliste anarkosindikaliste jugosllave dhe, në përgjithësi, atë të superstrukturës së përshtatshme për këtë strukturë. Kështu Hua Kuo Feni vjen në Jugosllavi për t'u përlur përpara Titos, për t'u thënë atij dhe botës se udhëheqja kineze njih gabimet e mëdha të Mao Ce Dunit, i cili, në një kohë (jo se udhëhiqej nga pikëpamjet marksiste-leniniste) kishte sulmuar Titon si antimarksist, renegat dhe sistemin që po vendosej në Jugosllavi si një sistem kapitalist.

Me fjalë të tjera, Hua Kuo Feni vjen në Beograd më keq se Hrushovi dikur. Hua Kuo Feni ndjek dy qëllime: Së pari, t'i thotë botës se Kina, dhe veçanërisht Mao Ce Duni, kanë gabuar rëndë ndaj Titos e titizmit, se ata gjoja kanë qenë influencuar nga Stalini dhe me dashje ose pa dashje kanë zbatuar direktivat e tij për demaskimin e titizmit; së dyti, duke vepruar kështu, Hua Kuo Feni sulmon njëkohësisht Stalinin e bolshevizmin, por edhe Maon, të cilin e kanë pompuar si një «filozof të madh», si një «ideolog e vazhdues të veprës së Marksit e të Leninit» dhe e kanë shpallur si perëndi, si «papën» e «komunizmit të ri».

Tash «papa» i këtij «komunizmi të ri», Hua Kuo Feni, vjen në Beograd t'i thotë Titos dhe mbarë botës se Maoja s'qenkej ashtu siç është cilësuar, prandaj atë dhe pasuesit e tij ne i dënuam, vetëm se dënimin e Maos nuk e kemi shpallur akoma haptazi, por aty jemi, ne po e diskreditojmë në gjithë veprimtarinë e tij. Ne, do t'i thotë botës Hua Kuo Feni, jemi për një filozofi që kërkon një botë të qëndrueshme, me teknologji të përparuar dhe këtë shoqëri që kërkojmë ne, e kemi gjetur te shoqëria e përparuar amerikane, jugosllave etj.

Pra, Hua Kuo Feni vjen në Jugosllavi që të bëjë autokritikë përpara Titos, të njohë epërsinë ideologjike të titizmit dhe të kërkojë prej tij ndihmë më tepër mo-

rale, sesa materiale. Këtë e them se duhet të pranojmë që Hua Kuo Feni do të kërkojë nga Titoja ndonjëfarë eksperience për të marrë kredi nga imperialistët amerikanë dhe nga gjithë imperialistët e tjerë. Ai do të kërkojë sidomos që Titoja të bëhet ndërmjetësi më i mirë, siç ka qenë kurdoherë dhe siç është bërë në çdo kohë, i të gjithë renegatëve dhe i të gjithë atyre borgjezëve kapitalistë që ndodheshin në një *marasme*<sup>1</sup>, siç ndodhej edhe Jugosllavia, për të kërkuar ndihmën e imperializmit amerikan dhe të imperialistëve të tjerë, por, kuptohet, duke u shitur imperialistëve pasuritë e vendit, lirinë, pavarësinë dhe sovranitetin. Këtë gjë do të kërkojë Hua Kuo Feni nga Titoja.

Me rëndësi të madhe do të jenë intrigat politike që do të kurdisin Hua Kuo Feni dhe Titoja. Do të kenë apo jo sukses këto intriga, është tjetër çështje, por që të dy janë intrigantë. Duke bërë analizën e situatës botërore sipas pikëpamjeve të tyre antimarksiste, ata do të përpiqen të dalin në disa shtigje të përbashkëta, për të krijuar disa situata të reja politike që t'u shërbejnë forcimit të kapitalizmit botëror dhe veçanërisht shteteve kapitaliste në vendet e tyre.

Hua Kuo Feni, përfaqësues i Kinës me një popullsi prej 800-900 milionësh, kërkon të nxjerrë disi popullin e tij nga mjerimi, që të evitojë revoltat e pashmangshme, prandaj ai ka nevojë për një ndihmë të fuqishme nga imperialistët e ndryshëm. Kjo ndihmë i duhet për të krijuar atë shtresë kapitaliste të përparuar, me një teknologji moderne, për të krijuar atë pushtet kapitalist dhe ato armë që ta ruajnë dhe ta mbrojnë këtë pushtet nga revoltat dhe revolucionet popullore. Këta antimarksistë e dinë fare mirë që dialektikisht, si kudo gjetkë, edhe në Kinë, revolucionin do të shpërthejë kur të pihen kushtet.

<sup>1</sup> Frëngjisht — dobësi e madhe, apati e thellë, amulli.

Pra, në këtë gjendje kaotike Hua Kuo Fenit nuk vjen te Çausheku dhe te Titoja vetëm për t'u bërë atyre një vizitë kortezie. Jo, vizita e tij ka qëllime politike.

Ne e dimë fare mirë se ç'qëndrime politike mban Titoja. Ai hiqet si udhëheqësi i «vendeve të paangazhuara» dhe ka bërë e po bën përpjekje të mëdha që lëvizja e këtyre vendeve të konsiderohet si një fuqi e madhe që neutralizon gjoja influencën *néfaste*, negative të superfuqive. Por kjo që thotë Titoja është një profkë sepse superfuqitë lëvrojnë, intrigojnë dhe bëjnë çdo përpjekje materiale, politike e filozofike që të mbajnë popujt e botës të shtypur, të përçarë, nga ana tjetër të krijojnë dhe të fuqizojnë klikat që sundojnë mbi popujt në këto vende dhe të shkojnë deri atje saqë në ato vende, ku interesat e tyre janë në rrezik, t'i futin popujt në luftë njëri me tjetrin, të krijojnë kontradikta, të cilat, natyrisht, do të shkaktojnë gjakderdhje në popull. Këto kontradikta nuk do të zhvillohen vetëm midis popujve të atyre vendeve ku sundojnë superfuqitë, por edhe midis vetë superfuqive, ato do të thellohen deri në shpërthimin e një lufte të re botërore. Kina e Hua Kuo Fenit e predikon këtë luftë, por që ta bëjnë të tjerët.

Jugosllavia e Titos hiqet si një vend gjoja i paangazhuar, por në të vërtetë është e angazhuar ndaj imperializmit amerikan si dhe ndaj shteteve të tjera kapitaliste perëndimore, që e kanë subvencionuar dhe e mbajnë gjallë. Në këtë drejtim Jugosllavia është bërë një neokoloni e kapitalizmit amerikan dhe e kapitalizmit botëror, por Titoja, si një element trockist, revizionist, si ballkanas i zgjuar, ka një kapacitet manovrimi dhe e ruan deri diku «neutralitetin». Si në aparençë ashtu edhe në praktikë ai nuk i acaron situatat me revizionistët sovjetikë në atë mënyrë që i ka acaruar dhe po i acaron aktualisht Kina e Mao Ce Dunit dhe e Hua Kuo Fenit.

**Titoja nuk shprehet si kinezët që armiku kryesor**

është Bashkimi Sovjetik; ai, gjithashtu, nuk thotë se armiku kryesor është imperializmi amerikan, por, pa u vënë emrin, thotë se fuqitë imperialiste ose hegjemoniste janë të rrezikshme dhe se «bota e paangazhuar» duhet të zhvillojë një politikë të tillë që «t'u kundërvihet» ekzistencave të superfuqive. Ai është një intrigant. Titoja nuk është «boshti» i botës, por është një kodosh i zgjuar. Ai, siç e kam thënë dhe herë të tjera, në tratativat që bën me qeveritë e ndryshme nxjerr fitime, bie dhe shpie, nxjerr deduksione, taton pulsën e njerit e të tjetrit, dhe atje ku i intereson, bën përpjekje që të ndihmojë ato klane dhe ato klika që tregohen të gatshme t'i shërbejnë politikës së tij për të përfituar sa më shumë nga bankat e njërës ose të tjetrës superfuqi, për «lulëzimin» e Jugosllavisë së tij gjoja socialiste.

**Sigurisht, Titoja me Hua Kuo Fenin do të bëjnë një «politikë të madhe» dhe që të dy do të jenë dakord në çështje kryesore të politikës ndërkombëtare. Që të dy janë dakord për luftën që duhet t'i bëjnë Shqipërisë, sepse për të dy këta Shqipëria është armiku i tyre më i madh. Por Shqipëria është, gjithashtu, armiku më i madh i gjithë botës kapitaliste jo nga madhësia e territorit të saj, jo nga numri i popullsisë së saj, por nga idetë marksiste-leniniste që ajo përfaqëson dhe mbron.** Prandaj qëllimi, dëshira e kapitalizmit botëror dhe e të dy kalanderëve, Tito-Hua, është që zërin e fuqishëm të Shqipërisë, që dëgjohet sot në të katër anët e botës, ta mbytin. Por që ta mbytin këtë zë, më parë ata duhet të shkatërrojnë vendin tonë, ta degjenerojnë Partinë e Punës të Shqipërisë, domethënë të bëjnë te ne ato transformime kapitaliste që po bëjnë në vendet e tyre. Në këtë rrugë të dy këta do të përpiqen të krijojnë dhe të forcojnë bllokadën politike dhe ideologjike po e po, por edhe bllokadën ekonomike, duke menduar se Shqipëria nuk do të mund të rrojë dot e vetmuar, pa marrë kredi dhe

ndihma nga shtetet e tjera kapitaliste e revizioniste. Ata mendojnë kështu dhe janë të bindur për këtë gjë, sepse filozofia ku ata mbështeten është e tillë. Qoftë Hua Kuo Feni e Ten Hsiao Pini, qoftë Titoja, qoftë kapitalistët, në marrëdhëniet me njëri-tjetrin, që të gjithë zhvillojnë këtë veprimtari. Ata rrojnë në sajë të investimeve të njëri-tjetrit, në sajë të krijimit të shoqërive të përbashkëta, të shfrytëzimit të përbashkët të pasurive të popujve në favorin e më të madhit, duke lënë të varur nga kapitali i madh pavarësinë, sovranitetin dhe lirinë e popujve të tyre.

Në këtë drejtim, pra, për sa i përket luftës kundër Shqipërisë, Hua Kuo Feni do të ngulë këmbë më shumë, për arsye se Titos i është regjur lëkura nga lufta e ashpër dhe e vazhdueshme që i kanë bërë Partia e Punës e Shqipërisë dhe Republika jonë Popullore Socialiste dhe se titizmi ka gjetur njëfarë stabiliteti në botë. Pavarësisht se marksistë-leninistët dhe Partia e Punës e Shqipërisë e demaskojnë çdo ditë Jugosllavinë titiste, cipa e fytyrës së saj nuk skuqet, ajo mbetet ashtu siç ishte, bjellogardiste e grevëthyese. Kurse aktualisht Hua Kuo Feni, me cipën e tij të verdhë, është inatosur jashtëzakonisht për shkak të demaskimit radikal që po u bëhet dhe që do të vazhdojë t'u bëhet vijës dhe veprimtarisë anti-marksiste të Partisë Komuniste të Kinës e të udhëheqjes së saj nga Partia e Punës e Shqipërisë.

**Kjo është arsyeja që kapitalizmi i ri kinez, revizionizmi specifik kinez shpërthen hapur ndaj marksizëm-leninizmit, ndaj Partisë marksiste-leniniste të Punës të Shqipërisë.** Kjo duhet të na bëjë ne shumë vigjilentë dhe, pa ditur se ç'mund të bisedojnë konkretisht, ne mund t'i marrim me mend se ç'metoda do të përdorin ata, po të mundin, që t'ua arrijnë qëllimeve të tyre kundër vendit tonë. Por ata nuk do të mundin t'i realizojnë qëllimet e tyre armiqësore, se do të dështojnë. Veçse

këtu ka një gjë: Titoja nuk do të jetë shumë i zellshëm në propozimet e Hua Kuo Fenit për sa i përket Shqipërisë, se nuk është budalla si Hua Kuo Feni. Ai ka fituar një eksperiencë nga ndeshja me shqiptarët dhe e di fare mirë që Shqipëria nuk është një kockë e lehtë për t'u gëlltitur. Në rrugën e tij armiqësore për të realizuar çka dëshiron kundër vendit tonë ai ka shumë vështirësi.

Së pari, Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë është e fortë, se populli shqiptar është një popull trim, se Partia e Punës e Shqipërisë ka një të kaluar të lavdishme, ka një unitet të çeliktë marksist-leninist në radhët e saj dhe ka përballuar me sukses të gjitha vështirësitë që i janë krijuar dhe sulmet që i janë bërë. Prandaj, po t'i futet një lufte ideologjike ose politike, për të mos thënë një lufte të armatosur me Shqipërinë, Titoja e di se do të ketë humbje të mëdha, se Shqipëria do ta mposhtë këtë luftë të titizmit.

Së dyti, lufta kundër Shqipërisë në Ballkan, e marrë si e shkëputur, nuk është aq e lehtë për Titon, për arsye se në Jugosllavi ndodhet një minoritet i madh shqiptar. Ky minoritet shqiptar, që jeton në një tokë që i është shkëputur Shqipërisë, ka vuajtur shumë nga serbomëdhenjtë e nga titizmi. Për këta Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë, atdheu i tyre, është shumë i dashur dhe, aktualisht, në qoftë se preket Shqipëria, preken edhe ata në Jugosllavi e kjo do të krijojë një situatë të re në disfavor të titizmit, do të jetë një katastrofë për të. Kësaj gjëje Titoja i ruhet, si në platformën kombëtare, ashtu edhe në atë ndërkombëtare, për arsye se ekzistojnë kontradikta të mëdha për një veprimtari të tillë të ndër-marrë nga vetë Titoja se Hua Kuo Feni vetë s'ka ç'i bën Shqipërisë nga larg. Hua Kuo Feni do të përpiqet që këtë ose Çausheskun t'i bëjë me vete, me qëllim që këta të dy dhe miqtë e tyre të kurdisin diçka kundër Shqipërisë. Prandaj në bisedimet që do të zhvillojë Hua Kuo Feni, në

Rumani e në Jugosllavi do të ketë edhe koordinime e akorde, por edhe disakorde.

**Në parim dhe në strategji Titoja dhe Hua Kuo Feni janë dakord kundër Shqipërisë, veç në taktika jo, për arsytet që thashë më lart. Pastaj çështja e Ballkanit është shumë delikate, por këtë nuk e kupton fare Kina e Mao Ce Dunit, e Çu En Lait, e Hua Kuo Fenit dhe e Ten Hsiao Pinit.** Këta njerëz janë «barëra të egra» të një shteti të madh, që janë harlisur dhe mendojnë se pikëpamjet dhe veprimet e tyre duhet të dominojnë e të udhëheqin botën dhe të gjithë t'i dëgjojnë e të veprojnë sipas këshillave të tyre. Për këtë arsye udhëheqësit kinezë mendojnë se do të bëjnë një politikë efikase në Ballkan, se këtë politikë do të mund ta organizojnë me shtetet ballkanike për të bërë një barrierë të fortë kundër Bashkimit revizionist Sovjetik, barrierë që do të shërbejë, gjithashtu, për izolimin, për ndërhyrje dhe pushtimin e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë. Njëkohësisht një politikë e tillë ndihmon edhe imperializmin amerikan, me të cilin Kina dhe Jugosllavia janë të lidhura ngushtë. Në këtë çështje interesat e të dy kalanderëve do të puqen dhe që të dy do të përpiqen të koordinojnë disi veprimet e tyre. Megjithatë Titoja si më i regjur në këto punë nuk do t'i pranojë marrëzitë e Hua Kuo Fenit.

**Titoja mbështetet tek imperializmi amerikan, mbështetet te partnerët e tij, ai është për NATO-n dhe këtë pakt ushtarak e konsideron si një forcë mbrojtëse të tij, por pa e pohuar një gjë të tillë.** Ai ka frikë nga Traktati i Varshavës dhe nga Bashkimi Sovjetik, megjithatë përpiqet të tregohet si «neutral». Kurse Kina e Hua Kuo Fenit dhe e Ten Hsiao Pinit ka deklaruar hapur se është pro NATO-s dhe Tregut të Përbashkët Evropian, kundër Bashkimit Sovjetik, kundër Traktatit të Varshavës dhe KNER-it. Në këto qëndrime taktike Hua Kuo Feni dhe

Titoja nuk janë dakord, prandaj dëshirat e Hua Kuo Fenit, për të krijuar një Ballkan sipas pikëpamjeve të tij, nuk mund të realizohen me Jugosllavinë. Nuk mund të realizohen as me Rumaninë, sepse shteti rumun është në shërbim të plotë të sovjetikëve. Bashkimi Sovjetik nuk duron vicka. Në qoftë se Çausheku do të hidhte vicka tok me njerëzit e tij, në kundërshtim me interesat e mëdhenj e të thellë të Bashkimit Sovjetik, ky do ta kishte hedhur me kohë në erë nga brenda, pa ndërhyrë si në Çekoslovakia me tanke. Por një gjë të tillë Bashkimi Sovjetik nuk e bën edhe për shkak të opinionit botëror, por edhe për arsye se ka fitime nga Çausheku, nga ky njeri pa principe, që përpiqet të bëhet një «figurë e madhe botërore».

Udhëheqja kineze e ka ndihmuar dhe po e ndihmon Çaushekun, sepse ajo nuk i njeh dhe nuk ka atë forcë logjike t'i gjykojë në thellësi veprimet dhe mendimet e njerëzve dhe të shteteve ku sundojnë këta njerëz. Përveç kësaj, duhet mbajtur parasysh edhe çështja tjetër: Kina, duke ndjekur një politikë të lëkundshme, duke bërë zigzage shumë të mëdha gjatë gjithë kohës, që nga viti 1949 e deri tash, ka mundësi që në momente të caktuara ta kthejë fytyrën nga Bashkimi Sovjetik, ta braktisë aleancën me Shtetet e Bashkuara të Amerikës ose të arrijë të mbajë një pozicion si të Jugosllavisë titiste, domethënë të bëjë një kthesë 90 ose 180 gradëshe, drejt Bashkimit Sovjetik.

**Ë gjithë kjo manovër e kinezëve ka për qëllim që Kina të fitojë kohë, të bëjë shantazhe, të tregohet si një fuqi e madhe politike dhe ekonomike që mund të dalë «në tregun botëror», të tregohet si një shtet i madh, që hapet nga të katër anët, në të gjitha shtetet kapitaliste, se edhe ata nga kjo hapje e Kinës kanë fitime të mëdha.** Kështu Kina bëhet një faktor i rëndësishëm në statukuonë botërore kapitaliste. Me fjalë të tjera Kina e Mao Ce Dunit dhe e Hua Kuo Fenit bëhet një fuqi e re imperia-

liste reaksionare që i vë fre, i vë kufi imperializmit sovjetik dhe krijon mundësinë e një rindarjeje të re të botës në kurrizin e popujve të ndryshëm dhe në disfavorin e revolucionit proletar.

Nga informata të sigurta mësojmë se kinezët, para se Hua Kuo Feni të vejë në Rumani dhe në Jugosllavi, po bëjnë një politikë prej budallai pranë ministrive të jashtme të shteteve të ndryshme të Ballkanit, deri dhe te presidentët e republikave si tek ai i Turqisë, i Greqisë dhe i Bullgarisë, bile edhe duke ditur se kjo e fundit është një satelite shumë e bindur e Brezhnjev. Në se konsiston kjo politikë e kinezëve? Konsiston në propagandën që bëjnë këta njerëz «të zgjuar» për «t'u hapur sytë» turqve dhe grekëve për rrezikun e madh që u turret nga ana e sovjetikëve. Pra, sipas kinezëve, njerëzit që udhëheqin këto dy shtete kapitaliste, sikur kanë dalë tash nga veza dhe nuk e njohin botën, as shtetet kapitaliste e as qëllimet e tyre, prandaj presin që t'ua thotë këto njëfarë Hua Kuo Feni nga Kina! Nga ana tjetër politika që po bën Kina, duke u thënë këtyre shteteve që të dobësojnë marrëdhëniet ekonomike e shtetërore me Bashkimin Sovjetik, synon të krijojë një koalicion prokinez në mes popujve të Ballkanit. Me fjalë të tjera, nga ana e Kinës kjo është historia e krijimit të një barrikade të re ballkanike kundër Bashkimit Sovjetik. Udhëheqësit kinezë, me politikën që po bëjnë kundër vendit tonë, përpiqen, gjithashtu, të propagandojnë në shtypin e tyre se Shqipëria, e rrethuar nga të katër anët nga vende armike të saj, tash që kinezët e lanë, gjoja është e detyruar të mbështetet diku. Dhe, natyrisht, preferojnë që ne të mbështetemi te Jugosllavia dhe te Rumania ose te ky koalicion ballkanik që kanë ëndërruar dhe ëndërrojnë kinezët.

Ky ishte edhe qëllimi i propozimit të Çu En Lait, të cilin ne qysh atëherë ia hodhëm poshtë dhe aktualisht e demaskuam botërisht. Tash këtë gjë do të realizojë edhe

Hua Kuo Feni me ardhjen e tij në Beograd. Ai dhe propaganda kineze punojnë për të gënjyer opinionin botëror se Shqipëria paska vetëm dy mundësi: ose të bashkohet me Jugosllavinë, domethënë të lidhë aleancë me të dhe kështu të futet në aleancë edhe me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me të cilat Kina është bërë bythë e brekë, siç themi ne shqiptarët, ose të mbështetet te revizionizmi sovjetik dhe te satelitët e tij.

Në këto dy tablo përpiqet Kina të dëmtojë qëndrimin burrëror marksist-leninist, të palëkundshëm të Partisë dhe të shtetit tonë proletar, por ajo, ashtu si dhe gjithë reaksioni botëror, do të dështojnë. Ne nuk do të mbështetemi tek imperializmi amerikan, te borgjezia reaksionare, te NATO-ja dhe Tregu i Përbashkët Evropian, por do t'i luftojmë me ashpërsinë më të madhe. Ne, gjithashtu, do të luftojmë me rreptësinë më të madhe socialimperializmin sovjetik, Traktatin e Varshavës, KNER-in dhe të gjitha ato shtete, që nga Jugosllavia e deri te djalli me të birin, që do të përpiqen të dëmtojnë pavarësinë dhe sovranitetin e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë.

**Pra, portet tona nuk do të hapen kurrë as për flotën e Bashkimit Sovjetik, as për flotën e NATO-s dhe kufijtë tanë tokësorë nuk do të çahen, ata nuk do të kapërcehen nga asnjë fuqi armike.** Kush do të guxojë të prekë kufijtë tanë, do të gjejë vdekjen. Këtë gjë ne ia kemi bërë të qartë gjithë botës dhe përsëri do ta theksojmë në fjalimet e ardhshme. **Shqipëria do të mbetet kurdoherë e pavarur.** Ajo nuk është dhe nuk do të jetë kurrë e izoluar, se me të janë popujt dhe interesat e popujve, dëshirat dhe pikëpamjet liridashëse të të cilëve nuk mund të konfondohen me qëllimet e aspiratat e milionerëve e të miliarderëve kapitalistë dhe revizionistë.

**Popujt, proletariati, elementët përparimtarë në botë janë me ne.** Këtë e ka provuar koha, e kanë provuar be-

tejat tona të njëpasnjëshme fitimtare kundër superfuqive, kundër titizmit, kundër imperializmit amerikan, kundër socialimperializmit sovjetik dhe aktualisht kundër kinezëve. Për këtë arsye propaganda kineze dhe propaganda keqdashëse kapitaliste nuk mund të gënjejnë opinionin botëror se gjoja Shqipëria aktualisht do të mbështetet të Bashkimi Sovjetik. Jo! Kjo nuk do të ngjasë kurrë! Shqipëria e urren socialimperializmin sovjetik aq sa urren edhe imperializmin amerikan.

Populli shqiptar dhe Partia e Punës e Shqipërisë udhëhiqen nga një doktrinë, e cila ndjell miqësinë me popujt, prandaj edhe te populli grek, jugosllav dhe italian, që i kemi rreth e rrotull, ne kemi miq të shumtë. Qëndrimet e drejta të Partisë së Punës të Shqipërisë e të shtetit shqiptar, në mos thellësisht kanë hyrë deri në njëfarë shkalle në masat punonjëse të këtyre vendeve dhe kanë bërë që të zhduken ato ndjenja armiqësore që ishin kultivuar më parë kundër Shqipërisë, nga udhëheqësit reaksionarë të këtyre vendeve, që na konsideronin si një plaçkë tregu që shitej e blihej nga rusi, nga jugosllavi, nga kinezi e të tjerë. Por udhëheqës borgjezë të arsyeshëm të këtyre vendeve panë se gaboheshin në mendimet e në politikën e tyre të mëparshme ndaj Shqipërisë, ata panë se Shqipëria e vogël nuk është përkulur dhe nuk do të përkulet kurrë para çfarëdo diktati, para çfarëdo fuqie dhe kështu reflektuan ndaj dëshirës së saj për të pasur marrëdhënie të mira fqinjësie në interes të përbashkët, pa ndërhyrë në punët e brendshme të njëri-tjetrit.

Politika e drejtë e Partisë së Punës të Shqipërisë ka një efekt të madh në Ballkan dhe ky efekt do të bëjë të dëshojnë edhe megalomania e shtetit të madh kinez e komplotet që po bën ky shtet në rajonin e Ballkanit dhe në botë kundër vendit tonë, po ashtu do të bëjë të dëshojnë edhe synimet e fshehta dhe të hapëta të revizionizmit jugosllav e të megaloidesë greke. As socialimperializ-

mi sovjetik dhe as imperializmi amerikan me intrigat e tyre nuk do të mundin ta dëmtojnë dot këtë politikë të drejtë dhe të qëndrueshme si malet tona, të Partisë së Punës të Shqipërisë.

Natyrisht, vizita e Hua Kuo Fenit në përgjithësi në Ruman dhe në Jugosllavi do të bëjë bujë në botë, po buja do të jetë në disfavorin e Kinës dhe në favorin e Jugosllavisë, se, sa për Rumaninë, kjo vizitë nuk do të ketë asnjë efekt, për arsye se gjithë bota e di që Rumania është një vend i shitur, është një shtet agjenturor në duart e sovjetikëve. Imperialistët dhe reaksioni kanë besim të madh te Jugosllavia titiste, se kjo u shërben më shumë imperialistëve amerikanë dhe imperialistëve perëndimorë, të cilët dëshirojnë që Jugosllavia të ketë përkrahjen e Kinës, që ajo të ketë te Kina një treg të madh eksportues. Me vajtjen e Hua Kuo Fenit në Jugosllavi Titoja do ta krijojë këtë treg se ka nevojë të madhe për të. Një gjë e tillë do ta ndihmojë Jugosllavinë që të zbrazë depot, të zvogëlojë në këtë mënyrë papunësinë që mbretëron atje. Këtë gjë Titoja do ta fitojë nga Hua Kuo Feni. Në këtë drejtim kreu titist do të ketë, gjithashtu, ndihmën dhe përkrahjen e imperializmit amerikan dhe të imperialistëve të tjerë, se Titoja e nxit Kinën të bëjë një politikë në interes të imperializmit amerikan. Dhe në realitet kështu po ndodh. Politika kineze ecën drejt mbrojtjes së politikës amerikane.

Nga ana tjetër, Shtetet e Bashkuara të Amerikës në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, e këshillojnë Kinën, që të mbështetet veprimtarinë e Jugosllavisë, të flasë mirë për teorinë ose lëvizjen e «botës së paangazhuar», që gjoja e udhëheq Titoja, botë ku mbretëron një kaos i madh, pse nuk mund të mbretërojë gjë tjetër.

**Me vajtjen e Hua Kuo Fenit në Jugosllavi prestigji i Jugosllavisë së Titos do të ngrihet disi përpara revizionistëve në botë, kurse prestigji i Kinës revizioniste dhe**

imperialiste në botë do të ulet. Kina me këtë rast do të humbasë shumë te popujt e vegjël të kontinenteve të ndryshme kurse Bashkimi Sovjetik do ta shtojë veprimtarinë e tij kundër Kinës dhe kundër Jugosllavisë. Pikërisht këtu ne mund të shohim një rrezik të ardhshëm, prandaj duhet të jemi jashtëzakonisht vigjilentë, të vazhdojmë të forcojmë pozitën tonë të pushtetit proletar, të forcojmë ekonominë, ta ngremë më lart politikisht popullin, ta ngremë më lart ideologjikisht Partinë, çdo gjë t'ia bëjmë të qartë, ta kalitim atë në beteja e ta lidhim ngushtë me popullin. Çdo ditë ne duhet të forcohem ushtarikisht, se pas vdekjes së Titos unë mendoj se do të ketë situata të vështira për Jugosllavinë, të cilat tërthorazi do ta vështirësojnë situatën në Ballkan, mundet edhe në Evropë. **Jugosllavia, një vend kapitalist me shumë kombësi, do të ketë një të ardhme të turbullt, për arsye të kontradiktave që ka krijuar vetë sistemi kapitalist vetadministrues, të kontradiktave që ka ngjallur shovinizmi dhe sidomos të atyre midis serbëve dhe kroatëve, midis serbëve e shqiptarëve, midis sllovenëve e serbëve dhe midis maqedonasve, serbëve dhe bullgarëve.**

Sistemi i vetadministrimit jugosllav ka krijuar vetëm një gjë të mirë: unitetin e shqiptarëve që banojnë në Jugosllavi me Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë. Por çështja është se pas vdekjes së Titos imperializmi amerikan dhe Kina, dëshirojnë dhe do të përpiqen ta ruajnë unitetin e Federatës Jugosllave në favorin e tyre, kurse sovjetikët do të bëjnë përpjekje të mëdha që unitetin e kësaj Federate ose ta kthejnë në favorin e tyre, ose ta përçajnë dhe përçarja mund të vijë, dhe duhet të vijë, historikisht nga Serbia. **Elementët serbomëdhenj janë më të fortë, më agresivë dhe do të përpiqen të dominojnë në Federatë, por edhe kroatët nuk do të mbeten pas.** Pra, sovjetikët do të përpiqen që me elementin serbomadhi të krijojnë në Jugoslla-

vinë titiste një lëvizje pro tyre dhe politika jugosllave të marrë një drejtim të favorshëm për revizionizmin sovjetik. Natyrisht, në një situatë të tillë imperializmi amerikan nuk do të qëndrojë pa punuar e pa luftuar.

Pasi Hua Kuo Feni të ketë vajtur në Rumani dhe në Jugosllavi dhe pasi ta ketë mbaruar këtë vizitë e të shohim edhe rezultatet e saj, ne duhet të përgatitim një artikull mbi këto çështje. Sigurisht, rezultatet që do të shohim ne do të jenë të sipërfaqshme, sepse asgjë nuk do të kuptohet nga komunikatat ose nga deklaratat që palët do të bëjnë të njohura. Sidoqoftë, ne mund të parashikojmë se çfarë do të thuhet, se çfarë do të konkludohet dhe deri në ç'shikallë do të puqen mendimet e veprimet e kinezëve me jugosllavët dhe me rumunët.

**Unë do të bisedoj me Ramizin që për këto çështje të përgatitim një artikull, kurdoherë në lartësinë e duhur politike, në atë lartësi që të tërheqë vëmendjen e opinionit politik botëror, të shteteve dhe të shërbejë, siç kanë shërbyer edhe materialet e tjera që ka botuar Partia jonë, për të sqaruar opinionin botëror mbi politikën e Partisë dhe të shtetit socialist shqiptar.** Në të njëjtën kohë ky artikull të shërbejë për të demaskuar ashtu siç duhet tratativat e hapëta dhe të fshehta të revizionistëve kinezë, jugosllavë dhe rumunë. Artikulli duhet përgatitur me kujdes, pra, si të thuash, jo të intrigojmë, se ne nuk e kemi zakon të intrigojmë, por duke njohur mirë karakterin e politikës së Titos, të Çausheikut dhe të kinezëve, jemi të bindur se ata do të intrigojnë kundër nesh. Prandaj, duke thënë të vërtetën, ne do të tërheqim vëmendjen e opinionit botëror, se, pavarësisht që Titoja dhe Hua Kuo Feni hiqen si pro-imperialistë, ka mundësi që në këtë mes të ketë dorë në një të ardhme edhe socialimperializmi sovjetik.

**Kina, duke ndjekur rrugën për t'u bërë një superfuqi, përpiqet të krijojë stabilitet në mes të tri superfuqive im-**

perialiste, me qëllim që ta rindajë botën jo në dy, po në tri dhe së toku të krijojnë, në unitet dhe në rivalitet një statukuo kapitaliste. Natyrisht, kjo statukuo kapitaliste është diçka efemere, fare e përkohshme, për arsye se lufta për fuqi, për hegjemoni dhe për tregje në botën aktuale, kur revolucioni është në marshim, kur popujt janë zgjuar dhe po luftojnë në forma të ndryshme për të fituar lirinë, pavarësinë dhe sovranitetin nëpërmjet reformave, nëpërmjet luftërave nacionalçlirimtare e revolucionit, nuk do të shkojnë si në gjalpë. Popujt nuk do të lejojnë superfuqitë që të krijojnë atë situatë që dëshirojnë ato. Do të ketë me siguri gjakderdhje, do të ketë luftëra, do të ketë ndryshime aleancash. Veçse në këto përpjekje të superfuqive do të krijohet po ashtu një aleancë e madhe popujsh, një aleancë kundër superfuqive gjakpirëse kolonialiste dhe kundër të gjithë agjentëve të tyre në çdo shtet të botës, kundër demagogjive të ndryshme politike dhe ideologjike që shërbejnë për të mbajtur në errësirë popujt, që pengojnë zhvillimin e ndërjegjes së tyre për të fituar lirinë dhe pavarësinë.

Gjithashtu mendoj, dhe këtë do ta bisedoj edhe me shokët, se ka ardhur koha të shtypet dhe të dalë botërisht libri im «Imperializmi dhe revolucioni». Tash s'kemi pse ta mbajmë më si një material për përdorim të brendshëm në Parti, se lufta ideologjike dhe politike me kinezët ka marrë formën e vërtetë. Domethënë nuk ka pse të presim që demaskimi i ideologjisë antimarksiste kineze të mos konkretizohet në një manual, siç e kemi konkretizuar, dhe këtë t'ia japim në dorë opinionit botëror për ta lexuar. Ky libër le të ndihmojë për aq sa mund të ndihmojë. Vlera që ka ai, duhet ta bëjmë të shërbejë si për gjithë masat tona punonjëse, ashtu edhe për të tjerët që luftojnë në botë kundër mashtruesve, kundër shtypësve, kundër luftënxitësve imperialistë.

## S'KA Ç'FLITET PËR LITAR NË SHTËPINË E TË VARURIT

Shtypi titist, radiotelevizioni dhe agjencia Tanjug, gati heshtin për zhvillimet e fundit me shumë rëndësi në mes Shqipërisë dhe Kinës. Ata kanë dhënë vetëm një njoftim të shkurtër prej 5-6 radhësh, ku vënë në dukje se Kina i preu ndihmat ekonomike dhe tërhoqi specialistët nga Shqipëria dhe se Shqipëria, nga ana e saj, botoi një notë me të cilën kritikon Kinën për qëndrime nga pozitat e shtetit të madh. Nga ana tjetër, në këtë njoftim thuhet se Kina ia preu këto kredi Shqipërisë, për arsye se shqiptarët janë mosmirënjohës dhe me kaq mbaron, nuk i shkohet më tutje kësaj çështjeje, pse kjo u djeg.

Titistët, ashtu si revizionistët kinezë sot, këtë veprimtari armiqësore kundër Shqipërisë e kanë zhvilluar me vite, deri më 1948, prandaj s'ka ç'flitet për litar në shtëpinë e të varurit. Nga ana tjetër, Jugosllavia aktualisht me Kinën i ka marrëdhëniet sheqer e mjaltë. Këtë muaj atje do të pritët Hua Kuo Feni dhe do të bëhen bisedime të ngushta dhe të përzemërta me të. Natyrisht, do të ekzistojë për ta një re kërcënuese që do të vijë nga Shqipëria, prandaj i ruhen breshërit. Për këtë arsye nuk flasin, nuk i nxitin çështjet, qëndrojnë «neutralë», por këtë qëndrim ua do taktika e tyre revizioniste, kapitaliste. Në të vërtetë jugosllavët nuk janë

perialiste, me qëllim që ta rindajë botën jo në dy, po në tri dhe së toku të krijojnë, në unitet dhe në rivalitet një statukuo kapitaliste. Natyrisht, kjo statukuo kapitaliste është diçka efemere, fare e përkohshme, për arsye se lufta për fuqi, për hegjemoni dhe për tregje në botën aktuale, kur revolucioni është në marshim, kur popujt janë zgjuar dhe po luftojnë në forma të ndryshme për të fituar lirinë, pavarësinë dhe sovranitetin nëpërmjet reformave, nëpërmjet luftërave nacionalçlirimtare e revolucionit, nuk do të shkojnë si në gjalpë. Popujt nuk do të lejojnë superfuqitë që të krijojnë atë situatë që dëshirojnë ato. Do të ketë me siguri gjakderdhje, do të ketë luftëra, do të ketë ndryshime aleancash. Veçse në këto përpjekje të superfuqive do të krijohet po ashtu një aleancë e madhe popujsh, një aleancë kundër superfuqive gjakpirëse kolonialiste dhe kundër të gjithë agjentëve të tyre në çdo shtet të botës, kundër demagogjive të ndryshme politike dhe ideologjike që shërbejnë për të mbajtur në errësirë popujt, që pengojnë zhvillimin e ndërgjegjes së tyre për të fituar lirinë dhe pavarësinë.

Gjithashtu mendoj, dhe këtë do ta bisedoj edhe me shokët, se ka ardhur koha të shtypet dhe të dalë botërisht libri im «Imperializmi dhe revolucioni». Tash s'kemi pse ta mbajmë më si një material për përdorim të brendshëm në Parti, se lufta ideologjike dhe politike me kinezët ka marrë formën e vërtetë. Domethënë nuk ka pse të presim që demaskimi i ideologjisë antimarksiste kineze të mos konkretizohet në një manual, siç e kemi konkretizuar, dhe këtë t'ia japim në dorë opinionit botëror për ta lexuar. Ky libër le të ndihmojë për aq sa mund të ndihmojë. Vlera që ka ai, duhet ta bëjmë të shërbejë si për gjithë masat tona punonjëse, ashtu edhe për të tjerët që luftojnë në botë kundër mashtruesve, kundër shtypësve, kundër luftënxitësve imperialistë.

## S'KA Ç'FLITET PËR LITAR NË SHTËPINË E TË VARURIT

Shtypi titist, radiotelevizioni dhe agjencia Tanjug, gati heshtin për zhvillimet e fundit me shumë rëndësi në mes Shqipërisë dhe Kinës. Ata kanë dhënë vetëm një njoftim të shkurtër prej 5-6 radhësh, ku vënë në dukje se Kina i preu ndihmat ekonomike dhe tërhoqi specialistët nga Shqipëria dhe se Shqipëria, nga ana e saj, botoi një notë me të cilën kritikon Kinën për qëndrime nga pozitat e shtetit të madh. Nga ana tjetër, në këtë njoftim thuhet se Kina ia preu këto kredi Shqipërisë, për arsye se shqiptarët janë mosmirënjohës dhe me kaq mbaron, nuk i shkohet më tutje kësaj çështjeje, pse kjo u djeg.

Titistët, ashtu si revizionistët kinezë sot, këtë veprimtari armiqësore kundër Shqipërisë e kanë zhvilluar me vite, deri më 1948, prandaj s'ka ç'flitet për litar në shtëpinë e të varurit. Nga ana tjetër, Jugosllavia aktualisht me Kinën i ka marrëdhëniet sheqer e mjaltë. Këtë muaj atje do të pritët Hua Kuo Feni dhe do të bëhen bisedime të ngushta dhe të përzemërta me të. Natyrisht, do të ekzistojë për ta një re kërcënuese që do të vijë nga Shqipëria, prandaj i ruhen breshërit. Për këtë arsye nuk flasin, nuk i nxitin çështjet, qëndrojnë «neutralë», por këtë qëndrim ua do taktika e tyre revizioniste, kapitaliste. Në të vërtetë jugosllavët nuk janë

neutralë, përkundrazi si revizionistë që janë, janë prokinezë dhe antishqiptarë.

Sidoqoftë, populli jugosllav e kupton se ku qëndron e drejta dhe ku qëndron e padrejta, ai, gjithashtu, i kupton qëllimet e klikës titiste në fuqi. **Veçanërisht shqiptarët që banojnë në Jugosllavi janë të egërsuar kundër Kinës që veproi në një mënyrë të tillë të pabesë kundër Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë dhe u bashkua me shtypësit e tyre, me Titon dhe bandën e tij.** Kjo për ne ka rëndësi të madhe dhe i shërben çështjes së socializmit dhe të fuqizimit të atdheut tonë në arenën ndërkombëtare, në Ballkan dhe veçanërisht brenda në Jugosllavi, pse shqiptarët që banojnë në Jugosllavi janë një faktor me rëndësi, ata janë përkrahës të atdheut të tyre të vërtetë, Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, janë dashamirë dhe mbështetës të politikës marksiste-leniniste të Partisë së Punës të Shqipërisë kundër vetadministrimit skllavërues jugosllav.

POGRADEÇ, E DIEL

6 GUSHT 1978

## PARTITË NORDIKE JANË ME KINEZËT

Artikujt më të këqij që janë shkruar kundër nesh në lidhje me vendimin e poshtër, antimarksist e antishqiptar të kinezëve janë ata të të dyja partive të ashtuquajtura marksiste-leniniste të vendeve nordike, të Suedisë dhe të Norvegjisë. Artikulli i shkruar nga partia e Norvegjisë është më i egër dhe më i ulët. Kjo parti me kohë është duke mbajtur qëndrime armiqësore kundër Partisë sonë. Ajo është e paguar nga kinezët dhe kjo kuptohet, për arsye se edhe pse është një parti e vogël, ka blerë një shtypshkronjë të madhe, nga e cila nxirren gazeta, fletushka dhe propagandohet me të madhe politika kineze në të gjitha ato rrethe ku ka mundësi. Me fjalë të tjera, ajo është kthyer në një qendër spiunazhi kinez në Norvegji.

Edhe partia e Suedisë është një organizatë më shumë socialdemokrate. Në radhët e saj ekzistojnë fraksione. Kryetari i asaj partie, që më duket se e quajnë Peterson, qëndron i lëkundshëm dhe nuk merr vendim as pro nesh, as pro Kinës. Edhe me ne ai do të bisedojë, po hap-tazi nuk del. Sidoqoftë shtypin e kësaj partie e kanë në dorë revizionistët. Janë këta që propagandojnë në këtë parti vijën e Mao Ce Dunit dhe tash së fundi flasin kundër qëndrimeve tona, duke pretenduar se jemi ne shkaktarë që kinezët i prenë ndihmën Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, natyrisht duke përdorur po ato arsye

bajate, pa kripë, që ka përdorur nota kineze, pse nga ato arsye mbështetet çdo propagandë e Kinës kundër nesh. Prandaj një propagandë e tillë nuk bën shumë efekt, mbasi gjithë shtypi suedez flet në favorin tonë, kurse këta, që hiqen si marksistë-leninistë, flasin kundër nesh.

**POGRADEC, E HËNE**

**7 GUSHT 1978**

## **KINËS SË SOTME, PËRKRAH BUDIZMIT DHE MAOIZMIT, I DUHET EDHE KRISTIANIZMI**

**Mbrëmë televizioni italian dha lajmin se vdiq papa Pavli i 6-të nga një atak kardiak.** U likuidua kështu edhe një kryereaksionar, i cili do të zëvendësohet nga një kryereaksionar tjetër, natyrisht, pas shumë intrigash e dallaveresh që do të luhen në Vatikan dhe në kancelaritë e ndryshme të vendeve me popullsi katolike.

Papa Piu i 12-të dhe papa Pavli i 6-të kanë luajtur role politike jo vetëm nëpërmjet fesë, por edhe drejtpërdrejt në marrëdhënie me shtetet e ndryshme. Papa Piu i 12-të ka qenë një mbështetës i Musolinit dhe i hitlerianëve, ai ka qenë i dërguari i papës kur Hitleri erdhi në fuqi, dhe gjatë Luftës të Dytë Botërore, ai ishte papë në Vatikan.

Në ato kohë papa Piu i 12-të u përpoq të ruante lidhjet e tij të fshehta dhe «diplomatike» si me fashistët italianë, ashtu dhe me hitlerianët. Personalisht ai dhe ideologjia metafizike kristiane e ndihmuan shumë fashizmin dhe hitlerizmin në luftën e tyre shkatërrimtare. Kurse papa Pavli i 6-të u tregua disi më liberal në çështjet e liturgjisë, në çështjet e lidhjeve të kristianizmit me kishat e tjera dhe veçanërisht me kishën ortodokse dhe patrikanën e Stambollit. Ai bëri një varg shëtitjesh në kontinente të ndryshme (bile edhe u plagos nga një filipinas), por të gjitha këto kanë pasur për qëllim të rirforconin linjën fetare katoliko-romane në të gjitha ato vende ku koha

kishte bërë punën e saj dhe kishte dobësuar jashtëzakonisht influencën e fesë.

Papa Pavli i 6-të thirri, gjithashtu, koncilin e dytë të Vatikanit, pas koncilit të parë që e pati thirrur papa Xhovanani. Ky koncil bëri disa reforma brendapërbrenda kishës, në lidhje me atë që feja kristiane t'u adaptohej më mirë zhvillimit të ngjarjeve në botë, zhvillimit të fashizmit, kalbëzimit të imperializmit dhe të kapitalizmit botëror. Natyrisht, këtu ai pati edhe kundërshtarë të fortë, që kërkonin të ruheshin të gjitha format, liturgjia dhe zakonet e vjetra klasike të Vatikanit, siç ishte kardinali francez Lëfevrë, të cilin e çuan bile deri në herezi.

Veçanërisht në Itali, feja ka një fuqi të madhe dhe mund të themi se kristianizmi, me të gjitha mjetet, ka hedhur kudo kthetrat e veta, në familjet italiane, sidomos në masat e grave. Ai ndërhyr edhe në punët shtetërore, natyrisht ku drejtpërdrejt, ku tërthorazi, nëpërmjet partisë demokristiane që është një parti e Vatikanit dhe ka ardhur në fuqi që në vitet e para pas Luftës së Dytë Botërore si dhe nëpërmjet partive të tjera, pse edhe partitë e tjera tani kanë lidhje me Vatikanin.

Vatikanin është një forcë e madhe shpirtërore, por edhe ekonomike në Itali. Forca e tij ekonomike nuk është zhvilluar vetëm brenda Italisë, por, si rrjeta e merimangës, është përhapur kudo në botë. **Vatikanin ka shoqëri dhe koncerne të tij që bashkëpunojnë ngushtë me koncernet kapitaliste botërore.** Prandaj «Selia e shenjtë» është një kuçedër kapitaliste si nga pikëpamja ideologjike, ashtu edhe nga pikëpamja materiale për shtypjen shpirtërore dhe ekonomike të popujve të botës, veçanërisht të atyre që akoma i besojnë këtij institucioni të egër dhe barbar, i cili e ka qendrën në Romë, por ka degë kudo, në të gjitha kontinentet.

**Tash Vatikanin ka filluar të futet edhe në Kinë.** Në një libër që kam lexuar dy-tre vjet më parë gjen material

veçanërisht për katolicizmin, që ka qenë përhapur përpara në Kinë. Në ato kohë atje kishte episkopë dhe kardinalë në të gjitha qytetet kryesore dhe besimtarët katolikë në Kinë arrinin në një milion e gjysmë deri në dy milionë njerëz.

**Natyrisht, Kinës aktuale, përkrah budizmit dhe maoizmit, i duhet edhe kristianizmi romak.** Papa me doktrinën e tij kristiane do t'i shërbejë doktrinës metafizike dhe idealiste të ëndërruesit Mao Ce Dun. Populli kinez është një popull i mësuar prej shekujsh nga shfrytëzuesit që të besojë. Në përgjithësi ai është një popull fanatik, në kuptimin e konservimit të traditave fetare të budizmit të mbështjella me zakone prapanike, por fanatik edhe për atë që e kanë mësuar të mendojë se besimi fetar i shërben atij «për të shëruar» vuajtjet dhe plagët, natyrisht, me fjalë dhe me lutje! Kisha katolike romake me pompozitet është e zonja që aktualisht të ndikojë për t'i zbutur zemrat e «sklleverve kinezë» të cilët kanë prirje të revoltohen kundër regjimit kapitalisto-revizionist që po vendoset në vendin e tyre. Prandaj Hua Kuo Feni dhe Ten Hsiao Pini në mos sot, nesër, kur të shkojnë për vizita në Itali, nuk është çudi të venë për t'i bërë një vizitë edhe papës së ri që do të zgjidhet këto javë. Kështu, papa Montini, papa Pavli i 6-të, më duket, pati kënaqësinë të priste në Vatikan revizionistë që nga Hrushovi e deri te Gromikoja. Edhe papa i ri do të ketë, gjithashtu, kënaqësinë dhe do t'i quajë «figlioli miei» Hua Kuo Fenin dhe Ten Hsiao Pinin, që do t'i shtrëngojnë «atit të shenjtë» duart dhe do t'i japin peshqeshe, ndërsa ky, nga ana e tij, do t'u japë nga një kryq të drunjtë, mbeturina të kryqit që «Krishti mbante në supe». Me këtë rast, natyrisht, do t'u thotë Hua Kuo Fenit dhe Ten Hsiao Pinit se po i bekon që «shpëtuan» Kinën nga tmerrin e bolshevikëve, prandaj si të tillë ata janë djemtë e Krishtit dhe të Budës, të cilin papa i ardhshëm nuk do të harrojë t'ua zërë në gojë, pse edhe ai do të tregohet shumë politikan.

**POGRADEC, E MËRKURE**

**9 GUSHT 1978**

**MBI VËREJTJET E SHOKËVE TË PARTIVE  
MARKSISTE-LENINISTE PËR LIBRIN  
«IMPERIALIZMI DHE REVOLUCIONI»**

I shkrova një letër Ramizit lidhur me vërejtjet që kanë bërë shokët e partive motra për librin «Imperializmi dhe revolucioni», të cilat shokët e Drejtorisë së Jash-tme ia dërguan Nexhmijes. Ato i lexova edhe unë. Dje lexova edhe disa të tjera, që i dërguan një çikë më vonë.

Në secilin nga këto materiale kam vënë disa shënime, kam bërë disa vërejtje për mendimet që kanë shfaqur dhe propozimet që bëjnë shokët e partive motra. Ne duhet t'i kemi parasysh, pse ka edhe vërejtje të dobishme, por nga çdo vend dhe çdo parti ka edhe hollësira, «partikularizma», që, pavarësisht se mund të jenë të drejta, nuk duhet të hyjnë në platformën e librit tonë. Ka dhe vërejtje që nuk janë të sakta, për të mos thënë të padrejta, ka më në fund edhe pikëpamje të kamufluara dhe të gabuara.

Nga sa mund të gjykoj për ato vërejtje lakonike të shokëve të partive motra (se me një të lexuar të shpejtë të librit është e zorshme të thelloheshin më shumë), në përgjithësi të gjithë janë shprehur në mënyrë pozitive, e kanë aprovuar dhe e kanë vlerësuar të nevojshëm e të dobishëm librin.

Në qoftë se mund të bëj disa konkluzione për për-shtypjet që pata gjatë leximit të vërejtjeve, mund të them

se shokët kanë një përgatitje të pamjaftueshme teoriko-politike për t'i shikuar nën prizmin e plotë të marksizëm-leninizmit ngjarjet që zhvillohen në botë. Veçanërisht çështja kineze i mundon. Ata janë kundër revizionizmit kinez, por, në qoftë se nuk gabohem, nuk e kuptojnë plotësisht gjithë rrezikshmërinë e madhe të tij. Nuk duhet t'i bëjmë fajtorë, pse është akoma shpejt që ata të shkëputen nga një e kaluar e afërt, kur zhvillohej një «tamtam» i madh për «socializmin e vërtetë» në Kinë dhe për Mao Ce Dunin si «një marksist-leninist i madh».

Partitë e tyre, me bindje marksiste-leniniste në përgjithësi, lindën dhe u zhvilluan me këto parulla, prandaj tash ato hezitojnë të shkëputen menjëherë, kanë frikë nga përçarjet, kanë frikë se mos dëmtohen nga një autokritikë bolshevike dhe nga një analizë e gabimeve që janë bërë, duke mbrojtur një parti si ajo e Kinës, që ka ditur të kamufltojë vijën e saj antimarksiste.

Këto hezitime shfaqen gati në të gjithë, disa i shprehin hapur, disa tërthorazi, duke thënë se janë dakord me atë që «Partia Komuniste e Kinës po kthehet ose është kthyer në një parti revizioniste», por «Mao Ce Duni ka qenë dhe është një marksist-leninist i madh». Në këto pozita është shoku Palacio (kilian), i cili thotë se nuk është dakord me ne për çështjen e Maos. Ai, natyrisht, s'ka si të mos bëjë fajtorë dhe revizionistë pasardhësit e Maos që mbështetin Pinoçetin, por në rast se kinezët nuk do të kishin mbajtur këtë qëndrim, nuk dihej nëse Palacio do të qëndronte në pozitën e dy karrigeve. Do të kishte mundësi më tepër që ai të mbante një pozitë si argjentinasi, gjë që unë e konstatoj nga vërejtjet dhe pyetjet e shkurtra e lakonike që po bën mbi materialin tonë. Shumë hezitime dhe dyshime duken në qëndrimet e tij ndaj revizionizmit kinez në përgjithësi. Mbështetja që Partia Komuniste Revolucionare e Kilit i bëri letrës sonë të korrikut, ishte e mirë. Kjo duhet të na bëjë të

mos i humbasim shpresat, por të punojmë me durim që ta fitojmë edhe Palacion dhe, duke pasur parasysh pikëpamjet e tij, me rast ta sqarojmë dhe ta bindim.

Shumë më serioze është çështja e Rexh Bërçit, që paraqitet më i kamufluar, më dinak. Prandaj me të duhet të ecet me shumë kujdes dhe me shumë rezerva. Ai nuk është dakord me pikëpamjet tona për Partinë Komuniste të Kinës dhe nuk është dakord që ne të mbrojmë me kaq forcë, vendosmëri dhe besim marksizëm-leninizmin. Rexh Bërçi nuk është marksist-leninist. Mendimet që ka shfaqur për materialin tonë nuk kanë barazim, as ngjashmëri me vërejtjet dhe qëllimet konstruktive të shokëve të tjerë.

Taktika e Bërçit që në fillim është e dyshimtë: në disa çështje ai thotë haptazi se nuk është dakord me ne (për problemin e sindikatave ose për ndonjë problem tjetër), pastaj mburr Partinë tonë dhe materialin e saj. Pasi e pozon kështu problemin (ne të mos ia vëmë re, pse ai në fakt është në krye të një dege të tredunioneve), ai i rrëzon të gjitha tezat marksiste-leniniste të Partisë sonë.

1) Kur ai vë pyetjen: «A duhej bërë ky material në këtë kohë?», kjo do të thotë, se nuk duhej bërë, domethënë se, sipas tij, nuk duheshin trajtuar jo vetëm problemet kineze, por të gjitha ato që shkruhen në librin «Imperializmi dhe revolucioni». Me këtë qëndrim ai vihet kundër vijës së Partisë sonë. Një njeri, që quhet marksist-leninist, si mund të thotë: «A është koha për këtë material?». Ja është koha tani, ja s'ka qenë kurrë! Të heshtim, do të thotë t'u lëmë fushë veprimi imperializmit, kapitalizmit dhe revizionizmit, që luftojnë kundër marksizëm-leninizmit dhe socializmit. Ky qëndrim tregon se Bërçi është zjarrfikës i revolucionit proletar dhe i çdo revolucioni. Ai është një oportunist, një reformist.

2) Ai kërkon të na trembë, jo se i vjen keq për ne

(kjo duhet të jetë e qartë), por për presion, prandaj na thotë: «Mos u gënjeni nga zhurma e madhe dhe nga aleatët e dyshimtë që do të thonë se ju takon juve ta bëni këtë material» dhe më në fund lëshon «bombën»: «A ju takon juve ta bëni këtë gjë?».

Është e qartë se ai kërkon të përçmojë rolin dhe rrugën e Partisë sonë, kërkon të na shkëputë nga lëvizja marksiste-leniniste dhe të na izolojë nga lëvizja revolucionare e proletariatit. Ai është kundër partive marksiste-leniniste dhe këtë e tregon qartë izolimi i partisë së tij, që nuk rrjedh nga «karakteri anglo-sakson», por nga qenia e kësaj partie një «fraksion i majtë, i vogël i tredunioneve». Kjo është arsyeja që ai nuk shqetësohet për faktin që partia e tij nuk është në fuqi, por paska frikë për ne që jemi vend i vërtetë socialist. Socializmin Bërçi do ta mbyllë në guaskë, që të mos luftojë, prandaj na thotë: «Është detyra juaj të mos përpiqeni të luftoni në të njëjtën kohë të gjitha fantazmat». Të luftosh armiqtë e komunizmit dhe të marksizëm-leninizmit, për Bërçin do të thotë donkishotizëm. Për Bërçin armiqtë e komunizmit s'qenkan të rrezikshëm, por «fantazma» si mullinjtë me erë të Don Kishotit!

«Kapuni pas një hallke të dobët», — thotë Bërçi, po nuk na e thotë, cila është kjo hallkë e dobët.

«Mos shpërndani dyshime në botë», — thotë prapë ky prokinez, që është njeri i statukuosë, njeri plotësisht i tredunioneve, për të mos thënë diçka tjetër. Për të lufta jonë është e dyshimtë, ajo përhap dyshime, pra, sipas tij, ne qenkemi gënjeshtarë, demagogë, ngatërrestarë. Dhe, për të ilustruar këtë tezë reaksionare dhe disfatiste, ai hiqet si «revolucionar», duke na këshilluar, si Anastas Lula dikur, që të grumbullojmë forcat, të grumbullojmë marksistë-leninistët. Po pse t'i grumbullojmë këta marksistë-leninistë? Për të hequr valle?

«Mos krijoni lobi kineze dhe lobi shqiptare, thotë

Bërçi, pse lobia kineze do të na izolojë dhe do të na zhdukë». Qartë: Bërçi na këshillon ta lëmë lobinë kineze të veprojë, t'i lëmë Trockin, Bernshtajnin, Titon, Hrushovin, Maon, Ten Hsiao Pinin të punojnë, të krijojnë përandoritë e tyre në kurrizin e popujve dhe ne, marksistë-leninistët, të lidhim duart. Bërçi mbron jo vetëm Kinën revizioniste, teorinë e «tri botëve» dhe aleancën e «botës së tretë», me «botën e dytë» dhe me imperializmin amerikan, por ai mbron edhe imperializmin amerikan, anglez etj.

Marksizëm-leninizmin, ideologjinë e proletarietit, doktrinën e Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit, Bërçi e quan me përcmim «lobi shqiptare». Domethënë, për këtë reformist lufta nuk u bëka në mes ideologjisë marksiste-leniniste dhe ideologjisë borgjeze, nuk u bëka kundër kapitalizmit botëror dhe revizionizmit nga proletariati botëror dhe nga popujt që duan liri, por qenka një «luftë në mes dy lobive». Bërçi dhe partia e tij, duke lexuar librin tonë, ku ne kemi folur për dy lobitë kineze në Shtetet e Bashkuara të Amerikës gjatë luftës kino-japoneze, e konsideron luftën e madhe të marksizëm-leninizmit si të paqenë; për të ekzistojnë «dy lobi», ajo kineze dhe ajo shqiptare, bile ajo kineze do të fitojë, prandaj ne e paskemi kot që luftojmë.

Bërçi është varianti anglez i australianit Hill. Ky, kur iku nga Kongresi ynë i 7-të nuk vajti në Londër pse atje i ra rruga, por me qëllim të keq, gjë që provohet me faktin se qëllimet e të dyve janë identike. Hilli veproi i pari, haptazi dhe me ngut, kurse Bërçi më me vonesë dhe më me diplomaci.

Bërçi na «këshillon» të ulim tonin, se që të shuajmë luftën nuk mund ta thotë kaq haptazi. Duke përfutur nga modestia jonë, ai na pyet: «Pse i futeni kësaj valleje, kur s'jeni ju ata që duhet ta hiqni?».

Pikëpamjet dhe qëllimet e Hillit dhe të Bërçit, në

esencë, janë identike. Të dy ata mendojnë se ne dashkemi të bëhemi lidërsipët e luftës kundër revizionizmit modern, të dy janë kundër Kominternit, të dy me forma të ndryshme mbrojnë Kinën, i pari, Hilli, hapur dhe në bllok, kurse i dyti, Bërçi, mbron Maon, duke mos folur për të, por duke folur mirë për Çu En Lain, i cili është faktotumi më i zgjuar dhe pragmatist i ëndërrimeve antimarksiste të Maos. Çuja është elementi antimarksist më i kualifikuar i borgjezisë kineze. Bërçi jep ide pozitive për Çunë, gjoja duke u nisur nga kontaktet që ka pasur ndonjëherë me të. Por me siguri «lepuri fle gjetkë». Hilli mendoi të na frenonte që në fillim, por, kur lufta antirevizioniste po merr proporcione të gjera, del në skenë Rexh Bërçi për të na «këshilluar» që ta ndalim në mes, «të bëjmë një pauzë, të marrim ca frymë, të grumbullojmë marksistë-leninistët dhe të tregohemi më pak pretenciozë».

Interesant është dhe fakti që një sulm i tillë, i hapët dhe i maskuar, vjen nga dy elementë anglosaksonë, nga dy parti të quajtura «marksiste-leniniste», njëra australiane, tjetra angleze, të dyja pjellë dhe pjesë përbërëse e tredunioneve të këtyre vendeve. Hilli hiqet teoricien, se ka bërë dhe një libër mbi «tredunionet australiane», kurse Bërçi është i aktivizuar brenda në tredunionet angleze. Të dy janë reformistë, asnjëri nuk është marksist-leninist.

Për të dy këta persona dhe dy partitë e tyre, duhet të na tërheqë vëmendjen edhe diçka tjetër: A mund të jetë e rastit që Bërçi të denigrojë në sytë tanë «shokët» kanadezë, duke dyshuar për ta si spiunë të fuqive imperialiste, kur edhe Kanadaja është një vend me popullsi dërrmuese anglosaksone?! A mund të jetë e rastit që Hilli përçan Partinë Komuniste të Zelandës së Re dhe, ai që luftonte Uillkoxin, tash është puqur me të? Edhe Zelanda e Re është një vend me popullsi anglosaksone.

Ka mundësi që të dy, si Hilli, si Bërçi, të punojnë për një padron dhe për një qëllim: Të luftojnë në vendet anglosaksone çdo lëvizje të vërtetë revolucionare marksiste-leniniste.

Sipas mendimit tim një gjë është e vërtetë, që këta të dy janë antimarksistë, antirevolucionarë, pavarësisht nga taktikat dhe format që përdorin.

Ka mundësi që Bërçi ta vazhdojë këtë pseudomiqësi dhe t'i ruajë kontaktet me ne, por ne duhet të jemi shumë vigjilentë. Më mjaftuan shënimet e fundit, që më dërgoi Drejtorja e Jashtme e aparatit të Komitetit Qendror mbi mendimet autentike të Bërçit, për t'u bindur për idetë e tij politike dhe ideologjike antimarksiste.

Të mos e neglizhojmë kurrë punën e armiqve të kamufluar. Të jemi vigjilentë ndaj larmisë së formave dhe të metodave që përdorin ata. Populli thotë: «Çdo gjë që ndrit nuk është ar». Të kemi besim revolucionar, por kurdoherë të jemi vigjilentë dhe të mos humbasim kontrollin, pse armiqtë janë dinakë, të rafinuar, që nuk duhet t'i nënvleftësojmë.

Rekomandoj që gazetës së Bërçit t'i bëhet një studim më i imët i shikuar me një sy më metikuloz<sup>1</sup> marksist-leninist. Pas kësaj pune, shokët që do të ngarkohen me studimin e saj, të na bëjnë një relacion, ku të shprehin gjykimin e tyre se deri ku dhe në ç'forma ky person dhe kjo parti janë në pozita marksiste-leniniste e antirevizioniste në përgjithësi, dhe kundër revizionizmit kinez në veçanti. Ka mundësi që, të shtyrë nga dëshira jonë dhe nga disa «insinuata revolucionare» që elementët borgjezë demokratë lëshojnë çdo ditë në shtypin e tyre, ne të kemi formuar një mendim «pozitiv» pa baza.

Pse vallë Bërçi deri tash ka qëndruar i mbyllur në «kullën e fildishtë» angleze? Ne kemi qëndruar në besi-

1 Nga frëngjishtja — shumë i kujdesshëm.

min naiv se ai është anglosakson dhe gjoja e tillë është natyra e tyre. Por nuk është kjo arsyeja e mbylljes së tij. Një arsye e vërtetë është ajo që del nga këshillat që ai na jep tani neve, pra që të ulim tonin dhe forcën e luftës e «të mos ngatërrojmë dynjanë». Arsyeja tjetër del nga ajo që ai është kundër partive marksiste-leniniste, prandaj s'do të ketë kontakt dhe bashkëpunim me to. Arsyeja e tretë është që ta frenojë lëvizjen revolucionare.

Në qoftë se nuk gabohem, kur shoku Ramiz e pyeti Bërçin se për ç'arsye ai nuk merr kontakt me partitë e tjera, ai u përgjigj: Do të mendohem për këtë gjë. Ai mund të dalë me mendimin se ka ardhur koha për të që të veprojmë më hapur kundër unitetit të lëvizjes marksiste-leniniste, prandaj nuk duhet inkurajuar kontakti i tij me partitë e tjera dhe as duhet bërë ndonjë farë reklame për të në shokët dhe në miqtë e Partisë sonë në botën e jashtme.

Në letër i them Ramizit se i shkrova gjatë për Bërçin, pse më erdhi rëndë dhe më bënë përshtypje të keqe mendimet e tij aq cinike, të shprehura gjoja me «dashamirësi dhe sinqeritet». Unë formova bindjen se mendimet e tij nuk janë të tilla, prandaj porosita që shokët tanë të Drejtorisë së Jashtme t'i studiojnë me një sy më të thellë bisedat e shokëve të huaj, që të mund të nxjerrin mandej konkluzione sa më të drejta, pse kështu mund ta ndajmë shapin nga sheqeri, mund të ndihmohemi nga ata, por edhe t'i ndihmojmë, duke mbajtur parasysh që edhe ata, por edhe ne mund të gabohemi në dhënien e ndihmës.

Disa nga mendimet e mia të mësipërme në mënyrë racionale dhe koncize mund t'i inkuadrojmë në librin tonë, në variantin tjetër, pse mund të ketë dhe parti të tjera që nuk e thonë hapur, por, në mos sot, nesër mund të mendojnë se «PPSH do të marrë flamurin» e të tjera mendime të paqena si këto, që i nxitin edhe borgjezia e revizionizmi për të na përçarë.

Nexhmija dhe unë mendojmë se, kur ta ripunojmë librin «Imperializmi dhe revolucioni», jo vetëm duhet të shikojmë më mirë kontinuitetin, duke korrigjuar përsëritjet që kanë rrjedhur nga puna e shkëputur që kam bërë për pjesët e ndryshme, në lidhje me shtruarjen në plenum të ndryshme, por duhen bërë edhe shtojcat për realizimin e atyre mendimeve të drejta që kanë propozuar shokët tanë e të huaj. Sidomos kapitullin e parë, por edhe disa kapituj të tjerë, duhet t'i plotësojmë, se për Partinë tonë ato probleme që shtrohen janë të kuptueshme, por për të tjerët duhen përcaktuar më gjerë, siç janë, për shembull, çështjet e revizionizmit sovjetik, të vetadministrimit jugosllav etj. Për këto kam shkruar diçka tash së fundi, por natyrisht nga materiali duhet zgjedhur ajo pjesë që na duhet dhe që i përshtatet dhe plotëson përmbajtjen e kapitujve në fjalë. Për këtë çështje do të bisedojmë edhe kur të kthehem unë nga Pogradeci.

Dhashë edhe një rekomandim të fundit: Në thëniet e shokut iranian ka gjëra për të cilat ai mund të mos jetë i qartë dhe kërkon shpjegime, por mund të ketë dhe gjëra që i mendon gabim e i shpreh në formë pyetjesh. Nuk i lexova dot me kujdes të tëra sa ka thënë ai, prandaj porosita që ta bëjnë shokët tanë këtë gjë. Të kihet parasysh se kjo parti është e re dhe jo shumë e njohur nga ne.

POGRADEC, E ENJTE

10 GUSHT 1978

### «PAPA» HUA, KËRKON TË BËJË «KONCIL» ME «KARDINALËT» KIM, TITO E ÇAUSH

Agjencia rumune e lajmeve Axherpres njoftoi se Nikolae Çausheku, president i Rumanisë, bëri një vizitë në Bashkimin Sovjetik te padroni i tij, Leonid Brezhnjevi.

Ky udhëtim i Çaushit ka një karakteristikë të veçantë, për arsye se bëhet para vajtjes zyrtare në Rumani të presidentit kinez, Hua Kuo Fen. Çaushi, pra, më parë shkoi t'i merrte dorën padronit të tij, Brezhnjevit, të këshillohej me të se si duhej të vepronte me mikun e lartë nga Kina që do t'i vijë në Bukuresht. Ishte i natyrshëm dhe i domosdoshëm një takim i tillë në mes agjentit dhe padronit, ndryshe nuk ecin punët. Dhe, sigurisht, Brezhnjevi e këshilloi Çaushin të mos uthet dhe të mos shtrëngohet shumë me Hua Kuo Fenin, se pastaj mund t'i zihet fryma dhe të kalojë në atë botë, prandaj duhet ta luajë si duhet lojën e tij të dyfishtë. Brezhnjevi e ka këshilluar që në sipërfaqe të tregohet, po e po, edhe mik i Kinës, por t'i këshillojë Hua Kuo Fenit edhe një zbutje, mundet jo të menjëhershme, por graduale, me Bashkimin Sovjetik. Kështu që nga kjo edhe Çaushi fiton, edhe Hua Kuo Feni fiton, edhe revizionisti Brezhnjevi fiton.

Për t'i dhënë kësaj vizite kortezie, si me thënë, përshtypjen e vajtjes së shërbëtorit tek ustai, ajo nuk zgjati veçse një ditë. Kjo do të thotë se u dhanë urdhrat dhe

shërbëtori ka bërë «amin», pse, për të rënë dakord në një bisedë prej dy-tri orësh për gjithë ato probleme të mëdha ndërkombëtare që numëronte komunikata e përbashkët rumuno-sovjetike, duhet patjetër të ketë ekzistuar një miqësi e ngushtë në mes këtyre dy shteteve revizioniste, pavarësisht se, kur u kthye në Bukuresht, Nikolae foli përpara gazetarëve se gjoja ruan pavarësinë, mbron parimin e mosndërhyrjes, interesat reciprokë, mban ekulibrin në mes fuqive të mëdha dhe është për unitetin e kombeve (!), e të tjera e të tjera, me nder, pordhë si këto. **Në të vërtetë Çaushekun e dhaskalepsi mirë e si duhet Brezhnjevi dhe njëkohësisht e kërcënoi se një lëvizje e tepruar mund t'i shkaktonte thyerjen e qafës. Çaushi i ka shumë të ndjeshëm qafën dhe kurrizin, ose, më drejt, shtyllën vertebrore ai e ka mjaft të përkulshme. Këtë kuptim ka udhëtimi i Çaushtit në Bashkimin Sovjetik.**

Tash të vijmë në një çështje tjetër. Dihet se kur vdes një papë në Vatikan, ai zëvendësohet atje me një papë tjetër. Pasi bëhen ceremonitë e duhura për papën që harroi të merrte frymë dhe pasi bëjnë të kalojnë me mijëra veta përpara trupit të tij të ekspozuar dhe të balsamosur, pas shumë liturgjive dhe skenave fetare, atë e marrin dhe e groposin thellë e më thellë në bodrumet e Vatikanit dhe i këndojnë *De profundis*-in. Kështu bëjnë në Vatikan për të gjithë papët. Pastaj mbledhet korporata e kardinalëve në një mbledhje të fshehtë që e quajnë Konklavë. Në këtë mbledhje kardinalët rrinë me ditë, të kyçur me çelësa, atje hanë, atje pinë, atje flenë, atje, me nder, dhiten e bëjnë intriga të panumërta dhe më në fund e më në bisht «zgjedhin» një papë të ri, i cili zakonisht është ndër më të moshuarit. Gjithë këto procesione zgjatin kaq shumë, sepse gjatë emërimit të papës së ri zhvillohen plot dallavere dhe allishverishe.

**Edhe në Kinë vdiq «papa», i cili s'quhej Pavël ose Piu, por Mao Ce Dun. Ky nuk e kishte profesion kristianizmin, por kishte një ideologji që u quajt maocedunide.** Edhe ky «papë», baba i maocedunidesë, harroi një ditë të merrte frymë dhe për të nuk u kënduan shumë liturgji, por u bë si u bë, në mënyrë misterioze dhe me një grusht shteti, u vetëmërua një «papë» i ri, që u quajt Hua Kuo Fen. «Papën» e vdekur në Kinë nuk e futën në bodrume, siç futën Pavlin e 6-të, por e lanë mbi dhe në një shesh që quhet Tien An Men, e balsamosën dhe i thanë: «Tash rri atje, se mirë je, «papa» Hua dhe ne do të bëjmë këtu punën tonë». Dhe kështu, në kundërshtim me ceremonitë që u bënë për papa Pavlin e 6-të, «papës» kinez i kënduan një *De profundis* një çikë të çuditshëm: nga njëra anë u vunë kazmën atyre pseudo-ideve të Maos që ishin si shumë të ngadalshme për restaurimin e kapitalizmit në Kinë, nga ana tjetër po me flamurin e Maos «të rinjtë» ua hipën kuajve qiellorë për t'u lidhur me imperializmin amerikan dhe me kapitalizmin botëror.

**«Papa» i ri kinez, me emrin Hua Kuo Fen, ka po atë fytyrë prej idioti të papëve më idiotë. Këtij nuk i duhet vetëm aprovimi i klikës kineze për grushtin e shtetit që bëri, por i duhet edhe aprovimi i jashtëm, prandaj ky «papë» i ri i Kinës, i rrumbullakosur në fytyrë dhe në trup, do të dalë me dhisk për të krijuar «Sinodin» ose «korporatën e kardinalëve». Kjo është arsyeja që Hua Kuo Feni do të ndërmarë një udhëtim tjetër nëpër botë.**

Udhëtimin e parë «papa» i ri kinez e bëri në Kore te «kardinali» Kim Ir Sen. Ky «kardinal» ngjet si dy pika uji me kardinalët e kishës së Romës që tërë jetën e tyre kanë gënjyer masat e besimtarëve dhe kanë rrojtur në kurrizin e tyre, kanë marrë lëmoshë nga të katër anët e botës dhe kanë krijuar një pushtet të vetin. **I tillë është edhe Kim Ir Seni. Ky na paska një «besim» të veçantë**

që e quan «revolucionar», por që në mënyrë po të veçantë quhet teoria «çuçe». Kjo teori, sipas «kardinalit» Kim Ir Sen, duhet të zaptojë botën. Kim Ir Seni nuk e quan veten si një «kardinal» të thjeshtë, por si udhëheqësin shpirtëror të të gjithë botës. Kjo nuk është një frazë fejtoni, por është një frazë dhe teori që shpaloset çdo ditë në gazetatat koreane. Prandaj Hua Kuo Feni, «papa» i Kinës, vajti në Kore që ta bindte këtë «papë» tjetër që të bëhej duaxhiu i tij, domethënë të bëhet «kardinal», pjesëtar i një «konklavi» që kishte mbaruar me një puç në Kinë, por që kërkonte aprovimin edhe të «kardinalëve» të jashtëm.

Kim Ir Seni, natyrisht, i etur për kredi, për dollarë, e priti «papën» e Kinës me një bujë të madhe dhe u duk sikur ishte dakord me të, pse u ndanë nga njëri-tjetri me buzëqeshje. Hua Kuo Feni iu dha nga Kim Ir Seni busti i një heroi korean, iu dha edhe një thikë simbolike, që në Kore, kur martohen, burri ia jep gruas në shenjë besnikërie. Këtë Kimi e bëri për të treguar besnikërinë e tij ndaj «papës» së ri të Kinës. Dhe Hua Kuo Feni, nga ana e tij, i tregoi botës se gjoja e siguroi mbështetjen e «kardinalit» korean.

Tash Hua Kuo Feni do të fillojë udhëtimin e tij në Evropë, në atë Evropë, të cilën me predikimet e tij ai kërkon ta hedhë në një luftë të tretë botërore. Dhe, që ta hedhë si duhet Evropën në një luftë të tretë botërore, ai po e fillon vizitën e vet nga «kardinali» Nikolae, «Nikolai Ftaroj»<sup>1</sup> — alias Çausheku. Në këtë kontinent Huaja do të pritët nga dy «kardinalë» të tjerë pa cipë dhe, nga komunikatat që do të lëshohen, me siguri do të dalë se janë në «akord» të plotë, në «miqësi» të shëndoshë. «Papa» i Kinës do të mburrë veprën «madhështore» të Nikolae, i cili e mbron me zjarr kashte «pavarë-

sinë, lirinë dhe sovranitetin e Rumanisë», nga «ariu rus», tek i cili «kardinal» Çausheku shkoi disa ditë më parë dhe mori instruksione.

Pra «papës» së Kinës iu bënë dy «kardinalë» që ka vizituar, i treti është «më i bukuri», «më i fuqishmi», «më rinori». Atë e quajnë Josif. Josifi, siç dihet, bëri me barrë Marinë dhe nxori në dritë djalë e perëndisë, Krishtin. Pra «kardinal» Josifi, që në botën kontemporane njihet edhe me emrin Broz Tito, lindi titizmin në një Jugosllavi që e shiti te mbretërit mazhë, për të cilët Testamenti i ri i «kishës së shenjtë» tregon se shkuan në haurin e Josifit të Marisë e të Krishtit Jezu, që, sipas Biblës, lindi me «frymën e shenjtë».

Titoja lindi nga ndërzimi me imperializmin amerikano-anglez. Këta përnjëherë shkuan pasi «kardinal» Josifi zhvilloi shizmën në Jugosllavi dhe i çuan këtë burri peshqeshe të panumërta, ndërsa Jugosllavinë e vunë nën zgjedhën e tyre. Babai i kësaj feje të re që e quajnë «titizëm» dhe që është fe idealiste në shërbim të kapitalit, siç është edhe kristianizmi, u bë një shërbëtor i dëgjuar, mbasi u shërbente mirë kapitalistëve.

Përveç kësaj titizmi polli edhe një vezë tjetër, kufkë që quhet vetadministrimi jugosllav. Këtë vezë kufkë ai kërkoi ta shesë, në të gjithë botën si një vezë të freskët dhe për këtë ai ndihmohet nga të gjithë, duke përfshirë edhe kinezët, të cilët po e blejnë këtë vezë boshe. Por Josifi, babai i titizmit ishte pjellor nga mendja. Ai nxori edhe një teori tjetër, teorinë e «botës së paangazhuar». Në këtë «botë të paangazhuar» ai «grumbulloi» ose bëri një stan me lepuj dhe këtë stan gjoja e udhëhiqte ky farë burri. Këtë pjellë të kësaj mendjeje të çakërditur të «kardinal» Josifit e ngritën në qiell të gjithë kapitalistët e botës. Dhe tash «papa» i Kinës, «papa» i ri, jo vetëm e shikon me admirim Josifin, por dëshiron edhe ta trashëgojë, pse fundi i fundit Josifi është plak dhe, në mos sot,

<sup>1</sup> Rusisht — Nikolla i dytë. Aludim ironik me car Nikollën.

nesër, do ta futin edhe atë në bodrumet e ndonjë «Vatikanit» jugosllav, ose do ta varrosin mbi tokë. Por kjo nuk ka rëndësi. Rëndësi ka çështja që Hua Kuo Feni vete jo të «kardinali» Tito, por të «perëndia» Tito, ai vete t'i puthë dorën, t'i lëpijë çizmet, t'i thotë Titos: «O zoti im, o udhëheqësi ynë shpirtëror! Të kemi sharë, të kemi hedhur gjithë ato plehra në fytyrë, të kemi quajtur renëgat, tradhtar, por të gjitha këto, o at i shenjtë, i ka bërë paraardhësi im, «papa» Mao Ce Dun. Por edhe paraardhësi im, «papa» Mao Ce Dun, i bëri këto pse e detyroi Stalini, pavarësisht se ky kishte vdekur. Megjithatë «papa» Mao mund ta kthente pllakën më vonë, por ai nuk e ktheu fare haptazi, jo se nuk të donte ty, o prindi im, i madhi Josif, por se, po ta kthente, do të fitonte antipatinë e gjithë popullit kinez dhe të popujve të tjerë të botës, kurse unë, «papa» i ri i Kinës, i vura punët drejt dhe çdo gjë në vendin e vet. Prandaj erdha këtu që të më japësh bekimin, të më japësh gjithashtu edhe votën tënde, pse pas teje kam ndër mend të bëj udhëtime të tjera për të parë e për t'u takuar me të tjerë «kardinalë» më pak hyjnorë se ti, por prapëseprapë «kardinalë» janë dhe më duhen në rrugën time».

**Dhe Titoja, nga maja e plehut ku po qëndron prej kaq vjetësh, do ta bekojë Hua Kuo Fenin, por me kujdes të madh, pse ai është «i paangazhuar», domethënë është si Josifi i Biblës — edhe burri i Marisë, edhe jo burri i Marisë.** Pra «kardinal» Josif Brozi është edhe me amerikanët, edhe me sovjetikët. Aktualisht «papa» i Pekinit tregohet antisovjetik aq sa tregohet edhe proamerikan, gjë që për Titon nuk para është e leverdishme. Prandaj ata do të kuptohen dhe do t'i çuquritin vesh më vesh njëri-tjetrit: rruga që kemi ndjekur është më e mira dhe ne duhet të ecim në këtë rrugë të amerikanëve, por duhet të kemi një cikë kujdes nga ekzagjerimet kundër Bashkimit Sovjetik, se ariu polar mund të na futë ndonjë

dhëmb dhe të na gjakosë. Edhe ju, do t'i thotë Titoja Hua Kuo Fenit, duhet t'ia keni frikën «ariut rus». Ju keni nevojë për paqe hyjnore dhe paqe hyjnore s'do të thotë të mos zaptosh vende, të mos pasurohesh në kurriz të popujve, të mos i ruash popujt për t'i mjelë, për t'i shtypur dhe për t'u pirë gjakun. Jo, por ti ndiq mirë rrugën time, sido që kjo rrugë ka shumë gropa të thella dhe në to disa herë unë për pak e theva qafën, dhe, po të mos ishte ndihma amerikane, do të kisha mbaruar. Ti, «papa» i Pekinit, e ke kuptuar mirë këtë çështje, meqenëse të dy vendet tona ndërtojnë «socializmin» dhe ky socializëm kapitalist nuk mund të ndërtohet pa ndihmën e atyre që kanë forcën materiale, që kanë forcën ushtarake, që kanë, gjithashtu, edhe bekimin e zotit — Vatikanit të vërtetë. Ju besoni Budën, do t'i thotë Titoja, por kjo s'prish ndonjë punë, besojini që të dy, edhe Budën, edhe Vatikanin. Kështu bëjnë edhe gjermanët, që edhe Vatikanin e besojnë, edhe luteranë janë, anglezët po ashtu. Shikoni çështë Shmidi dhe gjithë kancelarët gjermanë, që nuk kanë munguar të venë në Vatikan? Edhe unë kam vajtur, edhe ti në mos sot, nesër do të vesh. Pra, siç e di fare mirë, do t'i thotë «kardinal» Josifi «papës» së ri kinez, feja kurdoherë nuk ka qenë e keqe për ne, prandaj ta vëmë atë në shërbim të qëllimeve tona. Dhe me brohoritje e me demonstrata, hipur në një automobil të hapët, tok me Titon, «papa» i Pekinit, i shoqëruar me 6 ose 8 motoçikleta, do të bredhë nëpër rrugët e Beogradit, të Zagrebit, të Lubljanës, mundet edhe të Shkupit, por besoj jo të Kosovës, pse kjo u djeg këmbët edhe jugosllavëve, edhe kinezëve. Kështu do të vazhdojë udhëtimi, plot turp, i këtij «pape» të ri të Pekinit, «papë» që po vihet në shërbim të kapitalit botëror.

U dhashë këtyre shënimeve njëfarë ngjyre fejtoni, sido që unë s'kam shkruar kurrë fejtone. Por të gjitha këto allishverishe, këto vajtje-ardhje, këto bisedime të

fshehta dhe të hapëta të krerëve revizionistë e kapitalistë më neveritin pa masë, janë gënjeshtër për popujt, janë komplete për paqen botërore, janë orvatje për të mbajtur nën zgjedhë popujt liridashës, për të luftuar dhe për të bërë përpjekje që të krimbin ideologjinë tonë të pavdekshme, marksizëm-leninizmin, për t'i mbajtur gjallë frymën imperializmit dhe kapitalizmit botëror.

Të gjithë këta — Titoja, Hua Kuo Feni, Brezhnjevi, Karteri me miun Çausheku po bëjnë atë lojë, e cila do të përfundojë në një gjakderdhje katastrofale për popujt. Prandaj popujt duhet t'i kuptojnë djallëzitë e tyre, të mos gënjejnë nga luksi, nga buja dhe nga fjalët, por të përgatitin luftën revolucionare, të përgatiten e të futen në aksione për të shkatërruar planet e këtyre armiqve e tradhtarëve, të cilët tok me padronët kapitalistë dhe revizionistë të çdo vendi, kërkojnë ta hedhin botën në një kasaphanë të tretë, të tmerrshme.

POGRADEC, E PREMTE

11 GUSHT 1978

## PËRSE HUA KUO FENI PO E SHTYN VIZITËN NË BALLKAN?

Sot lexova në buletin e lajmeve se Hua Kuo Feni e ka shtyrë udhëtimin e tij për në Rumani. Këtë njoftim e jepte nga Pekini agjencia franceze e lajmeve. Shtyrja, thuhej, është bërë për arsye se Hua Kuo Feni do të presë ministrin e Jashtëm të Japonisë, i cili ka vajtur në Pekin për të nënshkruar marrëveshjen kino-japoneze. A do të firmoset kjo marrëveshje ashtu si e kërkon Kina, duke përcaktuar qartë se kujt i referohet termi «hegjemonizëm», apo do të firmoset pa këtë fjalë, këtë do ta shohim. Kush ka bërë koncesione ndaj njëra-tjetrës, Japonia apo Kina? Termi «hegjemonizëm», që Kina e ka bërë të saj, i ka dhënë një kuptim të shtrembër dhe dëshiron që gjithë bota të kuptojë se, kur flitet për hegjemoni, është fjala për Bashkimin Sovjetik dhe vetëm për të. Kurse në fakt të jesh hegjemon, do të thotë të dominosh gjithë botën, ose pjesërisht këtë, do të thotë të bësh ligjin mbi të tjerët, t'i komandosha ata. Pra, nuk mund të pranojmë që me fjalët «hegjemonizëm i shteteve të mëdha mbi shtetet e tjera», duhet kuptuar vetëm dominimi i socialimperializmit sovjetik. Ky term në të vërtetë u përshtatet imperializmit amerikan, socialimperializmit sovjetik, imperializmit kinez, imperializmit francez, imperializmit anglez etj., bile edhe titizmit, që kërkon të vendosë hegjemoninë e vet politike mbi lëvizjen e «të paangazhuarve» etj.

Në disa raste Kina është gjendur në vështirësi për ta zënë në gojë me emër Bashkimin Sovjetik, për arsye se është ndodhur përpara përfaqësuesve të shteteve të tjera, të cilët për interesat e tyre nuk kanë dashur të përmendet nga ndonjë përfaqësues kinez emri i Bashkimit Sovjetik, prandaj Kina e ka gjetur si më të kollajtë fjalën «hegjemonizëm», me të cilën ajo nënkupton vetëm Bashkimin Sovjetik.

Vizitën për në Rumani Hua Kuo Feni e ka shtyrë për pak ditë, për arsyen që theksova më lart, sepse edhe ministri i Jashtëm i Kinës, Huan Hua, shoqëron ministrin e Jashtëm të Japonisë dhe pra, duhet të përcjellë këtë e pastaj të shkojë tok me Hua Kuo Fenin në Rumani. Këtë do ta shohim. Megjithatë ka mundësi që kjo të jetë arsyeja kryesore e shtyrjes së vizitës, sepse, në qoftë se nuk është një arsye e tillë, shtyrja bëhet me një afat të pacaktuar, kjo do të thotë se kemi të bëjmë me çështje të rëndësishme politike domethënë Bashkimi Sovjetik duhet të ketë ndërhyrë në Rumani, të ketë bërë kërcënime, të ketë caktuar pastaj edhe kushte. Por në këtë shtyrje mund të ketë efekt edhe Letra që Komiteti Qendror i Partisë dhe Qeveria jonë u drejtuan Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kinës dhe qeverisë kineze, për arsye se ajo trajtonte çështje ndërkombëtare dhe ballkanike që konsistonin në lidhje aleancash të predikuara nga Çu En Lai kundër Bashkimit Sovjetik dhe për krijimin në Ballkan të një situatë të turbullt. **Deri tash as qeveria jugosllave, as qeveria rumune nuk e kanë zënë në gojë çështjen që denoncuam ne, propozimin e Çu En Lait për një aleancë në mes Shqipërisë, Jugosllavisë dhe Rumanisë. Ata nuk deklaruan që qeveritë e tyre s'kanë ditur asgjë nga kjo çështje dhe se as nuk kanë pasur ndonjë mendim për një aleancë të tillë. Natyrisht, kjo të lë shumë të dyshosh se Çu En Lai, Titoja dhe Çausheku ishin marrë vesh mbi këtë çështje dhe patjetër agjentura**

**ua kishte futur në vesh edhe sovjetikëve, edhe amerikanëve. Megjithatë për këtë së shpejti do të sqarohemi.**

Para vizitës së Hua Kuo Fenit në Bukuresht, siç kam shkruar, Çausheku vajti në Krime, por agjencitë e lajmeve njoftojnë se edhe Titoja do të shkojë në Moskë, pas bisedimeve që do të ketë me Hua Kuo Fenin. Vajtja e Titos në Moskë ka disa arsye. Sigurisht, ai do të raportojë, veçse jo ashtu si Çausheku, i cili raporton dhe merr urdhra, pse Titoja është më diplomat e më dinak dhe s'pranon të marrë urdhra. Ai, siç duket, e shikon të arsyeshme, që të vejë në Bashkimin Sovjetik, t'i thotë Brezhnjevut se Jugosllavia mban kurdoherë një politikë «të paangazhuar» dhe në kuadrin e kësaj vije i mban edhe lidhjet me Kinën. «Interesat ekonomikë të Jugosllavisë, kuptohet, — do t'u thotë Titoja, — e duan që ne t'i zgjerojmë marrëdhëniet me Kinën, sepse kjo është një treg i madh dhe mallrat tona, që nuk i blen lehtë kushdo, do t'i eksportojmë atje; pastaj Kina do të na japë edhe kredi, sikurse na jepni ju. Natyrisht, — do t'u thotë Titoja sovjetikëve, — me miqësinë që po zhvilloj unë me Kinën i shërbej çështjes sonë të përbashkët».

Cila është kjo çështje e përbashkët? Kuptohet, kalbëzimi i Partisë Komuniste të Kinës. Partia e Titos dhe e Brezhnjevut janë kalbëzuar, pra Titoja duke afirmuar se vendos lidhjet me Partinë Komuniste të Kinës do të thotë se punon për ta kalbëzuar më tej këtë parti që nuk ka qenë kurrë një parti marksiste-leniniste.

Titoja me siguri do të informohet nga Çausheku për rezultatet e bisedimeve, që ky do të bëjë me Hua Kuo Fenin, gjithashtu Titoja do të ketë patjetër propozime të mëtejshme nga Brezhnjevi për Hua Kuo Fenin dhe, me mënyrën e tij të një prokseneti më të kualifikuar se Çausheku, ky do të bëjë pazarllëqe të mëtejshme me Kinën dhe me Bashkimin Sovjetik, natyrisht, duke parë interesat e Jugosllavisë së vet, por sidomos interesat

e imperializmit amerikan, me të cilin Titoja është në ujdi të plotë. Pra, ka mundësi që, pas bisedimeve me Hua Kuo Fenin, Titoja të shkojë të takohet me Brezhnjevën, gjoja për t'i kthyer vizitën miqësore, por në realitet për t'i thënë Brezhnjevës se si rrahin pulset e Hua Kuo Fenit dhe të Kinës. Prandaj, në qoftë se me Kinën Titoja mund të arrijë diçka, ai është i gatshëm që, pasi të marrë «kompensimin», domethënë ndihma nga Brezhnjevi, të vazhdojë tratativat e mëtejshme për ta bërë Kinën më pak të patrajtueshme nga Bashkimi Sovjetik dhe të pandashme nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Zaten ky është roli i këtyre dy agjentëve të kapitalit botëror, Titos dhe Çausheskut, që të dy u bëjnë shërbim superfuqive në interes të tyre.

Yksëzimisht e Kinës në Komunistat e Shtetit në të cilin të dy partitë, si Kinë dhe Mao Ce Duni, në të cilin Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë bërë përpjekje për të shprehur këmbëngulësinë e tyre në lidhje me këtë çështje.

## POGRADEC, E HËNE

14 GUSHT 1978

Pra, mund të imagjinojmë se Titoja dhe pa t'i marrë parasysh se mënyrë të tjerë ka për të bërë përpjekje për të marrë parasysh këmbëngulësinë e tyre në lidhje me këtë çështje.

## TRAKTATI KINO-JAPONEZ I KA RRËNJËT

### TEK IMPERIALIZMI AMERIKAN

Radio Pekini, radiot e botës, azhanset dhe gjithë shtypi ndërkombëtar japin lajmin e bujshëm të nënshkrimit të Traktatit të paqes dhe të miqësisë në mes Kinës dhe Japonisë. Më në fund u arrit në konkluzionin e dëshiruar nga Kina dhe të nxitur nga imperializmi amerikan.

Kina është tepër e gëzuar për këtë marrëveshje megjithëse ajo mund të ishte nënshkruar edhe më parë, por ka dëshiruar dhe ia arriti që marrëveshjes t'i japë karakterin e një aleance kundër Bashkimit Sovjetik. Kjo gjë në traktatin e nënshkruar u shpreh me formulën që «të dy vendet janë kundër hegjemonizmit në botë».

Natyrisht, për kinezët, për japonezët dhe për partnerin e tyre të madh, që u qëndron prapa krahëve, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, hegjemonizmi ka shenjë e barazimit me socialimperializmin sovjetik.

Kina bën një propagandë të vazhdueshme, me të cilën kërkon t'u hedhë hi syve njerëzve në botë, duke thënë se për vete të saj gjoja nuk do të luftojë kurrë për hegjemoni, gjë që është një gënjeshtëri. Nga ana tjetër, në politikën dhe në propagandën e saj ajo lë të kuptohet qartë se Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk luftojnë aspak për hegjemoni dhe se gjoja këtë rezultat kaq «të madh» e kanë arritur Çu En Lai e Mao Ce Duni me

**Niksonin e Kisingerin në Komunikatën e Shangait, në të cilën, të dy partnerët, si Kina e Mao Ce Dunit, ashtu edhe Shtetet e Bashkuara të Niksonit, kanë deklaruar se qenkan kundër hegjemonizmit! Gjithashtu na del se edhe Japonia, «Perandoria e lindjes së diellit», nuk na qenka hegjemoniste!**

Pra, mund të konkludojmë pa hezitim dhe pa u gabuar, se, meqë ky traktat kaq shumë i dëshiruar nga Kina imperialiste u arrit, kjo do të thotë që u poqën situatat për një gjë të tillë, domethënë se «dielli amerikan» i çau «retë» që ekzistonin mbi oqeanin Paqësor dhe i lëshoi «rrezet» e tij mbi Kinën, se për sa i përket Japonisë, «rrezet» e Shteteve të Bashkuara të Amerikës ka kohë që janë lëshuar mbi të.

**Kur Shtetet e Bashkuara të Amerikës e panë se arritën në qëllimin e dëshiruar prej tyre, se Kina u largua përgjithmonë nga rruga e socializmit dhe e komunizmit dhe pranoi miqësinë me imperializmin amerikan dhe me imperialistët e tjerë, atëherë Uashingtoni dha sinjalin: hapi dritën jeshile dhe kështu u nënshkrua ky traktat.** Nënshkrimi i këtij traktati është kundërshtuar më parë nga Japonia pikërisht për arsye të klauzolës ku bëhej fjalë «kundër hegjemonizmit», sepse Japonia nuk donte ta zemëronte Bashkimin Sovjetik, fqinjin e saj shumë të rrezikshëm. Por tani, siç duket, interesat e Kinës, të Japonisë edhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës e duan një unitet të tillë, një lidhje të ngushtë në ideologji e në politikë, në tregti dhe në fushën ushtarake dhe aktualisht nuk kanë frikë nga kërcënimet e Moskës. Moska ka shumë kohë që e kundërshton nënshkrimin e Traktatit kino-japonez të paqes dhe të miqësisë me një klauzolë të tillë dhe i ka bërë presione Japonisë duke i thënë se nënshkrimi i këtij traktati do të shkaktojë vështirësi të mëdha dhe ngatërresa në marrëdhëniet sovjeto-japoneze dhe, natyrisht, Moska do ta konsiderojë këtë si një

hap armiqësor. Mirëpo u kapërcye mbi këto shantazhe dhe kërcënime të Moskës. **Kjo do të thotë se Kina, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Japonia, të lidhura me njëra-tjetrën, po formojnë një bllok të fortë dhe kundërshtojnë çdo rindarje të botës, që nuk u intereson.**

Siç e kam theksuar në shkrimet e mia, Kina këtë politikë e shpalli me kohë, qëkurse u deklarua kundër Bashkimit Sovjetik, pra që në kohën e Stalinit, bile edhe më parë. Afrimin dhe lidhjen me Shtetet e Bashkuara të Amerikës Kina e kishte në shpirt e në zemër, por Mao Ce Duni dhe klika e tij i zhvilluan ato gradualisht, për të mos u demaskuar përnjëherë në sy të botës. Që kur Mao Ce Duni me teorinë e «tri botëve» deklaroi se Kina bënte pjesë në të ashtuquajturën botë e tretë, u duk qartë se ai predikonte aleancën në mes Shteteve të Bashkuara të Amerikës, «botës së dytë» (siç i quan ajo shtetet e tjera imperialiste — Japoninë, Gjermaninë Federale, Francën, Anglinë, Australinë etj.) dhe «botës së tretë». Pra, kjo aleancë nuk mbeti vetëm një mendim ideologjik reaksionar i Mao Ce Dunit dhe i pasardhësit të tij, por u konkretizua.

Me Japoninë u nënshkrua traktati i paqes. Me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, kuptohet, do të vendosen marrëdhënie diplomatike, të cilat, edhe në qoftë se nuk janë vendosur zyrtarisht, ekzistojnë në mënyra të tjera, të cilat bëjnë që marrëdhëniet në mes Kinës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës të zhvillohen dita-ditës në një platformë të gjerë.

Po kështu Kina është hapur në të gjitha shtetet kapitaliste të botës, veçanërisht në Evropë. Ajo është lidhur me Gjermaninë Perëndimore, me Francën, me Anglinë, tash edhe me Italinë e me të gjitha ato shtete si Irani e të tjera, nga të cilat mund të nxjerrë fitime për t'u bërë superfuqi. Këtu është qëllimi taktik i Kinës.

**Për sa i përket idesë mbi «botën e tretë», kjo nuk**

është gjë tjetër veçse ideja e vjetër e imperializmit, të cilën Kina e bëri të sajën. Imperializmi gjithnjë ka synuar që vendet e tjera të vogla, që i kishte emërtuar «de tiers monde», t'i përdorte për t'i shfrytëzuar më mirë e për t'i mbajtur nën influencën e vet dhe, sa të ishte e mundur, të pengonte socialimperializmin sovjetik të fuste hundët në kolonitë e reja të sunduara nga imperializmi amerikan, francez, anglez etj. Pra, synimi ishte që të mos lejonte Bashkimin Sovjetik të krijonte në këto vende të «botës së tretë» tregje dhe zona të veta të influencës.

Kështu pra, traktati kino-japonez e vuri në rrugë këtë klauzolë të madhe të politikës reaksionare kapitaliste skllavëruese të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të Kinës. Japonia dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë interesa të mëdhenj, që ta kenë Kinën me vete, ta forcojnë deri në atë shkallë që u intereson dhe, kur kontradiktat në mes Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Sovjetik të thellohen, ta përdorin Kinën si një barrierë kundër Bashkimit Sovjetik në një luftë të tretë botërore. Përveç kësaj, Kina dhe Japonia, si dy shtete aziatike në unitet ideologjik e politik, si dy shtete agresore që janë, kanë synime të mëdha mbi Siberinë, mbi Mongolinë, bile edhe më tej, në thellësitë e perandorisë revizioniste sovjetike.

Rivendikimet territoriale i ka parashtruar me kohë Mao Ce Duni, por duke i krahasuar me këto të sotmet, ato të asaj kohe janë minimale. Dy shtetet imperialiste, Kina dhe Japonia, kanë interes të madh të hedhin në dorë pasuritë e Siberisë dhe, sigurisht, do të gjejnë shumë arsye gjoja politike, ose «do të vërtetojnë» se perandoria e carëve kishte zaptuar toka ku jetonin popuj, në dejet e të cilëve rridhte gjaku i racës së verdhë. Natyrisht, tërë kjo është një ideologji raciste imperialiste.

Përveç të tjerave, Kina shumë e prapambetur sheh te Japonia edhe një rrezik për veten e saj, por, në të

njëjtën kohë, edhe një mike të ngushtë, që mund ta ndihmojë dhe do ta ndihmojë që të bëhet një vend i zhvilluar ekonomik. Japonia ka nevojë për një shtrirje të tregtisë dhe të industrisë së saj në kontinentin aziatik. Ajo ka bërë luftë të armatosur për ta zaptuar këtë kontinent, tash bën një luftë jo të armatosur, por një luftë politike dhe me teknologji.

Kina, si me thënë, ka qenë xheloze për zhvillimin e madh industrial të Japonisë, për organizimin e forcës ushtarake tokësore, detare e ajrore të saj. Japonia përparoi kaq shumë në këtë drejtim, sa që në Luftën e Dytë Botërore nuk desh t'ia dinte më për Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe mudi të zaptonte një pjesë të madhe të Kinës, të Azisë Juglindore dhe të ishujve të oqeanit Paqësor. Kina e Mao Ce Dunit, pas 1949-s, shikonte me admirim e me zili sukseset e mëdha të Japonisë në mjaft fusha, veçanërisht në fushën e shkencës, të teknikës moderne, megjithëse nuk mund të mos vinte re njëkohësisht edhe mizerjen e punëtorisë dhe të fshatarësisë japoneze. Udhëheqësit kinezë studionin me xhelozë se si arriti një shtet me një popull të po asaj race dhe jo më të zgjuar nga populli kinez, të krijonte një forcë të tillë dominuese dhe ekspansioniste në botë. Dhe iu duk se e gjetën edhe ata «çelësin» e këtij sekreti. Kështu Mao Ce Duni, Çu En Lai dhe gjithë klikat rreth tyre arritën në konkluzionin se, që të bëhej Kina një fuqi e madhe, duheshin braktisur, sikurse u braktisën që në fillim, marksizëm-leninizmi e socializmi dhe duhej ndjekur rruga e kapitalizmit.

Mao Ce Duni dhe shokët e tij e panë se, me gjithë shkatërrimet e mëdha që pësoi Japonia në Luftën e Dytë Botërore, me gjithë rrënimet, me gjithë dëmet kolosale të shkaktuara nga shpërthimi i bombës atomike në Hiroshima dhe në Nagasaki, ku u vranë 100 000 veta, pra, megjithëse Japonia doli e rraskapitur nga kjo luftë, bren-

da një kohe shumë të shkurtër ajo u ringjall, u bë një fuqi e madhe në botë, një fuqi e madhe ekonomike dhe, nën dorë e jo në bazë të traktateve, rriti e forcoi potencialin e saj ushtarak në të gjitha drejtimet. Ka mundësi që edhe Japonia ta ketë bombën atomike, por edhe në qoftë se nuk e ka, në kushtet aktuale të favorshme që krijohen nga marrëdhëniet në mes këtyre tri shteteve imperialiste, që duan të dominojnë botën dhe t'i ngushtojnë rrethin socialimperializmit sovjetik, s'është çudi që një ditë Japonia të deklarojë botërisht se edhe ajo e ka bombën atomike.

Mao Ce Duni, që ka qenë një antisovjetik, e dinte se pikëpamjet japoneze ishin thellësisht antiruse e aq më tepër antisovjetike. Japonia e Hirohitos dhe e samurajve nuk mund t'ua faltë Leninit dhe Stalinit meritën për triumfin e sistemit socialist në një të gjashtën e botës. Ishte ky sistem socialist ai që ia theu oreksin Japonisë, duke ia zënë në grykë synimet ekspansioniste mbi Siberinë dhe mbi Mongolinë, ishte ky sistem që i tregoi vendin asaj në Luftën e Dytë Botërore.

**Pra Mao Ce Duni e dinte se tek udhëheqësit japonezë ai kishte partnerë të denjë në pikëpamjet e tij shoviniste e raciste të shtetit të madh të ngjyrës së verdhë, të dominimit botëror, dhe, mund të themi se, me traktatin e paqes që u nënshkrua para dy ditëve në Pekin, udhëheqja kineze ia arriti këtij qëllimi.** Kjo arritje u siguron Kinës, Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Japonisë mundësitë ekspansioniste për dominimin e Pacifikut, të Australisë e të një pjese të madhe të Azisë. Kjo marrëveshje ushtron një kërcënim të madh mbi Bashkimin Sovjetik revizionist, u bën një presion të madh Indisë dhe më tej Pakistanit, Afganistanit, Iranit, Emirateve të Gjirit Persik dhe bëhet një kërcënim imediat edhe për Vietnamin e për Laosin. Që tash po duken synimet e një dominimi kinez mbi Vietnamin. Kina kërkon të likuidojë

pavarësinë dhe sovranitetin e Vietnamit dhe e ka filluar aktivitetin në këtë drejtim me incidente, bile me incidente kufitare të përgjakshme, me pretekstin për gjoja mbrojtjen e pakicave kombëtare kineze që jetojnë në Vietnam. Kina nxit Kamboxhian kundër Vietnamit dhe do të shohim se ku do të dalë një politikë e tillë, me siguri ose në nënshtrimin e Vietnamit e të Laosit ndaj influencës kineze, ose në një luftë vietnamezo-kineze.

Kurse për sa i përket Indisë, Kina tok me Shtetet e Bashkuara të Amerikës do të bëjnë çmos që qeveria e Desait ose një qeveri tjetër që mund të vijë në fuqi, të bëhet krejt proamerikane, të normalizohen marrëdhëniet e Indisë me Pakistanin dhe të bëhen përpjekje që edhe në Afganistan të krijohet një situatë e disfavorshme për Bashkimin Sovjetik.

Për sa i përket shahut të Iranit, ky është i lidhur ngushtë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Rreziku për këtë potentat mesjetar dhe barbar është Bashkimi Sovjetik, kështu që ai është armatosur dhe po armatohet vazhdimisht nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Hua Kuo Feni, pas turneut të tij në Evropë, do të shkojë të vizitojë mikun e tij, shahun e Iranit dhe princeshat që kanë vizituar shumë herë Mao Ce Dunin.

Këtë politikë antimarksiste të Mao Ce Dunit, të Çu En Lait dhe të shokëve të tyre Partia jonë e parashikoi prej kohësh, pavarësisht se faktet në duart tona nuk kanë qenë të mjaftueshme për të ardhur në një konkluzion të drejtë. Por ishte mendimi shkencor marksist-leninist ai që na i bëri neve të qarta pikëpamjet ideologjike të kësaj klike që kishte ardhur në Kinë dhe, me aq informata sa kishim, mundëm të arrinim në konkluzione të pagabueshme. Kurse bota kapitalisto-imperialiste dhe revizionistët sovjetikë, për sa i përket Kinës, dispononin materiale të shumta, dokumente zyrtare, dokumente gjysmë-zyrtare, ata kishin ekipe të mëdha spiunësh dhe agjentësh

që qëmtonin edhe thënien më të vogël, edhe shkrimin më të humbur të Kinës dhe kësisoj ndërtonin rrjedhën e politikës reaksionare të tyre e të Mao Ce Dunit. Tash që ky u demaskua (dhe për këtë ka një meritë të madhe Partia jonë), shohim të botohen një numër i madh librash dhe dokumentesh zyrtare, të cilat vërtetojnë pikëpamjet e drejta që i ka formuluar me aq kujdes dhe me aq bindje Partia jonë për politikën dhe ideologjinë e Partisë Komuniste të Kinës dhe të qeverisë kineze. Partia jonë e demaskoi këtë politikë dhe këtë ideologji pa marrë parasysh sakrificat. Qëllimi ynë ka qenë kurdoherë mbrojtja e socializmit, e revolucionit, mbrojtja e pastërtisë së marksizëm-leninizmit.

Sikurse revizionizmi sovjetik dhe gjithë revizionizmi modern, edhe revizionizmi kinez kishte arritur ta ruante maskën marksiste-leniniste nën një demagogji të kualifikuar, si me thënë, të mbuluar me një prestigj të pompuar për Mao Ce Dunin dhe për idetë e tij, të cilat i reklamnin me bujë të madhe sikur ishin «marksizëm-leninizmi i botës së sotme». Marksizëm-leninizmi i vërtetë për ta ishte ideologji e një epoke të perënduar, e një epoke e cila, sipas tyre, tashmë kishte dështuar, prandaj bota u dashkej udhëhequr drejt socializmit nga një ideologji e re, që ishte maocedunideja. Me fjalë të tjera në Kinë duhej likuiduar çdo orvatje për ndërtimin e socializmit, duhej luftuar revolucioni dhe duhej krijuar një *modus vivendi* i ri kapitalisto-revizionist, një shoqëri, siç e kam quajtur në shkrimet e mia, hibride, ku proletariati, fshatarësia, gjithë të shtypurit, të rronin në harmoni me shtypësit e gjakpirësit e tyre. Kjo ishte ideologjia e re, maocedunideja, që kinezët kërkonin ta mbulonin me marksizëm-leninizmin. Por Partia e Punës e Shqipërisë ua çori maskën.

Pra, qëllimet e Kinës janë të qarta: ajo ecën drejt asaj rruge nëpër të cilën mendon se do të bëhet një fuqi

e madhe imperialiste duke e ndarë botën me imperializmin amerikan dhe me Japoninë, duke u lënë një pjesë të vogël vendeve të «botës së dytë» dhe duke shfrytëzuar vendet e ashtuquajtura të botës së tretë. Këto hesape ka bërë dhe po bën Kina, këto mendon të realizojë ajo me politikën aktuale që ndjek grupi i Hua Kuo Fenit dhe i Ten Hsiao Pinit. Natyrisht, kjo politikë do të sjellë rreziqe të mëdha për botën.

Partia jonë do t'i demaskojë pa mëshirë imperializmin amerikan, socialimperializmin sovjetik dhe imperializmin kinez. Të tre këta imperializma, duke u bashkuar me ta edhe imperializmi japonez e tërë reaksioni botëror, do t'i thellojnë kontradiktat në mes tyre, në mes shteteve më të dobëta dhe imperialistëve, do t'i shtojnë kontradiktat në mes popujve dhe qeverive të tyre reaksionare dhe do të arrihet në atë që dëshiron Kina, në një luftë të madhe botërore. Ajo dëshiron që lufta të zhvillohet në Evropë, por kjo luftë e madhe botërore ka më shumë mundësi të zhvillohet në Azi në mes kino-japonezëve nga njëra anë dhe sovjetikëve nga ana tjetër, për arsye se sytë e Kinës janë ngulur në Siberi, në Mongoli dhe në republikat e tjera lindore të Bashkimit Sovjetik.

Imperialistët e kanë luftën në gjak. Me politikën agresive që po ndjekin ata, lufta grabitqare imperialiste po bëhet gjithnjë e më kërcënuese; në mos sot, pas dhjetë a pesëmbëdhjetë vjetëve ose edhe më parë, ajo mund të shpërthejë. Kontradiktat e mëdha në mes imperialistëve, shtypja e popujve, krijimi i zonave të influencës, regjimet kapitaliste reaksionare, të gjitha këto i shtypjnë imperialistët t'i shpallin luftërat botërore. Stoqet e bombave atomike janë shtuar e, megjithëse ato përbëjnë një kërcënim për të gjitha vendet kapitaliste të botës ndërluftuese, kërcënojnë në të njëjtën kohë edhe popujt e tjerë, sepse lufta që mund të shpërthejë, do të jetë e përgjithshme. Imperialistët përgatiten për luftë. Një krim i madh

po përgatitet kundër njerëzimit dhe popujt e shohin një gjë të tillë, por nuk luftohet kudo në mënyrë të koordinuar që të shkatërrohen këto plane të imperialistëve. Shkatërrimi i planeve të imperialistëve për luftë botërore bëhet vetëm nëpërmjet bashkimit të proletariatit e të popujve, nëpërmjet kryerjes së revolucionit brenda vendeve të ndryshme kundër klikave reaksionare të shitura tek imperialistë të ndryshëm dhe kundër imperialistëve që sundojnë në vende të ndryshme me kapitalet e tyre, me forcat e armatosura, me baza ushtarake dhe me një mijë e një fije të ndërlikuara.

**Partia jonë e Punës, e vogël, por në unitet me partitë e vërteta marksiste-leniniste, me gjithë marksistë-leninistët, me proletariatin e popujt e shtypur në botë dhe me gjithë njerëzit përparimtarë po e ngre zërin me forcë kundër imperializmit, socialimperializmit, revizionizmit kinez e kapitalizmit botëror.** Por duhet bërë kohezioni i forcave përparimtare. Revolucioni duhet të ngjitet, përpjekjet dhe sakrificat duhet të jenë të mëdha për t'i prishur planet e imperializmit dhe të reaksionit se, po nuk u prishën ato, atëherë gjaku i popujve do të derdhet si lumë për fitoren e një grushti kapitalistësh dhe intrigantësh, kriminelë të popujve.

**Kina pseudosocialiste predikon luftën imperialiste. Udhëheqësit kinezë janë kriminelë, sepse jo vetëm predikojnë luftën, por edhe e përgatitin dhe e nxitin luftën e tretë botërore.** Ata predikojnë që kjo luftë botërore të zhvillohet në mes Bashkimit Sovjetik dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Aktualisht këto janë dy superfuqi të armatosura deri në dhëmbë, me regjime reaksionare shtypëse, regjime kolonizatorësh dhe të etura për hegjemoni. Por Kina, që e predikon këtë luftë, predikon edhe aleancën me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me kapitalin botëror dhe me të ashtuquajturën botë e tretë. Shtetet e vogla kapitaliste të botës, sipas udhëheqësve

kinezë, duhet të bashkohen në një front të përbashkët për t'i deklaruar luftë Bashkimit Sovjetik, pra, për ta hedhur botën në një kasaphanë të tretë botërore. Një gjë të tillë revizionistët kinezë nuk e fshehin, por e thonë haptazi dhe pikërisht për këtë arsye, pikërisht se janë luftënxitës, ata janë kriminelë përpara syve të njerëzimit. Është e domosdoshme që kundër tyre të drejtohet një luftë e ashpër, sepse në politikën e përgatitjes dhe të predikimit të luftës së tretë botërore ata fshihen nën maskën e marksistë-leninistëve, kur s'kanë asnjë lidhje me marksizëm-leninizmin. Ata janë kapitalistë nga më të ndyrët. Por llogaritë ekspansioniste të kinezëve janë të gabuara, sepse, në rast të një lufte botërore, të shpërthyer në mes Bashkimit Sovjetik dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Kina nuk do të mbetet jashtë, siç shpreson ajo, që t'ia nxjerrin gështenjat nga zjarri aleatët e përhershëm, por të deklaruar botërisht tani, që janë imperializmi amerikan dhe ai japonez. Jo, për mendimin tim, në qoftë se do të shpërthejë lufta imperialiste grabitqare, ka 95 për qind mundësi që kjo të shpërthejë në mes Bashkimit Sovjetik dhe Kinës. Aktualisht Kina me Japoninë, në bazë të traktatit që nënshkruan më 12 gusht, janë bërë një barrikadë, një pararojë e imperializmit amerikan kundër Bashkimit Sovjetik revizionist.

Pra, shtetet në fjalë: Bashkimi Sovjetik, Kina dhe Japonia, janë konkurrencte imperialiste për dominim, veçanërisht në Azi. Prandaj ose Bashkimi Sovjetik nuk do ta lërë Kinën të forcohet, siç synon me planet e saj (dhe do të shohim çfarë masash do të marrin sovjetikët në këtë drejtim), ose, me kalimin e kohës, Kina do të forcohet, Japonia do të forcohet akoma më shumë se ç'është forcuar dhe, të dyja bashkë, do të bëhen rrezik për imperializmin sovjetik.

Imperializmi sovjetik aktualisht nuk ka interes të

sulmojë Evropën, siç pretendon Kina, sepse një gjë e tillë nuk do t'i sjellë ndonjë fitore. Ai siguron fitore duke sulmuar hallkën e dobët në skakierën ndërkombëtare dhe kjo hallkë e dobët është Kina, janë edhe të gjitha vendet e tjera të vogla, veçanërisht të Azisë, pa thënë për vendet e Afrikës që janë shumë të dobëta, por shumë të pasura. Në rast se Bashkimi Sovjetik kërkon që të hapet gjerësisht në Afrikë dhe të cenojë interesat e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, atëherë lufta mund të shpërthejë edhe në Evropë, duke marrë shkas Afrikën. Veçse duhet pasur parasysh se Shtetet e Bashkuara të Amerikës kurdoherë kanë nxitur të tjerët të luftojnë për to, kurse në mbremje shpejtojnë të vënë dorën e tyre në anën e fituesve për të korrur vetë fitoren e plotë. Prandaj ata e mbështetin Kinën dhe do të vazhdojnë ta mbështetin edhe atë, edhe Japoninë, duke u përpjekur njëkohësisht që kontradiktat në mes këtyre dy partnerëve të rinj të tyre të ekzistojnë, sepse, në rast të kundërt, ka mundësi që kjo forcë e madhe aziatike (Kina e Japonia) të bëhet po ashtu një rrezik dominacioni në oqeanin Paqësor dhe kërcënues për imperializmin amerikan në botë. Imperializmi amerikan, si një fuqi e madhe imperialiste, forcën e tij nuk e ka vetëm në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ai e ka braktisur doktrinën «Monro» dhe është përhapur në të gjitha vendet e botës, ku ka shtrirë kthetrat e tij, ku ka bazat e tij ushtarake, njerëzit e vet në fuqi, prandaj edhe quhet një perandori e fuqishme botërore.

Si mund të shpëtojë njerëzimi nga një katastrofë e madhe botërore? Vetëm me revolucion, i cili, natyrisht, duhet të përgatitet. Revolucioni duhet të përgatitet veçanërisht në Bashkimin Sovjetik dhe në Kinë, pa neglizhuar ngritjen e popujve në vendet e tjera të botës. Kjo është dëshira dhe aspirata e komunistëve, e revolucionarëve në të gjithë botën. Por shpresat nuk janë aq të më-

dha sa janë dëshirat. Aktualisht në Bashkimin Sovjetik është vendosur një diktaturë e egër e kapitalit dhe si zor që atje të pëlçasë relativisht shpejt një revolucion i dytë bolshevik, një revolucion i dytë i madh si ai i Tetorit. Bashkimit Sovjetik të sotëm i mbetet vetëm një rrugë — rruga e luftës grabitqare. Udhëheqja aktuale tradhtarë, antimarksiste, imperialiste e Bashkimit Sovjetik ecën drejt kësaj rruge. Që të pëlçasë revolucioni duhet të përmbysset tërë situata në Bashkimin Sovjetik, të përmbysset pushteti i revizionizmit modern, i socialimperializmit dhe të vendoset diktatura e proletariatit me një parti të re me të vërtetë marksiste-leniniste, që të zbatojë si duhet doktrinën e madhe shkencore, marksizëm-leninizmin. Kjo është rruga ku duhet të ecë Bashkimi Sovjetik dhe kjo rrugë e dytë do të jetë shpëtimtare për njerëzimin, se atëherë Bashkimi Sovjetik do të bëhet siç ka qenë në kohën e Leninit dhe të Stalinit. Në qoftë se realizohet një gjë e tillë, një dëshirë e tillë jona, Bashkimi Sovjetik do të bëhet një mbështetje e fuqishme e revolucionit botëror, por, natyrisht, kjo aktualisht është një dëshirë me një pikëpyetje të madhe, jo se marksistë-leninistët humbasin çdo shpresë të proletariati i Bashkimit Sovjetik, por sepse vetëm një gjakderdhje e madhe mund ta përmbysë këtë situatë të tmerrshme që është vendosur në Bashkimin Sovjetik.

Edhe për Kinën rruga tjetër është që regjimi aktual kapitalist, revizionist, imperialist, fashist kinez të rrëzohet dhe të shkatërrohet tok me ideologjinë e Mao Ce Dunit dhe Partia Komuniste e Kinës të rindërtohet nga fillimi mbi bazat e marksizëm-leninizmit. Kinës i duhet të dalë nga situata kaotike ku është zhytur prej kaq dekadash, të shkëputë lidhjet që po ndërton me imperializmin amerikan e me imperializmin botëror dhe të ecë në rrugën e socializmit shkencor. Vetëm kjo rrugë është ajo që

eviton për një kohë më të gjatë luftën imperialiste grabitqare. Vetëm kjo rrugë, qoftë për Kinën, qoftë për Bashkimin Sovjetik, shpejton revolucionin socialist dhe i jep grushtin vendimtar të vdekjes kapitalizmit botëror. Por ashtu si po ecin punët në këto dy vende, në Bashkimin Sovjetik dhe në Kinë, shpresat tona, të marksistë-leninistëve dhe të popujve revolucionarë, janë të largëta.

Kapitalizmi dhe imperializmi janë në kalbëzim, popujt vuajnë në mjerim, në uri, në papunësi, polarizohen pasuria dhe varfëria dhe kjo kontradiktë në mes dy botëve, botës kapitaliste dhe botës socialiste, ashpërsohet. Pakënaqësia e madhe botërore kundër kapitalizmit, imperializmit dhe revizionizmit po ngrihet dhe nga sasi do të kthehet në cilësi. Por kjo cilësi do të arrihet me përpjekje, me luftëra, me gjakderdhje, sepse imperialistët dhe revizionistët me doktrinat e tyre nuk e lënë aq lehtë pushtetin kapitalist që kanë krijuar. Avantazhet që u jep ky pushtet dhe, për ta mbrojtur këtë, ata kanë krijuar forca të mëdha ushtarake represive. Në këtë drejtim popujt, proletariati, me marksistë-leninistët në krye, duhet të sabotojnë përgatitjet ushtarake në çdo vend imperialist e revizionist, të sabotojnë përgatitjen dhe stërvitjen e ushtrisë, të përpiqen ta ngrenë ushtarin në një platformë të tillë politike që ai të kuptojë se është bërë vegël e një grushti imperialistësh dhe kapitalistësh, pse tash djemtë e popullit, ushtarë të kapitalizmit, mbrojnë një kauzë jo të vetën, por një kauzë të armiqve të tyre.

Nga ana tjetër duhet që në gjirin e klasës punëtore, dhe veçanërisht atje ku fabrikohen armët vdekjeprurëse të fuqive të mëdha imperialiste, të punohet që të bëhet e ndërjegjeshme klasa punëtore për ta sabotuar me të gjitha forcat, me gjithë zotësinë dhe mjeshtërinë e saj, prodhimin e këtyre armëve. Masat e gjera të popullit duhet të ngrihen në revolta, në demonstrata dhe ta mbësh-

tetin luftën e përgjithshme revolucionare në gjirin e ushtrive borgjezo-kapitaliste, në gjirin e proletariatit që prodhon dhe vuan për bukë dhe që kapitalistët e detyrojnë të përgatitë armë për të vrrarë vëllezërit e tij të vendeve të ndryshme e për t'u bërë vetë mish për top për manjatët dhe për trustet e kapitalizmit botëror.

**POGRADEC, E MARTE**

**15 GUSHT 1978**

## **DALIN NË DRITË DOKUMENTE TË FSHEHTA**

Aktualisht kanë dalë dokumente të rëndësishme që vërtetojnë se Mao Ce Duni dhe Çu En Lai kanë qenë me kohë ashtu siç janë paraqitur në Ditarin Politik për Çështje Ndërkombëtare.

Le të shohim ç'thotë një nga këto dokumente që u publikua pardje në mbrëmje, më 13 gusht.

Agjencia angleze e lajmeve Rojter njofton nga Uashingtoni se Çu En Lai qenka përpjekur në mënyrë të fshehtë për të kërkuar ndihmë ekonomike nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës përpara se komunistët në Kinë të merrnin plotësisht fuqinë në dorë në vitin 1949. Kjo, thotë Rojteri, u bë e qartë dje, kur Shtetet e Bashkuara botuan disa nga dokumentet më delikate lidhur me marrjen e pushtetit nga komunistët në Kinë.

Në Ditar unë kam shkruar se, në kohën e Luftës së Dytë Botërore, në Uashington ekzistonin dy lobi për Kinën: lobi i Mao Ce Dunit dhe lobi i Çan Kai Shisë. Natyrisht, në Shtëpinë e Bardhë fitoi lobi i Çan Kai Shisë, por në Senatin Amerikan kishte njerëz, sikurse ishin përfaqësuesit ushtarakë amerikanë në Kinë pranë Çan Kai Shisë, si Marshalli dhe Vandemejery, që u thoshin krerëve të Uashingtonit se duhej ndihmuar Kina, se nuk duhej lënë ajo të binte në duart e Stalinit. Të njëjtat gjëra thoshin, natyrisht, edhe Ana Luiza Strong, Edgar Snou

e shumë agjentë të tjerë, të cilët vinin rrotull në shtabin e Mao Ce Dunit.

Ne, nga ato që kemi lexuar e konstatuar vetë, kishim arritur në disa konkluzione për udhëheqjen kineze, por ato që kishim lexuar ishin shumë të pakta. Më vonë, kur e pamë se vija e Partisë Komuniste të Kinës nuk ishte një vijë marksiste-leniniste, dolëm në konkluzione të plota, ndonëse përsëri pa pasur në dorë dokumente të mjaftueshme. Tani ky dokument i vërteton plotësisht konkluzionet tona të drejta që kishim nxjerrë qysh atëherë.

**Le të vazhdojmë përsëri me këtë dokument: Rojteri thotë se botimi i këtyre dokumenteve ishte ndaluar për disa vjet nga përkrahësit amerikanë të administratës nacionale të Çan Kai Shisë, të cilën dokumentet e përshkruajnë si një administratë të korruptuar dhe të paaftë.**

Një zyrtar i sektorit të historisë në Departamentin e Shtetit u tha gazetarëve: «Në vitin 1972, kur presidenti Nikson hapi rrugën e marrëdhënieve kino-amerikane me turneun që bëri në Kinë, u mendua që dokumentet nuk duhej të botoheshin për sa kohë që jetonte Çu En Lai».

Pra, ato që kemi thënë ne për Mao Ce Dunin dhe për udhëheqjen kineze në letrën që u dërguam atyre për vajtjen e Niksonit në Kinë, për tratativat e kinezëve me amerikanët dhe për marrëdhëniet e përbashkëta që po vendosnin, tash vërtetohen plotësisht. Këto tratativa ekzistonin qysh më përpara, bile me dokumente, por mbaheshin e do të mbaheshin të fshehta për sa kohë që do të rronte Çu En Lai.

**Dokumentet «Marrëdhëniet e jashtme të Shteteve të Bashkuara më 1949 — Vëllimi i 8-të, Kina», përfshijnë një raport të konsullit të përgjithshëm të Shteteve të Bashkuara të Amerikës Edmund Killab në Pekin mbi qëndrimin e Çusë për ndihmë. Sipas këtij dokumenti, Killabi bën të ditur se më 1 qershor 1949 Çu En Lai i dërgoi atij një mesazh me anë të një ndërmjetësi të besuar, ga-**

**zetarit australian Mikael Keon.** Në mesazh thuhej se komunistët (të cilët zyrtarisht erdhën në fuqi nga fundi i atij viti), ishin përfundimisht të ndarë në dy krahë: në radikalë dhe në liberalë. Duke folur në emër të liberalëve (dhe kështu e kemi cilësuar edhe ne) Çuja ishte për t'iu drejtuar Shteteve të Bashkuara të Amerikës për ndihmë ekonomike, meqenëse dëmet e luftës të Bashkimit Sovjetik tregonin se ai nuk mund t'u jepte ndihmë.

**Dokumenti vazhdon:** «Çuja nuk mori asnjëherë një përgjigje zyrtare për mesazhin e tij, megjithëse me miratimin e presidentit Truman, u hartua një përgjigje e tillë ku thuhej se Shtetet e Bashkuara të Amerikës dëshironin marrëdhënie të mira, por Kina duhet t'i lidhë fjalët me vepra». Me fjalë të tjera, duhej që Kina të braktiste rrugën e komunizmit dhe të ndërtimit të socializmit, domethënë të shkëputej që në atë kohë nga Bashkimi Sovjetik. **Këtë gjë Kina e bëri më vonë.**

Vazhdojmë: Kllabi citon mesazhin e Çusë që shkruante se «radikalët kinezë kërkonin një aleancë me Bashkimin Sovjetik të njëlojtë me atë që ekzistonte midis Shteteve të Bashkuara dhe Britanisë, ndërsa liberalët e konsideronin politikën internacionaliste sovjetike si «të çmendur»». Tekstualisht kështu është shkruar.

«Çuja, — vazhdon dokumenti, — e ndien se Bashkimi Sovjetik po rrezikon një luftë, të cilën nuk është i aftë ta kryejë me sukses dhe se marrëdhëniet e mira të punës midis Kinës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës do të kenë një efekt të caktuar zbutës në qëndrimin e partisë ndaj vendeve perëndimore...».

Të gjitha këto që shkruhen në këtë dokument gjatë gjithë periudhës që kemi analizuar, i shohim të thuhën dhe të realizohen nga udhëheqja kineze.

**Dokumenti vazhdon:** «Çuja mendon se Shtetet e Bashkuara të Amerikës duhet ta ndihmojnë Kinën, sepse:

1) Kina nuk është akoma komuniste dhe, në qoftë

se politika e kryetarit të partisë, Mao Ce Dunit, zbatohet drejt, atëherë komunizmi në Kinë mund të mos realizohet për një kohë të gjatë.

2) Kina demokratike do të shërbejë në sferën ndërkombëtare si ndërmjetëse midis fuqive perëndimore dhe Bashkimit Sovjetik.

3) Kina, në kaos, nën çdo regjim qoftë, do të përbëjë një kërcënim për paqen në Azi dhe në botë».

Më poshtë Kllabi thotë se në mesazhin e Çusë theksohej se «ai, (Çuja) si zëdhënës i krahut liberal, kur të vijë koha që komunistët të marrin pjesë në çështjet ndërkombëtare, bashkë me grupin e tij do të punojë në parti për një zgjidhje të arsyeshme për qorrsokakun midis Bashkimit Sovjetik dhe Perëndimit dhe do të bëjë ç'të jetë e mundur për ta detyruar Bashkimin Sovjetik të heqë dorë nga politika e tij që të çon drejt luftës». Domethënë Çuja më 1949 u premtonte Shteteve të Bashkuara të Amerikës se do të bëjë çmos që regjimi socialist dhe diktatura e proletariatit në Bashkimin Sovjetik të degjenerojnë e të zhduken dhe kështu ai të mos bëhet më «një rrezik lufte», me fjalë të tjera, të mos bëhet një udhëheqës i revolucionit botëror.

Kaq thotë dokumenti, për ato që Çu En Lai i ka transmetuar Uashingtonit në mesazhin e tij sekret.

**Dokumentet, thotë Rojteri, bënin të ditur se shenja të njëjta, megjithëse jo me kaq hollësi, iu dërguan në atë periudhë Shteteve të Bashkuara të Amerikës nga Huan Huaja, drejtor i punëve të jashtme i komisionit të kontrollit ushtarak komunist kinez në Nankin, dhe nga Ho Su Juan, ish-kryetari i Bashkisë në Pekin. Huan Huaja (tani ministër i Jashtëm i Kinës) ishte ndërlidhësi kryesor midis komunistëve kinezë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, pavarësisht nga refuzimi amerikan për të njohur regjimin komunist, derisa personeli amerikan u largua nga Kina nga fundi i atij viti.**

Dokumenti më poshtë vazhdon: «Çuja nuk e mori asnjëherë projektpërgjigjen për mesazhin e tij, sepse Departamenti i Shtetit nguli këmbë që të përdoret një ndër-mjetës tjetër, si për ta mbajtur sekret përgjigjen, ashtu dhe për t'u siguruar se shkëmbimi po bëhej me të vërtetë me Çu En Lain. Por Çuja, atëherë anëtar i Komitetit Qendror, refuzoi nëpërmjet ndërmjetësve të pranojë përgjigje nga ndonjë kanal tjetër».

Në dokument thuhet se «Projektpërgjigjja përmbante ankesa për zhvillimin e propagandës antiamerikane nga forcat komuniste dhe për trajtimin e ashpër prej tyre të diplomatëve amerikanë, duke përfshirë këtu mbajtjen në arrest për një vit të përfaqësuesit amerikan në Mukden, Huan Huaja, në një nga kontaktet e tij me diplomatët amerikanë, u orvat t'i siguronte Shtetet e Bashkuara të Amerikës se gjithë këto vështirësi do të qartësoheshin në goftë se ato do të njihnin qeverinë komuniste, do të jepnin ndihmë dhe do të vendosnin marrëdhënie tregtare me Kinën. Por tërheqja e misionit amerikan dhe stuhitë politike brenda në vend (sidomos Revolucioni Kulturor) e penguan një gjë të tillë».

Kjo është një pjesë e dokumenteve që jep agjencia Rojter e që bëjnë fjalë për marrëdhëniet në mes Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Kinës që në vitin 1949 (vëllimi i 8-të). Por me siguri ka edhe dokumente të tjera, sepse është e qartë që Mao Ce Duni, Çu En Lai dhe gjithë kaporionët e tjerë që udhëhoqën luftën nacionalçlirimtare në Kinë, nuk ishin marksistë-leninistë, por demokratë borgjezë. Ata shikonin me cmirë dhe me mëri që aleati natyral i tyre, imperializmi amerikan, ndihmonte kundërshtarin e tyre, Çan Kai Shinë. Megjithëkëtë, Mao Ce Duni me shokët e tij, gjatë gjithë kohës së luftës, dhe këto janë fakte, kanë mbajtur lidhje të ngushta dhe i kanë siguruar amerikanët se Kina nuk do të jetë një

vend komunist, por një vend me tipare demokratike si ato të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Nuk është e rastit kur lexon në kujtimet e Niksonit që Mao Ce Duni i flet atij për Shtetet e Bashkuara të Amerikës me aq simpati dhe i thotë se është i kënaqur kur sheh se në vende të ndryshme, si në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në Angli, në Gjermani, vijjnë në pushtet të djathtë. Mao Ce Duni me këto pikëpamje nuk është as demokrat borgjez, por një reaksionar, një nga elementët më të djathtë të reaksionit, që kënaqet e gëzohet kur në krye të një shteti dhe mbi kurriz të popullit vijjnë në fuqi kapitalistët më të tërbuar.

1949. Dokumenti më poshtë vazhdon: «Çuja nuk e mori asnjëherë projektpërgjigjen për mesazhin e tij, sepse Departamenti i Shtetit nguli këmbë që të përdoret një ndër-mjetës tjetër, si për ta mbajtur sekret përgjigjen, ashtu dhe për t'u siguruar se shkëmbimi po bëhej me të vërtetë me Çu En Lain. Por Çuja, atëherë anëtar i Komitetit Qendror, refuzoi nëpërmjet ndërmjetësve të pranojë përgjigje nga ndonjë kanal tjetër».

Në dokument thuhet se «Projektpërgjigjja përmbante ankesa për zhvillimin e propagandës antiamerikane nga forcat komuniste dhe për trajtimin e ashpër prej tyre të diplomatëve amerikanë, duke përfshirë këtu mbajtjen në arrest për një vit të përfaqësuesit amerikan në Mukden, Huan Huaja, në një nga kontaktet e tij me diplomatët amerikanë, u orvat t'i siguronte Shtetet e Bashkuara të Amerikës se gjithë këto vështirësi do të qartësoheshin në goftë se ato do të njihnin qeverinë komuniste, do të jepnin ndihmë dhe do të vendosnin marrëdhënie tregtare me Kinën. Por tërheqja e misionit amerikan dhe stuhitë politike brenda në vend (sidomos Revolucioni Kulturor) e penguan një gjë të tillë».

**QËLLIME DJALLËZORE TË REVIZIONISTËVE KINEZË**

**Disa teza për një artikull të mundshëm kundër politikës  
kineze të Hua Kuo Fenit me rastin e turneut  
të tij në Ballkan**

Këto teza, që po radhis në këtë shkrim, mund të plotësohen më vonë, pasi të kemi dëgjuar dhe lexuar fjalimet e ndryshme që do të mbajë Hua Kuo Feni në Rumani dhe në Jugosllavi, si dhe fjalimet që do të mbajnë Çausheku, Titoja dhe udhëheqësit e tjerë të këtyre dy vendeve. Pra, duke u bazuar në këto fjalime dhe në jehonën e tyre, ne do të nxjerrim disa ide plotësuese për të shkruar një artikull kundër qëllimeve të revizionistëve kinezë.

**Së pari**, unë mendoj që vizitën e Hua Kuo Fenit në këto vende, në kushtet e sotme, kur Kina haptazi flet për një aleancë të saj, të së ashtuquajturës botë e tretë, me imperializmin amerikan dhe me gjithë reaksionin botëror kundër socialimperializmit sovjetik, **duhet ta trajtojmë e ta konsiderojmë si një provokacion**. Vizita e tij është, njëkohësisht, një provokacion, sepse Hua Kuo Feni vjen në Rumani dhe në Jugosllavi pak kohë pasi Kina, në mënyrë brutale, ka prishur marrëdhëniet miqësore me Shqipërinë. Domethënë **Hua Kuo Feni vjen në këto vende për të thelluar përçarjen midis popujve të Ballkanit**.

Në artikull ne duhet të theksojmë se shkëmbimi i

delegacioneve të ndryshme midis vendeve është një praktikë e zakonshme në marrëdhëniet midis tyre dhe për një gjë të tillë nuk kemi asnjë kundërshtim, por ne kundërshtojmë ato qëllime të këqija që përmbajnë këto shkëmbime delegacionesh në dëm të paqes botërore dhe të popujve, që luftojnë e kërkojnë të rrojnë të lirë, independentë dhe sovranë.

Ardhja e Hua Kuo Fenit në Rumani dhe në Jugosllavi nuk ka një karakter të përgjithshëm, nuk bëhet në kuadrin e vizitave zyrtare e «miqësore» dhe në përgjigje të vizitave që u kanë bërë udhëheqësit e këtyre vendeve, por bëhet me qëllime të mbrapshta.

**Së dyti**, Hua Kuo Feni dhe grupi i tij, që udhëheqin aktualisht Kinën, më përpara kanë mbajtur pozita gjoja të theksuara antirevizioniste dhe, veçanërisht, shkrimet e Mao Ce Dunit, të Çu En Lait, të Ten Hsiao Pinit e të tjerëve kanë qenë gjoja të ashpra, denigruese dhe demaskuese për revizionizmin jugosllav, për titizmin dhe Titon personalisht. Aktualisht ne shohim se janë pikërisht udhëheqësit kinezë që po u bëjnë nderime të mëdha rrymës së egër revizioniste titiste dhe atyre që e udhëheqin këtë rrymë. Me fjalë të tjera, **ne tash shohim që një nga qëllimet e udhëheqjes aktuale kineze është të riparojë «gabinet» që janë bërë në të kaluarën nga udhëheqja e PKK kundër kësaj rryme antimarksiste dhe ta quajë këtë rrymë «marksiste-leniniste të vërtetë», ashtu siç vetëquhet dhe udhëheqja e PKK, «marksiste-leniniste e vërtetë», por që në realitet është një udhëheqje revizioniste.**

Kështu që qëllimi i parë dhe kryesor i vajtjes së Hua Kuo Fenit në Jugosllavi është krijimi i një uniteti midis titizmit dhe maocedunizmit, i një uniteti politik-ekonomik midis dy rrymave revizioniste të kapitalizmit botëror, pra, që midis tyre të ekzistojë unitet sidomos për dhënien e ndihmave politike dhe ideologjike Titos dhe titizmit nga ana e kinezëve. Kinezët, gjithashtu, duke

bërë autokritikë për «gabimet» dhe duke përkulur kurri-  
zin përpara jugosllavëve, do t'i japin shtetit jugosllav, ku  
është vendosur vetadministrimi kapitalist, edhe ndihma  
ekonomike.

**Së treti, rëndësi të madhe aktuale për Kinën merr  
çështja e fitimit nga ana e saj e pozitave të humbura të  
një fuqie të madhe botërore.** Me fjalë të tjera, Kina me  
kursin revizionisto-kapitalist që po ndjek përpiqet të kri-  
jojë zonat e influencës së saj, zona, të cilat deri tash nuk  
kanë ekzistuar. Kjo është, në radhë të parë, arsyeja që  
Kina është hapur në drejtim të favorshëm ndaj shteteve  
kapitaliste dhe është në unitet me imperialistët ameri-  
kanë dhe me imperialistët e tjerë.

**Synimi i parë i politikës kineze është që në strate-  
gjinë e vet të përgjithshme të krijojë unitet politik me  
imperializmin amerikan, me imperialistët e tjerë për do-  
minimin e botës nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës,  
nga Kina dhe nga vendet e tjera kapitaliste.** Natyrisht,  
kjo ndarje e sferave të influencës, veçanërisht në ato  
vende që janë në zhvillim, si në Afrikë e në ndonjë kon-  
tinent tjetër, nuk mund të bëhet pa përpjekje dhe pa u  
thelluar kontradiktat në mes tyre. Por aktualisht Kina  
synon që, së toku me Shtetet e Bashkuara të Amerikës,  
t'u vërë gardh ambicieve ekspansioniste të socialimperia-  
lizmit sovjetik. Pra, Kina me ndihmën e Shteteve të  
Bashkuara të Amerikës mendon ta kundërshtojë Bashki-  
min Sovjetik me ekspansionin imperialist dhe të zërë  
vetë vendin e tij. Këtu e ka burimin politika antisovje-  
tike e kinezëve.

Këtij qëllimi i shërben edhe traktati që Kina nën-  
shkroi tash së fundi me Japoninë, traktat i cili, siç e kam  
thënë, është si një barrierë kundër sovjetikëve dhe një-  
kohësisht një mjet për marshimin eventual të Kinës mbi  
Bashkimin Sovjetik.

Kina po vepron në Afrikë, duke mbështetur impe-

rializmin amerikan dhe imperialistët e tjerë si Francën,  
Anglinë dhe ndonjë tjetër dhe, nën maskën e mbrojtjes  
së popujve të Afrikës, ajo përpiqet të krijojë zona influ-  
ence e tregje për vete, gradualisht me fuqizimin e saj  
ekonomik nga ndihmat që i japin e do t'i japin Shtetet e  
Bashkuara të Amerikës dhe shtetet e tjera kapitaliste.  
Nga ana e saj, Kina i «ndihmon» shtetet e Afrikës, por  
këto ndihma kanë për qëllim grabitjen e pasurive të kë-  
tyre vendeve dhe nënshtrimin politik të këtyre shteteve  
dhe popujve ndaj hegjemonisë kineze. Natyrisht, kjo gjë  
nuk do të bëhet me lehtësi, siç mendojnë kinezët, por me  
kundërshtime politike, mundet edhe me armë me impe-  
rialistët e tjerë, që kanë zënë vende më parë në Afrikë  
si dhe me Bashkimin Sovjetik, që nuk ka qëndruar duar-  
lidhur për të krijuar zonat e tij të influencës në këtë  
kontinent.

**Qëllimi tjetër i politikës së Kinës është që të infil-  
trohet në Ballkan.** Domethënë, kur Kina pa se me Shqi-  
përinë nuk mund të vepronte si një shtet i madh kapita-  
list, ajo i preu marrëdhëniet ekonomike dhe politike me  
të, se ideologjikisht ne ishim në luftë me maoizmin dhe  
përpjekjet tona, për t'i sjellë kinezët në rrugën e drejtë  
të marksizëm-leninizmit, vajtën kot. **Kina, natyrisht, ka  
pasur synime që Ballkanin ta bënte një plasdarm ose  
një fushë politike, ekonomike e ideologjike në Evropë, me  
qëllim që prej këtej të vepronte për drejtimin e vendeve  
revizioniste, si: Bullgaria, Çekosllovakia, Hungaria, Polo-  
nia, dhe në këtë mënyrë të krijonte një zonë influence  
kineze në Evropë, në kundërshtim me interesat e Bash-  
kimit Sovjetik.**

Kështu udhëheqja kineze, në një rrugë me Çaushe-  
kun e Rumanisë dhe me Titon e Jugosllavisë, ndërroi  
përnjëherë fletë e qëndrim dhe u bashkua ideologjikisht  
e politikisht me këto dy vende kapitaliste, që janë të li-  
dhura me reaksionin botëror dhe, veçanërisht, me impe-

rializmin amerikan, por që i buzëqeshin nga frika edhe Bashkimit Sovjetik. Pra, aktualisht Kina i ka forcuar pozitën politiko-ideologjike dhe ekonomike me Jugosllavinë e me Rumaninë dhe mendon që këto pozita duhet t'i konsolidojë, t'i thellojë që, nëpërmjet kësaj situatë të krijuar, të kalojë më tej. Natyrisht, një rol të madh në këtë mes do të luajë tregu kinez, i cili do t'u hapet Jugosllavisë dhe Rumanisë. Kështu që këto dy vende, të cilat me zor gjejnë treg në vendet e tjera të botës, për arsye se mallrat e tyre nuk janë të asaj cilësie që të përballojnë tregtinë dhe konkurrencën e vendeve perëndimore të zhvilluara, por njëkohësisht janë edhe me çmime të larta, tash do t'i eksportojnë këto në Kinë. Tregtia e tyre me Kinën ka filluar të zhvillohet dhe do të zhvillohet akoma më shumë në të ardhmen, kuptohet, deri në njëfarë shkalle, sepse një gjë e tillë do të varet nga politika që do të zhvillohet midis Kinës dhe këtyre dy vendeve, nga influenca që Kina do të mund t'u imponojë dhe, më në fund, nëse këto dy vende do të pranojnë të veprojnë siç dëshiron Kina. Unë mendoj se do të jetë e zorshme që Jugosllavia dhe Rumania të veprojnë siç dëshiron ajo.

Sidoqoftë Kina, me politikën që ndjek, synon të krijojë një rajon të influencës kineze në Ballkan, duke na izoluar ne dhe mbasandaj do të orvatet t'i afrohet edhe Greqisë. Edhe kjo mund të ngjasë, pra, që Greqia të simpatizohet me Kinën, të bëjë tregti me të, për arsye se Greqia është partnere e NATO-s dhe mike e Amerikës. Por Kina do të kalojë edhe më tej, në Turqi, duke synuar kështu që ta vazhdojë rrethimin në Ballkan kundër Bashkimit Sovjetik dhe të përgatitë plasdarmin dhe vendin nga ku mund të depërtojë më mirë në satelitët e Bashkimit Sovjetik. Kjo politikë është një politikë e imperializmit amerikan, politikë që imperializmi amerikan dhe kapitalizmi evropian, nëpërmjet Tregut të Përbashkët Evropian,

Titos e Rumanisë, e kanë zhvilluar me kohë dhe po e zhvillojnë akoma më shumë në ditët e sotme për të influencuar në vendet e Traktatit të Varshavës.

**Hapja e Kinës në Evropë nuk ndalet vetëm në Ballkan.** Më parë Kina e ka deklaruar veten në favor të Tregut të Përbashkët Evropian dhe të «Evropës së Bashkuar» dhe me kohë ka hyrë në marrëdhënie tregtare me Tregun e Përbashkët Evropian, bile ka edhe përfaqësuesin e saj në këtë organizatë ekonomike pa qenë anëtare e saj. Por, natyrisht, tregtia midis vendeve kapitaliste të Evropës dhe Kinës po zhvillohet në shkallë të gjerë, po ashtu edhe me pjesëtarët e Tregut të Përbashkët Evropian, në radhë të parë, me Republikën Federale të Gjermanisë, me Francën, me Italinë, me Anglinë, me Holandën, me Suedinë etj. Kështu që Evropa është një synim i ekspansionit sovjetik dhe kinez. Kina për këtë qëllim punon nën maskën e parullës së politikës «antisovjetike» dhe të parullës tjetër që «Evropa rrezikohet me një luftë të tretë, bërthamore nga Bashkimi Sovjetik».

**Pra vizita e Hua Kuo Fenit në Rumani dhe në Jugosllavi bën pjesë në hapjen e Kinës në Evropë.** Kjo vizitë bëhet me qëllim që Kina, siç e vura në dukje edhe më lart, të marrë kredi nga vendet e zhvilluara të Evropës, që ajo të krijojë në Ballkan një fushë politike e ideologjike të favorshme për t'u rifutur më mirë në vendet satelite të Bashkimit Sovjetik, për të kundërshtuar në përgjithësi Bashkimin Sovjetik dhe influencën e tij në Evropë, për t'i hapur Evropës kapitaliste tregjet e saj, për të tërhequr kreditë e këtyre shteteve kapitaliste evropiane për vete dhe për t'i zvogëluar këto kredi për Bashkimin Sovjetik. Ky është një plan i izolimit të imperializmit sovjetik për të forcuar dominimin e imperializmit amerikan dhe dominimin e imperializmit kinez në botë.

**Në bisedimet me Çaushegun, dhe veçanërisht me**

rializmin amerikan, por që i buzëqeshin nga frika edhe Bashkimit Sovjetik. Pra, aktualisht Kina i ka forcuar pozitën politiko-ideologjike dhe ekonomike me Jugosllavinë e me Rumaninë dhe mendon që këto pozita duhet t'i konsolidojë, t'i thellojë që, nëpërmjet kësaj situatë të krijuar, të kalojë më tej. Natyrisht, një rol të madh në këtë mes do të luajë tregu kinez, i cili do t'u hapet Jugosllavisë dhe Rumanisë. Kështu që këto dy vende, të cilat me zor gjejnë treg në vendet e tjera të botës, për arsye se mallrat e tyre nuk janë të asaj cilësie që të përballojnë tregtinë dhe konkurrencën e vendeve perëndimore të zhvilluara, por njëkohësisht janë edhe me çmime të larta, tash do t'i eksportojnë këto në Kinë. Tregtia e tyre me Kinën ka filluar të zhvillohet dhe do të zhvillohet akoma më shumë në të ardhmen, kuptohet, deri në njëfarë shkalle, sepse një gjë e tillë do të varet nga politika që do të zhvillohet midis Kinës dhe këtyre dy vendeve, nga influenca që Kina do të mund t'u imponojë dhe, më në fund, nëse këto dy vende do të pranojnë të veprojnë siç dëshiron Kina. Unë mendoj se do të jetë e zorshme që Jugosllavia dhe Rumania të veprojnë siç dëshiron ajo.

Sidoqoftë Kina, me politikën që ndjek, synon të krijojë një rajon të influencës kineze në Ballkan, duke na izoluar ne dhe mbasandaj do të orvatet t'i afrohet edhe Greqisë. Edhe kjo mund të ngjasë, pra, që Greqia të simpatizohet me Kinën, të bëjë tregti me të, për arsye se Greqia është partnere e NATO-s dhe mike e Amerikës. Por Kina do të kalojë edhe më tej, në Turqi, duke synuar kështu që ta vazhdojë rrethimin në Ballkan kundër Bashkimit Sovjetik dhe të përgatitë plasdarmin dhe vendin nga ku mund të depërtojë më mirë në satelitët e Bashkimit Sovjetik. Kjo politikë është një politikë e imperializmit amerikan, politikë që imperializmi amerikan dhe kapitalizmi evropian, nëpërmjet Tregut të Përbashkët Euro-

pian, Titos e Rumanisë, e kanë zhvilluar me kohë dhe po e zhvillojnë akoma më shumë në ditët e sotme për të influencuar në vendet e Traktatit të Varshavës.

**Hapja e Kinës në Evropë nuk ndalet vetëm në Ballkan.** Më parë Kina e ka deklaruar veten në favor të Tregut të Përbashkët Evropian dhe të «Evropës së Bashkuar» dhe me kohë ka hyrë në marrëdhënie tregtare me Tregun e Përbashkët Evropian, bile ka edhe përfaqësuesin e saj në këtë organizatë ekonomike pa qenë anëtare e saj. Por, natyrisht, tregtia midis vendeve kapitaliste të Evropës dhe Kinës po zhvillohet në shkallë të gjerë, po ashtu edhe me pjesëtarët e Tregut të Përbashkët Evropian, në radhë të parë, me Republikën Federale të Gjermanisë, me Francën, me Italinë, me Anglinë, me Holandën, me Suedinë etj. Kështu që Evropa është një synim i ekspansionit sovjetik dhe kinez. Kina për këtë qëllim punon nën maskën e parullës së politikës «antisovjetike» dhe të parullës tjetër që «Evropa rrezikohet me një luftë të tretë, bërthamore nga Bashkimi Sovjetik».

**Pra vizita e Hua Kuo Fenit në Rumani dhe në Jugosllavi bën pjesë në hapjen e Kinës në Evropë.** Kjo vizitë bëhet me qëllim që Kina, siç e vura në dukje edhe më lart, të marrë kredi nga vendet e zhvilluara të Evropës, që ajo të krijojë në Ballkan një fushë politike e ideologjike të favorshme për t'u rifutur më mirë në vendet satelite të Bashkimit Sovjetik, për të kundërshtuar në përgjithësi Bashkimin Sovjetik dhe influencën e tij në Evropë, për t'i hapur Evropës kapitaliste tregjet e saj, për të tërhequr kreditë e këtyre shteteve kapitaliste evropiane për vete dhe për t'i zvogëluar këto kredi për Bashkimin Sovjetik. Ky është një plan i izolimit të imperializmit sovjetik për të forcuar dominimin e imperializmit amerikan dhe dominimin e imperializmit kinez në botë.

**Në bisedimet me Çausheksun, dhe veçanërisht me**

**Titon, Hua Kuo Feni nuk do të qëndrojnë pa folur edhe për Shqipërinë.** Kina revizioniste synon të kombinojë luftën e saj kundër Shqipërisë, me atë të të tjerëve. Ajo ka për qëllim ta izolojë Shqipërinë jo vetëm politikisht dhe ideologjikisht, duke zhvilluar një luftë akoma më të ashpër kundër saj, por edhe ekonomikisht, duke bërë që edhe Jugosllavia e Rumania revizioniste të influencojnë në marrëdhëniet e Shqipërisë në rrugën tregtare me vendet e tjera kapitaliste. Kështu që, sipas mendimit kinez, «fiku shqiptar të piqet, të vyshket» dhe të bjerë në gojën e tyre prej ujku të uritur. Por kjo nuk do të ngjasë kurrë.

Sigurisht, Hua Kuo Feni do të bisedojë me Titon edhe për rrezikun sovjetik, rrezik që mund t'i vijë Shqipërisë nga deti. Prandaj Titoja, Çausheku dhe aleatët e tyre perëndimorë «duhet të vëzhgojnë dhe të punojnë» që t'i presin rrugën një sulmi sovjetik për të zaptuar Shqipërinë. Ata parashikojnë se gjoja këtë «sulm të mundshëm» të sovjetikëve ndaj Shqipërisë ne «mund ta kërkojmë në mënyrë paqësore»! Domethënë këta armiq të Shqipërisë hala nuk e paskan kuptuar se Shqipëria socialiste është armiku më i tërbuar i revizionistëve sovjetikë, i imperializmit amerikan, i NATO-s, i Traktatit të Varshavës, i titizmit dhe i imperializmit kinez, dhe që asnjë nga mendimet e mbrapshta të tyre nuk do të realizohen.

**Çështja tjetër, që unë mendoj se Hua Kuo Feni do të shtrojë, sidomos në bisedimet e tij me Titon dhe në fjalimet në republikat e ndryshme të Jugosllavisë, veçanërisht në Maqedoni, do të jetë «zgjidhja e drejtë» që ka bërë Titoja për pakicat kombëtare.** Këtë «meritë» të Titos e vuri në dukje më përpara Sajfudini, kur vizitoi Jugosllavinë, por tash Hua Kuo Feni me autoritetin e tij si kryetar i Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kinës dhe kryetar i Këshillit të Shtetit të Republikës

Popullore të Kinës mund ta theksojë një gjë të tillë. Kjo mund të jetë një arsye tjetër për ne që ta demaskojmë Hua Kuo Fenin dhe titizmin, duke i thënë konkretisht Hua Kuo Fenit se mbështetja që i bëhet politikës së Titos në çështjet e rregullimit gjoja të drejtë të problemeve të pakicave kombëtare, shpjegohet me faktin që Titoja ka nevojë të madhe për këtë përkrahje, por Hua Kuo Feni nuk është në gjendje të gjykojë nëse çështjet e pakicave kombëtare nga regjimi titist janë zgjidhur drejt ose jo. Këtë gjë, më mirë janë në gjendje ta gjykojnë ato pakica kombëtare që rrojnë sot nën regjimin titist e që kanë rrojtur edhe më parë nën regjimin e kralëve serbë.

**Përveç këtyre, në artikull ne duhet të theksojmë se futja e kinezëve në Ballkan synon prishjen e gjendjes ekzistuese, krijimin e armiqësive midis popujve të Ballkanit dhe nxitjen e një lufte të tretë botërore.** Hua Kuo Feni e konsideron Ballkanin si fuçi baruti, ashtu siç e kanë pasë konsideruar kurdoherë imperialistët evropianë dhe imperializmi amerikan.

Kina ka deklaruar haptazi se «Bashkimi Sovjetik në një kohë shumë të afërt» do të shpallë luftën kundër imperializmit amerikan dhe Evropës. Prandaj **ardhja e Hua Kuo Fenit në Ballkan duhet të paraqitet në artikullin tonë si një nxitje që i bëhet Jugosllavisë dhe Rumanisë për prishjen e situatave aktuale në këtë zonë dhe nxitje e këtyre dy vendeve në luftë të hapët kundër Bashkimit Sovjetik.**

E gjithë kjo strategji e Kinës ka për qëllim që Bashkimi Sovjetik të godasë Evropën dhe të largohet nga një luftë me Kinën në Lindjen e Largme. Por Kina i bën llogaritë gabim, jo për arsye se Bashkimi Sovjetik revizionist nuk është një imperializëm agresor dhe nuk ka synime pushtimi për të shtypur e për të shfrytëzuar popujt, por sepse Bashkimi Sovjetik kapitalist dhe im-

perialist do të godasë me siguri, në radhë të parë, në atë pjesë të botës ku interesat për të janë më të mëdhenj dhe ku hallka e vendeve, që ai mendon të sulmojë, është më e dobët. Aktualisht këtë bën Bashkimi Sovjetik me ndërhyrjet e ndryshme, në mënyrë «paqësore», në Afrikë, por ndërhyrja e tij ushtarake, në situatat e tanishme, është shumë më e favorshme të bëhet kundër Kinës, sesa kundër Evropës, sepse lufta e Bashkimit Sovjetik me NATO-n do të jetë një luftë e madhe botërore, një luftë atomike, kurse me Kinën lufta i leverdis Bashkimit Sovjetik. Shtetet e Bashkuara të Amerikës dëshirojnë dhe përpiqen që këto dy fuqi imperialiste, Bashkimi Sovjetik dhe Kina, të ndeshen me njëra-tjetrën dhe të shkatërrohen. Një gjë e tillë, natyrisht, është në fitim të tyre.

Prandaj në kushtet aktuale nuk mund të realizohen llogaritë e imperializmit kinez, që Evropën ta futë në zjarr, domethënë që të nxitë luftën, siç po bën midis dy vendeve imperialiste, Bashkimit Sovjetik dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës e aleatëve të tyre, për interesat hegjemonistë të tij.

Tash ne duhet të presim, siç e thashë, edhe fjalimet që do të mbajnë këta udhëheqës në Bukuresht dhe në Beograd që, përveç këtyre tezave, të formulojmë më qartë teza të tjera për një artikull të mundshëm kundër ardhjes së Hua Kuo Fenit në Ballkan dhe kundër qëllimeve të tij armiqësore ndaj Shqipërisë dhe paqes në botë.

DURRËS, E SHTUNË  
19 GUSHT 1978

## ANDRE FONTENI KËRKON NJË INTERVISTË

Mora një letër nga Andre Fonteni, kryeredaktor i gazetës pariziane «Lë Mond». Ai më kërkon një audiencë televizive për problemet aktuale që kemi ngritur, domethënë për përçarjen midis Partisë sonë dhe Partisë Komuniste të Kinës. Natyrisht ai kërkon të marrë mendimin tim të autorizuar për këtë problem, por unë mendoj të mos ia jap këtë audiencë për intervistë.

E para, se nuk dua të bëhet reklamë jashtë. E dyta, se qëllimi i këtyre njerëzve është që të përfitojnë nga kjo situatë për ta thelluar akoma më shumë kontradiktën tonë jo vetëm me kinezët, por edhe me të tjerë. E treta, ata duan ta paraqesin çështjen ashtu si i leverdis borgjezisë së madhe franceze.

Unë mendoj që ambasadori ynë në Paris ta falënderojë për kërkesën, por të përpiqet të gjejë një arsye për këtë refuzim, si për shembull se aktualisht momentet nuk janë të përshtatshme, sepse te ne janë zgjedhjet e deputetëve të Kuvendit Popullor, kështu që një intervistë e tillë është e pamundur të realizohet sivjet. Shoku Enver, t'i thotë, do ta ketë parasysh për një moment të përshtatshëm.

### 3 AMBASADORËT TANË TË MERREN EDHE ME PROBLEMET E TREGTISË

Ambasadorët tanë jashtë duhet të instruktohen më mirë në këto momente që janë aq shumë të përshtatshme, nga të cilat ne mund të nxjerrim përfitime jo vetëm politike dhe ideologjike, se në këto drejtime mendoj që ata e bëjnë mirë punën. Me fjalë të tjera ambasadorët tanë kanë krijuar kontakte të shumta miqësore me ambasadorët e vendeve të kontinenteve të ndryshme, me sekretarët e ambasadave, me atashetë tregtarë, të cilët u flasin tanëve me një simpati shumë të madhe për politikën e Partisë dhe të Qeverisë sonë, për qëndrimet tona burrërore, të drejta etj.

Natyrisht, diplomatët e huaj bëjnë edhe pyetje se ç'do të bëjmë ne paskëtaj. Disa e vënë pyetjen me qëllim të caktuar dhe duan të dinë se «te kush do të mbështetemi, do të mbështetemi te perëndimorët apo te Bashkimi Sovjetik për të zhvilluar ekonominë, të cilën na e dëmtoi Kina». Natyrisht përfaqësuesit tanë diplomatikë në këtë drejtim u përgjigjen se ne do të mbështetemi në forcat tona dhe kjo është një përgjigje e drejtë. Ata u thonë, gjithashtu, se ne do të vazhdojmë marrëdhëniet tregtare me vendet me të cilat kemi të tilla marrëdhënie, që edhe kjo është e drejtë, por vazhdojnë t'u thonë se ne i kemi marrë të gjitha masat që çdo gjë të ecë përpara.

Edhe kjo është e drejtë gjer në njëfarë shkalle, por trajtimi i problemit të marrëdhënieve tregtare nuk është i mjaftueshëm me aq sa bëjnë ambasadorët tanë. Me të vërtetë ne kemi marrë masa, por një nga masat që nuk kemi marrë dhe për të cilën duhet të punojmë që ta realizojmë si duhet dhe qind për qind, e më tepër se qind për qind, është çështja e eksportit dhe e importit.

Prandaj në këto situata kaq të favorshme për vendin tonë, ambasadorët tanë duhet të instruktohen që të mos u thonë kolegëve të tyre të huaj se ne i kemi marrë të gjitha masat, por t'u bëjnë të ditur që nuk do të mbështetemi dhe nuk do të marrim kredi nga asnjë vend, kurse tregti do të bëjmë dhe t'u flasin konkretisht çfarë tregtie do të bëjmë, me cilin shtet dhe për çfarë mallrash na intereson të bëjmë shkëmbime tregtare, po kështu edhe vendeve që bëjnë tregti për çfarë u intereson të bëjnë tregti me ne. Me fjalë të tjera, ambasadorët tanë jashtë duhet ta konkretizojnë këtë problem kaq të rëndësishëm, siç është import-eksporti. Këtë problem ata nuk duhet të presin ta bëjnë vetëm delegacionet që dërgohen nga Ministria e Tregtisë së Jashtme. Këto delegacione u dërguan një herë dhe nuk mund të dërgohen vazhdimisht që të shëtitin botën, pse kështu nga mallrat që do të shesim, do të marrim më pak të ardhura, mbasi, shpenzimet e këtyre delegacioneve do të ishin më të mëdha sesa të ardhurat nga mallrat që do të eksportojmë.

Çështja është që ne, nëpërmjet përfaqësuesve tanë diplomatikë, t'u bëjmë të njohur ambasadorëve të shteteve të ndryshme, sipas vendeve, sipas tregtisë që bëjnë dhe nivelit të zhvillimit të tyre, ç'mallra mund të shesim ne në to dhe ç'mallra ka mundësi të importojmë prej tyre, sidomos me klering. Ka vende, dhe natyrisht këto zënë vendin e parë për ne, që dëshirojnë të blejnë krom prej nesh ose hekur, bakër e minerale të tjera të dorës

së parë, por ka vende të tjera që duan çingla-mingla, si: prodhime të artizanatit, bimë industriale, zarzavate, e shumë artikuj të vegjël të kësaj natyre, që në asnjë mënyrë ne nuk duhet t'i neglizhojmë, sepse edhe ato na sjellin të ardhura të konsiderueshme, krijojnë klering, por krijojnë edhe devizë. Këtë punë nuk po e bëjnë ambasadorët tanë, por mua më duket se në këtë drejtim ata mbahen, si me thënë, me njëfarë kryelartësie jo të rekomandueshme ndaj bashkëbiseduesve të tyre.

Qëndrimet politike ndaj revizionistëve kinezë, social-imperialistëve sovjetikë, imperializmit amerikan dhe borjezisë reaksionare duhet të mbahen ashtu siç është vepruar deri tash, po për sa u përket marrëdhënieve tregtare, të cilat kanë të bëjnë me marrëdhënie ekonomike, domethënë nuk kanë të bëjnë me kërkesë kredie nga kurrkush, pra shkëmbimet ekonomike e tregtare ata duhet t'i aktivizojnë dhe të dinë të përfitojnë nga kjo situatë, prandaj t'u jepen sa më parë orientime, sepse ka kohë që radiogramet që na dërgojnë shohim që janë të mbushura vetëm me mburrje dhe me mbështetjen që bëjnë me fjalë ambasadorët e huaj për vijën e drejtë të Partisë dhe të shtetit tonë.

Kjo, natyrisht, është një gjë shumë pozitive, por neve nuk na mjafton vetëm kjo. Ne duhet ta konkretizojmë këtë miqësi ose këtë simpati kaq të madhe që tregohet nga ana e tyre, prandaj instruktimi të ketë parasysh që ambasadorët tanë të flasin edhe për këto çështje, por Ministria e Jashtme dhe ajo e Tregtisë së Jashtme duhet t'i furnizojnë ata me të dhëna se çfarë dëshirojmë ne të shesim e çfarë duhet të blejmë dhe diplomatët tanë, në takimet e tyre me diplomatët e huaj, duhet të bëjnë diskutime serioze, jo të përcepta, ata duhet të hedhin mbi tryezë çështjet që duam ne të shtrojmë, t'u bëjnë të ditur mallrat që duam të shesim dhe ato që na duhet të blej-

më dhe të bëjmë kështu që bashkëbiseduesit të lajmërojnë qeveritë e tyre e t'u nxitin interesimin për këto shkëmbime e marrëdhënie me ne. Është e domosdoshme një gjë e tillë. Prandaj duhet të këshillohen shokët që në këtë drejtim të veprojnë medoemos.

## INTRIGA POLITIKE TË KINËS NË BALLKAN

Hua Kuo Feni i Kinës, si një «buf kënete», e mbaroi udhëtimin e tij në Rumani dhe sot në mëngjes u ndodh në Beograd, te miku i tij i ngushtë, Titoja.

Për sa i përket vizitës së tij në Rumani, duke u bazuar në të dhënat e shtypit e në emisionet televizive që kemi parë, mund të themi se ajo mbaroi pa sukses e pa shkëlqim. Bisedimet midis kinezëve dhe rumunëve u mbyllën, por konstatojmë se nuk u dha asnjë komunikatë zyrtare, siç veprojnë revizionistët rumunë megalomanë, pse këta, me Çaushekun në krye, gjithmonë kanë dashur e duan t'i tregojnë botës se vërtitin politikën e madhe ndërkombëtare. Këtë herë nuk guxuan ta bënin një gjë të tillë, pse u ndodhën ngushtë.

Siç informohemi, kur filluan bisedimet ditën e parë, në takimin në mes të dyja palëve, problemet që u vunë në rend të ditës, natyrisht, nuk ishin të kënaqshme për palën kineze, se rumunët rekomanduan një program kashhtë. Mirëpo «bufi i kënetës» nga Kina kishte mendimin që në Rumani të tregonte madhështinë e Kinës, politikën e saj «të urtë» e «tejpamëse» dhe vlerën e saj të madhe botërore, prandaj nuk ndihej i kënaqur.

Siç dihet, disa ditë më parë Çaushi ishte në Kremlin, ku ia kishin vënë këmbët në një këpucë dhe i qe tërhequr veshi nga Brezhnjevi se duhej të tregohej i matur, ndryshe mund t'i ngjisnin gjëra të papritura, siç

i ngjanë. Prandaj, më 17 gusht, kur filluan bisedimet, u diskutua për probleme ideologjike, politike, ekonomike, tekniko-shkencore dhe për marrëdhëniet midis dy partive. Sigurisht, këto probleme u diskutuan në sipërfaqe, siç po duket nga artikujt që botohen në gazetatat rumune ose kineze. Kurse probleme ushtarake nuk konfirmohet të jenë marrë në diskutim gjatë këtyre bisedimeve, as edhe përpara ardhjes së Hua Kuo Fenit, megjithëse disa ambasadorë rumunë në vende të ndryshme, në biseda me njerëzit tanë, nuk e kundërshtojnë kategorikisht propozimin që Çu En Lai na bëri neve, për një aleancë ushtarake në mes shqiptarëve, jugosllavëve dhe rumunëve, por shtojnë se, edhe sikur të bëhej një aleancë e tillë, nuk do të ishte keq për vendet tona, ajo do të ishte një barrierë kundër sovjetikëve.

Me fjalë të tjera, këta ambasadorë rumunë, nga njëra anë thonë se mjaft e ka Rumania një aleancë, ç'do ajo të futet në aleanca të tjera, nga ana tjetër këtë e quajnë si një mjet që mund t'i shërbente gjoja ruajtjes së pavarësisë dhe sovranitetit të popujve të Ballkanit! Por, natyrisht, kjo nuk u shkoi as kinezëve, as jugosllavëve. Bile një ambasador rumun i ka thënë një ambasadorit tonë se «na futët në telashe të rënda që e deklaruat këtë çështje, sidomos, pak kohë përpara se në Rumani të vinte Hua Kuo Feni». Ne nuk e deklaruaam këtë fakt për arsye se Hua Kuo Feni do të vinte në Ballkan, por sepse ky propozim, që Çu En Lai na e kishte bërë shumë kohë përpara, ishte antimarksist e antishqiptar. Pastaj, janë udhëheqësit kinezë ata që, duke prerë marrëdhëniet me ne, na detyruan të hapnim defterët e vjetër dhe të shpjegonim rrugën e tyre armiqësore dhe antimarksiste.

Sipas të dhënave që edhe mund të mos jenë të sigurta, mësojmë se gjatë bisedimeve, Hua Kuo Feni dhe Çausheku kanë pasur edhe kontradikta në mes tyre për

sa u përket çështjeve të sotme të politikës ndërkombëtare dhe qëndrimit ndaj vendeve «socialiste». Nga kjo kuptojmë se kinezët kanë dashur që ta shpëputin fare Rumaninë nga Bashkimi Sovjetik dhe nga vendet e tjera «socialiste», ta futin atë më thellë në batak. Por është e zorshme që Rumania të shpëputet nga Bashkimi Sovjetik dhe nga satelitët e tij. Themi kështu sepse ajo është e lidhur fort pas qerres së tyre dhe Bashkimi Sovjetik e ka mbërthyer mirë. Për këtë arsye Hua Kuo Feni me propozimet e tij nuk ia arriti qëllimit në Rumani, me gjithë «miqësinë» e ngushtë që tregohet nga ana e Kinës ndaj këtij vendi, me gjithë ndihmat e mëdha që i janë dhënë dhe që mund t'i jenë dhënë edhe tani nga Kina me rastin e kësaj vizite.

Të gjitha takimet dhe vizitat e Hua Kuo Fenit në Rumani, sipas njoftimeve të ambasadës sonë në Bukuresht, nuk janë dhënë të plota në televizion; janë dhënë vetëm disa kronika të thjeshta rreth tyre. Shtypi rumun, gjithashtu, i ka pasqyruar shumë të përmbledhura aktivitetet, takimet dhe bisedimet e delegacionit kinez në qendra pune, në kryeqytet dhe në rrethe. Kjo është e kuptueshme, për arsye se Çausheku nuk ka mundur të afishohet në atë mënyrë që ia ka dashur zemra me kinezët, për arsye të frikës nga sovjetikët, që i ka hyrë thellë në palcë. Kështu, as në Bukuresht, as në rrethet e tjera, ku shkoi Hua Kuo Feni, nuk u organizua ndonjë miting.

Për nder të Hua Kuo Fenit ishte vendosur të jepej një shfaqje artistike. Në fillim ajo ishte parashikuar të jepej në teatrin e madh kombëtar. **Shfaqja që e pamundur të jepej këtu sepse, kur Hua Kuo Feni po pritej në aeroport, ndërtesës së teatrit i doli flaka në majë të çatisë dhe për shuarjen e saj u deshën 24 orë!** Për këtë arsye u vendos që kjo shfaqje të jepej në stadium, por në fakt ajo u dha në pallatin e sportit sepse protestuan sovjetikët,

duke thënë se shfaqje në stadium nuk ishte dhënë as për Brezhnjevin, pra, si mund të jepej tani për Hua Kuo Feni! Pastaj, në programin e shfaqjes që u dha, kishte vetëm një këngë kineze. Sigurisht, kinezëve u ka ardhur shumë thartë për këtë, sepse pritin që në Rumani të kishte një entuziazëm të papërshtuar për ta. Edhe në darkën zyrtare, si për çudi, nuk u ftuan shefat e misioneve diplomatike. Kjo u bë sepse u parashikua që përfaqësuesit e vendeve të Traktatit të Varshavës do të refuzonin pjesëmarrjen.

**Ambasada jonë na informon se ditën e dytë, të tretë dhe të katërt jehona e vizitës së Hua Kuo Fenit pati shumë ulje në krahasim me ditën e parë. Emri i Mao Ce Dunit, «udhëheqësit të madh» dhe «timonierit të madh», nuk u zu në gojë fare nga rumunët, ndërsa Hua Kuo Feni e përmendi vetëm një herë në dollinë e darkës zyrtare. Rumunët nuk folën fare në shtypin e tyre për bashkëpunimin në fushën politike dhe ideologjike midis Rumanisë dhe Kinës, por përdorën *en bloc* fjalët: «Pritje e përzemërt, e ngrohtë, miqësore» e të tjera, e të tjera pallavra të tilla. Natyrisht, Hua Kuo Feni ngriti lart «trimërinë» dhe «heroizmin» e rumunëve për ruajtjen e pavarësisë, të sovranitetit e të tjera e të tjera profka si këto, dhe si një buqetë lulësh, një ditë pas ardhjes së Hua Kuo Fenit, rumunët arrestuan Nikolae Doikarutin, i cili deri në maj të këtij viti ishte zëvendësministër i parë i Brendshëm, kurse më pas ishte bërë ministër i Turizmit.**

**Flitet se kinezët në Bukuresht u takuan edhe me përfaqësuesit e partisë revizioniste të Karriljos dhe zhvilluan bisedime me ta.**

**Me pak fjalë, Hua Kuo Feni vajti në Rumani për lesh dhe doli i qethur, pra, hyri dhe doli fishek. Ai nuk ia arriti qëllimit që kishte caktuar, por HSINHUA-ja dhe tok me të «Zhenminzhibaoja» u përpoqën që ta lyejnë**

këtë vizitë me një penel me ngjyrë ari. Hua Kuo Feni në fjalimin e tij, për sa u përket rumunëve tha se ata e kanë fituar luftën «me përpjekje e me heroizma». Këtë fjalim e dhanë agjencia dhe gazetat zyrtare kineze, në materialet e të cilave, midis të tjerash, lexojmë «xheva-hiret» e mëposhtme:

«Të dashur shokë (u drejtohet ai rumunëve), vizita jonë e tanishme ishte shumë e frytshme. Ne kemi zhvilluar me shokun Nikolae Çausheku dhe me shokët e tjerë udhëheqës të partisë e të qeverisë rumune bisedime të përzemërta e të sinqerta për rrugët e forcimit e të zhvillimit të mëtejshëm të marrëdhënieve tona të dyanshme dhe shkëmbyem mendime për gjendjen e tanishme ndërkombëtare e për çështjet e tjera me interes të përgjithshëm. Ne bashkohemi (këtu është me pyka) me mendimin se vendet e mëdha ose të vogla duhet të jenë të barabarta, se kombet e mëdha nuk duhet të bëjnë shantazh mbi të voglat, kombet e fuqishme nuk duhet të shtypin të dobëtat dhe kombet e pasura nuk duhet të shfrytëzojnë të dobëtat dhe se çështjet e një vendi duhet të zgjidhen nga populli i tij dhe çështjet ndërkombëtare duhet të zgjidhen nga të gjitha vendet e interesuara nëpërmjet konsultimeve mbi një bazë të barabartë...». Dhe Hua Kuo Feni vazhdoi: «Ne që të dy kundërshtojmë politikën e forcës, të diktatit, të ndarjes në sfera të influencës dhe kërcënimet me përdorimin e forcës. Ne mendojmë se agresioni, kontrolli, ndërhyrja dhe subversioni i ndërmarrë nga ndonjë vend kundër vendeve të tjera duhet të dënohet në mënyrë të gjithanshme dhe të kundërshtohet me vendosmëri» etj., etj.

Të gjitha këto çka tha «bufi i kënetës» janë një bluf, sepse në praktikë revizionistët kinezë bëjnë të kundërtën. Aktet e tyre kundër Shqipërisë dhe kundër Vietnamit vërtetojnë katërcipërisht të kundërtën e sloganeve

që lëshoi ai në Bukuresht. Të gjitha ato çka nxori nga goja Hua Kuo Feni ishin pa kripë dhe kanë bërë efekt shumë të keq në opinionin botëror duke vërtetuar edhe një herë se kinezët janë hipokritë, demagogë. Ata bëjnë të kundërtën e atyre që thonë. Për këtë flasin qartë ngjarjet e freskëta, veprimet antimarksiste që rrjedhin nga fuqia e një shteti të madh, diskriminimi, shtypja, kërcënimet, shantazhet që ata i bëjnë dhe vazhdojnë t'i bëjnë çdo ditë Shqipërisë. Pra, në Bukuresht, me fjalë boshe, pa kripë e të rrema, Hua Kuo Feni u përpoq të zbuste pak përshtypjen e thellë dhe të rëndë që ka bërë në botë qëndrimi i Kinës ndaj Shqipërisë dhe Vietnamit, si dhe ndaj popujve të tjerë.

Edhe një herë e theksoj se vizita e Hua Kuo Fenit në Bukuresht, në vend që ta bënte politikën e tij dhe të Ten Hsiao Pinit «të shkëlqente», e errësoi më shumë.

Kështu që Hua Kuo Feni u nis me bisht në shalë për në Beograd dhe, siç po mësojmë nga lajmet dhe nga emisionet televizive, pritja që iu bë atje ishte e thjeshtë. Titoja nuk shkoi në aeroport për ta pritur personalisht Hua Kuo Fenin, me pretekstin se është plak, por çështja ishte që ai të mos i jepte bujë vizitës së udhëheqësit kinez në Beograd, ashtu siç e kërkonte Hua Kuo Feni dhe siç ia bëri nderin ky Titos kur shkoi në Pekin. Pra, Titoja u tregua i moderuar në manifestime ndaj Hua Kuo Fenit. Të tjerë udhëheqës jugosllavë e pritën atë në aeroport, ku nuk kishte ndonjë grumbullim të madh populli, por kishte mjaft ushtarë, që dukej se ishin pa armë dhe në duar mbanin flamurë e lulka dhe gjoja brohoritnin. Nëpër trotuare kishte njerëz që tundnin disa flamurë, por jo shumë. Edhe televizioni jugosllav nuk dha ndonjë gjë të jashtëzakonshme. Mbasandaj «timonierin e ri» të Kinës e pamë në Pallatin e Bardhë të Titos. Atje ishte rresh-tuar garda dhe Hua Kuo Feni kaloi në revistë me Titon. Të dy i dhanë dorën shoqi-shoqit, **Huaja e përqafoi Titon,**

**e puthi në të dy faqet me rudha dhe, kur ngjiten shkallët, u pa që Hua Kuo Feni e mbante Titon nga krahu për t'i treguar afrimin e tij të madh dhe respektin që ka ky revizionist ndaj revizionistit plak.**

Më vonë do të shohim se si do të zhvillohen bisedimet midis jugosllavëve dhe kinezëve, Titos dhe Hua Kuo Fenit. Por nga një bisedë e zhvilluar në mes dy ambasadorëve të huaj dhe sekretarit të parë të ambasadës kineze, kemi marrë vesh se ky u ka thënë atyre që pala kineze ka kërkuar që Hua Kuo Feni të vizitonte edhe Ohrin e Kosovën, por jugosllavët nuk e pranuan këtë kërkesë. Është e qartë për ne se Titos nuk ia ka qejfi që Hua Kuo Feni të vejë në këto vende, sepse mendon që do të acaroheshin kontradiktat midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë dhe një gjë e tillë nuk është në interes të Jugosllavisë.

Pra, Hua Kuo Feni dëshiron shumë të shkojë në Kosovë dhe atje të na shajë e të shpifë për ne, por, po ta bëjë këtë, me të vërtetë kjo do të jetë një armë e madhe që ai do të na japë neve për të demaskuar Jugosllavinë revizioniste edhe më mirë se ç'e kemi demaskuar deri tash. Dhe një gjë tjetër më e bukur akoma do të ndodhte, po të shkonte Hua Kuo Feni në Kosovë, atje do të krijohej një situatë e tillë e rëndë si kundër Kinës, ashtu edhe kundër Titos dhe titizmit, prandaj Titoja e refuzoi këtë kërkesë. Ai është një dhelpër e vjetër që nuk i ha të tilla gjellë kineze.

Sipas informatave që kemi, Huaja do të shkojë në Shkup dhe atje më duket se do të vizitojë universitetin. Mundet që vendësit ta bëjnë edhe «*doktoris honoris causa*». Në Shkup Hua Kuo Feni ka mundësi të flasë për «zgjidhjen e drejtë» të çështjeve nacionale nga ana e titizmit. Titistëve u intereson që ai ta ngrejë këtë çështje atje kundër Bullgarisë, e cila patjetër do të tërbohet, dhe prapa saj edhe Bashkimi Sovjetik. Me këtë rast do të acarohen kontradiktat midis Jugosllavisë, Bashkimit So-

vjetik e Bullgarisë dhe do të vërtetohet kështu ajo që kemi thënë ne se Hua Kuo Feni vjen në Ballkan për të zhvilluar intriga dhe për të ngjallur përçarje e armiqësi midis popujve të kësaj zone.

## HUA KUO FENI KOKË MË KOKË ME TITON NË BEOGRAD

Hua Kuo Feni po vazhdon bisedimet me Titon. Mbrëmë kreu i revizionistëve të Beogradit dha një banket të madh në Shtëpinë e Bardhë të tij për Hua Kuo Fenin, ku të dy burrat e shtetit mbajtën fjalime. Natyrisht, këto fjalime nuk dilnin jashtë caqeve të asaj vije që secili prej këtyre dy revizionistëve e ka përcaktuar që më përpara, sidomos revizionisti plak dhe dinak Tito. Në mënyrë të përmbledhur po shkruaj këtu për pikëpamjet politike që shfaqti ai me këtë rast. Titoja tha se Jugosllavia ka ndjekur dhe ndjek një vijë «të paangazhuar» dhe është për lëvizjen e «të paangazhuarve», e cila është një nga «lëvizjet më përparimtare», që, sipas tij, duhet të kontribuojë në dobësimin e dy superfuqive. Titoja theksoi se në botë superfuqitë nxjerrin ngatërresa dhe luftojnë për të dominuar e për të krijuar tregje dhe zona influente për veten e tyre. Këto dy superfuqi, sipas Titos, kërcënojnë botën me një luftë botërore. Në kontinente të ndryshme shihen plasaritje të shumta, të cilat sa vete e po shtohen. Natyrisht, Titoja është larg asaj situatë idilike «të mrekullueshme» të gjendjes në botë siç vazhdojnë ta paraqesin kinezët.

Përveç kësaj, Titoja deklaroi përpara Hua Kuo Fenit se «është hapur një kapitull i ri në marrëdhëniet në mes Jugosllavisë e Kinës. Brenda vitit, shtoi ai, këto marrë-

dhënie ekonomike, politike, partie, shkencore e kulturore, janë zhvilluar dhe do të zhvillohen akoma më shumë. Duhet t'i zhvillojmë, sepse këto janë në interesin e të dy vendeve dhe të paqes në botë».

Nga ana tjetër, Titoja theksoi që «Miqësia në mes të dy popujve nuk duhet të cenohet në asnjë mënyrë miqësinë që ka secili nga këto dy shtete me popuj dhe vende të tjera». Titoja, si dhelpër dinake që është, tha se «të gjitha shtetet, të mëdha e të vogla, duhet të bëjnë përpjekje për t'i zhvilluar marrëdhëniet në paqe, në bashkekzistencë paqësore, në mosndërhyrje» e të tjera formula, që ai i përsërit vazhdimisht.

Titoja theksoi se Jugosllavia dhe Kina ndërtojnë «socializmin autentik». Në Jugosllavi, tha ai, ekziston forma e socializmit vet-administruar, kurse në Kinë ekziston një formë tjetër e ndërtimit të socializmit (që Titoja nuk e përcaktoi). Ai tha, gjithashtu, se Jugosllavia nuk është për receta ose për dogma në lidhje me ndërtimin e socializmit; çdo vend mund dhe duhet të gjejë mënyrën dhe format e ndërtimit të socializmit.

**Marksizëm-leninizmin Titoja dhe Hua Kuo Feni e kanë hedhur tej, pothuajse as e përmendën fare ose e përmendën shkarazi, se ekziston një teori e tillë që quhet marksizëm-leninizëm.**

Hua Kuo Feni, nga ana e tij, nuk mungoi t'i thurte lavde të mëdha Jugosllavisë «socialiste», «socializmit të vërtetë autentik», duke përsëritur fjalët e Titos për vet-administrimin jugosllav, nuk mungoi të tregonte për heroizmat e popullit jugosllav dhe të heroit Tito. Përmendi, gjithashtu, se në mes këtyre dy vendeve socialiste janë hedhur themelet e një rruge të përbashkët për ndërtimin e plotë të socializmit dhe për mbrojtjen e paqes në botë e plot formula të tjera në këtë drejtim. Bile ai shtoi edhe fjalët e Mao Ce Dunit që e paska lavdëruar me fraza bombastike Josip Broz Titon. Si dhuratë Hua Kuo Feni i

dha Titos një tablo të madhe, vepër e një piktori të shquar kinez, ku tregohet një shqiptonjë heroike, me një krye ose me dy krerë këtë nuk e dimë, po sigurisht me një, sepse Hua Kuo Feni dhe Titoja përbëjnë një të vjetër: revizionizmin modern me dy faqe.

Këto ishin, me pak fjalë, mendimet e shprehura në banket. Hua Kuo Feni, në qoftë se nuk gabohem, nuk e zuri asnjëherë me gojë çështjen e «botës së tretë», por mburri, mbështeti dhe mbrojti lëvizjen e «të paangazhuarve» e, natyrisht, sulmoi Bashkimin Sovjetik pa ia përmendur emrin, por duke thënë se ekzistojnë fuqi imperialiste dhe hegjemoniste, të cilat, sipas tij, përpiqen ta çajnë e ta përçajnë këtë farë lëvizjeje «të paangazhuar» që gjoja ekzistoka në një formë monolite e të fuqishme.

Hua Kuo Feni mburri lëvizjen e «të paangazhuarve» jo pa qëllim. Këtë e bëri në mënyrë që të mos ekzistojë asnjë çarje në mes Jugosllavisë dhe Kinës, sepse revizionistët kinezë e kuptojnë që janë qëllimet e imperializmit amerikan ato që shprehen nëpërmjet Titos me teorinë e «të paangazhuarve» dhe hëpërhë Kina e lë mënjanë teorinë e saj të «botës së tretë» dhe adapton teorinë e lëvizjes «së paangazhuar» për të marrë kryesinë e kësaj lëvizjeje pas vdekjes së Titos. Edhe vetë revizionistët kinezë tash po konstatojnë se «bota e tretë» nuk pati sukses, përkundrazi, kjo e demaskoi kryekëput Kinën.

Qëllimet e Titos njihen, ai di ta ruajë balancën. Edhe ky fjalim i tij ishte si kurdoherë i balancuar, ai nuk preku as Bashkimin Sovjetik, as Shtetet e Bashkuara të Amerikës, foli me terma të përgjithshëm: «fuqitë e mëdha» dhe «fuqi imperialiste», por se cilat janë këto, nuk e përcakttoi. Nga ana tjetër, duke thënë se «u hap një fletë e re», ai lë të kuptohet se është Kina që iu nënshtrua Jugosllavisë, sepse fleta e mëparshme ishte një fletë ar-

miqësore, ishte kundër revizionizmit jugosllav. Pushteti aktual kinez bëri autokritikë, e lavdëroi Titon, titizmin dhe vetadministrimin jugosllav.

Me vizitën në Rumani dhe në Jugosllavi Hua Kuo Feni synon që në pellgun e Ballkanit të krijojë pozita për Kinën dhe të intrigojë e t'i nxitë këto vende kundër socialimperializmit sovjetik, njëkohësisht të forcojë pozitën e amerikanëve dhe të shteteve të tjera kapitaliste në Ballkan. Sigurisht, Hua Kuo Feni në Bukuresht dhe në Beograd ka folur kokë më kokë me Çausheksun e me Titon edhe për Shqipërinë, të cilën e ka sulmuar. Titoja dhe Çausheksu sigurisht që e kanë aprovuar renegatin kinez, por nuk ia kanë ushqyer sa duhet pikëpamjet e tij për ta likuiduar Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë, sepse edhe Titoja, edhe Çausheksu na njohin më mirë se «bufi i kënetës» kinez.

Kina është një vend revizionist dhe ndjek një politikë raciste. Në një shkrim të agjencisë HSINHUA, në lidhje me Traktatin Kino-Japonez, thuhet se ky traktat shënon një datë historike. Po në këtë shkrim jepet një figurë e tillë që zogjtë e një familjeje, përdoret një term që nuk e kam parasysh ekzaktësisht, duhet të qëndrojnë në një fole. Të gjitha synimet e Kinës janë që raca e verdhë të jetë në unitet me racën e zezë.

Pra, kinezët duan t'u thonë afrikanëve, zezakëve, se «bota e tretë» është e ardhmja e këtyre dy racave, në unitet kundër «hundëmëdhenjve». Hundëmëdhenjtë për kinezët janë të bardhët. Kjo ndjenjë raciste është shumë e theksuar në Kinë. Kina kërkon ta shfrytëzojë për qëllimet e saj atë zemërim të thellë që ruajnë vendet afrikanë «të posaçliruara» kundër imperialistëve dhe kolonialistëve të vjetër e të rinj që i kanë shtypur, i kanë skllavëruar, i kanë vranë e u kanë pirë gjakun. Ndjenjat e urrejtjes ajo kërkon t'i nxitë kundër të bardhëve dhe këtu i ka rrënjët predikimi që bën Kina për një luftë

botërore në mes Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Sovjetik. Kina mendon se, duke i vënë në grindje dhe në luftë, «të dy hundëmëdhenjtë» do të dobësohen, do të shkatërrohen dhe Kina, natyrisht, do të mbetet ajo superfuqi dominuese në botë, që tok me shtetet e tjera të Afrikës dhe të Azisë, domethënë shtetet me ngjyrë, të ketë supremaci në botë.

Por, po ta gjykojmë mirë këtë çështje, vëmë re se në përgjithësi politika e Kinës në të gjithë botën po dështon, veçanërisht ajo po dështon në Ballkan. Ne shohim se Rumania e Çausheikut është e lidhur me Bashkimin Sovjetik dhe nën presionin e tij, Çausheiku sa kaloi radhën me vizitën e Hua Kuo Fenit, se nuk u duk më ndonjë manifestim ose fjalim publik me këtë rast, që të shprehte pikëpamjen e gjelit rumun dhe të linte të kuptohet se ai nuk pyet për fuqinë agresore të sovjetikëve, duke ditur se ka në krah Kinën e Hua Kuo Fenit.

Edhe në Jugosllavi Hua Kuo Feni nuk korri ndonjë sukses me politikën e tij të nxitjes së luftës e të ndërimit të Jugosllavisë kundër Bashkimit Sovjetik dhe vendeve të tjera. Natyrisht, Titoja është kundër Bashkimit Sovjetik, por frikën ia ka dhe nuk do luftë me të. Ai e di se, po të mbajë qëndrimin që kërkon Hua Kuo Feni, Jugosllavia do të rrezikohet me një sulm të jashtëm ose të brendshëm. Një gjë të tillë nuk e dëshiron jo vetëm Titoja, por as aleatët e tij të zemrës, domethënë imperializmi amerikan dhe shtetet e tjera perëndimore, të cilat nuk duan që Jugosllavia të bëhet një shesh intrigash dhe një plasdarmë sovjetike, domethënë një fushë ku sovjetikët, për një arsye ose për një tjetër, nga brenda ose nga jashtë, ta invadojnë Jugosllavinë e të krijojnë atje një pushtet të favorshëm për vete.

Imperializmi amerikan dhe shtetet kapitaliste perëndimore janë shumë prudente, ato përpiqen ta evitojnë luftën me Bashkimin Sovjetik, po jo luftën e Bashkimit

Sovjetik me Kinën. Në këto situata, kur Kina ka nevojë të madhe për ndihmën amerikane, japoneze dhe të kapitalistëve evropianë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës do ta ndihmojnë, do ta armatosin, me qëllim që ta ndërsejnë kundër Bashkimit Sovjetik e pastaj ta lënë në baltë. Por mund të ngjasë edhe ajo që kinezët e kanë në gjak dhe e përdorin vazhdimisht, pra, që ata të ndërrojnë këmishë dhe nga një strategji proamerikane të hidhen në një strategji prosovjetike, kundër amerikanëve.

**Këto eventualitete të politikës së lëkundshme të Kinës të gjithë i kanë parasysh, prandaj përpiqen t'i shfrytëzojnë koniunktura të tilla, të shfrytëzojnë dobësinë e Kinës dhe pasuritë e saj të mëdha për t'u mahur, pse tendencat dhe drejtimet e politikës kineze ndaj aleatëve të saj të rinj kapitalistë dhe imperialistë nuk do të kenë atë sukses që synon ajo.**

Këto janë disa përshtypje fillestare që na japin fjalimet e mbajtura në banketin e parë nga Titoja dhe Hua Kuo Feni. Patjetër këta dy burra shteti, revizionistë dhe kapitalistë, do të kenë edhe bisedime të tjera. Titoja, natyrisht, do ta çojë Hua Kuo Fenin në Mekën jugosllave, në Brioni, ku do të zhvillojnë bisedimet përfundimtare. Nuk dimë nëse do të ketë apo nuk do të ketë komunikatë, por në fakt me rumunët nuk u nënshkrua një gjë e tillë. Por edhe nga Jugosllavia zoti Hua Kuo Fen do të dalë fishek, si në Rumani, megjithëse intriga do të bëjë pa masë për t'ia arritur qëllimit. Edhe Titoja po ashtu do të bëjë shumë intriga, do të bëjë allishverishe me Kinën në tregti dhe në diplomaci. S'është çudi që ai, brenda caqeve që ia lejon aleanca me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, t'i bëjë propozime, nga ana e Hua Kuo Fenit, edhe Brezhnjev, se flitet që më pas Titoja do të shkojë në Moskë. Sigurisht, ai do të shkojë atje për të qetësuar Brezhnjevin dhe për të shkëmbyer mendime për një çerek afrimi me Kinën, sepse Jugosllavisë nuk i leverdis

një politikë e tillë agresive nxitëse si ajo që po zhvillon Kina.

Titoja dhe Jugosllavia janë futur në borxhe dhe dëshirojnë të rrojnë në borxhe, ta gëzojnë këtë jetë plot borxhe e të shitur te të huajt për fatkeqësinë e mjerimin e popullit jugosllav.

Si përfundim mund të themi se revizionisti Tito me vizitën e tij në Pekin dhe revizionisti Hua me vizitën që po bën në Beograd i dhanë një lustër revizionizmit në përgjithësi; të dy këta krerë revizionistë afirmuan tradhtinë e tyre të madhe ndaj marksizëm-leninizmit dhe socializmit. Ata treguan fytyrat e tyre të vërteta si elementë kryesorë të borgjezisë dhe renegatë të marksizëm-leninizmit, në unitet të plotë për veprime tok me imperialistët e kapitalistët e botës.

DURRËS, E PREMTE

25 GUSHT 1978

## BOTA TË MOS HARROJË SARAJEVËN!

Kryetari Hua Kuo Fen, pasi bëri mjaft vizita në qytetin e Beogradit, pasi vizitoi ndërmarrje, muze etj., mburri e lavdëroi në mënyrë hiperbolike dhe të shkëlqyeshme Titon dhe vetadministrimin jugosllav, nuk mungoi të fliste, gjithashtu, edhe për zgjidhjen e drejtë që gjoja u ka bërë titizmi problemit nacional dhe, veçanërisht, pakicave kombëtare që jetojnë në Jugosllavi. **Këto vërtet quhen pakica kombëtare, por në realitet vetëm pakica kombëtare shqiptare arrin gati në 2 milionë, kurse Mali i Zi, që është një republikë e veçantë e Federatës Jugosllave, nuk ka veçse 500 mijë banorë dhe në këtë numër ka edhe disa dhjetëra mijë shqiptarë.**

Natyrisht, zoti Hua Kuo Fen mund të flasë për çfarë t'i dojë qejfi dhe të mburrë tradhtarin Tito dhe tradhtinë titiste ndaj marksizëm-leninizmit, ndaj revolucionit botëror. **Nuk çuditemi kur shohim që një renegat mbështet një renegat tjetër. Kjo për ne është fare e qartë, se nuk mund të ndodhë ndryshe. «Më thuaj me kë rri, të të them se cili je», thotë populli ynë.**

Pra, Hua Kuo Feni nuk mund të fliste ndryshe gjatë vizitës së tij në Jugosllavi, për arsye se partia e tij, ai dhe shokët e tij, nuk janë marksistë-leninistë, por borgjezë, kapitalistë. Ata hiqen si marksistë, pavarësisht se s'kanë qenë asnjëherë të tillë. Në fakt ata janë tradhtarë të marksizëm-leninizmit, siç janë titistët, me të cilët pu-

then e përqafohen. Të shkosh në Jugosllavi dhe të afirmosh që titizmi i ka zgjidhur më së miri çështjet nacionale, kjo do të thotë që të bëhesh mbrojtës i padrejtësive më të mëdha të kapitalizmit dhe të imperializmit botëror, të cilët në të kaluarën dhe tash kanë flakur tej interesat e popujve, i kanë përçarë e i përçajné ata, duke marrë njëri ose tjetri një pjesë ose të tërë territorin e tyre, vetëm e vetëm për të përmbushur interesat e tyre hegjemonistë.

**Përveç kësaj, kjo që bën Hua Kuo Feni, që mburr rregullimin në rrugë «marksiste-leniniste» të nacionaliteteve dhe të kombësive në Jugosllavi, është një provokacion i hapët kundër Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë.** Kjo në mënyrë të veçantë është një padrejtësi flagrante që bëhet nga një revizionist, nga një imperialist, kundër kauzës së shqiptarëve në Kosovë, në Mal të Zi e në Maqedoni. Por një gjë e tillë tregon shumë gjëra:

**E para, se problemi i kombësive dhe i pakicave kombëtare në Jugosllavi nuk është zgjidhur drejt.** Këto pakica kombëtare trajtohen si në skllavëri nga kombësitë më të mëdha, prandaj zgjidhja e padrejtë që i bëhet çështjes së atyre kombeve dhe kombësive duhet të mbështetet nga dikush. Dhe kjo dikush është Kina revizioniste.

**E dyta, në armiqësi të hapët me Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë zoti Hua Kuo Fen e ngre këtë çështje për t'u thënë shqiptarëve të Kosovës që fati i tyre dhe fati i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë është dhe duhet të jetë i lidhur me Jugosllavinë titiste.** Kjo do të thotë se Hua Kuo Feni zbaton teorinë e përçapjet antishqiptare, antimarksiste të Çu En Lait.

**E treta, çështja që ngre Hua Kuo Feni indirekt nxit ndjenjat e bashkimit të shqiptarëve që jetojnë në Jugosllavi me Shqipërinë.** Natyrisht, nga njëra anë mbështetja që ai u bën titistëve për zgjidhjen e problemit të pakicave

kombëtare është në favorin e Jugosllavisë, por nga ana tjetër, kjo mbështetje i acaron shqiptarët kundër Federatës dhe kundër Kinës. Një gjë e tillë, sigurisht, mund të krijojë edhe incidente të padëshirueshme që mund të bëhen shkas që titistët të marrin masa represive kundër shqiptarëve të Jugosllavisë.

**Pakicat kombëtare në Jugosllavi, zgjidhjen e problemit të të cilave e mbështet Hua Kuo Feni, nuk janë të pakëta, se atje jetojnë shqiptarë, si në Kosovë, në Maqedoni, në Mal të Zi dhe në Zarë (kjo e fundit është një qendër e vogël ku banojnë shqiptarë, të ikur që në kohët e vjetra, që në kohën e Skënderbeut), ka gjithashtu edhe pakica të tjera, sidomos rumunë, hungarezë e maqedonas.** Për këta të fundit vihet një pikëpyetje: janë maqedonas probullgarë apo proserbë? **Natyrisht, regjimi titist ka marrë masa për këtë dhe ka krijuar një republikë të veçantë me emrin Maqedoni, por që në realitet është një republikë hibride ose me dy-tri nacionalitete bashkë, me shqiptarë, me maqedonas, me pakicë bullgare autentike, me turq dhe me ciganë.**

Të tilla zgjidhje i ka dhënë titizmi çështjes së Maqedonisë, e cila ka qenë dhe aktualisht po bëhet çdo ditë e më shumë mollë shërr midis Bullgarisë dhe Jugosllavisë (është e qartë se prapa Bullgarisë qëndron Bashkimi Sovjetik).

Në përgjithësi ngritja e problemit nacional në Jugosllavi nga zoti Hua Kuo Fen është një mbështetje për titizmin, gjoja për ta shtyrë e për ta fuqizuar këtë kundër Bashkimit Sovjetik. Sa do të ecë Titoja në rrugën e qëllimeve luftënxitëse imperialiste të Hua Kuo Fenit, këtë do ta shohim, por ky i dyti është plotësisht në terren jo vetëm antimarksist, por edhe antihistorik e në kundërshtim me pikëpamjet e shtruarra më parë nga Mao Ce Duni, flamurin e të cilit gjoja e mban lart.

Hua Kuo Feni nuk di, ose bën sikur nuk di, që Jugo-

sllavia është pjellë e Traktatit të Versajës, pjellë e imperializmit francez, atij amerikan dhe anglez, dhe që Titoja e ruajti pas Luftës së Dytë Botërore. **Vepër e Konferencës së Ambasadorëve dhe e Traktatit të Versajës është veçanërisht «zgjdhja» e çështjes së shqiptarëve të Kosovës, të Maqedonisë e të Malit të Zi.** Domethënë ishin imperialistët ata që «zgjdhën» problemin e pakicave kombëtare në Jugosllavi, që i shkëputën Shqipërisë një pjesë të madhe të territorit dhe të popullsisë së saj dhe ia dhu-ruan kralit serb. Kështu, **Titoja nuk rregulloi dhe nuk zgjidhi asgjë për sa u përket kombësive dhe pakicave kombëtare, se këto «i kishin zgjidhur» të tjerë imperialistë, ai vetëm e adoptoi plotësisht atë zgjidhje dhe eci në rrugën e kralëve serbë, në mos më keq se ata.**

Le t'i marrë e t'i lexojë Hua Kuo Feni shkrimet e një varg serbomëdhenjve, të cilët në parlamentin e kralëve të Serbisë kanë trajtuar problemin e likuidimit, të gjenocidit të popullsisë shqiptare në Kosovë dhe në Maqedoni, në mënyrë që vendet ku jeton kjo popullsi të kolonizoheshin gati totalisht me serbë e me malazezë. Pra, një pjesë e shqiptarëve të likuidohej, një pjesë të dëbohej në Shqipëri, një pjesë tjetër, myslimanë, gjoja turq, të kalonte në Turqi dhe të tjerë të shpërndaheshin kashtë e kokërr në gjithë Jugosllavinë ose të lejoheshin të emigronin në vende kapitaliste, ku të punonin si skllëvër. **Këto «teori» u vunë në zbatim nga krali i Serbisë. Dhe autori i këtyre propozimeve në akademinë e kombësive dhe në parlamentin e carit të Serbisë, në kohën e çlirimit dhe të pasçlirimit, u bë ministër në kabinetin e Titos dhe tash rron akoma e ruan një post në kryesinë e studimeve të popujve të Jugosllavisë<sup>1</sup>.** Këto dokumente aktualisht janë zbuluar dhe Hua Kuo Feni do të bëjë

<sup>1</sup> Është fjala për dr. Vaso Çubrilloviq — një nga ministrat e qeverisë së Titos, pas Luftës së Dytë Botërore, anëtar i LKJ, i Akademisë së Shkencave të Serbisë e të Bashkimit Sovjetik.

mirë t'i lexojë, ose ne do të gjejmë rastin që t'ia vëmë në dukje atij këto, që të shohë poshtërsinë dhe padrejtësinë e tij të madhe që bën, kur afirmon një absurditet të tillë se problemi i pakicave kombëtare në Federatën Jugosllave qenka zgjidhur në rrugë «marksiste-leniniste», dhe kur ngacmon një çështje, që Shqipëria vetë nuk e ka ngritur ndonjëherë si një problem rivendikimi të territoreve të grabitura nga mbretëria serbokroate dhe nga mbretëria titiste.

Ne shohim se Hua Kuo Feni, duke ardhur në Ballkan e duke llogotitur të tilla profka, ka për qëllim që të krijojë këtu një situatë të acaruar në një shkallë të lartë kundër socialimperializmit sovjetik, që ka synime ndaj Jugosllavisë, Shqipërisë dhe gjithë Ballkanit, dhe që nga ky incident të shkaktojë një konflagracion të madh në Evropë.

**Hua Kuo Feni, me veprimet e tij, me shtruarjen e të tilla problemeve në Beograd, harron Sarajevën, e cila ka qenë mina që i vuri zjarrin «fuçisë së barutit» dhe u ndez Lufta e Parë Botërore. Kjo ishte rezultat i përgatitjeve për luftë midis Gjermanisë së Kaizer Giomit e perandorisë së Franc Jozefit, nga një anë, dhe imperializmit francez, anglez dhe rus, nga ana tjetër, me qëllim që të rindanin zonat e influencës veçanërisht në Evropë dhe pastaj territoret jashtë Evropës. Mina që e hodhi fuçinë në erë ishte Sarajeva, plumbi që vrau princin austriak Ferdinand. Ai që qëllloi mbi të ishte një serb, por prapa tij ndodhej atasheu ushtarak rus, shefi i sigurimit serb të Beogradit.**

Pra, Hua Kuo Feni ka ardhur në Ballkan që nga Pekini për të ndezur një Sarajevë tjetër. Ne jemi shumë vigjilentë në këtë drejtim. Edhe popujt e Jugosllavisë e popujt e tjerë të Ballkanit duhet të jenë vigjilentë përpara këtyre intrigave të mëdha që luan Kina në kurriz të tyre. Vigjilentë, po ashtu, duhet të jenë edhe popujt

e shteteve të tjera imperialiste të Evropës. Bota të mos harrojë Sarajevën!

Këtu ne duhet të shohim edhe një çështje tjetër. **Mao Ce Duni, siç e dimë, në një bisedë që ka bërë me një grup parlamentarësh socialistë japonezë, kritikoi Stalinin dhe aleatët e tjerë që përfunduan Luftën e Dytë Botërore me fitore, se kishin bërë padrejtësi në rregullimin e kufijve të vendeve të ndryshme të Evropës dhe të Azisë.** Natyrisht, kuptohet përse e predikoi Mao Ce Duni tezën për rregullimin e atyre «padrejtësive» që ishin bërë pas Luftës së Dytë Botërore nga Stalini e aleatët e tjerë. **Mirëpo zoti Hua Kuo Fen për ato «padrejtësi», që u bënë, pra, pas Luftës së Dytë Botërore e pranon tezën e Mao Ce Dunit, kurse për padrejtësitë e mëdha që u janë bërë kombeve të tjera nga Lufta e Parë Botërore grabitqare imperialiste dhe veçanërisht padrejtësitë që i janë bërë popullit shqiptar, ai nuk ndjek vijën e Mao Ce Dunit, përkundrazi, shkon në kundërshtim me të. Ai aprovon kështu ato padrejtësi flagrante që kanë bërë fuqitë imperialiste.**

Natyrisht, Hua Kuo Feni nuk mund të bëjë ndryshe, për arsye se me Titon, si dy revizionistë, si dy shërbëtorë të imperialistëve, nuk mund të flasin për rregullimin e padrejtësive, përkundrazi, në akord me njëri-tjetrin përpiqen dhe luftojnë që padrejtësitë të rforcohen dhe të ruhen me egërsi. **Këta përpiqen që të gjithë imperialistët, amerikanë, anglezë, francezë, jugosllavë etj., që kanë bërë ato të këqija, ato padrejtësi të mëdha ndaj popujve, të bashkohen së toku dhe të ruajnë pasuritë e grabitjet e tyre, të ruajnë statukuonë në Evropë për veten e vet dhe të futen në një luftë kundër socialimperializmit sovjetik.**

Pra, duket qartë politika e pabesë, koniunkturale, praktikiste, kapitaliste dhe ekspansioniste e Republikës Popullore të Kinës. Është e qartë se udhëheqja kineze, që nga koha e Mao Ce Dunit e deri tash, ka synuar dhe synon që Kina të bëhet një fuqi e madhe hegjemone në

botë, bile të zaptojë të gjithë botën. Domethënë me politikën e saj ajo ka synuar e synon që të bëjë ligjin kudo në botë, të krijojë një botë të re, ku të dominojë raca e verdhë dhe njerëzimi të orientohet drejt një vije bastarde antinjerëzore, që do të jetë pjellë e trurit të këtyre elementëve *paranoiaque*, hysterikë, fashistë që dominojnë aktualisht Kinën.

Si mundet që njerëzit përparimtarë të botës të mos thellohen në këto probleme kaq të mëdha, të mos thellohen në këtë politikë kineze plot intriga dhe rreziqe për njerëzimin dhe të mos mobilizohen për të luftuar këtë politikë dhe këto orvatje antinjerëzore që nxitin luftën imperialiste grabitqare në kurriz të popujve të botës? Me doemos ne, pavarësisht se jemi një popull i vogël e një Parti e vogël, duhet të ngremë zërin kundër kësaj vije antinjerëzore, kapitaliste dhe ta demaskojmë atë në të gjitha shfaqjet e saj, në të gjitha përpjekjet dhe aleancat që ajo bën, në të gjitha veprimet që kryen, se Kina aktualisht po bën një politikë jashtëzakonisht të shfrenuar dhe të zgjeruar. Për këtë politikë që po bën ajo ka mbështetjen e imperializmit botëror. Kina ka vënë frenat në dhëmbë dhe nuk ka marrë parasysh se bota jo vetëm nuk e pranon zhvillimin e një politike të tillë, por e karakterizon dhe e lufton atë, ashtu siç është në të vërtetë, një politikë imperialiste.

Udhëheqja kineze nuk do të dijë se ç'thotë bota, ashtu siç nuk donte të dinte Hitleri në kohën e tij se ç'thoshte opinioni botëror kundër kërkesave, pretendimeve dhe përgatitjeve të tij për luftë. Një situatë të tillë ne po shohim të zhvillohet aktualisht nga udhëheqja kineze. Ato qarqe a persona përgjegjës që nuk e kuptojnë dhe nuk thellohen ta kuptojnë këtë situatë që ka krijuar Kina, në bashkëpunim të ngushtë me imperializmin amerikan e kapitalizmin botëror, ato bëjnë një krim të madh ndaj gjithë njerëzimit, ndaj popujve e vendeve të veta. Në këtë drejtim duhen hapur mirë sytë.

E MARTË

29 GUSHT 1978

### TREKËNDËSHI I SUPERFUQIVE

**Çështja e Kinës do të na preokupojë vazhdimisht, pse ajo me politikën e saj po kërcënon botën me një luftë të re botërore grabitqare, imperialiste. Kina ka hyrë me të dyja këmbët në këtë rrugë armiqësore kundër popujve dhe, pa i fshehur as edhe një grimë dhe në asnjë mënyrë synimet e saj, po ndërmer të gjitha masat që të krijojë trekëndëshin e superfuqive, Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Bashkimit Sovjetik dhe vetë Kinës, dhe kështu të sundojnë mbi shtetet dhe mbi popujt, të shtypin çdo revolucion e çdo luftë nacionalçlirimtare të popujve dhe të dominojnë botën nga çdo pikëpamje. Ky është qëllimi i Kinës, të cilin udhëheqja e saj, që nga Mao Ce Duni dhe deri te Hua Kuo Fen i e Ten Hsiao Pini, e ka shprehur haptazi. Mao Ce Duni ka thënë që kinezët duhet të sundojnë botën.**

Kjo pikëpamje tash është e qartë. Në politikën e Kinës sot po vihet në zbatim kursi i shtetit të madh, i fuqisë së madhe, i hegjemonisë botërore, në atë rrugë, me atë politikë dhe me ato masa që mund t'i arrihet këtij objektiv, domethënë, duke luftuar kundër marksizëm-leninizmit, kundër socializmit dhe duke eliminuar një nga superfuqitë.

Dy superfuqitë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Sovjetik, natyrisht, nuk e duan ngjitjen e Kinës në një shkallë me të, por kjo nuk do të thotë që

njëra nga këto superfuqi, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe kapitali botëror, të mos bëjnë me të punën e vet. Këta e financojnë Kinën që të realizojë planet e saj për t'u bërë një fuqi kapitaliste, një bastion kapitalist kundër revolucionit proletar dhe luftërave nacionalçlirimtare. Një gjë e tillë do të nxitë edhe kontradiktat që kanë filluar e do të shtohen më shumë në të ardhmen midis Kinës dhe Bashkimit Sovjetik, për arsye se Shtetet e Bashkuara të Amerikës ndihmojnë njëkohësisht si Bashkimin Sovjetik, ashtu edhe Kinën. **Kjo do të thotë se imperializmi amerikan dhe kapitalizmi botëror e dozojnë ndihmën e tyre ndaj dy superfuqive të tjera.** Për ta socialimperializmi sovjetik është një fuqi e madhe imperialiste me një industri dhe me një ushtri të fuqishme dhe të modernizuar, kurse Kina, aktualisht, ka potencial vetëm nga popullata, se nga pikëpamja ekonomike e ushtarake ajo është shumë prapa. Dhe këto fuqi imperialiste, domethënë imperializmi amerikan dhe kapitalizmi botëror, që ndihmojnë Kinën, e dinë fare mirë se programi i caktuar nga Kina, që brenda këtij shekulli të bëhet një superfuqi, nuk do të realizohet për shkak të prapambetjes së saj të madhe.

Kina, natyrisht, do të fuqizohet, por jo në atë shkallë që mendon dhe aspiron ajo. Edhe fuqitë e tjera kapitaliste do të fuqizohen gjatë kësaj kohe, kuptohet në qoftë se të dyja palëve politika u ecën si thika në gjalpë. Shkenca marksiste-leniniste, dialektika dhe zhvillimi materialist historik i shoqërisë na mësojnë se situatat nuk zhvillohen sipas dëshirës së imperializmit, që është faza e fundit e kapitalizmit. **S'ka dyshim që një gjë e tillë do të krijojë kontradikta të thella midis vetë superfuqive dhe midis tyre dhe shteteve e popujve të tjerë, që shfrytëzohen nga këto superfuqi.**

Prandaj politika e këtyre tri superfuqive përbën aktualisht një rrezik të madh për botën, pse që të tria

**këto përpiqen të dominojnë mbi njëra-tjetrën, kuptohet, në kurriz të shteteve më të dobëta kapitaliste dhe gjithë popujve të botës në përgjithësi.**

Kina haptazi ndërmerr aksione fillestare me karakter të gjerë me dy qëllime:

**Së pari, që të sigurojë kredi, të marrë teknologji moderne nga kush të mundë dhe të sigurojë zhvillimin e kulturës e të arsimit për përdorimin e një teknologjie të këtyllë.**

**Së dyti, të bëjë një propagandë në favor të vet, të aleatëve amerikanë dhe të borgjezisë kapitaliste botërore, të japë në këtë fushë ndihmë efektive pro tyre dhe kundër Bashkimit Sovjetik.** Prandaj shohim që Kina po dërgon nga të katër anët emisarët e saj për këto dy qëllime. Vetë Hua Kuo Feni ka dalë me dhisk për ndihma ekonomike dhe për propagandë prokineze e pro-amerikane.

Në Evropë, pa neglizhuar kontinentet e tjera, shohim që Kina ka vënë të gjitha forcat e saj për të mbështetur ato aglomeracione politiko-ushtarake-ekonomike që mendon se ekzistojnë, i ndihmon që të konsolidohen dhe të mbrohen nga propaganda subversive e sovjetikëve. Këtë propagandë subversive ajo e quan paraprijëse të një lufte të re botërore që Bashkimi Sovjetik do t'i deklarojë Evropës. Por Kina me pseudoideologjinë e saj përpiget të mbytë çdo tentativë revolte dhe revolucionit të proletariatit kundër fuqive kapitaliste ose revizioniste në Evropë. Prandaj ne shohim që Kina të mbështetë në Evropë, haptazi, Tregun e Përbashkët Evropian, që është gati një superfuqi ekonomike dhe ushtarake. Nga ky aglomerim ajo kërkon kredi, teknologji dhe njëkohësisht bën propagandë, duke i këshilluar shtetet kapitaliste, antisovjetike të regjura, që jo vetëm të kenë mendjen nga rreziku sovjetik, por të armatojnë e të jenë gati për të sulmuar.

Kina mbështetet më shumë te Republika Federale e Gjermanisë, sepse njeh potencialin e saj ekonomik e ushtarak dhe epërsinë e saj në Tregun e Përbashkët Evropian. Ajo mbështetet, gjithashtu, tek Anglia, më rrallë te Franca dhe përpiget të futë këmbët në Ballkan. Për t'ia arritur këtij qëllimi, Kina, meqenëse nuk mundi ta thyente Shqipërinë socialiste ose ta bënte këtë revizioniste si veten, dhe meqë Partia jonë e demaskoi ideologjinë e saj kapitaliste, atëherë pothuajse i preu të gjitha marrëdhëniet me ne. Edhe marrëdhëniet diplomatike qëndrojnë në një fije peri, asnjë veprim nuk zhvillohet, veçse ne kemi ambasadën tonë në Pekin dhe ata kanë të tyren në Tiranë.

Në këtë situatë Kinës në Ballkan, hëpërhë, i duhej të zhvillonte aktivitetin e vet në drejtim të Jugosllavisë dhe të Rumanisë. Këto dy shtete janë revizioniste dhe puqen plotësisht me pikëpamjet ideologjike të saj. Por edhe për sa u përket qëndrimeve politike, Jugosllavia e Titos dhe Rumania e Çausheikut puqen me politikën kineze. Domethënë të dy këto shtete, Jugosllavia dhe Rumania, kjo e fundit në pozita më të vështira se Jugosllavia, në thelb kanë qenë e janë antisovjetike, janë për një politikë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe me kapitalizmin botëror. E tërë politika e tyre, veçanërisht e Titos, është një politikë në mbështetje të këtij kapitalizmi. Por në këtë rajon, natyrisht, nuk ekzistojnë vetëm Jugosllavia dhe Rumania, por edhe Shqipëria, Bullgaria, Greqia dhe Turqia.

Kinës, që të krijojë rrethin ose «kordonin sanitar» kundër Bashkimit Sovjetik, i duhet të ushtrojë ndikimin e saj edhe në shtetet e tjera të Ballkanit. Me Shqipërinë ajo i lau duart përfundimisht në të gjitha drejtimet. Mbetet Greqia, por kjo nuk ka interesa të mëdhenj që të lidhet aq shumë dhe verbërisht me Kinën. Greqisë do t'i interesonte të bënte tregti me Kinën dhe do të bëjë

tregti me të, por pa u influencuar në asnjë mënyrë nga planet hegjemoniste të kinezëve. Ne shohim se Greqia simpatizon NATO-n dhe veçanërisht Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Anglinë dhe Francën, por, edhe në këtë të ashtuquajtur miqësi me këto shtete, konstatojmë se nuk mungojnë divergjencat, nuk mungojnë lëkundjet.

Për sa i përket Turqisë, kjo është shumë larg Kinës dhe tradicionalisht në çdo pikëpamje është e lidhur ngushtë me imperializmin amerikan. Është e vërtetë se socialimperializmi sovjetik është rreziku i Turqisë, por s'është Kina ajo që do t'i vijë në ndihmë asaj, në rast të ndonjë lufte, ose të ndonjë sulmi sovjetik.

Për këto arsye Titoja ka qenë shumë i matur në bashkëbisedimet me Hua Kuo Fenin. Pavarësisht se është një antisovjetik, që në fillim të vizitës Titoja i vuri pikat mbi i në bisedimet me Hua Kuo Fenin në Jugosllavi. Titoja do të bëjë një politikë të balancës, ai nuk do që miqësia me Kinën të jetë shkak për prishjen ose keqësimin e marrëdhënieve me fqinjët e me shtetet e tjera. Me fjalë të tjera, Titoja i tregoi Hua Kuo Fenit se nuk mund të futet në aventurën antisovjetike në ato forma e në ato rrugë që do Kina, pra nuk mund të futet në armiqësi të hapët me Bashkimin Sovjetik, se në armiqësi është me Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë. Po ashtu edhe nxitja kundër Bullgarisë do të bëhet sipas interesave të çastit dhe të diktatit që Bashkimi Sovjetik do të ushtrojë mbi Bullgarinë.

Kurse udhëheqja rumune, natyrisht, si agjenturë e sovjetikëve që është, ka në gjirin e vet forca që e duan lidhjen me Kinën, vetëm e vetëm për t'u shpëputur nga Bashkimi Sovjetik, megjithëse e dinë që ajo nuk mund të ndikojë në këtë drejtim; ka edhe të tjerë që janë pro-amerikanë, por ka edhe prosovjetikë. Sidoqoftë, udhëheqja aktuale e partisë dhe e shtetit në Rumani është në mëshirën e sovjetikëve.

**Pra, mund të themi se Hua Kuo Feni, gjatë vizitës në Ballkan pati sukses vetëm në paradat që iu bënë në Rumani, por ca më shumë në Jugosllavi, duke e kaluar në mes të popullit i cili tundte flamurë. Ndërsa, për sa u përket pikëpamjeve politike të tij, nuk mund të themi që pati sukses, veçse duhet vënë në dukje se Titos ai i thuri lavde, e bëri hero, shkurt e ngriti në qiell. Huaja foli, gjithashtu, për miqësinë me titizmin dhe nuk harroi t'i kërkonte ndjesë Titos për sulmet që Kina dhe Mao Ce Duni u kanë bërë atij dhe titizmit. Ai ngriti lart vetadministrimin jugosllav dhe, sigurisht, përveç kredive që duhet t'i ketë dhënë, i siguroi Jugosllavisë titiste tregje në Kinë. Dhe për të gjitha këto Titoja dhe banda e tij nuk munguan ta nxirrnin këtë marionetë kineze me automobila e me motoçikleta në mes popullit të Beogradit, Shkupit, Zagrebit e Brionit, t'i thoshin fjalë të mira, të propagandonin me forcë vetadministrimin jugosllav dhe, në mënyrë të veçantë, çështjen e partisë.**

**Jugosllavia është një «shembull i madh» për Kinën për sa i përket çështjes se si duhet likuiduar partia, ajo parti që s'ka qenë kurrë marksiste, por që duhet, qoftë edhe në formë e në emër, në mënyrë të falsifikuar, të duket se është një parti e proletariatit, domethënë një parti marksiste-leniniste. Hua Kuo Feni në Jugosllavi nuk e zuri në gojë fare marksizëm-leninizmin dhe këtë nuk e bëri pa qëllim. Ai i është adaptuar që përpara formulës revizioniste të titistëve dhe të eurokomunistëve. Pra, Lenini dhe Stalini nuk mund të kenë vend në ideologjinë kapitaliste kineze. Por edhe Karl Marksi do të qëndrojë vetëm si emër, ai do të zhduket nga ideologjia e tyre.**

Ne do të shikojmë çfarë rruge do të marrë Kina, por jemi të sigurt se atje do të vendoset kapitalizmi. **Pra-ndaj klikës aktuale kineze, që të fuqizojë vijën e saj kapitalisto-imperialiste, që të thithë dhe të përfitojë nga**

teknologjia e re, nga kreditë e shumta që po merr, i duhet të gjejë format e përshtatshme ekonomike strukturore dhe superstrukturore për të krijuar një sistem të ri kapitalist.

Natyrisht, në krijimin e këtij sistemi të ri kapitalist, do të mbahet parasysh madhësia e territorit kinez. Edhe në ndarjen administrative Kina do të ketë parasysh eksperiencën e vet, eksperiencë që nuk ka qenë socialiste, por kapitaliste me forma socialiste. Ajo do të bëjë një shartim të kësaj eksperience me vetadministrimin jugosllav, kuptohet, deri në njëfarë shkalle, për arsye se vetadministrimi jugosllav nuk mund t'u përshtatet si duhet territorit të gjerë dhe popullsisë së madhe kineze. Pastaj, ndryshe është situata në Jugosllavi, ndryshe është në Kinë. Megjithatë, ne do të shohim se si do të ecë ky proces në Kinë se përveç vetadministrimit jugosllav, për vendosjen e kapitalizmit, ajo, në radhë të parë, do të marrë si model ndërtimin kapitalist të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të Japonisë. Këto dy shtete aktualisht janë aleate të Kinës dhe eksperiencat e tyre do të jenë pasqyra e ardhshme e ndërtimit të një strukture dhe superstrukture të re në Kinë.

Kapitalistët kinezë i kanë sytë te Japonia, sepse ata kanë parë që ajo, e djegur dhe e shkatërruar nga Lufta e Dytë Botërore, mundi në një kohë relativisht të shkurtër, me ndihmën e imperializmit amerikan, të bëhet një fuqi e madhe botërore. Atëherë këta kapitalistë kinezë thonë: Pse të mos shohim si e kanë ngritur japonezët fuqinë e tyre kapitaliste, imperialiste e militariste? Ashtu siç e kanë ndërtuar ata, po ashtu ta ndërtojmë edhe ne.

Pra në Kinë, mendoj unë, do të krijohen shoqëri e truste të mëdha kapitaliste si në Japoni, të cilat do të likuidojnë industrinë e vogël, duke krijuar në këtë mënyrë kuadrot dhe klasën që do t'i drejtojnë këto shoqëri të mëdha në bashkëpunim me shoqëritë e tjera shumë-

**kombëshe dhe veçanërisht me shoqëritë japoneze, amerikane dhe me ato të Gjermanisë Perëndimore.**

Traktati Kino-Japonez, siç e kam thënë dhe herë të tjera, është një traktat që kërcënon botën me një luftë të re dhe është e qartë se ai u bë nën patronazhin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Ky traktat është në favorin e kapitalizmit në botë, veçanërisht në favor të kapitalizmit kino-japonez.

Natyrisht, Kina kërkon që, tok me Japoninë dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të ruajë të paktën statusin në Lindjen e Largme, në Azinë Juglindore, në Indi dhe në Gjirin Persik, në mos e shtriftë dominimin e saj në gjithë këtë pellg. Vajtjet e ardhjet e kinezëve në Filipine, në Pakistan, Afganistan dhe tash së fundi në Iran, si dhe buzëqeshjet ndaj Indisë, tregojnë qartë synimet e tyre ekspansioniste.

Me Vietnamin udhëheqësit revizionistë kinezë kanë hyrë në një grindje të thellë dhe shkaktarë për këtë janë vetë, sepse edhe herë të tjera kanë shkaktuar grindje. Ndërkaq ata përpiqen që Korenë dhe Kim Ir Senin, t'i kenë në anën e tyre, natyrisht derisa ky të mos luajë përsëri kartën e sovjetikëve. Është e qartë se kur Kim Ir Seni të shikojë se i ka ardhur fundi dhe kinezët nuk janë më në gjendje ta financojnë, me siguri do të luajë kartën tjetër. Por revizionistët kinezë, duke u afruar me Korenë, duke u përpjekur që ta kenë atë nën influencën e tyre, përpiqen njëkohësisht që Koreja e Jugut të qëndrojë nën influencën amerikane. Ata veprojnë ashtu siç kanë vepruar deri tash edhe për Tajvanin, problemi i të cilit nuk hidhet më në tryezë si më parë. Përkundrazi, udhëheqësit kinezë dalin kundër bashkimit të Tajvanit me Kinën. Dhe, pas ca kohësh, kur Kina të zërë pak a shumë ato pozita që synon, ajo do ta konsiderojë Tajvanin si një provincë autonome të saj. Me fjalë të tjera, me këtë Kina do t'i tregojë botës se çështja e Tajvanit u zgjidh me sukses të madh në mënyrë paqësore!

**Kina**, siç thashë më lart, ka synime edhe në Gjirin Persik. Për këtë flet fakti që sot, më 29 gusht, Hua Kuo Feni vete t'i bëjë vizitë shahut të Iranit, këtij monarku barbar mesjetar. Ai ia bën këtë vizitë shahut në një kohë kur në të gjitha qytetet e Iranit po zhvillohen demonstrata e po vriten me qindra njerëz të popullit, në një kohë kur fshatarësia iraniane vuan në tmerrin e urisë dhe të sëmundjeve të panumërta, kurse reaksionarët majmen me fitimet e mëdha që u vijnë nga nafta. Pra, kreu i udhëheqjes kineze vete në Iran pikërisht në këto kohë dhe kur qeveria e shahut, për arsye të revoltave popullore ra dhe u krijua një qeveri e re, e cila pardje bëri betimin. Unë pashë në televizor ceremoninë e betimit të qeverisë së Iranit, gjithçka bëhej tamam si në mesjetë. Kryeministri dhe të gjithë ministrat me radhë bënë betimin përpara shahut të Iranit dhe i puthën dorën. Në këto momente, në këto situata, Hua Kuo Feni kinez shkon në Iran të puthet, të bisedojë miqësisht me shahun e Iranit dhe ta ndihmojë atë në luftën kundër lëvizjes kryengritëse të popullit iranian. Kjo është e qartë. Politika kineze është një politikë fashiste, një politikë kundërrevolucionare, e ujdisur me imperializmin amerikan kundër çdo lufte nacionalçlirimtare të popujve.

Natyrisht, vajtja e Hua Kuo Fenit në Iran do ta discreditojë akoma më shumë Kinën. Ne ia çorëm maskën këtij regjimi antimarksist, kapitalist dhe socialimperialist. Por udhëheqja kineze ka arritur në atë shkallë saqë nuk i bëhet vonë në quhet apo nuk quhet më socialiste Kina. Ajo nuk e peshon fare opinionin e popujve, për arsye se qëllimet e saj janë antipopullore. Kina synon të dominojë mbi ta. Këtë dominim ajo përpiqet ta arrijë sidomos në vendet afrikane, që janë, si të thuash, akoma të prapambetura ekonomikisht, të shfrytëzuara e të shtypura në kulm nga kapitalizmi amerikan dhe perandoritë e vjetra, të cilat kanë ruajtur në këto vende privilegjet, bankat,

komptuaret, trustet, koncernet e tyre dhe shfrytëzimin. Pikërisht në kontinentin afrikan Kina shpreson të infiltrohet si gjarpri, me lëkurë të verdhë, për t'i bindur njerëzit me ngjyrë të zezë në drejtësinë e vijës së saj pseudosocialiste, duke pretenduar se tok me ta bëhet një barazh i fortë kundër socialimperializmit sovjetik dhe njëkohësisht edhe fuqive të tjera imperialiste. Ajo përpiqet t'u lërë të kuptojnë atyre se ndihma e saj është një ndihmë çlirimtare për ta.

Në përgjithësi kjo është strategjia e Kinës dhe e Hua Kuo Fenit, që po bredh e do të bredhë në të ardhmen në shumë vende të tjera të botës. Një gjë do të fitojë Hua Kuo Feni me këto vizita jashtë Kinës: reklamën që do t'i bëjë vetes brenda në vend, nëpërmjet dokumentarëve e telekronikave që do të shfaqen, për t'u treguar masave të gjera të popullit kinez se te ky ato kanë një «president të madh», që e zëvendësoi aq mirë Mao Ce Dunin, bile po e errëson pothuajse krejt figurën e Maos. Këtë gjë, do t'i thotë popullit Hua Kuo Feni, shiheni me sytë tuaj, këtë e vërtetojnë udhëtimet e mia «triumfale» në Bukuresht, në Beograd, në Teheran, e më vonë në Bon, në Londër e në vende të tjera.

Kjo, natyrisht, i shërben politikës së gënjeshtërt të udhëheqjes kineze, por jo për shumë kohë se fraksioni i Ten Hsiao Pinit, i cili rri në rojë dhe me siguri ka kontraktat me grupin e Hua Kuo Fenit, nuk do ta pëlqejë këtë tamam e reklamë që po i bëhet kryetarit të padëshiruar. Prandaj vizitat pompoze, por pa rezultate, pra, jo siç i do udhëheqja kineze, do të kenë edhe pluset, edhe minuset e tyre brenda në Kinë. Këto do të bëjnë që kontradiktat të thellohen dhe qëllimet e ndërtimit me aq shpejtësi e me aq siguri të kapitalizmit atje të hasin në vështirësi të panumërta. Megjithatë koha do t'i vërtetojë pikëpamjet tona.

Për sa i përket vizitës së tij në Jugosllavi e në Ru-

mani, ne do të jemi vigjilentë, sepse Huaaja, Titoja dhe Çausheku kanë biseduar hollësisht kundër vendit tonë, kanë biseduar se si t'i dëmtojnë, t'i dobësojnë dhe t'i likuidojnë pushtetin e demokracisë së vërtetë proletare, Partinë marksiste-leniniste të Punës dhe socializmin në Shqipëri. Por ata do të na marrin të keqen, sepse ne do ta forcojmë situatën, brenda dhe jashtë, do ta ndërtojmë socializmin me forcat tona dhe do t'u tregojmë miqve dhe gjithë botës se socializmi është i pavdekshëm, se një popull i vogël, që u qëndron besnik parimeve themelore të doktrinës së Marksit, Engelsit, Leninist dhe Stalinit, bëhet shembull i një force të madhe.

Sot, kur avioni po transportonte Hua Kuo Fenin për në Teheran te shahinshahu i Iranit, nga Teherani nisej për në Moskë një avion tjetër, që transportonte princshën Ashraf, motrën dhe këshilltaren e shahut, mikeshën e Mao Ce Dunit, të Çu En Lait dhe të Ten Hsiao Pinit, mikeshën e ish-ambasadorit amerikan Henderson. Kështu që shahu i Iranit po merr masa që të mos zemërojë sovjetikët, që edhe me ta punët t'i shkojnë mirë.

Shahu është një personalitet që rron në sajë të fuqive të mëdha. Njihën historia e ndyrë e jetës së tij, shtypja dhe barbarizmat ndaj popullit në kohën e borgjezit demokrat Musadek, që përkrahej nga partia «Tudeh», kur shahu u detyrua të lërë fronin dhe të nisej me avion për në Romë. Por gjatë kësaj kohe CIA, sipas atyre që kemi lexuar, pagoi lumpenin e Teheranit me nga një dollar për kokë, vuri në lëvizje tanket e komanduara nga gjenerali Zahedi, agjent i saj, i cili gjoja për të mposhtur kundërshtarët e Musadekut, sulmoi pallatin «Gjylamen», ku ndodhej qeveria dhe e arrestoi Musadekun. Kështu që ky u fut në burg. Hendersoni u kthye menjëherë në Teheran dhe i bëri telegram shahut që të kthehej nga

Roma. Ky erdhi me avion dhe përdori forcën derisa kryengritja e popullit të Iranit u mbyt. Sigurisht, pas kësaj, pasuritë e naftës u ndanë ose u rindanë më mirë. Kështu që Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në sajë të Hendersonit dhe të ndërhyrjes në favor të shahut, morën pjesën e luanit, anglo-persianët mbajtën pjesën më të vogël, kurse thërrimet i mbetën shahut.

Pra, të tillë lojë luajnë në kurriz të popujve shahu dhe miqtë e tij, qofshin këta amerikanë, kinezë apo sovjetikë. Irani është bërë një qendër intrigash dhe shahu e ndien të ftohtit e veriut rus, se brenda ziejnë azerbajxhanasit, të cilët u ngritën kundër tij, saqë në një kohë kryeministrit, Xhafar Sharif Emamit, iu desh të merrte masa drakoniane kundër tyre. Ky nuk i shtypi dot azerbajxhanasit e nxitur nga sovjetikët, por këta u tërhoqën. Megjithatë nuk do të na çuditë fakti që Rusia të kthehet përsëri në Iran, nga jashtë ose nga brenda, por më tepër mundësi ka nga brenda.

Këto ditët e fundit, pas formimit të qeverisë së re, kur gjithë anëtarët e kabinetit i puthën dorën me radhë shahut, ky u bë «reformator i madh demokrat» dhe lejoi krijimin e legalizimin e 16 partive. Të gjitha këto parti, me emra të ndryshëm, janë të djathta, besnike të reaksionit iranian. Mirëpo partinë «Tudeh» shahu nuk e lejoi të dilte nga ilegaliteti. Kjo parti mbështetet nga sovjetikët dhe këta me siguri do të kenë protestuar për këtë «padrejtësi» të shahinshahut «demokrat». Nuk është çudi që për këtë arsye vete princesha Ashraf në Kremlin, për t'u shpjeguar sovjetikëve përse nuk u rehabilitua partia «Tudeh» dhe për t'u thënë se do ta legalizojnë, por me kusht që të mos ngrihet kundër shahinshahut. Pra për të marrë njëfarë sigurie prej tyre.

Natyrisht, Kremlinin do të bëjë sikur do ta pranojë një gjest të tillë mënjanimi të shahinshahut por ai nuk heq dorë nga ndërhyrja. Medoemos shahu, që mbështetet

nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe nga Kina, por edhe nga gjithë imperialistët e tjerë që kanë fitime nga nafta e Iranit, do të qëndrojnë vazhdimisht mbi gjemba dhe mbi zjarr të ndezur kundër tij nga sovjetikët, nga reaksioni i jashtëm, nga mbreti Saud.

Në këtë situatë marksistë-leninistët duhet të organizohen dhe të propagandojnë me forcë të madhe, në radhë të parë, luftën kundër shahinshahut, kundër borgjezisë anadollake, perandorake, mesjetare të tij, kundër social-imperializmit sovjetik, që kërkon të hedhë kthetrat në këtë vend, kundër imperializmit amerikan, kundër imperializmit anglez e socialimperializmit kinez që kanë filluar të depërtojnë në punët e Lindjes së Mesme në favor të imperializmit amerikan dhe në favorin e vet.

E MËRKURË  
30 GUSHT 1978

## MAO CE DUNI NUK MUND TË KRAHASOHET ME STALININ

Në artikullin e fundit redaksional në gazetën «The Worker» të partisë së tij, Bërçi mban pozita të hapëta antimarksiste kundër Partisë së Punës të Shqipërisë në lidhje me vlerësimin që u bëjmë ne pikëpamjeve të Mao Ce Dunit. Për Bërçin Mao Ce Duni e Çu En Lai janë marksistë-leninistë të mëdhenj, kurse të gjithë ata që i kritikojnë, janë të grupit buharinist dhe të tipit të intelektualëve perëndimorë. Me fjalë të tjera, Bërçi e ndan udhëheqjen aktuale kineze të Hua Kuo Fenit dhe të Ten Hsiao Pinit nga udhëheqja e Mao Ce Dunit dhe e Çu En Lait. Për të, Kina, sa ishin gjallë Mao Ce Duni dhe Çu En Lai, qe një vend socialist dhe Partia Komuniste e Kinës një parti komuniste, por, sipas tij, pas vdekjes së tyre, ajo u rrëmbye nga revizionistët dhe renegatët Hua Kuo Fen dhe Ten Hsiao Pin. Kjo është teza e Bërçit, i cili bën një paralelizëm midis Kinës dhe Bashkimit Sovjetik, pra vë shenjën e barazimit midis ndërtimit të socializmit në Bashkimin Sovjetik, nën drejtimin e Leninit e të Stalinit dhe tradhtisë së hrushovianëve që e kthyen Bashkimin Sovjetik në një vend revizionist e socialimperialist me gjendjen në Kinë në kohën e Mao Ce Dunit dhe të Çu En Lait.

Kështu, ai mendon se në të dy vendet situatat janë identike, çdo gjë ka ngjarë njësoj, prandaj njësoj duhen

**trajtuar.** Për Bërçin Lenini dhe Stalini janë marksistë-leninistë, por për të janë po aq marksistë-leninistë edhe Mao Ce Duni e Çu En Lai. Ne që i kritikojmë pikëpamjet antimarksiste të Mao Ce Dunit, sipas tij, jemi buharinistë, me fjalë të tjera, jemi trockistë të rinj. Bërçi mban qëndrime të hapëta publike kundër Partisë së Punës të Shqipërisë, udhëheqjes sonë dhe e shpjegon botërisht atë që la me shkrim, kur ishte herën e fundit në Shqipëri. Pasi lexova këtë material, i kritikova pikëpamjet dhe qëndrimet e Bërçit dhe ai doli fishek, tregoi fytyrën e tij të vërtetë, si një renegat.

**Ky problem nuk shtrohet vetëm për Bërçin, por do të bëhet objekt i një lufte të ashpër ideologjike në lëvizjen komuniste ndërkombëtare. Si e kuptoj unë këtë luftë? Pikërisht në qëndrimin që do të mbahet ndaj pikëpamjeve të Mao Ce Dunit.** Pozicioni që ka marrë Partia jonë në këtë çështje, tashmë është i njohur. Aktualisht po mbahen edhe disa pozicione të tjera. Një nga këto është pozicioni i Bërçit, të cilin e theksova më lart, pra, që ndan Mao Ce Dunin e Çu En Lain nga klika Hua Kuo Fen-Ten Hsiao Pin.

**Një pozicion tjetër, më parë se ai i Bërçit, është pozicioni i Hillit të Australisë, i cili mbron en bloc udhëheqjen kineze.** Domethënë, sipas Hillit, Kina kurdoherë ka ndërtuar socializmin, është një vend socialist, Mao Ce Duni është një marksist-leninist i madh, Çu En Lai është një marksist-leninist i dashur, Hua Kuo Fen dhe Ten Hsiao Pini janë shpëtimtarët e socializmit dhe të revolucionit në Kinë dhe është «katërshja» ajo që i ka bërë tërë të këqijat, prandaj të gjithë ata që janë kundër pikëpamjeve të tilla, janë antimarksistë. **Në aparençë duket sikur pozita e Hillit ndryshon nga pozita e Bërçit, por që të dy aty janë, përkrah njëri-tjetrit.** Bërçi, duke mbrojtur Mao Ce Dunin dhe Çu En Lain, pavarësisht se i lufton Hua Kuo Fenin e Ten Hsiao Pinin, përsëri është me këta të

dy, sepse, ashtu si Hilli, nuk e ka dënuar Mao Ce Dunin, por vazhdon ta mbrojtë. Pra, Bërçi përdor një variant pak më të theksuar, me një nuancë më të ndryshme nga Hilli, por atje qëndron edhe ky.

**Ka edhe të tjerë që e heqin veten marksistë-leninistë, por që nuk janë dakord me tezën, sipas së cilës Mao Ce Duni nuk është marksist-leninist i madh, përkundrazi, thonë ata. Sipas tyre, Mao Ce Duni nuk duhet atakuar, por nuk kanë si t'i shpjegojnë dhe t'i kundërshtojnë faktet që vërtetojnë se vija e Mao Ce Dunit është një vijë antimarksiste.** Ata mbrohen me prova gjenerike, e barazojnë Maon me Stalinin dhe, kur u thuhet se Mao Ce Duni ka bërë gabime, përgjigjen se edhe Stalini ka bërë gabime. Po t'u thuash se Stalini s'ka bërë gabime, atëherë shprehen se as Mao Ce Duni nuk ka bërë gabime. Kur u thua se ka një ndryshim të madh midis tyre, mbasi Stalini ishte një marksist, nxënës i Leninit, që mbronte normat marksiste-leniniste të partisë së tij, ata ngulin këmbë se edhe Maoja i mbronte këto, por e gënjyen, e izoluan dhe, ashtu sikurse Stalini nuk i pa revizionistët, edhe Maoja nuk i pa!

**Të gjitha këto «fakte» të këtyre pseudomarksistëve, që dalin në mbrojtje të Maos, nuk kanë asnjë bazë reale, as teorike, pale praktike, se në praktikë e shohim qartë gjithë vijën që ka ndjekur Mao Ce Duni, e cila është një vijë antimarksiste dhe që në situatat aktuale rezultoi se ishte ndjekur me plot ndërgjegje.**

Në luftën e saj për të nxjerrë në shesh të vërtetën në lidhje me pikëpamjet e Mao Ce Dunit, në ishin këto marksiste apo jomarksiste, Partia jonë do të ndeshet me mendime udhëheqësish të partive e njerëzish të ndryshëm, që me ndërgjegje ose pa ndërgjegje e mbrojnë Mao Ce Dunin si marksist-leninist. Por çështjen unë e shtroj kështu: ata që e mbrojnë me ndërgjegje, janë revizionistët modernë, të cilët, duke qenë në shërbim të

kapitalizmit, i gënjejnë proletariatin dhe masat e gjera të popujve, me qëllim që këta të mos njohin se cilët janë armiqtë e rinj të tyre dhe, duke pasur besim në marksizëm-leninizmin, mendojnë se mund t'i mbështetin tek ata shpresat e tyre për çlirim.

☞ **Mirëpo revizionizmi jugosllav, revizionizmi sovjetik, revizionizmi i vendeve të lindjes, eurokomunizmi e aktualisht edhe revizionizmi kinez janë demaskuar e po demaskohen çdo ditë e më shumë si rryma kundërrevolucionare, antimarksiste, që u shërbejnë statukuosë së kapitalizmit e forcimit të tij nëpërmjet ndihmës që i japin për të mos u shkatërruar, për të mbajtur në këmbë e për të fuqizuar akoma më shumë imperializmin amerikan, socialimperializmin sovjetik, socialimperializmin e ri kinez dhe vendet e tjera kapitaliste të zhvilluara që të mos kalbëzohen dhe të mos shkatërrohen.**

☞ Qysh kur lindi teoria shkencore e Marksit, Engelsit, Leninit e Stalinit, borgjezia kapitaliste dhe të gjitha partitë e kapitalit, ku bëjnë pjesë edhe partitë revizioniste, u futën në luftë kundër saj që ta diskreditojnë e ta shtrembërojnë, ta errësojnë atë si teori e revolucionit dhe e proletariatit, si teorinë që është në themel të shembjes së rendit kapitalist dhe të ndërtimit të shoqërisë së re socialiste e komuniste. Praktikisht në Bashkimin Sovjetik dhe në vendet e tjera ish-socialiste lufta kundër marksizëm-leninizmit gjeti aplikimin e saj me anën e revizionizmit. Ne shohim se në të gjitha këto vende, me përjashtim të Shqipërisë, u vendos kapitalizmi.

☞ Në të gjithë botën ka mbetur një kështjellë e socializmit, e cila quhet «anakronike» nga i gjithë kapitalizmi botëror, sepse u qëndron ballë për ballë dallgëve të tërbuara të kapitalizmit botëror, të imperializmit e të revizionizmit, potencialit ekonomik-ushtarak, intrigave, diversionit dhe mashtrimeve të tyre.

☞ Pra, po i bëhet një luftë kësaj kështjelle të pampo-

shtur, të vogël, por që rrezaton atë shkencë të pavdekshme, që është marksizëm-leninizmi, dhe ngjall e fuqizon shpresat dhe luftën e proletariatit botëror. Natyrisht, të gjithë armiqtë e marksizëm-leninizmit do të bashkohen në këtë luftë kundër nesh, por ne do t'u qëndrojmë, sepse s'jemi vetëm. Në pushtet nuk ekziston më asnjë parti komuniste, përveçse në Shqipëri, por as më 1917-n nuk ekzistonte, megjithatë vetëm në Bashkimin Sovjetik u vendos pushteti i proletarëve. Por ky pushtet i proletarëve u vendos në Bashkimin Sovjetik që ishte një vend i madh, mund të thonë, që kishte një popull të madh në numër, kishte Partinë e bolshevikëve me Leninin në krye. Kjo është e vërtetë, por Partia e Leninit dhe e Stalinit, Partia e bolshevikëve dhe shteti i madh i proletarëve e rrezatuan kudo në botë ideologjinë marksiste-leniniste, të cilën sot e zbaton me besnikëri, në teori e në praktikë, në kushtet konkrete, Partia e Punës e Shqipërisë. Proletariati botëror aspiron që të shembë pushtetin kapitalist dhe ta marrë vetë në dorë pushtetin, ai e shikon Shqipërinë si një atdhe të tij, prandaj them se ne nuk jemi vetëm. Ne jemi një shtet ku janë në fuqi proletariati dhe pararoja e tij, Partia marksiste-leniniste, jemi një shtet drejt të cilit i ka kthyer sytë proletariati i të gjitha vendeve të botës.

☞ Kapitalizmi botëror e sheh se revizionizmi modern në të gjitha vendet është thikë me dy presa: nga njëra anë lufton revolucionin, dhe këtë ai e gjen të drejtë, por nga ana tjetër përpiqet edhe të dominojë në botë, domethënë kërkon të rindajë tregjet botërore në mes vendeve kapitaliste dhe vendeve revizioniste. Pra, ky transformim strukturor, reformist, i shkaktuar nga revizionizmi, nuk i pëlqen kapitalizmit botëror, por ky nuk është aq i fuqishëm sa ta gënjejë proletariatin e botës dhe popujt që vuajnë nën thundrën e kapitalit, që të mos luftojnë për liri, demokraci dhe përparim. **Prandaj atij i duhet mao-**

cedunideja, e cila nuk është demaskuar akoma plotësisht si një teori revizioniste. Borgjezisë dhe kapitalizmit u intereson shumë që ta ruajnë këtë si një atû të veçantë për të shtypur revolucionin, gjë që nuk mund ta bëjnë në atë shkallë revizionistët sovjetikë ose eurokomunistët, të cilët, si të tillë, pra, si revizionistë, tash janë bërë bajatë. Prandaj borgjezia nxit revizionistët, nxit agjenturat e saj që ta ruajnë me çdo mënyrë Mao Ce Dunin nga sulmet që mund t'i vijnë nga marksistë-leninistët dhe veçanërisht nga Partia e Punës e Shqipërisë, me qëllim që ta përdorë këtë si një element ideologjik korrodues, gërryes, shkatërrues kundër ideologjisë marksiste-leniniste, të ruajë nën «filozofinë marksiste-leniniste» të Maos gjoja thelbin e vërtetë «marksizëm-leninizmin» e kohëve aktuale, të kohëve moderne, të shoqërisë së konsumit, të industrializimit të madh etj., etj.

Pra, në këtë drejtim punon dhe do të punojë agjuntura e imperializmit dhe e kapitalizmit, si Bërçi, që, besoj unë, aktivizohet me ndërgegje. Por do të jenë edhe të tjerë që do ta mbrojnë Mao Ce Dunin për sentimentalizëm ose pse udhëheqja e ndonjë partie apo disa udhëheqës janë lidhur e komprometuar në këtë linjë, dhe, sa kohë kalon, ata komprometohen më tepër dhe bëhen të zellshëm në këtë drejtim. Këta do ta mbrojnë Mao Ce Dunin, Kina do t'i subvencionojë. Kështu, ne do të gjejmë përpara një fakti të ri, domethënë faktit që ekziston aktualisht: përçarjes në mes marksistë-leninistëve dhe Partisë Komuniste të Kinës, por do të asistojmë edhe në një përçarje tjetër, domethënë në mes marksistë-leninistëve të vërtetë dhe njerëzve ose partive që gjoja luftojnë kundër grupit të ri që erdhi pas Maos, por që e mbrojnë këtë, Çu En Lain dhe të tjerët që kanë vdekur.

Udhëheqja revizioniste kineze nuk e do Mao Ce Dunin, por për arsye taktike dhe strategjike nuk e hedh poshtë figurën e tij, pra nuk vepron si Hrushovi, sepse

krahasime në mes hrushovianëve dhe revizionistëve aktualë kinezë mund të bëhen fare kollaj. Por duhet pasur parasysh se në Kinë ekzistojnë rryma dhe grupe të ndryshme të fuqishme, kështu që disa do të mbështeten më shumë në figurën e Mao Ce Dunit, disa më pak, disa nuk do ta zënë në gojë fare.

Aktualisht të gjithë e përmendin Mao Ce Dunin, por jo shumë. Unë mendoj se Hua Kuo Fëni do ta ruajë më tepër nga të tjerët emrin e Mao Ce Dunit, me shpresë e synim që të eliminojë grupin e Ten Hsiao Pinit, duke shfrytëzuar faktin se populli kinez, një popull me tradita mistike, i ekzaltuar dhe jo i ngritur si duhet politikisht, e konsideron Mao Ce Dunin si njeri të pagabueshëm, si një perëndi, një Budë të kohëve moderne. Ten Hsiao Pini, po dihet, nuk e do Mao Ce Dunin, për arsye se ky i luftoi si atë edhe Liu Shao Çinë. Në goditjen që u bëri këtyre, Maoja nuk u nis nga pozitën marksiste-leniniste, por nga pozitën për pushtet personal. Edhe Teni lufton me këmbëngulje për pushtet personal, për vete dhe për shtresën e re kapitaliste, në lidhje të ngushtë me kapitalizmin botëror. Në këtë çështje, këto rryma e grupe më nuanca që anojnë më tepër nga lënia e figurës së Maos në mauzole, do t'u japin dorë të gjithë fraksionistëve të rinj, agjentë të imperializmit, ose elementë të paqartë, që ta mbrojnë Mao Ce Dunin për të vetmen arsye, se gjoja ai po luftohet ose nuk zihet fare në gojë nga udhëheqja aktuale. Kështu që këta njerëz bëjnë arsyetimin: meqë kjo udhëheqje e sotme është revizioniste, kapitaliste, fashiste e çfarë të duash, e lufton Mao Ce Dunin, për arsye të ideve të tij marksiste-leniniste. Pra, Mao Ce Duni, thonë ata, është një marksist-leninist dhe jo si thonë shqiptarët.

Sqarimit të këtyre situatave ne duhet t'i shkojmë deri në fund. Taktika jonë duhet të mendohet e të përpunohet mirë. **Për vënien në dukje me fakte, me doku-**

mente, se Mao Ce Duni nuk ka qenë marksist-leninist, nuk duhet as të vonohemi, por as edhe të shpejtohemi. Të vonohesh do të thotë t'u lësh kohë të gjithë këtyre elementëve fraksionistë të rinj, përçarës të partive komuniste e të lëvizjes komuniste ndërkombëtare, që të veprojnë për të krijuar e për të përhapur tezën që e theksova më lart, domethënë që udhëheqësit aktualë kinezë janë antimarksistë, kurse Maoja ishte marksist dhe, pra, pikëpamjet e Partisë së Punës të Shqipërisë nuk janë të drejta.

Por neve nuk duhet as të shpejtohemi, e me këtë unë kuptoj që duhet të argumentojmë fort, saktë e plotësisht mendimin tonë. Për këtë ekzistojnë fakte, të cilat duhet t'i kërkojmë e t'i gjejmë. Ato janë edhe në veprat e Mao Ce Dunit, që kanë namin se janë të gjitha të drejta. Veprimet e Mao Ce Dunit kanë qenë në rrugën antimarksiste dhe ka dokumente të shkruara që i kanë botuar tash së fundi, të cilat vërtetojnë se ai nuk ecte në rrugën e shkencës marksiste-leniniste, përkundrazi, ishte një idealist, pragmatist, një eklektik, borgjez demokrat-revolucionar. Në veprat e tij ne duhet të thellohemi, pse do të gjejmë «xhevahire» që vërtetojnë se edhe në to, megjithëse janë të rregulluara, ka pikëpamje antimarksiste.

Ne nuk duhet të lejojmë që fraksionistët e rinj ta krahasojnë çështjen e Mao Ce Dunit në mënyrë banale me luftën dhe me situatën në Bashkimin Sovjetik, kur udhëhoqi Stalini. Në asnjë mënyrë nuk duhet bërë një krahasim i tillë, sepse kjo është e padrejtë dhe nuk duhet të biem në banalitetet e këtyre mbrojtësve të rremë të marksizëm-leninizmit.

E MËRKURE

30 GUSHT 1978

## FYTYRA E VËRTETË E REXH BËRÇIT

Nga Pogradeci i dërgova shokut Ramiz një letër, ku i komentoja me hollësi mendimin tim për Rexh Bërçin, i cili kohët e fundit, kur ishte në vendin tonë, ka lënë një dokument në Komitetin Qendror. Ky dokument vërteton se Bërçi është një revizionist, dhe ka të ngjarë të jetë dhe agjent i Intelixhens Servisit.

Tash mendimet që shfaqja në letrën dërguar shokut Ramiz për Rexh Bërçin, po vërtetohen. Ky i nxori veshët se ç'ishte. Në një artikull redaksional që ka shkruar në gazetën e tij në datën 10 gusht 1978, në mes të tjerash, duke folur për eksperiencën e madhe të Revolucionit Socialist të Tetorit, për Leninin, për Stalinin, për luftën që i është bërë Stalinit nga hrushovianët, nga buharinistët e të tjerë, e të tjerë, Bërçi vjen edhe në çështjen e Kinës. Ai e lavdëron Kinën sikur kjo në kohën e Mao Ce Dunit dhe të Çu En Lait ka qenë gjoja në pozita marksiste-leniniste, se atje ndërtohej socializmi, pavarësisht se udhëheqësit aktualë kinezë kanë devijuar nga marksizëm-leninizmi. Në këtë kryeartikull Rexh Bërçi del hapur kundër Partisë së Punës të Shqipërisë. Deri tash ai gjoja ka qenë pro nesh, por fshihej nën etiketën e marksizëm-leninizmit, të miqësisë dhe të unitetit me Partinë e Punës të Shqipërisë. Herën e fundit, kur erdhi te ne dhe me këtë rast lexoi librin «Imperializmi dhe revolucioni», sigurisht atij i dogji shumë përmbajtja dhe fryma

e tij, prandaj nuk mund të qëndronte më në ato pozita false që kishte ndaj Partisë sonë. Për këtë arsye në bisedimet që bëri me Ramizin, ai na këshillonte ne që të hiqnim dorë nga ky libër, të mos merreshim me «fantazma», domethënë Mao Ce Dunin dhe Hrushovin me shokë ai i quan «fantazma», pastaj vinte pyetjen nëse na përkiste neve që të trajtonim një problem të tillë teorik.

Çdo gjë, pra, doli ashtu siç e mendnim ne, që Rexh Bërçi është në pozitat e Hillit, mik i revizionistëve kinezë. Po ca më mirë që mbajti qëndrimin e vërtetë dhe u demaskua, në vend që të vazhdonte të hiqej si marksist përpara nesh dhe gjithë shokëve të tjerë marksistë-leninistë. Natyrisht, në këtë luftë të madhe që po zhvillojmë kundër revizionizmit modern, veçanërisht kundër revizionizmit titist, sovjetik dhe aktualisht atij kinez, do të dalin njerëz të tillë dhe grupe si Rexh Bërçi e shokët e tyre, që do të na luftojnë. Kjo është e sigurt, por asnjë luftë e tillë nuk na tremb ne dhe nuk na bën që të lëvizim nga vija jonë e drejtë për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit. Të gjithë këta janë njerëz të shitur të kapitali, tek imperializmi, i cili i ka ngarkuar të qëndrojnë të maskuar për të shuar revolucionin e për të përçarë lëvizjen revolucionare dhe marksiste-leniniste në botë. Prandaj asgjë nuk na çudit. Ne, sigurisht, do të shohim edhe të tjerë njerëz që të dalin me fytyrë si ajo e Bërçit, por jemi, gjithashtu, të bindur se do të dalin të tjerë, bile më me shumicë, që do të na mbrojnë dhe do t'i forcojnë revolucionin dhe lëvizjen marksiste-leniniste në botë.

Bërçi dhe ata që mendojnë si ai janë në shërbim të imperializmit. Bërçi është, veçanërisht, në shërbim të imperializmit anglez dhe i leverdis ta ketë mirë me Kinën aktuale të Hua Kuo Fenit dhe të Ten Hsiao Pinit, pavarësisht se vetë Bërçi i përçmon këta të dy, bile gjoja edhe i kritikon. Por perandoria angleze, Intelixhens Servisi dhe qeveria laburiste e Anglisë, e dinë fare mirë se

ç'ideologji kanë pasur Mao Ce Duni dhe Çu En Lai, se këta ishin kurdoherë antisovjetikë, antimarksistë, ishin pro Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe veçanërisht pro demokracisë amerikane e demokracisë perëndimore në përgjithësi.

Prandaj nuk është çudi që aktualisht Bërçi mban një qëndrim në dy karrige, edhe për të gënjer njerëzit në Angli, por edhe për të përçarë partitë e tjera. Ai ka gjetur rrugën se është gjoja kundër Hua Kuo Fenit dhe Ten Hsiao Pinit, por në asnjë mënyrë nuk duhen prekur dhe atakuar Mao Ce Duni dhe Çu En Lai, të cilët, sipas tij, kanë qenë marksistë-leninistë të mëdhenj, që kanë ndihmuar marksizëm-leninizmin, revolucionin dhe kanë hapur, siç thotë Bërçi, rrugë të reja për revolucionarët e marksistë-leninistët. Natyrisht, në këtë fushë dhe në këtë taktikë do të ketë njerëz nga partitë e tjera marksiste-leniniste që do të krijojnë përçarje, por kjo nuk mund të na lëvizë ne nga pikëpamjet tona për Mao Ce Dunin, për Çu En Lain dhe për gjithë revizionistët e tjerë. Neve na vihet detyrë që, përveç studimeve që kemi bërë, të thellohemi akoma në veprën e Mao Ce Dunit dhe të Çu En Lait e të vërtetojmë edhe më mirë me fakte e me dokumente se çfarë ishin këta dy njerëz, të tregojmë me argumente se ata nuk ishin marksistë-leninistë, por demokratë borgjezë përparimtarë dhe asgjë më shumë, derisa arritën të zhvillonin pikëpamjen e shtetit të madh kinez, domethënë të krijimit të një Kine pro imperializmit dhe të një shteti të madh socialimperialist kinez.

E ENJTE

31 GUSHT 1978

## TË DEMASKOJMË VIZITËN E HUA KUO FENIT NË BUKURESHT DHE NË BEOGRAD

**E** lexova projektartikullin tonë që bën konkluzionet e vizitës së Hua Kuo Fenit në Bukuresht dhe në Beograd. Më duket se në përgjithësi tezat që i kisha dhënë shokut Ramiz janë realizuar mirë. Po sot bisedova me të dhe i dhashë një sërë mendimesh të tjera «me spec», domethënë që në artikull të inkuadrohen edhe disa probleme që dalin aktualisht në politikën ndërkombëtare.

Përveç të tjerash i thashë të theksohet mirë natyra e revizionizmit jugosllav, natyra e «mosangazhimit» të Jugosllavisë, «loja në litar» e Titos dhe rreziqet e saj për popujt e Jugosllavisë, «diplomacia e madhe» e presidentit Tito, që e ka bërë Jugosllavinë një vend të varur dhe që miqtë e saj të zemrës i shohin rreziqet e kësaj politike akrobatike, shohin se në portet jugosllave po ankorohet flota sovjetike e të tjera e të tjera gjëra të tilla, të cilat përbëjnë një rrezik të madh për botën dhe veçanërisht për popujt e Ballkanit.

Të vihet çështja e zërave që dalin nga Pekini dhe nga Beogradi, se politika që ndjek Shqipëria gjoja ndihmon socialimperializmin sovjetik, pra, të demaskohet kjo pikëpamje. Të demaskohet, gjithashtu, koncepti se Shqipëria tash ka mbetur e izoluar dhe do t'u nderë dorën fuqive imperialiste për ndihmë dhe për kredi, të shpjegohet mentaliteti i krijuar në botë se s'ka shtet të madh

ose të vogël që të rrojë pa kredi dhe pa ndihma nga fuqitë imperialiste e kapitaliste.

Të flasim për të mos konfunduar kreditë me zhvillimin e tregtisë në bazë të leverdisë reciproke, po ashtu edhe se Shqipëria socialiste e thotë haptazi të vërtetën dhe njëkohësisht e ruan miqësinë me popujt e Jugosllavisë. Këto ide dhe disa të tjera ia thashë Ramizit që t'i inkuadrojë në këtë artikull, që ky të bëhet një material i plotë dhe therës.

**E ENJTE**  
**31 GUSHT 1978**  
**IDE TË TJERA PËR ARTIKULLIN MBI UDHËTIMIN**  
**E HUA KUO FENIT NË BALLKAN**

Materialeve që i kam dhënë Ramizit për artikullin që duhet të bëjmë lidhur me vizitën e Hua Kuo Fenit në Rumani dhe në Jugosllavi, u shtova edhe një sërë idesh të tjera me qëllim që ai të bëhet më i qartë dhe më aktual.

Së pari në këtë artikull edhe një herë, natyrisht në mënyrë sintetike, duhet ta bëjmë të qartë ç'përfaqëson **teoria e «lëvizjes së paangazhuar» dhe ta demaskojmë atë**, pse parashikojmë që këtë problem Titoja do ta trajtojë me Hua Kuo Fenin bile do t'ia kundërvërë, pa e zënë fare në gojë, teorisë së «tri botëve» të Kinës. Nga ana e tyre kinezët, si marifetçinj e hipokritë që janë e të përlulur përpara këtij miku që duan ta shfrytëzojnë, edhe pse e dinë që është dinak, do ta adoptojnë teorinë e «lëvizjes së paangazhuar» titiste, do të bëjnë sikur edhe ata po e mbështetin këtë teori dhe në fakt e mbështetin, pse shikojnë që teoria e tyre e «tri botëve» nuk ka shumë sukses, aq sa nuk ka sukses edhe teoria e «lëvizjes së paangazhuar». Sidoqoftë kjo teori, pjellë e imperializmit amerikan dhe e agjenturës së tij, titizmit, ka pasur një jetë më të gjatë dhe zotërinjtë kinezë, pas vdekjes së Titos, shpresojnë të marrin drejtimin e kësaj lëvizjeje e të bëjnë qinosen e plotë të «lëvizjes së paangazhuar» me «botën e

tretë». Natyrisht, për të arritur këtu, sipas rregullave që nuk kanë asnjë bazë, por që ka vendosur «lëvizja e të paangazhuarve», më parë duhet të pranohesh në këtë «lëvizje», pra edhe Kina duhet të pranohet në të. Mirëpo do të jetë e zorshme që ajo të pranohet veçanërisht në mbledhjen e ardhshme që do të mbahet në Mukavata, pse atje as Kuba e Fidel Kastros, as Algjeria dhe as shumë të tjerë nuk do të lejojnë jo vetëm që Kina të pranohet në këtë lëvizje si anëtare me të drejta të plota, por besoj as si dëgjuese apo pjesëmarrëse nga jashtë, siç kanë pranuar Rumaninë. Sidoqoftë në këtë artikull ne duhet ta **përcaktojmë «mosangazhimin» jugosllav si një teori false.**

Së dyti, duhet të theksojmë se **politika e «valles mbi litar» e Titos nuk u ka sjellë dhe nuk do t'u sjellë asgjë të mirë popujve të Jugosllavisë dhe popujve të tjerë.** Kjo politikë e «valles mbi litar» e Titos është një politikë akrobatike, e përshtatshme për ideologjinë e tij revizionisto-oportuniste dhe për qëllimet specifike të tij, që ta ketë mirë me të gjithë, të marrë nga të gjithë kredi, që të mund t'i lajë gradualisht kreditë e mëdha. Me fjalë të tjera politika gjoja e madhe e këtij revizionisti të paskrupullt ka për qëllim vazhdimin e robërimit të popujve për interesat personale të klasës kapitaliste jugosllave që ka krijuar titizmi.

Së treti, në fjalimet që mbajti Hua Kuo Feni qoftë në Rumani, por sidomos në Jugosllavi, tha shumë herë se miqësia në mes Jugosllavisë dhe Kinës është jo vetëm e sinqertë (kuptohet false), por i ka rrënjët të thella. Se ku i ka këto rrënjë të thella kjo miqësi në mes Jugosllavisë dhe Kinës merret me mend. Por kjo është vetëm një slogan, pse në realitet rrënjë të thella ajo nuk ka dhe nuk mund të ketë. Një Kinë revizioniste nuk mund të jetë mike me shtete të tjera, për arsye se politika e saj antimarksiste ka për qëllim hegjemoninë kineze në botë, nënshtrimin e popujve ndaj politikës së saj dhe diktimin

e dëshirave të saj të tjerëve. Prandaj **kjo farë miqësie me rrënjë «kaq të thella» duhet përmendur diku sa për ta vënë në dukje, se në fakt ajo është një bluf.**

E vërteta është se **ideologjikisht titizmi dhe maocedunideja janë në një rrugë.** Ato pajtohen me njëra-tjetrën. Mao Ce Duni ka qenë me kohë pro Titos, e ka mbrojtur titizmin edhe në kohën e Informbyrosë, kur ne dhe të gjitha partitë marksiste-leniniste të asaj kohe bëmë demaskimin e këtij revizionizmi dhe të kësaj agjente të kapitalizmit botëror. Por Maoja dhe udhëheqja kineze, natyrisht që nga 1948-a e tëhu, kanë lëvizur njëqind herë në qëndrimet e tyre dhe s'mund të bënin ndryshë, për arsye se janë partizanë të «njëqind shkollave e të njëqind luleve». Pra një nga «lulet e bukura» të kopshtit kinez ishte dhe titizmi, era e kundërmuar e qelbësirës titiste.

Së katërti, duhet shtuar, gjithashtu, se **kjo farë miqësie që po lidhet në mes Jugosllavisë dhe Kinës tjerr rreziqe për popujt jugosllavë dhe për popujt e tjerë të Ballkanit.** Ideja është kjo që Hua Kuo Feni vete në Jugosllavi për të nxitur armiqësinë e titistëve kundër socialimperializmit sovjetik, për të krijuar tok me Rumaninë një front kundër Bashkimit Sovjetik dhe mundësisht për ta provokuar këtë të fundit që të bëjë një ndërhyrje goftë në Rumani, goftë në Jugosllavi dhe të vërtetohen kështu tezat false dhe dinakëria kineze. Por dihet që anti-sovjetizmi i kinezëve nuk është për qëllime parimore. po për qëllime dominimi në botë, prandaj kinezët kërkojnë të krijojnë në Ballkan një zonë influence për pikë-pamjet e tyre politike dhe hegjemoniste.

Së pesti, duhet theksuar se **«diplomacia» e presidentit Tito që pretendohet se e ka bërë Jugosllavinë një vend të pavarur, në fakt e ka bërë atë plotësisht të varur, e ka angazhuar me fuqi të tjera kapitaliste dhe imperialiste.** Këtë rrugë do të ndjekë edhe Kina, pavarësisht se

është një kontinent i tërë, një shtet i madh me 800 milionë njerëz. Madhësia e saj territoriale është çështje tjetër, ndërsa ideologjia, politika e diplomacia e kinezëve do të jenë të njëjlojta si ato të titistëve dhe do të çojnë në një vartësi relative të Kinës ndaj fuqive kapitaliste dhe imperialiste.

Së gjashti, duhet të theksohet se **«miqtë e zemrës» të titistëve i shohin dhe i peshojnë këto rreziqe që paraqet kjo politikë diplomatike e Jugosllavisë.** Megjithatë ata e nxitin dhe e lejojnë, duke menduar e duke shpresuar se aktualisht janë të plotfuqishëm dhe mund të kontrollojnë veprimtarinë e socialimperializmit sovjetik, duke krijuar një «kordon sanitar» ose duke lejuar kinezët të krijojnë zonat e tyre në Evropë, kuptohet, zona fiktive, por që mund ta trembin socialimperializmin sovjetik në veprimtarinë e tij ekspansioniste dhe kapitaliste. Këta «miq» të Titos sigurisht mendojnë se në të njëjtën kohë kontrollojnë edhe veprimet e kinezëve dhe rezultatet e mundshme të tyre. Mirëpo një mendjelehtësi e tillë nuk mund ta evitojë katastrofën që do të vijë, për arsye se do të shtohen kontradiktat në Evropë. Këtë e dëshiron dhe për këtë bën shumë përpjekje Kina. Këto përpjekje të saj mund të zënë vend vetëm duke hapur gjerësisht dyert e Kinës për kapitalizmin ndërkombëtar, domethënë për të lejuar kapitalistët evropianë, amerikanë e japonezë të investojnë dhe të nxjerrin të ardhura të majme në kurriz të popullit kinez. Është e kuptueshme që mbi këto të ardhura edhe kinezët do të vënë disa kushte, të kenë edhe ata fitime nga ana e tyre dhe, në rast se nuk do t'ia arrijnë dot qëllimit, ata janë mësuar dhe atëherë do të bëjnë pirueta politike dhe kthesa 90 dhe 180 gradëshe.

Kapitalizmi botëror, veçanërisht kapitalizmi evropian, me prerjen e ndihmave të Kinës për Shqipërinë, dukeshin si mjaft të alarmuar për qëndrimin që do të mbanim ne. Ata kishin frikë se mos ne u ndërnim dorën social-

imperialistëve sovjetikë. Megjithatë ata e gjejnë të natyrshme që flota sovjetike e luftës të ankorohet në portet jugosllave. Natyrisht, ankorimi i anijeve luftarake sovjetike në portet jugosllave ndjell një rrezik të madh për të gjitha vendet bregdetare të Adriatikut e të Mesdheut, veçanërisht për vendin tonë. Këtë ne e kemi theksuar, kemi qenë dhe jemi kundër këtij veprimi dhe do ta ngremë zërin deri në kupë të qiellit. Imperialistët dhe kapitalistët evropianë të mos «bëhen» merak për bregdetin tonë. Ai është e do të jetë i paprekshëm. Ne nuk do të lejojmë kurrkënd të vërë këmbë në këtë bregdet. **Kush do të orvatet të vërë këmbë në bregdetin tonë, duhet ta ketë të qartë se do të ketë luftë me popullin shqiptar, se lufta do të jetë në favorin tonë dhe disfata e pashmangshme i pret shkelësit e kufirit shqiptar.**

I thashë shokut Ramiz që këto mendime dhe materialet që i kam dhënë si bazë për këtë artikull, të përpunohen dhe t'i botojmë sa më parë, pse mendoj që është e domosdoshme ta sqarojmë opinionin botëror mbi rreziqet e kësaj hapjeje reaksionare dhe hegjemoniste të Kinës, që fsheh jo miqësi, por rreziqe lufte, intriga për dominim nga ana e saj dhe forcim të dominimit të kapitalizmit evropian dhe botëror mbi shtetet e Evropës.

Hapja e Kinës në çdo vend, veçanërisht në Evropë, ku ekziston një proletariati i madh me eksperiencë, ka për qëllim që ta neutralizojë këtë forcë të madhe varrimëse të kapitalizmit botëror. Këtu qëndron krimi më i madh i revizionistëve kinezë, prandaj ata haptazi predikojnë nënshtrimin e proletariatit botëror dhe veçanërisht të atij evropian nën thundrën e kapitalizmit, të së ashtuquajturës botë të dytë. Për këtë e zhvillojnë ata hapjen, këtë politikë e diplomaci të tyre, dhe, nga ana tjetër, financojnë disa lëvëre, disa parti pseudomarksiste, të cilat shpifin kundër Partisë sonë dhe bëjnë zhurmë pro Kinës. Por realiteti qëndron në atë që Kina në mos

sot, nesër, do të lidhet me të gjitha partitë revizioniste të Evropës dhe të botës, me të gjitha ato parti revizioniste që do të preferojnë më mirë të jenë të lidhura me Kinën revizioniste, sesa me Bashkimin Sovjetik revizionist, për arsye se politika e kapitalizmit të shtetit të tyre ka interesa më shumë për investime dhe shfrytëzim në Kinë, sesa në Bashkimin Sovjetik.

Prandaj partitë revizioniste eurokomuniste, që kanë tendencë të theksuara të marrin pjesë në qeveritë borgjeze, do të ndjekin po këtë politikë të qeverive të tyre, domethënë dashamire ndaj Kinës revizioniste, e cila i hap tregje të mëdha fitimi kapitalit botëror. Partia Komuniste e Kinës, që është një parti revizioniste, nuk ka se si të mos puqet, të mos lidhet e të mos veprojë së toku me të gjitha partitë e tjera revizioniste, me përjashtim, hëpërhë, të Bashkimit Sovjetik. Ashtu siç po bën aktualisht me Lidhjen e Komunistëve të Jugosllavisë, me Partinë Punëtore Rumune, ashtu do të bëjë Partia Komuniste e Kinës edhe me Partinë Komuniste revizioniste të Francës, të Italisë, të Spanjës etj.

Revizionizmi kinez do të përpiqet të çajë frontin e revizionizmit që është nën drejtimin sovjetik, aq sa është ky front nën drejtimin sovjetik, dhe të krijojë, me aq sa do të ketë mundësi, një front revizionist nën drejtimin e Partisë Komuniste (revizioniste) të Kinës. Natyrisht partia kineze shkop dirigjenti nuk mund të bëhet, por orvatje do të bëhen.

Ne duhet të luftojmë me të gjitha forcat tona të gjithë revizionistët modernë, në të gjitha format që këta paraqiten, në të gjithë veprimtarinë që zhvillojnë kundër teorisë sonë, kundër partive marksiste-leniniste dhe veçanërisht kundër Partisë së Punës të Shqipërisë.

**E ENJTE**  
**31 GUSHT 1978**

## **PROBLEME E TAKTIKA TË DISA PARTIVE MARKSISTE-LENINISTE QË DUHEN PARË ME VËMENDJE**

Në Portugali, në një mbledhje të fundit, që është quajtur kamping, shohim disa pikëpamje taktike, këtë herë jo të rregullta. Partia Komuniste Portugeze (e Rindërtuar) kishte ftuar në këtë kamping përfaqësues të rinisë nga të gjitha partitë komuniste marksiste-leniniste. Këtij takimi do t'i jepej një kuptim miqësor, natyrisht politik, dhe mundet që të ishte si një kundërvënie e mbledhjes së rinisë botërore, që bëhej në Kubë. Por çështja është se në këtë takim udhëheqja e Partisë Komuniste Portugeze (e Rindërtuar), përpara përfaqësuesve të rinisë të partive të tjera, shtroi çështjen se nuk duhet folur për imperializmin amerikan, për socialimperializmin sovjetik, për reaksionin botëror, por të flitet në përgjithësi, pa i përmendur konkretisht këta armiq.

Natyrisht, një vijë e tillë nuk ishte e pranueshme nga të gjithë pjesëmarrësit, përfaqësues të rinisë të partive komuniste marksiste-leniniste. Atje vajti edhe delegacioni ynë, të cilin e pritnin me padurim. Portugezët ua shtruan këtë pikëpamje përfaqësuesve të rinisë sonë, por këta e kundërshtuan dhe u thanë se ne nuk mund të jemi dakord me këtë vijë, përkundrazi, duhet të flasim haptazi për problemet që preokupojnë rininë e vendeve tona dhe t'i hapim perspektivë e t'i tregojmë asaj rrugën

që duhet të ndjekë. Para se të shkonte atje delegacioni ynë, këtë pikëpamje e kishin mbrojtur me forcë edhe gjermanët, spanjollët, italianët e të tjerë. Kështu që përfaqësuesit e Shqipërisë u gjendën në një radhë me partitë marksiste-leniniste, pra, në kundërshtim me përfaqësuesit e rinisë të Partisë Komuniste Portugeze (e Rindërtuar). Në mbledhjet e përgjithshme u dukën qartë kontradiktat e mëdha, që ekzistonin në mes pikëpamjeve të kësaj partie, nga njëra anë, dhe të masave e simpatizantëve të saj, si dhe të përfaqësuesve të partive të tjera, nga ana tjetër. Kështu, gjithë turma bërtiste: Poshtë imperializmi amerikan, poshtë socialimperializmi sovjetik, poshtë imperializmi kinez, poshtë borgjezia reaksionare etj., etj. Kjo donte të thoshte se masa ishte më përpara, kurse Partia Komuniste Portugeze (e Rindërtuar) qëndronte prapa.

Por një gjë që më shqetëson është se përfaqësuesi i rinisë i Partisë Komuniste të Brazilit u përpoq t'i bindte shokët tanë se «orientimet që dhanë portugezët ishin rezultat i një analize të situatës së brendshme në Portugali, prandaj, po të ketë mundësi, delegacioni shqiptar t'i mbështetë» etj., etj. Natyrisht, delegacioni ynë i kundërshtoi këto pikëpamje të shokëve brazilianë, të cilët pas dy ditësh u rikthyen te shokët tanë, u përpoqën të shfaqësoheshin duke thënë se mos fjalët e tyre ishin keqkuptuar, se nuk kishin ato mendime etj., etj. Me fjalë të tjera, duke parë qëndrimin tonë të vendosur, që koïncidonte me qëndrimet e drejta të partive të tjera marksiste-leniniste, shokët brazilianë bënë një tërheqje strategjike.

Ne e dimë se Partia Komuniste e Brazilit ka influencë te Partia Komuniste Portugeze (e Rindërtuar). Megjithatë, nuk është e thënë që nga ana taktike shokët e Partisë Komuniste të Brazilit të kenë influencuar për një taktikë të tillë si ajo që mbajtën portugezët, duke e quajtur këtë frytdhënëse në situatat që po kalonte Por-

tugalia, sepse ishte në ato kohë kur qeveria e Suaresit kishte rënë dhe do të vendosej një qeveri tjetër. Por taktika nuk duhet të bjerë në kundërshtim me strategjinë, sidomos me vijat kryesore të strategjisë. Në qoftë se nuk flitet kundër imperializmit amerikan, kundër socialimperializmit sovjetik dhe kundër politikës aventureske e antimarksiste kinezë, atëherë kjo i përngjet shumë taktikës së titistëve. Edhe këta flasin për imperializmin amerikan, për socialimperializmin ose për hegjemonizmin e për shtetet e mëdha kapitaliste, por pa përcaktuar se cilat janë këto shtete dhe cilët janë këta armiq. Pra, në qoftë se shokët e delegacionit të rinisë të Partisë Komuniste të Brazilit kanë influencuar në këtë drejtim, kjo ka qenë një taktikë e gabuar. Unë besoj se duhet të kenë influencuar, për arsye se shoku Arruda, para disa kohësh i kishte thënë një shokut tonë, se shokët spanjollë janë ca sektarë ndaj shokëve portugezë. Kaq kishte folur ai dhe asgjë më tepër.

Tash së fundi që Arruda erdhi në Shqipëri (ai ndodhet këtu me një grup shokësh brazilianë dhe presin edhe Amazonasin), gjatë një bisede me shokun Ramiz ishte shprehur për rëndësinë e madhe ndërkombëtare të librit «Imperializmi dhe revolucioni», dhe kishte thënë se «ne e lexuam, e diskutuam dhe atë e gjejmë si platformën e vetme të lëvizjes komuniste ndërkombëtare, se nuk ka tjetër platformë përveç saj». Pra, ai foli mirë për Partinë tonë. Pas kësaj i tha shokut Ramiz: Do të them edhe diçka që s'duhej t'juaj thosha dhe merre sikur s'ta kam thënë, sepse do të ta shtrojë Amazonasi këtë çështje, pra që ne mendojmë se do të jetë mirë sikur të bëjmë një mbledhje të përgjithshme të të gjitha partive tona komuniste marksiste-leniniste dhe të adoptojmë librin «Imperializmi dhe revolucioni» si platformë të përbashkët ideologjike, vetëveprimi.

Një herë tjetër Arruda ka pyetur nëse e lexuan

shokët gjermanë këtë libër tonin dhe ç'mendim kishin shprehur ata. Shokët tanë iu përgjigjën. Tash mua më lindin disa mendime e disa dyshime. Partia Komuniste e Brazilit është dakord në të gjitha çështjet me Partinë tonë, por a është dakord me analizën që ne u kemi bërë pikëpamjeve të Maos? A është dakord ajo me pikëpamjen tonë se Mao Ce Duni nuk ka qenë marksist-leninist dhe se në Kinë nuk ndërtohet socializmi? Ndërtimi i tij është lënë në mes të rrugës, janë bërë disa hapa përpara, por ata kanë qenë të çalë dhe si rezultat Kina u shndërrua në një vend revizionist, kapitalist. Pse për çështjet e tjera shokët brazilianë janë plotësisht dakord me ne? Mundet që edhe për çështjen e Mao Ce Dunit ata të jenë dakord me pikëpamjet e me argumentet tona, e bile të kenë edhe argumentet e tyre që e plotësojnë këtë mendim. Arruda, me ato që i tha Ramizit, mund të jetë plotësisht i sinqertë, pavarësisht se mendimi ynë është që nuk duhet të bëjmë një mbledhje të tillë, ku të diskutohet dhe të merrret si platformë libri ynë.

Ka mundësi, ky është mendimi im, por mund edhe të mos jetë kështu, që shokët e Partisë Komuniste të Brazilit taktikisht, për të mos i thënë haptazi dhe drejtpërdrejt disa kundërshtime që mund të kenë me Partinë tonë, në lidhje me përcaktimin e çështjes së pikëpamjeve të Mao Ce Dunit, të propozojnë në këtë rrugë një mbledhje të partive, duke aprovuar si të vetmen platformë pikëpamjet e shprehura në librin tonë «Imperializmi dhe revolucioni». Kështu që po të pranohet një mbledhje e tillë, atëherë, natyrisht, në format e domosdoshme demokratike do të diskutohen e do të shfaqen mendime për të gjitha problemet që ngrihen në këtë libër, kurse ky nuk ka një platformë për të diskutuar, është vetëm një libër teorik që nxjerr Partia e Punës e Shqipërisë. Por derisa e marrim në diskutim në një mbledhje të tillë, do të pranohet edhe mendimet e shokëve dhe sidomos

në pikat kryesore, veçanërisht në çështjen e maocedunidesë. Kilianët, për shembull, në qoftë se ne thërresim përfaqësues nga Partia Komuniste (m-l) e Anglisë ose nga ndonjë parti tjetër, mund të mos jenë dakord me qëndrimin tonë në këtë çështje dhe të mbajnë qëndrimin që duhen ndarë Mao Ce Duni dhe Çu En Lai nga Hua Kuo Feni e Ten Hsiao Pini, domethënë që Kina është vënë në rrugën revizioniste dhe po shkon drejt transformimit të saj në një vend kapitalist, vetëm pas vdekjes së Çu En Lait e të Mao Ce Dunit, «sa ishte gjallë Mao Ce Duni atje ndërtohej socializmi». «Partia Komuniste e Kinës dhe Mao Ce Duni kanë bërë disa gabime, por edhe Stalini ka bërë disa gabime» do të thonë ata. Por situata ka qenë krejt ndryshe kur rronte Stalini, prandaj nuk duhet lejuar të bëhet një krahasim i tillë. Pra, vlerësimi i këtij problemi do të krijojë një çarje.

Ne nuk duhet ta bëjmë një mbledhje të tillë, për arsye se këtë libër ne nuk e bëmë që t'ua imponojmë si platformë partive marksiste-leniniste. Aty ne shprehim një sërë të vërtetash marksiste-leniniste, por mund të ketë parti të tjera që të kenë mendime të ndryshme nga tonat. Deri tash vetëm disa shokë të partive komuniste (m-l) kanë marrë dijeni për materialin tonë ose drejtpërsëdrejti, ose u është shpjeguar, kurse e tërë udhëheqja e partive marksiste-leniniste dhe tërë partitë, nuk kanë dijeni për këtë material. Prandaj unë mendoj që ta botojmë publikisht dhe të përballojmë kritikën e opinionit të komunistëve dhe të kujtdo në botë, të bëjmë autokritikë në qoftë se ndonjë çështje nuk e kemi shikuar drejt, por t'i lëmë të tjerët t'i gjykojnë parimet që shtrohen në këtë libër, pastaj në qoftë se ka çështje ku ndonjë ose disa parti mund të kenë kundërshtime me pikëpamjet tona, atëherë mund të bëhet mbledhja.

Sidoqoftë, për sa i përket Partisë Komuniste të Brazilit, ne do ta shohim më qartë qëndrimin e saj në këtë

problem, se e dimë që ajo është një parti e vërtetë marksiste-leniniste, që e do Partinë tonë për arsye se pikëpamjet tona puqen plotësisht në të gjitha problemet kardinale të teorisë marksiste-leniniste. Shokët brazilianë sinqerisht janë treguar entuziastë për ndërtimin e socializmit në vendin tonë dhe për drejtësinë e vijës së Partisë, por mundet, supozoj, mund edhe të gabohemi që në këtë çështje, në anën taktike, ata mund të kenë disa dyshime për mosshpejtimin nga ana jonë, por ne do të shpjegohemi me ta.

E ENJTE  
31 GUSHT 1978

## DITIRAMBE E GËNJESHTRA TË SHTYPIT KINEZ

Agjencia HSINHUA njofton se në gazetën «Zhenminzhibao» u botua një kryeartikull që përshëndet suksesin e vizitës së Hua Kuo Fenit në Jugosllavi. Nuk mund të gjenden fraza më ditirambike dhe shprehje pompoze të tilla si udhëtimi, vizita dhe bisedimet që bënë Hua Kuo Feni me Titon që s'kanë rëndësi vetëm për Kinën dhe Jugosllavinë, por «përputhen me aspiratat e popujve të të gjithë botës». Ja deri ku arrijnë mendjemadhësia e kinezëve dhe përpjekjet për ngritjen në shkallë të lartë të një renegati të marksizëm-leninizmit dhe shërbëtori të imperializmit amerikan, siç është Titoja.

Kjo vizitë, thotë «Zhenminzhibao», shënon një ngjarje të rëndësishme në historinë e marrëdhënieve midis të dyja partive. **Pra, relatohet zyrtarisht se të dyja partitë revizioniste, kineze dhe jugosllave, puqen në të gjitha mendimet.**

Çështja kryesore që ngrihet në kryeartikull ka të bëjë me pikëpamjet ideologjike të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë dhe të Partisë Komuniste të Kinës, ku të dyja partitë puqen. **Lidhjen e Komunistëve të Jugosllavisë, të kryesuar nga Titoja, kryeartikulli e cilëson si një «parti të lavdishme». Deri këtu kanë arritur revizionistët kinezë, të cilët dikur Lidhjen e Komunistëve të Jugosllavisë e kanë cilësuar si një parti revizioniste,**

**armike të betuar të marksizëm-leninizmit. Por tash e kthyen fletën.**

Gazeta pretendon se «kjo parti e lavdishme komuniste e Jugosllavisë ka zbatuar të vërtetën universale të marksizmit në praktikën konkrete në Jugosllavi, vendosi dhe zhvilloi sistemin e vetadministrimit socialist të përshtatshëm për kushtet specifike të vendit, duke nxjerrë kështu në pah entuziazmin socialist të klasës punëtore dhe të punonjësve të tjerë dhe duke sjellë administrimin racional dhe shkencor të ekonomisë».

**Me pak fjalë, kinezët, këta kasnecë të revizionizmit, që duan ta luftojnë marksizëm-leninizmin me të gjitha mjetet, e quajnë vetadministrimin jugosllav, nga i cili ata do të marrin orientimet kryesore, si një ndërtim të vërtetë socialist dhe administrim racional të ekonomisë kombëtare.** Përveç kësaj, ata pretendojnë se «socializmi specifik», që po ndërtohet në Jugosllavi, ka ngjallur entuziazmin e madh të punëtorëve. Nuk e shikoni «ç'entuziazëm» të madh ka krijuar në Kosovë?! Atje po mbyllen me qindra ndërmarrje dhe në të gjithë Jugosllavinë me mijëra, papunësia ka arritur kulmin, çmimet po ngrihen në qiell etj. Të gjitha këto janë rezultat i këtij vetadministrimi, i «socializmit specifik», të cilin udhëheqja kineze e ngre në një pedestal kaq të lartë.

Pale pastaj ç'thotë kryeartikulli për politikën e «mosangazhimit»: «Jugosllavia ka ndjekur me vendosmëri një politikë të mosangazhimit në çështjet ndërkombëtare dhe ka përkrahur aktivisht luftërat revolucionare të popujve dhe të vendeve të shtypura». «Mosangazhimi» titist i paska bërë këto gjëra!! Përkundrazi, vetadministrimi dhe «mosangazhimi» titist jo vetëm nuk u kanë sjellë asgjë të mirë këtyre popujve, por nëpërmjet tyre titistët përpiqen t'i mbajnë këta popuj nën zgjedhën e fuqive imperialiste dhe të kapitalit botëror. Vetëm se në sajë të kësaj politike të «mosangazhimit» që predikojnë Titoja dhe

kinezët, ata marrin kredi të panumërta nga imperializmi amerikan dhe nga kapitalizmi botëror.

Për pritjen që iu bë Hua Kuo Fenit nga populli jugosllav, gazeta shprehet se «kjo tregon që miqësia kino-jugosllave ka hedhur rrënjë dhe lulëzon midis popullit». Kjo është një gënjeshtër, është një fokus. Populli jugosllav nuk provon asnjë ndjenjë miqësie, pale që ajo të ketë hedhur rrënjë të thella. Përkundrazi, ai e ka parë se udhëheqja kineze e ka sharë titizmin, gjë që një pjesë e popullit jugosllav e ka mbështetur dhe e mbështet, prandaj nuk e harron ç'është thënë për tradhtarin Tito. Por propagandës kineze ia do nevoja që të propagandojë e të përhapë gënjeshtër të tilla, për t'i ngritur «ajarin» Hua Kuo Fenit, revizionistit të ri që ka marrë frenat në dorë në udhëheqjen e Kinës. Hua Kuo Fenit i duhet që midis tij dhe kundërshtarëve të vet, Ten Hsiao Pinit me shokë, të krijojë një ndarje që populli kinez të shikojë se ky farë burri, Hua Kuo Feni, qenka i tillë saqë me dhjetëra e qindra mijë njerëz nga populli dalin nëpër rrugë dhe e përshëndesin, pra, të duket se «Hua Kuo Feni është njeri i madh, të cilin aq më tepër populli kinez duhet ta dojë e ta respektojë».

Kjo propagandë, natyrisht, ka efektin e vet në masat e gjera të popullit, në ato masa që politikisht nuk janë të ngritura, por sidoqoftë, puna e revizionistëve kinezë do të duket dhe kjo do t'ua nxjerrë kallajin këtyre.

## SHTREMBËROHET REALITETI, MBROHET FALSITETI

Më 2 shtator HSINHUA-ja dha pjesë nga një artikull i botuar në gazetën «Zhenminzhibao» me titull «Mbi falsitetin e Lin Biaos: Çdo fjali është e vërtetë». Që të kuptojmë mirë arsyen e botimit të këtij artikulli gjoja kritiko-teorik kundër Lin Biaos dhe bandës së «të katërve», më parë duhet të themi se ai drejtohet kundër ideve të Partisë së Punës të Shqipërisë.

Disa «miq» të Partisë sonë, që jeta po vërteton se nuk janë të tillë, por janë revizionistë, deri edhe agjentë të mundshëm të Intelixhens Servisit, ose të borgjezisë kapitaliste ndërkombëtare, siç është Rexh Bërçi, për të cilin do të flas përsëri më poshtë, i kanë vënë në korent kinezët për librin «Imperializmi dhe revolucioni», ku ne, përveç të tjerave, trajtojmë edhe maocedunidenë. Prandaj idetë e këtij artikulli, siç do ta shohim nga pasazhet kryesore që po nxjerr, dhe ato të kryeartikullit që, në qoftë se nuk gabohem, ka shkruar më 10 gusht Rexh Bërçi, puqen plotësisht në çështjet kryesore. Pra, idetë e partisë revizioniste kineze puqen me ato të revizionistit Rexh Bërç.

Kinezët, duke mos pasur akoma materialin e plotë dhe zyrtar në dorë, domethënë librin «Imperializmi dhe revolucioni», atakojnë Lin Biaon se ky gjoja hodhi një numër të madh parullash demagogjike dhe revizioniste mbi problemin e ideve të Mao Ce Dunit. Ky artikull

kinezët, ata marrin kredi të panumërta nga imperializmi amerikan dhe nga kapitalizmi botëror.

Për pritjen që iu bë Hua Kuo Fenit nga populli jugosllav, gazeta shprehet se «kjo tregon që miqësia kino-jugosllave ka hedhur rrënjë dhe lulëzon midis popullit». Kjo është një gënjeshtëri, është një fokus. Populli jugosllav nuk provon asnjë ndjenjë miqësie, pale që ajo të ketë hedhur rrënjë të thella. Përkundrazi, ai e ka parë se udhëheqja kineze e ka sharë titizmin, gjë që një pjesë e popullit jugosllav e ka mbështetur dhe e mbështet, prandaj nuk e harron ç'është thënë për tradhtarin Tito. Por propagandës kineze ia do nevoja që të propagandojë e të përhapë gënjeshtër të tilla, për t'i ngritur «ajarin» Hua Kuo Fenit, revizionistit të ri që ka marrë frenat në dorë në udhëheqjen e Kinës. Hua Kuo Fenit i duhet që midis tij dhe kundërshtarëve të vet, Ten Hsiao Pinit me shokë, të krijojë një ndarje që populli kinez të shikojë se ky farë burri, Hua Kuo Feni, qenka i tillë saqë me dhjetëra e qindra mijë njerëz nga populli dalin nëpër rrugë dhe e përshëndesin, pra, të duket se «Hua Kuo Feni është njeri i madh, të cilin aq më tepër populli kinez duhet ta dojë e ta respektojë».

Kjo propagandë, natyrisht, ka efektin e vet në masat e gjera të popullit, në ato masa që politikisht nuk janë të ngritura, por sidoqoftë, puna e revizionistëve kinezë do të duket dhe kjo do t'ua nxjerrë kallajin këtyre.

E HËNË  
4 SHTATOR 1978

## SHTREMBËROHET REALITETI, MBROHET FALSITETI

Më 2 shtator HSINHUA-ja dha pjesë nga një artikull i botuar në gazetën «Zhenminzhibao» me titull «Mbi falsitetin e Lin Biaos: Çdo fjali është e vërtetë». Që të kuptojmë mirë arsyen e botimit të këtij artikulli gjoja kritiko-teorik kundër Lin Biaos dhe bandës së «të katërve», më parë duhet të themi se ai drejtohet kundër ideve të Partisë së Punës të Shqipërisë.

Disa «miq» të Partisë sonë, që jeta po vërteton se nuk janë të tillë, por janë revizionistë, deri edhe agjentë të mundshëm të Intelixhens Servisit, ose të borgjezisë kapitaliste ndërkombëtare, siç është Rexh Bërçi, për të cilin do të flas përsëri më poshtë, i kanë vënë në korent kinezët për librin «Imperializmi dhe revolucioni», ku ne, përveç të tjerave, trajtojmë edhe maocedunidenë. Prandaj idetë e këtij artikulli, siç do ta shohim nga pasazhet kryesore që po nxjerr, dhe ato të kryeartikullit që, në qoftë se nuk gabohem, ka shkruar më 10 gusht Rexh Bërçi, puqen plotësisht në çështjet kryesore. Pra, idetë e partisë revizioniste kineze puqen me ato të revizionistit Rexh Bërç.

Kinezët, duke mos pasur akoma materialin e plotë dhe zyrtar në dorë, domethënë librin «Imperializmi dhe revolucioni», atakojnë Lin Biaon se ky gjoja hodhi një numër të madh parullash demagogjike dhe revizioniste mbi problemin e ideve të Mao Ce Dunit. Ky artikull

thotë se «njëra prej tyre që pati ndikim të madh ishte se çdo fjali që thotë kryetari Mao është e vërtetë dhe mban një peshë të tillë sa për 10 mijë fjali të zakonshme. Duke u nisur nga ky formulim Lin Biaoja dhe banda e të katërve përçanë sistemin e plotë, monolit dhe shkencor të maocedunidesë, e copëtuan dhe e gjymtuan në fraza e në fjali të veçanta për qëllimin kriminal të shtrembërimit dhe të falsifikimit të saj».

Ja, pra, si shtrohet prej tyre ky problem pseudo-teorik. Me këtë unë nuk dua të them që Lin Biaoja ishte marksist, ai ishte antimarksist, pse gjithë veprimet e tij «filozofike» kanë qenë idealiste, jomarksiste. Veprimet konkrete të Lin Biaos dëshmojnë për synimet që kishte ai për pushtet personal. Kjo do të thotë se në përpjekjet për realizimin e këtyre synimeve ai luftonte kundër grupit tjetër, që edhe ai ishte antimarksist e përpiqej gjithashtu për pushtet. **Çështja është se Lin Biao kinezët e marrin për «kokë turku», për të atakuar Partinë tonë dhe tezat e saj të drejta mbi çështjen e teorisë marksiste-leniniste.**

Le t'ia lëmë fjalën artikullit në këtë drejtim, prandaj po citoj këtu tekstualisht pjesë të tij:

«Marksizëm-leninizmi — idetë e Mao Ce Dunit, është shkencë që proletariati duhet të njohë dhe të ndryshojë botën. Ai është një pasqyrim i ligjeve të zhvillimit të botës objektive. Bota objektive është një e tërë e bashkuar, prandaj marksizëm-leninizmi — idetë e Mao Ce Dunit, është, gjithashtu, një sistem i plotë dhe integral dhe pjesët e tij përbërëse e parimet e tij janë të lidhura me njëra-tjetrën në një unitet të brendshëm organik. Në rast se ai përçahet dhe ndahet në fraza e në fjali të veçanta, që nuk janë të lidhura me njëra-tjetrën, ai nuk është më një shkencë që të pasqyrojë drejt ligjet e zhvillimit të botës objektive dhe prandaj nuk është më i vërtetë. Shkatërrimi i sistemit të plotë të marksizmit

është ajo që kanë dashur të bëjnë gjithmonë revizionistët për të kundërshtuar marksizmin».

«Pas vdekjes së Marksit dhe të Engelsit, — vazhdon artikulli, — oportunistët dhe revizionistët në Rusi si Buharini dhe Bogdanovi, hoqën tërësinë e filozofisë marksiste në një orvatje për të flakur tej materializmin historik — arritjen e madhe të Marksit dhe të Engelsit. Duke mbrojtur tërësinë e filozofisë marksiste, Lenini theksoi: Nga kjo filozofi marksiste, që është derdhur nga një copë e vetme çeliku, ju nuk mund të hiqni një pjesë bazë, një pjesë thelbësore, pa u shkëputur nga e vërteta objektive, pa rënë pre e falsitetit borgjezo-reaksionar. Faktet kanë vërtetuar deklaratën e Leninit. Tërësia dhe saktësia janë kërkesat bazë në sistemin shkencor të marksizëm-leninizmit — idetë e Mao Ce Dunit. Kur ato minohen, marksizëm-leninizmi — idetë e Mao Ce Dunit, mund të shtrembërohet në falsitete».

Ky është paragrafi kryesor, pastaj vijnë teorira boshë që polemizojnë me Lin Biao, gjoja për të vërtetuar se ai ka shtrembëruar fjalët, teoritë e Mao Ce Dunit etj., etj., që nuk na interesojnë këtu në këtë shkrim. Vetëm dua të citoj diçka nga ky artikull. Në një vend thuhet: «Rreziku kryesor është empirizmi, fjalë të përdorura nga kryetari Mao për të kundërshtuar empirizmin idealist në vitet 50-të, u përdorën nga ata (domethënë nga Lin Biaoja dhe nga «katërshja» — Shënimi im) në vitet 70-të për të kundërshtuar kuadrot revolucionarë veteranë, që kishin përvojë praktike».

**Më tej, revizionistët kinezë demaskojnë në këtë artikull Lin Biao dhe «katërshen», duke i cilësuar pragmatistë, për të shfajësuar veten e tyre, për pikëpamjet pragmatiste që kanë vetë ata.**

Më në fund po citoj edhe një pasazh tjetër nga ky artikull. Pasi teorizohet mbi procesin e zhvillimit, lindjen e kontradiktave, etj., etj. dhe teorinë e famshme të kon-

tradiktave vulgare të Mao Ce Dunit, në artikull thuhet:

«Kryetari Mao theksoi qartë se partia nuk i kuptoi menjëherë ligjet që drejtojnë revolucionin kinez. Ai tha: Në qoftë se ndokush pretendon se ndonjë shok, për shembull, ndonjë shok i Komitetit Qendror, apo për këtë çështje unë vetë i kuptova plotësisht që në fillim ligjet që drejtojnë revolucionin kinez, atëherë ai është një mburravec dhe ju nuk duhet ta besoni atë. A nuk është kështu?».

«Në periudhën e revolucionit demokratik, — vazhdon artikulli, — partia arriti ta kuptonte këtë botë objektive të Kinës vetëm pasi arriti fitore, pastaj disfatë, fitore përsëri, pasaj disfatë përsëri, vetëm pasi ajo kishte bërë dy herë krahasime. Vetëm pas kësaj ajo e çoi revolucionin e ri demokratik në fitore të plotë. Njohuritë ndaj ligjeve që drejtojnë revolucionin socialist pas çlirimit në shkallë kombëtare nuk u fituan nga partia dhe kryetari Mao me një përpjekje».

Ky është thelbi kryesor i qëllimeve të këtij artikulli të «Zhenminzhibaos».

Tash le të vijmë te kryeartikulli i Rexh Bërçit, i datës 10 gusht 1978.

Ky është një artikull editorial i gazetës «The Worker», organ i Partisë Komuniste të Britanisë (marksist-leniniste).

Që në fillim aty shkruhet tekstualisht:

«Lidhur me Revolucionin e Tetorit Lenini ka thënë: «Ajo që është fituar nga revolucionin rus është e pamohueshme. Asnjë fuqi në botë nuk mund ta mohojë këtë». Këto janë fjalët e Leninit që citon Bërçi, dhe më poshtë ai e mbron këtë thënie pa asnjë diskutim dhe pa asnjë dyshim. Ai thekson se kjo është një fitore e madhe për popujt dhe për proletariatin, pavarësisht nga ajo që ngjau në Bashkimin Sovjetik.

Në këtë kryeartikull Bërçi nuk lë pa mbrojtur Sta-

linin, udhëheqësin e madh, që, siç thotë ai, e çoi popullin punonjës të Bashkimit Sovjetik drejt fitores mbi fashizmin. Më poshtë shkruhet tekstualisht:

«Një grup i vogël dhe qesharak intelektualësh borgjezë, që po përpiqen të rehabilitojnë Buharinin, duke sakrifikuar Stalinin dhe socializmin, janë vetëm një varg brezash shërbëtorë të fundit, urrejtja e të cilëve për Stalinin nuk bën gjë tjetër veçse provon shërbimin që ai i ka bërë klasës punëtore. Revizionistët, trockistët dhe një pjesë tjetër e borgjezisë, vazhdojnë në mënyrë të ethshme përpjekjet për të varrosur Stalinin dhe marksizmin bashkë me të, por përderisa punëtorët do të vazhdojnë luftën për t'i dhënë fund shfrytëzimit, shpirti i Stalinit është i gjallë midis nesh dhe komunikon me ne».

Në dukje kjo është e drejtë, por se sa të drejta janë mendimet dhe pikëpamjet filozofike të Bërçit, kjo është një çështje tjetër, që do ta shohim më poshtë. Kryeartikulli nuk mungon të flasë edhe për Shqipërinë: «Mposhtja, pa ndihmën e askujt, nga ana e Shqipërisë e forcave pushtuese të Italisë dhe të Gjermanisë fashiste dhe ndërtimi, duke u mbështetur në forcat e veta, i socializmit, përballë armiqtësisë së vendeve imperialiste, duke përfshirë edhe ish-miqte, është një fitore tjetër e pamohueshme jona». Kryeartikulli vazhdon:

«Në Kinë, gjithashtu, me gjithë devijimet e tanishme nga marksizmi, janë arritur fitore të mëdha proletare që janë të pamohueshme. Nën udhëheqjen e Partisë Komuniste të Kinës populli kinez u çlirua nga agresioni imperialist, kreu revolucionin dhe filloi transformimin e vendit të tij. Ushqimi, veshja dhe strehimi i 800 milionë njerëzve, që përbëjnë një të katërtën e popullsisë së botës, sigurimi i shëndetit të tyre dhe i mirëqenies, si dhe rritja e vazhdueshme e standardit të jetesës ishin disa nga arritjet e mëdha të socializmit dhe hodhën poshtë përgjithmonë pretendimin kapitalist se skamja dhe vuaj-

tja janë të pashmangshme për vendet e populluara dhe të pa-industrializuara. Klasa punëtore kineze mbushi të çarën e krijuar nga dezertimi i Bashkimit Sovjetik nga kampi socialist dhe u mobilizua jo vetëm për të ngritur nivelin e zhvillimit teknologjik të Kinës në nivele të pa-ëndërruara, por, gjithashtu, ajo e ndau këtë zhvillim me vendet socialiste vëllezër si Vietnam dhe Shqipëria.

Ne nuk mund ta harrojmë kurrë, — vazhdon krye-artikulli, — zemërgjerësinë e Kinës socialiste, kur, pasi bëri që të dështojë politika agresive e Indisë, lidhur me kufijtë e diskutueshëm, ushtria çlirimtare popullore ndaloi yryshin e pandalshëm të indianëve, liroi të gjithë të burgosurit, ktheu të gjitha armët e kapura» etj., etj. Pastaj ai vë në dukje se Mao Ce Duni e ka mbrojtur Shqipërinë, kur kjo sulmohej nga revizionizmi sovjetik. Dhe pas disa tiradave të tjera, konkluzioni i këtij krye-artikulli është ky që po citoj:

«Dhe duke kujtuar këto fitore, ne do të ndiejmë respektin më të madh vëllazëror për udhëheqësit e popullit kinez, Mao Ce Dunin, i cili kontribuoi në mënyrë kaq krijuese për botëkuptimin marksist-leninist, si dhe Çu En Lain. Hrushovi e denigroi Stalinin në kuadrin e fushatës për të eliminuar socializmin. Është një shpifje e madhe të pretendosh se idetë jomarksiste dhe kundërrevolucionare burojnë nga veprat e Mao Ce Dunit. Ata që veprojnë kështu ideologjikisht janë më afër grupit probuharinist të intelektualëve perëndimorë. Buharini thekson, gjithashtu, rëndësinë e forcave prodhuese, duke përjashtuar atë të marrëdhënieve në prodhim, me qëllim që të dobësonte dhe të eliminonte revolucionin».

«Të gjitha këto fitore dhe triumfe të klasës punëtore, — vazhdon kryeartikulli, — janë të pamohueshme, pavarësisht nga përpjekjet e shumta të njerëzve të ulët, të vegjël dhe meskinë në shërbim të kapitalizmit për t'i errësuar dhe për t'i minuar ato. Ne shprehim me forcë

të vërtetën e thellë të kësaj gjëje të pamohueshme, duke u hedhur në luftë klasore kundër shfrytëzimit, të inkurajuar, të ndriçuar dhe të vendosur nga shokët tanë rusë dhe kinezë, të cilët kanë hapur rrugë të reja para nesh».

Tash, duke pasur parasysh këta dy artikuj, mund të dalim me këto konkluzione: **me siguri është dhënë një orientim nga Pekini për ta trajtuar këtë problem kyç, mbrojtjen e «socializmit» në Kinë e sidomos mbrojtjen e maocedunidesë, domethënë Mao Ce Dunin si pasardhës të Marksit, Engelsit, Leninit e Stalinit, pra si një klasik i marksizëm-leninizmit.** Të gjitha frazat që tirren në këta artikuj, kuptohet se duan t'u kundërvihen pikëpamjeve të librit tonë «Imperializmi dhe revolucioni», mbi të cilin kanë marrë dijeni udhëheqës të partive marksiste-leniniste dhe një nga këta është edhe Rexh Bërçi. **Supozohet se në mos qind për qind, 99 për qind Rexh Bërçi është në lidhje me Hillin dhe me kinezët, të cilët i ka vënë në dijeni që Partia e Punës e Shqipërisë ka përgatitur materiale, ku atakon Kinën se kjo ecën në rrugën imperialiste, rrugë që udhëhiqet nga maocedunideja, që nuk është marksizëm-leninizëm dhe se në Kinë aktualisht, por edhe në kohën e Mao Ce Dunit, nuk ndërtohej socializmi, se ekzistonin disa shfaqje në ekonomi ose në politikë, që mund të çonin në socializëm, por revolucioni mbeti në mes të rrugës.**

**Pra, kinezët kanë hartuar gjoja mbrojtjen teorike për këtë problem të ardhshëm që do t'u dalë përpara si barrierë në ecjen e tyre drejt një shteti socialimperialist. Theksin, pra, kinezët e vënë mbi idenë që marksizëm-leninizmi dhe maocedunideja janë një e të pandarë, janë rrjedhim logjik i teorisë që duhet të udhëheqë për ndërtimin e botës së re. Me fjalë të tjera, marksizëm-leninizmi është uniteti i teorisë së Marksit, Engelsit dhe Leninit, e, sipas kinezëve, meqë kjo teori ishte e përshtatshme për kohët e mëparshme, idetë e Mao Ce Dunit, «që për-**

bëjnë vazhdimin e marksizëm-leninizmit», janë të përshtatshme për sot, prandaj përbëjnë një të tërë objektive sikundër është bota, siç thonë kinezët, dhe kush i ndan këto, nuk është marksist, nuk e kupton marksizëm-leninizmin. Pra, Mao Ce Duni, sipas tyre, është një «klasik» dhe nuk mund të ndahet as nga Marksi, as nga Engelsi dhe as nga Lenini, se Stalinin ata e kanë hedhur tej.

Për kinezët ata që e pranojnë këtë formulë: «marksizëm-leninizëm — idetë e Mao Ce Dunit», pranojnë se ky është një sistem i plotë dhe integral dhe nuk ka tjetër sistem për revolucionin dhe për shkuarjen në socializëm. Parimet e tij, sipas kinezëve, janë në një unitet të brendshëm organik dhe jo të sajura kot. Me fjalë të tjera, ne, shqiptarët, që Mao Ce Dunitin nuk e quajmë marksist-leninist, por e quajmë një eklektik, një demokrat revolucionar, bëjmë gabimin më të madh. Pra, si rrjedhim, ne e çajmë idenë ose sistemin e plotë integral, «marksizëm-leninizëm — idetë e Mao Ce Dunit», me të cilin do të mësojë dhe do të ndryshojë bota.

Ata duan të na thonë që ju, shqiptarët, shkatërroni misionin e plotë të marksizmit kur kërkonin të vërtetoni se maocedunideja nuk është marksizëm-leninizmi. Gjoja për ta mbështetur këtë pikëpamje të tyre antimarksiste dhe reaksionare, ata përdorin thëniet e Leninit që e quan filozofinë e Marksit dhe të Engelsit të derdhur nga një copë e vetme çeliku. Pse e përdorin ata këtë thënie të Leninit? Që këtij çeliku të vetëm t'i shtojnë një copë çelik fals dhe të ndryshkur. Në qoftë se Lenini i ka demaskuar buharinistët, trockistët e të tjerë, që kërkonin ta çanin këtë çelik, por nuk e çanin dot, revizionistët kinezë nuk mund të na krahasojnë dot kurrë ne me buharinistët e me trockistët, pse kërkojmë të ndajmë teorinë antimarksiste të Mao Ce Dunit nga marksizëm-leninizmi. Ne këtë gjë e bëjmë për të ruajtur pastërtinë e marksizëm-leninizmit, pra, për ta mbrojtur e jo për ta përçarë

marksizëm-leninizmin. Ne e mbrojmë teorinë tonë shkencore me fakte e me dokumente, duke u mbështetur në marksizëm-leninizmin. Përrallat e revizionistëve dhe të reaksionit botëror nuk i beson kush. Janë revizionistët kinezë ata që falsifikojnë marksizëm-leninizmin, janë ata vetë borgjezë reaksionarë dhe kurrë ne.

«Tërësia dhe saktësia, — thuhet në artikullin e kinezëve, — janë kërkesat bazë në sistemin shkencor të marksizëm-leninizmit — idetë e Mao Ce Dunit». Por nuk mund të jetë kurrë kështu, përkundrazi, ndarja e marksizëm-leninizmit nga idetë antimarksiste të Mao Ce Dunit është një kërkesë objektive e domosdoshme që duhet mbrojtur me të gjitha forcat, pse, po të mos mbrohet kjo, atëherë shtrembërohet realiteti dhe mbrohet falsiteti. Kinezët janë falsifikatorë të historisë dhe të ideologjisë marksiste-leniniste.

Tezën e kinezëve po e mbron edhe Rexh Bërçi. Ky, në kryeartikull, si konkluzion thotë se janë shokët bolshevikë dhe shokët kinezë që na hapën rrugët për në socializëm. Kjo është një teori false, një teori armiqësore për marksizëm-leninizmin. Nuk mund të thuhet kurrë për maoizmin se na udhëheq në socializëm, sepse në socializëm dhe në komunizëm na udhëheq vetëm marksizëm-leninizmi.

Pra, tezat e revizionistit dhe të renegatit Bërç janë të njëjlojta me ato të revizionistëve dhe të renegatëve kinezë, por ai e pozon problemin me djallëzi, gjoja paraqitet si antihrushovian, paraqitet kundër Hua Kuo Fenit e Ten Hsiao Pinit, mbron Bashkimin Sovjetik leninist-stalinian, mbron Shqipërinë socialiste, mbron edhe socializmin maoist dhe idetë e Mao Ce Dunit dhe, si konkluzion, thotë se kush i atakon idetë e Mao Ce Dunit është një buharinist si intelektualët perëndimorë.

Në ato citatë të artikullit të «Zhenminzhibaos» që përmenda më sipër, të bie në sy mënyra që përdorin ki-

nezët për të na atakuar ne, natyrisht, duke marrë për «kokë turku» Lin Biao dhe «katërshen». Atyre u është raportuar për idetë e përgjithshme të librit «Imperializmi dhe revolucioni», por nuk kanë dijeni të plotë rreth tij, prandaj në artikull tërthorazi polemizohet me ne, duke prekur problemin e empirizmit, të eklektizmit kinez etj. Pra, kinezët në këtë artikull përpiqen të japin mendime, po si i japin këto mendime? A mund ta luftojnë ata empirizmin që ka ekzistuar në Kinë jo vetëm në vitet 50-të, por që përpara dhe deri tash? Nuk mundën dot dhe përpiqen të krijojnë një ndarje, gjë që bëhet prej tyre në mënyrë aq banale, sa të bën të qeshësh. Si bëhet kjo ndarje? Vetëm duke përdorur një thënie të Mao Ce Dunit që e theksova edhe më lart, se «rreziku kryesor është empirizmi». Këtë e ka thënë Maoja, domethënë pranohet që ka ekzistuar ky rrezik në Kinë, por këta tani shtojnë se Maoja këtë e ka përdorur për të kundërshtuar empirizmin idealist në vitet 50-të, pra në vitet 50-të ka pasur empirizëm, por ky ka qenë empirizëm idealist, kurse empirizmi i Mao Ce Dunit, sipas kinezëve, nuk ka qenë idealist. Si nuk paska qenë i tillë, kur vetë Maoja dhe idetë e tij kanë qenë idealiste? Renegatët aktualë kinezë shtojnë se këtë citat të Maos e përdori Lin Biaoja në vitet 70-të për të kundërshtuar Çu En Lain, Ten Hsiao Pinin, Li Hsien Nienin, Hua Kuo Fenin dhe të gjithë këta që bënë puçin. Me fjalë të tjera, duan të na thonë: Edhe ju shqiptarët, që na akuzoni ne si empiristë, nuk jeni përveçse në ujdë të plotë me bandën e «katërshes» dhe me teoritë idealiste a çfarë të duash të Lin Biaos. Logjikë «të fortë» kanë këta kinezët!

Pjesëtarët e «katërshes» i akuzojnë në këtë artikull se ishin pragmatistë pse thonë se çdo gjë e dobishme për ta ishte e vërtetë. Këtë mund ta thoshin ata, por jo për çdo gjë ata thoshin se është e vërtetë. Pohonin se kishte dhe jo të vërteta, kishte edhe gënjeshtër, prandaj nuk

arrihet aq kollaj që me një të rënë të shkëputit t'i akuzosh ata për pragmatistë dhe me një dush të lehtë të shpëlahesh vetë nga pragmatizmi i theksuar, domethënë nga antimarksizmi.

**Një çështje, të cilën ne e kemi shtruar, që u djeg shumë kinezëve dhe ka rëndësi të madhe për ta është: A ndërtohej socializmi në Kinë para revolucionit dhe pas revolucionit? Prandaj ata përpiqen që ta arsyetojnë dhe ta pranojnë deri diku, gjoja, si një zhvillim dialektik të historisë të të kundërtave, se vetë Mao Ce Duni ka thënë që partia nuk i kishte kuptuar mirë dhe plotësisht ligjet që drejtonin revolucionin kinez që në fillim. Kurse në periudhën e revolucionit demokratik partia arriti ta kuptonte këtë botë objektive, thonë kinezët, por vetëm kur arriti fitoren. Dhe, për ta arritur këtë fitore, ajo pësoi disfatë, fitoi përsëri, pastaj pësoi disfatë përsëri, pastaj fitoi përsëri e të tjera kontradikta të tilla. Por çfarë fshehin të gjitha këto kontradikta?**

**Nuk është çështja e zhvillimit dialektik, por është çështja e vijës së Partisë Komuniste të Kinës që nuk ishte një vijë marksiste-leniniste, por një vijë eklektike, një vijë borgjeze e lëkundshme, pra, ajo i shkaktonte këto disfata dhe këto «fitore» e që nuk e lejonte Partinë Komuniste të Kinës të kuptonte ligjet e revolucionit. Në qoftë se ata do të kishin ndjekur marksizëm-leninizmin dhe do të kishin marrë eksperiencën e Revolucionit të Madh të Tetorit e të ndërtimit të pushtetit të proletarëve në Bashkimin Sovjetik, atëherë do t'i kuptonin edhe ligjet e revolucionit demokratiko-borgjez, edhe ligjet e revolucionit socialist. Pra arsyeja që nuk i kuptuan këto është se ata nuk ishin në rrugën marksiste-leniniste dhe nuk mësuan nga gjithë kjo eksperiencë që theksova më lart.**

Ne duhet të ndjekim zhvillimin e mëtejshëm të propagandës antimarksiste kineze dhe të shërbëtorëve të saj,

që do të dalin në skenë si rezultat i luftës së drejtë që po bëjnë dhe do të bëjnë edhe në të ardhmen Partia jonë si dhe partitë e tjera marksiste-leniniste. Por, siç e kam thënë edhe herë të tjera, borgjezia kapitaliste do të bëjë përpjekje që ta ruajë figurën e Mao Ce Dunit, si figurë të një «marksist-leninisti të madh» dhe idetë e tij si ide që gjoja i shërbejnë revolucionit proletar. Me fjalë të tjera, idetë e Mao Ce Dunit, borgjezia reaksionare do t'i përdorë si pompa për të shuar zjarrin revolucionar në botë, prandaj lufta jonë ka një rëndësi të madhe dhe duhet që çdo artikulli, i cili do të përpiket të shtrembërojë teorinë marksiste-leniniste, t'i përgjigjemi me fakte teorike dhe politike, t'i demaskojmë këto shtrembërime dhe të gjithë ata njerëz ose ato parti, që do të ndjekin këtë strategji dhe këto taktika të imperializmit e të revizionizmit modern.

**Ne jemi në gjendje t'i bëjmë ballë kësaj furtune, e cila aktualisht ka filluar e do të vazhdojë midis atyre që mbrojnë Mao Ce Dunin si marksist-leninist dhe maocedunidenë si një pjesë organike të marksizëm-leninizmit, dhe të tjerëve që janë kundër Mao Ce Dunit si një marksist-leninist dhe maocedunidesë si një unitet organik me marksizëm-leninizmin. Pra, ne do ta luftojmë këtë unitet fals që kërkojnë t'u imponojnë revizionistët kinezë dhe kapitalizmi botëror partive komuniste marksiste-leniniste të vërteta dhe proletare të të gjithë botës.**

E ENJTE

7 SHTATOR 1978

## STRATEGJIA E KINËS NË AZINË JUGLINDORE

**HSINHUA**-ja jep një koment politik me titull: «**Të jemi vigjilentë ndaj ngritjes së kryeurës së besueshme të Bashkimit Sovjetik në Azinë Juglindore**».

Ky koment ose shënim zbulon të gjitha qëllimet kolonialiste shtypëse, ekspansioniste të Kinës aktuale dhe përpjekjet e saj për ta gjunjësuar dhe për ta nënshtuar Vietnamin. Natyrisht, Vietnami, i djegur nga lufta, kërkon të rindërtojë vendin dhe për këtë ai ka nevojë për ndihma, duke ruajtur lirinë, pavarësinë dhe sovranitetin e vet. Por propaganda kineze thotë se Bashkimi Sovjetik e ka deklaruar haptazi që Vietnami është një «kryeurë e besueshme e socializmit në Azinë Juglindore» dhe se ai ka shprehur «përkrashjen e tij të vendosur» për përpjekjet e Vietnamit «për të forcuar pozitën e tij ndërkombëtare». Forcimi i pozitave të Vietnamit, sidomos në Azinë Juglindore, vihet në dukje në koment, i shërben social-imperializmit sovjetik.

Kjo është teza aktuale strategjike e Kinës, të cilën ajo e ka mbështetur edhe me versionin tjetër, që Vietnami kërkon të krijojë një federatë indokineze, të gllabërojë Laosin e Kamboxhian dhe të bëhet kështu një rrezik për Kinën. Për këtë arsye, nga njëra anë, Kina mbështet me armë, me municione e me ushqime Kamboxhian, që është bërë një satelite e saj agresore kundër Vietnamit dhe, nga ana tjetër, përdor, siç e dimë, kolonën

e pestë, kinezët, që rrojnë prej kohësh në Vietnam, për të realizuar qëllimet e saj hegjemoniste dhe ekspansioniste. Në fillim Kina kërkoi t'i tërhiqte njerëzit e popullsisë «hoa» me origjinë ose kombësi kineze, se gjoja ata persekutoheshin nga vietnamezët, kurse tash ajo kërkoi t'i futë përsëri në Vietnam. Dhe që t'ia arrijë këtij qëllimi, Kina s'po lë gjë pa bërë. Ajo ndërmer provokacione, shkel kufijtë tokësorë, ajrorë dhe detarë që si e si ta futë brenda në Vietnam këtë kolonë të pestë.

Gjithashtu Kina ka kohë që po dërgon emisarët e vet, nga më kryesorët, si Ten Hsiao Pinin, Li Hsien Nienin e të tjerë, në të gjitha vendet e Azisë Juglindore, që nga Birmania në Filipine, në Singapor dhe tash kërkoi t'i dërgojë edhe në Indonezi. Ajo i buzëqesh Indonezisë i buzëqesh Indisë e kujtdo, mjafton që ky ose ai shtet të ketë disa tendenca antisovjetike. Qëllimi i Kinës është që të dominojë politikisht, ideologjikisht dhe ushtarakisht mbi gjithë ASEAN-in, prandaj e shikon me zemërim dhe me xhelozë Vietnamin, i cili përpiqet të krijojë miqësi me vendet anëtare të kësaj shoqate, që ta ndihmojnë në ndërtimin e vendit të shkatërruar nga lufta. Një gjë e tillë, natyrisht, Kinës nuk i pëlqen dhe, pra, këto përpjekje të Vietnamit i konsideron djallëzore, të nxitura. të përgatitura e në ujdi me Bashkimin Sovjetik.

Aktualisht Kina ka ngritur teorinë e dhënies së këshillave vendeve të Azisë Juglindore. Ajo u thotë se kjo «kryeurë e besuar» vietnameze është një taktikë e sovjetikëve për të krijuar një hegjemonizëm rajonal, duke organizuar federatën indokineze dhe do të jetë një mjet agresioni i armatosur i njëpasnjëshëm kundër Kamboxhias dhe vendeve të tjera të ASEAN-it.

**Të njëjtën këshillë Kina ua jep edhe vendeve të «Evropës së Bashkuar», duke u thënë që të kenë kujdes nga Bashkimi Sovjetik, se ai do të sulmojë Evropën. Po këtë këshillë u dha Hua Kuo Feni edhe Titos dhe Çau-**

sheskut në Ballkan: Kini kujdes, se Bashkimi Sovjetik do t'ju sulmojë. Pra Kina ka dalë të shesë mend nga të katër anët e botës, duke folur për rrezikshmërinë e Bashkimit Sovjetik dhe për shpalljen e luftës nga ana e tij.

**Strategjia e Kinës në Azinë Juglindore synon të krijojë përshtypjen se kjo kryeurë gjoja do të zëvendësojë shoqatën e ASEAN-it, që është nën drejtimin e saj, me një sistem sigurimi kolektiv në Azi. Në të vërtetë Kina dëshiron ta ketë nën kontrollin e vet ASEAN-in, prandaj, siç e vura në dukje, miqësinë e Vietnamit me vendet e Azisë Juglindore ajo e quan si një maskë të veprimtarisë sovjetike kundër këtyre vendeve.**

Kina e akuzon Vietnamin pse propagandon dhe lavdëron propozimin e Bashkimit Sovjetik që në Azinë Juglindore të vendoset «një rajon paqeje, lirie dhe asnjansiesie».

**Kremlini filloi përsëri të tundë shkopin e tij, — thotë Kina, — kur vendet e ASEAN-it filluan të dyshojnë dhe të qëndrojnë vigjilente kundër intrigës sovjetike. . . Mirë, po Kina çfarë po bën? Edhe ajo po tund shkopin e vet nga të katër anët e botës. Pra, që të dyja këto superfuqi kanë ngritur shkopin dhe përpiqen kush e kush ta zaptojnë botën dhe të akuzojë njëra-tjetrën për hegjemoni.**

Kina mbron hapur konferencën e 3-4 gushtit në Uashington, një konferencë ministeriale midis Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe ASEAN-it për të diskutuar «bashkëpunimin ekonomik» dhe «marrëdhëniet me leverdi reciproke». Menjëherë Kremlini, — thotë Kina, — vuri në lëvizje makinën e tij propagandistike kundër kësaj konference, duke thënë gjoja se ASEAN-i do të futet nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës «në rrugën e militarizmit» dhe «krijimit të një blloku ushtarak». Pra, hap-tazi, Kina mbron veprimtarinë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe dënon veprimtarinë e kundërt të Bashkimit Sovjetik. **Duket qartë që edhe Bashkimi Sovjetik, edhe**

**Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë qëllime të mbrapshta dhe që Pekini mbron Uashingtonin.**

Por Kina nuk mjaftohet me kaq, shkon edhe më tej. Me strategjinë e saj, tash të hapur, ajo thotë se kryeura sovjetike në Azinë Juglindore, domethënë Vietnam, drejtohet, gjithashtu, kundër Japonisë, Australisë dhe vendeve të tjera të «botës së dytë» në Evropën Perëndimore, që kanë marrëdhënie tradicionale dhe të ngushta me vendet e Azisë Juglindore. Kjo, — vazhdon komenti i HSINHUA-së, — përbën një kërcënim veçanërisht për Japoninë. Dhe, duke marrë thënie nga një artikull i një gazete japoneze, ku thuhet se «Vietnami do të jetë një bazë e rëndësishme për flotën sovjetike në Paqësor» dhe kështu paraqet një «kërcënim të madh ushtarak për Japoninë», Kina tjerë më tutje, duke cituar një gazetë tjetër japoneze se «infiltrimi sovjetik dhe ekspansioni sovjetik në rajonin e ASEAN-it, duke shfrytëzuar Vietnamin mund të paraqesë rrezikun e prerjes së arteries për Japoninë». «Dy arterie komunikimi të rëndësishme për ekonominë e Japonisë ndodhen në rajonin e ASEAN-it, njëra për naftën e Lindjes së Mesme dhe të Lindjes së Afërt dhe tjetra për mineralin e hekurit australian. Të dyja këto arterie bashkohen në këtë rajon».

Dhe më poshtë komenti vazhdon: «Kur u nënshkrua kohët e fundit Traktati i paqes dhe i miqësisë midis Kinës dhe Japonisë, ishte kjo «kryeurë» që e sulmoi atë me tërbim menjëherë pasi u sulmua nga Moska».

Si konkluzion, në këtë koment kinezët thonë se përdorimi i Vietnamit si «kryeurë» në agresionin dhe në ekspansionin e Bashkimit Sovjetik në Azinë Juglindore është një pjesë e rëndësishme e strategjisë globale të Moskës në rivalitetin për hegjemoni botërore me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Tani Evropa është qendra e këtij rivaliteti. Në Azi dhe në Afrikë Bashkimi Sovjetik po përdor «dy palë darë» për të pakësuar ndikimin ame-

rikan dhe për të rritur epërsinë e tij. Një palë darë janë forcat kubane, që i shërbejnë Moskës në Afrikë dhe pala tjetër janë autoritetet vietnameze që njihen si «Kuba në Azi». Kuptohet që janë pikërisht kinezët ata që ua kanë vënë këta tituj kubanezëve.

Me këtë ata duan të thonë se Bashkimi Sovjetik po përdor dy palë darë, njëren nga Lindja dhe tjetren nga Perëndimi për të forcuar pozitën e tij dhe për të dobësuar pozitën e superfuqisë amerikane në botë. Pastaj thuhet se duke zëvendësuar ASEAN-in me sistemin e sigurimit kolektiv në Azi, Bashkimi Sovjetik mund t'i detyrojë Shtetet e Bashkuara të Amerikës të tërhiqen nga Paqësori në Lindje dhe të presë rrugën e tyre detare nga Paqësori në Oqeanin Indian në Perëndim, duke i vënë kështu ato në gjendje të vështirë ekonomike e ushtarake dhe duke lehtësuar bashkimin e rajoneve aziatike dhe evropiane të Bashkimit Sovjetik me anë të rrugëve detare.

Kuptohet qartë se me një strategji të tillë të qepur me pe të bardhë perandoria e re kineze kërkon t'u tregojë Shteteve të Bashkuara të Amerikës se Bashkimi Sovjetik përbën një rrezik të madh për to jo vetëm në Evropë, siç thoshte dje, por aktualisht edhe në Azi. Me këtë Kina tregon haptazi se Traktati Kino-Japonez, që u realizua nën patronazhin amerikan prapa krahëve, është një traktat ushtarak që drejtohet kundër Bashkimit Sovjetik, pra për ta sulmuar atë dhe për t'u mbrojtur nga ai.

Natyrisht, Bashkimi Sovjetik imperialist nuk rri e nuk do të rrijë me duar lidhur. Ashtu sikundër superfuqitë e tjera imperialiste: Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Kina dhe militarizmi japonez, i cili është forcuar jashtëzakonisht shumë, po bashkohen kundër tij, po ashtu edhe ky do të veprojë kundër tyre, për të çarë rrethimin dhe për t'u prishur planet. Është e qartë se të gjitha këto përpjekje do të bëhen duke thelluar kontradiktat deri në shpërthimin e një lufte botërore. Por Kina për-

piqet t'i bindë Shtetet e Bashkuara të Amerikës se Bashkimi Sovjetik aktualisht vepron në Azinë Juglindore, gjoja nëpërmjet Vietnamit, dhe rrezikon rrugët e Paqësorit e të Oqeanit Indian, rrezikon transportimin e naftës së Lindjes së Mesme.

**Është e vërtetë që Bashkimi Sovjetik e përbën këtë rrezik, por edhe shtetet e tjera imperialiste këtë punë po bëjnë. Edhe Kina, që hiqet si një vend socialist, po e tregon hapur se e gjithë politika, strategjia dhe taktika e saj janë socialimperialiste, në unitet me imperializmin amerikan dhe japonez kundër revolucionit në botë, kundër socialimperializmit sovjetik, i cili kërkon të ruajë pozitat e fituara dhe t'i zgjerojë këto në kurriz të popujve liridashës dhe të superfuqive të tjera, Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Kinës dhe Japonisë.**

**Pra, duket qartë që Traktati Kino-Japonez, i mbështetur nga imperializmi amerikan, është një traktat luftënxitës, ekspansionist, imperialist. Dhe, që të konkretizohet si duhet kjo aleancë, domethënë që Kina të bëhet një superfuqi me një ushtri me të vërtetë moderne, të pajisur edhe me armë atomike dhe që Japonia, gjithashtu, të ketë bombën atomike, aktualisht si «kokë turku» po merret Vietnami, i cili akuzohet si një «kryeurë e besuar» e Bashkimit Sovjetik në Azi që rrezikon Kinën, Japoninë, si dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës me luftë dhe me ekspansion.**

Kjo është një lojë e turpshme e imperializmit kinez, një manovrim politik dhe ushtarak për të dalë nga situata e turbullt dhe e papranueshme botërore që ka krijuar, duke thënë se rreziku iminent për shpërthimin e një luftë në shkallë ndërkombëtare ekziston në Evropë. Tash Kina ngre edhe rrezikun e një lufte në Azi, pra përpiqet të krijojë dy pole të rrezikshme të luftës së ardhshme botërore. Është e qartë se revizionistët kinezë qëndrojnë në pozitat e nxitjes së luftës në Evropë e kudo në botë.

Ten Hsiao Pini përgatitet të vejë në Japoni për të ratifikuar traktatin famëkeq që u përfundua midis dy vendeve, por dje ose pardje, në qoftë se nuk gabohem, Hua Kuo Feni u deklaroi haptazi gazetarëve se Japonia nuk duhet ta ndihmojë me kredi dhe me teknologji Vietnamin, për arsye se ky po bëhet një kryeurë kundër Kinës dhe kundër Japonisë.

**Duket sheshit që Kina me të gjitha mjetet përpiqet ta izolojë Vietnamin ose, si të thuash, ta likuidojë Republikën Demokratike Popullore të Vietnamit dhe ta bëjë këtë një satelite të bindur të saj, sikundër ka bërë Kamboxhian. Këtë thirrje, me të njëjtin argumentim, për t'i prerë ndihmat Bashkimit Sovjetik, ajo ua ka bërë edhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, edhe Tregut të Përbashkët Evropian. Kina vepron kështu se vetë përfiton nga ndihmat amerikane dhe nga ndihmat e Tregut të Përbashkët Evropian për të qenë në gjendje që të kryejë një agresion kundër Bashkimit Sovjetik. E tillë është logjika e strategjisë dhe e politikës kineze.**

Ne e shikojmë pozitën e vështirë të Vietnamit. Vietnami ka bërë një luftë heroike që ka çuditur gjithë botën. Ai mundi superfuqinë më të madhe botërore, agresorët më të tërbuar që ka parë njerëzimi, që janë më të tërbuar se hitlerianët. Aktualisht këta hitlerianë të rinj janë miqtë dhe aleatët e Kinës pseudosocialiste. Ne e kemi mbrojtur sinqerisht Vietnamin gjatë gjithë kohës së luftës, por nuk kemi munguar të bënim edhe kritika për disa veprime të tij në fushën e luftës ose në çështjet politike.

**Sot ne përsëri e mbrojmë Vietnamin, sepse shohim që Kina ka qëllime të këqija ndaj tij, por nuk mund të themi se s'ka qëllime të tilla edhe Bashkimi Sovjetik. Dëshira jonë është që Vietnami t'u bëjë ballë të dyja fuqive imperialiste, si Kinës edhe Bashkimit Sovjetik dhe**

të mos bjerë në gabime fatale që krahu oportunist e revizionist të lidhet me Bashkimin Sovjetik. Një gjë e tillë duhet mbajtur mirë parasysh nga Vietnami, se në këto situata të vështira Bashkimi Sovjetik do të bëjë përpjekje që, nën maskën e ndihmës për Vietnamin, i cili kërcënohet nga Kina, të futet brenda dhe, natyrisht, të krijojë një situatë të mirë për vete, por të vështirë për popullin vietnamez, duke i dhënë në këtë mënyrë armë socialimperializmit kinez në luftën e tij kundër Vietnamit. E gjithë kjo punë varet nga qëndrimi i drejtë marksist-leninist, burrëror, trimëror, i palëkundshëm e sovran i Vietnamit. Se ç'qëndrim do të mbajë ky, këtë do ta shohim.

**Në këtë drejtim Vietnami ka një shembull. Kjo është Shqipëria, e cila është në luftë me të gjithë, kërcënohet nga të gjithë dhe mund të sulmohet nga të gjithë. Ajo është sulmuar më parë, mund të sulmohet edhe sot, edhe nesër, por qëndrimet e saj, organizimi i mirë i punës, marrja e masave të domosdoshme për forcimin e situatës së brendshme, strategjia dhe taktika e saj e frymëzuar nga një politikë e qartë, largpamëse, që bazohet në marksizëm-leninizmin, e bën Shqipërinë e vogël një kështjellë të fortë, që nuk ka frikë nga askush dhe nuk i trembet syri nga kërcënimet që i turren.**

Në qoftë se Vietnami arrin të mbajë qëndrime të tilla, pra të ndërtojë një politikë të tillë dhe ta organizojë e ta forcojë punën brenda, të fuqizojë ekonominë, të përgatitet ushtarakisht, sepse kërcënohet aktualisht nga Kina, atëherë ai do të dalë patjetër me sukses nga këto vështirësi. Pastaj planet, që Kina i harton me kaq lehtësi, nuk do të kenë suksesin që mendojnë Hua Kuo Feni dhe Ten Hsiao Pini. Opinioni botëror nuk do t'i pranojë këto strategji luftënxitëse të Kinës socialimperialiste. Imperializmi amerikan di ç'bën dhe di kur rrezikohen e sa rrezikohen rrugët e oqeanit Paqësor dhe ato të Oqeanit

Indian. Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë përgatitur me kohë për këtë mbrojtje dhe aktualisht po përgatitin edhe Japoninë. Kështu që Kina nuk do të arrijë ta bëjë këtë një satelit të saj, pra që ajo të punojë për interesat e Kinës dhe si të dojë Kina. Japonia do t'i shikojë mirë interesat e saj.

**E MARTË**  
**12 SHTATOR 1978**

## **PËR TË QESHUR E PËR TË QARË**

Për çështjen kineze jemi preokupuar mjaft. Një gjë e tillë ndodh sepse ajo ka rëndësi të madhe botërore. Prandaj në këto pak shënime nuk do të flas shumë për Kinën, megjithatë do të them disa gjëra për të qeshur dhe për të qarë, që vërtetojnë jo vetëm pragmatizmin e politikës kineze, por edhe një papjekuri të madhe të kësaj politike.

Revizionistët kinezë për të sulmuar Bashkimin Sovjetik jo me emër, përdornin termin «hegjemonizëm». Kur ata zinin në gojë këtë term, mendonin se gjithë bota duhej ta kuptonte se ishte fjala për socialimperializmin sovjetik.

Pse e bënin ata këtë gjë? Natyrisht e bënin se socialimperializmi sovjetik kërkon hegjemoni, por edhe vetë revizionistët kinezë kërkojnë hegjemoni, pra ata e bënin këtë për të bërë dallimin midis vetes së tyre dhe Bashkimit Sovjetik. Ata, gjithashtu, përdornin termin «hegjemonizëm» për të mos zënë në gojë drejtpërdrejt Bashkimin Sovjetik, veçanërisht në manifestimet zyrtare. Pra, kështu ishin «të detyruar» të vepronin në manifestimet ose në vizitat e ndryshme që bënin udhëheqësit kinezë në vende të tjera, sepse ata gjendeshin në pozita të vështira dhe, për hatër të miqve që kishin ftuar ose të mikpritësve ku ishin ftuar, nuk mund ta zinin dot

në gojë Bashkimin Sovjetik me emër, prandaj në vend të tij përdornin termin «hegjemonizëm».

**Kur Hua Kuo Feni shkoi në Jugosllavi, fjalën hegjemonizëm e përdori për qëllimin që dimë, por edhe Titoja e përdori këtë fjalë, duke thënë se «ne jemi kundër hegjemonizmit të shteteve të tjera». Këtu, natyrisht, dukej identiteti i mendimeve të Hua Kuo Fenit dhe të Titos, por, pasi iku miku nga Jugosllavia, Titoja, tash së fundi, mbajti një fjalim dhe bëri një shpjegim «të drejtë» se ç'do të thotë hegjemonizëm. Ai, me pak fjalë, tha që nuk ekziston vetëm një hegjemonizëm, por ekzistojnë shumë hegjemonizma, domethënë ka shumë shtete që kërkojnë të jenë hegjemone. Me një pohim e shpjegim të tillë Titoja u nda nga Hua Kuo Feni në këtë çështje dhe u tha sovjetikëve që «fjalën hegjemonizëm unë e përdora duke pasur parasysh shpjegimin që jep diksioneri për të, domethënë nuk e drejtova kundër jush».**

**Këtë Hua Kuo Feni e vuri re tash në festën «madhështore» të themelimit të Republikës Popullore Demokratike të Koresë, ku ishin ftuar 100 delegacione, mbretërisht, presidentësh, kryeministrash, zëvendëskryeministrash etj. Natyrisht, «udhëheqësi i gjithë botës», siç e quan propaganda koreane Kim Ir Senin, do të fliste me këtë rast kundër dikujt, që gjoja pengon planet e tij për bashkimin e vendit në një Kore të vetme. Kuptohet, gjithashtu, se ai nuk do të fliste as kundër Bashkimit Sovjetik, as kundër Kinës, se me të dy këto shtete ai është në miqësi. Veçse kur Kina nuk i jep para Kim Ir Senit, atëherë fillon dobësohet miqësia midis Koresë e Kinës, dhe forcohet, del në plan të parë, miqësia midis Koresë dhe Bashkimit Sovjetik.**

**Aktualisht Kina e ka mirë me Korenë. Është ngritur vlera e Kinës në sytë e Kim Ir Senit dhe është ulur ajo e Bashkimit Sovjetik, sepse ai është një batakçi i tillë, që lavdëron atë që i jep më shumë. Por Kina, përveç ndih-**

mës materiale që i jep Koresë, i jep asaj edhe shpresa se do ta ndihmojë, duke ndikuar tek amerikanët gjoja për të gjetur një zgjidhje për bashkimin e Koreve, bashkim që tash Kim Ir Seni e pranon edhe pa u bërë asnjë ndryshim në regjimin e Koresë së Jugut.

Por çështja është këtu, që termi «hegjemionizëm» u zhdruk si nga fjalori i Kim Ir Senit, ashtu edhe nga ai i Ten Hsiao Pinit dhe u zëvendësua me fjalët «shtet dominues». Domethënë «hegjemionizmi», pas kritikës së Titos, u bë «shtet dominues». Kush është ky «shtet dominues»? Është ai shtet, që kërkon t'u imponojë të tjerëve ligjet e tij, natyrisht, larg mendimit se Kina e bën një gjë të tillë vetë. Por, në qoftë se ka një shtet që me të vërtetë kërkon t'u imponojë të tjerëve mendimet e veta, është pikërisht Kina. Fakt është se ajo ka kërkuar t'u imponojë pikëpamjet e saj Shqipërisë, Vietnamit, por të njëjtën gjë kërkon ta bëjë edhe me të tjerët.

Çështja tjetër është teoria e «botës së tretë». Udhëheqësit kinezë po shohin se kjo teori bëri fiasko, prandaj kanë filluar të heshtin, ose të flasin shumë pak për të, apo ta bashkojnë atë me «botën e paangazhuar». Kjo është taktika kineze, taktika e bashkimit të dy gjërave të kundërta! Marksizëm-leninizmin, shkencën tonë të lavdishme, ata e bashkojnë me maocedunidenë, që është diçka e palavdishme dhe antimarksiste. Duke vepruar në këtë mënyrë ata kanë krijuar termin «marksizëm-leninizëm-maocedunide», për t'i treguar botës se «shoqëria sot do të ecë sipas idesë së Mao Ce Dunit», që në vetvete gjoja përfaqëson marksizëm-leninizmin, i cili na qenka vjetruar. Megjithatë, duan të thonë kinezët, «ne e ruajmë këtë teori në kujtesë, natyrisht, pa e zbatuar, se për zbatim sot është maocedunideja, që është marksizëm-leninizmi në përputhje me kushtet aktuale».

Pra, revizionistët kinezë tash që panë se «bota e tre-

të» s'ka më sukses, mendojnë që këtë ta bashkojnë me «lëvizjen e të paangazhuarve», që gjoja po e udhëheq Titoja. «Lëvizja e të paangazhuarve», siç e kam theksuar edhe herët e tjera, s'ka asnjë kuptim, se shtetet që përfshihen në këtë lëvizje, janë të angazhuara dhe pikëpamjet e tyre janë të ndryshme. Në mes tyre ekzistojnë antagonizma të mëdhenj, ato s'kanë asnjë qëllim të përbashkët ose qëllimet e tyre të përbashkëta janë të shturura dhe të ndryshme në potencial, në kohë, në ideologji e në politikë. Megjithatë, udhëheqësit kinezë, duke menduar se «bota e tretë» s'pati sukses dhe se «bota e paangazhuar» gjoja ka një konsistencë më të pëlqyeshme për imperia-lizmin amerikan, i bashkuan të dyja këto dhe tash flasin për «botën e paangazhuar» dhe «botën e tretë». Domethënë ata këto dy botë i bënë një, me mendimin që nesër ta trashëgojnë këtë «lëvizje të paangazhuar» të titistëve, se «të paangazhuar» do të hiqen edhe kinezët, pavarësisht se kanë marrë kreditë e dynjasë.

Tanjugi, kohët e fundit, përmendte një numër kredish kolosale, me miliarda dollarë, që Kina ka marrë vetëm nga Japonia. Por Kina po merr kredi akoma më të mëdha nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës e nga vende të tjera kapitaliste të Evropës.

Meqenëse në këto shënime zura në gojë «udhëheqësin më të madh të botës», Kim Ir Senin, duhet të them se ky është xheloz për këto kredi të mëdha që i jepen Kinës nga vende të ndryshme kapitaliste të botës, prandaj po përpiqet të marrë diçka edhe vetë. Është fakt se ky farë udhëheqësi i madh deri tashti ka marrë kredi nga të katër anët, por s'u paguan kapitalistëve borxhet, rentat, kamatën. Kështu që kjo ka bërë që kapitalistët të mos kenë më besim tek ai. Sot te Kim Ir Seni s'ka më besim Bashkimi Sovjetik dhe nesër nuk do të ketë besim as Kina. Gjithçka është e qartë. Koreja e Kim Ir Senit me siguri do të falimentojë. Dhe më e bukura është se ai,

në fjalimin me rastin e festës së 30-vjetorit të Republikës Popullore Demokratike të Koresë, në çdo paragraf përsëriste se po e ndërton socializmin në vend, duke u mbështetur në forcat e veta! U lodh «udhëheqësi i madh» që të na bindë se po e ndërton Korenë me forcat e veta! Sigurisht, me forcat e veta ai ka ndërtuar pallatin e madh prej 6 katesh, siç e dha komunikata, i cili do të grumbullojë të gjitha peshqeshet që i kanë dhënë shtetet e ndryshme të botës këtij farë burri. E gjithë Koreja, Pheniani e qytetet e tjera, që janë ndërtuar me ndihmën e shteteve të ndryshme, janë mbushur me statuja të Kim Ir Senit në gur, në çimento, në bronz, bile edhe në flori.

**Por Kim Ir Seni nuk vepron si kinezët. Ai ka një taktikë tjetër. Filozofia e tij është krejt e veçantë. Në Kore nuk bëhet fjalë për marksizëm-leninizmin, vetëm thuhet se socializmi atje ndërtohet sipas kimirsenizmit dhe ky quhet teoria «çuçe». Pra, në Korenë e Veriut na qenka një teori e re me emrin «çuçe» dhe vendi atje përfytyrohet si «kali fluturues». Veçse regjimi i ashtuquajtur socialist i Koresë së Veriut i përngjet një regjimi perandorak, regjimit të shahut të Iranit, të Muhamed Reza Pahlevisë. Ashtu siç sundon ky i fundit mbi popullin iranian, ashtu sundon edhe Kim Ir Seni mbi popullin korean, veçse duhet theksuar ndryshimi që ekziston midis tyre. Ndërsa shahu i Iranit e ka lënë popullin pa bukë, në mjerim dhe afro 80 për qind të popullsisë analfabete, Kim Ir Seni popullin e ka veshur, por ky ka pak të hajë, mbasi atje vazhdon sistemi i triskëtimit.**

Ka rëndësi të njihet edhe forma e udhëheqjes së Kim Ir Senit në Kore. Ai është bërë si një perandor i vërtetë, që dominon gjithë jetën politike të vendit, që heq dhe vë ministra si të dojë e kur të dojë, që historinë e popullit korean e ka lidhur me gjyshërit e stërgjyshërit e tij, të cilët gjoja e kanë udhëhequr këtë popull në luftë kundër japonezëve, kundër mongolëve dhe kinezëve. Dhe,

pra, Kim Ir Seni është trashëgimtari i tyre i predestinuar nga fatet. Të gjitha këto shkruhen në libra. Dinastia e tij do të vazhdojë me djalin e Kim Ir Senit, i cili mund të jetë nja 30 vjeç, por që tash ka marrë emrin «qendrori i partisë». Ky njeri, pra, edukohet e stërvitet për të zënë vendin e babait, pas vdekjes së këtij. Domethënë dinastia e Kim Ir Senëve vazhdon e do të vazhdojë në këtë vend të quajtur socialist, por që, në fakt, nuk është socialist.

Kur lexon për historinë e perandorëve japonezë, të samurajve bile edhe të popullit japonez, shikon një konsekuencë politike, një mendim të madh reaksionar feudal militarist, por të paktën konsekuent. Japonezi di ç'bën dhe përgatitet për atë që ka vendosur vetë, një politikë reaksionare, ekspansioniste, militariste. Kurse te koreanët dhe te kinezët shohim një politikë të çoroditur, pavarësisht se çfarë politike është, pavarësisht se kjo politikë nuk i përngjet aktualisht të paktën as politikës militariste reaksionare të Mikadove dhe të Togove. Kjo është një politikë pa shtyllë kurrizore, një politikë e koniunkturave, politikë e ndryshimeve të përhershme të strategjisë, pale të taktikës. Ç'thuhet sot, nuk thuhet nesër, ç'qëndrim mbahet sot, nuk mbahet nesër. «Për një fjalë, për një halë», siç thotë një fjalë popullore, shikon të ndryshojnë qëndrimet e tyre politike dhe ideologjike.

Në këto vende, pra, si në Kore, ashtu edhe në Kinë, grupe të shumta e të ndryshme janë në konflikt me njëri-tjetrin. Edhe në Japoni ekzistojnë grupe të ndryshme kapitaliste që grihen me njëri-tjetrin, por duket qartë qëllimi i përbashkët i tyre ndaj popujve të tjerë, prandaj edhe mund të mbash më lehtë qëndrim ndaj niponit. Kurse koreanët dhe kinezët janë kurdoherë në konfuzion dhe duhet të jesh vigjilent ndaj tyre, se sot të lajnë e të lyejnë, nesër të tradhtojnë, të gënjejnë, shpifin, të godasin, të sulmojnë dhe pasnesër të mburrin

përsëri. Një qëndrim i tillë mbahet prej tyre jo vetëm ndaj shteteve e popujve të tjerë, por edhe ndaj njëri-tjetrit.

Ne kemi parë se si Kim Ir Seni e ka mohuar luftën e madhe që kanë bërë kinezët për çlirimin e Koresë nga amerikanët, luftë që e ka marrë të tërë përsipër vetë. Bile ai arriti deri atje sa që në kohën e Revolucionit Kulturor prishi edhe varret e kinezëve të rënë në luftë. Por edhe Kina ka mbajtur qëndrime të tilla ndaj Koresë, kurse tash të dy këto shtete mbajnë qëndrime të mira ndaj njëri-tjetrit. Kjo ndodh për arsye se Koreja nuk merr dot ndihma aq sa kërkon nga Bashkimi Sovjetik, se ka marrë shumë dhe nuk ka të paguajë borxhet. Pastaj sovjetikët kanë vetë halle të mëdha. Halle shumë ka dhe do të ketë akoma më shumë e më të mëdha nesër edhe Kina. Kështu që ajo nuk do të mund t'i japë gjë Koresë. Atëherë ne do të shohim që Kim Ir Seni do ta braktisë Kinën dhe do të kthehet nga Japonia, të cilën tashti gjoja e kritikon, do të kthehet, gjithashtu, edhe nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Të tilla janë këto shtete të Lindjes së Largme. Koreja dhe Kina janë dy shtete aziatike që vetëquhen socialiste, por faktet, jeta, tregojnë qartë se ato nuk janë socialiste dhe në udhëheqjet e tyre ekziston një filozofi e një mentalitet i vjetër idealist, pragmatist dhe hipokrit ndaj të tjerëve e vetvetes.

Si mund ta quash socialist një vend si Kinën dhe marksist-leninist udhëheqësin e saj që vajti te Titoja dhe te Çausheku, të cilët janë dy revizionistë me damkë, dhe prej andej u ngrit e shkoi te shahu i Iranit, te ky perandor mesjetar barbar, tiran, që për vite me radhë po vret popullin iranian, të revoltuar kundër tiranisë së tij? Pikërisht këtë perandor barbar Hua Kuo Feni, udhëheqësi pseudomarksist i Kinës, e titulloi «i nderuari madhëri» dhe e siguroi për një miqësi e dashamirësi nga ana e Republikës Popullore të Kinës.

Është plotësisht e qartë se Kina e Hua Kuo Fenit dhe e Ten Hsiao Pinit është një vend kapitalist, që ndihmon kapitalizmin në botë dhe kërkon prej tij ndihmë për t'u fuqizuar dhe për të dominuar botën.

Natyrisht, në parashikimet tona edhe mund të gabohemi, por mendojmë se aktualisht qëllimi kryesor i Kinës është që ta ketë mirë, «urtë e butë dhe plot tiganin», siç i thonë një fjale, me imperializmin amerikan dhe me të gjitha vendet kapitaliste e reaksionare të botës. Këtë qëllim përpiqet ta realizojë ajo nën maskën e luftës kundër socialimperializmit sovjetik, por në realitet për të marrë ndihma.

Me gjithë ndihmat që merr Kina në kredi e në teknologji për zhvillimin e ekonomisë, për ndërtimin e një industrie të rëndë dhe të armatimeve, për të krijuar një ushtri të fuqishme agresive, prapëseprapë asaj i duhet kohë që të bëhet një superfuqi dhe të luajë, gjithashtu, një politikë akrobatike në litar, e cila mund edhe t'i rrezikojë atë dhe botën para kohe. Por aktualisht Kina mban anën e imperializmit amerikan dhe të të gjithë reaksionarëve të botës kundër Bashkimit Sovjetik. Kjo është e afishuar qartë.

Edhe Bashkimi Sovjetik do të luajë kartën e vet në këtë politikë të fuqive të mëdha grabitqare. Ai do të vazhdojë armatimin, luftën kundër Kinës, po ashtu do të vazhdojë të jetë vigjilent ndaj imperializmit amerikan dhe do të marrë edhe ndihma prej tij. Pra Kina, nga një anë, dhe Bashkimi Sovjetik, nga ana tjetër, janë dy partnerë që duan të neutralizojnë njëri-tjetrin ndaj Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe t'i kenë këto si furnizuese të tyre. Dhe që të tria këto shtete bëjnë politikën e balancës.

Megjithëse Kina është një partnere më e dobët nga dy të parat, ajo, prapëseprapë, pavarësisht nga kjo dobësi, mund dhe do t'u bëjë shantazhe edhe Shteteve të

Bashkuara të Amerikës, edhe Bashkimit Sovjetik, derisa të arrijë qëllimin e saj, domethënë forcimin ekonomiko-ushtarak. Kur t'ia arrijë këtij qëllimi, atëherë do të ketë epërsi dhe do të bëhet e rrezikshme, për arsye të popullsisë së madhe që ka dhe që do të ketë në fund të këtij shekulli, kohë kjo që e ka caktuar vetë se i duhet për t'u bërë një fuqi e madhe socialiste, por në të vërtetë një superfuqi kapitaliste, ekspansioniste.

Është e vërtetë se as Bashkimi Sovjetik, as Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk supozojnë se çështjet Kinës mund t'i kalojnë lehtë, si në gjalpë. Edhe ato nuk do të qëndrojnë me duar lidhur, por do të forcohen teknikisht dhe me armatime edhe më shumë nga Kina. Fakt është se edhe Kina do të bëjë përpjekje të mëdha, pas marrjes së teknikës moderne nga shtete të ndryshme kapitaliste, me qëllim që t'i perfeksionojë armatimet e saj dhe, në radhë të parë, bombën atomike. Dhe atëherë vijmë te fjalët që ka thënë Mao Ce Duni në fjalimin që mbajti në Mbledhjen e partive komuniste dhe punëtore në Moskë në vitin 1957 se «ne nuk kemi frikë nga imperializmi amerikan dhe nga bomba e tij atomike, pavarësisht se mund të shuhet 400 milionë kinezë». Pra, në rast se Kina arrin të krijojë një potencial të madh ushtarak të konsiderueshëm për një luftë të re botërore, ose për qëllime ekspansioniste, ajo do të bëhet e rrezikshme, për arsye të popullatës së madhe. Dhe për një vend me popullsi të madhe, 400 milionët, që përmendi Mao Ce Duni atëherë, se mund të shfarosen nga bomba atomike, nuk janë aq shumë. Për Kinën e ardhshme imperialiste kjo shifër nuk llogaritet. Sigurisht Kina e mendon se do të pësojë humbje të tilla në njerëz dhe në materiale, por edhe ajo do t'u shkaktojë humbje, qoftë Shteteve të Bashkuara të Amerikës, qoftë Bashkimit Sovjetik, varet se kundër kujt do të shpallë luftë botërore. Ajo do të kërkojë hapësirë jetike si Hitleri dhe kjo hapësirë jetike e Kinës

nuk është veçse Siberia e pakufizuar, e pasur në minerale, dhe Mongolia me gjithë Azinë Qendrore Sovjetike.

Natyrisht, s'jemi vetëm ne që bëjmë parashikime të tilla lidhur me çështje që janë shumë të rrezikshme për njerëzimin, por këto i bëjnë edhe armiqtë e njerëzimit, i bëjnë imperializmi amerikan dhe socialimperializmi sovjetik etj. Dhe, sigurisht, gjatë gjithë këtyre periudhave, kontradiktat në mes tyre do të thellohen dhe do të rezultojnë në konflikte, qoftë të dyanshme, qoftë ndërkombëtare, por që do t'i shkaktojnë njerëzimit vuajtje e dëme kolosale.

Aktualisht politika që ndjekin këto tri superfuqi është në dëm të popujve të botës, në kundërshtim me interesat e tyre. Kjo gjë duhet të kuptohet nga popujt dhe këta të përgatiten që t'u prishin planet atyre. Në qoftë se nuk kuptohet një gjë e tillë, në qoftë se vazhdohet të mbahen shpresa te reformat sporadike që jep njëri ose tjetri shtet kapitalist ose imperialist, atëherë, natyrisht, planet e tyre të hegjemonizmit e të neokolonializmit nuk mund të luftohen lehtësisht. Kapitalizmi i cilitdo shteti të tillë ka një etje të madhe për fitime dhe kjo etje, që shuhet në kurriz të popujve, nëpërmjet trativave të shteteve kapitaliste imperialiste, shkakton, në radhë të parë, atë politikë të balancës së paqëndrueshme, pragmatiste, të fuqive të mëdha, por edhe të fuqive të mesme e të vogla kapitaliste. Dhe ne do të asistojmë vazhdimisht në qëndrime politike të ndryshme, në aleanca e në bashkëpunime, në vartësinë e njërit dhe të tjetrit shtet kapitalist, që disa herë do të paraqiten si «fitore» të popujve, por në realitet ato nuk janë fitore, disa herë do të duken edhe si disfata për shtetin tjetër ose për grupe shtetesh. Natyrisht, këto ndryshime krijojnë kurdoherë situata të vështira për njerëzimin.

Në arenën ndërkombëtare nuk janë vetëm fuqitë e mëdha, vetëm fuqitë e mesme ose të vogla kapitaliste

që veprojnë, por janë edhe popujt që luftojnë, që i kuptojnë qëllimet djallëzore të këtyre fuqive, prandaj reagojnë me forma dhe me mjete të ndryshme dhe organizohen në luftë kundër një politike të tillë skllavëruese, luftënxitëse e grabitqare. **Aktualisht ne shohim se kjo rezistencë kundër kapitalit, kundër ekspansionit kolonialist, ashpërsohet çdo ditë e më shumë, idetë progresiste zhvillohen dhe zënë rrënjë në mendjet dhe në zemrat e njerëzve. Ato krijojnë një psikozë organizimi, lufte, rezistence në forma të ndryshme, të cilat, në momente të caktuara dhe në vendet ku kapitalizmi është më i dobët, do të shpërthejnë më me forcë dhe do të konkludojnë me fitore kundër tij.**

Politika antimarksiste e Titos përqafohet nga revizionistët kinezë edhe për këtë arsye: titizmi jo vetëm është antisovjetik në thelb, se ky shtet kapitalist jugosllav, i krijuar në bazë të antimarksizmit dhe të antileninizmit, rrezikohet nga socialimperializmi sovjetik, por edhe sepse politika e Titos është, gjithashtu, një politikë e «valles mbi litar», e balancimit, e gënjeshtërsë, e ruajtjes së statukuosë nëpërmjet bisedimeve dhe marrëveshjeve. Natyrisht, të gjitha këto marrëveshje e bisedime janë në disfavor të popujve, se ato kanë për qëllim të ruajnë kurdoherë respektin për kapitalin botëror dhe, jo vetëm kaq, por të ruajnë unitetin dhe forcën e këtij kapitali të madh botëror, vetëm se ky kapital duhet të evitohet revolucionin, të evitohet revoltën e masave të popullit, duke lejuar dhe duke realizuar kërkesat e disa reformave sporadike, gjoja socialiste, që manifestohen në shtresat e gjera të popujve të globit.

**Pikërisht, këtë politikë modus vivendi të revizionistëve titistë jugosllavë dhe të revizionistëve kinezë Partia jonë duhet ta demaskojë me ashpërsi.** Është e qartë për ne kur shohim se Jugosllavia dhe Titoja, ky renegat i marksizëm-leninizmit, e ka mirë politikën me Bashkimin

Sovjetik, më mirë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, mirë me Anglinë, me Francën, me Kinën, me Japoninë, me Korenë etj. Me një fjalë, ai e ka mirë me të gjitha udhëheqjet reaksionare të shteteve imperialisto-kapitaliste, që do të thotë keq me popujt, të cilët vuajnë nën thundrën e kapitalit. Kjo politikë titiste maskohet me teorinë marksiste dhe në mbështetje të kësaj teorie pseudomarksiste vijnë kinezët me teorinë e tyre antimarksiste, prokapitaliste, neokolonialiste.

**Pra, ne kemi përpara një luftë të madhe, të ndërlukuar e të gjatë. Për këtë është e domosdoshme të kuptojmë se rreth marksizëm-leninizmit duhet të grumbullohen fuqitë revolucionare, të cilat të udhëhiqen nga teoria e Marksit, e Engelsit, e Leninit dhe e Stalinit, që të kuptojnë përmbajtjen dhe problemet e epokës aktuale dhe ta analizojnë këtë në dritën e marksizëm-leninizmit.** Në çdo vend, proletariati, partitë marksiste-leniniste të tij, së toku me njerëzit revolucionarë duhet ta zhvillojnë luftën në përshtatje me situatat. Megjithatë, ky afirmim që është i drejtë, nuk është aq i lehtë për t'u zbatuar. Që të mund të zbatohet një gjë e tillë, duhet medoemos të ekzistojë bërthama e shëndoshë marksiste-leniniste, domethënë partia marksiste-leniniste, e cila të bëhet epiqendra e kësaj lëvizjeje revolucionare në çdo vend. Kjo parti me politikën e saj parimore klasore duhet të dijë t'i grumbullojë rreth vetes aleatët e natyreshëm të saj, njerëzit përparimtarë, të dijë t'i organizojë këta në një politikë të çlirimit nga kapitalizmi, i brendshëm dhe i huaj, në një politikë me nuanca të veçanta, e t'i konvergojë përpjekjet e njerëzve, të masave në një revolucion për rrëzimin e pushtetit të kapitalit dhe për krijimin e një pushteti revolucionar, jo me dekrete nga një pushtet kapitalist, por me reforma të vërteta demokratiko-borgjeze, nga një pushtet revolucionar e pastaj t'i përgatitë masat për një kalim cilësor në një shoqëri socialiste.

Kur them që lufta është e gjatë, kam parasysh se imperializmi, kapitalizmi, organizmat e tij dhe forca ekonomike e ushtarake që ai disponon, duhen gërryer nga themelet që të rrëzohet fortësa. Që të bëhet kjo ka vështirësi materiale, por ka edhe vështirësi politiko-ideologjike, të cilat janë po aq të rrezikshme, po aq vdekjeprurëse për revolucionin, sa edhe forcat fizike ose materiale që disponon kapitali.

Prandaj lufta e partive marksiste-leniniste nuk mund të bëhet e izoluar. Duhet futur thellë me pikëpamje të shëndosha, të qarta, marksiste-leniniste, me një organizim të zhdërvjellët, legal dhe ilegal, te masat e gjera të popullit dhe, në radhë të parë, te proletariati dhe te fshatarësia e varfër. Në të gjitha shtresat e shoqërisë duhet të zhvillohet një luftë sqaruese, bindëse, se si e qysh duhet luftuar edhe struktura, edhe superstruktura e kapitalizmit, se si duhet kaluar nëpërmjet fitoresh dhe disfatash në fitoren përfundimtare. Këto gjëra partia marksiste-leniniste duhet t'ua mësojë masave të gjera të popullit në revolucion. Natyrisht, në radhë të parë, një gjë e tillë kërkon qartësi ideologjike e politike dhe organizim të shëndoshë nga ana e partisë, kërkon, gjithashtu, vendosmëri, trimëri dhe sakrificë nga ana e komunistëve dhe komunistët nuk u tremben të gjitha këtyre. As koha nuk i tremb ata, se e dinë që fitorja nuk mund të arrihet përnjëherë. **Komunistët e vërtetë e kanë të qartë se fitorja pa disfata nuk mund të arrihet dhe se revolucionin nuk mund të ecë në rrugë të drejtë. Ai do të ketë zigzage, por këto zigzage, disfatat dhe pësimet, ata duhet të dinë që t'i kthejnë në fitore përfundimtare për revolucionin.**

E PREMTE  
22 SHTATOR 1978

### TË AKTIVIZOJMË KËRKESËN PËR DËMSPËRBLIMET NGA GJERMANIA FEDERALE

Organet tona kompetente duhet të aktivizojnë kërkesën nga qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë për dëmshpërblimet e luftës. Ne u kemi dërguar gjermanëve një memorandum, por ata nuk janë përgjigjur. Vetëm nëpërmjet një gazetari ose të ndonjë ministri kanë thënë diçka. Çështja është që këtë të drejtë tonën ne duhet ta kërkojmë.

Për këtë arsye porosita që në Ministrinë e Punëve të Jashtme të studiojnë Statusin e Gjykatës Ndërkombëtare të Hagës, në këto drejtime: **Një**, a ka gjë ajo në kompetencën e saj, po ta hedhim në gjyq ne qeverinë e Bonit, për t'i kërkuar dëmshpërblimet e luftës? **Dy**, ç'kushton një veprimtari e tillë? **Tre**, ç'do të na kushtojë po të dërgojmë në këtë gjyq avokatë për të mbrojtur kauzën tonë? Ministria e Jashtme të ketë gati të gjitha materialet e dokumentacionet e duhura për këtë gjë.

Por, para se të veprojmë, Ministria e Punëve të Jashtme duhet të na japë një raport për këto çështje. Pastaj jo përnjëherë, por një nga ambasadorët tanë, ai që ka dorëzuar memorandumun, duhet të vejë përsëri tek ambasadori i Bonit e t'i shtrojë çështjen nëse do të na jepet ndonjë përgjigje e memorandumit apo jo, nëse ka

ndër mend qeveria e Bonit të merret vesh me qeverinë e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë për problemin e dëmshpërblimeve apo jo, pse, në qoftë se ajo nuk dëshiron të merret vesh, atëherë edhe ne do të marrim masa të mëtejshme.

**E PREMTE**  
**22 SHTATOR 1978\***

### **TRE POLITIKANË DHE PROBLEMET E LINDJES SË MESME**

Më 18 shtator agjencia e lajmeve Asosiejted Pres dha nga Uashingtoni tekstin e marrëveshjeve<sup>1</sup> që u arritën në Kemp Dejvid në takimin midis Xhimi Karterit, Anvar el Sadatit dhe Menaem Beginit mbi problemin e Lindjes së Mesme, problem që është me rëndësi të madhe jetike për popujt arabë e që njëkohësisht i intereson shumë edhe imperializmit amerikan.

Imperializmi amerikan në Lindjen e Mesme i ka futur thonjtë thellë dhe bën një politikë përçarëse në mes popujve arabë, të cilët nuk e kanë gjetur dhe nuk po e gjejnë me njëri-tjetrin fjalën e përbashkët edhe në këto momente kaq të vështira për të gjithë komunitetin arab. Kjo ngjet për arsye se pushteti në vende të ndryshme të këtij rajoni ndodhet në duart e borgjezisë së madhe reaksionare, shtypëse, shfrytëzuese e antipopullore, antiarabe. Borgjezia, në të gjitha vendet e këtij rajoni vetëm emrin ka arabe, sepse kokë e këmbë është shitur te të huajt, tek imperialistët amerikanë, në radhë të parë, te sovjetikët, te francezët, tek anglezët dhe te të gjithë reaksionarët e botës. Prandaj reaksioni botëror

1 a. — Marrëveshja për «një plan paqëje në Lindjen e Afërt».  
b. — Marrëveshja për «një plan mbi përfundimin e një traktati paqëje midis Egjiptit dhe Izraelit».

bën çdo përpjekje që këtë rajon ta mbajë të përcarë dhe shtetet e ndryshme arabe të rrojnë vazhdimisht në kontradikta me njëri-tjetrin. Domethënë reaksioni botëror synon t'i mbajë këta popuj nën zgjedhë, në interes të dinastive që mbretërojnë në këto vende, në varfëri, në robëri, bile mesjetare, dhe t'i detyrojë të shesin pasurinë e tyre të madhe, naftën, për të nxjerrë prej saj përfitime përrallore.

Në këto situata Shtetet e Bashkuara të Amerikës, që janë xhandari dhe padroni kryesor, si me thënë, i këtij pellgu, ndjekin vazhdimisht politikën «përça e sundo». Ato vënë njërin shtet kundër tjetrit, grupojnë disa shtete kundër shteteve të tjera, nxitin e zhvillojnë luftëra lokale në mes Izraelit dhe Egjiptit, në mes Izraelit dhe Sirisë, në mes Sirisë e marionetave libaneze, në mes irakianëve e sirianëve, në mes Arabisë Saudite e Jemenit të Veriut ndaj Jemenit të Jugut, krijojnë mosmarrëveshje në Gjirin Persik e të tjera komplete të tilla djallëzore.

Veçanërisht Izraelin imperializmi amerikan e ka përdorur si xhandar të vërtetë në shërbim të tij. Ky xhandar ka arritur të shkaktojë deri luftëra të përgjakshme me Egjiptin, Sirinë, Libanin, Jordaninë etj. Imperializmi amerikan e mbështet fuqimisht Izraelin me armë nga më modernet, bile, siç thuhet, i ka dhënë edhe bombën atomike. Shtetet e Bashkuara të Amerikës e kanë ndihmuar Izraelin, gjithashtu, edhe nga ana logjistike, për arsye të peshës së madhe dominuese që kanë qarqet reaksionare financiare sioniste në ekonominë kapitalisto-imperialiste botërore. Pra, imperializmi amerikan e ka bërë Izraelin veglën e tij më të përshtatshme. Në momentet kur Shtetet e Bashkuara të Amerikës acarohen me vendet arabe për naftën, për çështjen e furnizimit e të çmimit të saj, nëpërmjet veglës së tyre, Izraelit, krijojnë, sikurse kanë krijuar, incidente të përgjakshme që kanë vajtur deri në luftë. Këto luftëra i kanë dhënë

mundësi Izraelit të pushtojë territore egjiptiane, siriane e jordaneze, si: Sinain, Cisjordaninë, Golanin, rripin e Gazës dhe as lëviz më që andej pa e detyruar.

Me gjithë rezolutat e panumërta që janë marrë në Organizatën e Kombeve të Bashkuara kundër veprimeve të Izraelit, megjithëse shtetet e botës e kanë ngritur me të madhe zërin kundër tij, Izraeli ka vazhduar veprimtarinë e vet agresive. Ai jo vetëm ka pushtuar territore arabe, por në to, duke pranuar çifutë emigrantë nga Polonia, nga Rumania, sidomos nga Bashkimi Sovjetik dhe nga vende të tjera të Evropës, ka krijuar koloni çifute.

Më tepër nga të gjithë popujt arabë po vuan populli heroik palestinez, i cili ka dekada të tëra që mban mbi shpinë mjerimin më të madh që ka parë njerëzimi. Ai rron si muhaxhir, duke u strehuar nëpër kasolle dhe në tenda të shkretëtirës, sepse ka humbur atdheun e tij që ia kanë pushtuar izraelitët dhe s'ia lëshojnë. Prandaj populli palestinez është ngritur në luftë të pamëshirshme, deri tash pa kompromis. Pavarësisht se brenda në lëvizjen çlirimtare palestineze ka grupe me pikëpamje të ndryshme, në përgjithësi të gjithë dëshirojnë çlirimin e vendit të tyre nga sionistët izraelitë.

Ku nuk e gjen popullin palestinez që rron i shpërndarë në të tëra vendet arabe: në Liban, ku ai është i vendosur në fshatra që janë qendra luftarake; në Egjipt, ku ka jetuar si muhaxhir dhe si luftëtar; në Siri, ku herë lejohet të luftojë, herë nuk lejohet; ka jetuar e jeton edhe në Jordani, ku është shtypur barbarisht; në Irak, në Arabinë Saudite, në Jemen, në Emiratet e Gjirit Persik, bile edhe në Francë etj. Ai është një popull trim, luftëtar, që s'e ka pushuar rezistencën e vet asnjë ditë. Kudo që është, në rajonin e Lindjes së Mesme, ai lufton në forma të organizuara gueriljesh, kurse në vende të tjera të botës bën sabotazh kundër gjithçkaje izraelite, organizon atentate, të cilat bota kapitaliste i quan terro-

rizëm, sepse ajo kërkon qetësi, për të shfrytëzuar si duhet e sa i duhet pasurinë e këtyre vendeve që ka nën sundimin e vet.

Tash, në këto situata të vështira dhe pak a shumë paqësore që Shtetet e Bashkuara të Amerikës krijuan në mes Egjiptit dhe Izraelit, pas shumë diskutimesh, manovrash, prapaskenash e dredhish të panumërta, të tre këta u mblodhën në Kemp Dejvid, gjoja për të rregulluar gjendjen e Lindjes së Mesme. Ata diskutuan kokë më kokë trembëdhjetë ditë. Bile Xhimi Karteri u bë pjesëtar aktiv i këtyre bisedimeve, domethënë bisedimet nuk zhvilloheshin më midis Sadatit dhe Beginit, por midis Karterit, Sadatit dhe Beginit. Karteri u quajt kështu si një partner i tretë i këtyre bisedimeve për të vendosur gjoja paqen në Lindjen e Mesme. Natyrisht nga e gjithë kjo «punë» «mali polli një mi». Ky mi përfaqëson atë çka «fitoi» ose nuk fitoi populli palestinez dhe në përgjithësi popujt arabë. Në Kemp Dejvid, sipas komunikatës, imperializmi amerikan arriti «të përfundonte» njëfarë pajtimi në mes Izraelit të Beginit dhe Egjiptit të Sadatit për një paqe të përkohshme, për një rregullim të përkohshëm të zonës së Cisjordanisë, të rripit të Gazës dhe të shkretëtirës së Negevit.

Në të vërtetë asgjë konkrete nuk u arrit. Mund të themi se u përcaktua vetëm që brenda 5 vjetësh duhet të veprohet në atë mënyrë që pjesërisht Izraeli të tërhiqet nga bregu perëndimor i lumit Jordan (Cisjordania) dhe nga Gaza, me qëllim gjoja që aty të vendoset shteti autonom i palestinezëve të këtyre zonave. Administrata palestineze autonome, natyrisht, «do të garantohet» nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe kurdoherë e indirekt do të jetë nën sundimin ose nën vëzhgimin e Izraelit, të Egjiptit dhe të Jordanisë.

Egjiptit iu dhanë edhe disa satisfaksione të vogla. Kështu, për shembull, u ra në marrëveshje për njëfarë

tërheqjeje të Izraelit nga një pjesë e gadishullit të Sinait. E gjithë kjo është një manovër djallëzore e imperializmit amerikan dhe e agjentëve të tij. Për imperializmin amerikan kjo është, si me thënë, një fitore e përkohshme, sepse, siç thashë më lart, është caktuar që brenda 5 vjetëve gjoja do të punohet për të arritur në një shtet «të vetëqeverisur» në bregun perëndimor të lumit Jordan dhe në rripin e Gazës. Ky i ashtuquajtur shtet i vetëqeverisur gjatë kësaj kohe do të ketë njëfarë force policore të vetën, por aty kurdoherë do të jenë të pranishme forcat ushtarake e policore izraelite për të ruajtur kufijtë, si dhe forcat jordaneze. Kështu palestinezët, natyrisht, do të kenë vetëm hapëset e kashtës. Dhe në rast se arrihet një statukuo e tillë, siç u vendos në Kemp Dejvid, atëherë mund të nënshkruhet një marrëveshje paqeje midis Egjiptit dhe Izraelit. Gjithë synimi është që gjatë kësaj periudhe 5-vjeçare imperializmi amerikan të ketë njëfarë qetësie për ta shtrydhur mirë «lopën» arabe, që nafta të rrjedhë me lehtësi në cisternat dhe në naftësjellësit amerikanë dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës të zhvillojnë një fushatë intrigash në të gjitha shtetet arabe për të pranuar vendimet e Kemp Dejvidit dhe për të arritur në një konkluzion të përbashkët rreth një paqeje gjoja të përgjithshme. Mirëpo populli palestinez me të drejtë asgjë nuk pranon në gjithë këtë dallavere të Sadatit, të Beginit dhe të Xhimi Karterit, sepse, në fakt, nuk fiton asgjë. Atdheu i tij është i pushtuar, prandaj me të drejtë ai do të luftojë deri në fund për çlirimin e tokave të atdheut të vet dhe për vendosjen e një qeverie të vërtetë të popullit palestinez, pa ndërhyrje dhe pa tutelë të armiqve të tij të përhershëm.

Por është për t'u çuditur se me paturpësinë më të madhe në komunikatë thuhet se marrëveshja e arritur bëhet edhe me pjesëmarrjen e Jordanisë, kurse kjo nuk ishte fare në Kemp Dejvid. Qeveria jordaneze e mbreti

Hysein, megjithëse dihet ç'janë, deklaruan se s'kanë asnjë angazhim për sa është vendosur në Kemp Dejvid.

Marrëveshjen e Kemp Dejvidit nuk e pranoi Siria, e cila e quan Sadatin tradhtar të kombit arab, nuk e pranuan as Algjeria, Maroku, Libia, të gjitha vendet e tjera arabe. Bile kundër foli edhe mbreti i Arabisë Saudite. Pra, e gjithë kjo dallavere u bë vetëm në mes tre personave.

Natyrisht, për të bindur ata që kundërshtuan, Shtetet e Bashkuara të Amerikës gjatë këtyre 5 vjetëve do të bëjnë dallavere të tjera të panumërta, bile këto filluan. Në fakt, pas botimit të komunikatës sekretari i Departamentit të Shtetit, Sajrus Vens, u nis për në Lindjen e Mesme që të bisedojë me mbretin Saud, me mbretin Hysein, me Asadin e të tjerë, me qëllim që si e si t'i bindë, t'u bëjë presione ose t'u japë «këste» që të pranojnë zgjidhjen e përkohshme që i dha kësaj çështjeje Xhimi Karteri. Kështu do të vejë kjo punë.

Në këtë mes Kina botoi në shtypin e saj një njoftim për marrëveshjen e Kemp Dejvidit. Tani për tani nuk mban qëndrim të hapët, por kuptohet se ajo qëndron në anën e imperializmit amerikan dhe të Sadatit. Më vonë do ta shfaqë më hapur këtë mbështetje, sepse ajo lufton për statukuonë aktuale në Lindjen e Mesme, domethënë që atje të sundojë imperializmi amerikan e jo vetëm atje, po kudo në botë, bile edhe afër saj në Japoni, në Kore, në Tajvan e gjetkë dhe Kina të përfitojë nga lëmoshat e nga kreditë e tij për t'u bërë superfuqi. Dhe tërë kjo politikë bëhet për arsye se gjoja luftohet social-imperializmi sovjetik.

Natyrisht, edhe socialimperializmi sovjetik përfiton nga këto situata dhe ndodhet automatikisht në krah të regjimeve të tjera, gjoja të forta, që mbajnë qëndrim kundër marrëveshjes Sadat-Begin.

Ne duhet të përgatitim një artikull që ta demaskoj-

më këtë lojë të imperializmit amerikan, i cili kërkon të mbajë në robëri popujt arabë, t'i shfrytëzojë këta, t'i intrigojë, t'i përçajë, të bëjë që populli palestinez të mos fitojë kurrë tokat e veta dhe të mos vendosë kurrë qeverinë e tij. Njëkohësisht të demaskojmë Izraelin, i cili është vegla e përhershme barbare fashiste e imperializmit amerikan në Lindjen e Mesme.

## KINA ECËN SI KALI PA FRE DREJT IMPERIALIZMIT

Kina po zhvillon në mënyrë të ethshme, me ritme shumë të shpejta e në shkallë globale, politikën e dyerve të hapëta, qoftë në politikë, qoftë në ekonomi, në të gjitha kontinentet dhe në vende të ndryshme, me imperialistët amerikanë, me shtetet e tjera kapitaliste të zhvilluara dhe në përgjithësi me të gjitha vendet kapitaliste.

Këto ditë, Hua Kuo Feni, në një fjalim që mbajti, mbasi u kthye nga «Kanos», nga Beogradi, tha se «për zhvillimin e Kinës dhe arritjen e atyre rezultateve që kjo të bëhet një shtet socialist i fuqishëm, nuk do të pritet fundi i shekullit. Një gjë e tillë, theksoi ai, do të realizohet brenda 10 vjetëve». Ku e bazon Hua Kuo Feni këtë thënie të tij? Natyrisht, ky pohim është pa baza, sipas mendimit tonë dhe sipas mendimeve të ekspertëve ekonomikë ndërkombëtarë, të cilët komentojnë, vazhdimisht, të dhëna të tilla të udhëheqjes kineze.

Ne nuk e besojmë, por siç duket, Hua Kuo Feni e hodhi këtë parullë për disa arsye:

**E para, të forcojë pozitat e tij** politike dhe organizative në pushtet e në parti dhe t'u kundërvihet pikëpamjeve të grupit kundërshtar të tij, që udhëhiqet nga Ten Hsiao Pini.

**E dyta, të tregohet se është shumë i shkathët në politikën ndërkombëtare, bile më i shkathët se Çu En Lai,** i cili nuk e kishte parashikuar drejt hapjen dhe fuqizi-

min e Kinës në botë, sepse ai kishte caktuar afatin që Kina do të bëhet një «shtet i fuqishëm socialist» në fund të shekullit.

**E treta, të shesë pasuritë e Kinës tek imperializmi amerikan dhe kapitalizmi botëror për të shlyer kreditë e shumta,** me miliarda, që po merr e do të marrë Kina nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, nga Japonia, nga Republika Federale e Gjermanisë dhe nga një varg shtetesh të tjera.

Deri tashti dimë që Kina ka marrë kredi të shumta nga Japonia; sipas njoftimeve të agjencive të lajmeve bëhen rreth 20 miliardë dollarë kredi, kurse Japonia ka marrë përsipër të bëjë shpime për shfrytëzimin e naftës në gjirin e Port-Arturit, bile këtë e ka marrë si koncesion. Po ashtu ajo ka marrë përsipër ndërtimin komplet në Kinë të një sërë minierash për nxjerrjen e qymyrit, si dhe ndërtimin e uzinave, sidomos të atyre metalurgjike. Si kompensim për këto, Japonia do të paguhet me naftë, qymyre e lëndë të tjera të para.

Agjencia jugosllave e lajmeve Tanjug, që është bërë zëdhënësja e Kinës për këto çështje, interesohet të vërë në dukje se edhe Kina është bërë si Jugosllavia, domethënë lyp andej-këtej, dhe merr copa të mëdha nga kapitalizmi botëror. Pra, kjo agjenci jepte lajmin se vetëm për disa miniera qymyri Gjermania Perëndimore i akordoi Kinës 8 miliardë marka. Por këto janë kredi vetëm për disa miniera qymyri, se Gjermania Perëndimore, në fakt, po i jep Kinës teknologji moderne edhe në shumë drejtime të tjera, veçanërisht për armatime. Sigurisht, ajo i shet Kinës edhe armatime të reja.

**Përveç Japonisë e Gjermanisë Perëndimore, janë edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës që i kanë hapur bankat e tyre për Kinën,** bile agjencitë amerikane të lajmeve thonë se këto banka private do t'i akordojnë

kredi të panumërta asaj, natyrisht me garanci të forta në interes të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Agjencitë amerikane të lajmeve njoftojnë, gjithashtu, se Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë rënë në ujdi me Republikën Popullore të Kinës që së shpejti të vejë në Kinë një grup i madh afaristësh prej rreth 40 vetash, që të bisedojë për çështje të ndryshme të zhvillimit të ekonomisë, për çështjen e armatimeve etj.

Po ashtu njoftohet se Tregu i Përbashkët Evropian do të dërgojë në Kinë një grup afaristësh të mëdhenj prej 30 vetash, që do të bisedojë për çështje tregtare dhe ekonomike. Fjala është për marrëdhëniet me shtetet kryesore që i akordojnë Kinës kredi dhe akaparojnë prej saj pasuritë e mbitorës e të nëntokës. Pra, ne shohim që në këtë drejtim qeveria kineze po ecën si kali pa fre dhe po e shet vendin tek imperialistët e huaj. Vitin e ardhshëm do të dërgohen në Shtetet e Bashkuara të Amerikës 10 mijë studentë kinezë, të cilët do të mësojnë në universitetet amerikane e, natyrisht, në të njëjtën kohë do të stërviten për t'u bërë spiunë, për të çuar në Kinë mënyrën amerikane të jetesës dhe për të realizuar qëllimet e CIA-s. Përveç kësaj, 10 mijë studentë të tjerë do të shkojnë në vende të ndryshme të Evropës, sidomos në Gjermaninë Perëndimore, për të mësuar teknologjinë dhe shkencën e re. Një numër i madh studentësh do të dërgohen edhe në Japoni.

Pra, Kina po ecën revan në rrugën e kapitalizmit. Sikurse e kemi thënë edhe herë të tjera, kjo ndodh, për arsye, se udhëheqja aktuale kineze është një udhëheqje kapitaliste, fashiste — rezultat i politikës antimarksiste të Mao Ce Dunit, i cili ecte edhe ai në këtë drejtim, por me hapa më të ngadalshëm dhe me forma ëndërruese. Tratativat me amerikanët bëheshin që në kohën e Mao Ce Dunit dhe të Çu En Lait. Që para dhe pas çlirimit të Kinës bisedimet me amerikanët ishin në zhvillim, vetëm

se Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk kishim besim te pushteti që po ngrihej në Kinë.

Ministri i Jashtëm i Kinës, Huan Hua, ka qenë nxënësi dhe student në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku është dhaskalepsur mirë nga amerikanët. Ai ka qenë, pikërisht, një nga ata që Mao Ce Duni dhe Çu En Lai e kanë çuar në ambasadën amerikane të dorëzonte një letër, në të cilën udhëheqja kineze u kërkonte ndihma Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për ndërtimin e Kinës, sepse Bashkimi Sovjetik, tek i cili Mao Ce Duni e Çu En Lai nuk kishin besim, nuk mund t'i jepte. Por në atë kohë qeveria amerikane nuk iu përgjigj kësaj kërkesë. Aktualisht të gjitha këto dëshira të vjetra të Mao Ce Dunit e të Çu En Lait po i realizon udhëheqja që erdhi pas tyre.

Gjithçka bëhet në drejtim të kthesës së madhe të Kinës në një vend socialimperialist, në një vend agresiv e luftënxitës. Por kjo veprimtari e gjerë në fushën ekonomike shoqërohet, gjithashtu, edhe me një fushatë të madhe politike. Kjo fushatë politike në Kinë ka angazhuar në shkallë të gjerë shtypin, propagandën dhe delegacione të shumta kineze që lëvizin si të çmendura, duke shkuar në vende të ndryshme kapitaliste. Këto delegacione janë nga më të ndryshmet: politike, ushtarake, ekonomike, kulturore, deri tek udhëtimet jashtë shtetit të Hua Kuo Fenit, të Ten Hsiao Pinit, të Li Hsien Nienit, të Huan Huasë, dhe për së shpejti përsëri të Hua Kuo Fenit, i cili do të vizitojë, siç ka deklaruar, Anglinë, Francën, Republikën Federale të Gjermanisë etj.

Të gjitha këto lëvizje të shfrenuara të kinezëve kanë për qëllim t'i sigurojnë vendet kapitaliste ku ata shkojnë, për besnikërinë e Kinës, për qëndrueshmërinë e saj në këtë politikë reaksionare, për mbështetjen e politikës së këtyre shteteve kapitaliste e imperialiste nga ana e Kinës.

Gjithë bota e kupton se ku e ka qëllimin kjo veprimtari e ethshme politike, sa «e sinqertë» është dhe përse bëhet, por bota kapitaliste nga kjo veprimtari e tradhtarëve kinezë nxjerr përfitime të mëdha ekonomike, strategjike e ushtarake.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në radhë të parë, dëshirojnë që Kina të armatohet deri në dhëmbë dhe të bëhet një rrezik i vërtetë për Bashkimin Sovjetik, bile po ta nxitin atë të hapet drejt Bashkimit Sovjetik, natyrisht në luftë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk kanë frikë se mos Kina bëhet një rrezik për kontinentin amerikan; ato e marrin me mend se tendencat e Kinës për ekspansion nuk mund të jenë drejt Paqësorit, drejt Shteteve të Bashkuara të Amerikës, por drejt Siberisë, drejt Rusisë, pa lënë mënjanë synimet për dominim në Indi, në Pakistan, në gadishullin e Indokinës, në ishujt e Indonezisë etj. Por në këto të fundit, natyrisht, Shtetet e Bashkuara të Amerikës vigjilojnë dhe nuk do të lejojnë kurrë që Kina të ngulë thonjtë e saj. Që Kina të ketë njëfarë influence për të kundërbalancuar influencën sovjetike, është e sigurt se kjo gjë do të lejohet nga ana e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, por aspak më tej. Shtetet e Bashkuara të Amerikës do t'i japin dorë të lirë Kinës, kundër Bashkimit Sovjetik, gjë që është në favor të kapitalizmit botëror e veçanërisht të imperializmit amerikan.

Natyrisht, ne, do të shohim zhvillimin e situatave. Tërë kjo punë, të gjitha këto synime të përbashkëta të imperializmit amerikan dhe të socialimperializmit kinez nuk mund të shkojnë si në gjalpë, sepse patjetër edhe Bashkimi Sovjetik do të përpiqet t'i dobësojë pozitat e Kinës e të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të çajë rrethimin. **Nuk dihet se ku dhe se si do të bëhet kjo, por ndaj të gjitha këtyre veprimeve të tmerrshme armiqësore kundër njerëzimit, vendi ynë duhet të jetë**

**kurdoherë vigjilent për mbrojtjen e atdheut. Me propagandën e vet t'u thotë të vërtetën popujve, t'i paralajmërojë ata për rrezikun që u kanoset, të demaskojë qëllimet e tri superfuqive, të cilat nuk duhen lejuar në asnjë mënyrë që të veprojnë duke derdhur lumë gjakun e popujve të botës.**

Ministri i Jashtëm kinez Huan Hua është në Athinë. Ne nuk do të flasim në publik për këtë. Qeveria greke na ka vënë në korent për vajtjen e tij dhe për qëndrimet që do të mbajë ndaj Kinës. Ajo na ka thënë se Greqia ka interesa ekonomike, por në asnjë mënyrë nuk do të merret vesh me Kinën në dëm të Shqipërisë. Ne e dimë përse po afrohet Kina me Greqinë. Udhëheqja kineze kërkon të influencojë tek ajo kundër nesh, të influencojë sidomos kundër Bashkimit Sovjetik dhe të përpiqet të krijojë ato lidhje aq shumë të dëshiruara për të në mes Jugosllavisë, Rumanisë, Greqisë dhe Turqisë. Por kësaj Kina nuk do t'ia arrijë kurrë, pse sidomos Greqia dhe Turqia kanë interesat e tyre. Para se të vinte ministri i Jashtëm kinez në Athinë, shkoi në Moskë ministri i Jashtëm i Greqisë, Ralis, ku pati bisedime «të përzemërta» me sovjetikët. Domethënë ai vajti për t'i siguruar sovjetikët se politika e Greqisë ndaj Bashkimit Sovjetik dhe shteteve të tjera nuk do të ndryshojë nga ajo që është sot. Siç na njoftuan vetë grekët, ministri i tyre i Jashtëm shkoi në Moskë sepse Bashkimi Sovjetik, gjoja, i ndihmon për çështjen e Qipros. Natyrisht, Greqia kërkon të përfitojë politikisht nga të gjitha anët, por ne besojmë se aktualisht, në situatat miqësore që ekzistojnë midis dy vendeve tona, kundër nesh Greqia nuk do të marrë asnjë pozitë të përbashkët me Kinën.

E MARTË

26 SHTATOR 1978

## UNITET NË MENDIME MIDIS REVIZIONISTËVE KINEZË E JUGOSLLAVË

Në një vend të librit «Vetadministrimi» jugosllav teori dhe praktikë kapitaliste» që do të botohet së shpejti e që e kam përgatitur për të analizuar librin e revizionistit titist Eduard Kardel me titull: «Drejtimet e zhvillimit të sistemit politik të vetadministrimit socialist», kam theksuar: «Duke shprehur lidhjet, solidaritetin dhe unitetin e Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë me eurokomunistët dhe me të gjitha partitë e tjera revizioniste që, në një mënyrë ose në një tjetër, në këtë ose në atë formë, mbrojnë kapitalizmin e luftojnë kundër revolucionit dhe socializmit të vërtetë, Kardeli thotë: «... kemi arsye ta mbrojmë sistemin parlamentar dhe pluralizmin politik kur e sulmojnë forcat reaksionare të shoqërisë borgjeze...». «Ideologu» do të thotë se klasa punëtore dhe pseudokomunistët e Evropës Perëndimore kanë të drejtë të bashkohen me institucionet kapitaliste, me parlamentin dhe me qeverinë borgjeze, sepse nga ky bashkim dhe vetëm në këtë mënyrë klasa punëtore do të aftësohet për të ndryshuar shoqërinë!».

Këtë arsyetim timin e vë në fillim për të ilustruar, përveç të tjerave, edhe një nga shkaqet e tezave të partisë revizioniste kineze në lidhje me teorinë e «tri botëve» dhe me predikimin e aleancës së «botës së tretë» me «botën e dytë» e të këtyre dy botëve me imperializ-

min amerikan kundër socialimperializmit sovjetik. Me këtë vijë reaksionare dhe luftënxitëse të revizionistëve kinezë del qartë se ata i bëjnë thirrje jo vetëm proletariatit, por bashkë me të edhe gjithë popujve, u bëjnë thirrje edhe partive të kapitalit e partive revizioniste që të bashkohen në një aleancë të ngushtë kundër revolucionit, megjithëse këtë ata nuk e thonë shprehimisht, por flasin kundër socialimperializmit sovjetik. Ata e dinë se socialimperializmi sovjetik nuk ndryshon nga socialimperializmi i tyre që po zhvillohet dhe as nga imperializmi amerikan.

Të gjitha arsyet për të cilat revizionistët kinezë sulmojnë socialimperialistët sovjetikë i kemi sqaruar, por këtu ne do të shikojmë atë unitet mendimi që ekziston midis revizionistëve jugosllavë dhe revizionistëve kinezë. Kardeli mbron në librin e tij sistemin parlamentar dhe pluralizmin politik kur e sulmojnë forcat reaksionare të shoqërisë borgjeze. Edhe revizionistët kinezë, duke predikuar unitetin e borgjezisë kapitaliste me proletariatin e vendit të vet dhe aleancën midis kapitalizmit botëror me proletariatin botëror, natyrisht, nuk janë as kundër pluralizmit politik, as kundër parlamentarizmit. Në fakt ata janë pro parlamentarizmit, e konsiderojnë këtë si diçka të mirë, ashtu siç e konsiderojnë edhe titistët. Pra, sipas tyre, kjo formë qeverisjeje nga ana e borgjezisë duhet të mbrohet. Po nga kush duhet të mbrohet? Nga shoqëritë borgjeze, thotë Kardeli, kurse në realitet ajo duhet të mbrohet nga revolucioni dhe nga proletariati. Pra, sipas Kardelit dhe kinezëve, nuk duhet të bëhet revolucion, prandaj që të mos bëhet ky, duhen mbrojtur sistemi parlamentar dhe pluralizmi politik, pastaj nëpërmjet reformave do të kalohet në një shoqëri pseudosocialiste, të cilën, goftë për revizionistët titistë, goftë për revizionistët kinezë, e rrezikon socialimperializmi sovjetik dhe vetëm socialimperializmi sovjetik.

Në një vend tjetër të librit të Kardelit është edhe pohimi sipas të cilit forma e demokracisë aktuale jugosllave i përngjet më shumë demokracisë amerikane sesa demokracisë perëndimore. Një gjë të tillë e ka thënë edhe Mao Ce Duni, prandaj mund të arrijmë në konkluzionin se burimi i këtyre teorive antimarksiste është imperializmi, kapitalizmi botëror e në veçanti imperializmi amerikan.

Duke u bazuar në këto fakte, nuk duhet çuditur aspak që kinezët e errësuan qenien e tyre si shtet socialist dhe, pa e deklaruar se s'janë socialistë, u bënë pjesëtarë të «botës së tretë». Kjo do të thotë se kinezët në vetvete gjetën afinitete të shumta me «botën e tretë», e cila është një botë josocialiste, një botë ku ekzistojnë shtete borgjezo-kapitaliste, shtete të varura, të skllavëruara politikisht, ideologjikisht e ekonomikisht, që kanë një liri, pavarësi e sovranitet formal, në të cilat ekzistojnë pluralizmi dhe parlamentarizmi. Të gjitha afinitetet me këto shtete revizionistë kinezë i kanë në strukturën dhe në superstrukturën e tyre, jo vetëm pas vdekjes së Mao Ce Dunit, por i kanë pasur edhe në kohën e tij. Ne bile dimë se Mao Ce Duni ka adoptuar filozofinë e vjetër kineze të shekullit të 6-të para erës sonë, filozofi në të cilën tekstualisht thuhet që «të lulëzojnë njëqind lulet e të konkurrojnë njëqind shkollat». Këtë Maoja e ka pasë bërë një filozofi të tijën, e cila nuk është një filozofi abstrakte, por ai e ka vënë atë edhe në praktikë.

Në praktikë Mao Ce Duni ka adoptuar të dyja format: edhe atë të një «partie», edhe pluralizmin, dhe që të dyjave u ka dhënë të njëjtat kompetenca, të njëjtat funksione, por asnjë kompetencë dhe asnjë funksion konkret. Vetëm se teorikisht «demokracia e re», e predikuar nga Mao Ce Duni, nuk ishte një demokraci e vërtetë proletare, por një demokraci që i afrohej demokracisë ame-

rikane, e cila është në kundërshtim të plotë me demokracinë proletare.

Janë parimet e kundërta deri në vdekje në mes Partisë sonë marksiste-leniniste dhe revizionistëve kinezë ato që na ndajnë, janë këto parime që i detyruan partinë pseudokomuniste të Kinës dhe shtetin pseudosocialist kinez që të mbajnë një sërë qëndrimesh antimarksiste, antishqiptare, antisocialiste dhe kundërrevolucionare ndaj vendit tonë, socializmit në Shqipëri dhe në përgjithësi kundër revolucionit proletar botëror e çlirimit të popujve.

**Pra, uniteti dhe dashuria që u shfaqën kaq haptazi në dritën e diellit dhe që aktualisht po thellohen kaq shumë në mes Kinës dhe Jugosllavisë e kanë bazën pikërisht në këtë unitet parimesh, jo vetëm në çështjen e pluralizmit ose të mbrojtjes së parlamentarizmit, të demokracisë borgjeze, por edhe të formave të tjera të strukturës dhe të superstrukturës.** Këto forma kinezët do t'i huajnë gjithnjë e më shumë nga jugosllavët dhe do t'i aplikojnë më gjerësisht e më thellësisht në Kinë. Për këtë qëllim po punohet aktivisht nga të dyja anët.

Mao Ce Duni jo nga 1956, por shumë kohë më parë, ka qenë revizionist. Ai ka qenë i influencuar me kohë nga demokracia borgjeze dhe maskohej si marksist-leninist. Maoja ishte një antisovjetik, një kundërshtar i Leninit e i Stalinit dhe përkrahës i ideologjisë së vjetër idealiste konfuciane të maskuar me formulime marksiste. Për sa i përket titizmit, Mao Ce Duni përnjëherë mbajti anën e tij që më 1948. Këtë, natyrisht, e shpalli edhe përpara nesh, por manovronte, pse ishte politika e tij eklektike, politika e koniunkturave që, herë e shtynte ta mbronte titizmin, herë e detyronte të luftonte kundër tij. Pas vdekjes së Stalinit, ai e mbrojti Titon dhe në vetvete Mao Ce Duni ishte plotësisht dakord me pikëpamjet titiste si dhe me zhvillimin e format që merrte kapitalizmi në Jugosllavi.

Udhëheqja aktuale kineze, natyrisht, po i thellon dhe po i zgjeron parimet revizioniste, por nuk i ka të reja. Këto parime ajo i ka të vjetra, i ka të trashëguara nga Mao Ce Duni dhe nga udhëheqja e Partisë Komuniste të Kinës, nga veprimtaria dhe nga ideologjia e saj.

Të gjitha këto që po i them aktualisht i kanë vërtetuar edhe marrëdhëniet që Partia Komuniste e Kinës mban me partitë e tjera revizioniste. Përveç Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë Partia Komuniste e Kinës mban lidhje të ngushta edhe me partinë revizioniste të Rumanisë, sepse ka pikëpamje të njëjllota me të.

Ne dimë se Karriljoja, që udhëheq Partinë Komuniste revizioniste të Spanjës dhe që hodhi tej teorinë marksiste-leniniste mbi revolucionin e mbi çdo gjë që është leniniste, ka qenë në Kinë dhe ka rënë dakord me Partinë Komuniste të Kinës. Rruga që ka zënë Kina dhe predikimi i saj për aleancën e «botës së dytë» me «botën e tretë» dhe me imperializmin amerikan do ta çojnë këtë, në mos e kanë çuar akoma, që të lidhet me partitë e tjera revizioniste të botës, pse tratativa po bëhen që partia revizioniste e Kinës të marrë kontakt me to.

Flitet se Partia Komuniste e Italisë dhe Partia Komuniste e Kinës morën kontaktin e parë në Rumani nëpërmjet Longos e Hua Kuo Fenit. Kjo mund të jetë e vërtetë, po mund edhe të mos jetë e vërtetë. Flitet, gjithashtu, që Partia Komuniste e Italisë do të dërgojë një delegacion në Pekin me Pajetën në krye. Vajtja e këtij delegacioni ne nuk na çudit, përkundrazi, kemi bindjen se kjo do të bëhet. Kemi, gjithashtu, bindjen se edhe Partia Komuniste e Francës do të dërgojë delegacion të saj në Kinë, pse ia do interesë për të mbështetur regjimin e borgjezisë franceze dhe interesat që kjo borgjezi ka krijuar në Kinë. Pra, Partia Komuniste e Kinës do ta mbështetë teorinë eurokomuniste.

Përveç kësaj, me partitë e tjera revizioniste që ek-

zistojnë në të gjithë Evropën, përmbledhim këtu edhe ato të Anglisë, të Gjermanisë Federale, të vendeve skandinave, të Greqisë, të Spanjës, të Portugalisë etj., Partia Komuniste e Kinës do të vendosë marrëdhënie, dhe ka interesa t'i vendosë këto marrëdhënie, derisa ka interes të madh edhe nga shtetet kapitaliste të këtyre vendeve për të zhvilluar me to marrëdhënie ekonomike, politike dhe tregtare. Në këto koniunktura Kina nuk mund të kënaqet me një palo parti të Zhyrkesë në Francë, të Lëfvevit në Belgjikë, ose me atë parti në Norvegji që s'ka asnjëfarë vlere. Megjithatë, këto parti që i ka krijuar e i ka financuar Partia Komuniste e Kinës, do të ruhen si bishtra të saj derisa nuk i prishin ndonjë punë, përkundrazi, ato janë të gatshme ta ndihmojnë në luftë kundër Partisë sonë e partive të tjera marksiste-leniniste. Njëkohësisht Partisë Komuniste të Kinës nuk i prish ndonjë punë që të vendosë marrëdhënie të rregullta partie edhe me partitë e mëdha revizioniste të vendeve të ndryshme e t'i mbrojnë këto parti, pse edhe këto do ta mbrojnë Kinën nga revolucionarët, do ta ndihmojnë që të futet më thellë në lidhjet e saj me vendet kapitaliste dhe kapitalet e tyre të futen më lehtë në Kinë.

Kina nuk merr parasysh se Zhyrkeja, Lëfvevi dhe shokët e tyre do të zemërohen, sepse ajo do të mbajë lidhje me partinë e Berlinguerit, të Marshesë, të Karriljos ose të të tjerëve. Gjuha vërtitet dhe këto lidhje gjoja i do interesi i përgjithshëm i socializmit, i atij socializmi pluralist, i atij socializmi reformist, i atij socializmi që «do të realizohet» në rrugë parlamentare, i atij socializmi që duhet të krijojë një unitet moralo-politik dhe ushtarak të «tri botëve» kundër socialimperializmit sovjetik agresiv që e rrezikon.

Pikërisht në të gjitha këto qëllime, në këto ideologji pseudomarksiste, në këto pikëpamje fashiste kapitaliste, duhet t'i gjejmë ne shkaqet e kësaj egërsie të madhe të

udhëheqjes revizioniste kineze kundër Shqipërisë socialiste. Shqipëria socialiste dhe Partia e saj e Punës janë bërë një barrikadë e madhe për revizionistët e Kinës, por edhe për të gjithë revizionistët në botë e frymëzuesin e tyre, kapitalizmin botëror. Prandaj udhëheqja kineze, pa marrë parasysh se demaskohet në veprimtarinë e saj, mban qëndrime jashtëzakonisht të egra, shkel çdo ligj, bile edhe ato demokratiko-borgjeze, që si e si t'u bëjë dëm Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë dhe Partisë sonë të vërtetë marksiste-leniniste.

Në duhet t'i demaskojmë me rrënjë të gjitha këto veprimtari armiqësore të revizionistëve kinezë, të demaskojmë demagogjinë, dhëlpëritë, mashtrimet e sloganet e tyre. Të luftojmë në mënyrë që fjala jonë të zërë vend, të jetë e qartë, e kuptueshme dhe e prekshme nga proletariati, nga punonjësit dhe nga popujt e botës, të cilët të mund të shohin se ç'po luhet në kurrizin e tyre nga Kina, nga Bashkimi Sovjetik, nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, nga vendet e tjera kapitaliste, nga revizionizmi titist etj. Të gjithë këta armiq të popujve dhe të socializmit përpiqen të përjetësojnë shfrytëzimin kapitalist mbi ta, të ruajnë neokolonializmin, të krijojnë konflikte të përgjakshme në mes popujve, konflikte ndërkombëtare për të ndarë sferat e influencës në mes tyre.

Prandaj, neve dhe partive të tjera marksiste-leniniste, na vihet detyrë t'i demaskojmë të gjitha përpjekjet e këtyre armiqve. Partive të tjera marksiste-leniniste u vihet, gjithashtu, detyrë që të thellohen më shumë akoma në kuptimin dhe në demaskimin e rolit të keq mashtrues që ka luajtur Mao Ce Duni në lëvizjen komuniste ndërkombëtare dhe në zhvillimin e Kinës në rrugën kapitaliste. Ato duhet të kuptojnë se Hua Kuo Feni e Ten Hsiao Pini me shokë janë një klikë fashiste, por kjo nuk vërteton që Mao Ce Duni ka qenë një marksist-leninist i madh. Jo, Mao Ce Duni s'ka qenë kurrë një marksist,

e shumta ai mund të quhet një revolucionar demokrat-borgjez, por asnjëherë marksist-leninist.

Shumë parti të reja marksiste-leniniste nuk e konsiderojnë më Mao Ce Dunin klasik, pse ai s'ka qenë dhe s'mund të jetë kurrë i tillë, por ato duhet të arrijnë në konkluzionin se ai s'ka qenë as marksist. Në qoftë se ndonjëri si Rexh Bërçi pohon se Mao Ce Duni ka qenë marksist dhe nuk duhet atakuar, atëherë me këtë i shërben klikës së sotme renegate fashiste kineze, e cila ka ndjekur ideologjinë e Mao Ce Dunit, që ishte një ideologji pseudomarksiste, u shërben kështu ideologjisë fashiste të klikës së re që ka ardhur në fuqi në Kinë dhe intereseve të kapitalit.

**E PREMTE**

**29 SHTATOR 1978**

**PËRSE DISA PARTI (M-L) TË AMERIKËS LATINE  
NUK I KUPTOJNË GABIMET DHE FAJET  
E MAO CE DUNIT**

Po konstatojmë se midis partive komuniste, marksiste-leniniste, të vendeve të Amerikës Latine disa probleme aktuale të komunizmit ndërkombëtar, veçanërisht për sa i përket deviacionit revizionist kinez, ka që i kuptojnë, po ka edhe që nuk i kuptojnë.

Se ç'është udhëheqja e sotme kineze, pas vdekjes së Mao Ce Dunit dhe të Çu En Lait, ato e kuptojnë dhe mund të themi e kuptojnë drejt. Domethënë ato kuptojnë se banda e Hua Kuo Fenit dhe e Ten Hsiao Pinit e kanë tradhtuar marksizëm-leninizmin dhe po e çojnë Kinën drejt një vendi revizionist, kapitalist, po e bëjnë një superfuqi socialimperialiste. Me fjalë të tjera mjaft nga këto parti e dënojnë qëndrimin aktual të Kinës. Kjo do të thotë se historinë e Kinës ose marksizëm-leninizmin në këtë vend ata e ndajnë në dy: para vdekjes së Çu En Lait dhe të Mao Ce Dunit dhe pas vdekjes së tyre. Para vdekjes së Mao Ce Dunit dhe të Çu En Lait Kina, sipas tyre, ka qenë një vend socialist, Mao Ce Duni ka qenë një marksist-leninist dhe Partia Komuniste e Kinës një parti marksiste-leniniste, kurse pas vdekjes së tyre udhëheqja e re që mori fuqinë në dorë është një udhëheqje renegate, revizioniste, që ka devijuar nga marksizëm-leninizmi.

Disa parti si ajo e Kilit, e Kolombisë e disa të tjera si këto, e dënojnë gjithë veprimtarinë politike, ekonomike dhe ushtarake të Kinës së sotme të Hua Kuo Fenit e të Ten Hsiao Pinit. Ato veçanërisht dënojnë teorinë e «tri botëve». Për këtë teori, si edhe për problemet e tjera, po veçanërisht për këtë, këto parti janë plotësisht dakord me Partinë tonë, meqë kjo e atakoi për herë të parë këtë teori antimarksiste dhe mund të themi se luftën kundër kësaj teorie deri diku ato e kanë kuptuar dhe këtë teori e luftojnë.

Por këto parti nuk thellohen, ose edhe mund të mos kenë sa duhet të dhëna për t'u thelluar më shumë dhe për të gjetur origjinat e vërteta të këtij devijimi antimarksist të Partisë Komuniste të Kinës, prandaj periudhën e sotme të tradhtisë e presin si me thikë, sikur kjo ka lindur brenda ditës dhe pa pasur asnjë burim të mëparshëm. Këtu qëndron gabimi, ose si me thënë mosthëllimi nga ana e tyre. Kjo ose merret lehtë nga ana e tyre, ose ato nuk duan që t'i atakojnë Partinë Komuniste të Kinës dhe Mao Ce Dunit për gabimet që ky ka bërë dhe që kanë sjellë pasojat e sotme.

Siç e kam thënë edhe herët e tjera, një taktikë të kërtillë ndjek edhe borgjezia kapitaliste, e cila, për të luftuar marksizëm-leninizmin, mbron ata persona që janë quajtur ose janë hequr e njohur si marksistë-leninistë dhe kanë fituar njëfarë fame, por në realitet koha vërtetoi se ata nuk ishin të tillë, po mund të ishin dhe në fakt ishin vetëm revolucionarë përparimtarë, por jo marksistë-leninistë. Borgjezisë kapitaliste i intereson që këta persona të vazhdojnë të quhen marksistë-leninistë dhe komunistë. Ajo mbështetet në pseudoteorinë e këtyre të ashtuquajturve marksistë-leninistë, domethënë mbështetet në një teori që s'është marksiste-leniniste. Në këtë mes, në rast se marksistë-leninistët nuk thellohen në çështjet, në problemet dhe nuk i shohin këto dhe eveni-

mentet me syrin marksist-leninist, atëherë fiton kauza e kapitalizmit. Kjo ngjet, pra, për sa i përket çështjes së Partisë Komuniste të Kinës dhe personalisht të Mao Ce Dunit.

Udhëheqësit e partive në fjalë bëjnë disa krahasime mekanike me hrushovizmin dhe me luftën që Hrushovi i bëri Stalinit dhe e barazojnë këtë situatë me atë të Kinës. Kështu, sipas tyre, Mao Ce Duni ka qenë një marksist-leninist, i cili sot sulmohet nga banda e Hua Kuo Fenit dhe e Ten Hsiao Pinit që nuk janë përveçse hrushovianë. Pra Mao Ce Duni na qenka një marksist-leninist si dhe Stalini, kurse Hua Kuo Feni me Ten Hsiao Pinin janë revizionistë si Hrushovi.

Në qoftë se bëhet një paralelizëm i tillë shumë i gabuar dhe antimarksist, atëherë është e pamundur që t'i shohësh ngjarjet në prizmin e marksizëm-leninizmit e të dialektikës marksiste-leniniste. Stalini ka qenë një marksist-leninist dhe nuk ka gabuar as në teori, as në praktikë. Ai ka mbrojtur teorinë leniniste mbi partinë, mbi ndërtimin e socializmit, mbi diktaturën e proletariatit, mbi luftën e klasave, mbi zbatimin e normave marksiste-leniniste në parti. Në bazë të leninizmit ai nuk lejoi që në parti të mbretëronin fraksionet, krijoi unitetin parti-popull. Në kohën e tij në Bashkimin Sovjetik ekzistonte diktatura e proletariatit, ishte në fuqi klasa punëtore në aleancë me kolkozianët, kurse në Kinë punët nuk qëndrojnë kështu. Mao Ce Duni nuk ka qenë marksist-leninist. Ai ka qenë një demokrat borgjez përparimtar revolucionar që udhëhoqi luftën e çlirimit, bëri disa reforma, por dhe këto mbetën në mes të rrugës. Maoja, pra, filloi të zbatonte disa reforma për të ecur në rrugën drejt socializmit, por rruga që ndoqi ai nuk çonte në ndërtimin e vërtetë të socializmit. Ajo ishte rruga e një «demokracie të re», siç e quajti ai. Kjo ndodhi për arsye se Mao Ce Duni nuk e shikonte partinë e tij si një parti marksiste-

-leniniste, nuk e ndërtoi atë në bazë të teorisë marksiste-leniniste, në parti nuk ekzistonin normat leniniste. Maoja predikonte se në partinë e tij ekzistonin dy vija që ishin në luftë të vazhdueshme me njëra-tjetrën, predikonte se revolucioni nuk do të merrte fund kurrë, as për 10 mijë vjet. Në çdo periudhë, që bile ai e përcaktonte me vite, në 7 ose në 8 vjet një herë, do të kishte, sipas tij, revolucion, pastaj kundërrevolucion dhe kështu pa mbarim.

Megjithëkëtë udhëheqësit e disa partive të vendeve të Amerikës Latine njohin disa gabime të Mao Ce Dunit, por përciptazi dhe nuk thellohen mbi origjinën e tyre. Për shembull, ata thonë se Mao Ce Duni ka bërë gabim që priti Niksonin dhe këtë e quajnë si një pritje të thjeshtë kortezie dhe nuk thellohen të gjejnë se pritja e Niksonit është ndërrimi i një strategjie ose vazhdimi me një forcë më të madhe i strategjisë së Mao Ce Dunit dhe të Partisë Komuniste të Kinës drejt afrimit me imperializmin amerikan.

Pra Mao Ce Duni dhe Çu En Lai nuk e pritën Niksonin si me thënë sa për ta pritur, por e pritën për të lidhur një aleancë të ngushtë me imperializmin amerikan dhe me kapitalizmin botëror, me synimin e ndërtimit të Kinës me ndihmën e imperializmit amerikan dhe për të përgatitur një luftë kundër socialimperializmit sovjetik tok me imperializmin, me kundërrevolucionarët dhe me imperialistët e tjerë.

Për sa u përket «botës së tretë» dhe aleancës së kësaj bote me dy «botët» e tjera, pra teorisë së «tri botëve», udhëheqësit e partive të disa vendeve të Amerikës Latine gjykojnë pa u thelluar sa duhet se nuk është Mao Ce Duni që e ka predikuar këtë teori, por Ten Hsiao Pini. Në qoftë se pranohet që Mao Ce Duni ka bërë gabim që ka pritur Niksonin dhe nuk thellohen arsyet pse e priti atë, ngjarje kjo që solli pasojat e mëvonshme, atëherë mund të thuhet që teoria e «tri botëve» është

e të tjerëve dhe jo e Maos. Por, në fakt, kjo teori është e Maos, jo vetëm sepse vetë ky i ka predikuar këtë teori dhe këtë aleancë, por pritja e Niksonit dhe marrëveshja e arritur me Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë prova që vërtetojnë se kjo ishte teoria e Mao Ce Dunit.

Çështje tjetër, udhëheqësit e këtyre partive dënojnë ekzistencën e dy vijave në partinë kineze, por, derisa këta e dënojnë ekzistencën e dy vijave në parti, atëherë duhet t'i futen thellë kësaj çështjeje dhe t'i gjenden rrënjët se ç'do të thotë të lejosh dy vija në parti. Por këtu nuk është çështja vetëm e dy vijave. Këtu është çështja e shumë vijave, është çështja e «shumë luleve», e «shumë shkollave» që Mao Ce Duni ka pasë predikuar të lulezonin, është çështja e pluralizmit të partive dhe e kompetencave të barabarta të partive të borgjezisë me partinë komuniste në pushtet, pas çlirimit të Kinës.

Të gjitha këto ç'vërtetojnë? Ato vërtetojnë se Mao Ce Duni nuk ndiqte rrugën marksiste-leniniste në ndërtimin e partisë, nuk ndiqte vijën e proletariatit. Pra në Kinë nuk ishte në fuqi proletariati, partia e tij, por ishin shumë parti. Këto parti të shumta përfaqësonin klasa dhe shtresa të ndryshme. Kështu problemi i fshatarësisë në pushtet dhe në udhëheqje nuk është një fjalë boshe, por është një teori e tërë që ka mbrojtur dhe ka zbatuar Mao Ce Duni gjatë gjithë jetës së tij, kurse proletariati për atë ka qenë aleati i fshatarësisë. Kështu, në qoftë se analizohen deri në fund këto çështje, del se Mao Ce Duni nuk ka qenë një marksist-leninist, po një demokrat borgjez përparimtar.

Shokët e partive të disa vendeve të Amerikës Latine thonë se Mao Ce Duni ka gabuar që caktoi Lin Biaon si zëvendësin e tij dhe këtë e vuri dhe në statutin e partisë. Domethënë, ata pranojnë se ky ishte një gabim teorik dhe organizativ, që nuk përputhet me demokracinë proletare të një partie komuniste. Atëherë ky caktim i Lin

Biaos si zëvendës i Mao Ce Dunit prej vetë Mao Ce Dunit shpreh një botëkuptim të tërë, ai pasqyron një botëkuptim të veçantë mbi normat e partisë, mbi demokracinë proletare, pasqyron çfarë konsiderate ka ai për partinë e proletarëve. Të caktosh zëvendësin e partisë, se kështu ta dashka qejfi, kjo nuk është një normë marksiste-leniniste dhe pikërisht këtë duhet ta thellojnë shokët e disa partive marksiste-leniniste të vendeve të Amerikës Latine dhe jo vetëm të thonë që ky ishte një gabim.

Në këtë mënyrë ata numërojnë një sërë gabimesh, por, kur e bëjnë këtë, nuk thellohen, gjë që do të thotë se ose nuk kanë atë logjikë të fortë marksiste-leniniste që t'u venë çështjeve deri në fund, ose nuk janë të ngritur teorikisht, ose me ndërgjegje nuk duan të thellohen. Natyrisht këtë ne do ta shohim gjatë veprimtarisë së mëtejshme të tyre, po kur i pyet ata përse është Mao Ce Duni marksist-leninist, të përgjigjen: Është marksist-leninist për arsye se ndihmoi në çlirimin e popujve të botës e të tjera gjëra të tilla. Ndërsa në fakt nuk ishte Mao Ce Duni që ka ndihmuar në çlirimin e popujve të botës. Natyrisht lufta e popullit kinez ka pasur influencë pozitive në çështjen e çlirimit të popujve. Ideologjia e Mao Ce Dunit dhe teoria e tij nuk e ndihmuar këtë çlirim. Po ta analizojmë këtë çështje, çlirimin e popujve, do të shohim se influenca politiko-ideologjike e Kinës, për të mos thënë ekonomike ose ushtarake, nuk ka qenë ndonjë ndihmë kushedi se si e se çfarë, për arsye se Mao Ce Duni dhe Partia Komuniste e Kinës nuk kanë qenë kundër imperializmit amerikan.

Një çështje tjetër që këta shokë përdorin për të ilustruar tezën e tyre në favor të Mao Ce Dunit është ajo sipas së cilës ai është autori i pikëpamjes që brenda në revolucionin proletar duhet të vazhdohet revolucioni. Në Kinë kjo pikëpamje nuk shpreh një realitet të shëndoshë marksist-leninist, për arsye se i ashtuquajturi Revolu-

cion i Madh Kulturor proletar nuk ishte një revolucion me karakteristikat e një revolucioni klasik kundër borgjezisë që kishte marrë fuqinë. Përkundrazi, Revolucioni Kulturor nuk u udhëhoq nga partia, qoftë edhe ashtu siç ishte kjo parti. Ky revolucion ishte vepra e Mao Ce Dunit dhe e grupit të tij, i cili, duke u mbështetur në autoritetin e Maos, ngriti studentët, rininë në një ecje të pandalshme, me slogane e me dacibao dhe urdhëroi likuidimin e shtabeve të partisë, të organizatave të masave. Me një fjalë, për interesin e grupit të tij, ai likuidoi të gjithë ata që e pengonin të ecte ashtu siç kishte vendosur. Ata kundër të cilëve Mao Ce Duni ngriti rininë në Revolucionin Kulturor ishin edhe më të djathtë e më reaksionarë se vetë Maoja me grupin e tij.

Prandaj, po të analizohet në një prizëm të shëndoshë Revolucionin Kulturor, në të nuk shihet ndonjë gjë me të vërtetë marksiste-leniniste, po përsëritja e traditës së vjetër kineze e luftës për pushtet nga ana e grupeve të ndryshme, luftë që ka ekzistuar para, gjatë dhe pas luftës nacionalçlirimtare. Pra lufta filloi dhe u vazhdua në një rrugë jo mbi kritere revolucionare marksiste-leniniste, përkundrazi mbi kritere puçiste. Një botëkuptim i tillë mbi revolucionin vazhdoi edhe më vonë, pse prapë për pushtet luftuan, me puç, edhe Ten Hsiao Pini, Hua Kuo Feni dhe të tjerë shokë të tyre që rrëmbyen pushtetin në Kinë. Ata mund të thonë fare lehtë që ndjekim vijën e Mao Ce Dunit, domethënë se po vazhdojnë revolucionin brenda revolucionit proletar.

Në fakt, në Kinë nuk ekziston rendi proletar, po ekziston një rend demokratiko-borgjez, i cili aktualisht po merr karakter të theksuar kapitalist, që po e shndërron gjithë ekonominë e këtij vendi në një ekonomi kapitaliste, ndërsa jashtë, duke u bashkuar në aleancë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe me të gjithë kapitalizmin botëror, lufton për të shuar revolucionin dhe përga-

titet për t'i shpallur luftë superfuqisë së dytë, Bashkimit Sovjetik. Qëllimi është që Kina të bëhet një forcë e madhe kapitaliste në botë.

Këtë nuk po e kuptojnë akoma shokët e disa partive komuniste marksiste-leniniste të vendeve të Amerikës Latine. Natyrisht, ne duhet të kemi durim. Të kemi durim, do të thotë të mbrojmë pikëpamjet e Partisë sonë për këto çështje dhe të mos bëjmë lëshime, të kemi durim do të thotë të bëjmë përpjekje për t'u argumentuar shokëve të këtyre partive me fakte, me të dhëna, me analiza marksiste-leniniste, se pikëpamjet dhe qëndrimet e tyre për këto çështje nuk janë të bazuara dhe nuk mbështeten në parimet e marksizëm-leninizmit, prandaj nuk janë të drejta. Ato janë pikëpamje të cekta apo sentimentale, që mund të lidhen me faktin se këto parti, kur u formuan, sepse ato u formuan në kohën e Revolucionit Kulturor proletar Kinez, kanë mbajtur pozita pro Kinës dhe pro Mao Ce Dunit, atëherë ka mundësi të gjejnë forca që këtë gjendje ta kapërcejnë në mënyrë revolucionare, marksiste-leniniste, ashtu siç e kapërceu edhe Partia jonë.

Edhe Partia jonë për një kohë ka konsideruar se Kina ndërtonte socializmin, se ajo ishte shtylla e revolucionit botëror, se Mao Ce Duni ishte një marksist-leninist i madh. Por, kur ajo pa se këto konsiderata nuk kishin baza, kur pa se në Kinë nuk ndërtohej socializmi dhe Mao Ce Duni nuk ishte një marksist-leninist, pa lëre i madh, atëherë kërkoi të shpjegohej me ta, të shprehte pikëpamjet e veta. Udhëheqësit kinezë nuk i pranuan takimet me Partinë tonë dhe kishin arsye të mos i pranoin, sepse do të ndesheshin me ne dhe nuk do të binim dakord. Prandaj edhe ne mbajtëm qëndrimet tona, i kapërcyem këto situata.

Shokët tanë, duhet t'i sqarojnë me fakte e argumente shokët e partive motra, në mënyrë që ata të kenë përshtypjen se Partia jonë nuk ia imponon kujt pikë-

pamjet e saj, por këto pikëpamje që ka ajo i mbron dhe në të njëjtën kohë është nga ato parti që, kur të tjerët ia argumentojnë se një pikëpamje e saj e dhënë nuk ka baza, nuk është marksiste-leniniste, ajo, domethënë Partia jonë, është e gatshme, ta njohë dhe ta korrigojë atë. Por shokët e disa partive të vendeve të Amerikës Latine, për sa u përket Kinës dhe Mao Ce Dunit nuk japin arsye të kundërta që të na vërtetojnë neve se Mao Ce Duni ishte një marksist-leninist i madh, se në Kinë para vdekjes së Maos ndërtohej socializmi, kurse pas vdekjes së tij ndryshoi gjithë situata. Prandaj ne duhet të vazhdojmë të punojmë me durim me këta shokë, pse armiku imperialist, kapitalist, revizionist lufton me forma të ndryshme kundër socializmit dhe kundër teorisë marksiste-leniniste.

Aktualisht është ngritur një fushatë e madhe kundër Leninit dhe leninizmit dhe kjo ka arsyet e saj. Autorët e kësaj fushate, Marksini e konsiderojnë si filozof të një epoke të vjetër, kurse sot ata pretendojnë se bota ka ndryshuar, domethënë imperializmi është forcuar, se tash pra është epoka e imperializmit të fortë. Mirëpo këtë epokë të imperializmit Lenini e ka analizuar dhe ka treguar rrugët e vërteta se si duhet ta kuptojë atë proletariati dhe si duhet ta luftojë ai imperializmin. Lenini me mësimet e tij të pavdekshme na udhëheq në këtë fazë dhe na tregon qartë se si proletariati duhet të ecë në revolucion dhe të rrëzojë pushtetin e kapitalit. Pikërisht për këtë arsye borgjezia kapitaliste ia ka frikën dhe përpiqet të mbrohet nga Lenini dhe leninizmi, dhe pikërisht për këtë, qoftë në programin e revizionistëve modernë të të gjitha rrymave, qoftë në veprimtarinë e socialdemokracisë ndërkombëtare, u është shpallur luftë leninizmit dhe Leninit, duke e quajtur teorinë leniniste mbi revolucionin si një teori të paqenë, si një teori që nuk mund të zbatohet aktualisht.

Disa thonë se ajo u zbatua në Bashkimin Sovjetik në periudhën e paraluftës, ndërsa aktualisht, pas Luftës së Dytë Botërore, bota paska ndryshuar, botëkuptimet kanë ndryshuar, proletariati ka ndryshuar dhe se në shoqërinë aktuale janë bërë shumë ndryshime të tjera. Prandaj, thonë ata, duhen gjetur teori dhe forma të reja lufte për të shkuar në socializëm. Dhe një nga këto forma të reja është vetadministrimi jugosllav, janë teoritë e reja që po ndërtojnë revizionistët sovjetikë dhe adeptët e tyre, është maocedunideja dhe teoria e «tri botëve», ose forma dhe mënyra e botëkuptimit dhe e organizimit të pseudosocializmit në Kinë, domethënë qëndrimi në vend, ruajtja e statukuosë dhe e kapitalizmit botëror.

Partia jonë dhe gjithë marksist-leninistët duhet të ngrihen në një luftë të ashpër për t'i luftuar këta reneгатë, këta armiq dhe për të mbrojtur teorinë tonë të pavdekshme, marksizëm-leninizmin.

## E SHITUNË

30 SHTATOR 1978

### Ç'DUHET TË BËJË MINISTRI YNË I JASHTËM NË OKB

Ministri ynë i Punëve të Jashtme, niset nesër për të asistuar në mbledhjen e Asamblesë së Kombeve të Bashkuara në Nju-Jork. Unë bisedova gjatë me të për problemet që ai duhet të shtrojë në OKB.

E pyeta për ç'arsye nuk ka dëshirë të vejë në mbledhjen e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, gjë që ma kishte thënë Ramiz Alia. Ai më dha përgjigjen se ka dashur të vejë në Organizatën e Kombeve të Bashkuara sa herë që hapet sesioni vjetor dhe të mbajë atje fjalimin që na përket, por «kryeministri, — tha ai, — mendonte një herë që të mos veja unë, po të vente Reiz Malile. E diskutuam këtë çështje, pastaj erdhëm edhe në Komitetin Qendror, ku u vendos që të veja unë». Kjo ishte përgjigja e tij.

Sipas meje në sesionin e Asamblesë së Kombeve të Bashkuara është mirë që një herë në vit të vejë vetë ministri ynë i Punëve të Jashtme dhe asnjëri tjetër në vend të tij. Ai mund të shoqërohet në këto raste nga zëvendësministra ose ambasadorë, por duhet të vejë personalisht. Duhet të vejë, për arsye se është i vetmi rast kur ne, domethënë ministri i Jashtëm, merr kontakt me ministrat e Jashtëm të vendeve të ndryshme të botës që na interesojnë. Ky kontakt është i domosdoshëm se ne nuk vemi e nuk vijmë te njëri-tjetri për arsyet që

dimë, prandaj nuk duhet në asnjë mënyrë të lëmë përshtypjen ose të tregojmë *de facto* që po izolohehi dhe nuk mjafton vetëm fjalimi që mbajmë atje për të thënë se ne jemi për marrëdhënie miqësore reciproke, për marrëdhënie ekonomike etj. Një kjo.

Çështja tjetër. E pyeta: — «Përse ju niseni me kaq vonesë në OKB, domethënë pas 20 e ca ditësh që hapet Asambleja e Përgjithshme dhe kur ministrat e Punëve të Jashtme të vendeve kryesore, me disa nga të cilët ne kemi interes të marrim kontakt, kanë ikur?». Ai nuk ishte në gjendje të më përgjigjej, po ia tregova unë arsyet:

E para, — i thashë, — qëndron te nënvleftësimi që i bëni ju Organizatës së Kombeve të Bashkuara, natyrisht, për aq sa ka vlerë kjo Organizatë.

E dyta, ju nuk përgatiteni me kohë për mbledhjen e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, por përgatitni një fjalim dhe atë me zor dhe me vonesë të madhe.

E treta, është çështja subjektive ajo që pengon këtu. Meqenëse kontakti yt me ministrat e tjerë të Punëve të Jashtme është inekzistues, të duket sikur duke vajtur në OKB do të kapërcesh male e shkëmbinj, domethënë nuk e ndien veten të sigurt në bisedat që duhet të kesh me ministrat e Punëve të Jashtme të vendeve të tjera. Mund të ketë edhe arsye të tjera, por këto, mendoj unë, janë arsyet, meqenëse nuk m'u përgjigje. Ai më tha se këto janë të drejta dhe do t'i ketë parasysh herë tjetër.

Pyetja e tretë që i bëra: A jeni përgatitur ju aktualisht dhe çfarë planesh keni? Ai më tha se është përgatitur. Pika e parë e punës që do të bëjë ai atje, është fjalimi, sipas tij, kurse për çështjet e tjera përgatitja është ç't'i dalë përpara, domethënë një punë rutinë, piqu me njërin, piqu me tjetrin në kafenenë e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, jep një drekë, shko në një darkë, shtrëngo dorën dikujt, thuaji një fjalë njërit, një halë tjetrit

dhe të gjitha këto vetëm për çështje politike, për çështjen e qëndrimit ndaj problemeve botërore dhe pastaj takimi i darkës edhe me koloninë shqiptare. Ky ishte programi. Pra, shokët e Ministrisë sonë të Punëve të Jashtme nuk kanë djersitur shumë për këtë program, veçanërisht si-vjet, kur na vihen përpara probleme të mëdha ekonomike në fushën e tregtisë së jashtme me shtetet kapitaliste, në blerjen me klering të një sërë veprash.

Për çështjet ekonomike kuadrot e këtij dikasteri as që kanë menduar fare dhe as e kanë ndarë punën. Për këtë arsye i thashë se një punë e tillë nga ana e tyre është e dobët, është zbatuar një metodë pune pa perspektivë dhe e dënueshme. Prandaj, i theksova se vajtjen e tij në OKB ai duhet ta konsiderojë si një çështje me rëndësi për vendin tonë. Ne duhet të kemi që këtu një plan të qartë se me cilin ministër të Jashtëm kemi interes të pëqemi, cilit kemi interes t'i japim një drekë, apo t'i vemi për darkë, me cilin të bëjmë muhabetë të përgjithshme ose të veçanta dhe me cilin të kemi vetëm një shtrëngim dore, apo t'i japim një përsëndetje.

Për sa i përket çështjes që na intereson, pse çështja politike na intereson shumë, ne ashtu siç bëjmë në fjalim, por edhe nëpër kuluare, edhe nëpër kontakte, duhet të afirmojmë vijën tonë, qëndrimin tonë të palëkundur, guximin tonë, papërkulshmërinë tonë, mendimin tonë që do të ndërtojmë socializmin me forcat tona. Por po ashtu me ato shtete dhe me ata ministra të Jashtëm të shteteve me të cilat kemi marrëdhënie tregtare ose duam të krijojmë marrëdhënie tregtare për të shitur më shumë, por edhe për të blerë, duhet që tash, që pa u nisur, të kemi një plan të përcaktuar dhe i prura shembullin e Forlanit<sup>1</sup>, i cili u ka thënë punonjësve të

<sup>1</sup> Në atë kohë ministër i Punëve të Jashtme të Italisë.

përfaqësisë sonë në Nju-Jork se dëshiron të ketë një takim me ministrin e Jashtëm tonin kur të vijë këtu, ose një takim edhe në Romë. Mirëpo Forlani, që kishte shkuar me kohë në OKB, kur të vejë ministri ynë, ai pa-tjetër do të jetë larguar, pra nuk do ta gjejë atje. Atë, po ta gjente, do t'i fliste konkretisht, por edhe ai do t'i thoshte të tijat, më parë duke filluar nga çështje realizuar, sepse është realizuar tregti me Italinë, bile kjo është shtuar me këtë vend, gjë që duhej vënë në dukje.

Gjithashtu i duhet thënë Forlanit që ne e shohim me interesim zhvillimin e gjuhës shqipe të shqiptarët e Kalabrisë, të të gjithë arbëreshët. Kërkesa e tyre për hapjen e shkollave shqipe neve na duket se është e drejtë dhe shpresojmë se qeveria italiane, si një qeveri demokratike, do t'ua japë këtë të drejtë. Pastaj duhet futur në çështjet e shtimit të marrëdhënieve tregtare dhe t'i themi edhe arsyet përse ne duam t'i shtojmë ato.

E para, se jemi afër njëri-tjetrit dhe duhet të zhduket fryma që ka pasë ekzistuar në borgjezinë italiane, që kjo dhe fashizmi italian kishin krijuar kundër Shqipërisë. Këtu, më duket mua, t'i thotë ministri ynë italianit, Ministria e Punëve të Jashtme Italiane duhet të influencojë në ndërmarrjet, se ne e dimë që atje është një regjim kapitalist, por një fjalë nga ana e Ministrisë së Punëve të Jashtme mund të ndihmojë për të aktivizuar gjallërimin e tregtisë sonë me Italinë.

Ja me Zhirengonë<sup>1</sup> ai, gjithashtu, mund të bisedonte dhe ta falënderonte për mirësjelljen, për miqësinë që tregojnë punonjësit e shkençës mjekësore franceze ndaj njerëzve tanë, bile dhe nga ana e punonjësve të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Francës, e cila kurdoherë që ne i kemi kërkuar ndihmën e saj, na ka dhënë pa kursim në këtë drejtim; t'i thotë që nga ana jonë ne ke-

<sup>1</sup> Louis de Guiringo, në atë kohë ministër i Punëve të Jashtme të Francës.

mi simpati për Francën, për kulturën franceze, progresiste natyrisht, blejmë literaturë, kërkujmë që të shkojnë në Francë ansamblet tona të këngëve e të valleve popullore, që Franca ta njohë popullin shqiptar. Pas këtyre bisedimeve mund të kalohet edhe në çështjet tregtare për ato mallra që ne dimë se ndërmarrjet franceze kanë mundësi të blejnë te ne. Kanë rëndësi këto kontakte se Franca, sidomos, ka potencial politik.

Po kështu duhet vepruar edhe me vendet skandinave, me Belgjikën, me Zvicrën, me Greqinë. Rastet që krijohen në këto rrethana janë shumë të volitshme.

Natyrisht, ministri ynë i Jashtëm të mos bëjë kontrata me ta, por zhvillimi i bisedimeve ka rëndësi të madhe, kështu hapet më drejtpërdrejt rruga, në vend që ta lëmë këtë çështje vetëm në dorën e ambasadorëve që kanë këto shtete këtu, në Tiranë, të cilët bëjnë ndonjë raport, këtë e merr atje në ministrinë e tyre nënshefi, pastaj shefi, më tej drejtori, pastaj sektori, derisa më në fund vete në shportë.

Ishte i volitshëm rasti që mund të bisedohej me ministrin gjerman të Bonit. Vihej një person i gjashtë nga ana jonë për këtë qëllim, bisedonte ai me një person të gjashtëm të tyre dhe mund të krijohej pastaj situata që atje të piqueshin edhe të dy ministrat e Jashtëm, yni dhe gjermani. Atëherë mund t'u flitej gjermanëve për çështjen e dëmshpërblimeve dhe t'u shpjegohej qartë pikëpamja jonë e për këtë mund të merrej edhe mendimi i Bonit. Mund të thuheshin, gjithashtu, me këtë rast, edhe disa nga kushtet tona, në qoftë se do të arrihej në disa konkluzione dhe t'i thuhej që marrëdhëniet tregtare kanë hyrë në rrugë me qeverinë gjermane, me fjalë të tjera kjo do të thotë një interesim i drejtpërdrejtë.

Në të gjitha këto drejtime, i thashë ministrit, ju s'e keni vënë ujët në zjarr. Ai u përgjigj: — «Kjo është e vërtetë, ne nuk e kemi vënë ujët në zjarr». Kjo do të

thotë që ju keni bërë gabim, — i thashë, — sepse ne e kemi shtruar në Byronë Politike që ambasadorët tanë jashtë duhet të interesohen për çështjet e tregtisë, por, kur flasim për ambasadorët, kush duhet t'i vërë në dijeni dhe kush duhet t'u kërkojë llogari atyre për këtë çështje? — e pyeta unë. Sigurisht Ministria e Punëve të Jashtme, ministri. Atëherë ministri, që e ka në dorë këtë rast, duhet të përfitojë dhe të shkojë të bisedojë me përfaqësuesit kryesorë të këtyre shteteve, me të cilat ne kemi marrëdhënie dhe ka mundësi të bëjmë tregti me to. A bëhet më mirë se kaq? Nuk bëhet. Jam dakord, — pranoi ai. Prandaj ti, — i theksova, — shkon atje pa u përgatitur, duhet të punosh dhe të përgatitesh të paktën gjatë këtyre tre-katër ditëve udhëtimi dhe gjatë qëndrimit në Nju-Jork për të arritur në disa konkluzione me ata ministra që na interesojnë dhe që ndodhen akoma atje.

Nuk duhet të harrohen vendet arabe. Përfaqësuesve të këtyre vendeve t'u flitni kundër marrëveshjes së Kemp Dejvidit, e cila është kundër interesave të popujve arabë, kundër popullit të Palestinës. Edhe me disa prej tyre mund të bisedohet për çështje ekonomike, ne nuk duhet të mungojmë që edhe mbretit të Arabisë Saudite t'i themi një fjalë të mirë për qëndrimin që ka mbajtur kundër vendimeve që kanë marrë në Kemp Dejvid, Karteri, Begini dhe Sadati e kështu me radhë. Domethënë për çdo njeri ne duhet të përcaktojmë që këtu detyrat, objektivat, qëllimet dhe të punojmë në këto vendime dhe në këtë plan që duhet të caktosh më parë.

I fola dhe për punën që duhet bërë me shqiptarët e Amerikës. I dhashë të fala për ta, e këshillova që, kur t'i mbledhë, t'u thotë se Shqipëria lulëzon, ajo është e fortë, se ka miq në të katër anët e botës e ju ka edhe ju, shqiptarët, një shtyllë që e mbron atë si gjithë shqiptarët

jashtë. Po ashtu, veçanërisht shokëve e miqve të vjetër, si Hulusi Kavos edhe Talat Shehut, i thashë t'u japë të falat e mia të përzemërta dhe t'u kërkojë ndjesë nga ana ime që nuk pata mundësinë të takohesha me ta kur ishin në Shqipëri dhe kishin kërkuar të piqeshin me mua.

E SHTUNË

30 SHTATOR 1978

### FJALIM DEMAGOGJIK

**Mbrëmë lexova fjalimin e ministrit të Jashtëm të Kinës, Huan Hua, mbajtur në Asamblenë e Përgjithshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Ai ishte një fjalim i gjatë dhe i mbushur me një demagogji bajate. Por s'mjafton me kaq, çdo problem që ngrihej në këtë fjalim ishte një hipokrizi aq e madhe, aq e papërshtuar, sa edhe e neveritshme.**

Huan Huaja e paraqiti Kinën si një fuqi të madhe botërore, që u paska sjellë e po u sjell kaq të mira njerëzimit dhe popujve. Sipas tij «Kina lufton për çlirimin e popujve, për pavarësinë dhe përparimin e tyre. Ajo respekton normat e mirësjelljes, mbron paqen, mbron çështjen e një jete më të mirë për popujt, të bazuar në një ndarje më të drejtë të forcave ekonomike», që do të thotë të pasurive ekonomike që ekzistojnë dhe që janë preja e fuqive të mëdha. Natyrisht, në këto fuqi të mëdha Kina «nuk bën pjesë», për arsye se bën pjesë në «botën e tretë», siç e ritheksoi përsëri ky farë diplomati, i dërguar nga Pekini, i mësuar në universitetet amerikane dhe mik i ngushtë i Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Këtë herë Huan Huaja nuk hamulliti kundër së ashtuquajturës bandë e të katërve pse kjo nuk i interesonte aq në detaje siç e parashtroui vitin e kaluar para Organizatës së Kombeve të Bashkuara e që skandalizoi gjithë dëgjuesit e OKB-së.

Sigurisht, shteteve kapitaliste, me imperializmin amerikan në krye, u interesonte jashtëzakonisht akti ilegal, barbar dhe antimarksist që u krye në Pekin, por që të dëgjonin përrallat që tregonte Huan Huaja nga tribuna e OKB-së, u dukej e tepërt. Megjithatë, sivjet dëgjuesit, delegatët e vendeve të tjera, nuk u mërzitën më nga përralla të tilla, por gjithë fjalimi i përfaqësuesit të social-imperialistëve kinezë ishte një përrallë e madhe që tregonte njëkohësisht qëllimet imperialiste të Kinës, që tregonte në mënyrë të falsifikuar politikën e saj gjoja në favor të paqes, e cila, sipas këtij farë diplomati, do të arrihet kur popujt të bashkohen në bazë të teorisë së «botës së tretë» me «botën e dytë» dhe me imperializmin amerikan kundër socialimperializmit. Huan Huaja në gjithë fjalimin e tij kishte si pikë qendrore luftën kundër socialimperializmit sovjetik.

Në çdo ide dhe pas çdo ideje ai vinte lajtmotivin e përhershëm, luftën kundër socialimperializmit që rrezikon paqen, që rrezikon Evropën, por që rrezikon më pak vendet e tjera të Azisë. Pra, si zakonisht, Huan Huaja theksoi se epiqendra e kontradiktave në mes dy superfuqive (pse nganjëherë ai e zinte në gojë edhe superfuqinë tjetër, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, sa për të mos thënë se nuk foli për të) është Evropa. Sipas këtij dadaje kinez, lufta do të bëhet në Evropë, megjithatë ai nuk ishte aq kategorik si herët e tjera, si padronët e tij, Ten Hsiao Pini dhe Hua Kuo Feni, të cilët kanë thënë se lufta është iminente.

Huan Huaja theksoi se «lufta nuk është iminente dhe Kina nuk është për luftë». Dje ajo ishte për luftë, kurse sot nuk na qenka për luftë! Natyrisht, këtë mosgenie për luftë ai e nxori nga konkluzioni se «Kina ndërton socializmin me forcat e veta, se ka nevojë për paqe» e të tjera dëngla të këtilla. Po a tha ai ndonjë fjalë që Kina bashkëpunon kaq ngushtë me imperializ-

min amerikan dhe me gjithë kapitalizmin botëror, se ajo po merr ndihma dhe kredi të panumërta nga këto vende për të arritur të «katër modernizimet», që do ta bëjnë Kinën një superfuqi socialimperialiste? Jo. Asnjë fjalë nuk tha për këto gjëra. A bëri fjalë ai se si sillet Kina ndaj shteteve të tjera, si Vietnami e Shqipëria? Jo, përkundrazi. Ai bëri vetëm aluzione për Vietnamin dhe për Shqipërinë, duke thënë se ka vende në botë që kërkojnë si e si ta dëmtojnë statukuonë, të dëmtojnë paqen, të prishin marrëdhëniet e mira miqësore që kanë ekzistuar në të kaluarën, të bëhen vegla të një fuqie imperialiste, dhe e theksonte shprehjen «të një fuqie imperialiste» pa e zënë në gojë Bashkimin Sovjetik. Kjo fuqi imperialiste bën këtë, ajo fuqi bën atë etj., etj., tha ai.

Pra, edhe në këtë drejtim, Huan Huaja nuk mbeti pa folur. Por fjalimi i këtij «diplomati» nuk bëri ndonjë efekt të madh, pse deri sot nuk shohim që shtypi botëror të ngrinte probleme të veçanta ose të njëfarë rëndësie nga fjalimi i ministrit kinez të Punëve të Jashtme.

Në televizion pamë mbrëmë bisedën e përzemërt që pati Huan Huaja me Forlanin, ministrin e Jashtëm italian, të cilit i bënte korte, për arsye se për së shpejti kreu i diplomacisë kineze do të vejë në Itali për të biseduar dhe për të kontraktuar atje kredi nga shoqëritë e përbashkëta italo-amerikane, për të ndihmuar shfrytëzimin e pasurive të vendit në interesin e përbashkët të Kinës dhe të kapitalizmit botëror.

## UDHËHEQJA KINEZE PO SHET VENDIN NË TË KATËR ANËT E BOTËS

Analizat që i kemi bërë e i bëjmë gjendjes në Kinë, po i vërteton jeta. Agjencia HSINHUA më 28 shtator njoftonte se gazeta «Zhenminzhibao» botoi një artikull me titull: «T'u përmbahemi parimeve të demokracisë socialiste».

Ky artikull, me pak fjalë, kërkon t'u mbushë mendjen popullit dhe komunistëve kinezë që t'u përmbahen parimeve të kësaj demokracie. Kinezët, me artikullin e «Zhenminzhibaos», kanë dashur, gjoja, të përcaktojnë ç'do të thotë demokraci proletare. Por nuk është vetëm kjo. Ajo që është karakteristike shprehet në fund të artikullit, sipas të cilit në Kinë nuk ekziston një demokraci e vërtetë, nuk ka as demokraci proletare. Bile, duhet thënë, se edhe demokracia borgjeze si zor të provohet nëse ekziston apo jo atje.

Në artikull vërtet bëhen përpjekje për të vërtetuar ekzistencën e një «demokracie proletare», demokracia më e përparuar, por, meqenëse në Kinë nuk ekziston një demokraci e tillë, artikulli s'ka ç'thotë përveçse të pranojë ekzistencën e klasave; kuptohet të klasave antagonistë, sepse ai përcakton që këto klasa dhe forca kundërshtojnë popullin, kundërshtojnë demokracinë.

Ky artikull vë në dukje ndikimin e theksuar të despotizmit feudal të shekujve të kaluar. Ku vajtën, pra,

frazat pa mbarim për «ndërtimin e socializmit» në Kinë gjatë gjithë kësaj periudhe, për partinë «marksiste-leniniste» të Mao Ce Dunit, për proletariatin «në fuqi» etj., etj.? Është e qartë se të gjitha këto paskëshin qenë vetëm profka. Të gjitha këto janë analizuar në Ditarin tim Politik për Çështje Ndërkombëtare.

Përveç kësaj, në artikull, theksohet se këtë demokraci e ka penguar, gjithashtu, edhe prodhimi i vogël në periudhën e diktaturës së proletarietit. Domethënë në Kinë, si në periudhën kur rronte Maoja, por sidomos tash-ti, bile ca më keq akoma, ekziston prodhimi i vogël që ndalon jo vetëm demokracinë, por ndalon ndërtimin e socializmit dhe krijon, — siç thotë Lenini, — kapitalizmin. Aktualisht udhëheqja kineze nuk bën gjë tjetër veçse e nxit shtimin e këtij prodhimi të vogël, bile ajo po nxiton të krijojë borgjezinë e madhe me pasuri të shumta. Fakt është se që në kohën e Mao Ce Dunit, kur flitej se në Kinë ndërtohej socializmi, prodhuesit e mëdhenj ekzistonin, fabrikantët e mëdhenj ekzistonin, ata drejtonin fabrikat e tyre dhe merrnin rentat. Merret me mend se ç'bëhet tani atje!

Si konkluzion, ky artikull thotë se «Kina ka akoma një luftë të gjatë për të bërë që të arrijë demokracinë e plotë socialiste». Me fjalë të tjera kjo do të thotë se Kina nuk do ta arrijë kurrë demokracinë e plotë socialiste. Si mund të jenë për një demokraci të vërtetë Ten Hsiao Pini me shokë, kur vetë në «autokritikën» që ka bërë, ka pranuar se është kundërrevolucionar dhe e ka quajtur veten ruajalist?

Duke e lexuar me kujdes artikullin, s'është e vështirë të kuptosh se në të, padashur, vërtetohet një çështje që ka rëndësi të madhe, mosekzistenca e një demokracie të vërtetë proletare në Kinë, për arsye se proletariati nuk është klasë në fuqi dhe Partia Komuniste e Kinës nuk është një parti e proletarietit. Udhëheqja aktuale kineze

vazhdon të zhvillojë strategjinë e Mao Ce Dunit, që e hapi politikën e Kinës drejt Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe drejt vendeve kapitaliste perëndimore. Aktualisht Kina zhvillon marrëdhënie të rëndësishme tregtare dhe nënshkruan me Evropën Perëndimore kontrata të mëdha për shitjen e mallrave të ndryshme dhe blerjen e pajisjeve ushtarake.

Për këto veprime të udhëheqjes kineze në hapjen e saj drejt kapitalizmit botëror njoftojnë të gjitha agjencitë e shtypit. Kam shkruar edhe më parë se një delegacion i madh industrialistësh gjermanoperëndimorë nënshkroi me Pekinin një protokoll tregtar, me një vlerë prej 4 miliardë e 100 milionë dollarësh. Në këtë marrëveshje vihet theksi në projektet për modernizimin e industrisë së minierave. Siç thonë agjencitë e lajmeve, kjo është marrëveshja më e madhe e nënshkruar midis Kinës dhe një vendi evropian. Aktualisht, siç është lajmëruar, në Kinë ndodhet një grup industrialistësh dhe bankierësh të «Evropës së Bashkuar», të cilët marrin kontakte e zhvillojnë bisedime për ngritje ndërmarrjesh të tjera ekonomike atje, që do të bëhen me investimet e kapitalistëve të Evropës Perëndimore.

Kina kërkon me ngulm armë antitanke dhe aeroplanë luftimi nga Franca, nga Gjermania Perëndimore dhe nga Britania e Madhe, veçanërisht, aeroplanë sulmues britanikë «Herrier». Diplomatët perëndimorë janë të mendimit se kryetari Hua Kuo Fen ka synime të mëdha në fushën ushtarake dhe për këtë qëllim ai do të bëjë edhe vizita në Evropë.

Hua Kuo Feni në një fjalim të këtyre ditëve të fundit, u rekomandoi vendeve të «Evropës së Bashkuar» që të armatosen intensivisht, sepse është rrezik që Bashkimi Sovjetik të shpërthejë një luftë kundër tyre. Kështu, në Gjermaninë Perëndimore, kur po zhvilloheshin manovrat e NATO-s, asistonin edhe dy oficerë të ushtrisë kineze

që bashkëpunonin jo vetëm duke fotografuar, përpara reporterëve perëndimorë, zhvillimin e manovrave, por jepnin edhe mendimin që NATO-ja duhet të armatohet akoma më shumë.

Vitin e kaluar Tregu i Përbashkët Evropian eksportoi në Kinë mallra me një vlerë prej afro 1 miliard e 100 milionë dollarësh, kurse importimi ishte vetëm 992 milionë dollarë. Kjo do të thotë se Kina pati një bilanc pasiv me këtë organizatë. Por, sipas agjencive të lajmeve, me nënshkrimin e marrëveshjeve tregtare të prillit shpresat për përfundimin e një sërë marrëveshjesh të reja janë shumë të mëdha dhe në fjalimet e Pu Minit, drejtor i përgjithshëm i bankës qendrore kineze, mbajtur vitin e kaluar, u theksua se Kina ka ndër mend ta rritë tregtinë e saj me Tregun e Përbashkët Evropian në atë nivel të shkëmbimeve që ka me Japoninë, gjë që mendohet se do të kapë shumën 20 miliardë dollarë për vitet e ardhshme.

Tregu i Përbashkët Evropian i zbuti kushtet e tarifave për importin e shumë artikujve kinezë, duke përfshirë prodhimet kineze prej lëkure dhe druri. Përveç shkëmbimeve tregtare dhe kredive të mëdha që Kina mori nga Gjermania Perëndimore, ajo, me ndihmën e firmave britanike, do të ndërtojë edhe uzina kimike me një vlerë prej 18 miliardë e 200 milionë dollarësh. Vetëm për një minierë Anglia do të investojë atje një shumë prej 35 milionë dollarësh. Oreksi i udhëheqjes revizioniste kineze ka arritur deri në atë shkallë sa që Tregu i Përbashkët Evropian është shumë i çuditur, por edhe i shqetësuar, për arsye të urisë së madhe që ka Kina, aq sa vendet anëtare të këtij Tregu mendojnë se është e pamundur që t'ia plotësojnë të gjitha këto kërkesa me kredi.

Me Japoninë, përveç shkëmbimeve të shumta tregtare, investimeve të mëdha që po merr për naftë e për miniera qymyrguri etj., Kina po bën porosi të mëdha

edhe për ndërtim anijesh. Tridhjetë anije për lundrime oqeanike, thotë agjencia amerikane e lajmeve Asosiejted Pres, do të ndërtojë Kina në Japoni. Por në të njëjtën kohë Kina u kërkon anije edhe vendeve të Tregut të Përbashkët Evropian, edhe Rumanisë, edhe Greqisë, edhe Jugosllavisë e kujtdo.

Pra, siç tregojnë faktet, Kina ka hyrë me të dyja këmbët në ingranazhin e zinxhirëve skllavërues kapitalistë, duke shitur nga të katër anët e botës pasuritë e saj, ose më mirë duke shitur veten, domethënë lirinë dhe të famshmen «demokraci», që artikulli i «Zhenminzhibaos» e propozon të vendoset në Kinën e amshueme. Kjo nuk do të jetë gjë tjetër veçse një demokraci për pasanikët, për borgjezinë e re që është ringjallur, që është krijuar e që është forcuar duke zënë pozitat, të cilat përpiqet t'i forcojë në sajë të shitjes së lirisë, të pavarësisë, të sovranitetit dhe të ekonomisë kineze.

E ENJTE  
5 TETOR 1978

## NJË KONFERENCË ME RËNDËSI TË JASHTËZAKONSHME

Dje mbaroi Sesioni Shkencor i organizuar nga Instituti i Studimeve Marksiste-Leniniste mbi «Problemet e zhvillimit të sotëm botëror». Referatin kryesor e mbajti shoku Ramiz Alia, po kishte edhe tri referate të tjera. Referati i shokut Ramiz ishte shumë i mirë, i ndërtuar drejt, i qartë dhe ideologjikisht në nivelin e duhur. Ashtu ishin edhe referatet e tjera. Kumtesat, që ishin të shumta, zhvillonin në mënyrë të qartë teorike dhe politike problemet e mëdha e kyç që preokupojnë Partinë tonë dhe gjithë marksistë-leninistët në botë, siç janë problemi i revolucionit, lufta kundër imperializmit, kundër socialimperializmit, kundër revizionizmit modern dhe socialimperializmit kinez.

I tërë ky sesion, që zgjati tri ditë, ka një rëndësi të jashtëzakonshme për zhvillimin e mëtejshëm të punimeve dhe të tezave të Kongresit tonë të 7-të, për armatosjen akoma më shumë të anëtarëve të Partisë me ideologjinë tonë dhe me zhvillimin konkret të revolucionit në vendin tonë dhe në botë. Por rëndësi ka se në këtë sesion asistonte edhe një numër i madh delegacionesh të partive motra marksiste-leniniste të Evropës dhe të Amerikës Latine. I dëgjova me vëmendje fjalimet e tyre. Disa prej tyre diskutuan, disa të tjerë përshëndetën sesionin. Që të tërë kishin përgatitur materiale shumë të mira, me

përmbajtje revolucionare, me frymëzim, i kishin të qarta problemet që shtroheshin dhe në veçanti problemin e madh që na preokupon, demaskimin e revizionizmit të ri kinez dhe të maocedunidesë.

Vetëm mund të them se përfaqësuesi i Partisë Komuniste Revolucionare të Kilit, nuk i ka aspak të qarta këto mendime dhe zhvillimin revolucionar të botës. Ai nuk e ka të qartë çështjen e revolucionit kinez dhe problemin e Mao Ce Dunit. Natyrisht, ai foli në mënyrë të maskuar, megjithatë ne e dinim që më parë pikëpamjen e tij, sepse Ramizi ka pasur bisedime me të, por ai shkoi deri atje sa nuk tha të paktën një fjalë kundër Pinoçetit. Me fjalë të tjera, ai doli në mbrojtje të pikëpamjeve kineze deri në këtë shkallë. Përfaqësuesi i Partisë Komuniste Revolucionare të Kilit foli në përgjithësi kundër revizionizmit modern, si edhe kundër punës sabotuese që bëjnë partitë revizioniste prosovjetike në vendet e Amerikës Latine dhe vetëm kaq. Por kjo nuk ka rëndësi.

Rëndësi ka çështja që ne edhe Eçeverinë e Partisë Komuniste (marksiste-leniniste) të Ekuadorit duhet ta ndihmojmë akoma që të sqarohet më thellë për problemin e Mao Ce Dunit. Gjithë punimet që u zhvilluan në këtë sesion shkencor kanë bërë një efekt të madh tek ai. Prapëseprapë ne duhet të përpiqemi që këtë shok ta bindim, t'i shtrojë çështjet në partinë e vet dhe të diskutohet ky problem. Ne kemi shpresa se me përpjekje, me shpjegime e me fakte shokët e partive motra, edhe në qoftë se hëpërhë nuk i kuptojnë plotësisht situatat aktuale nëpër të cilat kalojmë, veçanërisht çështjet e Kinës, do të binden më vonë për drejtësinë e vijës së Partisë sonë dhe të lëvizjes komuniste ndërkombëtare marksiste-leniniste.

## SHËNIM

Shokëve të Byrosë Politike u kisha dërguar këto ditë librin që kam shkruar për vetadministrimin jugosllav si kundërpërgjigje të librit të Kardelit, me rekomandimin që ta lexojnë dhe të më bëjnë ndonjë vërejtje. Më njoftuan se e kanë gjetur të mirë dhe janë dakord që ta botojmë brenda dhe njëkohësisht ta përkthejmë për ta shpërndarë në vendet e tjera jashtë. Besoj se ai do t'u shërbejë shokëve marksistë-leninistë.

**E PREMTE**  
**6 TETOR 1978**

**VEPRIME FLAGRANTE TË POSHTRA**  
**E ARMIQËSORE TË TITISTËVE**  
**NDAJ VENDIT TONË**

Lexova relacionin që na bënte ambasadori ynë në Beograd, i cili, tok me trupin diplomatik të akredituar në kryeqytetin jugosllav, shkoi vizitoi Kosovën dhe Maqedoninë. Kjo shëtetje e trupit diplomatik nga ana e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Jugosllavisë, natyrisht, kishte disa objektiva politikë. Së pari, për t'i treguar trupit diplomatik në Jugosllavi se Kosova është një krahinë autonome, një republikë «independente» brenda Federatës; së dyti, se veçanërisht minoriteti shqiptar në Jugosllavi gëzon të gjitha të drejtat që gëzojnë edhe popujt e tjerë të këtij vendi; së treti, se edhe Maqedonia është një republikë më vete brenda Federatës dhe se rivendikimet bullgare ndaj kësaj republike janë veprime armiqësore kundër Jugosllavisë.

Natyrisht, trupin diplomatik jugosllavët e çuan andej e këndej, në disa fabrika dhe në disa qendra pune që i kishin përgatitur më përpara. Megjithatë ambasadori ynë na vë në dijeni për disa gjëra që janë flagrante, të poshtra e armiqësore. Në Kosovë, përveç të tjerave, diplomatëve u doli përpara një grup kalamanësh pionierë, dy-tre prej të cilëve ishin veshur me kostume shqiptare dhe mbanin në duar tufa me lule. Kur ambasadori ynë iu qas atyre, u dha dorën dhe u foli shqip, u konstatua

se ata nuk dinin shqip. Atëherë ai i pyeti: Shqiptarë jeni ju apo jo? Jo, iu përgjigjën ata, ne jemi serbë. Pra, titistët kishin marrë kalamanë serbë, i kishin veshur me rroba shqiptare sikur në Kosovë ku rrojnë afro 1 milion e 400 mijë shqiptarë, nuk kishte dy-tre kalamanë shqiptarë për t'i nxjerrë.

Përveç kësaj, në pritjen që bëri Xhavit Nimani, ky agjent i poshtër i reaksionit serb, në mes të tjerash tha se «ne, shqiptarët e Kosovës, jemi lidhur përjetë me Jugosllavinë titiste». S'ka si bëhet element më tradhtar se Xhavit Nimani. Ky i ka kaluar edhe Ferhat Dragat e Ceno beg Kryezinjtë. Ai mund të mos e thoshte atë që tha, por këtë e bëri apostafat kundër Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë dhe, si një provokator, kundër ambasadorit tonë. Megjithatë, thënia e Xhavit Nimanit nuk e ndërron karakterin etnik shqiptar të Kosovës dhe as të kombit shqiptar.

Çështja tjetër, që edhe kjo ka rëndësi, është se në Maqedoni, — tregon ambasadori ynë, — në darkën që kishin shtruar autoritetet, natyrisht, ishin disa udhëheqës maqedonas jo shqiptarë. Ambasadori ynë hapi muhabetin me ta dhe ua numëroi shumë mirë gjithë diskriminacionin që u bëhet shqiptarëve në Maqedoni, si: mosekzistenca e shkollave të mesme shqipe në shumë qytete, mosekzistenca e një universiteti shqiptar në këtë republikë, ku jetojnë mbi 400 mijë banorë të kombësisë shqiptare, të cilëve nuk u jepet punë, por i shtyjnë të shkojnë në Kosovë, apo të shpërndahen andej-këtej në gjithë Jugosllavinë dhe jashtë saj.

Kostumet shqiptare atje nuk i quajnë me këtë emër, por i quajnë «mitrovicka», «tetovicka» e të tjera «icka», për të mos folur për to se janë kostume shqiptare e shumë gjëra të tjera. Ata iu përgjigjën ambasadorit tonë se disa nga këto konstatime «nuk i dinin», për disa të tjera «do të informohen», disa do t'ia thonë udhëheqjes, sepse

ish-sekretari i parë i Maqedonisë, që tash është hequr si i implikuar me Jovankën e Titos, ka pasë bërë gabime kundër Shqipërisë e Maqedonisë, pra, sipas tyre, ishin bërë gabime në kohën e mikut të Jovankës. Mirëpo atje edhe tash vazhdojnë nga ana e tyre diskriminacioni dhe gjithë poshtërsitë kundër shqiptarëve.

Autoritetet maqedonase i ngritën, gjithashtu, ambasadorit tonë çështjen se gjoja në në Shqipëri nuk ua kemi dhënë të gjitha të drejtat atyre pak maqedonasve që ekzistojnë në rajonin e Prespës. Dhe yni iu përgjigj mirë atyre, duke u thënë të mos barazojnë 400 mijë shqiptarët që jetojnë në Maqedoni dhe shumë të tjerë që janë regjistruar me imponim si turq etj., me katër-pesë fshatra të vogla maqedonase që ekzistojnë në Shqipëri, ku njerëzit gëzojnë njëllor si të gjithë shtetasit shqiptarë të gjitha të drejtat. Ambasadori ynë bëri shumë mirë që ua tha këto, por ata që i dëgjuan ishin maqedonas dhe vërejtjet e ambasadorit shqiptar mund t'i mbajnë në mes tyre dhe më pas të bëjnë veshin e shurdhër. Për ne ka rëndësi që këtë çështje, kritikën që bëri ambasadori ynë t'i marrë vesh Beogradi. Prandaj mendoj dhe do të këshillohem me shokët, që ky të shkojë në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Jugosllavisë ku të thotë se vizita që bëmë në Kosovë dhe në Maqedoni ishte shumë instruktive, atje pamë shumë gjëra dhe të gjitha ato për të cilat na informoi ne, t'ia parashtrojë edhe Ministrisë të Punëve të Jashtme të Jugosllavisë, bile t'i shtojë kësaj që, në rast se ju ngrini çështjen e disa qindra maqedonasve që jetojnë në Shqipëri, ku ata gëzojnë të gjitha të drejtat demokratike, dhe i barazoni me një popullsi kaq të madhe shqiptare që jeton në Jugosllavi, duke pretenduar se ju nuk u jepni të drejtat që u takojnë shqiptarëve të Maqedonisë, për arsye se ne gjoja trajtojmë keq maqedonasit në Shqipëri, me këtë që po bëni, në vend që të vini vetullat, nxirrni sytë tuaj.

Unë, — të thotë ambasadori ynë, — ua vura në dukje këto konstatime autoriteteve maqedonase, me qëllim që të ndryshojnë qëndrim ndaj shqiptarëve dhe t'i konsiderojnë ata të barabartë me maqedonasit, pse janë sa një e treta e gjithë popullsisë së Maqedonisë dhe ajo është një etni shqiptare. Në rast se ju dëshironi që ne t'i ngremë këto çështje në shtyp, nuk na bëhet vonë, por ju themi se nuk dëshirojmë të ngjasë një gjë e tillë, sidomos në një kohë kur bullgarët po bëjnë gjithë këto gjëra kundër jush. Prandaj e drejta dhe e mira është që të korrighohen sa më parë këto qëndrime të dënueshme ndaj shqiptarëve të Maqedonisë; atje duhet të ketë shkolla, të ketë edhe universitet, shqiptarët duhet të marrin pjesë në drejtimin e pushtetit dhe të mos sikterisen andej-këndej, të mos varfërohen dhe të mos u blehen tokat për një copë bukë, duke sjellë në tokat e tyre pseudomaqedonas. Një veprim të tillë ne nuk e shohim si një politikë me qëllime të mira, e cila nuk ndihmon aspak për ekzistencën e marrëdhënieve të mira shtetërore në mes të dy vendeve.

Ne nuk e fshehim dhe ju duhet ta dini se në Jugosllavi ekziston një shumicë e madhe shqiptarësh. Kjo shumicë e madhe shqiptarësh duhet të ruajë kompaktësinë, pse po konstatojmë të duken tendenca që çojnë në të kundërtën e kësaj kompaktësie. Ju mund të më thoni mua se ata shpërngulen, ikin dhe shkojnë «ku u do qejfi», pse janë «të lirë», se në vendin tuaj «ka demokraci», se ata shkojnë të gjejnë punë në vende të tjera të Jugosllavisë, se «gëzojnë të drejtat» si gjithë jugosllavët etj. Të gjitha këto mund të na i thoni, po edhe unë di se si duhen kuptuar këto veprime.

Pra, në një frymë të tillë duhet t'u flasë ambasadori ynë, natyrisht t'ua parashtrojë si një konstatim dhe t'u thotë cila është pikëpamja jonë për këto probleme, t'u

vërë në dukje që përse doni ju që të krijoni situata të vështira me veprime të tilla brenda në këto krahina dhe republika. Bile mund edhe t'i thotë që unë e konsideroj si një provokacion të bërë kundër meje atë që zoti Xhavit Nimani në sy të të gjithëve bëri të njohur se shqiptarët e Jugosllavisë janë të lidhur përjetë me Jugosllavinë e Titos. Unë nuk dëshiroj të bëj asnjë koment për këtë çështje.

Një tjetër konstatim interesant në këtë shëtitje me diplomatët ishte edhe ai, që na bën të ditur ambasadori ynë, se nuk merrnin pjesë kinezët, amerikanët, Bashkimi Sovjetik dhe Franca. Pavarësisht se diplomatët jugosllavë që i shoqëronin thanë se kjo është diçka e rastit, fakt është që po atë ditë ambasada kineze në Beograd kishte pritje për festën e saj kombëtare. Jugosllavët e kishin caktuar ditën e nisjes të të gjithë trupit diplomatik për në Kosovë dhe u kërkuan kinezëve që ta ndryshonin ditën e pritjes që do të bënin për festën, po kinezët nuk u tërhoqën, edhe jugosllavët nuk u tërhoqën nga ana e tyre. Kështu që në pritjen e kinezëve në Beograd nuk shkoi asnjë titullar i ambasadave që përfaqësoheshin në këtë turne diplomatik që u bë në Kosovë e në Maqedoni.

Jugosllavët janë dobiçë, këtë ata e kanë bërë për t'u thënë të huajve se Jugosllavia nuk është e varur nga Kina, mundet edhe për të na thënë neve që Hua Kuo Feni erdhi në Jugosllavi pikërisht pas prerjes së marrëdhënieve me Shqipërinë dhe këtë ju e konsideroni si një provokacion, por ja, edhe ne ua lamë atyre festën dhe ambasadorët i çuam në Kosovë dhe në Maqedoni.

Por diplomatët jugosllavë janë të regjur, ata e vunë nën këmbë Kinën, arritën që Hua Kuo Feni të vinte në Beograd dhe të bënte autokritikë, t'i lëpinte çizmet Titos. Të dyja palët lidhën marrëveshje tregtare, jugosllavët morën sigurisht edhe kredi nga Kina, por për sa u për-

ket këshillave dhe politikës së Kinës, ata u lanë kinezëve të kuptojnë që nuk i hanë as mendimet, as propozimet e tyre. Dhe këtu Kinës ia bënë paq. Pavarësisht se titistët jugosllavë i kemi armiq, por, siç thotë populli, «armikun mos e duaj, po pjesën ia ruaj».

## KULTI I MAO CE DUNIT DUHET ULUR VETËM NGA POZITAT E MARKSIZËM-LENINIZMIT

Në gazetën «Zhenminzhibao» vëmë re se ka filluar të ulet popullariteti i Mao Ce Dunit. Dje ishte botuar një artikull ku, nëpërmjet kritikës që u bëhej bandës së «të katërve» dhe Lin Biaos, indirekt ulej edhe autoriteti i Maos. Konkretisht artikulli thotë se Lin Biaoja dhe banda e «të katërve» e kishin ngritur Maon në një person mbinjerëzor, në një perëndi, duke i thurur lëvdata të papranueshme, kurse Maoja ishte një element njerëzor, dhe pra duhet, sipas këtij artikulli, që si i tillë të vihet në vendin që i takon, domethënë të jetë personi kryesor i kohës së liberalizimit të partisë të viteve 50-të.

Për sa i përket hyznizimit të Mao Ce Dunit nga Lin Biaoja dhe nga të tjerët që u dënuan, këtë gjë e kemi dënuar edhe ne me kohë. Kulti i Maos ishte ngritur në qiell, ai ishte një veprim antimarksist. Ne e dënuam këtë kult, por e bëmë një gjë të tillë duke u nisur nga pozitrat e marksizëm-leninizmit, në shembullin e mësimëve të Marksit, të Engelsit, të Leninit e të Stalinit. Kurse aktualisht banda e Hua Kuo Fenit dhe e Ten Hsiao Pinit e kritikoi kultin e Maos nga rrugë të tjera dhe për qëllime të tjera: për të ulur prestigjin e Mao Ce Dunit, prestigj që në fakt ishte fals, dhe për të ngritur veten dhe pikëpamjet e tyre të theksuara revizioniste, kapitaliste, pro-imperialiste. Me fjalë të tjera, ata duan ta sjellin figurën

e Maos në nivele të tyre për ta pasur në shërbim të qëllimeve të veta. Për sa u përket qëllimeve të ekipit aktual në fuqi, këto në fakt, nuk kanë qenë në kundërshtim me ato të Maos, megjithëse në një periudhë Mao Ce Duni goditi Liu Shao Çinë, Ten Hsiao Pinin dhe të tjerë, që ishin në fuqi, pse donin qysh në atë kohë që Kina të ecte revan drejt kapitalizmit. Pra vetëm këtu qëndron ndryshimi midis tyre. Ne jemi dakord se duhet rrëzuar kulti i Mao Ce Dunit dhe jo vetëm kulti, por edhe miti që është krijuar për të si «marksist-leninist i shquar» ose edhe thjesht si «marksist-leninist». Mao Ce Duni nuk ka qenë asnjëherë i tillë, por vetëm një revolucionar demokrat borgjez ëndërrues dhe joveprues. Siç e theksova më lart, ne nuk nisemi kurrsesi nga pozitrat e udhëheqjes aktuale kineze për të ulur kultin e Maos, por vetëm nga pozitrat e marksizëm-leninizmit.

E HËNE

9 TETOR 1978

## VEPRIME POLITIKE PA CIPË TË UDHËHEQJES

### KINEZE

Kinezëve u ka plasur krejt cipa e ballit. Ata po veprojnë fare hapur, pa kurrfarë hezitimi, pa kurrfarë druajtjeje, pa pikë turpi, njëlloj si amerikanët.

Agjencitë e lajmeve thonë se së shpejti në Kinë do të vejë fashisti me damkë, Pinoçeti, diktatori i Kilit, i cili, pasi rrëzoi grupin e Alendes, vrau me dhjetëra mijë veta. Alendja ishte për atë demokraci si ajo që pretendojnë të kenë edhe kinezët, por në fakt këta nuk janë as demokratë borgjezë, përkundrazi, janë si Pinoçeti. Pra, Pinoçeti, ky barbar i urryer nga populli kilian, nga gjithë popujt e botës, bile edhe nga shumë shtete kapitaliste, deri edhe nga Vatikani, nëse do të shkojë vërtet, do të pritët me pompë si të gjithë presidentët, mbretërit, princërit e shahët në Pekinin e të famshmit Mao Ce Dun.

Dihet se Kina që në kohën e Alendes ka pasur marrëdhënie diplomatike me Kilin. Kur kundërrevolucionari, i udhëhequr nga fashisti Pinoçet, e likuidoi qeverinë e Alendes dhe bëri gjithë ato mizori kundër popullit kilian, natyrisht, një varg shtetesh, i tërhoqën ambasadorët nga ky vend me një diktaturë të hapët fashiste. Mbetën vetëm ambasadori amerikan dhe ambasadori kinez. Përballë furtunës së madhe të protestave, që u ngrit në tërë botën, kundër kësaj strategjie të shkaktuar nga fashistët, kinezët qëndruan të patundur, në ujdi me Pinoçetin dhe

në ndihmë të tij. Bile këtij regjimi fashist gjakatar ata i dhanë jo vetëm ndihmë politike, por edhe ndihmë ekonomike, me kredi etj. Tash arriti dita që këtë diktator fashist, siç po thuhet, ta presin edhe në Pekin. Më parë atje do të vejë ministri i Jashtëm i Kilit. Me siguri ai do të ujdisë terrenin edhe për vajtjen e Pinoçetit.

Megjithëse zyrtarisht asgjë nuk është konfirmuar, të gjitha agjencitë e lajmeve flasin se Pinoçeti do të shkojë në Kinë dhe unë mendoj se Kina e mirëpret atë, ashtu siç mirëpriti Niksonin, pasi ra nga posti i presidentit për batakçillëqet që bëri. Kinezët i presin e i takojnë këta njerëz dhe s'duan të dinë fare për skandalet e tyre. Ten Hsiao Pini deklaroi që, kur të vejë të ratifikojë traktatin me Japoninë, ka dëshirë të piqet me Tanakën, i cili është akuzuar se ka marrë rryshfete nga monopoli amerikan i prodhimit të mjeteve aeronautike.

E tillë, pra, është politika kundërrevolucionare, proimperialiste dhe hegjemoniste e Kinës. Tani ajo nuk vë asnjë maskë, por ecën revan, më keq se Titoja, i cili përpigjet t'u japë një çikë lustër veprimeve të tij për të mos u treguar haptazi ai që është, kurse kinezët nuk duan t'ia dinë. E tillë është megalomania e shtetit të madh, të tilla janë pikëpamjet e tyre politike. Fashiste është ideologjia e tyre, fashiste janë edhe veprimet që ata ndërmarrin në arenën ndërkombëtare. Nga pozita të tilla fashiste është nisur Kina me qëndrimet që mban ndaj Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë dhe ndaj Vietnamit. E keqja në udhëheqjen kineze kishte kohë që kishte zënë rrënjë, por popujt dhe shumë revolucionarë nuk e kishin kuptuar. Aktualisht të gjithë këta e mbështetin luftën e drejtë parimore të Partisë së Punës të Shqipërisë kundër udhëheqësve fashistë kinezë, të cilët nga dita në ditë, me veprimet e tyre të ulëta antimarksiste, po e tregojnë veten se cilët janë përpara gjithë botës.

**E MARTË**  
**10 TETOR 1978**

## **DEMOKRACIA PROLETARE NË KINË AS KA EKZISTUAR, AS EKZISTON**

Prej disa ditësh po vazhdoj të lexoj pjesë të nxjerra nga artikulli i gjatë i botuar në «Zhenminzhibao»: «T'u përmbahemi parimeve të demokracisë socialiste». **Në këtë artikull, gjoja teorik, bëhen përpjekje për të shpjeguar demokracinë proletare nën diktaturën e proletariatit në kushtet e Kinës.** Artikulli nuk ka asnjë vlerë nga ana teorike, domethënë e trajtimit të problemit në mënyrë filozofike dhe praktike, sepse vetë praktika vërteton që demokracia proletare në Kinë as ka ekzistuar dhe as ekziston.

Po citoj disa pjesë prej tij. Duke folur për të kaluarën, në një vend të artikullit thuhet: «Nga ana historike, Kina ishte për një kohë të gjatë një vend feudal i sunduar nga klasa çifligare. Megjithëse Kina u kthye nga një shoqëri feudale në një shoqëri gjysmëkoloniale dhe gjysmëfeudale në 100 vjetët midis luftës së opiumit dhe falimentimit të qeverisë guomindanase të Çan Kai Shisë, sistemi politik dhe ideologjia e autokracisë feudale mbetën mbështetja kryesore politike dhe shpirtërore e Kinës së vjetër». Mirë deri këtu.

Pastaj vazhdon: «Ideologjia dhe influenca e autokracisë feudale kanë depërtuar në çdo shtresë shoqërore dhe në çdo aspekt të jetës shoqërore. Me një fjalë, Kina kontemporane ishte një vend vetëm me tradita të autokra-

cisë, dhe pa tradita demokracie dhe në këtë drejtim ishte shumë më e prapambetur se Rusia përpara Revolucionit të Tetorit. Përderisa kushtet shoqërore në të cilat populli, nën udhëheqjen e partisë, kreu revolucionin demokratik, ishin shumë më të prapambetura se ato në Rusi përpara Revolucionit të Tetorit dhe përderisa zonat tona të bazave revolucionare ishin të copëtuara dhe të rrethuara për një kohë të gjatë nga Guomindani, që lejonte ideologjinë e klasave armike të depërtonte në radhët tona revolucionare, ishte shumë e lehtë për anëtarët dhe kuadrot të prekeshin nga autokracia feudale, burokracia dhe stili i punës i Guomindanit». Ky është citim ekzakt i artikullit të gazetës.

Më poshtë tregohet se Mao Ce Duni u përpoq që ta zhdukte këtë frymë, domethënë të zhdukte plotësisht influencën e dëmshme të autokracisë feudale, që është kundër popullit, dhe të vendoste demokracinë brenda partisë dhe radhëve revolucionare. Por, për fat të keq, na doli Lin Biaoja dhe banda e «të katërve», të cilët e prishën këtë «demokraci proletare» në këtë farë partie proletare dhe në këtë «shtet proletar». Pra, këtë traditë shekullore, që kishte zënë rrënjë, sipas artikullit, Lin Biaoja dhe banda e «të katërve» e prishën brenda 10 vjetëve.

Ky është një absurditet i madh, sepse së pari, vepri-met e Lin Biaos e «të katërshes», ashtu siç ishin ato, i udhëhiqte dhe i drejtonte vetë Mao Ce Duni. Së dyti, si mund të priset demokracia proletare në një kohë kaq të shkurtër dhe nga dy-tri veta, në qoftë se ajo ekziston e gjallë brenda në parti e në të gjitha shtresat e popullit? Jo, e vërteta është se Mao Ce Duni dhe Partia Komuniste e Kinës nuk kishin vepruar për të vendosur një shtet të diktaturës së proletariatit dhe, pra, një diktaturë të proletariatit, sepse proletariati nga ata nuk konsiderohej si klasa që duhej të ishte në fuqi, pra, nuk e njihnin rolin hegjemon të tij, por konsideronin si të tillë fshatarësinë.

Mentaliteti i Mao Ce Dunit dhe i shokëve të tij ishte mentalitet i kulakëve, «i zotërve të luftës», domethënë ata karakterizoheshin nga tiparet feudale të drejtimit, ashtu siç e kemi shpjeguar drejt në tezat tona, që figurojnë në materialet e Partisë për këtë çështje.

Artikulli, natyrisht, është shkruar me qëllime të caktuara nga klika e Hua Kuo Fenit dhe e Ten Hsiao Pinit. Në radhë të parë ky artikull është bërë për të justifikuar rrugën kapitaliste në të cilën po ecën zhvillimi ekonomik i Kinës. Kjo rrugë kapitaliste e prodhimit masiv, gjoja socialist, duhet të zhdukë prodhimin e vogël, prodhimin artizanal, që në fakt ekziston në Kinë. Por atje ekzistojnë, gjithashtu, edhe ndërmarrje kolektive që, natyrisht, nuk kanë drejtim socialist, por drejtim kapitalist dhe tash këto do të marrin një formë të prerë kapitaliste. Ja pse bëhet ky artikull.

Megjithatë artikulli nuk mund të lërë pa thënë se diçka është bërë në Kinë, dhe pikërisht në një vend ai thotë se «Tradita e lavdishme e demokracisë proletare u formua gradualisht në partinë tonë pas dhjetëra vjetësh të praktikës revolucionare dhe të luftës së vazhdueshme nën udhëheqjen e shokut Mao Ce Dun». Vëmë re se këtu demokracinë e quan «proletare», kurse më tej kjo nuk quhet më «demokraci proletare», por «popullore». Artikulli pohon: «Prapambetja e vendit tonë ekonomikisht nuk ka ndryshuar ende rrënjësisht, megjithëse kanë kaluar më tepër se dy dekada të revolucionit e të ndërtimit socialist dhe zhvillimit të madh në forcat prodhuese shoqërore, pasi Kina ishte një vend ku mbizotëronte kryesisht prodhimi i vogël, dhe me një ekonomi e kulturë jashtëzakonisht të prapambetur para çlirimit».

Po vazhdoj citimin: «Ekonomia jonë kombëtare nuk është lidhur plotësisht me bazën teknike të prodhimit masiv dhe ekzistojnë akoma mbeturinat e prodhimit të vogël. Ekzistojnë akoma disa metoda artizanale të pro-

dhimit dhe të administrimit në industri, komunikacion, transport dhe në ndërmarrje shtetërore të tregtimit; mbeturinat dhe karakteristikat e prodhimit të vogël janë më të theksuara në ekonominë kolektive në fshat, ku puna e krahut mbetet forma bazë e prodhimit. Këto kushte ekonomike bëjnë që të vazhdojë ekzistenca e ideologjisë së autokracisë feudale e psikologjisë dhe e zakoneve të prodhimit të vogël».

Me fjalë të tjera artikulli pohon se si në industri, ashtu edhe në bujqësi ka ekzistuar e theksuar prona private, por e karakterit feudal, domethënë fshatarët e pasur i kanë ruajtur pasuritë e tyre. Edhe në qoftë se janë krijuar disa komuna popullore ose kooperativa popullore, këto nuk kanë aspak karakterin e një drejtimi kolegjal marksist-leninist në bazë të eksperiencës së madhe dhe mësimëve të Leninit e të Stalinit.

Tash udhëheqësit e sotëm revizionistë e japin këtë pasqyrë të vërtetë të zhvillimit të deritanishëm të ekonomisë, qoftë në industri, në bujqësi, në tregti, në transport etj., për të përlligjur ndërtimin e një forme të re ekonomike në Kinë, që do të jetë forma kapitaliste. Këtë ata do ta huazojnë nga amerikanët, nga japonezët e nga jugosllavët dhe me fjalë bombastike pseudomarksiste do të përpiqen që gjithë këtij transformimi kapitalist të Kinës t'i japin një emërtim gjoja marksist-leninist.

Kështu, mendimet që kam shprehur në Ditar për një varg problemesh të ndërtimit gjoja të socializmit në Kinë, po vërtetohen në jetë dhe këtë vërtetim po e bëjnë vetë kinezët. Ata për të bërë ndryshimet e plota në drejtimin kapitalist të ekonomisë, atyre reformave borgjezo-demokratike të fillimit, duan s'duan, duhet t'u japin një shtytje përpara në metodologji, ose më mirë të themi, në «katër modernizimet» që kanë përcaktuar aktualisht e që do ta çojnë Kinën në rrugën e një superfuqie imperialiste.

E PREMTE  
13 TETOR 1978

## **KINA PO NXITON NË QORRSOKAKUN KAPITALIST DHE NJË MËNGJES DO TË THYEJË QAFËN**

Vija antimarksiste kapitaliste e Partisë Komuniste të Kinës dhe e shtetit kinez nuk mund të fshihet as me slogane, as me parulla, as me artikuj. Gjithë bota e shikon në dritën e diellit se udhëheqja revizioniste kineze e ka futur Kinën me të dyja këmbët në rrugën e kapitalizmit pa kurrfarë drujtjeje, pa iu skuqur cipa e fytyrës, përkundrazi, duke i bërë reklamë të madhe kësaj vepërimtarie armiqësore që ka ndërmarrë kundër popullit kinez dhe kundër popujve revolucionarë të botës.

Shokët tanë të ambasadave, në Pekin e gjetkë, kanë pasur bisedime të veçanta me ambasadorët e vendeve të tjera për çështje dhe probleme të lidhjeve të shteteve kapitaliste me Kinën. Gjatë këtyre bisedimeve këta ambasadorë janë shprehur me kënaqësi për zhvillimin e marrëdhënieve të tyre të gjithanshme me Kinën, por ankohen se nuk i përballojnë dot delegacionet e grupet e shumta që vijnë nga vendet e tyre në Kinë. Domethënë **është shumë i madh numri i delegacioneve të shumëllojta që venë nga vendet e ndryshme kapitaliste në Pekin për t'u marrë vesh me udhëheqjen kapitaliste kineze.**

Këta ambasadorë i kanë thënë ambasadorit tonë në Pekin se vendet e tyre dy vjetët e fundit kanë pasur një bilanc deficitar, kurse nga tregtia e sivjetshme me Kinën qysh tani kanë suficite të mëdha. Ata thonë se për sa i

përket financimit të blerjeve të saj në Perëndim, Kina tashti e ka ndryshuar politikën dhe ka hequr dorë nga parimi që të mos marrë borxhe.

Një parashikim i tillë, që ne e kemi bërë me kohë, po vërtetohet. **Tani Kina pranon kredi nga vendet e tjera, edhe pse akoma zyrtarisht ruan parimin e mosmarrjes së borxheve, që sigurisht është i përkohshëm.** Ambasadorët e mësipërm thonë se Kina hiqet sikur nuk pranon kredi në rrugë shtetërore, nuk pranon investime të huaja të drejtpërdrejta, nuk pranon të marrë pjesë në investime të përbashkëta me shtete të tjera në një vend të tretë, por në fakt dy «nuk»-et e para janë sa për formë. Kina tani pranon kredi në rrugë bankare dhe dihet se banka në Kinë është shtetërore; të gjitha kreditë nga Japonia asaj i janë garantuar nga shteti japonez etj. Po kështu **Kina po bashkëpunon me firmat japoneze dhe amerikane për shfrytëzimin e përbashkët të naftës në dete.** Këto firma furnizojnë Kinën me teknikë e me pajisje dhe paguhen prej saj me naftën që nxjerrin. Po ç'janë këto? A nuk janë investime të drejtpërdrejta? Kësaj i thonë jo ve, po kokove.

Ambasadorët në fjalë thonë se vendet e tyre janë në bisedime intensive me qeverinë kineze për të marrë pjesë në realizimin e programit të «modernizimit» të Kinës. Parashikohet që këto vende të ndërtojnë në Kinë uzina moderne për prodhimin e plehut kimik e për insekticidet, si dhe termocentrale, hidrocentrale, fabrika të mëdha çimentoje, platforma për shfrytëzimin e naftës në dete, uzina mekanike, elektrike, për armatime etj. Këto nuk mund të paguhen me eksportin e Kinës në këto vende, prandaj do të jepen me kredi. Ky problem tani po diskutohet nga firmat përkatëse me krerët kinezë. Zvicra, për shembull, në krahasim me vendet e tjera të Perëndimit, çmimet dhe kamatat i ka disi më të ulëta,

por vlera e frangut zviceran është shumë e lartë në krahasim me dollarin dhe është vazhdimisht në rritje, pra ndaj, siç tha ambasadori i Zvicrës, Kina ka interes të blejë me dollarë e lira, ndryshe, kur të paguajë kredinë me frangat zvicerane të mbivlerësuara, efektivisht do t'i paguajë mallrat më shtrenjtë.

Gjithashtu këta ambasadorë i thanë ambasadorit tonë në Pekin se kanë mendimin që vizita dhe bisedimet e delegacionit të Tregut të Përbashkët Evropian në Kinë kishin më tepër karakter politik sesa ekonomik. Në fakt nuk është plotësisht kështu. Siç tha ambasadori i Belgjikës, delegacioni më vonë diskutoi edhe për zgjerimin e importimeve të Kinës nga vendet e Tregut të Përbashkët Evropian, për kushtet e financimit të eksportit në Kinë etj.

**Pra del se midis vendeve të Tregut të Përbashkët Evropian ka filluar konkurrenca e rreptë për tregti me Kinën;** po kështu, këta me zemër të thyer pranojnë se tregu kinez është i rezervuar në radhë të parë për Japoninë, por ua kanë frikën edhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Ambasadori danez i tha ambasadorit tonë: «Unë habitem për vizitën që po bën tani në Kinë shefi i misionit amerikan në Pekin, Gejt, me një grup bankierësh e afaristësh. Këtu ndodhet edhe gruaja e ish-shefit të misionit amerikan në Pekin, Xhorxh Bushit, që më pas u emërua shef i CIA-s».

Edhe ambasadori zviceran i tha ambasadorit tonë se vendet perëndimore kanë tarifa preferenciale në çmime dhe kamata për eksportet në vendet në zhvillim. Për të përfituar nga kjo dispozitë, këto vende duhet të bëjnë një deklaratë me shkrim. Kur ia kishin propozuar më parë Kinës një gjë të tillë, qeveria kineze kishte kundërshtuar, por tani, — siç tha ambasadori, — kinezët

pyesin nëse është e mjaftueshme deklarata me gojë që të mund të përfitojnë nga kjo dispozitë, Ja deri ku kanë rënë ata, por do të shohim se do të bien akoma më poshtë.

Mendimi i ambasadorëve është se, pavarësisht nga deklaratat, kinezët nuk do t'i realizojnë dot brenda shekullit planet e tyre ambicioze për «katër modernizimet».

Njëri prej tyre i foli ambasadorit tonë me pesimizëm për perspektivën e bujqësisë së prapambetur të Kinës, për transportin e papërshtatshëm, për drejtimin dhe për administrimin e keq të ekonomisë, për mungesën e kuadrin të aftë teknik etj. Por përmirësimi i gjendjes në Kinë, tha ai, ka interes. Përfundimi ka interesat e tij që ta përkrahë Kinën në këtë program të zhvillimit të saj.

Po kështu u shpreh edhe ambasadori zviceran. Ai tha se planet e udhëheqësve kinezë për modernizimin e Kinës janë reale, veçse këtu në Kinë mungojnë infrastrukturën, e megjithatë shumë gjëra do të bëhen. Ky ambasador tha se ka lexuar me vëmendje materialet tona, se ato e kanë bërë të mendojë për Kinën, për politikën e saj dhe për ngjarjet në botë, e se në këto materiale gjen mendime e analiza shumë të thella ndonëse nuk është dakord me të gjitha pikëpamjet tona.

Duke folur për gjendjen në Kinë, ai tha se këto ndryshime që po ndodhin janë shumë të mëdha, nuk mund të flitet më për ideologji, se Kina tani i ka vënë vetes qëllim kryesor të dalë nga prapambetja, të industrializohet e të ngrejë nivelin e jetesës së popullatës pa pyetur shumë në ç'rugë e me ç'mjete do ta bëjë këtë dhe, në këtë plan, qëndrimet dhe kritikën e Partisë së Punës të Shqipërisë janë të drejta e me vend.

Ja rruga ku po ecën Kina. Situata, kjo rrugë dhe të gjitha veprimet e udhëheqjes revizioniste kineze janë analizuar shkencërisht nga Partia jonë dhe jeta po i vër-

tëton; kjo tregon se nuk kemi qenë të gabuar. Kina po shpejtohet në këtë qorrrokak dhe një mëngjes do të thyejë qafën. Kjo me siguri do të ndodhë, sepse ekonomia kinëze do të hyjë plotësisht nën zgjedhën e kapitalizmit botëror dhe Kina do ta humbasë pavarësinë politike; sa për ideologjinë e saj, kjo do të jetë një ideologji krejtësisht kapitaliste.

E SHTUNË

14 TETOR 1978

### KIM IR SENI PO E KTHEN VETEN NË PERËNDI

Kam folur edhe herë të tjera për antimarksistin korean me emrin Kim Ir Sen, që drejton si një perandor mesjetar popullin heroik të Koresë.

Ky person, nëpërmjet një propagande të turpshme, shurdhuese e të shumanshme, po e kthen veten në një perëndi, si një person i ardhur nga qiejt për t'i shërbyer, po më mirë të themi, siç thotë propaganda koreane, «për të ndriçuar dhe për të udhëhequr» jo vetëm popullin korean, por gjithë popujt e botës. Kush i këndon këto radhë që po shkruaj këtu, mund të thotë se shoku Enver po ekzagjeron. Unë nuk ekzagjeroj asnjë fije, bile s'kam se si t'i përsërit të gjitha ato marrëzi që shkruan shtypi korean.

Ky njeri rrjedhka, sipas tij, nga një dinasti që gjysh pas gjyshi e djalë pas djali kanë ardhur në Kore nga një frymë hyjnore për ta bërë këtë vend një «diell të madh» që «të ndritë botën», që «të ndritë epokën tonë aktuale». Epoka aktuale, sipas propagandës koreane, është epoka kimirseniane dhe bota duhet të zhvillohet sipas pikëpamjeve filozofike, ideologjike dhe politike të këtij farë burri. Deri këtu ka arritur kjo çështje. S'ka asnjë fije turpi nga bota, për të mos folur për thjeshtësi, pse kjo nuk ekziston as te ky person, as te lakenjtë e tij në Kore, që flasin të tilla budallallëqe sa mali i Himalajës.

Bota ka parë megalomanë plot, por një megaloman

të tillë si Kim Ir Seni as më kanë dëgjuar veshët dhe as më kanë parë sytë në gjithë ata libra të shumtë që kam lexuar. Kanë dalë njerëz të mëdhenj gjatë shekujve, për të cilët ka folur bota, po më shumë ka folur kur ata kanë vdekur dhe kur pas kanë lënë gjurmë. Por edhe kur është folur për ta që kur kanë qenë gjallë, njerëzit janë shprehur në mënyrë njerëzore, kanë vënë në pah meritat, por edhe dobësitë e tyre, sepse nuk ka njerëz pa dobësi, pavarësisht nga shumë të mirat që mund të ketë ndonjë person që i ka vënë ato në shërbim të popullit dhe të klasës së tij.

Pedagogë të lëndëve shoqërore të universitetit të kryeqytetit korean, duke folur në biseda dhe në kurse për klasikët e marksizëm-leninizmit, për Marksit dhe për Leninin theksojnë pikëpamje me të cilat tregojnë se s'janë veçse revizionistë. Kështu ata vënë në dukje se mjaft pikëpamje të klasikëve të marksizëm-leninizmit janë vjetruar, se ato kanë qenë të vlefshme për kohën kur ata kanë jetuar. Marksit, Engelsi, Lenini thonë këta pedagogë, kanë jetuar në kohën kur forcimi i ndërgjegjes revolucionare të klasës punëtore ishte në fazën fillestare të saj, se klasikët e marksizëm-leninizmit nuk kanë mundur t'u jepnin zgjidhje shumë problemeve, sidomos atyre që i përkasin kërkesës së ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste.

Pra në shkollat e larta dhe në universitetin e Phe-nianit hidhen poshtë klasikët, ata hidhen në pluhur, në harresë dhe bëhen përpjekje të vërtetojnë, siç po bën gjithë kapitalizmi botëror dhe revizionizmi modern, se këta shkencëtarë të mëdhenj, që ndritin rrugën tonë, qenkan vjetruar, se atyre u ka kaluar koha, pse, sipas tradhtarëve të marksizëm-leninizmit, këta nuk kanë parashikuar ndërtimin e shoqërisë socialiste. Të tillë njerëz nuk mund të themi se janë qorra, por i kanë qorruar, ata nuk shohin çfarë tradhtie të madhe po i bëjnë botës,

njerëzimit, revolucionit, socializmit. Dhe përse këto? Për të mburrur Kim Ir Senin dhe të ashtuquajturat ide dhe teori «çuçe», gjoja të famshme botërore të këtij farë burri.

Këta profesorë të pseudomarksizmit thonë se qenkan idetë «çuçe», ideologjia më e përsosur që u japin zgjidhje të gjitha problemeve të epokës sonë. Deri këtu kanë arritur poshtërsitë dhe marrëzitë e tyre. Asnjë problem nuk ka zgjidhur Kim Ir Seni, asnjë problem nuk kanë zgjidhur idetë «çuçe» dhe partia e tij antimarksiste. Pikëpamjet revizioniste të koreanëve pasqyrohen në mënyrë të hapët e të shfrenuar në shtypin e partisë së tyre. Gazeta «Nodom Shinmun», tek e cila lexova një artikull kushtuar jetës dhe veprës së Marksit, pasi flet për meritat e tij në atë kohë, as më pak dhe as më shumë thekso-n: «Që kur ka dalë marksizmi kanë kaluar 100 vjet. Gjatë kësaj periudhe në arenën ndërkombëtare historike kanë ndodhur transformime rrënjësore, ka ndërruar në mënyrë rrënjësore pamja e botës».

Më poshtë ky artikull vazhdon: «Epoka jonë është një epokë e re historike, krejtësisht ndryshe nga periudha kur fantazma e komunizmit po vërtitej mbi Evropë dhe kur klasa punëtore po përgatitej për luftën revolucionare». Epoka jonë, sipas koreanëve, është epoka e madhe e pavarësisë, kur masat e gjera të popullit u kanë dalë zot fateve të tyre dhe sundojnë botën, vendosin vetë për këtë fat në mënyrë të pavarur e krijuese. Kjo, sipas revizionistëve koreanë dhe mendjemadhit Kim Ir Sen, do të thotë se gjithë bota ka fituar sot çlirimin dhe kjo është epoka e sundimit të tij. U zhduk për të revolucionit, nuk ekziston më për të marksizëm-leninizmi që udhëheq klasën punëtore kundër kapitalizmit e borgjezisë që e shtypin dhe e shfrytëzojnë.

Kjo gazetë vazhdon: «Udhëheqësi i madh i revolucionit, Kim Ir Seni, duke pasqyruar kërkesat e epokës

së re të pavarësisë, që kanë depërtuar në zhvillimin historik të njerëzimit e të lëvizjes revolucionare të klasës punëtore, ka krijuar ideologjinë e madhe revolucionare, ideologjinë «çuçe», që është «botëkuptimi revolucionar i klasës punëtore në epokën e tanishme, është busulla më e saktë udhërrëfyese që çon në rrugën e fitores revolucionare dhe në ndërtimin e socializmit».

Në një numër tjetër të po kësaj gazete kam lexuar një artikull kushtuar jetës dhe veprimtarisë së Leninit. Pasi flitet shkurt për meritat e tij në atë kohë, artikulli thotë se pasurimi i marksizmit nga Lenini është bërë në përputhje me kushtet e reja historike të periudhës revolucionare proletare, kurse epoka e sotme është epoka e pavarësisë etj. Siç del qartë, këtu kemi të bëjmë me një antimarksist.

Ne e dimë se ky element s'ka asnjë fije kuptimi të qartë për ideologjinë marksiste-leniniste, s'ka asnjë fije kuptimi për teorinë e Marksit, të Engelsit, të Leninit e të Stalinit. Ai, pa asnjë dyshim, e ka përçmuar vazhdimisht Leninin dhe as që ka menduar ndonjëherë ta ndjekë këtë në rrugën e tij të lavdishme, në mësimet e tij të mëdha për fitoren e revolucionit, për ndërtimin e një partie marksiste-leniniste të vërtetë, për shembjen e kapitalizmit e të borgjezisë, për revolucionin. Jo. Ky njeri është një monark absolut që shfrytëzon popullin dhe rron si monark jo vetëm nga të mirat materiale, por edhe nga ushqimi shpirtëror. Ai ka krijuar një organizim të tillë në Kore, nën kërbacin e mercenarëve të tij, që shërben për ta çuar popullin atje ku do ai dhe si do ai. Kim Ir Seni e ka lënë popullin të rrojë me triska. Djersën e gjakun e popullit korean ai i shfrytëzon për «madhëstini» e tij personale, për oborrin e tij, për trashëgimtarët e tij, të cilët i ka përgatitur që tash, siç po i përgatit në personin e djalit të tij që ta zëvendësojë, kur babai-mbret të vdesë dhe të lërë në fron princin trashëgimtar.

Unë nuk flas për lakenjtë e sahanlëpirësit, për njerëzit që përfitojnë nga peshqeshet e këtij megalomani, që edhe vetë ambasadori zviceran e quan një veprim prej të çmenduri porosinë që ka bërë Kim Ir Seni në Zvicër, për të prodhuar me mijëra orë të florinjta, mbi të cilat të shkruhet emri i tij. Këto mijëra orë të shtrenjta e gjëra të tjera që ka porositur ky perandor megaloman, po i përdor për t'ua dhuruar atyre që e ruajnë dhe që i shërbejnë. Ambasadori zviceran tha se ata vetë përfitonin nga kjo punë, pse i shesim gjithë këto orë, por kemi nderin, — tha ai, — që mbi këto prodhime tonat të vihet emri i Kim Ir Senit, veçse një porosi e tillë, — shprehte ai habinë, — nuk na ka bërë ndonjëherë vaki.

Ky udhëheqës «i ndritur» ka bërë që shteti i tij të jetë në prag të falimentimit. Ka marrë aq borxhe sa s'ka shtet kapitalist që ta besojë dhe të vazhdojë t'i japë kredi. Për të shpëtuar nga kjo gjendje herë kthehet nga Kina, herë nga Bashkimi Sovjetik. Kim Ir Seni merr kredi nga të gjithë, por këto kredi ai nuk i kthen dhe çfarë bën e si vepron, kam shkruar edhe herë të tjera. U bë një skandal i madh në botë kur u zbulua se ambasadat koreane kudo ishin bërë qendra ku zhvillohej trafiku i drogave. Deri këtu ka degjeneruar regjimi korean, udhëheqësi i të cilit përpiqet të rrëzojë kolosët, Marksën dhe Engelsin, Leninin dhe Stalinin, të ndërrojë epokat dhe të hiqet vetë si udhëheqësi botëror i kësaj epoke të re.

E MARTË  
17 TETOR 1978

## **POLITIKA E «KATËR MODERNIZIMEVE»**

### **— POLITIKË SUPERFUQIE**

Problemi i Kinës tash është krejtësisht i qartë. Kina e Hua Kuo Fenit dhe e Ten Hsiao Pinit, haptazi, pa druajtje, pa dorashka, e tashmë edhe gati pa demagogji, është bërë dhe vepron si një shtet imperialist.

Këtë situatë e sheh e gjithë bota, e cila ka po këtë mendim që unë shpreh këtu. Kur them se ka këtë mendim, një gjë të tillë nuk e imagjinoj, por e bazoj në fakte. Në kontaktet e herëpashershme që kanë ambasadorët tanë me ambasadorë të shteteve të ndryshme të botës, konstatojnë se te këta është i rrënjosur ky mendim dhe ka arsye të jetë i rrënjosur, sepse me shtetet borgjeze kapitaliste e imperialiste Kina zhvillon një veprimtari intensive e të shumanshme politike, ekonomike dhe ushtarake. Këtë ajo e bën me qëllime të caktuara për të realizuar të ashtuquajturat katër modernizime, në bazë të të cilave synon të ndërtojë një ekonomi moderne, të ndërtojë një shtet modern, një bujqësi dhe një ushtri moderne. E që t'i bëjë këto, Kina e Hua Kuo Fenit dhe e Ten Hsiao Pinit ka hyrë në marrëveshje të plotë dhe të hapët, në radhë të parë, me imperializmin amerikan e me atë japonez dhe pastaj me të gjitha shtetet kapitaliste, që nga Anglia, Franca, Gjermania Perëndimore dhe të gjitha vendet e tjera të industrializuara, që janë të gatshme t'i japin asaj kredi.

Kina kapitaliste aktualisht i ka vënë vetes si detyrë që t'ia hapë dyert e saj kapitalit botëror nëpërmjet kredive të shumta që merr prej tij etj. Në fillim udhëheqja kineze thoshte se këto kredi nuk do t'i merrte në rrugë shtetërore, por gjoja në formë private dhe nga banka private, megjithëse dihet që të tilla banka në kohën tonë nuk ekzistojnë, por ekzistojnë kapitalet e mëdha financiare të çdo shteti, të ndërthurura dhe në rivalitet me njëri-tjetrin, që ndodhen nën kontrollin e trusteeve financiare dhe të bankave të mëdha, të cilat janë përfaqësuese të shteteve të tyre. Tash Kina u detyrua të deklarojë se këto kredi i pranon edhe nga shtetet kapitaliste e imperialiste, me përjashtim të Bashkimit Sovjetik. Kjo ka qenë prej kohësh dëshira e saj.

Pra, aktualisht në Kinë vërshojnë kapitalet e huaja. Deri tashti, nga sa dimë dhe nga sa po deklarojnë zyrtarisht agjencitë e ndryshme të lajmeve të botës kapitaliste, këto janë jo më një miliard, por me dhjetëra miliardë dollarë, franga franceze, franga zvicerane, sterlina etj.

Grupe të mëdha shkencëtarësh, ekonomistësh, politikanësh, ushtarakësh dhe me dhjetëra delegacione kineze kanë bredhur vitin e fundit në shumë vende kapitaliste për të studiuar dhe për të kontraktuar teknologji të re, armatime të reja, ndërtime kombinate të fuqishme metalurgjike, kimike dhe reaktorë atomikë. **Pra Kina e Hua Kuo Fenit, vazhduesja e Kinës së Mao Ce Dunit, po bëhet një superfuqi. Vetëm se kjo superfuqi e re që po ngrihet është nën kontrollin e imperializmit amerikan, të atij japonez dhe të Tregut të Përbashkët Evropian, të cilët do të bëjnë dhe po bëjnë ligjin në Kinë, do t'i diktojnë kësaj politikën e tyre dhe do ta ndihmojnë deri në atë shkallë që atyre do t'u leverdisë nga ana ekonomike.** Pra, do të shfrytëzojnë pasuritë e mëdha që ka Kina për t'i thithur gjakun popullit kinez dhe për të krijuar klasën e borgjezisë kapitaliste në këtë vend që të lidhet

ngushtë me borgjezinë e madhe kapitaliste të tyre dhe të bëhet një armë në duart e kapitalizmit ndërkombëtar, në luftë kundër socialimperializmit sovjetik.

Furnizuesit e teknologjisë moderne, pra, ata që kanë marrë përsipër fuqizimin e industrisë, të bujqësisë, të ushtrisë kineze etj., kanë të dhëna të shumta e të gjithanshme mbi Kinën. Këto të dhëna ata i bazojnë në gjithë ato studime që kanë bërë rreth saj, bile kanë institute të veçanta për këtë qëllim, ku studiohet historia e Kinës, karakteri i saj, karakteri i kinezit si individ dhe si popull. ndjenjat e aspiratat e tij, ngritja politike, ideologjike, intelektuale etj. Natyrisht, të gjitha këto të dhëna ata do t'i kenë kurdoherë parasysh në ndihmën që do t'i japin Kinës, që kjo të jetë gjithmonë në shërbim të kreditorëve e të investitorëve.

Megjithatë, mendoj se kjo nuk do të thotë që imperializmi amerikan, japonez, Tregu i Përbashkët Evropian etj. do të bëjnë me Kinën si të duan. Do të ketë edhe përkëdhelje, edhe shfrytëzim të egër nga ana e tyre, por do të ketë edhe kontradikta, të cilat, natyrisht, do të shtohen më vonë, atëherë kur kreditë që merr Kina do të bëjnë efekt, pra, kur të rritet potenciali i saj ushtarak, ekonomik, industrial e veçanërisht ai bujqësor.

Duke pasur parasysh karakteristikat e Kinës, të udhëheqjes së saj dhe karakterin e kinezëve, është e qartë se në të ardhmen megalomania e shtetit të madh nuk do ta pranojë zgjedhën ashtu siç duan partnerët e saj aktualë. Edhe këta nga ana e tyre nuk do të vazhdojnë ta ndihmojnë dhe ta financojnë Kinën ashtu siç do ajo vetë. Prandaj, më vonë, do të lindin fërkime, që do ta kenë burimin në qëndrimet politike kapitaliste të Kinës dhe të partnerëve të saj. Edhe ajo maskë e hollë që Kina mban duke u hequr se gjoja është një vend socialist, shpejt do të bjerë, në mos sot, me siguri nesër. Bile që tash mund të themi se kjo maskë është çjerrë në

treçerekët e saj dhe të gjithë e dinë e të gjithë thonë se Kina ka ndryshuar rrugë, ajo nuk është më socialiste, por kapitaliste. Dhe këtu nuk gabohen. Këtë nuk e fsheh edhe vetë udhëheqja kineze, e cila ka kohë që ecën në këtë rrugë.

Kjo udhëheqje tashmë i është nënshtruar fare hapur kapitalit të madh ndërkombëtar. Duhet thënë se në politikën e saj vihet re një agresivitet i madh fashist kundër Shqipërisë e Vietnamit. Për sa i përket qëndrimit ndaj Shqipërisë, këtë e kemi analizuar dhe po shohim se çdo ditë që kalon qëndrimi kinez po bëhet shumë i egër. **Ten Hsiao Pini, në një bisedë që ka pasur me gazetarë japonezë, ka thënë se ai ishte i mendimit që me Shqipërinë Kina duhej t'i kishte prerë marrëdhëniet me kohë, «por nuk më dëgjuan, u shfajësua Teni, më thanë të presim dhe ca». Kurse lidhur me Vietnamin, ai i deklaroi agjencisë japoneze të lajmeve Kioto se qeveria kineze do të ndihmojë një popull, i cili rrezikohet nga një popull tjetër.** Ai nuk përmendi emra, por kuptohet se është fjala për Kamboxhian që gjoja rrezikohet nga Vietnamit. Pastaj shtoi se «në rast se Kina nuk e ndihmon këtë popull (pra Kamboxhian), që sulmohet nga një popull tjetër, atëherë unë i bëj thirrje popullsisë kineze që jeton atje (pra në Vietnam), të ngrihet dhe ta rrëzojë këtë qeveri aktuale». Por Ten Hsiao Pini «harron» të shtojë çështjen tjetër: Në radhë të parë, ai që duhet të ngrihet është populli kinez, i cili të rrëzojë qeverinë fashiste që sundon në Kinë e që sulmon një popull tjetër, popullin vietnamez, sepse në fakt Kina e ka vetëm një pretekst çështjen e Kamboxhias. Ndaj Vietnamit heroik ajo mban një qëndrim të hapur agresiv. Çdo ditë avionët kinezë shkelin hapësirën ajrore të Vietnamit, me mijëra milicionerë dhe ushtarë me bajoneta e me pushkë në duar kapërcejnë kufirin, përleshën e vrasin vietnamezë. Lufta nuk është deklaruar, por kjo është një luftë e he-

shtur, e vazhdueshme dita-ditës. Nga ana tjetër, Kina ka vënë të gjitha forcat dhe po e ndihmon udhëheqjen fashiste kamboxhiane të kryejë veprime mizore të mëdha ndaj popullit të saj, por veçanërisht ndaj Vietnamit.

**Kina është bërë një shtet fashist dhe e nxit këtë luftë, për arsye se dëshiron të dominojë Vietnamin, Laosin, Kamboxhian, Tajlandën, Filipinet, Singaporin, Malajzinë, me një fjalë gjithë Azinë e jo vetëm atë. Siç e kam theksuar edhe në shkrime të tjera, ajo ka oreks të madh e nuk ngopet vetëm me Azinë, por kërkon të krijojë në Ballkan një aleancë të saj, pra të krijojë boshtin Kinë-Jugosllavi-Rumani.**

Udhëheqja kineze është një udhëheqje dinake, hipokrite, mendjemadhe, por jo e zgjuar. Ajo mendon se popujt e tjerë do t'u binden pikëpamjeve të saj jo vetëm të porealizueshme, por shumë herë pa baza dhe pa kurrfarë logjike. Ajo akoma nuk e ka kuptuar se ç'është titizmi, se sa dinak e ç'pehlivan është Titoja që luan në litar, që nuk i ha kollaj as planet, as propozimet e Hua Kuo Fenit. Ai e di mirë se nuk mund të hapë dot zjarr kundër Shqipërisë, sepse atëherë do të digjej e do të përvëlohej për veten e vet, por s'mund të hapë dot zjarr kurrë as edhe kundër Bashkimit Sovjetik revizionist.

Plani i kinezëve kalon edhe më larg. Ata në Evropë kanë ndërmarrë një politikë të gjerë nënshtrimi dhe varësie ndaj Tregut të Përbashkët Evropian, të cilit i buzëqeshin, nënshkruajnë me të kontrata të mëdha, me kredi të shumta dhe me kamata të rënda për Kinën, domethënë angazhojnë pavarësinë, lirinë dhe sovranitetin e Kinës, duke e bërë atë një vend të varur nga Perëndimi. Nga ana tjetër, Kina me vendet e tjera, ku nuk ka asnjë interes për të marrë kredi, si me Greqinë, me Turqinë etj., buzëqesh me atë buzëqeshjen e saj hipokrite, që nuk gënjen njeri.

Një politikë të tillë zhvillon Kina në Evropë, kurse

në Lindjen e Mesme, ku sundojnë Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Izraeli, Arabia Saudite dhe sovjetikët, ajo indirekt, nëpërmjet një vargu shtetesh arabe, luan rolin e tellallit. Më kujtohet nga koha e vogëlisë, kur dilte tellalli nëpër qytet e thërriste me sa zë që kishte, duke lajmëruar se të nesërmen duhej të mblidheshin njerëzit përpara bashkisë se do të bëhej, bie fjala, festë për Ditën e Flamurit. Pra Kina ku drejtpërdrejt, ku tërthorazi vëpron në vendet arabe për të mbështetur politikën amerikane dhe atë izraelite, duke u hequr njëkohësisht si mikeshja e popujve arabë, sidomos mikeshja e Iranit, e Emirateve të Gjirit Persik, duke u përpjekur të lidhë miqësi me Arabinë Saudite, me Irakun. Të gjitha këto i bën për të fituar kredi, në radhë të parë, që të krijojë njëfarë influence si një shtet gjoja në zhvillim, dhe që mund t'u lërë edhe këtyre vendeve fushë penetrimi në Kinë, por sidomos të krijojë një influencë të tillë, që këto vende të forcojnë lidhjet e tyre me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe të bëhen një barrierë kundër invadimit të mundshëm sovjetik. Në qoftë se kontradiktat arrijnë deri në atë shkallë sa sovjetikët ta shohin pisk, ata, duke e ditur se Lindja e Mesme është një nga pikat më të dobëta të imperializmit amerikan, mund të çajnë drejt Turqisë, Kaukazit, Irakut, Iranit dhe të dalin në Oqeanin Indian, duke prerë krejt rrugët e naftës. Në këtë rast preken drejtpërdrejt interesat e kapitalit amerikan, burimet e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të të gjitha shteteve kapitaliste të zhvilluara. Kjo do të bëjë që të dilet nga kuadri i luftërave lokale dhe të shpërthejë lufta botërore.

Kur Naseri kundërsulmoi Izraelin dhe kur Franca me Anglinë sulmuan Suezin, Ideni, kryeministër i Anglisë, i tha Hrushovit se ju, sovjetikët, nuk duhet të ndërhyni në Lindjen e Mesme, se atëherë do të ketë luftë botërore. Në fakt kjo zonë është një pikë shumë nevralgjike dhe

sovjetikët këtë e kanë si një atë. Se sa do të mundin ata t'ua prishin planet Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Izraelit dhe Egjiptit, këtë do ta shohim, por ata punojnë intensivisht në këtë drejtim dhe baza e tyre kryesore, dashur pa dashur, është Siria, por nuk mbeten pas as Algjeria e Libia.

Pra, në këtë pellg Kina sapo ka filluar të futë hundën, por hundën e ka shumë të shkurtër dhe popujt arabë janë zgjuar e i kuptojnë synimet e saj. Nga ana tjetër, udhëheqjet e këtyre vendeve, pavarësisht si janë, e dinë se fitimet e tyre nga Kina janë të pakta, kurse nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe nga Bashkimi Sovjetik janë të shumta dhe më konkrete. Tani Kina i bie vetëm trumbulekut dhe nuk dihet se sa do të rritet influenca e saj në të ardhmen në këto vende. Unë mendoj se kjo do të rritet në mënyrë shumë proporcionale dhe ky proporcionalitet do të vlerësohet me ndihmat ekonomike e ushtarake që Kina duhet t'u japë këtyre shteteve, por kjo do të bëhet kur ajo të krijojë mundësitë, sepse aktualisht akoma nuk i ka krijuar.

Mund të themi se e njëjta gjë ngjet edhe në Afrikë. Edhe këtu Kina po i bie daulles, sepse nuk gjen vend të lirë. Që të mund të infiltrohet, asaj i duhet të dëbojë dikë, në qoftë se e lënë të lirë ato fuqi të mëdha kapitaliste, të cilat me investimet e tyre edhe aktualisht e kanë në dorë këtë kontinent. Ato do ta lejojnë Kinën të bëjë disa investime të vogla pa prishur interesat e tyre, do ta lënë të bëjë propagandë sa të dojë kundër Bashkimit Sovjetik, të bëjë propagandë edhe për pseudosocializmin e saj, sepse kapitalistët e dinë mirë që s'është socializëm ai i Kinës, pra s'u prish punë, veç u ndreq. Për këtë arsye ata e mbrojnë Kinën dhe ideologjinë e saj gjoja socialiste, e mbrojnë Mao Ce Dunin dhe maocedunidenë, sepse e dinë mirë që si Kina dhe ideologjia e saj nuk kanë asgjë marksiste-leniniste, nuk janë për revolucio-

nin, por për kënetën, për batakun, për ruajtjen e kapitalizmit, të atyre formave kapitaliste që popujt të mos mundin dot kurrë t'i thyejnë zinxhirët e robërisë, të mos hidhen në revolucion, të mos fitojnë lirinë, pavarësinë dhe sovranitetin e vërtetë të tyre, të mos kenë asnjë mundësi të ndërtojnë jetën e denjë të lumtur e socialiste.

Prandaj, aktualisht, me këtë politikë në Afrikë, Kina, si me thënë, i ka këmbët në kënetë dhe hëpërhë s'i ngre dot nga llumi ku është futur. Ndërsa të tjerët që sundojnë në Afrikë janë «të motorizuar», kanë dollarë, kanë rubla, kanë klika, kanë aeroplanë etj., Kina akoma nuk i ka krijuar kushtet për të pasur nga këto, më vonë mund edhe t'i krijojë, po do të shohim se si do të zhvillohet situata më tej.

Sidoqoftë, udhëheqja aktuale fashiste kineze duhet të vërë rregull dhe disiplinë në shtëpinë e vet, sepse atje rregulli dhe disiplina janë zhdukur e mbretëron kaosi. Organizatës së partisë atje i ka mbetur vetëm emri; partia është ndarë, është bërë pjesë-pjesë, secili është pjesëtar i një grupi dhe çdo grup vepron sipas interesave të atyre zotërinjve që e udhëheqin. Këto grupe nuk përfaqësohen vetëm në parti, por edhe në qytete, edhe në provinca e në fshatra. Nga sa dëgjojmë e lexojmë, ka pakënaqësi të madhe për politikën e udhëheqjes kineze, veçanërisht nëpër fshatra, ku fshatarët i mashtrojnë duke u premtuar se gjoja do të zhvillohet bujqësia, por në fakt u është vënë kujdes kryesisht zhvillimit dhe modernizimit të ushtrisë e të industrisë, sidomos të industrisë së rëndë.

Udhëheqjes kineze i duhet të vendosë disiplinë të hekurt, të tipit fashist në punë dhe, brenda në shtet e në popull, i duhet të krijojë njëfarë «autoriteti» të së ashtuquajturës Parti Komuniste dhe të të ashtuquajturave parti demokratike, parti të borgjezisë që janë në bashkëpunim me atë komuniste, të cilat, siç jemi informuar,

kanë afishuar në të katër anët e Kinës portretet e Sun Jat Senit. Prandaj, ajo, formalisht, po shpejton të riorganizojë organizatën e gruas, organizatën e rinisë, bashkimet profesionale. Aktualisht këto janë organizata formale, por edhe kështu formale vlejné për demagogji e mashtrim, sepse ligjin në Kinë, natyrisht, e bën shkopi, e bën pushka, e bëjnë terrori e burgu dhe jo ideologjia. Atje ideologjia marksiste-leniniste nuk ekziston, por ekziston fashizmi dhe pikërisht kjo diktaturë krijoi «organizatën e gruas», zgjodhi pa bujë edhe udhëheqjen e saj. Nuk jam sa duhet në dijeni mbi ç'u tha e ç'u bë në këto mbledhje të mëdha dhe në fjalimet lumë të kongresit të rinisë etj., por u interesova pak se ç'probleme u shtruan në kongresin e bashkimeve profesionale dhe, meqë nuk pati të dhëna nga HSINHUA-ja, i kërkova ambasadorit tonë të më dërgonte një informatë mbi fjalimin e Ten Hsiao Pinit në këtë kongres dhe ai ma dërgoi.

Në datën 11, më duket, u çel kongresi i 9-të i bashkimeve profesionale të Kinës, ku bashkë me pjesëtarët e tjerë të Byrosë Politike merrte pjesë edhe Vu Tehu. Përshëndetjen në emër të Komitetit Qendror të Partisë dhe të qeverisë e mbajti Ten Hsiao Pini. Ja disa vërejtje rreth fjalimit të Tenit:

Në këtë fjalim nuk flitet gjëkund për rolin hegjemon të klasës punëtore në shtetin socialist, as për sindikatat si leva të partisë, por vetëm për «edukimin komunist të punëtorëve». Kjo, natyrisht, është vazhdimësia e vijës së përhershme të Mao Ce Dunit, sipas të cilit sindikatat nuk janë leva të partisë, as transmetuese të vijës së partisë në masat. Po kështu asgjëkund nuk flitet për marksizëm-leninizmin dhe arsyeja është e qartë. Atje ekziston maocedunideja. Por edhe emri i Mao Ce Dunit dhe teoria e tij vetëm një herë u përmendën.

Në planin ndërkombëtar Ten Hsiao Pini flet vetëm për «pavarësinë kombëtare», për «emancipimin» e klasës

punëtore, por aspak për revolucionin, për marrjen e pushtetit, për përparimin e njerëzimit. Marrjen e pushtetit nga ana e klasës punëtore ndërkombëtare revizionistët kinezë e kanë hedhur në kalendat greke.

Ten Hsiao Pini i quan të drejtë (pra rehabilitohen) kongresin e 6-të, të 7-të e të 8-të të bashkimeve profesionale të Kinës, që kanë qenë kryesisht revizioniste e ku mbizotërojnë vija e Liu Shao Çisë, pra edhe e Ten Hsiao Pinit. Me sa duket rehabilitimi i vijës së Liu Shao Çisë dhe i këtij vetë individualisht është vënë në rrugë.

Në qendër të të gjithë fjalimit të Ten Hsiao Pinit qëndrojnë, natyrisht, «katër modernizimet» dhe lufta kundër «katërshe». Në të gjithë fjalimin duken qartë fund e krye pikëpamjet krejtësisht revizioniste e kapitaliste, ekonomiste e teknokrate të Tenit dhe asgjë politike. «Katër modernizimet» Ten Hsiao Pini i quan një revolucion që do ta nxjerrë Kinën nga prapambetja, revolucion, i cili në shumë drejtime duhet të ndryshojë marrëdhëniet në prodhim, superstrukturën, formën e administrimit në ndërmarrje dhe administratën shtetërore gjithashtu etj. Të gjitha këto ide janë krejtësisht kapitaliste e revizioniste.

Ai parashtron çështjen e ndryshimit të sistemit shoqëror, bën thirrje për transformime të mëdha në fronte të ndryshme të ekonomisë, jo vetëm lidhur me teknikën, por edhe me sistemin e drejtimit e të organizimit dhe kërkon që sindikatat të ndihmojnë energjikisht në këtë drejtim, që punëtorët të kenë disiplinë, të pranojnë lehtë transformimet etj., etj. Me fjalë të tjera Ten Hsiao Pini kërkon që punëtorët t'u binden lehtë urdhrave të tij e të klikës së tij.

Teni kërkon që ndërmarrjet të respektojnë sistemin e përgjegjësisë nga drejtori apo administratori (kllakërit, siç i quan ai ala amerikançe), nën «udhëheqjen» e komiteteve të partisë. Natyrisht, ai kërkon nga ndërmarrjet

një sistem të fortë për drejtimin e prodhimit, udhëheqje administrative thellësisht të centralizuar dhe me pushtet të plotë në sistemin komandues të prodhimit. **Me një fjalë drejtori për Ten Hsiao Pinin është tiran absolut.**

Për demagogji revizioniste, punëtorëve, sipas këtij fjalimi, u njihet e drejta të zgjedhin shefat e reparteve, siç ndodh në vetadministrimin jugosllav me sistemin e të deleguarve. Teni thotë se sindikatat duhet të mbrojnë mirëqenien e punëtorëve, por thekson se kjo nuk do të arrihet shpejt. Do të duhet një kohë që përmirësimi i kushteve të punës, të jetesës, të higjienës dhe ndihma reciproke midis punëtorëve të vijnë në rrugën që gjoja dëshiron Teni.

**Fjalimi i Ten Hsiao Pinit është një platformë anti-marksiste, antiproletare, revizioniste borgjeze, që i klandis sindikatat në organizata fashiste, në levë të klasës borgjeze revizioniste në fuqi, për skllavërimin e klasës punëtore, kurse kuadrot sindikalë i kthen në xhandarë dhe në pjesëtarë të aristokracisë punëtore.** Ky kongres i bashkimeve profesionale nuk ka karakter marksist-leninist, as nuk bëhet për qëllime politike dhe ideologjike marksiste-leniniste, pra nuk bëhet për të vendosur hegjemoninë e klasës punëtore. Përkundrazi, në Kinë bashkimeve profesionale u imponohet një pikëpamje e huaj, një administrim i huaj, josocialist, dhe kërkohet prej tyre një punë me një disiplinë të fortë të pandërgjegjshme, të imponuar, disiplinë që synon ta bëjë Kinën një vend të fuqishëm socialimperialist. Që Kina të bëhet e tillë, punëtorët duhet të vuajnë, udhëheqja kineze të realizojë akumulim të madh në kurriz të punëtorëve siç po bën Japonia, për të modernizuar ushtrinë, teknologjinë dhe tok me shpenzimet e investimet e huaja, të krijojë mundësi të mëdha për të larë borxhet e shumta dhe për t'u shitur vendeve të së ashtuquajturës botë e tretë armët e vjetra, ashtu siç kanë bërë socialimperia-

listët sovjetikë. Pra, u shet të tjerëve vjetërsirat dhe ushtrinë e vet e pajis me armatim të ri modern.

Nga sa vihet re, e kohët e fundit kjo u duk edhe në kongresin e bashkimeve profesionale, ku Ten Hsiao Pini mbajti fjalim, në hierarkinë kineze po forcohet tendenca e Tenit për të qenë udhëheqës kryesor mbi Hua Kuo Fenin. Aktualisht ky e mban tufën, mundet më vonë ta përqendrojë fuqinë plotësisht në duart e veta, por është Ten Hsiao Pini ai që po jep direktiva të prera. Siç na njofton ambasadori ynë, që e ndoqi kongresin edhe në televizion, Teni duket shumë i shqetësuar, pavarësisht se në të gjitha postet po vë njerëzit e tij; kryetarin e Bashkisë së Pekinit e likuidoi, gjithashtu likuidoi komandantin e garnizonit të Pekinit dhe vuri një njeri të tijin etj. Sidoqoftë, në udhëheqjen kineze ekzistojnë rryma e grupe të ndryshme që janë në grindje me njëri-tjetrin dhe ndonjë mëngjes do të pëlcasë përsëri një pseudorevolucion, një përmbysje tjetër e rrufeshme.

**E SHTUNË  
21 TETOR 1978**

## **KINA DHE FUQITË E TJERA IMPERIALISTE**

Po konstatojmë se imperialistët e ndryshëm, dhe në radhë të parë imperializmi amerikan, socialimperializmi sovjetik, socialimperializmi kinez, militarizmi japonez dhe revanshizmi gjerman, janë në aktivitet të madh. Këto fuqi imperialiste janë duke konsoliduar pozitën e tyre strategjike, duke u vënë rëndësi armatimeve të sofistikuara, zhvillimit të ekonomisë dhe të teknologjisë, përgatitjes njëkohësisht të luftës me armë moderne si dhe përgatitjes së prapavijave të veta.

Prandaj ndërmjet tyre po zhvillohet një garë marrëveshje, ka filluar ndarja e zonave të influencës ose përcaktimi më konkretisht i zonave të influencës së këtyre imperializmave kryesorë dhe njëkohësisht rrëmbimi ose neutralizimi i njërës nga tjetri i disa zonave, siç janë: Afrika, Lindja e Mesme, Azia, Paqësori etj.

Konstatojmë, gjithashtu, se, në kundërshtim me pikëpamjen kineze, e cila është një pikëpamje e gënjeshtërt, kapitaliste dhe revizioniste, imperializmi amerikan është në sulm, kurse socialimperializmi sovjetik në rrethanat e krijuara më tepër po del në mbrojtje. Prandaj, në traktativat që thashë më lart, rolin kryesor në botë aktualisht e luan imperializmi amerikan, i cili dominon ekonomikisht dhe ushtarakisht. Po ashtu imperializmi amerikan përpiqet të ruajë aleancat e vjetra dhe të krijojë aleanca të reja të parrezikshme për të, në favor të tij dhe në disfavor të

socialimperializmit sovjetik ose të imperialistëve dhe militaristëve të tjerë që mund të kërcënojnë fuqinë imperialiste amerikane.

Në NATO, natyrisht, Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë një potencial dhe një influencë të madhe ushtarake, politike dhe ekonomike. Por ne shohim se me gjithë unitetin e saj, brendapërbrenda, kjo organizatë ka filluar të diferencohet nga pikëpamja e influencës së një shteti mbi të tjerët.

Republika Federale e Gjermanisë po forcohet çdo vit e më shumë në NATO. Forca e saj ekonomike e politike dhe tregtia që bën ajo me armë i kapërcejnë kufijtë e Tregut të Përbashkët Evropian dhe mund të themi se Gjermania Perëndimore po merr tiparet e një revanshizmi totalitar fashist që kërkon të krijojë zonat e veta të influencës. Kjo, natyrisht, nuk u vjen për hosh as Anglisë, as Francës, dy partnereve kryesore të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në NATO.

Veçanërisht me Kinën Republika Federale e Gjermanisë po zhvillon marrëdhënie shumë të afërta dhe lidhjet e saj me të zënë vendin kryesor për sa u përket vendeve kapitaliste të Evropës Perëndimore. Këto lidhje nuk ekzistojnë vetëm në fushën ekonomike, Gjermania Perëndimore është furnizuesja më e madhe dhe më e fuqishme e Kinës edhe në kredi, në teknologji e në armatime moderne të sofistikuara.

Anglia dhe Franca po ashtu kanë interesa në Kinë, prandaj po i zhvillojnë marrëdhëniet me të, mirëpo Kina, si fashiste që është dhe partnere besnike e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, ka interesa më të mëdhenj me Bonin. Kështu që Anglia dhe Franca shohin te Republika Federale e Gjermanisë një rrezik brenda në aleancë, pse Gjermania mund të dominojë akoma më shumë mbi partnerët e tjerë të aleancës. Prandaj konstatojmë se, qoftë qeveria angleze, qoftë ajo franceze, flasin për miqësinë

dhe për marrëdhëniet me Kinën, por nuk harrojnë të theksojnë se dëshirojnë të zhvillojnë më tej marrëdhëniet ekonomike dhe miqësore edhe me sovjetikët. Bile, haptazi dhe në kundërshtim me pikëpamjet kineze, flasin se në Evropë është larg lufta në mes Bashkimit Sovjetik dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, domethënë në mes Bashkimit Sovjetik dhe NATO-s. Me këtë ata duan t'i thonë Bashkimit Sovjetik se nuk kanë arsye të sulmojnë vende të Traktatit të Varshavës, përkundrazi, dëshirojnë të vazhdojnë miqësinë me to. Këtë e thotë edhe Boni, mirëpo ky po i zhvillon me shpejtësi marrëdhëniet me Kinën, e cila paraqitet si armikja kryesore e Bashkimit Sovjetik. Gjeneralët hitlerianë, revanshistët e vërtetë dhe më të fuqishëm të Bonit, afishohen haptazi si aleatë të fuqishëm të Kinës. Kështu Bashkimi Sovjetik e shikon Gjermaninë Federale jo njësoj si Francën dhe Anglinë. Nga ana tjetër, vetë Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në gjithë lojën e tyre strategjike, nuk i acarojnë lidhjet me Bashkimin Sovjetik. Ato vazhdojnë tratativat SALT me të, pavarësisht se Karteri deklaroi se do t'i prodhojë bombat me neutron. Megjithatë në mes Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Sovjetik duket një tendencë për ruajtjen e statukuosë.

Pra në këtë drejtim shohim që Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe NATO-ja përpiqen të ruajnë statukuonë me Bashkimin Sovjetik, natyrisht, duke pasur edhe kontradikta të herëpashershme me njëri-tjetrin, por këto kontradikta janë larg predikimeve kineze se lufta në Evropë është iminente.

Imperializmi amerikan në të njëjtën kohë e mbështet Kinën që të fuqizohet ushtarakisht dhe ekonomikisht. Me fjalë të tjera **kapitalet amerikane po vërshojnë në Kinë, ku bëhen investime të mëdha me kredi prej bankave të mëdha amerikane**, por dhe prej shtetit amerikan, pse aktualisht Kina merr kredi jo vetëm nga bankat, por njëko-

**hësisht merr kredi edhe nga shtetet dhe jo vetëm nga Japonia e Shtetet e Bashkuara të Amerikës, por nga të gjitha shtetet e mëdha kapitaliste të industrializuara.**

Aktualisht Shtetet e Bashkuara të Amerikës kartën e Kinës po e luajnë me kujdes, bile fort, ato vazhdojnë, gjithashtu, të luajnë kartën e tyre të strategjisë botërore me Japoninë. Shtetet e Bashkuara të Amerikës duan t'i kenë ujërat të qeta me Japoninë, ndihma ndërmjet tyre duhet të jetë reciproke. Japonia, sipas amerikanëve, duhet të forcohet dhe të bëhet një Izrael në Lindjen e Largme, në Pacifik dhe në Azinë Juglindore dhe pse jo, më vonë edhe kundër Kinës.

Në këtë situatë e nënshkroi Kina traktatin e miqësisë dhe të bashkëpunimit me Japoninë. Por ky traktat kino-japonez i miqësisë merr dhe do të marrë në të ardhmen përpjesëtime të mëdha të shumanshme, të rrezikshme dhe të shëmtuara për fatet e botës. Do të ndodhë kjo për arsye se në mes Japonisë dhe Kinës do të stabilizohet një unitet ekonomik-ushtarak që do të ketë synime për krijimin e sferave të influencës, të veçanta dhe të përbashkëta, sidomos në të gjithë Azinë, Australinë dhe në pellgun e Paqësorit. Ky unitet, natyrisht, do të fillojë nën hijën e aleancës me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe i propaganduar kundër socialimperializmit sovjetik. E vërteta është se kjo aleancë kino-japoneze ka për qëllim kryesor mbytjen e socialimperializmit sovjetik dhe likuidimin e tij nga Azia, nga Siberia, nga Mongolia dhe gjetkë, por edhe zhdukjen e influencës së tij në të gjithë Azinë dhe në Oqeani, në të gjitha vendet e ASEAN-it.

Kjo është strategjia e madhe e imperializmit amerikan, po njëkohësisht edhe e imperializmit kinez dhe e militarizmit japonez. Shtetet e Bashkuara të Amerikës do të përpiqen që ta ruajnë në favor të tyre balancën e fuqisë kineze dhe të asaj japoneze që po ngrihet, por një mëngjes kjo balancë amerikanëve do t'u shpëtojë nga duart.

Kështu uniteti imperialist militarist kino-japonez do të bëhet njëkohësisht rrezik edhe për vetë Shtetet e Bashkuara të Amerikës, edhe për Bashkimin Sovjetik, për arsye se interesat e të dy këtyre vendeve të mëdha imperialiste aziatike, Japonisë e Kinës, puqen për dominimin e kësaj sfere të madhe të influencës dhe për dobësimin njëkohësisht edhe të imperializmit amerikan, edhe të socialimperializmit sovjetik. Ne do të asistojmë kështu në një zhvillim relativisht të shpejtë të shumë ndryshimeve në këtë zonë.

Nëpërmjet miqësisë dhe aleancës japono-kineze çështja e Koresë mund edhe të zgjidhet, Veriu me Jugun e Koresë do të bashkohen, duke ruajtur gjithsecila palë regjimet që kanë dhe, pak nga pak, do të bëhet fuzioni i të dyja pjesëve në një Kore hibride, por në aleancë me strategjinë japoneze, kineze dhe amerikane.

Edhe Tajvani nuk do të jetë më problem. Kjo çështje do të zgjidhet «me dashamirësi» derisa aktualisht Shteteve të Bashkuara të Amerikës, që kanë si aleate në këtë zonë Kinën dhe Japoninë, nuk ka ç'u duhet Tajvani. Natyrisht, për Shtetet e Bashkuara Tajvani ka rëndësi të madhe, pse, sipas mendimit tim, kanë filluar shqetësimet e amerikanëve për një fuqi të re imperialisto-militariste japono-kineze në të ardhmen. Shtetet e Bashkuara të Amerikës patjetër që përpiqen e do të përpiqen t'i ndihmojnë Kinën dhe Japoninë dhe t'i mbajnë nën drejtimin e tyre, të forcojnë aleancën me to dhe t'i hedhin kundër Bashkimit Sovjetik. Kjo është njëra mundësi. Por ekziston edhe mundësia që të vijë një ditë që politika djallëzore, hipokrite, perandorake, pa parime dhe në frymë imperialisto-militariste e këtyre dy superfuqive që i ndihmoi të mëkëmbeshin, të dalë kundër SHBA-së, ashtu siç bëri dikur Gjermania e Vejmarit, e cila u bë një fuqi e tmerrshme fashiste dhe sulmoi aleatët e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe vetë ato në kohën e Hitlerit.

Edhe këto dy superfuqi që po krijohen në Azi, në unitet me njëra-tjetrën, i rrezikojnë Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ne do të asistojmë, gjithashtu, në shtimin e kontradiktave midis vendeve të ASEAN-it, si dhe në mes Japonisë e Kinës, së toku dhe të veçuara nga njëra-tjetra, në mes këtyre të dyjave dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, në mes këtyre të dyjave dhe Bashkimit Sovjetik.

India, që është një vend i madh, do të bëhet një bastion kundër rrezikut imperialist që ngrihet përballë dy superfuqive të tjera. Edhe ajo, duke u ndihmuar nga Bashkimi Sovjetik dhe nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, do të përpiqet të kthehet në një superfuqi me bomba atomike. India do të jetë një pikësynim i rëndësishëm strategjik me potencial të madh njerëzor, ushtarak dhe teknologjik, që do të forcohet në konkurrencën midis Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Sovjetik, pse që të dyja superfuqitë kanë interesa të veçantë dhe të përbashkët për një të ardhme në rrjedhën e ndryshimeve të aleancave që mund të ngjasin.

Aktualisht Kina nuk ka asnjë influencë në Indi, përkundrazi. Por ajo dëshiron që të fillojë të ketë marrëdhënie diplomatike disi më të mira. Nga ana tjetër pretendimet e Indisë ndaj Tibetit janë të mëdha. India do të luftojë që ta likuidojë edhe atë influencë të paktë që mund të ketë Kina në Pakistan, për arsye se Pakistani është, gjithashtu, një vend strategjik në krah të Iranit e të Afganistanit dhe këtu fillon interesimi për pellgun e madh të vajgurit të Lindjes së Mesme. Natyrisht, në Lindjen e Mesme dominon imperializmi amerikan, ndërsa Kina vetëm sa ka futur majën e gishtit, por si zor që të depërtojë atje. Ajo do të bëjë një politikë kundër interesave të popujve arabë dhe pro interesave amerikanë. Kinën njëkohësisht do ta ndihmojnë Shtetet e Bashkuara të Amerikës që tok me vende si Irani, Arabia Saudite etj., të bëhen një barrierë e fuqishme kundër një depërtimi

politiko-ekonomik dhe ushtarak sovjetik në këtë zonë jetike për imperializmin amerikan dhe për imperializmin evropian, pse edhe NATO-n dhe «Evropën e Bashkuar» ne mund t'i quajmë si një grupim të ri imperializmi në krijim e sipër, me gjithë kontradiktat e shumta brenda.

Si përfundim duhet të themi se aktualisht ekziston imperializmi amerikan, ekziston, gjithashtu, socialimperializmi sovjetik, por ekziston edhe «Evropa e Bashkuar» e lidhur në NATO me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Vendet e «Evropës së Bashkuar» kanë tendenca imperialiste jo të koncentruara, por të veçanta, dhe nga ana politiko-ushtarake, po ta lypë nevoja, sikurse edhe imperialistët e tjerë, mund të bëhen një rrezik botëror.

Nga ana tjetër shohim imperializmin kinez që po ngrihet, si dhe militarizmin japonez që është ngritur. Këta dy imperializma po lidhen në aleancë me njëri-tjetrin për të formuar një fuqi imperialiste në kundërshtim me të tjerët dhe pastaj, në të ardhmen, do të ngrihet edhe India, e cila do të ketë edhe ajo pretendimet e veta për zonat e influencës të të tjerëve, sidomos në Azi. Në këto kushte shtohet rreziku i madh i luftës botërore.

Aleancat aktuale ekzistojnë, por këto do të shkojnë duke u zhvilluar ose duke u dislokuar. Ato do të vijnë duke u dislokuar në kuptimin e ndryshimit të drejtimeve, por jo të brendisë së tyre. Fuqitë imperialiste që numërova më lart gjer në zhdukjen e tyre do të mbeten imperialiste dhe luftënxitëse dhe, në mos sot, nesër, ato do ta futin botën në një luftë të madhe atomike.

Kina socialimperialiste aktualisht lufton në shumë drejtime. Së pari në drejtimin e brendshëm për të krijuar një unitet fashist dhe për të siguruar dominimin e borgjezisë kapitaliste kineze mbi popullin kinez, domethënë për të krijuar në këtë vend atë unitet që nuk ekziston, por që përpiqet ta krijojë me kërbac, me shtypje. Këtij uniteti ajo do t'i japë një formë demokratike të gënjesht-

tërt, pasi të ketë unifikuar ushtrinë dhe prapavijat që t'i shërbejnë kësaj ushtrie invaduese dhe shtypëse.

**Taktika aktuale e imperialistëve është që ta gënjejnë njerëzimin përparimtar, të gënjejnë popujt dhe të përhapin frikën e një lufte të re të përgjakshme,** të shtypin çfarëdo rezistence popullore, çfarëdo lufte nacionalçlirimtare, me pretekstin se gjoja çdo akt revolucionar qenka një akt banditesk, qenka një akt terrorist që prish «paqen», «qetësinë» dhe del nga kuadri i demokracisë, natyrisht, i demokracisë borgjeze. Këtë teori të tyre ata e fuqizojnë edhe me veprime të nxitura dhe të organizuara nga qendrat e sigurimit të vendeve imperialiste, si: CIA, KGB-ja, sigurimi kinez, sigurimi japonez etj. Të gjitha këto pjella të kapitalit organizojnë banda terroristësh që vrasin, presin dhe u dalin përpara elementëve revolucionarë të popujve, marksistë-leninistëve për t'i diskredituar dhe për t'i goditur.

Të gjithë imperialistët, së toku dhe veç e veç, kanë gjetur format e ndryshme për të mbajtur nën zgjedhë, për të shtypur dhe për të diskredituar revolucionin, teorinë marksiste-leniniste të tij dhe veçanërisht leninizmin, që është teoria marksiste e vërtetë e në veprim në epokën e sotme të imperializmit në kalbëzim, në epokën e revolucioneve proletare.

Është e qartë për ne dhe për të gjithë popujt e botës se rruga e revolucionit nuk është e lehtë. Shumë forca regresive veprojnë kundër tij në botë. Këto forca në çdo vend kanë vënë maska, të jashtme, të brendshme dhe janë në unitet e në divergjencë me njëra-tjetrën. Janë në unitet për mbajtjen e popujve nën zgjedhën e kapitalit botëror e vendës, por janë edhe në divergjencë për nxjerrje fitimesh sa më shumë për vete nga djersa e popujve dhe nga huatë skllavëruese që më të fuqishmit u japin më të dobtëve.

E gjithë kjo strategji globale e imperializmit botëror

është e vërtetë që përbëhet nga fuqi të mëdha e me potencial të madh ekonomik-ushtarak dhe politik-demagogjik. Por ekziston edhe strategjia jonë e lavdishme e revolucionit, ekziston teoria e madhe e marksizëm-leninizmit. **Zjarri i revolucionit zien kudo në zemrat e popujve të shtypur që dëshirojnë të fitojnë lirinë, demokracinë, sovranitetin e vërtetë, të marrin fuqinë në duart e tyre dhe të shkojnë në rrugën e socializmit, duke shkatërruar fuqitë imperialiste dhe shërbëtorët e tyre vendës.**

Ne, marksistë-leninistët, që jemi në ballë të luftës revolucionare, e cila po zhvillohet sot në mes proletariatit e popujve të shtypur që aspirojnë për liri, nga njëra anë, dhe imperialistëve të egër e gllabërues, nga ana tjetër, duhet të kuptojmë mirë qëllimet, taktikat, mënyrat dhe format e luftës të armiqve tanë të përbashkët dhe të armiqve të veçantë të çdo vendi. Këtë gjë ne nuk mund ta shohim si duhet, në rast se nuk mbështetemi në teorinë tonë marksiste-leniniste të revolucionit, në qoftë se nuk shohim se, në situatat aktuale dhe në situatat e ardhshme që do të zhvillohen, ekzistojnë një sërë hallkash të dobëta të zinxhirit kapitalist botëror. Revolucionarët dhe popujt, veç e veç e njëkohësisht, duhet të zhvillojnë një veprim të pandërprerë, një luftë të organizuar, të paepur e të guximshme që të çahen hallkat e zinxhirit njëra pas tjetrës. Kjo, natyrisht, kërkon punë, luftë, sakrificë e vetëmohim. Popujt dhe njerëzit e guximshëm, të udhëhequr nga interesat e revolucionit, të shikuar këta në prizmin e teorisë sonë marksiste-leniniste që aspiron realizimin e dëshirave të popujve, mund dhe do t'u bëjnë ballë këtyre forcave të mëdha të imperializmit e të reaktionit që po ngrihen, që po lidhen me njëra-tjetrën në aleanca të reja, që po kërkojnë zgjidhje në këto situata të vështira që u krijohen. Situatat e vështira këtyre forcave regresive ua krijojnë popujt, ua krijojnë demaskimi që u bëjnë marksistë-leninistët teorive dhe veprimeve të

ndryshme imperialiste në të gjitha shtetet e botës dhe në të gjitha kontinentet në përgjithësi.

Prandaj veprimet dhe mendimet tona duhet t'i shfaqim haptazi, pa druajtje, me guxim dhe pa marrë parasysh sakrificat. Kështu ne kontribuojmë në atë luftë të madhe që duhet të zhvillojnë popujt kundër shtypësve të tyre kapitalisto-imperialistë, që ne në asnjë moment nuk duhet t'i lëmë të livadhisin sipas qejfit të tyre dhe të kurdisin plane e intriga në kurrizin e popujve të botës.

Revizionistët modernë sovjetikë, titistë, kinezë, eurokomunistë luajnë një rol makiavelik e të egër në ndihmë të imperializmit e të kapitalizmit botëror. Prandaj ne duhet t'i demaskojmë vazhdimisht, në çdo veprim të tyre. Asgjë nuk duhet të na duket e ekzagjeruar dhe të nisëmi nga parimi i gabuar meqë jemi një shtet dhe një parti e vogël, nuk duhet të flasim e të themi të vërtetën, sepse të tjerët do të na quajnë mendjemëdhenj! Me siguri që ata do të na quajnë mendjemëdhenj, sepse nuk u leverdisin e vërteta dhe drejtësia e mendimeve që shprehin Partia e Punës e Shqipërisë dhe shteti shqiptar. Ata kanë shumë shigjeta në kukurën e tyre për të na goditur, vetëm se ne kemi një mburojë shumë më të fortë kundër shigjetave të tyre të helmatisura dhe kjo mburojë jona është e do të jetë uniteti i Partisë, uniteti i popullit me Partinë, është e do të jetë marksizëm-leninizmi që na udhëheq vazhdimisht në luftën tonë titanike.

**E DIEL**  
**22 TETOR 1978**

## **NJË PAPË POLAK NË KRYE TË VATIKANIT**

Në Vatikan erdhi një papë i ri. Ky është me kombësi polake, ish-kardinal i Krakovisë, qendër e famshme e katolicizmit polonez. Siç dihet, kisha në Poloni ka një influencë jashtëzakonisht të madhe. Pas Italisë në çështjet e fesë vjen Polonia. Kardinalët polakë, me kardinal Vishinski në krye, u kanë bërë ballë të gjitha qeverive pseudokomuniste, pseudosocialiste të Polonisë, si të Gomulkës, të Ohabit, të Gierekut etj., etj., dhe kanë fituar privilegje të mëdha. Giereku kohët e fundit e ka liruar krejt dorën; Vishinski bën ligjin në Poloni. Shteti atje jo vetëm i ka lënë të lirë besimtarët të mbushin kishat e katedralet, por me shpenzimet e tij ndërton nga themeli kisha të reja në vend të sallave të kulturës.

Prandaj, ardhja në krye të Vatikanit e një pape të ri ka rëndësi të madhe jo vetëm për çështjen e fesë kristiane romake, por ka edhe një rëndësi të veçantë politike. Kardinali i ri, i cili mori emrin e papa Xhovan-Pavli i 2-të, do të bëjë një politikë ndërkombëtare kristiane romake. Është pas katër shekujsh që në Vatikan vjen në krye një papë jo italian dhe pikërisht një polak. Unë mendoj se ardhja e këtij pape në krye të kishës katolike romake është vepra e CIA-s, e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, e Brzezinski, këtij polaku që është aktualisht ndihmës i presidentit amerikan për sigurimin kombëtar.

Paraardhësin e tij, papa Xhovan-Pavli i parë, ish-kardinali i Venedikut, një muaj pasi u zgjodh nga konklavi, siç thuhet, «me unanimitet», një mëngjes e gjetën të vdekur në krevat dhe siç thanë «vdiq papandehur». Mundet që vdekja, ashtu si edhe zgjedhja e tij të mos ishin të zakonshme. Kjo mund të ishte një manovër e kurdisur mirë, pse ai që vdiq nuk ishte shumë i vjetër dhe as vuante nga zemra. Ndaj tij u përdor një taktikë që zgjedhja të dukej e rregullt, shumë e pëlqyeshme, pa kundërshtime, por pastaj i kënduan *De profundis*-in në mënyrë të fshehtë, për të sjellë në krye papën e ri polak, papën e caktuar nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, i cili me politikën e tij do t'i shërbejë, në radhë të parë, imperializmit amerikan. Ardhja e këtij pape të ri do të influencojë shumë, veçanërisht në të gjitha vendet e Evropës dhe të botës, sidomos për të mbështetur imperializmin dhe për të gënjyer proletariatin dhe popujt. Në Poloni kjo ngjarje do të ndikojë shumë, po kështu në Çekoslovaki, në Hungari, në Francë, ku borgjezisë i pëlqen që në krye të kishës romake të mos jetë një kardinal italian. Italianëve, nga ana tjetër, u ka rënë pika, sidomos demokristianëve dhe, në përgjithësi, gjithë borgjezisë së këtij vendi, të gjitha partive të ndryshme të borgjezisë italiane dhe katolikëve italianë, për arsye se papa nuk është më i tyre, një papë i kristianizmit, i kishës romake, por me nënshtetësi polake dhe që ka marrë dorë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Ne do të konstatojmë mjaft kontradikta me karakter ndërkombëtar kishtar pas kësaj që ndodhi në Vatikan. Që tani në fillim duket se shtypi italian flet shumë ftohtë për ceremonitë dhe reklamat nga ana e tij janë të pakta për papën polak, Vojtivën.

## VDIQ ANTISHQIPTARI I EGËR MIKOJAN

Morëm vesh nëpërmjet radios se revizionisti i madh sovjetik, Anastas Mikojani, vdiq. Ky njeri i poshtër ka qenë një menshevik i maskuar, një trockist, antimarksist, kundërrevolucionar, antileninist dhe antistalinist. Natyrisht i tillë ai nuk u bë menjëherë, por e mori këtë rrugë në vazhdimësi, me gjithë përpjekjet e Stalinit për ta korrigjuar. Mikojani nuk ka qenë vazhdimisht në Byronë Politike, kurse në Komitetin Qendror po, ai ka qenë edhe ministër i Tregtisë.

Mikojani ishte një dallaveraxhi i klasit të parë, një njeri që s'çante kokën për të ndihmuar vendet socialiste, një njeri që bashkë me Hrushovin allishveriset i kishte me imperialistët. Jo më kot Stalini u pat thënë: «Ju do ta shitni BS tek imperialistët». Vetë Mikojani na pat thënë në një takim, kur po na fliste për gabimet e Stalinit, se tok me Hrushovin kishin vendosur të bënin *pokushenie* kundër Stalinit, por nuk e bënë. Në fakt ka shumë të ngjarë që ata ta kenë vrarë fshehurazi, sepse nuk mund të shpjegohet si u gjend Stalini, gjithë ai Stalin i madh, i vdekur në vilën e tij, ku nuk kishte asnjë njeri, asnjë doktor, asnjë infermier, asnjë shërbyes, vetëm se një rojë jashtë.

Mikojani është bashkautor i veprës së poshtër të Hrushovit. Këta të dy filluan ta gërryejnë dhe ta rrëzoj-

në shtetin e proletariatit në Bashkimin Sovjetik, ata hodhën baltë mbi leninizmin dhe mbi Stalinin, e akuzuan këtë si kriminel dhe iu vunë punës për ndërtimin e kapitalizmit në Bashkimin Sovjetik.

Mikojani me Hrushovin janë ata që hapën rrugën e aleancës sovjeto-amerikane, që transformuan Partinë Komuniste Bolsheviqe në një parti antimarksiste, që shkaktërruan diktaturën e proletariatit dhe e sollën Bashkimin Sovjetik në gjendjen aktuale, duke e shndërruar në një fuqi imperialiste grabitqare.

Në marrëdhëniet me ne, me Shqipërinë socialiste, me Partinë e Punës të Shqipërisë, Anastas Mikojani ishte armiku më i egër, më i paturpshëm, *sfacciato*<sup>1</sup>, siç thotë italiani, prandaj me të ne jemi ndeshur vazhdimisht. Ai ka qenë një nga personat që ka penguar ndihmat për vendin tonë. Kritikën për ne ai e kishte në majë të gjuhës, çdo gjë që bënim ne, ishte e keqe për të. Ky ishte një nga ata që u përpoq të na bindte e të na gënjente të mos flitnim, kur ne ishim përgatitur për ta sulmuar Hrushovin, këtë vetë dhe shokët e tyre në Mbledhjen e 81 partive komuniste dhe punëtores të botës. Por ne ua hodhëm poshtë të gjitha orvatjet dhe i sulmuam e i demaskuam.

Hrushovi e mbante këtë matrapaz kurdoherë nga pas. Matrapaz njëri, matrapaz tjetri. Hileqar njëri, hileqar tjetri. Hrushovi Mikojanin e kishte, siç thotë francezi, *le fou du roi*<sup>2</sup>, elementin që e mbante në krah dhe bënte shaka me të. Çdo bisedim, qoftë edhe në formë serioze Hrushovi e fillonte me shaka me Mikojanin, me shaka pa kripë. Një ditë Hrushovi më kishte thënë se Stalini i kishte hequr veshin, sepse Mikojani ndiqte shërbëtoret.

1 Italisht — i pafytyrë.

2 Frëngjisht — bufon i mbretit.



dustriale, në energjetikë dhe ato ushtarake, janë e do të jenë të pakufishme. Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Sovjetik po vëzhgojnë me sy vigjilent zhvillimin e këtyre ngjarjeve.

Agjencitë e lajmeve njoftojnë këto ditë nga Pekini se nuk është e vërtetë që Liu Shao Çia ka vdekur, por është gjallë dhe së shpejti do të rehabilitohet. Ten Hsiao Pini dhe Hua Kuo Feni, me siguri, të gjallë ose të vdekur, do ta rehabilitojnë atë, dhe kështu Mao Ce Dunit i jepet një goditje tjetër, derisa të vijë dita që të flasin hapur për gabimet e tij, ose të heshtin e ta lënë të qetë në «paqen qiellore».

E ENJTE  
26 TETOR 1978

## ALEANCA KINO-JAPONEZE — ALEANCË IMPERIALISTE PËR DOMINIMIN E BOTËS

Po lexoj lajmet që agjencia HSINHUA jep nga Tokioja mbi vizitën dhe deklaratat e Ten Hsiao Pinit. Ato janë plot premtime për çelikosjen e unitetit midis imperializmit kinez dhe militarizmit japonez.

Në fjalimet që ka mbajtur përpara perandorit Hirohito, që, siç dihet, ka vrarë e ka grirë aq shumë popullin kinez, si dhe përpara kryeministrit Fukuda, Ten Hsiao Pini është treguar aq shumë dashamir, sa nuk mund të përshkruhet. Njëlloj si Fukuda ai deklaroi se miqësia midis Kinës dhe Japonisë është një miqësi e lashtë prej 20 shekujsh, pa përmendur asgjë se ç'kanë bërë, ç'kanë vrarë, ç'kanë grirë, brenda këtyre 20 shekujve njëri me tjetrin perandorët e Perandorisë së Mesit dhe të Diellit të Lindjes. Por pa u ngjitur në lashtësitë, u harrua lufta e madhe nacionalçlirimtare e popullit kinez kundër Japonisë dhe kundër Çan Kai Shisë. Ajo u zhduk, e fshiu Teni nëpër bankete, nëpër dollira dhe në konferencën e shtypit me gazetarët.

Ai u tha gazetarëve se kjo miqësi, që tani u kalit dhe u çelikos me Traktatin e miqësisë e të bashkëpunimit kino-japonez, është një realitet i madh, është një «rrymë e re» që ecën përpara, ta merr mendja, një rrymë me ngjyrë të verdhë dhe një «unitet» i dy superfuqive aziatike që po armatosen dhe po ndihmojnë njëra-tjetrën për të dominuar botën.

Ten Hsiao Pini tha se marrëdhëniet tregtare, ekonomike dhe teknologjike me Japoninë kanë marrë një hov të madh. Deri tani shkëmbimet arrijnë në 20 miliardë dollarë, por brenda një kohe të shkurtër ato do të trifishohen, do të arrijnë në 60 miliardë. «Ne, — tha Ten Hsiao Pini, — admirojmë zhvillimin e madh industrial të Japonisë dhe do të marrim shembull nga ajo për të ndërtuar industrinë tonë të re». Këtu, natyrisht, fjala është për shfrytëzimin nga Japonia të pasurive të mëdha të Kinës dhe ngritjen në këmbë nga Kina të një ushtrie të madhe moderne.

Ten Hsiao Pini në konferencën e shtypit me gazetarët e huaj foli edhe për Korenë dhe parashikoi që ajo të bashkohet në «interes të popullit korean». Si do të bëhet ky bashkim, atë do ta ujdisin tre kalanderët: Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Japonia dhe Kina. Ai tha se edhe Tajvani duhet të bashkohet me Kinën, gjithashtu disa zona të tjera duhet të bashkohen me Japoninë. Kaloi edhe në Evropë, por vetëm në Gjermani, duke thënë se duhet të bashkohen dy Gjermanitë. Të gjitha këto, sipas Tenit, do të bashkohen medoemos, në mos sot, sipas terminologjisë së Mao Ce Dunit, «pas një mijë vjetësh». Me këtë ai u përpoq të fshihte politikën imperialiste për pushtimin e botës nga Kina në bashkëpunim me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe me Japoninë.

Teni nuk mungoi të fliste edhe kundër Vietniamit. Ai foli edhe kundër hegjemonizmit por, për hatrin e Japonisë, këtë hegjemonizëm e mbyti me ca ujë të përzier me verë, sepse Japonia nuk është «shtet hegjemon» dhe gjoja nuk është kundër Bashkimit Sovjetik, megjithëse të dyja, Kina dhe Japonia, kanë një qëllim: pushtimin e Siberisë, e jo vetëm të kësaj.

## LIDHUR ME MARRËDHËNIET TONA ME KOSOVËN

Sot u shtrova sekretarëve të Komitetit Qendror të Partisë një problem që ka lidhje me çështjen e Kosovës, me të cilën aktualisht zhvillojmë marrëdhënie tregtare dhe kulturore.

Për sa u përket marrëdhënieve kulturore ne kemi ndihmuar duke dërguar atje tekste dhe profesorë në Universitetin e Prishtinës, kemi dërguar, gjithashtu, me aq sa na kanë lejuar titistët, grupe artistike, folklorike dhe materiale letrare, në të cilat, natyrisht, nuk bëhet fjalë për çështjet e Partisë. Mirëpo nga ana e Jugosllavisë shkëmbimet kulturore me krahinën e Kosovës pengohen shumë. Por ç'të bëjmë, do të pranojmë të zhvillohen këto marrëdhënie në atë masë sa ata na lejojnë, prandaj këto ne duhet t'i shfrytëzojmë mirë. Kjo është një detyrë patriotike dhe kulturore që na vihet përpara, por nga ana jonë çështja nuk duhet të kufizohet vetëm në këto lidhje.

Banorët shqiptarë të Kosovës, shqiptarët e Maqedonisë dhe ata të Malit të Zi, janë patriotë të flaktë dhe sytë i kanë drejtuar nga Shqipëria socialiste, nga Partia e Punës e Shqipërisë. Për këtë nuk ka asnjë diskutim. Shqiptarët që jetojnë në Jugosllavi ndjekin me interesim dhe shikojnë me etje të madhe televizionin tonë, saqë në shumë vende të Kosovës ku televizioni ynë nuk shikohet, ata që e dinë se shikohet më mirë në ndo-

një anë tjetër, sidomos kur ka ndonjë ngjarje të rëndësishme në Shqipëri, ngrihen dhe shkojnë për ta parë apostafat. Ata lexojnë me ëndë të madhe revistat dhe çdo material tjetër që mund t'u bjerë në dorë. Ata dëgjojnë, gjithashtu, emisionet e Radio Tiranës, të cilat, ashtu si edhe ato të Radio Kukësit, dëgjohen mirë, por i dëgjojnë me zell të papërshtatshëm. Ky është një ushqim i madh për shqiptarët që banojnë në Jugosllavi. Këtë ushqim ata e marrin me dëshirë të madhe dhe gjallërohen.

Por ne duhet të njohim që për Kosovën nuk kemi bërë shumë. Prandaj u propozova shokëve që të krijojmë një grup kuadrosh dhe të bisedohet shtruar me ta që televizioni, radioja dhe shtypi ynë, në periudha të caktuara duhet të organizojnë emisione e programe të posaçme.

Çfarë do të paraqesim në to? Të dhëna për historikun e popullit shqiptar të krahinave shqiptare në Jugosllavi, të flasim për zakonet e tij të mira, të bëjmë studime për folklorin, për këngët, për etnografinë, të transmetojmë muzikë të veçantë popullore kosovare, të vëmë njerëz të shkruajnë drama patriotike me heronj kosovarë, të vjetër dhe të rinj, të shkruajmë për heronjtë shqiptarë kosovarë të Luftës Nacionalçlirimtare, të japim fotografi karakteristike të qyteteve, të fshatrave, të arkitekturës shqiptare në Kosovë, në Maqedoni e në Mal të Zi e shumë e shumë çështje të tjera.

Ne, duhet, gjithashtu, të botojmë më dendur vjersha e prozë nga autorët e rinj kosovarë, të vëmë në skenë ato pjesë dramatike që janë të përshtatshme, të transmetohen pjesë siç u bë, për shembull, me simfoninë muzikore të Çesk Zadesë, që u dha në Prishtinë, ku për herë të parë, u thirr edhe autori i saj. Kjo simfoni duhet të ekzekutohet edhe nga orkestra jonë simfonike e ra-

diotelevizionit në një emision të veçantë e kështu me radhë për shumë gjëra të tjera.

Këto janë disa ide që lidhen me shumë probleme të tjera, që mendoj t'i diskutoj me shokët, natyrisht ca ditë më vonë, pasi të kemi mbaruar me zgjedhjet e deputetëve për në Kuvendin Popullor. Çështja e Kosovës është për ne një problem me rëndësi të madhe nga çdo pikëpamje, prandaj një sërë problemesh ne duhet t'i zgjidhim dhe t'i rregullojmë në rrugë të drejtë, qoftë në lidhje shtetërore me krahinën, natyrisht nëpërmjet Federatës Jugosllave, qoftë edhe brenda në vendin tonë për Kosovën, për shqiptarët e Maqedonisë dhe për ata të Malit të Zi në forma patriotike, pse ata janë pjesë e pandashme e kombit tonë.

Ne flasim, na vjen mirë kur flasim dhe duhet të flasim edhe për arbëreshët. Ja, edhe mbrëmë dëgjova një bisedë të nivelit të lartë të Eqrem Çabejt, që fliste në televizion për arbëreshët. Ai na e bëri shumë të qartë çdo problem të arbëreshëve, na foli për origjinën e tyre, për kohën e shpërnguljes në Itali, për zakonet e doket, për shkrimtarët e mëdhenj arbëreshë, për gjuhën, për këngët, për vallet e tyre etj., dhe kjo ishte një kënaqësi për ne. Kurse, është shumë keq që për Kosovën nuk shohim të organizohen aktivitete të tilla. Pse të mos organizohen të tilla gjëra edhe për shqiptarët që jetojnë në Jugosllavi?

Kemi ne rivendikime tokësore ndaj Italisë për çështjen e arbëreshëve? Jo, s'kemi. Edhe për Kosovën ne nuk e shtrojmë çështjen e rivendikimeve tona tokësore, po në pozitat e jugosllavëve nuk mund të biem. Për të tilla veprime ata do të na quajnë shovinistë ose nxitës të irredentizmit e të tjera profka, por neve aq na bën, ne ecim në rrugën tonë të drejtë marksiste-leniniste. Këtë rrugë marksiste-leniniste ndaj Kosovës, shqiptarëve të Maqedonisë dhe të Malit të Zi në këto fusha ne duhet

ta zhvillojmë në mënyrë të organizuar dhe me plan e jo t'ia lëmë spontaneitetit.

Në çështjen e historisë së Shqipërisë, kur vijmë në vitin 1913 mbyllet kapitulli për Kosovën. Po përse mbyllet ky kapitull? Ne duhet të tregojmë historikisht të vërtetën ç'ka ngjarë pas vitit 1913 për Kosovën, për shqiptarët e Maqedonisë dhe të Malit të Zi. Ne pa të drejtë i ruhem i kësaj çështjeje dhe s'e kemi menduar mirë. Kosovarët kanë nevojë të ndihmohen nga atdheu i tyre, pse jemi një komb, jemi një gjak, jemi vëllezër. Gjithë këto të mira që ka krijuar Partia e Punës në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë ne duhet t'ua bëjmë të njohura vëllezërve e motrave tona kosovare, duhet të dimë të vëmë mirë në dukje të gjitha virtytet e mira, të gjitha aspiratat e mira, këngët, vallet, njerëzit, luftëtarët dhe patriotët kosovarë. Këtë gjë ne duhet ta bëjmë dhe asgjë s'duhet të na ndalojë.

Do të kem rastin, u thashë shokëve, që për këtë çështje të bisedoj më gjatë me ju, me qëllim që ta vëmë më mirë nga sa e kemi vënë deri tash këtë ujë në zjarr.

**E MËRKURË  
1 NËNTOR 1978**

## **NË VEND TË KULTIT TË MAOS PO NGRIHET KULTI I TENIT**

Siç kam shkruar edhe më parë, Ten Hsiao Pini vajti në Japoni dhe jo «nga të katër rrugët», siç thotë një shprehje franceze, por u fut «drejt e në thela», domethënë hyri në çdo pikëpamje në një aleancë të ngushtë, ka mundësi edhe në një aleancë të fshehtë ushtarake, me Japoninë militariste. E pse jo? Një klauzolë e këtillë në traktat nuk shfaqet sheshit, por ajo mund të jetë e fshehtë. Kurse në të gjitha fushat e tjera marrëveshja është e hapur.

**Pavarësisht se Hua Kuo Feni është kryetar i partisë, aktualisht në Kinë dominon grupi i Ten Hsiao Pinit, që bën ligjin.** Ky synon që Kina, pa marrë parasysh asnjë opinion të brendshëm ose të jashtëm, të ecë me të shpejtë, pa zigzage, në rrugën e kapitalizmit, drejt kthimit të saj në një superfuqi imperialiste.

Në këtë drejtim ky monarkist i vjetër, ky element reaksionar dhe kundërrevolucionar, që e ka pranuar edhe vetë se është i tillë, bile e ka pohuar me gojën e vet në «autokritikën» që ka bërë përpara Mao Ce Dunit, tash po realizon ëndrrën e vjetër të tij dhe të reaksionit kinez.

Natyrisht, Japonia është për Kinën një model dhe ndihmëse e kualifikuar e me potencial të madh. Është e vërtetë se në këto dy drejtime Japonia vjen pas Shteteve të Bashkuara të Amerikës, që janë ndihmëset krye-

ta zhvillojmë në mënyrë të organizuar dhe me plan e jo t'ia lëmë spontaneitetit.

Në çështjen e historisë së Shqipërisë, kur vijmë në vitin 1913 mbyllet kapitulli për Kosovën. Po përse mbyllet ky kapitull? Ne duhet të tregojmë historikisht të vërtetën ç'ka ngjarë pas vitit 1913 për Kosovën, për shqiptarët e Maqedonisë dhe të Malit të Zi. Ne pa të drejtë i ruhem i kësaj çështjeje dhe s'e kemi menduar mirë. Kosovarët kanë nevojë të ndihmohen nga atdheu i tyre, pse jemi një komb, jemi një gjak, jemi vëllezër. Gjithë këto të mira që ka krijuar Partia e Punës në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë ne duhet t'ua bëjmë të njohura vëllezërve e motrave tona kosovare, duhet të dimë të vëmë mirë në dukje të gjitha virtytet e mira, të gjitha aspiratat e mira, këngët, vallet, njerëzit, luftëtarët dhe patriotët kosovarë. Këtë gjë ne duhet ta bëjmë dhe asgjë s'duhet të na ndalojë.

Do të kem rastin, u thashë shokëve, që për këtë çështje të bisedoj më gjatë me ju, me qëllim që ta vëmë më mirë nga sa e kemi vënë deri tash këtë ujë në zjarr.

E MËRKURË  
1 NËNTOR 1978

## NË VEND TË KULTIT TË MAOS PO NGRIHET KULTI I TENIT

Siç kam shkruar edhe më parë, Ten Hsiao Pini vajti në Japoni dhe jo «nga të katër rrugët», siç thotë një shprehje franceze, por u fut «drejt e në thela», domethënë hyri në çdo pikëpamje në një aleancë të ngushtë, ka mundësi edhe në një aleancë të fshehtë ushtarake, me Japoninë militariste. E pse jo? Një klauzolë e këtillë në traktat nuk shfaqet sheshit, por ajo mund të jetë e fshehtë. Kurse në të gjitha fushat e tjera marrëveshja është e hapur.

**Pavarësisht se Hua Kuo Feni është kryetar i partisë, aktualisht në Kinë dominon grupi i Ten Hsiao Pinit, që bën ligjin.** Ky synon që Kina, pa marrë parasysh asnjë opinion të brendshëm ose të jashtëm, të ecë me të shpejtë, pa zigzage, në rrugën e kapitalizmit, drejt kthimit të saj në një superfuqi imperialiste.

Në këtë drejtim ky monarkist i vjetër, ky element reaksionar dhe kundërrevolucionar, që e ka pranuar edhe vetë se është i tillë, bile e ka pohuar me gojën e vet në «autokritikën» që ka bërë përpara Mao Ce Dunit, tash po realizon ëndrrën e vjetër të tij dhe të reaksionit kinez.

Natyrisht, Japonia është për Kinën një model dhe ndihmëse e kualifikuar e me potencial të madh. Është e vërtetë se në këto dy drejtime Japonia vjen pas Shteteve të Bashkuara të Amerikës, që janë ndihmëset krye-

sore të Kinës kapitaliste, por duhet thënë se Japonia ka një avantazh në krahasim me partnerin amerikan, sepse është e një race me Kinën. Sot Gobinoja<sup>1</sup>, tezat e të cilit frymëzuan dhe udhëhoqën Hitlerin në politikën e tij të çmendur, nuk lihet mënjanë pa u lexuar edhe nga militaristët japonezë e nga Ten Hsiao Pinët me shokë, që sundojnë në Kinë.

Arsyeja tjetër është se Japonia, siç kam thënë dhe herë të tjera, ka një fuqi të madhe ekonomike, industriale, një teknologji të lartë në shumë degë dhe një fuqi punëtore që shfrytëzohet në kulm e paguhet shumë pak. Dhe kjo ndodh në një vend shumë të industrializuar e me një popullsi relativisht të madhe. Megjithatë, duke e krahasuar me popullsinë e Kinës, ajo e Japonisë është rreth sa një e teta e kësaj.

Duke e zbatuar shembullin japonez në Kinën me një popullsi të varfër, kaq të madhe, kapitalizmi kinez mund të bëjë «mrekullira» për veten e tij dhe t'i zhytë në mjerim klasën punëtore e fshatarësinë kineze. Pra, meqenëse janë edhe shumë afër njëri-tjetrit, të dy vendet do të afrohen aq tepër, sa do të puthen një mëngjes, siç u puthën Ten Hsiao Pini me Fukudën, kur nënshkruan marrëveshjen.

Kjo, natyrisht, është si puthja e Judës, por, për sa u përket kundërrevolucionit, rivendikimeve në Siberi, vendosjes së influencës së tyre në të gjithë oqeanin Paqësor e në të gjitha vendet e Azisë, për të mos kaluar më tej, kjo do të jetë puthje e sigurtë, sepse këtu synimet e të dy këtyre superfuqive janë të përbashkëta. Të dyja ato do të armatosen deri në dhëmbë. Japonia që tash është e armatosur. Ajo vërtet nuk e ka bombën ato-

<sup>1</sup> Diplomati dhe shkrimtar francez (1816-1882), autor i librit «Ese mbi pabarazinë e racave njerëzore». Teoria e tij ka qenë frymëzuese dhe udhëheqëse për teoricienët e racizmit gjerman.

mike, por mund ta prodhojë kur të dojë. Edhe për sa i përket teknologjisë së re të armatimeve, Japonia është shumë e pasur dhe ka një eksperiencë të madhe sidomos në ndërtimin e kryqëzorëve dhe të flotës detare luftarake, të aviacionit luftarak sulmues etj. Këtë rrugë dëshiron e do ta ndjekë edhe Kina me ndihmën e Japonisë dhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Agjencia amerikane e lajmeve Asosjeted Pres nga Najrobi (Kenia) njoftonte se zëvendëssekretari i mbrojtjes i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Çarls Dunkan, u zotua se vendi i tij mund ta mbështetë Kinën për t'u armatosur dhe se edhe Kenia mund të mbështetet po ashtu në sigurimin e mbrojtjes nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, natyrisht, kundër Tanzanisë, pse aktualisht Idi Amini i Ugandës është në konflikt të armatosur me të.

Rezultatet e vizitës së Ten Hsiao Pinit në Japoni u transmetuan me bujë ditën dhe natën nga Radiotelevizioni kinez. Gjatë gjithë kësaj kohe televizioni i Pekinit nuk jepte gjë tjetër veçse fytyrën e Ten Hsiao Pinit, të bashkëbiseduesve të tij, me Hirohiton në krye, perandorin gjakatar të popullit japonez e të popullit kinez. Mendoj se një propagandë e tillë ishte e imponuar nga klani i Ten Hsiao Pinit, por e padëshiruar nga klani i Hua Kuo Fenit.

**Hua Kuo Feni, më duket mua, filloi të humbasë terrin dhe bëhet çmos që mbi të të ngrihet figura e shkurtabiqit të verdhë dhe e teoricienit të «katër modernizimeve»,** nëpërmjet të cilave Kina do të ecë me shpejtësi në rrugën imperialiste. Jo se Hua Kuo Feni nuk dëshiron dhe nuk lufton që Kina të ecë në këtë rrugë, por, siç duket, në udhëheqjen e vendit klani i Ten Hsiao Pinit, klani ushtarak, është më i fuqishëm.

Para ca kohësh Vu Tehu dhe Çen Hsi Lienit u hoqën nga funksionet që kishin, njëri si kryetar i Bashkisë së

Peknit dhe tjetri si komandant i rajonit ushtarak të Pekinit. Tash ata mbetën në Byronë Politike; por në Kinë asnjëherë nuk kanë pasur rëndësi as Byroja Politike, as Komiteti Qendror, sepse forcën dhe drejtimin e partisë e kishin klanet jashtë këtyre dy organeve të larta të partisë.

Pra, ne shohim një dobësim të pozitive të Hua Kuo Fenit në Komitetin Qendror edhe pse, përveç atyre të dyve që përmenda më lart, në Byronë Politike qëndrojnë edhe Sajfudini e të tjerë, e megjithatë «s'kanë asnjë zë në kapitull». Kështu që **Ten Hsiao Pini po kthehet në një perandor të ri dhe në favor të tij në të njëjtën kohë, zhvillohet edhe një fushatë tjetër e re për degradimin dhe për rrëzimin e figurës e të emrit të Mao Ce Dunit.**

Natyrisht, udhëheqësit aktualë kinezë kanë gjetur një mënyrë të përshtatshme për ta likuiduar Mao Ce Dunin. Për këtë qëllim ata përdorin «Zhenminzhibao», që sigurisht është në duart e grupit të Ten Hsiao Pinit, nëpërmjet së cilës kritikojnë me bujë «katërshen», veçanërisht Lin Biaon, të cilët e konsideronin Maon si perëndi. Maoja, thotë gazeta «Zhenminzhibao», nuk ka qenë perëndi, por një njeri i thjeshtë, dhe, për ta argumentuar këtë, e ilustron me një fjalim të Çu En Lait të mbajtur, në qoftë se nuk gabohem, në vitin 1948 përpara studentëve, ku ka thënë se Mao Ce Duni ka qenë edhe mistik, edhe fetar, edhe besimtar dhe se, kur i vdiq nëna, falej përpara Budës.

Sot **udhëheqja aktuale e shtron çështjen se Lin Biaoja dhe «katërshja» e kishin ngritur Maon në perëndi, duke e konsideruar të pagabueshëm, me qëllim që ata, si mbështetja kryesore e kësaj perëndie, të dilnin në skenë se «edhe vetë ishin perëndi».** Kjo është e vërtetë. Edhe ne i kemi kritikuar ashpër këto veprime e këto metoda të Lin Biaos me shokë, që hiqeshin si marksistë. Ata jo vetëm nxorën librin e kuq me citatet e Maos dhe

ky libër përdorej si një talisman i shenjtë në dorën e çdo kinezi, por kërkonin t'ua impononin edhe të tjerëve një gjë të tillë. Bile Çu En Lai, kur erdhi këtu, te ne, më dhuroi edhe mua një libër citatesh me autografin e tij, që, natyrisht, e mora dhe e vura në raftin e librave. Ata arritën deri atje sa mbushën gjokset e njerëzve me pafka mbi të cilat ishte stampuar në metal të verdhë fytyra e Mao Ce Dunit e rrethuar me rreze, sikur të ishte një diell. Ushtarëve e oficerëve ua varnin këtë pafkë në gjoks dhe çdo mëngjes, para se të hanin bukë, të gjithë përulëshin përpara portretit të Maos, duke kënduar ndonjë nga citatet e tij. Këto veprime qesharake arritën deri atje sa që nëpër spitale mjekët, para se të bënin operacionet, lexonin citatet e Mao Ce Dunit, bile qarkullonin fjalë se edhe kanceri qenkej shëruar në Kinë nga një mjek, i cili lexonte me pasion citatet e kryetarit.

Kjo veprimtari ishte antimarksiste, ishte e poshtër, e mund t'i vësh çfarë emri të duash, bile i kalon edhe caqet e veprimtarisë së revizionistëve. Një metodë të tillë ne e dënuam në rrugën marksiste-leniniste, sepse kulti i Maos ishte bërë i tmerrshëm. **Në një moment, kur Kina ishte në rrezik, ne e përkrahëm Mao Ce Dunin, sepse mbeti i vetmi person që shpresonim se mund ta kthente timonin e revolucionit dhe të shkatërronte reaksionin që ishte ngritur për të rrëzuar socializmin në Kinë.** Por duhet thënë se fajin nuk e kishin vetëm Lin Biaoja dhe «katërshja», por edhe vetë Maoja, sepse ky fare mirë mund të merrte masa, bile drakoniane, kundër këtij kulti të shfrenuar antimarksist që i bëhej personit të tij. Duke pasur parasysh atë që thuhet, se në Kinë nuk mund të dilte asgjë pa firmën dhe pa urdhrin e Maos, ishte fare e mundshme që Maoja të gjitha këto marrëzira t'i pengonte. Por ai nuk e bënte këtë, për arsye se i pëlqente ngritja e personit të tij në një shkallë të tillë të marrë, pavarësisht se ç'thoshte në fjalimet e tij.

Tash Ten Hsiao Pini dhe grupi i tij marrin hakën kundër Mao Ce Dunit, duke luftuar kundër kultit të Maos jo në rrugë marksiste, por në rrugë antimarksiste. Kështu bëri edhe Brezhnjevi, që e kalli në dhe atin e tij ultra-revizionist, Hrushovin. Brezhnjevi predikoi kolegjalitetin, predikoi gjoja thjeshtësinë për vete të tij, por nuk kaloi shumë kohë dhe vetë u propagandua si një perëndi. Këtë gjë do ta bëjë me siguri edhe Ten Hsiao Pini, bile që tani ka filluar ta bëjë dhe kjo do të vejë kreshehdo. Një gjë e tillë atij i duhet, sikurse i duhej edhe Maos, për të forcuar pozitat e tij dhe ato të grupit të vet, që ta marrë mirë në dorë pushtetin në Kinë dhe të vendosë atje ligjin kapitalist.

Natyrisht, për ta neutralizuar disi këtë propagandë të shfrenuar që bëjnë radioja dhe televizioni kinez në favor të Tenit, siç njoftojnë agjencitë e ndryshme të lajmeve, u dha edhe një film për vizitën e Hua Kuo Fenit në Rumani. Ky është një veprim qesharak dhe kuptohet mirë pse bëhet, për të mos thënë se Hua Kuo Feni është lënë në një qoshe. Ten Hsiao Pini, pasi të qëndrojë një katër-pesë ditë në Tokio, kur të kthehet në Pekin do t'i japë llogari jo Hua Kuo Fenit, por grupit të tij për sukseset «e mëdha» që ka arritur në përgatitjen e robërimit të popullit kinez nga militarizmi japonez. Pas kësaj vizite ai do të ndërmarrë një udhëtim të ri në Tajlandë, Malajzi e Singapor, mundet edhe në Birmani e Pakistan, me fjalë të tjera në të gjitha vendet e Azisë Juglindore.

Përse e bën Ten Hsiao Pini këtë turne? Për të rforcuar pozitat e tij kapitaliste, për të konsoliduar pozitat e Kinës nëpërmjet emigracionit të madh kinez që ndodhet në këto vende, për t'i siguruar udhëheqësit e këtyre vendeve se Kina aktuale është kundër revolucionit, kundër partive marksiste-leniniste që janë në luftë me klikat në fuqi në këto vende. Ai vete atje për të lidhur aleanca, mundet të deklaruar, por edhe të fshehta, duke i sigu-

ruar udhëheqësit e këtyre vendeve se te Kina kanë mbështetjen e tyre kryesore. Prandaj në këto vende Kina nuk është konkurrente as e Japonisë, as e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Në mënyrë «vëllazërore» Ten Hsiao Pini do t'u thotë udhëheqësve të këtyre vendeve se mund të zhvillojnë tregti, mund të shkëmbejnë eksperiencë dhe të luftojnë kundër gjithë elementëve revolucionarë, kundër të gjitha atyre partive marksiste-leniniste të vërteta që u bien në qafë klikave në fuqi. Natyrisht, ky udhëtim i Ten Hsiao Pinit do të bëhet me një tamtam të madh në radion e në televizionin e Pekinit, do të ngrihet kulti i tij i ri e do të errësohet kulti i Hua Kuo Fenit, se kulti i Maos po e po. Kështu mund të vijë ajo ditë që një mëngjes Ten Hsiao Pini ta likuadojë Hua Kuo Fenin, për arsye se ky dikur e ka mbështetur «katërshen», e ka quajtur demonstratën e Tien An Menit një demonstratë reaksionare, ka luftuar tok me Vu Tehun dhe Ten Hsiao Pinit e ka quajtur revizionist. Ten Hsiao Pini që po merr fuqinë, nuk ia harron këtë Hua Kuo Fenit, edhe pse tani është i detyruar ta pranojë Huanë përkohësisht.

E tillë është gjendja në Kinë e me këtë gjendje habiten jo vetëm marksistë-leninistët, revolucionarët, demokratët e ndershëm, por edhe të gjitha shtetet kapitaliste, pse këto shohin që po ngrihen dy fuqi të mëdha në Azi, të cilat do t'i konkurrojnë, do t'u marrin tregjet dhe do të hyjnë në konflikt në mes tyre, në mos sot, nesër. I tillë është kapitalizmi: edhe të ndihmon të armatosesh, por bashkë me këtë «ndihmë» përgatit edhe rrezikun e luftës në mes shteteve që armatosen. Veç kjo është një luftë grabitqare që rëndon mbi popujt e botës, të cilët do të paguajnë haraç për këta kriminelë, prandaj duhen luftuar kriminelët, nxitësit e luftërave grabitqare, duhen luftuar ideologjia dhe veprimet e tyre. Një luftë të tillë konsekuente e të vendosur po bën e do ta bëjë deri në fund Partia jonë.

## DY TRAKTATE QË PËRGATITIN LUFTËN IMPERIALISTE

Sot në mëngjes dëgjova në radio se në Moskë u nënshkrua Traktati i miqësisë dhe i ndihmës reciproke në mes Bashkimit Sovjetik revizionist dhe Vietnamit. Disa ditë më parë kishin arritur atje Le Zuani, sekretari i përgjithshëm i Partisë Komuniste të Vietnamit dhe Fam Van Dongu, kryeministër. E merrnim me mend se kjo do të ngjiste; logjika e imperialistëve dhe e revizionistëve modernë do të çonte patjetër në një akt si ky.

Një gjë të tillë e filloi Kina imperialiste me nënshkrimin e traktatit me Japoninë. Aleanca kino-japoneze ka prapa shpine mbështetjen e imperializmit amerikan dhe është drejtuar në fakt kundër socialimperializmit sovjetik. Nga ana tjetër, siç kam shkruar edhe më parë, duhet të jetë vendosur në mes tyre edhe një aleancë e fshehtë ushtarake, sepse Ten Hsiao Pini dhe Fukuda nuk mungojnë të mbajnë fjalime dhe, në intervista të hapëta, të shfaqin pikëpamjet e tyre se duhet armatosur për t'u mbrojtur nga «dikush», natyrisht, nga Bashkimi Sovjetik. Ata thonë «për t'u mbrojtur» ose «për të mbrojtur paqen», por çështja nuk është ashtu. Logjika e imperialistëve dhe e revizionistëve është që ata të armatosen dhe të nënshkruajnë traktate ushtarake ose të maskuara me «ndihma» reciproke që s'janë tjetër veçse traktate agresive, traktate që përgatitin luftën.

Sidomos Kina i bën një propagandë të madhe Traktatit Kino-Japonez dhe e quan atë si një shpëtim për paqen, jo vetëm në gjithë botën, por veçanërisht në oqeanin Paqësor dhe në gjithë Azinë. Me fjalë të tjera, **Kina dhe Japonia janë bashkuar me Shtetet e Bashkuara të Amerikës për të pasur nën zap të gjithë popujt e Azisë dhe për të mos lejuar rrënjosjen e influencës sovjetike në Azi, vetëm pse këtu ekziston një Vietnam.**

Vietnami sapo doli nga lufta kundër imperializmit amerikan, mbi të cilin fitoi në sajë të trimërisë dhe të heroizmit të popullit. Aktualisht ai do të rindërtojë vendin e, natyrisht, kërkon ndihma. Në këto situata ne shohim se udhëheqja revizioniste, puçiste, fashiste e Kinës ka hapur një konflikt në mes saj dhe Vietnamit dhe molla e sherrit gjoja është bërë Kamboxhia.

Kamboxhia që ka në krye një klikë satelite të Kinës, pretendon se Vietnami kërkon ta gllabërojë, prandaj, e shtyrë nga Kina, ajo po godet Vietnamin. Ky, natyrisht, i kundërpërgjigjet. Ka mundësi që edhe vietnamezët të kenë pretendime të dënueshme ndaj Kamboxhies, por kryesorja është se konflikti në mes këtyre dy vendeve të Azisë Juglindore është provokuar nga Kina dhe tërthorazi nga Bashkimi Sovjetik. Kina jo vetëm që e ndihmon Kamboxhian ushtarakisht, ekonomikisht, por ishte ajo që e kurdisi edhe konfliktin e saj me Vietnamin dhe shkak për këtë u bë emigracioni i vjetër ekonomik kinez në Vietnam.

Në këto kushte vietnamezët i kthyen sytë nga Moskë dhe nënshkruan traktatin në fjalë.

Më parë se të nënshkruanin këtë traktat, vietnamezët kërkuan të ishin anëtarë të KNER-it dhe kjo u pranua, pra **Vietnami hyri në orbitën e socialimperializmit sovjetik ekonomikisht e ushtarakisht.** Prapa këtij traktati, që u nënshkrua nga vietnamezët e sovjetikët, duhet të jenë nënshkruar edhe traktate të tjera të fshehta, domethënë traktate ushtarake.

Pra ne, ashtu siç e kishim parashikuar, shohim që në Lindjen e Largme po ndërlikohen problemet në mes imperialistëve të ndryshëm, amerikanë, kinezë, japonezë, sovjetikë. Kërcënimet e hapëta kundër njëri-tjetrit do të shtohen, kontradiktat do të thellohen dhe do të çojnë edhe në luftë.

**Lufta ka mundësi që të bëhet në Azi, në vend që të bëhet në Evropë, siç pretendonin, dëshironin dhe propagandonin kinezët.** Por aktualisht kinezëve u janë ftohur, me nder, pordhët për sa i përket këtij problemi dhe thonë se kanë nevojë për paqe. Mirëpo paqja nuk vjen me veprime të tilla agresive, me traktate imperialiste, prapa të cilave fshihen qëllime grabitqare dhe sunduese mbi popujt.

**Të dy traktatet, ai kino-japonez dhe ai vietnamezo-sovjetik, janë të dënueshme nga ana jonë, për arsye se qëllimi i tyre është shpërthimi i luftës grabitqare ndër-imperialiste.** Vietnami u fut në këtë ingranazh imperialist të luftës e do të vazhdojë të bëhet viktima e super-fuqive. Nuk themi që Vietnami, me nder, të zbathte brekët përpara fashistëve kinezë, por duhej t'u rezistonte atyre deri në luftë të armatosur dhe të mos lidhej me një aleancë të tillë ushtarake me Bashkimin Sovjetik, sepse kështu, duke menduar se gjoja mbrohet nga një armik, ai mbështetet te një armik tjetër.

Si Kina edhe Bashkimi Sovjetik në realitet janë armiq të të gjithë popujve, edhe të popujve të Vietnamit, pavarësisht se Traktati Vietnamezo-Sovjetik duket sikur është një ndihmë që i jepet Vietnamit nga Bashkimi Sovjetik kundrejt kërcënimeve kineze.

Fashistët kinezë që janë në udhëheqje, traktatin e nënshkruar me Japoninë e propaganduan ditë e natë si një traktat që po i vë fre ekspansionit sovjetik në Azi. Në të njëjtën kohë Ten Hsiao Pini po bën turneun e dytë në vende të ndryshme të Azisë, për t'i bindur këto

që të bashkohen me Kinën dhe me Japoninë, natyrisht, edhe me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në këtë aleancë, në mos me shkrim, të heshtur, në mes tyre dhe Kinës, por ta pranojnë aleancën si «nevojë historike dhe jetike» për ta. Kjo do të thotë që të gjitha këto vende të Azisë, që nga Pakistani e deri tek Indonezia, të bëhen vegla të boshtit të fuqishëm kino-japono-amerikan që po lind në Azi.

Këtu synon propaganda që bëjnë Ten Hsiao Pini dhe Hua Kuo Feni për unitetin e vendeve të ASEAN-it, duke trumbetuar me të madhe se Bashkimi Sovjetik do të zhvillojë invazion politik-ekonomik, në mos ushtarak, në të gjitha këto vende.

Pra, nën maskën se gjoja po i dalin përpara këtij veprimi sovjetik, kinezët nga ana e tyre veprojnë intensivisht në këtë drejtim. Siç duket ata kanë marrë aprovimin e heshtur ose diplomatik të një vargu vendesh të Azisë për këtë gjoja miqësi me Kinën, kurse Vietnami nuk i është bindur diktatit të Pekinit dhe prandaj propaganda kineze ka si bosht, nga njëra anë, rrezikun sovjetik dhe, nga ana tjetër, kërcënimin, shqetësimin, provokacionet ndaj Vietnamit.

Duhet thënë se po atë gjë që bën Kina, e bën edhe Bashkimi Sovjetik, pra, të dy veprojnë në një rrugë. Në qoftë se popujt e Azisë nuk e kuptojnë këtë strategji imperialiste grabitqare, atëherë ata do të digjen në zjarrin e luftës «për mbretin e Prusisë», siç thotë një shprehje franceze, domethënë për interesat e Bashkimit Sovjetik dhe të Kinës. Duhet të ndjekim me kujdes zhvillimin e situatave, se këto me siguri do të ashpërsohen në Lindjen e Largme.

Do të asistojmë në një shkallëzim të provokacioneve në mes Kinës dhe Vietnamit, në mes Kamboxhias dhe Vietnamit, në mes Kinës dhe Bashkimit Sovjetik, pra, në të gjitha këto synime të imperialistëve.

Unë mendoj se Mao Ce Duni dhe Çu En Lai, siç e kam theksuar shumë herë, nuk kanë qenë marksistë. Ata janë arkitektët e një Kine të madhe kapitaliste, imperia-  
liste, janë arkitektë dhe zbatues të aleancës kino-ameri-  
kane, të cilën po e vazhdojnë udhëheqësit aktualë, që  
janë arkitektët e aleancës kino-japoneze të realizuar nga  
Hua Kuo Feni dhe Ten Hsiao Pini. Për sa i përket çështjes së Vietnamit, mendoj se Mao Ce Duni dhe Çu En  
Lai do të ishin kundër Bashkimit Sovjetik deri në një-  
farë situatë të favorshme për ta, por nuk ma merr men-  
dja që, po të ishin gjallë këta, do ta provokonin Vietna-  
min, siç po e provokojnë pasardhësit e tyre fashistë në  
udhëheqjen aktuale të Kinës.

Jam i bindur se Kina, në rast se do të rronin Mao  
Ce Duni dhe Çu En Lai, do ta mbronte Kamboxhian e  
do t'i jepte ndihma të shumanshme e të shumëllojshme  
ekonomike për ndërtimin e vendit dhe ndihma ushtarake  
për ndërtimin e një ushtrie moderne, por jo në këto  
forma e me këto mënyra siç po e ndihmon aktualisht,  
për qëllimet e veta ekspansioniste, regjimi fashist ak-  
tual i Pekinit.

Është tragjike kur sheh se një udhëheqje revizio-  
niste, kapitaliste, fashiste e çon popullin në varfëri, e  
shtyp, i zhduk të gjitha liritë demokratike, e varfëron, e  
mjel si lopën. Kjo tregon se sa rëndësi ka çështja e udhë-  
heqjes, që kjo udhëheqje të ketë dalë nga gjiri i popullit,  
të frymëzohet nga ideologjia e proletariatit, të jetë e  
lidhur me popullin e me proletariatin dhe të sakrifiko-  
het për ta. Historia vërteton se e kundërta është kata-  
strofë.

**Vetëm populli, që natyrisht është gjithçka, është në  
gjendje ta rrëzojë e ta shkatërrojë një udhëheqje të tillë  
fashiste, revizioniste, kapitaliste dhe gjithë makinën shty-  
pëse të saj.** Por, që ta realizojë një gjë të tillë, populli  
duhet të jetë i përgatitur politikisht dhe të jenë plotë-

suar kushtet revolucionare, në radhë të parë duhet të  
jetë krijuar ajo parti e vërtetë që do t'i udhëheqë masat  
në revolucion dhe në përmbysjen e qeverisë fashiste.

Për fat të keq shohim se në Bashkimin Sovjetik,  
populli, proletariati, megjithëse kanë njohur dhe kanë  
jetuar në pushtetin e proletariatit, të udhëhequr nga  
Partia Bolshevike e Lenin-Stalinit aktualisht nuk bëj-  
në zë e u nënshtrohen zgjedhës dhe demagogjisë së udhë-  
heqjes revizioniste. Kështu ndodh edhe në Kinë. Sido që  
atje nuk ndërtohet socializmi, disa forma ekzistonin, një-  
farë lirie, si me thënë, ekzistonte, kurse aktualisht ky  
popull shtypet dhe nuk bën përpjekje të ngrejë zërin e  
dorën kundër padrejtësive që i bëhen dhe kundër rrugës  
imperialiste drejt së cilës po ecën vendi i tij. Pra ky fe-  
nomen konstatohet si në Bashkimin Sovjetik ashtu dhe  
në Kinë.

Këto ngjarje janë një mësim i madh për popujt,  
mbasi tregojnë se si duhet shkuar në revolucion, si du-  
het krijuar një udhëheqje revolucionare, të cilën prole-  
tariati dhe populli duhet ta mbajnë nën kontroll e në  
vigjilencë revolucionare e të mos lejojnë që kjo të de-  
gjenerojë. Çështja qëndron këtu: Proletariati vërtet du-  
het të mësojë nga partia e tij, por duhet të mësojë prej  
saj kur kjo është në rrugën e drejtë marksiste-leniniste  
dhe i interpreton si duhet, në dritën e marksizëm-leni-  
nizmit, ndodhitë, ngjarjet e vendit të vet.

Kjo arrihet në rast se proletariati, populli dhe kua-  
drot, kur edukohen, qoftë teorikisht, qoftë në zbatimin e  
planeve në praktikë, duhet të mos neglizhojnë kurrë për  
të parë me vigjilencë drejtësinë e fjalës e të veprimit.  
Pra, secili duhet t'i bëjë pyetjen vetes: Është e drejtë  
kjo që bëjmë apo është e gabuar? Dhe kur ka gabime,  
të bëhet ç'është e mundur që ato të ndreqen. Kur shi-  
het në udhëheqje, dhe jo vetëm në udhëheqjen kryesore,  
por që nga qendra e deri në bazë, ndonjë që nuk vepron

drejt, që nuk i gjykon ngjarjet në prizmin e marksizëm-leninizmit, që shkel normat marksiste-leniniste, që shkel vijën e drejtë të Partisë, njerëzit duhet të mobilizohen e, si të thuash, të përveshin llërët, të marrin sapunin e «t'ia lajnë kokën» mirë atij që gabon. Në qoftë se nuk bëhet një gjë e tillë, atëherë ndodh ajo që ka ndodhur në Bashkimin Sovjetik, në Kinë, në Kore dhe në të gjitha vendet e tjera që tradhtuan marksizëm-leninizmin e socializmin.

U bënë shumë ditë dhe nuk dihet se kur do të mbarojë «shëtitja» e Ten Hsiao Pinit nëpër Tajlandë, Malajzi, Singapor e në vende të tjera të Azisë Juglindore. Ai bën «la tournée des grands-ducs» dhe në këtë turne kurdis komplete për rritjen e influencës së Kinës në këto vende, me fjalë të tjera për t'u imponuar atyre politikën kineze. Se sa do t'ia arrijë qëllimit zoti Ten Hsiao Pin, ky është një problem tjetër, por kryesorja është se, edhe në qoftë se nuk ua imponon dot këtyre vendeve politikën e Kinës, ai do t'i frikësojë duke i kërcënuar që, në rast afrimi me Bashkimin Sovjetik, mund të pësojnë rreziqe të paparashikuara.

**E PREMTE**  
**10 NENTOR 1978**  
**KINA DHE BASHKIMI SOVJETIK JANË ARMIQ**  
**TË POPULLIT VIETNAMEZ**

Ai kudo pritet me pompë. Ndoqa në televizion vajtjen e tij në Tajlandë. E priti kryeministri, i cili i varilule e kordona. Teni kaloi në revistë rojën e nderit të Tajlandës, mbajti fjalime të zjarrta mbi një «miqësi shekullore» midis dy vendeve etj. Pastaj u prit nga mbretëresha. Vajti edhe në pagodën budiste, ku zhveshi këpucët dhe asistoi në pagëzimin e djalit të mbretit. Me pak fjalë, shkurtabiqi i verdhë budist, antimarksist, monarkist, ishte i lumtur që asistoi në tempullin e Budës në këtë ceremoni fetare tok me mbretin dhe me mbretëreshën e Tajlandës.

Sigurisht, komunikata që u dha me këtë rast, nuk

i përngjet komunikatës së dhënë pas nënshkrimit të Traktatit Kino-Japonez, por edhe në këtë bëhet fjalë për sigurimin e miqësisë, për bashkëpunimin e ngushtë në mes të dy vendeve. Tash Ten Hsiao Pini po ecën drejt Malajzisë e Singaporit. Nuk dihet nëse do të vejë edhe në vende të tjera, si në Filipine e gjatë, se në Kamboxhia ka shkuar një nënkryeministër tjetër, i cili që andej po i bën kërcënime Vietnamit. Pra, kërcënime nga Kamboxhia e kërcënime nga kufiri kinez.

Natyrisht, këto bëhen pas nënshkrimit të Traktatit Vietnamezo-Sovjetik, traktat të cilin ne e dënojmë. Vietnami ka gabuar, duke u futur në lojën imperialiste të sovjetikëve dhe të kinezëve. Në një konflagracion ai do të sakrifikohet dhe do të bëhet mish për top për social-imperializmin sovjetik, i cili gjoja do të përpiqet për mbrojtjen e Vietnamit, kur dihet nga të gjithë se ky luftoi heroikisht kundër një fuqie të madhe imperialiste, Shteteve të Bashkuara të Amerikës, rezistoi me vite të tëra dhe fitoi mbi të. Atëherë ai nuk lidhi aleancë me Bashkimin Sovjetik ose me Kinën, megjithëse ndihma prej tyre mori. Por ndihmë materiale e morale ai mori nga gjithë bota, e cila do të qe e gatshme ta ndihmonte përsëri Vietnamin, në rast se ky do të sulmohej nga Kina. Edhe pa e pasur traktatin, ndihmën e Bashkimit Sovjetik ai do ta kishte, kurse aktualisht Vietnami hyri në orbitën e socialimperializmit sovjetik, duke i dhënë kështu një armë në dorë Kinës. Tash kjo thotë se Vietnami është bërë Kuba e Bashkimit Sovjetik në Azi, siç është bërë Kuba mercenari i Bashkimit Sovjetik në Afrikë.

I thashë shokut Ramiz që të përgatitim një artikull, ku të dënojmë intrigat, kërcënimet, shantazhet dhe provokacionet që i bën Kina Vietnamit. Në këtë artikull të theksojmë edhe një herë se mosmarrëveshjet në mes Vietnamit dhe Kamboxhias duheshin zgjidhur pa ndër-

hyrjen e Kinës, por njëkohësisht të themi se ne mendojmë që marrëveshja vietnamezo-sovjetike nuk duhej nënshkruar, për arsyet që thashë më lart. Pra, në artikull të goditen qëllimet e Kinës dhe të Bashkimit Sovjetik, por edhe Vietnamit t'i thuhet mendimi ynë, natyrisht më butë, jo siç do të shprehemi në adresë të Kinës e të Bashkimit Sovjetik, sepse këta janë shkaktarët që Vietnamit i lejoi vetes të bënte këtë gabim.

## **SHËNIM**

Sot rishikova kapitujt e parë të librit «Imperializmi dhe revolucioni», të cilin po e përgatitim për ta rishtypur për botimin e dytë më të kompletuar. Besoj se ai do t'u shërbejë Partisë sonë dhe shokëve marksistë-leninistë jashtë vendit.

## **ARBËRESHËT NË ITALI RUAJNË ME NGULM TRADITAT DHE ZAKONET E ORIGJINËS SË TYRE**

Mbrëmë pashë në televizionin italian një shfaqje të Ansambllit tonë Shtetëror të Këngëve dhe të Valleve Popullore në fshatrat e ndryshme arbëreshe të Italisë. Ishin shumë simpatike edhe paraqitja televizive, edhe komentet që u bënë. Të binte në sy dashuria e madhe e popullit arbëresh për vëllezërit dhe për motrat e tyre, — siç thoshin ata, — të ardhur nga atdheu i tyre i lirë. Arbëreshët kishin veshur kostumet e tyre kombëtare dhe këndonin shqip. Ata kishin futur në mes të tyre artistët tanë dhe ecnin së bashku nëpër rrugët e fshatit për të shkuar në vendin ku u inaugurua busti i De Radës i mbuluar me flamurin kombëtar shqiptar dhe në një vend tjetër busti i Skënderbeut, i Odise Paskalit, i mbuluar edhe ky me flamur kombëtar. U hodhën valle, u mbajtën fjali-me nga kryetarët e bashkive. Njëri prej këtyre tha se kishin kërkuar nga qeveria italiane për të marrë vendim që gjuha shqipe të vihet zyrtarisht në shkollat fillore të arbëreshëve, sepse duan të ruajnë gjuhën dhe zakonet e popullit tonë.

Një diçka shumë karakteristike ishte kur një korrespondent i televizionit i vuri mikrofonin përpara një vajze arbëreshe kalabreze dhe e pyeti nëse ishte zonjushe apo e martuar. Ajo iu përgjigj se ishte zonjushe. Po me kë dë-

shiron të martohesh, — vazhdoi ta pyeste korrespondenti, — me italian apo me shqiptar?

Me shqiptar do të martohem, — ia ktheu vajza arbëreshe, — me një shqiptar nga fshati im.

Po ju ç'gjuhë flitni, — iu drejtua korrespondenti?

Nuk e shikon, — ia priti ajo, — unë me ju flas italisht, kurse në shtëpinë time dhe me fshatarët tanë ne flasim gjuhën shqipe, arbëreshe, të cilën e kemi ruajtur gjatë shekujve.

Ky ishte një episod shumë i bukur. Të marrin mend udhëheqësit kosovarë për politikën e poshtër të titizmit, që ndjekin, që është e njëjlojtë me politikën e kralëve serbë, saqë kur venë në Kosovë ansamblet tona, në shfaqje ata lejojnë vetëm njerëzit raja të udhëheqjes federative titiste dhe të tradhtarëve që sundojnë në Kosovë. Megjithatë populli kosovar e ka të zjarrtë dashurinë e madhe që ushqen për atdheun e tij, për Shqipërinë socialiste dhe i urren titizmin, serbomëdhenjtë dhe të tjerë shtypës e skllavërues të tij.

**E PREMTE**

**17 NENTOR 1978**

## **KAPITALIZMI NË KINË PO REND ME GALOP**

Duke ndjekur politikën aktuale të Kinës, ne bëjmë këto konstatime:

Brenda, siç po duket, nuk ka stabilitet. Në mes grupeve kryesore, që udhëheqin sot, atij të Hua Kuo Fenit dhe të Ten Hsiao Pinit, ekzistojnë kontradikta të thella, të cilat krerët po përpiqen t'i qepin me pe të bardhë. Përveç këtyre, ekzistojnë, gjithashtu, trazira politike, ideologjike dhe kundërshtime. Këto vijnë nga shtresa të ndryshme, që nga studentët, profesorët deri te punëtorët e fshatarët.

Për Mao Ce Dunin flitet, por jo me atë forcë si më përpara, për arsye se banda e Ten Hsiao Pinit ka marrë përsipër që, emrin dhe veprën e tij, në mos t'i likuidojë fare, t'i zbresë në një shkallë shumë të ulët. Për Tenin ka ardhur koha e hakmarrjes. Ten Hsiao Pini me shokë, që Mao Ce Duni i luftoi dhe i goditi si revizionistë e tradhtarë, tani janë në fuqi dhe pushteti i tyre është i madh, prandaj po punojnë që çdo gjë e bërë nga Maoja të likuidohet dhe të zëvendësohet me të tyret.

Në këtë mes Hua Kuo Feni përpriqet të mbajë deri në njëfarë shkalle flamurin e Mao Ce Dunit, domethënë të grumbullojë rreth vetes ata elementë që bënë puçin, por që janë në kundërshtim me veprimet dhe me politikën drakoniane kapitaliste të hapët të Ten Hsiao Pinit dhe i rezistojnë kësaj politike. I rezistojnë jo pse janë

kundër, por se dëshirojnë të jenë ata në krye të këtij zhvillimi të ri kapitalist të Kinës.

Ekzistojnë, pra, ambicie subjektiviste, ambicie grupi, të cilat reflektohen si brenda ashtu edhe në arenën ndërkombëtare.

Një gjendje e tillë, sipas informatave që kemi, brenda në Kinë ka shkaktuar çrregullime të mëdha në ekonomi dhe sidomos në bujqësi e në furnizimin e popullit, ku situata është e vajtueshme. Në kohën e Çu En Lait, kishte më rregull dhe një furnizim më të mirë të tregut, kurse tash furnizimi është i keq dhe, natyrisht, ka ankesa, kritika dhe pakënaqësi që shfaqen haptazi.

Përveç kësaj në Kinë shihet zhvillimi galopant i një degjenerimi moral. Kanë filluar të hapen klubet e natës, të organizohen ballo etj. Vajzat kineze, që ishin aq rigorozë dhe që vetë Çu En Lai kritikoi një aviator shqiptar pse doli shëtitje me një vajzë kineze, tani vishen ala evropiançe dhe venë e kërcejnë nëpër klubet e natës. Kërcimet janë një gjë e zakonshme, kurse në Kinë këto po marrin rrugën e kërcimeve dekadente e korruptuese evropianoperëndimore. Në Pekin dhe në qytetet e tjera kryesore, si në Shangai, në Kanton (Guangzhou), në Nankin jeta e degjeneruar amerikane dhe e Evropës Perëndimore po zhvillohet me shpejtësi të madhe. Kjo jetë e degjeneruar, drogat, krimet, vjedhjet, polarizimi i popullsisë dhe etja e gjithsecilit për përfitime personale nga pasuria shtetërore ose nga grabitjet, po përhapen në masë. Thonë se në rrugët kryesore të Pekinit është e rrezikshme të dalësh natën.

Në Kinë i është dhënë rëndësi e madhe stimulit material, i cili stimulon, si me thënë, borgjezinë e re, por jo punëtorët. Ky stimul po zhvillohet për të transformuar infrastrukturën. Vetadministrimi jugosllav po propagandohet me bujë nga vetë Hua Kuo Feni. Në Sinkiang, për shembull, ai rekomandoi të ndërtohen ferma industriale

bujqësore si ato të Beogradit, pra, nën shembullin e fermave kapitaliste jugosllave, e kështu me radhë.

Për sa u përket marrëdhënieve me jashtë, aktualisht çdo gjë bëhet haptazi në vijë kapitaliste dhe që nga Hua Kuo Feni, Ten Hsiao Pini, Li Hsien Nieni e udhëheqës të tjerë po deklarojnë se Kina nuk do të ndërtohet vetëm me forcat e veta, por do të marrë (siç merr) kredi nga qeveritë e huaja dhe nga bankat e mëdha ndërkombëtare. Li Hsien Nieni çdo ditë takohet me përfaqësuesit e shoqërive të mëdha amerikane, nga më të ndryshmet, të shoqërive të Gjermanisë Perëndimore dhe të të gjitha vendeve kapitaliste të industrializuara. Me Japoninë punët kanë shkuar aq larg sa që vetë Ten Hsiao Pini deklaroi se 60 për qind të tregtisë Kina do ta zhvillojë me Japoninë dhe 40 për qind me të gjitha shtetet e tjera kapitaliste të botës. Natyrisht, në këto 40 për qind pjesa e luanit u vete Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Gjermanisë Perëndimore, ndërsa të tjerëve kusuri.

Nuk janë të pakta kreditë që ka marrë Kina. Janë me dhjetëra miliardë, bile mund të themi se është e pamundur të përcaktosh një numër, por shohim shifrat që japin: 20 miliardë, 25 miliardë, 30 miliardë, nga Japonia, nga Gjermania Perëndimore, nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës etj. Të gjitha këto vende do të bëjnë investime të mëdha në Kinë dhe do të hipotekojnë pasuri të mëdha të këtij vendi, do të japin kredi të larta dhe do t'u imponojnë kinezëve kushtet e tyre të shfrytëzimit.

Për sa i përket emrit të Kinës në botë, mund të themi se edhe vendet kapitaliste e kanë parë qartë dhe thonë se ajo nuk është më një vend socialist, por një vend kapitalist, e kuptojnë mirë se Kina përpiqet që me ndihmën e tyre të bëhet një superfuqi botërore.

Dihet se socialimperializmi sovjetik konsiderohet nga kinezët si armiku i tyre kryesor, por edhe Bashkimi Sovjetik e konsideron Kinën armikun e vet kryesor. Bash-

kimi Sovjetik përpiqet të ruajë influencën e tij në të gjithë Azinë Juglindore, në Indi, Pakistan, Afganistan etj., kurse Kina, nga ana e saj, përpiqet t'ia minojë këtë influencë.

Në lidhje me vendet e vogla të «botës së tretë», siç i quajmë kinezët, këto në përgjithësi e kanë humbur krejtësisht besimin të Kinës dhe tashmë janë të bindura se ajo aktualisht është një superfuqi kapitaliste dhe në marrëdhëniet politike, ideologjike dhe ekonomike me këto vende të vogla synon që t'i vërë nën vartësinë e saj. Forcat përparimtare e realiste në këto vende e kanë kuptuar se ideologjia e «botës së tretë», maocedunideja, që kinezët i vënë shenjën e barazimit me marksizëm-leninizmin, është marksizëm-leninizëm i falsifikuar, prandaj s'i besojnë më Kinës dhe paraqiten të vendosura për të mbrojtur tezat e Partisë sonë në fushën ideologjike dhe politike. Kudo ku njerëzit tanë kanë kontakt me njerëz të këtyre vendeve, si edhe në shtypin e tyre, të gjithë shprehen pro nesh e përkrahin pikëpamjet politike, ideologjike dhe qëndrimet e qarta konsekuente të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë e të Partisë sonë të Punës. Kjo është një fitore për ne, sepse në radhët e proletariatit botëror, të kësaj force të madhe, armike të betuar të kapitalizmit botëror, kemi një aleat të fortë që na mbrohet.

Gjithashtu ne kemi me vete njerëzit demokratë përparimtarë, që deri dje ishin të gënjer nga pozitat gjoja socialiste, por në realitet false, të Kinës e që aktualisht shohin se ku qëndron e vërteta, pra shohin se e vërteta qëndron me Shqipërinë dhe jo me Kinën. Të gjithë këta elementë progresistë përkrahin Shqipërinë dhe dënojnë politikën e Kinës dhe veprimet e saj. Me pak fjalë mund të themi se Kina aktualisht po i djeg etapat. Ardhja në fuqi e Ten Hsiao Pinit dhe e Hua Kuo Fenit e shpejtoi shndërrimin e Kinës nga një vend demokratiko-borgjez, revolucionar deri në njëfarë shkalle, në një vend reaksionar kapitalist socialimperialist.

## NË BAZË TË KUNDËRREVOLUCIONIT KINEZ QËNDRON MAOCEDUNIDEJA

Mao Ce Duni filloi të demaskohet në Pekin.

Partia jonë e ka shprehur me kohë mendimin e saj se Mao Ce Duni jo vetëm nuk ka qenë një marksist-leninist, por edhe si demokrat borgjez revolucionar ai ka bërë gabime të mëdha. Prandaj ne e kishim parashikuar atë që po ndodh sot në Kinë, domethënë demaskimin e Maos.

Që kur erdhi në fuqi grupi i Ten Hsiao Pinit, bashkëpunëtor i Liu Shao Çisë, i Ho Lunit e i të tjerëve, për ne u bë e qartë se ky grup, natyrisht, do të merrte revanshin kundër Maos. Dhe tash, po ata që Maoja i trajtoi revizionistë, borgjezë-kapitalistë, kthehen dhe e atakojnë Maon si një element që i ka shkaktuar dëmet të mëdha Kinës.

Në krye të kësaj fushate kuptohet se është Ten Hsiao Pini, i cili aktualisht ka forcuar pozitat e veta dhe nga këto pozita të forcuar ka filluar sulmin dhe spastrimin jo vetëm kundër së ashtuquajturës bandë e të katërve, por edhe kundër të gjithë kundërshtarëve të tij, nga janë e nga nuk janë. Ai ka rehabilituar të gjithë reaksionarët, shokë të tij, të dënuar gjatë gjithë kohës, që pas rrëzimit të bandës së vet, të Liu Shao Çisë etj. Tash këta kanë zënë pozitat kyç kudo: në ushtri, në pushtet, nëpër ministri të ndryshme, si dhe në të ashtuquajtu-

rën parti komuniste, që as ka qenë e as është komuniste.

Siç e kam theksuar edhe në shkrime të tjera, aktualisht në Kinë ekziston një gjendje shumë e turbullt. Dy klane të kundërta po ndeshen midis tyre: klani i Hua Kuo Fenit dhe ai i Ten Hsiao Pinit.

Po zhvillohet një luftë e brendshme, që në Pekin duket më e ashpër, për arsye se këtu është qendra. Në Pekin ne kemi ambasadorin tonë, i cili edhe na vë në korent, por nuk dimë se ç'ngjet në provinca, ku patjetër kjo luftë duhet të jetë akoma më e ashpër. Grupi i Ten Hsiao Pinit, që ka ardhur në fuqi, natyrisht, në radhë të parë, do të hakmerret kundër Mao Ce Dunit, i cili është armiku i tij kryesor, jo armik ideologjik, por subjektiv, personal. Them është i tillë, për arsye se Mao Ce Duni nuk ka qenë marksist-leninist, po kështu edhe lufta e Ten Hsiao Pinit kundër Mao Ce Dunit, grupit të «të katërve» dhe Hua Kuo Fenit nuk bëhet nga pozitat e një demokracie revolucionare, por nga pozita fashiste.

Për të goditur Mao Ce Dunin po përgatitet terreni, për arsye se emri i Maos akoma përkrahet e respektohet shumë në Kinë, prandaj Teni me shokë po e minojnë, po i marrin krahët këtij emri dhe këtij personaliteti politik, për ta likuiduar fare. Kjo luftë zhvillohet në të gjitha fushat, sidomos me dacibao. Para tri ditësh, më 19 nëntor, në Pekin u vendos një dacibao, ku kritikohet Mao Ce Duni dhe akuzohet se ka qenë udhëheqësi dhe përkrahësi i «katërshes» në luftën kundër Ten Hsiao Pinit, se ai ka dhënë urdhër dhe ka qenë kryesori që u shtypën demonstratat në sheshin Tien An Men. Po ashtu në datën 20, një ditë më vonë, u vu një dacibao edhe kundër Hua Kuo Fenit.

Mirëpo, që më 18 nëntor, Hua Kuo Feni, duke parashikuar që po ngrihet vala e luftës kundër tij, shkroi titullin e një libri me vjersha që do të botohet, ku ngrihen lart ngjarjet e vitit 1976 në sheshin Tien An Men,

demonstratat që u bënë atje, të organizuara dhe të shtyra nga Ten Hsiao Pini e shokët e vet. Me fjalë të tjera, sipas zakonisht kinez, (zakon i bukur!) ai shkroi titullin e një libri me vjersha, ku ekzaltohet personaliteti i Çu En Lait. Hua Kuo Feni e ka shkruar vetë titullin, për të treguar se ky është i huaj për ato që ndodhën më 1976, pra, s'ka lidhje me masat që janë marrë kundër demonstratës.

Me fjalë të tjera, Hua Kuo Feni kërkon të lajë duart nga kjo ngjarje, e cila po ngrihet nga grupi i Ten Hsiao Pinit si një akuzë e madhe kundër Maos, «katërshes», por edhe kundër Hua Kuo Fenit. Duke e ndier rrezikun, Hua Kuo Feni kërkon t'ia hedhë edhe për këtë fajin «katërshes», pra, çdo gjë «katërshes».

Një nga ata që ka shkruar vjersha ose poema, të cilat do të botohen në këtë vëllim ose në dy vëllime, ka vënë një dacibao, ku thotë se do ta tërheqë poemën e tij nga ky botim, për arsye se nuk i përket Hua Kuo Fenit ta shkruajë titullin, por i përket vetëm Ten Hsiao Pinit. Me fjalë të tjera, ai me këtë do të thotë se Ten Hsiao Pini është heroi i turbullirave të Tien An Menit, turbullira të cilat ai i quan revolucionare. Në fund dacibaoja e këtij mbyllet me thirrjet: «Rroftë populli, rroftë demokracia!».

Në një nga këto dacibao prej 10-12 faqesh, të shkruara disa me shkronja të vogla, disa me shkronja të mëdha, thuhet se në vitin 1976 në Kinë u vendos një regjim fashist dhe feudal i tipit të car Nikollës. Pra car Nikolla baras Mao Ce Dun! Natyrisht, Mao Ce Duni nuk ishte tamam si car Nikolla, por një demokrat borgjez përparimtar, veç aspak një marksist-leninist ose revolucionar. Kjo dacibao ngre lart figurën e Çu En Lait, duke thënë se ai punoi për 28 vjet në gjirin e popullit tok me Çu Denë, me Çen Jinë, me Lo Ly Sinë e me ku di unë. Vetëm emri i Liu Shao Çisë nuk zihet në gojë, por nesër

patjetër do të dalë edhe emri i këtij, ashtu siç do të dalë edhe më hapur qelbësira kundër Mao Ce Dunit.

Dacibaot flasin se populli e do pa masë Ten Hsiao Pinin dhe autorët kërkojnë që të ngrihet një komision nën kryesinë e sekretarit të provincës së Seçuanit, kandidat i Byrosë Politike dhe mik i Ten Hsiao Pinin, me përfaqësues të organeve qendrore të partisë, të shtetit e të organizatave të masave, për të gjykuar kush ka dhënë urdhër që të dërgohen dhjetëra mijë ushtarë për të shtypur demonstratat në sheshin Tien An Men, për të derdhur gjak e për të vrarë njerëz dhe kush mban përgjegjësinë për personat që janë prekur nga incidenti. Kërkohet, gjithashtu, që fajtorët të hiqen nga postet që kanë dhe përfundimi është ky: «Ta lëmë perandorin të takohet me djallin», domethënë të vdesë. Sigurisht, mendohet që perandori numër dy është Hua Kuo Feni, se perandori numër një, Mao Ce Duni, e ka bërë tashmë «takimin me djallin».

Siç duket, strategjia e elementit fashist, me Ten Hsiao Pinin në krye, që ka marrë fuqinë, siç kam theksuar edhe më parë, është që të likuiojë Hua Kuo Fenin nga posti i kryetarit të partisë dhe i kryeministrit, t'i marrë këto poste në duart e veta dhe ta kthejë Kinën në një republikë demokratike borgjeze kapitaliste, në një superfuqi. Megjithëse aktualisht të gjitha veprimet në këtë drejtim, pra, për kthimin e Kinës në superfuqi, po bëhen haptazi, megjithëse miqësia dhe aleanca me imperializmin amerikan dhe me borgjezinë reaksionare nuk ka asnjë kufizim, çështja është që të mos ketë as edhe një pengesë në udhëheqjen kryesore. Me fjalë të tjera kapitalizmi botëror dhe kapitalizmi kinez dëshirojnë stabilitet, për arsye se stabilitet në Kinë nuk ka, dhe këtë mund ta vendosë dhe do ta vendosë vetëm një regjim fashist me Ten Hsiao Pinin në krye e me shokët e tij.

Në këtë mënyrë do të bëhet demaskimi i mëtejshëm i vetë Mao Ce Dunit.

Një gjë të tillë ne e kishim parashikuar. Vetë veprimet e revizionistëve kinezë do të ndihmonin që tezat tona të drejta të vërtetoheshin konkretisht. Ne e kemi thënë prej kohësh se Mao Ce Duni nuk ishte një marksist-leninist, se atij vetëm nami i madh i kishte dalë si i tillë, se Kina shitej si një vend socialist dhe Partia Komuniste e Kinës hiqej si një parti marksiste-leniniste, por duhej të ndodhnin gjithë këto ngjarje, që të mund të kuptohej e të dallohej qartë e kundërta e asaj që thuhej dhe e asaj që bëhej në Kinë. Pas gjithë këtyre ne arritëm në konkluzionin që dihet. Tash «perënditë» e Kinës po demaskohen dhe ky demaskim po bëhet me shpejtësi. Lind pyetja: Do ta ruajnë më në Kinë emrin e Mao Ce Dunit?

Mendoj se deri në njëfarë shkalle do ta ruajnë.

Aktualisht udhëheqësit kinezë po përdorin një taktikë djallëzore, duke thënë se «në kohën e Revolucionit Kulturor janë bërë gabime, ashtu sikurse janë bërë edhe në vitin 1939 në Bashkimin Sovjetik» dhe shtojnë se «Stalini është shprehur që në një goditje të tillë të armiqve mund të bëhen edhe gabime, bile ai i njihte këto gabime dhe kishte dhënë urdhër që të ndreqeshin». Me fjalë të tjera, edhe Ten Hsiao Pini, ky kundërrevolucionar, që e heq veten si revolucionar, sipas kinezëve po veproka si Stalini, veç po ngreq gabimet e Mao Ce Dunit; gabimet që gjoja Stalini ka bërë dhe ka pasë kërkuar të ndreqen, Hrushovi jo vetëm nuk i ndreqi, por i vazhdoi, dhe, më në fund, ia veshi edhe këto Stalinit. Me këto Ten Hsiao Pini do të thotë se janë Hua Kuo Feni dhe «katërshja» që e kishin gënjyer Mao Ce Dunit dhe, si duket, ata ia kishin mbushur mendjen të binte në gabime. Natyrisht, më vonë, po këta do t'ia hiqnin të gjitha pendët Mao Ce Dunit dhe, për t'u maskuar, do të

përdornin fraza nga të tijat, që janë me dy kuptime. Këtë gjë e ka parashikuar vetë Maoja dhe ka punuar në mënyrë të tillë që idetë e tij t'i përdorin, siç është shprehur vetë, edhe të djathtët, edhe të majtët.

Mao Ce Duni ka menduar se pikëpamjet e tij eklektike antimarksiste do të rrënjoseshin thellë në Kinë dhe pas vdekjes së tij gjithë brezat e politikanëve të ardhshëm do të udhëhiqeshin kurdoherë nga flamuri i tij, nga maocedunideja. Ky personalitet kinez kishte bindjen se kjo maocedunide do të udhëhiqte jo vetëm Kinën, por edhe gjithë botën. Kjo ishte bindja e Mao Ce Dunit, ndryshe ai nuk do të kishte lejuar që të zhvilloheshin situata të tilla, ashtu siç u zhvilluan gjatë kohës që jetonte dhe pas vdekjes së tij. Pra, Mao Ce Duni dhe idetë e tij kanë qenë dhe janë në bazë të të gjitha këtyre turbullirave dhe të kësaj rrjedhe fashiste, kundërrivolucionare në Kinë.

## E ENJTE

23 NËNTOR 1978

### TITOJA NJEH DHE POHON ME GOJËN E VET FALIMENTIMIN E REGJIMIT TË TIJ

Më 21 nëntor në Beograd u mbajt Kongresi i 8-të i Lidhjes së Sindikatave Jugosllave. Në këtë kongres e mori fjalën edhe «i famshmi» Tito. Ai i përshëndeti kongresistët dhe, në pragun e vdekjes së tij, u tha shumë gjëra të hidhura, me fjalë të tjera u lexoi *De profundis*-in e tij dhe të regjimit të vet.

Fjalimi i Titos është mbushur me paralajmërime të tilla, si: «Ua kam thënë edhe herë të tjera», «ua përsëris edhe tash», «e kam thënë në filan kohë këtë gjë», «kam folur për këto probleme edhe herët e tjera» e kështu me radhë. Në këtë mënyrë ky sharlatan revizionist dëshiron të shfajësohet përpara klasës punëtore dhe popullit jugosllav se çdo gjë që ka bërë ai, çdo gjë që ka thënë ai, ka qenë e drejtë, por, në qoftë se Jugosllavia gjendet në bankrutë dhe në pragun e humnerës, faji nuk është as i veti, as i politikës së tij, as i sistemit të tij, por është i të tjerëve. Se cilët janë këta të tjerë, këtë Titoja nuk e thotë.

Por ç'thotë ai? Ja: «Arritjet tona i zvogëlojnë problemet dhe vështirësitë, të cilat nuk janë vetëm të natyrës objektive». Me këtë ai do të tregojë se shkak i kësaj katastrofe të Jugosllavisë nuk janë vështirësitë për arsye objektive, por për arsye subjektive, është çështja e zhvi-

llimit të tanishëm ekonomik ku, siç shprehet Titoja, «hasim në disa tendenca e shfaqje negative, të cilat, për faktin se nuk i likuidojmë në kohën e duhur, bëhen probleme kronike dhe minojnë ato që kemi arritur».

Me fjalë të tjera bankruta jugosllave shkaktohet nga të metat subjektive, ngaqë nuk është zbatuar si duhet politika «e drejtë» e predikuar nga Titoja dhe se nuk janë marrë masa konkrete, por janë lënë gjërat të trashen dhe të arrihet në këtë ditë. Por pse janë lënë derisa janë trashur këto gjëra? Organizativisht pse nuk janë marrë masa, politikisht pse nuk është edukuar kjo masë që të kuptojë të mirën dhe të keqen dhe të mos arrihej në këto rezultate? Këtu Titoja përpiqet të shfaqësohet dhe t'ua hedhë fajin të tjerëve, me një fjalë popullit jugosllav. Ai do të vdesë siç thotë francezi *en beauté*<sup>1</sup>. Ja ç'thotë Titoja: «Strukturën ekonomike ne nuk po e ndryshojmë aq shpejt sa duhet, në përputhje me drejtimet strategjike të përcaktuara bashkërisht të zhvillimit tonë». Ku e paska caktuar këtë zhvillim bashkërisht, kur ai në çdo republikë ka vendosur regjimin e vetadministrimit deri në ndërmarrjet më të vogla? Si konsekuencë, — thotë Titoja, — «rendimenti i punës po rritet më ngadalë». Ta merr mendja që rritet më ngadalë, për arsye se atje s'ka as disiplinë, as kontroll, as ndërgjegje politike dhe ata që drejtojnë, mendojnë vetëm për veten e tyre, si të marrin dividende të larta dhe të tjerët të vuajnë ose të shkojnë në emigracion.

Titoja vazhdon: «Të gjitha llojet e konsumeve po rriten shumë shpejt dhe jashtë mundësive të prodhimit shoqëror». Lind pyetja: Cilët janë ata që konsumojnë? Natyrisht konsumojnë ata që kanë të holla, të cilat i sigurojnë duke grabitur pasurinë e shtetit dhe nuk tronditen aspak pse ngrihen çmimet. Këta kanë mundësi të

<sup>1</sup> Frëngjisht — me lavdi.

blejnë çdo gjë e bile ta blejnë me shumicë, të blejnë edhe toka, edhe vila, edhe tre apo katër automobila, të vënë edhe para në bankë, kurse prodhimi shkon përtokë. Nga ana tjetër populli për të jetuar merr borxhe. «Pra më shumë konsumojmë sesa prodhojmë», — vazhdon Titoja. «Në këtë mënyrë, — thotë ai, — ekonomia ngarkohet së tepërmi dhe hyn në borxhe, kështu dobësohet edhe baza materiale e vetadministrimit. Kjo e inkurajon më tej inflacionin, i cili në një gjendje të tillë rrezikon të bëhet akoma më i madh nga ç'është. Këtë rrjedh deficitin i lartë i bilancit të pagesave me botën e jashtme, të cilin e kam theksuar disa herë».

Të gjitha këto janë konsekuencat e regjimit të vetadministrimit, e politikës kapitaliste kaotike, e sistemit anarkosindikalist që ka krijuar një bandë grabitësish kapitalistë, vjedhësish, shpërdoruesish dhe ka shkaktuar mjerimin e popujve.

Titoja thotë: «Po hasim në mbylljen lokale e rajonale të ekonomisë, në shoqërizimin e pamjaftueshëm në ekonomi, që vështirësojnë zhvillimin e suksesshëm afatgjatë të të gjithë vendit, e veçanërisht të rajoneve të pazhvilluara sa duhet ekonomikisht». Po kush e ka shkaktuar këtë situatë? Natyrisht, vetadministrimi, por këtë Titoja nuk ka si e pohon, se ndryshe do të pohonte falimentimin e plotë, por thotë se një situatë e tillë vë në rrezik sloganet: barazi, bashkim e vëllazërim, të cilat, shprehet ai, «kanë qenë dhe mbeten kushte themelore të ekzistencës sonë dhe të zhvillimit në paqe dhe liri». Domethënë liri për vjedhësit, liri për kapitalistët, paqe për këta, kurse për popujt një situatë e tillë në asnjë mënyrë nuk mund të sjellë as paqe, as liri, por do të sjellë me siguri katastrofën.

Çuditet Titoja e pyet: «Përse në ekonomi nga viti në vit na dalin pothuajse të njëjtat probleme dhe dobësi? Nga vjen kjo, kur ne i paraqesim qartë dhe me saktësi

objektivat dhe detyrat vjetore e pesëvjeçare dhe pastaj konstatojmë se ato i kemi zbatuar vetëm pjesërisht?». I ka caktuar këto ai, por i ka caktuar vetëm në kartë, kurse poshtë nuk zbatohen dhe arsyet e dimë e i kemi shpjeguar qartë në kritikën që i kemi bërë librit «të famshëm» të Kardelit. Natyrisht edhe Titoja i di këto, por pyetjen pse ngjasin këto e bën për t'u shfajësuar. «Në një masë të madhe këtu bëhet fjalë për mosrealizimin e asaj që është përcaktuar nga marrëveshjet dhe bisedimet vetadministruese» — i përgjigjet ai pyetjes që bën vetë. Kurse ne i themi se këto marrëveshje dhe bisedime janë vetëm në kartë.

«Ne, — thotë Titoja, — po ndërtojmë me sukses sistemin (çfarë suksesi!), po miratojmë ligje dhe plane (sa të duash, bile me okë, them unë), po arrijmë në marrëveshje» (në asnjë marrëveshje nuk arrijnë). «Pra, — vazhdon ai, — këtu nuk është fjala për dobësitë e sistemit (pikërisht për dobësimin bile për falimentimin e sistemit them unë), megjithëse përmirësimi i tij i vazhdueshëm është i mundur dhe i nevojshëm, por për veprimtari jo sipas sistemit, për mospërmbajtje ndaj zgjidhjeve sistematike dhe qëndrimeve të marrëveshjeve, për përgjegjësi në nivele të ndryshme e në disa raste edhe për minimin me ndërjegje të atyre që i kemi miratuar». Gjëra të bukura shumë!!

Çdo gjë, — thotë Titoja, — «lihet pas dore dhe zvarritet zbatimi i saj ose pranohet formalisht dhe punohet me metodën e vjetër». Po të punohej me metodën e vjetër, me sistemin e vjetër të drejtimit, do të shkonte ndryshe puna, por pikërisht se e ka bërë fërtele drejtimin socialist, e ka vënë në këmbë, e ka shkatërruar, prandaj ngjasin këto gjëra dhe Titoja, me gojën e tij pohon ato që ne kemi shkruar në analizën që i kemi bërë librit të Kardelit, pra thotë se lindin spontaneiteti dhe mosstabi-

liteti në fusha të ndryshme dhe më në fund në fushën më të ndjeshme: në funksionimin e sistemit.

Ai pohon se në gjithë këtë drejtim dhe veprim duken karakteristikat e tendencave liberale dhe burokratike. Natyrisht, s'mund të jetë ndryshe, atje mbretërojnë burokracia, liberalizmi, sepse këto i pjell vetë sistemi i vet-administrimit dhe këto nuk mund të luftohen nga partia e Titos. Në këtë kapitull e kanë zërin administratorët dhe gjoja të deleguarit e punëtorëve, që s'janë veçse thithës të gjakut e të djersës së punëtorëve.

Pra, si konkluzion, Titoja thotë se «Orientimi ynë themelor duhet të jetë politika e stabilizimit». Po si do ta bëjnë stabilizimin? Duke luftuar, — thotë ai, — për zhvillim të stabilizuar. Thënie gjeniale! Dhe shton se s'është nevoja t'i bëjmë të gjitha ne, vijmë brezat e rinj dhe ata do të bëjnë diçka.

Por ç'po i lë Titoja këtij brezi që vjen pas? I lë shkatërrimin e vendit, shitjen e pasurive të vendit të kapitalizmi i huaj, i lë një shtresë kapitalistësh që do t'i pijë gjakun këtij brezi, që ka shkatërruar ekonominë e vendit dhe e ka lënë rininë në një rrugë pa perspektivë, duke shtyrë një pjesë të madhe të saj drejt një jete të degjeneruar. Këtë i ka lënë titizmi brezit të ri.

Nuk duhet t'ua shtojmë barrën punonjësve tanë, prodhuesve tanë, — shprehet ai, — kurse nga ana tjetër pohon të kundërtën: «Në kolektivat tanë punonjës ka rezerva të mëdha dhe mundësi për punë më produktive ekonomike dhe efikase, por me kusht që të kursehet më shumë, të punohet akoma më mirë dhe të veprohet në mënyrë më të racionalizuar në të gjithë shoqërinë», të mos vidhet, të mos priset por të përvishen llërët. Po kush t'i përveshë llërët dhe për kë t'i përveshë llërët? Natyrisht t'i përveshin punëtorët për borgjezinë e re dhe për kulakët. Këtë do të shprehë ai me gjithë këto lojëra fjalësh.

Të ulen, — thotë Titoja, — shpenzimet investuese; ato të përgjithshme, të përbashkëta si dhe personale. Janë 29 mijë objekte duke u ndërtuar (të gjitha këto natyrisht ndërtohen me djersën e popullit dhe me kreditë e jashtme). Kjo përbën rrezik të madh për inflacion, — thotë Titoja, — e duhet t'i lëmë për më vonë një pjesë të këtyre ndërtimeve dhe të ecim gradualisht. I ka rënë mendjes pas presidenti! Dhe si konkluzion thotë: «Unë ju paralajmëroj se gjendja nuk do të jetë e mirë, në qoftë se do të qëndrojmë në atë siç punojmë sot».

Po kush është përgjegjës, — pyet Titoja, — për dëshirat e tepruara, të cilat nuk përputhen me mundësitë? Se mos është Titoja! «Janë përgjegjës ata që marrin vendimet për investime etj.» — përgjigjet vetë. E me këtë përgjigje ai bie në kundërshtim me çka thotë më lart, kur shprehet se të gjitha vendimet i kemi marrë bashkërisht, kolegjisht. Por, meqë tashti nuk shkojnë mirë punët dhe ngaqë është e pamundur ta fshehë këtë situatë, ua hedh fajin të tjerëve.

«Ka, — thotë Titoja, — mjaft raste që vendoset në rrethe të ngushta për një sërë problemesh që i përkasin riprodhimit, ka mjaft ndikime në kundërshtim me marrëdhëniet vetadministruese». Këto janë profka, çdo gjë vendoset nga një grup kapitalistësh në krye të ndërmarrjes ose të ndërmarrjeve.

Vërtet termi është «vetadministrim», por kjo është një fjalë boshe. As i pyet kush punëtorët. Kapitalistët vendosin investime, të cilat s'mbarojnë kurrë. Këto investime bëhen me kredi nga jashtë dhe nga këto kredi pasurohen krerët e ndërmarrjeve, kurse koha e ndërtimeve zgjatet. Pra investime bëhen dhe prodhime nuk ka, prodhimi kombëtar zvogëlohet, të ardhurat kombëtare zvogëlohen, për arsye se ndërtime ka shumë, zvarriten e lihen në mes, por paratë merren, kreditë merren po këstu dhe kamatat i jepen kapitalistit të huaj. Natyrisht

të gjitha këto Titoja nuk i thotë aq hapur, se ndryshe do t'i hiqej krejtësisht maska.

Duhet të shtrëngojmë rripin, — thotë Titoja, — dhe, për ta zbutur pak këtë shprehje, shton: «Jo vetëm klasa punëtore, por edhe të tjerë», me fjalë të tjera edhe kapitalistët. «Konsumi ynë duhet të zbresë në kuadrin e mundësive reale dhe të jetë në vartësi të plotë nga rritja e rendimentit të punës». Të gjitha këto nuk mund të shkojnë mirë, bile jo mirë, por aspak mirë, nuk mund të shkojnë në një regjim të tillë, siç është regjimi vetadministrues. Këto janë llafe, janë formula, slogane dhe, për t'i dhënë një çikë kurajë e për të kënaqur një çikë veten ose më mirë për t'u shfaqësuar, Titoja thotë: «Është e qartë se problemet ekzistuese, që unë po shtroj, nuk mund të zgjidhen menjëherë. Ky është një proces i gjatë».

Po, po i gjatë, i gjatë po ke kaq vjet, me dhjetëra, me dekada që po e shkatërron ekonominë jugosllave dhe, në qoftë se nuk rrëzohet ky regjim, asgjë s'mund të ndreqet.

«Duhet të likuidojmë shkaqet e tyre, — vazhdon ai. — Kjo në mënyrë të veçantë tani është e rëndësishme në përgatitjen e planeve me afat të mesëm». U gjend kyçi i zgjidhjes së këtyre të këqijave! Vjen edhe në diçka tjetër, që është hedhur poshtë gjatë gjithë këtyre dekadave, kur thotë se «Çështjet aktuale në ekonomi duhet të tërheqin më shumë vëmendjen e Lidhjes së Komunistëve dhe të të gjitha organizatave të tjera, duke përfshirë edhe sindikatat». Deri tash Lidhja e Komunistëve, sipas statutit e sipas teorisë së vetadministrimit, i kishte larë duart nga ndërhyrja dhe nga udhëheqja e ekonomisë. Tash, sipas Titos, duhet të kthehet përsëri. Ç'thotë më tej? «Kjo kërkon që të kapërcehen me vendosmëri tendencat e shpeshherë edhe praktika e uzurpimit burokratik të të drejtave vetadministruese të punëtorëve, si dhe të të drejtave kushtetuese dhe detyrave të institucioneve të sistemit politik». Me fjalë të tjera në sistemin

vetadministrues, që nga ndërmarrjet më të vogla e deri te republika, është krijuar një shtresë burokratësh dhe kapitalistësh, të cilët kanë marrë në dorë drejtimin dhe ekonominë dhe veprojnë sipas interesit të klasës së re e aspak në interes të punëtorëve. Është tamam ajo që e kemi përcaktuar në kritikën që i kemi bërë vetadministrimit, nëpërmjet librit të Kardelit, se vetadministrimi është një bluf, është një sistem kapitalist anarkik, sistem, të cilin Titoja, duke ngritur gjithë këto probleme, pada-shur e demaskon vetë katërcipërisht. Na thotë edhe se «ka edhe përpjekje që interesat e veçantë të pjesshëm «të politizohen», gjë që maskon në vetvete rrezikun e manipulimit politik të punonjësve dhe të qytetarëve».

Titoja, Kardeli e të tjerë thonë se nuk duhen manipuluar politikisht punonjësit dhe se vetëm në vendet kapitaliste perëndimore dhe në vendet revizioniste lindore manipulohet individi, punëtori, kurse në vetadministrimin jugosllav kjo gjë nuk ngjet. Si mund të thuhet një gjë e tillë kur pikërisht kjo që ngjet në Jugosllavi është më keq sesa në vendet kapitaliste? Në vendet kapitaliste ka rregull. Është e vërtetë se kapitalisti e shtyp punëtorin dhe partitë e tjera e politizojnë këtë, po në të ashtuquajturin sistem vetadministrues të Jugosllavisë, çfarë po bëjnë? Këta i thonë punëtorit: Ti mos mendo politikisht, se mendojnë të tjerët, ti vetëm prano se gjoja vetadministron, se administrojnë të tjerët dhe merr ç'të të japin, kënaqu me kaq dhe mbyll gojën. Titoja pohon se elementët që vjedhin e që grabitin janë teknokratët dhe teknokracia është e lidhur ngushtë me burokracinë, prandaj zhduken interesat e punëtorëve në këtë mes. «Teknokratizmi, — thotë ai, — nuk do të kishte një forcë të tillë, në qoftë se nuk do të kishte përkrahjen e faktorëve të caktuar politikë, pra të burokracisë politike».

Por ai ka pretenduar shumë herë se në vetadministrimin jugosllav është zhdukur burokracia politike, kurse

tash pohon se «burokratizmi është shumë këmbëngulës dhe se rrënjët e tij nuk është lehtë të shkulen». Jo vetëm që nuk shkulen në Jugosllavi, por shkojnë thellë e më thellë, dhe zgjerohen e përhapen më shumë. «Prandaj kundër tij duhet luftuar, — thotë Titoja, — në të gjitha nivelet. Juve ju kujtohet, — vazhdon, — se unë shumë herë kam paralajmëruar për qëndrimin burokratik të disa individëve dhe grupeve, si edhe për tendencat për të uzurpuar pushtetin e klasës punëtore, kam folur edhe për aprovimin e vendimeve që nuk janë shprehje të intereseve e të dëshirave të vetë punonjësve». E bukur fort, i kënaqe punëtorët dhe popullin jugosllav! Flet ai për këto gjëra, por nga ana tjetër vepron në të kundërtën.

Sistemi i delegatëve është një përrallë, pavarësisht se Titoja thotë që «unë e kam ngritur këtë çështje edhe herën e fundit në kongres» dhe e ka përcaktuar rëndësinë e këtij sistemi të delegatëve. Në fakt delegatët janë një vërë në ujë, vrima e fundit e kavallit.

Në këtë fjalim të Titos ka edhe xhevahire të tjera, por ç'të zgjatemi. Ky fjalim i vërteton më së miri të gjitha dobësitë dhe kalbëzimin e sistemit të tij vetadministrues.

Në librin e botuar kohët e fundit, ku kritikojmë «teorizimet» boshe të Kardelit mbi vetadministrimin jugosllav, të gjitha këto çështje janë shtjelluar politikisht e ideologjikisht. Ata që e kanë lexuar këtë libër do ta krahasojnë me çka thotë Titoja dhe do ta shohin më konkretisht se analiza e bërë nga Partia e Punës e Shqipërisë është një analizë plotësisht e drejtë. Vetë formuluesi dhe zbatuesi i teorisë antimarksiste, anarkosindikaliste të vetadministrimit pohon me gojën e tij disfatën e plotë të regjimit në Jugosllavi dhe ndjell një të ardhme të errët për Federatën Jugosllave. Këtu e ka çuar tradhtia kundër marksizëm-leninizmit grupin titist dhe Jugosllavinë, grup i cili e ka shitur vendin kokë e këmbë të të huajt dhe e ka zhytur popullin në skamje e në mjerim.

## NË DALLGËT E LUFTËS PËR PUSHTET

Muret e Pekinit po mbushen me dacibao kundër Mao Ce Dunit. Kjo gjë pritej, por, natyrisht, do të kishte ecurinë e saj si një pjesë muzikore, që fillon me adaxhio, kalon në kreshendo e pastaj arrin kulmin në forte e fortissimo. Kështu do të ndodhë edhe me këto dacibao, derisa t'u vihet kapaku me gonget shurdhuese. Tash është kaluar faza e adaxhios. «I zgjuari» Hua Kuo Fen proklamoi se «me një të goditur shpartalloi katërshen», kundër së cilës u zhvillua një propagandë shurdhuese me muaj e me vite dhe të tëra meritat i mori përsipër ai vetë, që u zgjodh si kryetar i partisë dhe i republikës nga vetë Mao Ce Duni, i cili i tha: «Kur je ti në krye, unë vdes i qetë».

Kaloi kjo fazë, gjatë së cilës, natyrisht, u rehabilitua shkurtabiqi i verdhë, elementi fashist më energjik, Ten Hsiao Pini. Ky u tregua shumë aktiv në propagandimin e kësaj shtate që u krijua, domethënë zbatoi porosinë e Mao Ce Dunit, e la Hua Kuo Fenin ta ngrinte veten për ta rrëzuar pak më vonë, se me siguri do ta rrëzojë atë dhe kur ta rrëzojë, me siguri që do ta bëjë helaq.

**Hua Kuo Feni e shikon rrezikun që po i turret dhe ka manovruar për të sjellë rreth vetes, në udhëheqje dhe në bazë, një grup njerëzish që ta mbështetin.** Për shembull, në Byronë Politike ai kishte mbështetjen e Vu Tehut, të komandantit të garnizonit të Pekinit e të ndonjë

tjetri. Por gjatë periudhës kur po bëhej lufta kundër «katërshes» dhe gjoja për forcimin e brendshëm të situatës, Ten Hsiao Pini manovronte me shkathtësi e me gjallëri të madhe për të krijuar klanin e vet dhe për të vendosur rregullin e tij. Në se konsistonte ky «rregull»? Në shtyrjen e Hua Kuo Fenit jashtë pozitave që ai mban aktualisht dhe që Ten Hsiao Pini i quan të uzurpuara nga ky element pa vlerë. Që ta eliminojë këtë, Tenit i duhej më parë të eliminonte përkrahësit e tij në Byronë Politike dhe veçanërisht të zinte të gjitha kyçet, duke vënë njerëzit e vet në udhëheqje të shtetit, të partisë e të ushtrisë. Cilët ishin njerëzit e tij? Të gjithë ata që Mao Ce Duni i kishte likuiduar, kur kishte goditur grupin e Liu Shao Çisë e të Ten Hsiao Pinit me shokë me gjithë suitën e tyre deri në fund të piramidës. Mao Ce Duni ishte koka e këtij operacioni spastrimi. Por është e qartë se spastrimi që bëri Mao Ce Duni nuk u krye duke u nisur nga parimet marksiste-leniniste, as për forcimin e socializmit në Kinë, por u bë nga pozitat personale dhe për pushtet personal.

Në këtë rrugë Mao Ce Duni i diskreditoi së tepërmi këta dhe i detyroi të bënin autokritikë skandaloze. Tash që vdiq «timonieri i madh», doli nga një provincë e humbur dhe u vu në krye të partisë e të shtetit një leshko, Hua Kuo Feni, njeri pa kurrfarë vlere.

Gjithë llumi i madh, me Ten Hsiao Pinin në krye, që Revolucioni Kulturor e kishte fshirë, u ngrit dhe mori fuqinë në dorë. Në këtë periudhë Teni zuri të gjitha kyçet me njerëzit e tij dhe u përgatit për revansh. Revanshi do të ishte kundër Mao Ce Dunit, kundër veprës së tij dhe veçanërisht kundër Revolucionit Kulturor.

Gjatë këtij revolucioni 17 milionë veta u futën në parti, kurse gjatë kohës së revanshit të Tenit, të gjithë këta, ose shumica dërrmuese e tyre, u likuiduan, u hoqën nga postet që kishin zënë e në vend të tyre u rehabili-

tuan të gjithë ata që ishin dënuar nga Revolucioni Kulturor. Kjo është një fazë me rëndësi të madhe në historinë aktuale të Kinës, është një fazë kur reaksioni, fashizmi, kapitalizmi jo vetëm kanë ngritur krye, por kanë marrë fuqinë dhe këtë fuqi e manifestojnë. Vetë Hua Kuo Feni në kongresin e fundit të partisë tha se «Revolucioni i Madh Kulturor proletar mori fund». Me një fjalë, këtij revolucionit, të padiskredituar deri atëherë, tash iu vu pika.

Hua Kuo Feni bëri të ditur se aktualisht në Kinë filloi një revolucion tjetër, ai i «katër modernizimeve», që ka si autor Ten Hsiao Pinin. Ky revolucion ka qenë ëndrra e Çu En Lait, i cili ka punuar me kohë nën rrogoz. Tash zëvendësi i tij, Ten Hsiao Pini, është hedhur hapur në një aktivitet të shfrenuar për ta bërë Kinën një superfuqi socialimperialiste, për të forcuar aleancën me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, për të konkretizuar aleancën me Japoninë dhe bashkëpunimin e ngushtë me gjithë reaksionin botëror, me borgjezinë reaksionare të të gjitha vendeve. Që ta bëjë këtë, Tenit i duhet të ndryshojë strukturën organizative të Kinës, t'i heqë vijë politikës pseudomarksiste të Mao Ce Dunit, t'i heqë maskën teorisë së tij pseudomarksiste, e ta nxjerrë këtë në shesh ashtu siç ka qenë në fakt — një teori borgjeze kapitaliste, të krijojë një ushtri të fortë, të modernizuar, që ta mbajë nën zap popullin kinez, ta shtypë e ta shfrytëzojë në favor të borgjezisë kapitaliste të vjetër e të re kineze dhe të borgjezisë kapitaliste të huaj, amerikane, japoneze, evropiane etj. Ky është qëllimi i «katër modernizimeve».

Tash të vijmë te çështja e Mao Ce Dunit.

Ne kemi thënë se do të asistojmë në një situatë kur Mao Ce Duni do të demaskohet në Kinë dhe vetë antimarksistët kinezë me veprimet e tyre do të nxjerrin në dritë kalbëzimin e Kinës, kalbëzimin e teorisë pseudo-

marksiste të Mao Ce Dunit dhe kështu do të ndihmojnë për të dalë qartë vërtetësia e veprës së shëndetshme të Partisë sonë për këtë çështje. **Në periudhën aktuale Ten Hsiao Pini ia ka hipur kalit dhe ecën revan në dy drejtime: për demaskimin e Mao Ce Dunit dhe për rrëzimin e Hua Kuo Fenit.** Këtë ka për ta rrëzuar si atë kungullin e kalbur, pra, pa ndonjë mundim të madh, pa lënë gjurmë, kurse për demaskimin e Mao Ce Dunit do t'i duhet një punë më e madhe, më e vazhdueshme. Pikërisht kjo punë e dytë, që është më e vështira, është edhe më kryesorja për reaksionin e tërbuar kinez, me Ten Hsiao Pinin në krye, sepse, po t'ia arrijë kësaj, atëherë, s'ka dyshim, që Hua Kuo Feni është i likuiduar.

Për këtë arsye kanë filluar dacibaot. Këto vihen nga partizanët e Tenit, kështu duhet kuptuar, por ka mundësi që të mos vihen vetëm prej këtyre, por edhe nga marksistë-leninistët që shprehin mendimet e tyre të vërteta për vijën antimarksiste të Mao Ce Dunit, që kërkojnë shpjegime, pa vënë emrin. Natyrisht, kjo i shërben rrugës së Ten Hsiao Pinit, por, gjithashtu, u hap sytë të tjerëve për sa i përket figurës së alambikuar të Maos si një «marksist-leninist i madh». Në këtë mënyrë njerëzit e shëndoshë në Kinë, se natyrisht ka njerëz të tillë, në mos sot, nesër, do të reflektojnë se Mao Ce Duni nuk ka qenë marksist-leninist, se Ten Hsiao Pini është një fashist dhe se Hua Kuo Feni është një njeri i ardhur nga rruga dhe ka bërë lojën e Mao Ce Dunit e se edhe ky, edhe Ten Hsiao Pini, meritojnë të shkojnë në litar. Por aktualisht këto dacibao, pavarësisht se mund të flasin mirë për Tenin, shërbejnë që masat e gjera të popullit të thellohen pak në mendime e në gjykime e pastaj të kërkojnë shpjegime përse ngjasin këto gjëra, të pyesin: A lejon marksizëm-leninizmi, në qoftë se ky është zbatuar me konsekuencë, të zhvillohen situatat në këtë mënyrë siç po zhvillohen?

Një varg prej gjashtë dacibaosh u vu në muret e Pekinit nga një punëtor hekurudhash, i cili në mes të tjerash bën pyetjen: Kryetari Mao ka bërë më përpara gabime apo jo? Vetë ai përgjigjet me pohim: Po, ka bërë gabime, dhe citon autokritikën që Maoja gjoja ka bërë më 1962, kur ka marrë përsipër gabimet si kryetar i Komitetit Qendror të Partisë dhe gabimet e të tjerëve. Dhe po ky punëtor pyet: Po atëherë, meqë Mao Ce Duni ka bërë gabime, pse na quajnë ne kundërrevolucionarë, kur kritikojmë Maon? Kjo frazë, natyrisht, mund t'i vijë për ndihmë edhe Hua Kuo Fenit, dhe i vjen, por njëkohësisht i hap sytë edhe popullit se Mao Ce Duni nuk duhet adhuruar si një perëndi, si i pagabueshëm, por duhet shikuar një çikë më thellë.

Dacibao të tilla i detyrojnë njerëzit të thellohen e t'i drejtohen vetes: Pa të mendohemi një çikë si kanë qenë marrëdhëniet e Maos me Lin Biaon e me «bandën e të katërve». Dhe në një nga këto dacibao ky punëtor bën pyetjen: Në qoftë se Maoja nuk ishte dakord, si e la Lin Biaon të merrte një pushtet të tillë dhe të quhej për aq kohë zëvendësi i tij, bile edhe me statut?

Ose një pyetje tjetër e këtij punëtori: Kryetari Mao nuk e dinte se Çian Çini, gruaja e tij, ishte tradhtare?

Pyetja e tretë: Kryetari Mao nuk e dinte se Çan Çun Çiao, anëtar i «bandës së të katërve», ishte renegat?

Pyetja e katërt: Në qoftë se kryetari Mao nuk ishte dakord, si mundi të zhvillonte «banda e të katërve» një fushatë kundër vijës devianiste të djathtë dhe të hiqte Ten Hsiao Pinin?

Dhe pyetja e pestë: Në qoftë se kryetari Mao nuk ishte dakord, si mund të cilësohej kundërrevolucionar incidenti i Tien An Menit?

Të gjitha këto pyetje janë shumë djegëse dhe i bëjnë kinezët të futen në mendime, sepse janë shkruar plot artikuj që thonë se «Mao Ce Duni ishte një udhëheqës i

madh», «ishte vigjilent», se «asnjë dokument nuk aprovohej e asnjë punë nuk kryhej pa e pyetur atë». Prandaj njerëzit me të drejtë pyesin: Si u bënë këto, pse s'u panë?

Ky punëtor në këto dacibao shkruan: «Ne pretendojmë të gjithë se jemi marksistë-leninistë, por materializmi dialektik u mëson masave të vërtetën ashtu siç është dhe nuk i gënjen, nuk e shtrembëron historinë. Kryetari Mao është njeri dhe jo perëndi, ka ardhur koha që atij t'i jepet vendi i vërtetë. Vetëm në këtë mënyrë do të mbrohet marksizëm-leninizmi dhe maocedunideja; duke treguar se një njeri i madh si Maoja ka bërë gabime, kuadrot dhe masat do të pranojnë mësimet e tij, do të mund të evitojnë një tragjedi historike».

«Në qoftë se populli nuk ka një opinion të vetin lidhur me Maon, liria e mendimit është një fjalë boshe, vazhdon dacibaoja. Pa një revolucion të thellë ideologjik, revolucionin ynë do të dështojë dhe nuk mund të realizohet «katër modernizimet»».

Siç po konstatojmë, ky person flet për marksizëm-leninizmin që duhet mbrojtur, natyrisht shton edhe maocedunidenë dhe mendoj se e shton këtë pse duhet ta shtojë, por nuk e beson, ose e beson se nuk është tamam i qartë, por çështja tjetër është se ai thotë që materializmi historik nuk duhet ta shtrembërojë historinë dhe të gënjejë, se ky materializëm është ajo shkencë që e bën historinë të shkruhet si duhet. Pra në këto afishe kërkohet të rrëzohet Mao Ce Duni dhe kur thuhet se duhet rrëzuar Mao Ce Duni, natyrisht, nënkuptohet që duhet rrëzuar edhe kryetari Hua Kuo Fen, të cilin, siç është thënë, e ka zgjedhur vetë Mao Ce Duni.

Këto janë dacibaot e para, por pas këtyre me siguri do të vijnë të tjera, akoma më të thelluara dhe më dis- kredituese për Mao Ce Dunin. Ashtu siç bëri Mao Ce Duni me Liu Shao Çinë, me Ten Hsiao Pinin dhe me të

tjerë, ashtu do të bëjnë me Maon ata që aktualisht janë në fuqi. Fushata ka filluar në gazetën «Zhenminzhibao». Kjo ka botuar një artikull të gjatë, ku shkruhet se ky organ ka qenë një vegël në duart e «katërshes», ka bërë një punë kundërrevolucionare, u ka shërbyer tradhtarëve etj., etj. Në këtë mënyrë organi i Komitetit Qendror është diskredituar krejtësisht në sytë e opinionit botëror. Zaten kështu e kanë kuptuar kurdoherë autokritikën të ashtuquajturit komunistë kinezë. Kjo «autokritikë» imponohet nga lart dhe bëhet për të forcuar opinionin ose për të vërtetuar mendimin se një grup, që kishte marrë fuqinë në dorë dhe që hiqej marksist-leninist, ishte anti-marksist. Kur ky grup rrëzohej përtokë, grupi tjetër anti-marksist, që vinte në fuqi dhe që vetëquhet edhe ai marksist-leninist, vë në gojën e të parëve një autokritikë diskredituese, diskriminuese dhe... kështu do të vazhdojë. Ç'do të ngjasë më tutje? Ne themi se do të vazhdojë një situatë e tillë dhe se grupi i Hua Kuo Fenit do ta pranojë disfatën duke lidhur duart.

Të gjithë këta 17 milionë, që janë bërë komunistë në kohën e Revolucionit Kulturor dhe që tash po merren nëpër këmbë, a do ta pranojnë një situatë të tillë, apo do të ngrenë krye? Medoemos që do të ngrenë krye, por si do të ngrenë krye, me ç'drejtime politike, me ç'drejtime organizative e me ç'pikëpamje ideologjike, kjo do të shikohet më vonë. Kam shkruar edhe herë tjetër që, në qoftë se këta të revoltuar do të ndjekin ideologjinë e Mao Ce Dunit, ata do të dështojnë, s'do të bëjnë gjë, do të sakrifikohen kot dhe do ta mbajnë Kinën në një situatë kaotike si përpara, sepse ideologjia e Mao Ce Dunit ka pjellë kaosin, ka pjellë burokracinë dhe ka luftuar kundër socializmit e revolucionit.

E SHTUNË  
25 NËNTOR 1978

## DISA IDE PLOTËSUESE PËR LIBRIN «IMPERIALIZMI DHE REVOLUCIONI»

Pikëpamjet politike dhe ideologjike jomarksiste, eklektike, borgjeze të Mao Ce Dunit i dhanë Kinës së çli-ruar një superstrukturë të paqëndrueshme, një organizim shtetëror dhe ekonomik kaotik, që nuk u stabilizua asnjëherë. Kina ndodhej në një rrëmujë të vazhdueshme, bile anarkiste, rrëmujë që nxitej nga vetë Mao Ce Duni me parullën «duhet turbulluar për të sqaruar».

Në shtetin e ri kinez një rol të posaçëm ka luajtur Çu En Lai. Ky ishte një ekonomist dhe organizator i zoti, por nuk ka qenë kurrë një politikan marksist-leninist. Ai, si pragmatist tipik diti të zbatonte pikëpamjet e tij jomarksiste dhe t'i akordonte këto në mënyrë të përsosur me çdo grup që mernte fuqinë në Kinë. Ai ishte një *poussah* që qëndronte përherë në këmbë.

Çu En Lai ishte mjeshër i kompromiseve pa parim. Ai edhe i ka mbështetur edhe i ka dënuar Çan Kai Shinë, Kao Ganin, Liu Shao Çinë, Ten Hsiao Pinin, Mao Ce Dunit, Lin Biaon, «katërshen», por kurrë s'ka mbështetur Leninin dhe Stalinin, marksizëm-leninizmin.

Grupi i Hua Kuo Fenit dhe i Jeh Çien Jinit që erdhi në fuqi, për të forcuar pozitën e veta të lëkundshme, valëviti flamurin e Mao Ce Dunit. Nën këtë flamur ai dënoi demonstratën e Tien An Menit dhe likuidoi Ten Hsiao Pinin, të cilit i vuri etiketën e merituar të revizionistit.

Nën këtë flamur ky grup mori pushtetin me puç dhe shpartalloi «katërshen». Por kaosi që ka karakterizuar gjithnjë Kinën vazhdoi edhe më i madh. Kjo situatë e turbullt nxori në skenë dhe imponoi ardhjen në fuqi të Ten Hsiao Pinit, i cili rifilloi të ecë në rrugën e tij të ekstremit të djathtë me metoda fashiste.

Objektivi i tij i parë ishte të forconte pozitën e grupit të vet, të ndiqte pa dorashka kursin e aleancës me imperializmin amerikan dhe me borgjezinë reaksionare botërore. Ten Hsiao Pini nxori programin e «katër modernizimeve», i vuri pikën Revolucionit Kulturor, likuidoi gjithë atë masë kuadrosh të ngritur në pushtet, në parti dhe në ushtri nga ky revolucion dhe i zëvendësoi këta me njerëzit e reaksionit më të zi, të demaskuar dhe të dënuar më parë.

Tash po asistojmë në një periudhë që karakterizohet nga dacibaot kundër Mao Ce Dunit që vënë partizanët e Ten Hsiao Pinit, duke qëndisur me to muret e Pekinit. Është periudha e revanshit që ka dy synime: së pari, të likuidojë «prestigjin» e Maos dhe të qërojë pengesën Hua Kuo Fen dhe, së dyti ta bëjë Ten Hsiao Pinin një diktator fashist të plotfuqishëm dhe të rehabilitojë Liu Shao Çinë.

Në këto manovrime reaksionare ka nga ata në Kinë, por edhe jashtë, që bëjnë krahasimin e luftës së Ten Hsiao Pinit kundër Maos që nuk ka qenë kurrë marksist-leninist, me krimin e Hrushovit që i hodhi baltë Stalinit, i cili ishte dhe mbetet një marksist-leninist i madh. Asnjëri, me sadopak mend në kokë, nuk mund ta pranojë një analogji të tillë.

Krahasimi më i drejtë që mund të bëhet është ai që Brezhnjevi dhe grupi i tij revizionist rrëzoi Hrushovin dhe tash Brezhnjevi kinez, Ten Hsiao Pini, po rrëzon nga piedestali Hrushovin kinez, Mao Ce Dunin.

E tërë kjo është një lojë revizioniste, është një luftë

për pushtet personal. Kështu ka qenë kurdoherë në Kinë. Asgjë marksiste s'ka në këtë mes. Këtë situatë do ta ndreqë vetëm klasa punëtore kineze dhe një parti e vërtetë marksiste-leniniste e spastruar nga maocedunideja, nga tenhsiaopinideja dhe nga idera të tjera të tilla antimarksiste, revizioniste, borgjeze.

**Janë idetë e Marksit, të Engelsit, të Leninit dhe të Stalinit që mund ta shpëtojnë Kinën nga kjo gjendje nëpërmjet një revolucioni të vërtetë proletar.**

## RRËMUJË E MADHE DREJT SË DJATHTËS EKSTREME

Evenimentet në Kinë po precipitohen. Po shtohen dacibaot, po përgatitet një puç i ri ose një rrëmujë e madhe, siç ka predikuar Mao Ce Duni, rrëmujë drejt së djathtës ekstreme.

Autorët e dacibaove janë njerëzit e Ten Hsiao Pinit, pra grupi fashist i tij. Çdo gjë aktualisht ka hyrë në diskutim, bile, sipas njoftimeve të agjencive të ndryshme të lajmeve, kinezët që lexojnë dacibaot në sheshin Tien An Men dhe në rrugët kryesore të Pekinit, diskutojnë jo vetëm në mes tyre, por mund të zhvillojnë bisedime rreth këtyre çështjeve edhe me korrespondentët e agjencive të lajmeve, si të Frans Presit, Rojterit etj.

Në se konsistojnë këto dacibao? **Së pari, qëllimi kryesor është të likuidojnë emrin e Maos, domethënë ato përgatitin terrenin për të vërtetuar se autori i likuidimit të grupit reaksionar të Liu Shao Çisë, Ten Hsiao Pinit, Pen Çenit etj., ka qenë Mao Ce Duni, i cili ka luajtur rolin vendimtar. Ky ka qenë në krye, prandaj duhet të demaskohet.** Natyrisht, demaskimi i tij nuk bëhet drejtpërdrejt, por tërthorazi dhe gradualisht, siç e kanë zakon kinezët. Në këtë drejtim ata vazhdojnë të punojnë, ashtu siç punoi edhe Mao Ce Duni për demaskimin e Liu Shao Çisë dhe të bandës së tij. Dy vjet të tëra, në qoftë se nuk gabohem, vazhdoi demaskimi i Liut pa ia përmendur

emrin, derisa u cilësua Hrushovi i Kinës. «Hrushovi numër një» ishte Liu, «Hrushovi numër dy» ishte Teni. Më në fund, me shpërthimin e Revolucionit Kulturor, Maoja dha urdhrin «të sulmohen shtabet» dhe kështu grupi i Liu Shao Çisë dhe i Ten Hsiao Pinit u likuidua.

Në të njëjtën mënyrë edhe Ten Hsiao Pini tash ka hapur një fushatë të madhe kundër Mao Ce Dunit, me të cilën proklamoi se ky nuk ka qenë një marksist-leninist i madh, se ka qenë një njeri, i cili ka bërë gabime që duhet të nxirren në pah. Gabimi kryesor që vihet në dukje në dacibao, është se ai është autori i të gjithë të këqijave që janë bërë në vend: ai ka rrëzuar Liu Shao Çinë e Ten Hsiao Pinit, ai e ka mbështetur «katërshen», se pa urdhrin e Mao Ce Dunit ata nuk mund të vepronin, Revolucionin Kulturor e shpërtheu dhe e drejtoi ai etj. Pra të gjitha krimet që janë bërë në kohën e këtij revolucioni, drejtpërdrejt dhe tërthorazi, ia veshin Maos, natyrisht, për ta likuiduar. Në një dacibao thuhet se Maoja ka gabuar 30 për qind, kurse 70 për qind nuk ka gabuar, ashtu siç ka thënë Mao Ce Duni dikur për Stalinin, që «Stalini ka gabuar 30 për qind e 70 për qind nuk ka gabuar». I marrshin të keqen Stalinit, renegatët që nga Mao Ce Duni e deri te diktatori fashist Ten Hsiao Pin!

**Së dyti, prapa dacibaove fshihet synimi për likuidimin e gjithë mbështetjes së Hua Kuo Fenit.** Nga dacibaot del se Mao Ce Duni ka caktuar pasardhës Ten Hsiao Pinit dhe jo Huanë. Ne, atëherë kur u tha se Maoja caktoi Hua Kuo Fenin për t'i zënë vendin, dysuam, sepse ishte një caktim jashtë çdo norme partie. Si është e mundur, mendonim, që Mao Ce Duni të caktojë se kush duhet të jetë kryetar i partisë ose kryeministër?! Tash në dacibao vihet në diskutim kjo gjë, duke thënë se «nuk ka pasur demokraci», dhe «s'është e vërtetë që Hua Kuo Feni është caktuar nga Mao Ce Duni, por ky ka pasë

caktuar Ten Hsiao Pinin». Hajde gjeje këtë kinezëri! Qëllimi i Tenit e i grupit të tij është të likuidohen nga Byroja Politike ata që ishin pro «katërshes» e që pastaj kthyen fletën e u bashkuan me Hua Kuo Fenin, domethënë Vu Tehu, Çen Hsi Lienit e Van Tun Hsini. Ky i fundit ka qenë shefi i gardës së Maos, ishte me Maon, ishte me Çian Çinin, por ia ktheu krahët Çian Çinit e u bë me Hua Kuo Fenin. Van Tun Hsini drejtonte dhe aktualisht vazhdon të drejtojë «të famshmen» Zyrë të Përgjithshme. Tash në dacibao kërkohet që ky njeri i poshtër, të cilit mund t'i vihen plot epitete të tilla, të qërohet nga Byroja Politike, bile edhe të gjykohet. Se mos ka ndonjë rëndësi Byroja Politike për Ten Hsiao Pinin! Ajo është sa për sy e faqe. Për Ten Hsiao Pinin dhe për çdo njeri tjetër që merr fuqinë në Kinë, rëndësi ka ushtria. Aktualisht, siç po duket, grupi i Ten Hsiao Pinit ka mbështetjen e ushtrisë. Këto dacibao kanë për synim marrjen plotësisht në dorë të të gjitha funksioneve nga ana e Ten Hsiao Pinit, si kryeministër po e po, por mundet edhe funksionin e kryetarit të partisë, kurse Hua Kuo Feni të kthehet andej nga erdhi, bile të mos pranohet as në Ministrinë e Brendshme, se këtë, s'ka asnjë dyshim, do të përpiqet ta mbajë Teni me njerëzit e tij. Në u realizofshin këto synime të Tenit, atëherë Huasë do t'i mbetet të shkojë në provincë ku ka qenë sekretar, në mos e futshin fare në burg.

**Mundet që të bëhet edhe ndonjë kompromis: Ten Hsiao Pini të bëhet kryeministër dhe ta ketë ky tërë fuqinë, kurse Hua Kuo Feni të mbetet kryetar i partisë dhe Jeh Çien Jini të qëndrojë si president i republikës ose më mirë një mumje në krye të republikës. I plotfuqishëm, diktator, pra një Çu En Lai i ri, do të bëhet medemos Ten Hsiao Pini, kurse Hua Kuo Feni, po të mbetet kryetar i partisë, do të ketë hapëset e kashtës. Në vendet kyç në parti, në qoftë se do të mund t'i japin**

njëfarë konsiderate së ashtuquajturës Parti Komuniste të Kinës, do të jetë grupi i Ten Hsiao Pinit. Me fjalë të tjera, Teni nuk do të drejtojë në asnjë mënyrë nëpërmjet partisë, por do të drejtojë me anë të burokracisë, me administratën, me ushtrinë dhe me Sigurimin e Shtetit. Këto do të dominojnë në të ardhmen e Kinës, në qoftë se nuk ngjet ndonjë rrëmuje tjetër që t'i ndryshojë të dhënat. Por zor që të ndryshohen të dhënat në këtë situatë që po kalon Kina.

Vetëm një dacibao, ku merret në mbrojtje Mao Ce Duni, është dukur në muret e Pekinit. Aty thuhet se «Mao Ce Duni ka qenë njeri i mirë, pse ia hedhin të gjitha të këqijat mbi kurriz?».

Në një fletë të agjencisë AFP lexova se korrespondenti i saj u bëri një pyetje kinezëve që qëndronin përpara dacibaove: «Kë doni më shumë ju?». «Ne duam Ten Hsiao Pinin» kishin bërë titur rreth një mijë veta që ishin atje. «Po Hua Kuo Feni?», — i pyeti prapë ai. «Po, e duam edhe atë, por pas Ten Hsiao Pinit» — qe përgjigja.

Pra Ten Hsiao Pini, ashtu siç bëri edhe Maoja në Revolucionin Kulturor, për të marrë fuqinë, i jep përshypjen borgjezisë së vogël se njeriu në Kinë po çlirohet dhe aktualisht rron në demokraci, se mund të flasë lirisht, mund të shkruajë lirisht, derisa fuqinë e ka ushtria dhe Sigurimi i Shtetit me Ministrinë e Brendshme, armë këto të diktaturës fashiste që janë në duart e grupit të Ten Hsiao Pinit.

Deri tash kjo pamje po duket në qiellin perandorak të Pekinit, sepse në Kinë regjimi perandorak fashist vazhdon të ekzistojë, vazhdojnë kaosi, rrëmuja dhe populli, si ato valët e oqeanit, shkon sa nga një ekstrem në tjetrin, manipulohet nga elementët e borgjezisë e të reaksionit. A do të vazhdojë kështu gjithnjë? Do të shohim. Tash fuqinë në dorë e ka reaksioni.

## REHABILITIMI I GJITHË REAKSIONIT TË ZI

Në Kinë situata vazhdon të jetë e turbullt, vazhdon të turbullohet «që të qartësohet», — siç ka thënë Maoja, — por, në të vërtetë, që të mos qartësohet kurrë. Në fakt lufta në mes fraksioneve të ndryshme është e vazhdueshme, herë ngrihet e herë ulet dhe askush nuk mund të përcaktojë me saktësi se çfarë po ngjet konkretisht në Kinën e Mao Ce Dunit. Ajo që të gjithë e përcaktojnë saktë është se atje ka luftë për pushtet midis klanesh rivale, kush e kush të dominojë pushtetin dhe Partinë e ashtuquajtur Komuniste të Kinës.

Siç e kam theksuar edhe në shënime të tjera të mëparshme, janë pikërisht këto rryma të ndryshme, pjella të politikës antimarksiste që kanë zhvilluar tërë kohën Partia Komuniste e Kinës dhe Mao Ce Duni, që e shkaktojnë këtë gjendje aktuale kaotike në Kinë. Në kohën e Mao Ce Dunit dhe të Çu En Lait kaotizmi në politikë, në ekonomi dhe në sektorë të tjerë ekzistonte, por duhet thënë se Mao Ce Duni që drejtonte ushtrinë, dhe bashkëpunëtori i tij i ngushtë Çu En Lai, i cili drejtonte ekonominë, kishin vendosur mbi pushtetin kinez një diktaturë jomarksiste, diktaturë të klanit personal, dhe i kishin dhënë kësaj ngjyrën e diktaturës së proletariatit. Në fakt, në kohën e Mao Ce Dunit e të Çu En Lait atje as nuk mund të bëhej fjalë për diktaturën e proletariatit. Kjo u vërtetua gjatë periudhës kur ata ende nuk

ishin të plotfuqishëm në Kinë, pra edhe kur kjo u çlirua dhe u vendos gjoja demokracia e re, edhe në kohën e Revolucionit Kulturor. Por pas vdekjes së tyre, kjo «diktaturë e proletariatit» në Kinë, siç e quanin ata, ky autoritet i vendosur në këto forma, me këtë ideologji, në këtë gjendje kaotike mendimi e veprimi, u venit dhe shpërtheu lufta për pushtet, kush e kush të rrëmbente thelën më të madhe.

Aktualisht, siç po duket, rivalitetet janë koncentruar në dy pole, në polin e Hua Kuo Fenit dhe në polin e Ten Hsiao Pinit. Tash këto dy pole të kundërta po luftojnë ndërmjet tyre. Natyrisht, bëhet një luftë speciale kineze, me batica e me zbatice, të shkaktuara nga grumbullime fraksionesh të ndryshme, që militojnë në të dy klanet kryesore.

Në përgjithësi mund të thuhet se të dy klanet kryesore synojnë një objektiv të përbashkët: ta kthejnë sa më shpejt Kinën në një vend kapitalist imperialist, në një fuqi të madhe. Prandaj të dy klanet janë në ethe prej kali për realizimin e dy qëllimeve, që janë: njëri — «katër modernizimet» dhe tjetri — kush duhet të paraqitet, si udhëheqësi frymëzues i këtyre «modernizimeve», kush është lidërshipi i kësaj politike të re që do ta çojë vendin drejt një fuqie imperialiste të madhe botërore, klan i Ten Hsiao Pinit apo ai i Hua Kuo Fenit?! Kjo luftë ka anën e përbashkët, njëkohësisht ka edhe karakteristika të veçanta. E përbashkëta është se as njëri, as tjetri klan, nuk e harrojnë objektivin kryesor, shndërrimin e Kinës në një fuqi të madhe. E veçanta është se nga cili klan duhet të udhëhiqet Kina gjatë periudhës për realizimin e «katër modernizimeve», cili klan do të sundojë atje, cili do të fitojë besimin e imperializmit amerikan dhe të fuqive të tjera imperialiste, kapitaliste të zhvilluara?

Si mund të gjykohet rreth këtyre problemeve?

Natyrish, pozitat janë të qarta: në pushtet, në udhëheqje, mund të themi se superior është Hua Kuo Feni, i cili është edhe kryetar i partisë, edhe kryeministër, kurse Ten Hsiao Pini vjen në plan të dytë. Por një gjë e tillë është vetëm në sipërfaqe. Për arritjen e objektivave që përmendëm më lart, çështja se kush e ka në dorë ushtrinë në Kinë ka rëndësi të madhe, por për ne është e pamundur të përcaktohet drejt se kush e ka atë në dorë. Ushtrinë mund ta ketë në dorë Hua Kuo Feni ose mund edhe të mos e ketë ai, por Ten Hsiao Pini. Hua Kuo Feni, si rregull, është komandant i përgjithshëm i ushtrisë, por varet shumë me kë janë shefat e ndryshëm ose «zotërit e luftës», siç i quanin më përpara, dhe që aktualisht e ruajnë këtë karakter në ushtrinë kineze. Pra, ka rëndësi se nën vartësinë e kujt është shumica dërrmuese e këtyre njerëzve në ushtri. Këtë gjë, siç e vura në dukje, nuk mund ta dimë dhe ta përcaktojmë drejt ne, por edhe sikur ta përcaktojmë dhe të themi se Hua Kuo Feni është ai që ka shumicën e tyre në dorë, përsëri duhet mbajtur parasysh fakti që ushtria kineze është një ushtri me karakter kaotik, e paorganizuar, që nuk i përngjet aspak ushtrisë së një vendi socialist, për arsye se vetë Kina nuk është vend socialist. Domethënë ushtria kineze nuk është një ushtri popullore, s'është armë e diktaturës së proletariatit, sepse në Kinë nuk ekziston kjo diktaturë, por ajo, gjithashtu, nuk është as dhe një ushtri, si të thuash, e tipit të ushtrive amerikane, franceze apo japoneze, me tradita kapitaliste, ku ka organizim dhe ku është vendosur një strukturë e ndiqet një politikë e tillë ushtarake që urdhri i komandantit bën që ushtria të jetë në duart e tij si *perinde ac cadaver*.

Pra, në ushtrinë aktuale kineze nuk ekziston një situatë e tillë, atje nuk ka organizim, veçse një kaos të madh, prandaj kësaj do t'i duhet kohë që të bëhet një instrument i efektshëm në duart e një fuqie kapitaliste.

Këtu nuk është vetëm çështja e sigurimit të armatimeve, të cilat, natyrish, do të luajnë një rol të madh, por edhe problemi i frymës së disiplinës ushtarake, borgjezo-kapitaliste, imperialiste, që duhet të vendoset në një ushtri ku nuk ka ekzistuar kurrfarë discipline, pale disiplinë proletare. Pra, të themi që në Kinë «zotërit e luftës» bëjnë qind për qind ligjin në ushtrinë e tyre, mund dhe të gabohemi, por dhe që këta «zotër të luftës» të jenë plotësisht të bindur dhe të nënshtruar ndaj Ten Hsiao Pinit, përsëri edhe kjo do të jetë *hasardé*. Pastaj mund të ndodhin edhe ndryshime që disa «zotër» të kalojnë nga Ten Hsiao Pini te Hua Kuo Feni ose në të kundërtën. Sidoqoftë, Hua Kuo Feni ka njerëzit e vet, sikundër edhe Ten Hsiao Pini ka të vetët në ushtri.

Pra, fuqia kryesore, që bën ligjin aktualisht në Kinë, është në lëvizje. Atje ekziston një gjendje kaotike dhe luftohet me synimin që të krijohen bërthamat e një pushteti të shëndoshë të një ose të dy klaneve. Nuk mund të themi se klani i Hua Kuo Fenit nuk dominon tash në Kinë, ashtu si nuk mund të themi që nuk dominon klani i Ten Hsiao Pinit. Por fakt është se në Kinë ekziston një situatë amullie, një situatë përpjekjesh për pushtet, siç e kam thënë edhe në shkrime të mëparshme.

Është e vërtetë që Hua Kuo Feni e likuidoi «katërshen», domethënë nuk u mbështet te të katër figurat, të cilat ishin kreatyrat e Mao Ce Dunit, siç ishte edhe Ten Hsiao Pini. Çështja qëndron në atë që Hua Kuo Feni u propagandua si pasardhësi i Maos dhe i caktuar nga vetë ky në postin e kryetarit të partisë. Domethënë tash Huaja synon që gjithë opinionin pro Maos në Kinë të jetë ose të bëhet mbështetës i Hua Kuo Fenit, pa «katërshen». Natyrish, kjo mbështetje e tij nën flamurin e Mao Ce Dunit do të thotë që Huaja të adoptojë politikën e hartuar nga Çu En Lai dhe të aprovuar nga Mao Ce Duni, domethënë orientimin politik për marrëdhëniet e Kinës

me botën e jashtme, për aleancat e saj me shtetet kapitalisto-imperialiste dhe për zhvillimin e ekonomisë. Duhet thënë se Hua Kuo Feni, në përpjekjet për të adoptuar këtë program, kishte parasysh edhe mentalitetin e gjithë kësaj Kine të madhe të frymëzuar nga idetë kaotike të Mao Ce Dunit. Edhe Hua Kuo Feni, pas marrjes së fuqisë, për njëfarë kohe eci me «katërshen», kështu që Ten Hsiao Pini u likuidua edhe nga ky. Mirëpo, më pas, Hua Kuo Fenit iu desh të likuidonte edhe «katërshen», për arsye se edhe ajo po përgatiste puç në Kinë. (Gjatë kësaj kohe Ten Hsiao Pini grumbulloi forcat dhe doli në sheshin Tien An Men, ku u godit.)

Më pas, siç e dimë, në Kinë u krijuan situata të tilla që Ten Hsiao Pini rierdhi në fuqi. Natyrisht, ardhja e këtij në fuqi solli situata të reja. Në këtë kohë për Hua Kuo Fenin nuk kishte më vlerë një ardhje kaq e bujshme në fuqi e Ten Hsiao Pinit. Nga ana tjetër Revolucionit Kulturor i Mao Ce Dunit, si dhe veprimet për ngritjen e Hua Kuo Fenit në postin e caktuar, për Ten Hsiao Pini nuk kishin, gjithashtu, vlerë. Ky problem nuk shtruhej nga Ten Hsiao Pini dhe grupi i tij. Prandaj gjatë kësaj kohe ne asistojmë në veprime përgatitore për një luftë klanesh, e cila do të zhvillohej në vazhdim të thellimit të rigrupimeve e të reformimit të radhëve të klaneve. Kështu që brenda në Kinë nuk mund të ekzistonte veçse një rrëmujë më e madhe nga ajo që mendonte Mao Ce Duni, një rrëmujë që nuk kishte formën e Revolucionit Kulturor. Kjo, në vetvete, do të thoshte përmbysje e Revolucionit Kulturor të Maos dhe, në të njëjtën kohë, në heshtje dhe nën rrogë, shpallje e një «revolucionit tjetër kulturor» të Ten Hsiao Pinit. Domethënë kjo ishte periudha e revanshit. Në këtë periudhë punonin të dy klanet. Tek-tuk, ku më shumë e ku më pak, në Pekin e në provinca të ndryshme të Kinës filluan të merreshin masa për heqjen e kuadrove të më-

parshëm nga postet që kishin dhe zëvendësimin e tyre me të rinj. Të mëparshmit gjoja ishin përkrahës të «katërshes», kurse të rinjtë ishin ata që «katërshja» i kishte dënuar.

Gjithashtu gjatë kësaj periudhe u përgatitën dhe u konkretizuan çështje të tjera politike me rëndësi të madhe, të cilat do të zhvilloheshin në kuadrin e «katër modernizimeve». Natyrisht, paternitetin e kësaj vije, siç kam thënë, e mori Ten Hsiao Pini. Dhe menjëherë, nga të katër anët e botës u dërguan, siç dihet, delegacione politike, ushtarake e tregtare për të kërkuar kredi, për të marrë hua shtetërore dhe bankare, për të nënshkruar kontrata të majme tregtare me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me Japoninë dhe me vende të tjera kapitaliste, duke pasur për objektiv inkuadrimin e Kinës në tregun kapitalist. Në këtë drejtim u arritën mjaft rezultate, të cilat janë aq të shumta, sa që nuk mund t'i numëroj dot në këtë shkrim të shkurtër. Këto rezultate u kurorëzuan, sidomos, me Traktatin Kino-Japonez. Ky Traktat, pavarësisht se në dukje nuk është një pakt ushtarak, në fakt ka vlerën e një pakti të tillë dhe është nën patronazhin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Këtë të vërtetë e konfirmon më së miri edhe formimi në Japoni para nja pesë muajsh i «shoqërisë së miqësisë» në mes Kinës, Japonisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Përse të formohet në Japoni kjo shoqëri e këtyre «tre miqve të ngushtë»? Përgjigjja është plotësisht e qartë: «Miqtë» kanë për qëllim përgatitjen e një lufte kundër socialimperializmit sovjetik. Pikërisht për këtë luftë ndihmohet Kina, fuqizohet ajo me armatime moderne, me teknologji të re, me kredi të shumta, lidhet edhe me traktat me Japoninë.

Gjatë kësaj kohe Hua Kuo Feni, për t'i dhënë lustër vetes, u nis e shkoi në Rumani e në Beograd. Mirëpo këto vizita nuk i sollën shumë fitime udhëheqësit kinez,

për arsye se udhëheqjet e këtyre dy vendeve janë të diskredituara, revizioniste, shërbëtoresh të kapitalistëve, bile agjencitë të kapitalizmit amerikan e botëror dhe të socialimperializmit sovjetik.

Kurse Ten Hsiao Pini ndërmoi një turne aziatik. Ky, në radhë të parë, mori përsipër ratifikimin dhe nënshkrimin e Traktatit Kino-Japonez, që ishte baza e gjithë politikës së madhe kineze. Me këtë Ten Hsiao Pini doli në Kinë si një figurë e fuqishme, më e fuqishme se Hua Kuo Fenit. Ai bëri shumë vizita në një numër vendesh të Azisë që t'i siguronte këto për «miqësinë» e Kinës ndaj tyre dhe mundësisht për t'i lidhur pas qerres së saj.

Pra, Hua Kuo Fenit zgjodhi Evropën, kurse Ten Hsiao Pini Azinë, meqë politika kineze kryesisht është një politikë ksenofobe dhe hegjemoniste në botë, por veçanërisht në Azi, dhe në këtë kontinent figura dhe veprimtaria politike e Ten Hsiao Pinit kanë më rëndësi nga ajo e Hua Kuo Fenit.

Për sa u përket marrëveshjeve me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me Japoninë, me Gjermaninë Perëndimore, me një fjalë, me afaristët e me senatorët e këtyre vendeve, të gjitha këto i bën Ten Hsiao Pini si zëvendëskryeministër *de jure*, por *de facto*, si kryeministër dhe si udhëheqës kryesor i Kinës, pavarësisht se mbi kokë ka Hua Kuo Fenin.

Ky i fundit, me qëndrimet dhe me veprimet e tij, të jep përshtypjen e një Bude të vërtetë, kurse Ten Hsiao Pini paraqitet më agresiv e më i hedhur në politikë dhe në veprimtarinë konkrete. Qëllimi i veprimtarisë konkrete të Ten Hsiao Pinit është të marrë plotësisht në dorë fuqinë, pa dhënë përshtypjen se dëshiron t'u ngrejë këmbët Hua Kuo Fenit dhe grupit të tij. Këtë veprimtari ai e fillon me metodat e jashtme gjoja demokratike, të frymëzuara nga Mao Ce Duni. Dhe kjo formë e luftës për pushtet, nën maskën e demokracisë, përfaqësohet

nga dacibaot e vëna në muret e Pekinit. Njëpërmjet tyre bëhet e qartë se kush duhet rehabilituar, kush duhet dënuar, kush është kriminel e kush është njeri «i madh» në Kinë.

Dacibaot e vendosura i këndojnë himne Ten Hsiao Pinit, kurse Hua Kuo Fenit e përmendin shumë pak. Kjo formë veprimi «demokratike» u bë në një mënyrë aq skandaloze, sa që nga të gjithë u kuptua se imponohej nga grupi i Ten Hsiao Pinit, i cili, në vend që ta mbronte ngjitjen e Hua Kuo Fenit, po e dëmtonte. Ishte shumë e qartë: Bëhej një luftë joparimore ose, më mirë të themi, luftë fraksionesh. Atëherë u përdor taktika që midis dacibaove, që këndonin hosana për Ten Hsiao Pinin, të vihej edhe ndonjë dacibao e humbur për Hua Kuo Fenin. Në këto dacibao (natyrisht, të vëna nga grupi i Hua Kuo Fenit), u duk, gjithashtu, dënimi i ashpër i Revolucionit Kulturor dhe i gjithë atyre që morën pjesë në këtë «revolucion», veçanërisht kundër kryesorëve, të cilët u likuiduan.

Kështu, grupi i Ten Hsiao Pinit dhe ai i Hua Kuo Fenit filluan sulmet e maskuara, por kuptohej haptazi që ato drejtoheshin kundër Mao Ce Dunit. Domethënë në Kinë po zhvillohej një luftë sistematike e grupit të Hua Kuo Fenit dhe të Ten Hsiao Pinit kundër Revolucionit Kulturor, kundër së ashtuquajturës katërshe, pra, kundër përkrahësve kryesorë të këtij «revolucion», por edhe përkrahësve të tjerë, si dhe kundër udhëheqësit e frymëzuesit të tij, Mao Ce Dunit. Njëkohësisht në këtë luftë goditej edhe Hua Kuo Fenit, sepse ai për njëfarë kohe, siç e vura në dukje, mbështeti veprimtarinë e Revolucionit Kulturor, vazhdoi bashkëpunimin me «katërshen» dhe e demaskoi Ten Hsiao Pinin si revizionist, duke e shkarkuar nga të gjitha funksionet. Pra, kjo veprimtari, si dhe goditja që iu bë demonstruesve e për-

krahësve të Ten Hsiao Pinit në prill 1976, në sheshin Tien An Men, ishte e lidhur me këta persona: Mao Ce Dun, Hua Kuo Fen dhe «katërshe».

Në këto situata, Ten Hsiao Pini po merr revanshin. Hua Kuo Feni me gjithë pozat e «Budës» e ndien se po i hyn ujët nën rrogoz, po kjo nuk do të thotë dorëzim nga ana e tij. Aktualisht vihet re se Hua Kuo Feni përpigjet të mbajë afër një pjesë të atyre anëtarëve të Byrosë Politike, të cilët janë implikuar në veprimtarinë kundër Ten Hsiao Pinit, dhe gjithë opinionin që përkrah sentimentalisht ose me bindje Mao Ce Dunin, duke thënë: «Mao Ce Duni nuk ka gabuar. Çdo gjë që ka bërë, ai e ka bërë mirë». Kjo është një armë me rëndësi në duart e Hua Kuo Fenit, por Ten Hsiao Pini nga ana e tij, me situatën që krijoi dhe që e ushqen vazhdimisht, po merr masa drakoniane në ushtri, në Byronë Politike dhe kudo.

Me fjalë të tjera, aktualisht, ne asistojmë në një periudhë kur në Kinë po bëhet rehabilitimi i gjithë reaksionit të zi, të dënuar nga Revolucioni Kulturor ose edhe para tij. Pra, të gjithë elementët reaksionarë po rehabilitohen dhe po vendosen në postet që ata kanë pasur në kohën kur u pushuan, u dënuan ose u persekutuan. Shkurt, kjo është elita e Ten Hsiao Pinit, tek e cila ky element borgjez, kapitalist, reaksionar, monarkist kërkon të mbështetet e me të të krijojë atë pushtet në udhëheqje e në ushtri që të stabilizojë gjendjen dhe të likuidojë përfundimisht kundërshtarët e vet, radikalë, por edhe Hua Kuo Fenin.

Tash për tash duket që grupi i Ten Hsiao Pinit heziton të marshojë me të katra drejt një lufte civile ose likuidimit të Hua Kuo Fenit, për arsye se do të shtohen turbullirat e mëdha që ekzistojnë në Kinë. Veçse këto turbullira as tash, as në të ardhmen nuk do t'u pëlqejnë imperializmit amerikan dhe kapitalizmit botëror, që kanë hyrë në tratativa të thella ideologjike, politike, ekono-

mike dhe ushtarake me Kinën. Reaksioni botëror, që e mbështet Kinën, dëshiron që atje të vendoset rregulli dhe disiplina e fortë kapitaliste, me fjalë të tjera, disiplina fashiste, dhe jo të ekzistojë një gjendje kaotike, e cila vë në rrezik të ardhmen e ndihmës që Kina i jep reaksionit botëror dhe anasjelltas, të ndihmës që reaksioni botëror i jep asaj.

Prandaj, në këto situata, ne shohim që Ten Hsiao Pini deklaron se «nuk dëshiron» të bëhet kurrë kryeministër, se Hua Kuo Feni «është një udhëheqës i shquar i partisë», se Mao Ce Duni «është njeri i madh», se «pa Mao Ce Dunin nuk mund të kishte Kinë» e të tjera, e të tjera dëngla të tilla si këto, për të cilat Hua Kuo Feni s'ka asnjë fije besimi. Por kjo është një taktikë e përkohshme e Tenit, që do të zgjasë derisa të stabilizohet mirë situata e reaksionit në Kinë. Flas për këtë se Ten Hsiao Pini si person mund të rrojë edhe pesë-gjashtë vjet dhe pastaj duhet të zëvendësohet nga një njeri tjetër i fuqishëm dhe i përshtatshëm për ta mbajtur të grumbulluar reaksionin përpara popullit kinez, i cili, mendoj unë, në vazhdimësi do të jetë në lëvizje dhe në turbullira.

Pra, Ten Hsiao Pini po vë në zbatim parullën e tij të famshme: «Nuk ka rëndësi nëse macja është e bardhë apo e zezë, rëndësi ka që ajo të kapë minj». Për të nuk ekziston kurrfarë ideologjie ose ekziston ideologjia kapitaliste, fashiste, por jo ideologjia marksiste-leniniste.

Ne mund të themi se dhe në arenën ndërkombëtare opinioni nuk është i favorshëm për situatën në Kinë; shtetet e botës nuk janë të sigurta për gjendjen aktuale dhe për të ardhmen e Kinës. Natyrisht, reaksioni botëror dhe revizionistët modernë, me përjashtim të revizionistëve sovjetikë, të cilët janë drejtpërdrejt në luftë me imperializmin kinez, kanë frikë për fatin e investimeve të tyre në Kinë. Në këtë drejtim edhe kinezët janë prudentë. Këta përpigjen që të marrin më shumë e t'u pa-

guajnë më pak të tjerëve, por dhe ata që u japin hua kinezëve jo vetëm mendojnë dhe veprojnë për të kundërtën, pra që t'u japin sa më pak e t'u marrin sa më shumë, por shikojnë që dhe ato çka u japin atyre të jenë të sigurta, të mos u humbasin. Prandaj ecin me prudence në këto marrëdhënie me Kinën. Pastaj kjo e fundit, e ka lënë mënjane praktikën e mëparshme, të buzëqeshjes dinake, dhelparake, përlënë ndaj këtyre vendeve kapitaliste e revizioniste dhe tash, duke u treguar si partnere gjoja e barabartë me to, kërkon haptazi ndihmën e tyre të madhe. «Pa këtë ndihmë, — u thonë kinezët imperialistëve, — Kina nuk mund të arrijë objektivat që ka caktuar ose që i kanë caktuar së toku, domethënë që ajo të bëhet një fuqi e tillë e madhe imperialiste që të rezistojë, të dobësojë ose të likuidojë fuqinë imperialiste sovjetike».

Për të gjitha këto arsye udhëheqja aktuale kineze shpejton të konkretizojë sa më parë që të jetë e mundur huatë e shumta prej miliarda dollarësh nga të katër anët e botës, shpejton, gjithashtu, të blejë teknologji e armatime moderne nga kushdo qoftë. Prandaj, me qindra delegacione, të përbëra prej 50 e kusur vetash, i bien kryq e tërthor gjithë botës kapitaliste dhe konkludojnë marrëveshje të ndryshme. Kurse brenda në Kinë grupi i Ten Hsiao Pinit, duke rehabilituar gjithë borgjezinë, kërkon të zërë absolutisht të gjitha kyçet e pushtetit, të ekonomisë, të ushtrisë dhe të asaj të famshme partie «komuniste» të Mao Ce Dunit.

Dihet se pranë Komitetit Qendror ka ekzistuar Zyra e Përgjithshme, për të cilën unë kam folur. Në krye të kësaj zyre ka qenë roja e Mao Ce Dunit, i cili, natyrisht, u bashkua me Hua Kuo Fenin e me «katërshen» dhe u implikua në Revolucionin Kulturor e në përpjekjet për likuidimin e demonstratës së Tien An Menit, pra dhe në likuidimin e Ten Hsiao Pinit. Thuhet se tash ky person,

që quhet Van Tun Hsin, shkarkohet nga detyra, hiqet nga Byroja Politike, duke u akuzuar si kriminel. Në një afishe, të firmosur nga një shkrintar, kryetari Hua Kuo Fen këshillohet që në udhëheqje të Zyrës së Përgjithshme të Komitetit Qendror të caktojë një person tjetër dhe pikërisht 75-vjeçarin Jan Shan Kun. Cili është ky njeri? Ky është ish-kryetari i Zyrës së Përgjithshme në kohën e Liu Shao Çisë. Pra, nëpërmjet tij dhe kësaj Zyre, Liu Shao Çia kishte hedhur në dorë gjithë partinë, se në Kinë si në kohën e Liu Shao Çisë, ashtu edhe në kohën e Mao Ce Dunit, nuk kanë ekzistuar komitete partie. Në Partinë Komuniste të Kinës ka ekzistuar pushteti personal që zbatohet nëpërmjet kësaj Zyre të Përgjithshme dhe atij që ishte në krye të saj.

Pra, ky farë Jan Shan Kun që Revolucioni Kulturor e shkarkoi nga detyra e kryetarit të Zyrës së Përgjithshme dhe e dënoi rëndë, tash kërkohet të rivendoset në krye të kësaj Zyre. Më parë ai akuzohej se ishte agjent i sovjetikëve, se i kishte dhënë të fshehtat e Partisë Komuniste të Kinës ambasadorit të Bashkimit Sovjetik në Kinë. Këtë gjë na e kanë thënë vetë me gojën e tyre Mao Ce Duni dhe Kan Shen.

Tani hezitime ka dhe pazarllëqet bëhen. Do ta lëshojë Hua Kuo Feni nga duart e veta Zyrën e Përgjithshme të Komitetit Qendror apo jo? Do ta marrë në duart e tij këtë Zyrë Ten Hsiao Pini apo jo?

Mendimi ynë është se kjo Zyrë nuk ka shumë rëndësi. Rëndësinë asaj ia jep pushteti personal i krijuar në Kinë. Dhe që kjo Zyrë përfaqëson një parti ose një organ të një partie marksiste-leniniste, s'është e vërtetë. Zyra e Përgjithshme e Komitetit Qendror të së ashtuquajturës Parti Komuniste e Kinës është një gardë pretoriale në duart e një grupi njerëzish, e cila sundon jashtë ligjeve marksiste-leniniste në Kinë.

## KONCEPTE ANTIMARKSISTE QË MBIVLERËSOJNË FSHATARËSINË

Teoria e «katër modernizimeve» ose «revolucioni i ri» i Ten Hsiao Pinit dhe i revizionistëve kinezë, bazohet në fshatarësinë, të cilën e bën udhëheqëse kryesore të këtij revolucioni dhe të realizimit të «katër modernizimeve». Këtë e pohon gazeta «Zhenminzhibao» e 6 dhjetorit. Kjo do të thotë se konceptet e Mao Ce Dunit që «fshati zë vendin kryesor në udhëheqjen e revolucionit proletar», se «fshati të rrethojë qytetin», vazhdojnë të jenë të pranueshme në Kinë edhe nga banda e Ten Hsiao Pinit. Pra, që të dy, si Mao Ce Duni, ashtu edhe Ten Hsiao Pini ishin në një rrugë, pavarësisht se kishin kundërshtime, të cilat nuk ishin parimore, por personale për fuqinë në çështjen e ndërtimit të «socializmit» në Kinë.

Artikulli, ose komentatori i tij, sjell shembullin «e shkëlqyeshëm» të një kolektivi fshatar, që ka arritur «suksese të mrekullueshme» dhe i cilëson fshatarët si njerëz praktikë. Ai thekson se «fshatarësia e do shumë socializmin, vetëm kur e kupton se në lidhje me interesat e saj jetësorë ai është superior ndaj kapitalizmit». Në gjithë këtë artikull nuk flitet aspak për udhëheqjen e klasës punëtore ose të proletariatit dhe as që merret si shembull kjo klasë.

Artikulli vë në dukje se «banda e të katërve» dhe Lin Biaoja ishin kundër zhvillimit të Kinës, se ata shtre-

mbëronin politikën e partisë, përdornin slogane majtiste për të ulur rritjen e prodhimeve ose të të ardhurave fshatare. Mao Ce Duni personalisht, Çu En Lai dhe pastaj të tjerët, që këta i quajnë «banda e të katërve», për të vënë në dukje punën e tyre në fshat, flitnin për Taxhain etj., etj., por këto aktualisht errësohen krejtësisht dhe ripohohet se vetëm tash po zhvillohet një politikë e drejtë dhe bazale «për ndërtimin e socializmit» në Kinë, duke marrë si shembull jo më Taxhain, por Huansinë e provincës Kiansu ku, siç thotë artikulli, «është rritur shumë prodhimi dhe i jepet rëndësi e madhe ekonomisë kolektive të përparuar».

Ekonominë e Huansisë, të provincës Kiansu, gazeta «Zhenminzhibao» e jep si shembull zhvillimi jo vetëm për bujqësinë, por për të gjitha ndërmarrjet e tjera ekonomike të vendit. Sipas artikullit, duke ecur në rrugën e kësaj ndërmarrjeje fshatarësh, që është njëkohësisht ndërmarrje bujqësore dhe industriale, e ku ta di unë çfarë tjetër, do të arrihet në realizimin me sukses të «të katër modernizimeve». Por «katër modernizimet», që në të vërtetë kanë për qëllim ta kthejnë Kinën në një vend kapitalist, do ta varfërojnë fshatin dhe do të bëjnë që qytetet të mbushen me fshatarë. Pavarësisht se Kina ka një popullsi të madhe, rëndësi ajo do t'u kushtojë industrisë nxjerrëse dhe përpunuese, do t'i vërë rëndësi ndërtimit të koncerneve të mëdha, ndërmarrjeve kolosale ekonomike dhe ushtarake dhe do të ndërtojë një pushtet të fuqishëm ekonomiko-ushtarak si të Japonisë dhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës për të majmur dhe për të mbajtur në fuqi borgjezinë e re që ka ekzistuar dhe që po e mëkëmb grupi i Ten Hsiao Pinit. Të gjitha të tjerat janë përralla dhe dokrra, janë maska shumë të holla, si pëlhura e merimangës, për t'i dhënë përshtypjen botës se në Kinë gjoja vazhdohet të ndërtohet një shoqëri socialiste, natyrisht, me tipare aziatike, duke u mbështet-

tur gjoja në teorinë marksiste-leniniste, e cila, sipas udhëheqësve aktualë kinezë, është «vjetroar», ashtu siç është vjetroar edhe teoria e Mao Ce Dunit. Natyrisht, udhëheqësit e Kinës së sotme do të marrin nga kjo teori e fundit e vjetroar e që kurrë s'ka qenë marksiste-leniniste, ato tipare dhe ato drejtime që i leverdisin klikës së Hua Kuo Fenit dhe të Ten Hsiao Pinit.

E MARTË  
12 DHJETOR 1978

## PËRPJEKJE PËR NJË ALEANCË TË FORTË ME SHTETET E BASHKUARA TË AMERIKËS

Ten Hsiao Pini, mbreti i Kinës, ka marrë frenat në dhëmbë për të forcuar më tej aleancën kino-amerikane. Siç e kam theksuar, një rrugë e tillë drejt aleancës me Shtetet e Bashkuara të Amerikës u përcaktua nga takimi i Mao-Çu En Lai — Nikson-Kisinger dhe që nga ajo kohë, deri tash, është bërë një rrugë e gjatë. «Ura» e famshme e Niksonit ka arritur në Kinë, por Ten Hsiao Pini do t'ia hedhë themelet në Tien An Men. Kështu ajo do të kompletohet nga San-Franciskoja deri në qendër të Pekinit.

Në një intervistë që u ka dhënë kohët e fundit disa gazetarëve amerikanë Ten Hsiao Pini, në mes të tjerash, ka thënë: «Kina nuk është angazhuar të zhvillojë vetëm gjerësisht dhe thellësisht marrëdhëniet e saj ekonomiko-politike me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, por dëshiron që në mes saj dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës të arrihet në një aleancë të fortë». Pra, nuk është çështja vetëm për normalizimin dhe për zhvillimin e marrëdhënieve në mes dy superfuqive, por edhe për krijimin e një boshti kino-japono-amerikan, të kuptohemi, të një boshti ushtarak.

Ten Hsiao Pini, po në këtë intervistë, tha se vetëm kur të ekzistojë një aleancë midis Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Kinës, bota do të gjejë stabilitet dhe do të sigurohet paqja. Kjo rrugë, sipas tij, zgjidh edhe

çështjen e pushtimit të Tajvanit nga ana e imperializmit amerikan. Në këtë mënyrë Ten Hsiao Pini shprehu gatishtësinë e tij për të hyrë në marrëveshje me klikën e imperializmit amerikan që sundon në Tajvan për bashkimin e vendit, duke marrë parasysh sistemet e ndryshme politike që ekzistojnë në ishull dhe në Kinë. Ai siguroi se është dakord të ruhet një gjendje e veçantë për ishullin, gjë që do të thotë se Ten Hsiao Pini i pranoi amerikanët në Tajvan, ku, sipas tij, Shtetet e Bashkuara të Amerikës mund të vazhdojnë investimet dhe përpjekjet për shfrytëzimin e naftës e të pasurive të tjera.

Në intervistën e tij Ten Hsiao Pini vlerësoi, gjithashtu, rolin e rëndësishëm të klikës fashiste të Pak Çen Hisë në procesin e bashkimit të Koresë, si dhe aftësinë e trupave koreanojugore për të vepruar dhe për të sprapsur një sulm nga ana e Koresë së Veriut. Nuk ka si të flitet më qartë për unitetin e plotë të Kinës me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, derisa arrihet të braktisen të gjitha rivendikimet e mëparshme, derisa hiqet dorë nga përkrahja e politikës së Kim Ir Senit, i cili *de facto* dëshiron të ketë lidhje me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, por duke bashkuar të dy Koretë nën sundimin e tij. Për këtë qëllim «udhëheqësi i madh» korean shpresoi të Kina e Hua Kuo Fenit, kur ky shkoi për vizitë në Koreë e i dha njëfarë shprese, por, siç duket, kjo shpresë e dhënë prej Hua Kuo Fenit u venit e u shua nga Ten Hsiao Pini, siç vërtetohet nga fjalët që tha ky në lidhje me Pak Çen Hinë.

Ne kemi të dhëna se Kim Ir Seni nuk është aspak i kënaqur nga kjo politikë e kinezëve dhe ka filluar t'u buzëqeshë sovjetikëve. Mirëpo këta nuk i buzëqeshin më, po e lënë Kimin të egërsohet akoma më tepër me Kinën, pastaj të shkojë në Moskë që t'u puthë dorën Brezhnjevit me shokë. Dhe Kim Ir Seni është mjeshtër për të bërë veprime të tilla. Zaten tërë politika e tij ka

qenë një politikë me 100 flamurë, një politikë amorale që nuk mund të quhet kurrë marksiste. Edhe kapitalistët nuk veprojnë në këtë mënyrë që të ndryshojnë çdo dy-tre muaj orientimet politike të tyre.

Rëndësi ka çështja që gjithë ato fjalë bombastike për ishullin e Tajvanit, se «ky është territor i Kinës», se «ne do ta çlirojmë», se «Shtetet e Bashkuara të Amerikës duhet të largohen» etj., etj. ishin sfumatura. Ten Hsiao Pini është konsekuent në rrugën e tij. **Derisa Kina aktualisht është e lidhur, po afrohet më shumë dhe kërkon të bëjë aleancë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ç'kuptim ka që të ngulet këmbë për ishullin e Tajvanit?** Logjika e Ten Hsiao Pinit thotë që Tajvani të qëndrojë si një ishull kinez që ka statusin e tij, mban lidhje me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të cilat investojnë atje, siç investojnë edhe në Kinën kontinentale. SHBA kanë edhe një aleancë me Tajvanin, siç kanë dhe siç do të kërkojnë ta bëjnë hapur aleancën edhe me Kinën. Të gjitha këto tregojnë se çështja e Tajvanit nuk ekziston më, për arsye se nuk ekziston më as ajo politikë që e vinte Kinën gjoja socialiste në kundërshtim dhe në luftë me imperializmin amerikan. Pra, politika tradhtare dhe kapitaliste e grupit Hua Kuo Fen-Ten Hsiao Pin e tregon qartë këtë tradhti të madhe që u bëhet popullit kinez dhe botës mbarë.

**Në qoftë se Kina arrin në një aleancë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ashtu siç arriti me Japoninë, atëherë Bashkimi Sovjetik ose do të bjerë në gjunjë, ose do të provokojë luftën, e cila medoemos do të marrë ngjyrën e ndezur imperialiste dhe kjo do t'u shkaktojë mjerime të mëdha popujve.** Prandaj Partia jonë dhe gjithë popujt e botës, gjithë partitë marksiste-leniniste, gjithë njerëzit përparimtarë dhe demokratë, këtë situatë të tmerrshme që po krijojnë imperializmi amerikan, socialimperializmi sovjetik, socialimperializmi kinez dhe militarizmi japonez duhet ta luftojnë me të gjitha forcat, me të gjitha mjetet.

**Popujt janë në gjendje t'ua prishin aleancat dhe planet superfuqive e klikave kukulla.** Aktualisht ne shohim ç'po bëhet në Iran. Pavarësisht nga ç'ideologji udhëhiqen masat e gjera të popullit të Iranit, fakt është se ato janë ngritur kundër shahut, këtij mbreti feudal, xhelat dhe agjent i imperializmit amerikan. Mbrëmë një milion e gjysmë njerëz demonstruan në rrugët e Teheranit dhe të Ispahanit kundër shahut të Persisë. Ata bërtitnin: «Vdekje shahut!». Kjo gjendje ka muaj që vazhdon në Iran. Me qindra janë të vrarët dhe me mijëra të burgosurit. Në qoftë se kjo situatë do të vazhdojë edhe pak kohë, në një formë të tillë kaq *virulente*<sup>1</sup>, patjetër që shahu i Iranit do të marrë avionin e do të arratiset jashtë dhe, si rrjedhim, interesat imediatë të imperializmit amerikan në këtë vend do të dobësohen.

Me kohë do të duket se kush e shtyn këtë lëvizje popullore kundër shahut. Thonë se kjo ka ngjyrë islami-ke, por në televizor shohim që në demonstrata ngrihet grushti përpjetë. Natyrisht, atje duhet të kenë gisht edhe sovjetikët, që kanë njerëzit e tyre në Iran, por veprojnë edhe partitë e tjera demokrate, liberale etj. Sigurisht, në qoftë se do të arrihet që të rrëzohet shahu, në Iran do të krijohet një republikë «demokratike», si me thënë, megjithatë ky përsëri është një progres në rrugën e luftës çlirimtare të popullit të Iranit, në qoftë se nuk do të jetë një shkëndijë për të ndezur më pas një zjarr të madh në gjithë Lindjen e Mesme.

<sup>1</sup> Nga frëngjishtja — therëse.

**E MARTE**

**12 DHJETOR 1978**

## **RUMANINË NUK MUND TA SHPËTOJË AS KINA, AS TITOJA, AS FANFANI**

Këtë javën e fundit, apo nja 13 ditë më parë, s'ka rëndësi data, u mbajt mbledhja e Traktatit të Varshavës, natyrisht e kërkuar dhe e udhëhequr nga revizionistët sovjetikë. Në këtë mbledhje ishin të gjithë sekretarët e parë të partive të vendeve që bëjnë pjesë në këtë Traktat, bile, në qoftë se nuk gabohe, ishin edhe kryeministrit. Rendi i ditës kishte për qëllim «unitetin» e të gjitha partive të vendeve që janë në Traktatin e Varshavës, kundër Kinës që po bëhet një kërcënim për Bashkimin Sovjetik dhe marrjen e masave të mëtejshme për forcimin e ushtrive të këtij Traktati në drejtim të armatosjes së tyre me armë më moderne dhe, kuptohet, për t'i vënë këto më fort nën komandën e shtabit madhor sovjetik.

Në këtë drejtim sovjetikët kanë pasë për qëllim t'u japin jo armë moderne të prodhimit të fundit që disponojnë për trupat e tyre, sidoqoftë ata do t'u shesin sate-litëve armë më të perfeksionuara sesa ato që disponojnë aktualisht. Natyrisht këto nuk do t'ua japin gratis, po do të paguhen nga anëtarët e Traktatit të Varshavës dhe do t'u imponohet një situatë e tillë.

Kur mbaroi mbledhja, u botua një komunikatë, e cila njoftonte se punimet u zhvilluan, mbaruan me sukses dhe në unitet të plotë. Domethënë se rendi i ditës u konsumua më së miri, pa kundërshtime. Mirëpo fakt

është se atje u dëgjuan disa zëra në kundërshtim me dëshirat e sovjetikëve ose si me thënë u dëgjua një zë, siç pretendohet, zëri i Çausheikut. Ky, që para se të kthehej në Bukuresht, e kishte përgatitur mirë terrenin që të mbante konferencën e shtypit dhe t'i raportonte Byrosë Politike të Komitetit Qendror, ose asamblesë popullore për çka nënshkroi e për çka u vendos në mbledhjen e Traktatit të Varshavës dhe cilat ishin qëndrimet e tij.

Natyrisht, kjo ishte diçka e orkestruar mirë si nga herë për t'i dhënë përshtypjen opinionit publik naiv se në gjirin e bllokut sovjetik edhe një shtet tjetër po revoltohet, kuptohet, revoltohet me fjalë, por jo me vepra dhe ky shtet është Rumania e Çausheikut. Pra, Çausheiku po pompohet si një hero antisovjetik, si një udhëheqës «i madh marksist-leninist», bashkëpunëtor i ngushtë i Titos, që bën një politikë të pavarur botërore dhe i bën karshillëk Bashkimit Sovjetik. Të gjitha gazetatat flasin për një «trimëri» të tillë rumune.

Çausheiku, përpara se të bëhej mbledhja e Traktatit të Varshavës, shkoi te Titoja. Sigurisht ky e ka këshilluar atë të mos i prishë urat me Bashkimin Sovjetik, pse mund t'ia ngrejë këmbët, siç ia ngriti Dubčekut në Çekosllovakë. Titoja njeh mirë vlerën e personalitetit të Çausheikut, vlerën e ushtrisë rumune dhe gjendjen brenda në Rumani, por Titos i intereson, nga ana tjetër, që Rumania të rezistojë disa ditë në rast sulmi nga sovjetikët për t'i dhënë kohë Jugosllavisë të përgatitë frontin në kufi të Rumanisë kundër sulmit të mundshëm të Bashkimit Sovjetik. Megjithatë, Titoja e ka këshilluar Çaushin të mos lëshojë shumë nga ato të gomarit, se mund ta pësojë, megjithatë, ruaje mendimin tënd, — i ka thënë, — se ne nuk mund të nënshkruajmë një deklaratë antikineze, për arsye se dëshirojmë që të mbajmë me Kinën marrëdhënie miqësore, marrëdhënie ekonomike etj., të cilat tashmë i kemi vendosur.

Gjithashtu Çausheiku, sipas tij, në këtë mbledhje ngriti çështjen se nuk do të mund të pranojë armatimin e mëtejshëm të ushtrisë rumune, për arsye të vështirësive të mëdha ekonomiko-financiare nëpër të cilat kalon Rumania. Kështu ai e afirmoi qenien e tij në Traktatin e Varshavës, marrjen pjesë në të dhe e konsideron këtë Traktat si një organ që është bërë dhe duhet të hyjë në veprim kur të sulmohemi nga armiq të tjerë, domethënë nga NATO-ja. Ne të ruajmë armatimet aktuale, bile të përpiqemi, — gjoja ka thënë Çausheiku, — që të çarmatosemi, kurse sipas tij në këtë mbledhje të Traktatit të Varshavës është kërkuar që të inkuadrohen në të edhe Vietnamit, edhe Kuba. Gjoja Çausheiku e disa të tjerë si Kadari dhe polonezët kanë thënë se Traktatin e Varshavës, nuk duhet ta zgjerojmë duke pranuar edhe vendet e Azisë e të Amerikës Latine. Ky ishte thelbi gjoja i kundërshtimit të Çausheikut.

Kina përnjëherë e propagandoi me bujë këtë «kundërshtim», pse aleati i saj në Ballkan, Çausheiku, iu kundërvu politikës hegjemoniste të Bashkimit Sovjetik. Mirëpo, natyrisht, Çausheiku po i ftoh me nder... dhe, pasi tha gjoja se të tilla qëndrime, siç i tregova më lart, i ka mbajtur në këtë mbledhje, ai predikoi/ruajtjen e Traktatit të Varshavës, miqësinë me Bashkimin Sovjetik e me vendet e tjera anëtare të këtij Traktati dhe tash ka filluar të flitet se Bashkimi Sovjetik do t'i japë Rumanisë armë moderne si edhe të tjerëve.

Se sa është e vërtetë rezistenca e Çausheikut, kjo është hipotetike, sa e mbështetën në mbledhje vendet e tjera qëndrimin politik të Çausheikut, Hungaria dhe Polonia, siç pretendohet, edhe kjo është përsëri një hipotezë që mund të ketë ndonjë farë baze, por kurdoherë shumë të lëkundshme, edhe kjo është e kundërta e kësaj propagande të Sovjetikët, përpara gjithë kësaj propagande dhe këtij ekzaltimi të Çausheikut, nuk bënë zë fare sikur asgjë nuk

ka ekzistuar dhe s'ekziston në mes Rumanisë dhe Traktatit të Varshavës, se çdo marrëdhënie e Rumanisë me sovjetikët ecën si në gjalpë.

Unë mendoj se vickat e Çausheikut nuk e trembin Bashkimin Sovjetik. Ky e ka në dorë Rumaninë dhe Çausheikun. Çështja e tij është insinjifikative. Natyrisht, Bashkimi Sovjetik nuk do të veprojë, mendoj unë, siç veprimi në Çekoslovakia, duke lëshuar tanket dhe avionët mbi Rumaninë, pse nuk dëshiron që të bëhet një skandal i ri në botë, por Rumaninë ai e ka krimbur brenda dhe kjo është në falimentim ekonomik, ka nevojë të madhe për lëndë të para dhe, sado kredi që ka marrë nga Gjermania Perëndimore ose nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, këto janë gëlltitur dhe duhen paguar. Prandaj Bashkimi Sovjetik e ka Rumaninë në dorë ekonomikisht, por edhe politikisht. Ai ka me dhjetëra mijë kuadro të tij brenda në Rumani që punojnë natyrisht kundër Çausheikut. Në qoftë se Bashkimi Sovjetik nuk e merr pushtetin brenda në Rumani me njerëzit e vet, kjo vjen jo se s'ia arrin dot qëllimit, por se nuk i intereson. Atij i intereson që Rumaninë ta ketë si një mjet të vetin për të intriguar poshtë e lart, siç po bëjnë edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës me Titon. Në rast të një konflikti sovjeto-jugosllav, Rumania nuk mund të bëhet një barrikadë, sado e dobët qoftë për të mbrojtur Jugosllavinë, përkundrazi ajo do të bëhet një shoshë që të lehtësojë mirë osmozën sovjeto-serbomadhe nëpërmjet Rumanisë.

Prandaj nga ana e Bashkimit Sovjetik do të vazhdohet sabotimi brenda në Rumani, sidomos i ndërmarrjeve të mëdha ekonomike, dobësimi i pushtetit, vjedhjet, grabitjet, shantazhet, korruptimi. Kështu, në qoftë se aktualisht Rumania është qind për qind e degjeneruar, shpejt ajo do të kalojë edhe dyqind për qind, edhe treqind për qind, pavarësisht se Çausheiku do të qëndrojë si një kokosh mbi pleh. Ky është dhe do të jetë kurdo-

herë fati i një udhëheqjeje të tillë antimarksiste e kapitaliste të degjeneruar.

Çausheiku nuk është veçse një pasqyrë e mbretit të vjetër rumun dhe ministrat e tij nuk janë veçse lakenj, vjedhës të pasurisë së popullit dhe në shërbim të të huajve. Rumania nuk është një vend socialist dhe atë nuk mund ta shpëtojnë as Kina, as Titoja, as Fanfani që vajti dje, për t'u bërë doktor *honoris causa* i Universitetit të Bukureshtit, dhe as ministri i financave i Uashingtonit, që ka bërë me kohë investime të mëdha në këtë vend.

E MËRKURË

13 DHJETOR 1978

## BILANC I TMERRSHËM I NJË REGJIMI KU KA SUNDUAR PUSHTETI PERSONAL

Jemi në pragun e vitit 1979, kur do të mbushen plot 30 vjet qëkurse Kina u çlirua nga zgjedha e pushtuesve japonezë dhe nga sundimi feudo-borgjez i klikës së Çan Kai Shisë.

Kjo është një periudhë relativisht e shkurtër për të ndërtuar plotësisht shoqërinë socialiste, por nuk mund të thuhet se 30 vjet janë pak për ta transformuar deri në njëfarë shkalle shoqërinë e vjetër që ekzistonte në Kinë dhe për të ndërtuar të paktën bazat e socializmit, për të mos thënë, plotësisht socializmin.

Por, kur i hedhim një sy rrugës së zhvillimit të Kinës, që nga dita e çlirimit dhe deri tash, shohim se atje janë bërë përparime shumë të vogla, ndonëse ka pasur mundësi kolosale, me të cilat një pushtet me të vërtetë proletar, po t'i shfrytëzonte si duhej, do të bënte mrekulli.

Kështu, në Bashkimin Sovjetik, pas fitores së Revolucionit Socialist të Tetorit nën udhëheqjen e Leninit dhe të Stalinit, kur u vendos pushteti i sovjetëve, pushteti i proletarietit, Partia Bolshevike që zbatonte me konsekuencë mësimet e Marksit dhe të Leninit, mundi gjatë 30 vjetëve ta transformonte vendin në një fuqi të madhe socialiste, e theksoj, **socialiste**. Nën udhëheqjen e kësaj partie populli ndërtoi një ekonomi të fuqishme dhe zhi-

lloi veçanërisht industrinë e rëndë. Ky orientim ishte shumë i drejtë, sepse historia e zhvillimit të njerëzimit dhe ecja e një shteti proletar drejt socializmit tregojnë se **duhet të mbështetesh, në radhë të parë, në ndërtimin e një industrie të fuqishme**. Kjo që një domosdoshmëri për kushtet në të cilat ndodhej Bashkimi Sovjetik, që rrezikohej e kërcënohej vazhdimisht prej armiqve të jashtëm e të brendshëm.

Gjatë kësaj periudhe u zhvillua, po ashtu, një bujqësi e përparuar socialiste kolkoziane dhe arsimi e kultura u përhapën në masë. U formuan kuadro të lartë, të mesëm dhe punëtorë shumë të specializuar, që morën në duar teknologjinë e re dhe makineri moderne. Kështu që në një periudhë gati po kaq të gjatë sa edhe në Kinë, në Bashkimin Sovjetik u bënë transformime rrënjësore për përmirësimin e jetës së njerëzve dhe këto u kryen për arsye se atje u vendos pushteti i diktaturës së proletarietit, i cili udhëhiqej nga teoria e Marksit, e Engelsit, e Leninit dhe e Stalinit.

Çështja e kohës vërtet ka rëndësi, por më shumë rëndësi ka fakti se si e shfrytëzon këtë kohë, cilat janë ato ide që e detyrojnë kohën të ecë në favor të masave të gjera punonjëse dhe cilat janë ato që e keqpërdorjnë, ose e përdorin në dëm të masave. Po të marrim faktorin kohë, në të njëjtin interval, në Bashkimin Sovjetik dhe në Kinë janë arritur rezultate jo të njëjta, shihen drejtime të kundërta në zhvillim. Ndërsa në të parin kishte një zhvillim progresist drejt ndërtimit të plotë të socializmit, në Kinë **jo vetëm që nuk duket gjëkund të ndërtohet socializmi, por konstatohet ekzistenca e një regjimi të demokracisë borgjeze që ka numëruar në vend dhe rezultatet e zhvillimit në favor të popullit janë shumë të pakta**.

Në vitin 1949, kur Kina u çlirua, atje shtrohej problemi i pushtetit, sepse lufta nacionalçlirimtare në këtë

vend, ashtu si në çdo vend tjetër, u bë për të ndryshuar situatën e mëparshme, nga regresive në një situatë të re, progresive. Këtë shndërrim, këtë ndryshim progresiv, natyrisht, do ta bënin ato klasa që luftuan, e do të udhëhiqnin ai mendim, ajo politikë dhe ajo ideologji progresiste që udhëhoqën edhe luftën. Me fjalë të tjera, ata që marrin pushtetin në dorë, të udhëhequr nga partia e tyre, në aleancë me klasat mike, i vënë detyra vetes çfarë do të bëjnë pas fitores, në ç'rrugë do të shkojnë, ç'qëllime duhet të arrijnë dhe kur duhet t'i arrijnë.

Ky është dhe duhet të jetë programi i fitimtarëve, po varet se cilët janë këta fitimtarë dhe nga ç'ideologji udhëhiqen.

Lufta nacionalçlirimtare në Kinë u udhëhoq nga Partia Komuniste e Kinës. Nga analizat që kemi bërë e vazhdojmë të bëjmë, ka dalë se në fakt ajo nuk ka qenë një parti e vërtetë marksiste-leniniste. Qoftë në politikë, qoftë në ideologji, qoftë në taktikën dhe në strategjinë e luftës, edhe në orientimet e saj për marrjen e pushtetit dhe vendosjen e diktaturës së proletariatit, ajo nuk udhëhoqej nga ideologjia marksiste-leniniste, nuk ka qenë e frymëzuar nga kjo ideologji.

**Me aq sa na kanë lejuar materialet, kemi arritur në konkluzionin se Partia Komuniste e Kinës nuk ka qenë komuniste.** Në të ka pasur elementë që e donin komunizmin, e donin revolucionin, donin, gjithashtu, teorinë e Marksit dhe të Leninit, por atje që në fillim e vazhdimisht ka ekzistuar një kaos idesh, të cilat përplaseshin dhe nuk merrnin asnjëherë një formë të përcaktuar, notonin të gjitha në ujë të ndenjtur. Me këtë dua të them që në Partinë Komuniste të Kinës nuk ka ekzistuar një krah i fortë marksist-leninist, i cili, gjatë gjithë periudhës së luftës dhe të jetës së partisë, të mund të kristalizonte në parti një vijë të drejtë, të frymëzuar nga teoria shkencore e Marksit, e Engelsit, e Leninit dhe e Stalinit,

dhe t'i bënte partitë e tjera të borgjezisë, që notonin tok me të në një lumë jo të kulluar, aleate të saj ose kundërshtare. Rruga e parë do të ishte më e mirë, por pa u konfonduar partia komuniste me partitë e tjera, siç ndodhi me Partinë Komuniste të Kinës dhe siç po ndodh edhe aktualisht me të, sepse vija e saj nuk ka ndryshuar, të «njëqind lulet» predikoheshin dhe vazhdojnë të predikohen në të ashtuquajturën Parti Komuniste të Kinës.

Por e keqja nuk qëndron vetëm këtu. Këtu është burimi i së keqes, e cila krijoi pikëpamje të gabuara lidhur me luftën nacionalçlirimtare e me udhëheqjen e saj. Pikëpamja e kësaj partie për rolin e proletariatit ishte e gabuar. Kjo ishte më tepër një parti fshatarësh, që e konsideronte fshatarësinë e prapambetur kineze si udhëheqësen kryesore të revolucionit dhe duhej t'i udhëhiqte proletariatin dhe të gjitha masat e tjera në luftë.

Duke u bazuar në pikëpamje të tilla, kjo parti, gjatë gjithë periudhës së luftës e deri në fund, ruajti taktikat e një lufte partizane, megjithëse, si parti e një vendi të madh, me një popullsi të dendur, organizoi edhe njësite luftarake të mëdha. Por këto njësite ishin të ngjashme me ushtrinë e borgjezisë, me ushtrinë e Çan Kai Shisë, dhe udhëheqësit e armatave të ndryshme të ushtrisë nacionalçlirimtare nuk kishin ose kishin fare pak ndryshim nga gjeneralët e reparteve të mëdha të ushtrisë së Çan Kai Shisë.

Të gjithë këta udhëheqës kryesorë, me Maon në krye, kishin, natyrisht, ndjenjën e theksuar të çlirimit të vendit e të marrjes së pushtetit, por ideologjia e tyre nuk ishte ideologji e klasës punëtore. Ajo ishte ideologji fshatare. Domethënë këta mendonin si udhëheqës fshatarë, të të cilët mbizotëronin dhe mbizotëroi tendenca e drejtimit personal, e pushtetit personal, domethënë atje ku vepronin armatat e mëdha, udhëheqësit e tyre ishin «zotër lufte». Dhe këta quheshin komunistë, gjoja lidheshin

me Partinë Komuniste, drejtoreshin nga shtabi i Maos, por në praktikë, në fakt, ata drejtonin sipas kokës së tyre. Ndonëse e mbaruan luftën me fitore, kokën e kishin të mbushur me lakra, bile edhe këto lakra nuk ishin të sistemuara si duhej. Ata, gjatë gjithë periudhës së pasqirimit, do të lëkundeshin sa nga njëra anë, në anën tjetër, dhe do të përpiqeshin si e si të tërhiqnin nga vetja grupe të ndryshme, pjesëtarët e të cilave i njihnin, se kishin udhëhequr luftën për interesat e tyre personalë. Interesi i përgjithshëm i së ardhmes së vendit nuk ishte kristalizuar në një qëllim të vetëm, në një objektiv të vetëm, për arsye se partia që e udhëhoqi këtë luftë nuk ishte një parti në bazë të së cilës të qëndronte uniteti marksist-leninist, as nuk udhëhiqej nga teoria e marksizëm-leninizmit, por ishte një parti, si me thënë borgjezo-kapitaliste përparimtare. Edhe format që iu dhanë asaj gjatë luftës dhe pas luftës, mbetën vetëm forma, kurse brendia vazhdoi të ishte kaotike, gjë që nxitej edhe më tepër nga propagandimi i lulëzimit të «njëqind luleve» dhe i konkurrencimit të «njëqind shkollave».

Pra, orientimi dhe qëllimi kryesor i luftës e i revolucionit ishte marrja e pushtetit. Më 1949, kur Kina u çliroi, pushtetin e morën në dorë Mao Ce Duni dhe shokët e tij, që e udhëhoqën këtë luftë. Të gjithë këta, siç e theksova më lart, quheshin komunistë dhe vepronin nën maskën e komunizmit. Ata edhe mund që besonin, deri në njëfarë shkalle, në idetë e komunizmit, por ideologjia marksiste-leniniste nuk ishte kuptuar si duhej prej tyre dhe nuk u ishte rrënjësuar në zemër, që të konkretizohej në veprime të drejta. Tek ata gjatë gjithë kohës ka dominuar një filozofi e huaj për marksizëm-leninizmin, anët përparimtare të rrymave të ndryshme filozofike të vjetra kineze, të cilat u pleksën me disa pikëpamje të shtrembëruara të marksizëm-leninizmit dhe këto u zbatuan në rrethanat e luftës e të pasluftës.

Kështu që Partia Komuniste e Kinës, me Mao Ce Dunin në krye, nuk mund të ishte kurrsesi një parti e tipit marksist-leninist dhe çështja e pushtetit dhe e rolit udhëheqës në jetën e vendit nuk mund të shtrohej drejt prej tyre, pavarësisht se ky pushtet aktualisht ishte në duart e Maos me shokë dhe dukej sikur rolin udhëheqës e luante partia, që quhej parti komuniste. Pse ngjiste kjo? Për arsye se e gjithë lufta nacionalçlirimtare në Kinë u udhëhoq nga pikëpamje fshatare, sepse vetë Maoja dhe shokët e tij predikonin që fshatarësia kineze ishte më revolucionarja, prandaj ajo duhej ta kryente dhe ta udhëhiqte revolucionin, kurse klasa punëtore duhej të ishte aleate e fshatarësisë, meqë ishte e vogël dhe e pafortuar. Fshatarësinë, sipas teorisë maoiste, e kishin formuar si klasë vuajtjet e mëdha të saj. (Sikur klasa punëtore nuk kishte vuajtur po aq, bile edhe më shumë!)

**Çështja nuk shtrohet se kush ka vuajtur më shumë, por cila klasë është më përparimtare, klasa punëtore apo fshatarësia; kush është më e vendosur ta çojë revolucionin deri në fund, klasa punëtore apo fshatarësia.** Pra, që këtej, del se kush duhej të udhëhiqte edhe luftën e se i kujt do të ishte pushteti pas lufte, i proletariatit apo i fshatarësisë. Këto probleme, që ishin kapitale, medoemos duheshin zgjidhur drejt. Por që të zgjidheshin drejt, më parë duhej të përcaktoheshin drejt, kurse një gjë e tillë jo vetëm nuk u bë, por ndodhi e kundërta: Fshatarësia kineze vazhdoi dhe vazhdon të konsiderohet si udhëheqësja kryesore në revolucion. **Pra, pushteti që u vendos në Kinë pas 1949-s nuk ishte pushteti i diktaturës së proletariatit, por një pushtet demokratiko-borgjez i udhëhequr nga një mentalitet dhe nga një ideologji fshatare e përparuar, nga një ideologji eklektike, siç e kemi përcaktuar filozofinë jomarksiste të Mao Ce Dunit.**

Çështja e revolucionit dhe e luftës së klasave edhe gjatë luftës, por sidomos pas luftës, dilte si një problem

jashtëzakonisht i madh e i vështirë, veçanërisht në një vend të madh si Kina, ku akoma edhe pas çlirimit ekzistonin feudalizmi dhe forcat e shpartalluara të borgjezisë, që vazhdonin të kishin fuqi politike dhe ekonomike. Këta, revolucioni nuk i shkatërroi dhe lufta e klasave për të likuiduar fuqinë politike dhe ekonomike të klasës feudo-borgjeze nuk u zhvillua. Kjo ndodhi sepse në krye të Partisë Komuniste të Kinës nuk ishte proletariati dhe pushteti nuk ishte i diktaturës së proletariatit. Të gjitha këto bënë që në Kinë të mos kalohej nga reformat demokratike borgjeze në platformën e ndërtimit të socializmit. Për këtë arsye Kina, që pas çlirimit e deri sot, noton në një kaos të madh politik, ideologjik dhe ekonomik. Ajo mbeti prapa në të gjitha drejtimit dhe fatkeqësia më e madhe për të ishte se u kthye 180 gradë drejt ndërtimit të një shteti borgjez kapitalist imperialist, kundër revolucionit në këtë vend dhe në botë. Këtu fajin më të madh e ka Mao Ce Duni, sepse ky, gjatë gjithë veprimtarisë së tij, u përpoq, si element i përparuar i fshatarësisë, të dominonte me pushtetin e tij personal në Kinë dhe ta udhëhiqte zhvillimin e vendit në një rrugë krejt të gabuar, ta çonte atë në rrugë kryq, të mos e lejonte rrymën progresiste të vazhdonte drejt përparimit dhe konsolidimit të pozitave revolucionare marksiste-leniniste.

Pavarësisht nga emrat dhe nga format që janë përdorur pas çlirimit, qoftë për pushtetin e republikën, qoftë për partinë, në Kinë, në realitet, nuk ka ekzistuar një program i qartë, i përcaktuar dhe i studiuar për zhvillimin e vendit dhe as mund të ekzistonte një program i tillë. Vërtet u konsiderua se revolucioni u krye, thuhej se në ballë qëndronte Partia Komuniste dhe se në Kinë u vendos demokracia e re, por në fakt në këtë vend ekzistonin në kuadrin e një «uniteti» dhe luftonin nën një flamur edhe borgjezia e madhe, edhe borgjezia e mesme, edhe fshatarësia, edhe klasa punëtore, edhe borgjezia e

vogël e qyteteve, pra të gjitha klasat e shtresat bashkë, të gjitha në një sofër dhe secila kërkonte të impononte vullnetin dhe qëllimet e veta për të ardhmen e Kinës.

Kuptohet, këto klasa ndesheshin me njëra-tjetrën, ndesheshin jo në një platformë për një kohezion dhe për ndarjen e shapit nga sheqeri, por vërtiteshin si atomet dhe përpiqeshin kush e kush të fitonte supremaci, të fitonte pushtet, të ruante avantazhe ose të krijonte avantazhe të reja dhe progresi i përgjithshëm i Kinës të konsistonte vetëm në një përmirësim të sipërfaqshëm të gjendjes moralo-politike dhe ekonomike të popullit. Kjo lejoi stanjacionin, gjë që krijoi moçalishte në ideologji, në politikë, në organizim dhe në zhvillimin e ekonomisë. Propaganda ishte e kurdisur në mënyrë të atillë që, pa ecur përpara, thuhej se po ecej përpara; pa pasur rezultate, thuhej se arriheshin rezultate të mëdha dhe, pa u udhëhequr nga një parti komuniste e vërtetë, thuhej se udhëhiqte një parti komuniste e vërtetë, trumbetohej se udhëhiqte klasa punëtore, por në realitet nuk ishte sunduese ideologjia e saj dhe nuk qe kjo klasë që udhëhiqte, por ishin, në fakt, njerëz me mentalitet borgjez përparimtar ose feudal antipunëtor.

Natyrisht, në një pushtet me një ideologji të tillë, iu vu disi rëndësi bujqësisë, fshatarësisë, por brenda 30 vjetëve, pavarësisht nga forma gjoja e kolektivizimit, fshatarët e pasur u lejuan të posedonin toka, të shfrytëzonin krahun e punës në fshat, të nxirrnin fitime; fshatarësia e mesme u lejua të dominonte mbi fshatarësinë e varfër. Brenda 30 vjetëve u duk njëfarë ndryshimi për sa i përket gjendjes ekonomike të fshatarësisë, por, kur lexojmë materiale të autorëve që janë futur në thellësi, në brendinë e Kinës, dhe kanë parë gjendjen reale të fshatarësisë së këtij vendi, konstatojmë se ky ndryshim është shumë i paktë. Pra, ka pasur një lustër propagandistike dhe përmirësimi i jetës së fshatit ka qenë diçka efemere.

Për sa i përket industrisë, kësaj i është dhënë pak rëndësi. Gjatë këtyre 30 vjetëve industria në Kinë nuk ka përparuar. Është zhvilluar më tepër industria e vogël, artizanati. Kjo nuk do të thotë se atje nuk janë ndërtuar një sërë kombinatesh, por për gjerësinë e Kinës dhe popullsinë e saj shumë të madhe kjo industri është minimale. Zhvillimi i paktë i industrisë ka bërë që Kina të mbetet shumë prapa në zhvillimin e ekonomisë. Të gjitha këto janë pasojë e politikës jo të qartë proletare të partisë dhe të Mao Ce Dunit. Ky thoshte se industria udhëheq, por baza është bujqësia, kurse në realitet industria nuk udhëhiqte, por qëndronte në bisht dhe bujqësia nuk arrinte të bëhej me të vërtetë baza e industrisë.

Në Kinë, ashtu si edhe në vende të tjera, bëheshin plane të ndryshme ekonomike pesëvjeçare, përgatiteshin programe, hartohej edhe «hopi i madh», ndërtimi i industrisë së rëndë, por në realitet Kina këtu pati disfata, të cilat u propaganduan si fitore. Mao Ce Duni dhe udhëheqja kineze nuk bënë kurrë autokritikë për të treguar shkakun pse ngjanë këto disfata. Gabimet e njëpasnjëshme në këtë drejtim u bënë mbasi kishin një bazë shumë të favorshme për t'u zhvilluar dhe nuk mund të ndreqeshin duke ëndërruar ose duke imponuar mendimin e një personi, i cili kishte krijuar një autoritet dhe një famë në Kinë, siç ishte Mao Ce Duni, kurse të tjerët duhej t'i bindeshin atij.

Po bëheshin, pra, gabime të mëdha në politikë, në ideologji, në ekonomi dhe kurdoherë dilte se vetëm Mao Ce Duni kishte të drejtë e dënoheshin persona të tjerë, kurse gabimet vazhdonin të bëheshin, të mos njiheshin dhe të mos dënoheshin. Për shembull, u dënua fraksioni i Liu Shao Çisë, i cili ishte me të vërtetë një mbështetës i flaktë i borgjezisë fshatare dhe i borgjezisë së madhe e të mesme të qytetit, kurse kongresi që vendosi këtë vijë të Liut akoma nuk është dënuar. Ky kongres nuk u dënua

kurrë nga Mao Ce Duni, ndryshe autoriteti i tij në sy të popullit kinez do të binte. Kështu, kongresi u quajt e vazhdon të quhet i drejtë dhe «me plot të drejtë», bile Ten Hsiao Pini kërkon të rehabilitojë edhe Liu Shao Çinë dhe gjithë veprën e këtij.

Pra, kjo politikë krejtësisht e gabuar, krejtësisht antimarksiste, që ka zhvilluar Mao Ce Duni, e la Kinën në kaos dhe atje u zhvilluan një varg fraksionesh. Masat e ndryshme që janë marrë kundër tyre Mao Ce Duni i ka quajtur «luftëra të mëdha». Në fakt këto nuk ishin luftëra parimore për vendosjen e vijës së drejtë marksiste-leniniste, por luftëra për pushtet personal. Mao Ce Duni kurdoherë donte t'i shkonte fjala e tij. Liu Shao Çia kërkonte të njëjtën gjë, po kështu Ten Hsiao Pini, Pin De Huaja, Kao Gani e gjithë të tjerët me radhë, pra, të gjithë këta «mbretër», të mëdhenj e të vegjël, të Kinës dominin t'u shkonte e tyrja. Dhe, që t'ia arrinin qëllimit, të tërë ngrinin lart flamurin e Mao Ce Dunit, flamur i cili ishte si thika me dy presa: Nga njëra anë ngrihej kulti i Maos dhe kudo forcoheshin pozitrat e tij të gabuara, ide të gabuara, veprime të gabuara, dhe, nga ana tjetër, favorizoheshin deri në njëfarë mase personat e tjerë, si: Liu Shao Çinë, Pin De Huanë, Ten Hsiao Pinin, që tentonin organizimin e puçeve për marrjen e pushtetit. Disa prej këtyre ishin për rrëzimin e Mao Ce Dunit, të tjerë për mbajtjen e tij, për ta pasur si kukull në kolltuk, që vetëm të ëndërronte e të bënte llogje, duke treguar përralla e poezi të mbretërve, mbretëreshave e princërve e duke i interpretuar këto me një gjuhë filozofike, për t'i paraqitur gjoja si rrjedhim të zhvillimit historik materialist të Kinës.

Si u konkretizuan të gjitha këto? Në fushën politike, në përgjithësi, në botë Kina mori famën e një vendi socialist, Partia Komuniste e Kinës si një parti komuniste dhe Mao Ce Duni si marksist-leninist. Imperializmi amerikan e kapitalizmi botëror menduan se po ngrihej një

fuqi tjetër e madhe komuniste, e cila, në aleancë me Bashkimin Sovjetik, do të bëhej një rrezik i tmerrshëm për ta, prandaj në këtë situatë vepronin që rrezikun e ri, siç e konsideruan ata, ta eliminonin. Mao Ce Duni bëri lojën e aleancave. Kështu, pas çlirimit, politika e tij, që në sy të botës hiqej si marksiste-leniniste, dhe shteti i tij, si një shtet i diktaturës së proletariatit, u avitën nga Bashkimi Sovjetik për të qenë në një front me të dhe kjo për njerëzit në botë ishte e natyrshme, e do të ishte me të vërtetë e natyrshme, në rast se Kina dhe Mao Ce Duni me partinë e tij do të ishin marksistë-leninistë.

Por, megjithëse u afrua me Bashkimin Sovjetik, Mao Ce Duni as përpara, as edhe kur mori fuqinë e dërisa rronte Stalini, nuk kishte besim te Bashkimi Sovjetik, te Partia Bolshevike dhe te Stalini, por këtë mosbesim nuk e shfaqte, për arsye se do të dëmtoheshin e ardhmja politike dhe ekonomike e Kinës e zhvillimi i saj progresist. Megalomania e shtetit të madh dhe ekzistenca e një gjendjeje të dobët nga pikëpamja politike, ekonomike e ushtarake në Kinë e detyronin Maon që, pa pasur besim te Stalini, të tregojë gjoja i afërt e i bindur ndaj tij, «si nxënësi i vogël përpara mësuesit».

Pra, Mao Ce Duni gjatë kësaj kohe nuk besonte në një aleancë me Bashkimin Sovjetik. Në sipërfaqe ai avitej drejt një aleance të tillë, por në mendje bluante, në radhë të parë, të zgjaste kohën që Kina të bëhej vetë një fuqi e madhe, që, në rast se lidhej me Bashkimin Sovjetik, të kishte pozita force të njëjta me të. Nga ana e Bashkimit Sovjetik, të udhëhequr nga Stalini, nuk mendohej kështu. Afrimin me Kinën Partia Bolshevike e shihte si çështje të unitetit ideologjik, politik dhe ekonomik për fitoren e revolucionit në botë dhe për zhdukjen e kapitalizmit botëror. Pas vdekjes së Stalinit Bashkimi Sovjetik bëri kthesë në pikëpamjet politike dhe në lidhje me perspektivat e aleancave me Kinën.

Tradhtia e revizionistëve sovjetikë ndaj marksizëm-leninizmit dhe ardhja e hrushovianëve në fuqi i gëzoi shumë Mao Ce Dunin dhe shokët e tij për dy arsye:

**E para**, se parashikonin që Bashkimi Sovjetik do të tërhiqej krejtësisht nga rruga e ndërtimit të socializmit, pra do ta ndalonte kursin që kishte nisur drejt ndërtimit të plotë të socializmit në bazë të teorisë shkencore të Marksit, të Engelsit, të Leninit e të Stalinit dhe do të dobësohej nga ana ekonomike, duke iu afruar kështu qëllimit të fshehtë të kinezëve që epërsia e Bashkimit Sovjetik ndaj Kinës si fuqi e madhe të zvogëlohej.

**E dyta**, kinezët shpresuan se në situata të tilla të dobësimit dhe të rforcimit të pozitive të tyre, hrushovianët do të kishin nevojë për mbështetjen e jashtme të maoistëve. Prandaj, duke u nisur nga kjo pikëpamje, ata, natyrisht, kërkuan ndihmë nga Bashkimi Sovjetik hrushovian, të cilin tash e konsideronin si aleat pak a shumë të afërt në ideologji, por prapë të largët nga potenciali ushtarak dhe ekonomik. Mungesat në këto drejtime maoistët u përpoqën t'i plotësonin me ndihmat e Bashkimit Sovjetik dhe të tregonin në dukje një afrim shumë më të madh, të shoqëruar edhe me kërkesa më të mëdha.

Edhe hrushovianët, ndaj Kinës, bënë lojën e tyre, e afruan atë, i dhanë ndihma ekonomike, i premtuan edhe armë konvencionale, siç duket, edhe sekretin e bombës atomike. Kjo ishte një çështje kyç për fuqizimin e Kinës dhe për arritjen e barazisë së saj me Bashkimin Sovjetik hrushovian. Kështu gjatë kësaj kohe shohim një dashuri hipokrite nga të dyja anët për njëri-tjetrin. Grupi i Liu Shao Çisë paraqitej grupi më i afërt me hrushovianët, më në ujdi me të, për arsye se Liu ishte një menshevik, një kulak, një pseudosindikalist, që klasën punëtore e konsideronte si një klasë e cila duhej vetëm të punonte e të ishte nën thundër.

Gjatë kësaj kohe Mao Ce Duni shikonte se pushteti

i tij personal rrezikohej nga grupimi i fuqishëm i Liu Shao Çisë, Ten Hsiao Pinit, Çu En Lait e të tjerëve dhe u frikësua nga një izolim politik, ushtarak dhe ekonomik. Në mendjen e tij filloi hartimi i një plani për likuidimin e kësaj situate që po krijohej brenda në Kinë dhe në «aleancën» me Bashkimin Sovjetik. Çdo lidhje e nevojshme me Bashkimin Sovjetik duhej të bëhej vetëm nga Maoja, kurse të tjerët duhej t'i bindeshin atij.

Mirëpo çështjet nuk zhvilloheshin siç mendonte Mao Ce Duni. Hrushovianët vërtet kishin nevojë për mbështetjen e Kinës, për t'u lënë të kuptonin Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe botës kapitaliste se aleanca kinosovjetike po bëhej një rrezik për ta, por, nga ana tjetër, ata u treguan më të shkathët në politikën e tyre tradhtarë të «bashkekzistencës paqësore» dhe të përparimit drejt një miqësie e bashkëpunimi më të afërt me imperializmin amerikan. Me fjalë të tjera, ata, pas ardhjes në fuqi, përcaktuan politikën e tyre të brendshme, por sidomos atë të jashtme.

Një gjë e tillë për Kinën krijoi njëfarë deziluzioni, sepse kjo mendonte që aleanca duhej të kufizohej vetëm midis saj dhe Bashkimit Sovjetik e të dy bashkë të vepëronin mbi imperializmin amerikan dhe kapitalizmin botëror. Me fjalë të tjera, Kina dëshironte ta shfrytëzonte këtë afrim me Bashkimin Sovjetik për interesat e saj, por nuk i doli llogaria. Gjithashtu asaj nuk i doli as llogaria tjetër, plotësimi i kërkesave për ndihmat e mëdha ekonomike nga ana e Bashkimit Sovjetik dhe sidomos për bombën atomike. Te kjo e fundit qëndronte synimi kryesor, por bombën Kina nuk e mori dot. Atëherë në kokën e Mao Ce Dunit lindi, ose si me thënë, u ringjall, dhe u rihurua ideja e largimit të Kinës javash-javash nga Bashkimi Sovjetik.

Gjatë gjithë kësaj periudhe shohim që strategjia maoiste ndërroi drejtim: nga strategji për unitetin me

Bashkimin Sovjetik u kthye për luftë në të dy krahët: edhe kundër Bashkimit Sovjetik, edhe kundër imperia- lizmit amerikan. Natyrisht, u desh një proces i vazh- dueshëm, derisa u arrit në këto pozita. Por, siç manovroi Mao Ce Duni, manovruan edhe sovjetikët për konsolidi- min e pozitave brenda dhe për afrimin me imperializmin amerikan. Njëkohësisht ata mbështetnin në Kinë grupin e Liu Shao Çisë për të likuiduar veprimtarinë e Mao Ce Dunit, e cila, nuk ishte marksiste-leniniste, por sovjeti- kët e kuptuan mirë se ç'qëllime kishte ajo: krijimin e një Kine të madhe socialimperialiste, sikurse synonte për vete edhe Bashkimi Sovjetik. Këtij nuk i intereson- te që të kishte dy partnere kundër, prandaj punonte për t'i prerë hovin partneres së re (Kinës) që po manov- ronte të bëhej superfuqi. Kështu u zhvilluan një varg ngjarjesh dhe Mao Ce Duni një ditë u gjet i izoluar.

Izolimi i tij mund të themi se ishte i plotë. Ai s'ki- shte më fuqi as në parti, as në shtet, as në ushtri. Prandaj, duke e kthyer flamurin nga ajo anë, për të cilën shkrova më sipër, pra e autoritetit të tij, e kultit të tij të fryrë në një shkallë të lartë, Maoja filloi fushatën për likuidimin e grupit të Liu Shao Çisë. Më parë e filloi me Pin De Huanë, i cili ishte mik me Hrushovin dhe kishte kritikuar politikën e «hopit të madh» të Maos si dhe mënyrën e ecjes përpara për forcimin e ekonomisë. Mao Ce Duni kishte për qëllim ta eliminonte këtë nga ushtria dhe në vend të tij të sillte një njeri të vetin të besuar. Përfundimisht, Pinin e zëvendësoi me Lin Biaon.

Kurdoherë bëhej politikë personale në këto çështje. Para së gjithash Maoja e dinte se duhej të kishte me vete ushtrinë, se partinë dhe pushtetin, gjoja të demo- kracisë së re që krijoi, vërtet nuk i kishte në dorë, por ai e dinte se as partia, as pushteti nuk mund të vendos- nin ligjin në Kinë. Vetëm ushtria mund ta bënte një gjë të tillë. Prandaj Mao Ce Duni, pasi e likuidoi Pin De

Huanë, filloi likuidimin, gjithashtu, edhe të Liu Shao Çisë, të Ten Hsiao Pinit, të Pen Çenit, mundet edhe të Çu En Lait, dhe në kushtet e izolimit të plotë të tij shpërtheu Revolucionin Kulturor. Siç e kam theksuar edhe herë të tjera, ky nuk ishte një revolucion. Në brendi ai ishte një puç ushtarak, kurse në formë ishte ngritja e rinisë studenteske për të shkatërruar Partinë Komuniste të Kinës, atë parti që s'ishte komuniste, por që ndodhej në duart e grupit të Liu Shao Çisë dhe drejtohej prej tij.

Gjatë Revolucionit Kulturor Kina u fut akoma më thellë në një kaos politik, ideologjik, kulturor dhe u dobësua akoma më shumë ekonomikisht e ushtarakisht. Nuk dihej më se kush e bënte ligjin. Të gjithë bënë ligje, sidomos «gardistët e kuq», të cilët u lëshuan nga freri dhe sulmuan shtabet, sipas urdhrit të Maos. Kjo do të thoshte të likuidonin partinë. Ata hynë edhe në luftë me proletariatin, me fshatarët, bile edhe me ushtarët, duke krijuar një konfuzion dhe anarki, aspak në rrugën e një revolucioni proletar, por as edhe të një puçi të organizuar. Gjatë gjithë kësaj kohe mbizotëroi strategjia e re, «luftë kundër Bashkimit Sovjetik dhe kundër imperializmit amerikan».

Përsëri Maoja pati *présence d'esprit*<sup>1</sup> që ruajti personin e Çu En Lait nga likuidimi, sepse ky ishte një nga pjesëtarët më kryesorë të grupit të Liu Shao Çisë dhe i qe besuar organizimi dhe drejtimi i ekonomisë. Në fakt, Çuja pak a shumë ishte figura kryesore si organizator i ekonomisë dhe i pushtetit, por në analizë të fundit del se ai nuk «shkëlqeu», sepse ekonomia e Kinës s'doli asnjëherë nga kaosi, nga varfëria dhe nga prapambetja. Për Maon, Çu En Lai ishte një person me shumë rëndësi, se në rrëmujën e madhe që u bë në atë kohë në Kinë, duhej ruajtur deri në njëfarë shkalle stabiliteti në organizimin

<sup>1</sup> Frëngjisht — shkathtësi mendimi.

e ekonomisë, në funksionimin e fabrikave, në zhvillimin e çalë të bujqësisë etj.

Kështu Çu En Lai dhe Maoja e likuiduan grupin e Liu Shao Çisë dhe të ashtuquajturën politikë të tij, të cilën nuk e kritikuan, por e aprovuan sikur ishte e Maos, dhe në fakt e këtij ishte. Ata e panë se **Revolucioni Kulturor po shkonte larg objektivave që kërkonin të arrinin, pra panë se ai nuk i sillte Kinës asnjë përfitim në strategjinë bazë që kishte vendosur Mao Ce Duni me kokën e tij «të madhe»: shndërrimin e Kinës në një fuqi të madhe imperialiste.** Atëherë menduan se duhej qetësuar ky Revolucion Kulturor dhe duhej stabilizuar gjendja që të mund të realizohej taktika e re e mëvonshme e lënies mënjanë të strategjisë kundër Bashkimit Sovjetik, kundër imperializmit amerikan dhe kapitalizmit botëror, për të adoptuar një strategji të re, atë të luftës kundër Bashkimit Sovjetik dhe pro imperializmit amerikan e borgjezisë kapitaliste botërore.

Në këtë drejtim u manovrua gjatë gjithë Revolucionit Kulturor dhe Mao Ce Duni e Çu En Lai vendosën për kthesën e përshtatshme, domethënë që ta bënin Kinën një superfuqi, gjë që ka qenë ide e përhershme e tyre. Në kokën e Mao Ce Dunit e të Çu En Lait ziente mendimi se ishin larg realizimit të idesë së madhe të përjetshme për të dominuar botën dhe se politika e ndjekur deri në atë kohë ka qenë katastrofike, prandaj duheshin bërë sa më parë riparime në politikë. Dhe kështu e kthyen fytyrën gradualisht drejt Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe shteteve të tjera kapitaliste të botës. E hoqën nga rruga barrierën gjoja të pakapërcyeshme: Ose me Tajvanin dhe kundër Kinës, ose me Kinën kundër Tajvanit. Tash u përdor taktika që mund të mbyllej njëri sy për lidhje diplomatike me shtete kapitaliste të zhvilluara, duke gjetur një formulë që këto të fundit të pritnin marrëdhëniet diplomatike me Tajvanin, gjë që e bënë shumë

nga vendet kapitaliste të zhvilluara, të cilat lidhën marrëdhënie diplomatike me Kinën.

Kina filloi të zbatojë pjesën e parë të programit të saj: hapin drejt Perëndimit. Ajo u pranua në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, shkëmbeu ambasadorë me shtete të ndryshme kapitaliste etj. Kështu filluan kontaktet e para, buzëqeshjet, njohjet, lajkat, natyrisht, të matura, në fillim, por këto ishin, si me thënë, trokitje në derën e pallatit amerikan ose depërtim në livingrumet<sup>1</sup> e pallatit për t'u ngjitur në katin më të lartë, pra, për t'u lidhur me amerikanët.

Qëllimi kryesor i ndryshimit të strategjisë kineze ishte lidhja e Kinës me Shtetet e Bashkuara të Amerikës nga e cila do të zgjidheshin të gjitha problemet e tjera. Mirëpo Shtetet e Bashkuara të Amerikës qëndronin të patundura në pozitë të tyre ndaj Tajvanit dhe, pa u siguruar mirë, ato nuk e lëshonin dhe nuk mund ta lëshojnë Tajvanin. Por interesi i tyre ishte që të dobësonin kundërshtarin e vet, Bashkimin Sovjetik, duke e tërhequr Kinën nga ana e tyre dhe të mos e linin atë që ta përdorte Kinën si një forcë «aleate» kundër Shteteve të Bashkuara të Amerikës, qoftë në një luftë të re botërore, qoftë për presionet që do t'i bënte gjatë gjithë zhvillimit të kontakteve.

Në Pekin u bë takimi i fshehtë me Kisingerin dhe u ujdisen llafet. Atje vajti, gjithashtu, presidenti Nikson, që u prit nga Mao Ce Duni me një dashamirësi të jash-tëzakonshme. Ky ishte fillimi, por që premtonte se do t'i hapej porta një strategjie të re botërore ose, siç e përcaktoi Niksoni, që «do t'i sillte botës ekuilibrin dhe paqen». Në fakt Shtetet e Bashkuara të Amerikës kishin qëllimin që thashë, që Kinën ta bënin një neokoloni të tyre, sepse e dinin që ekonomia e këtij vendi ishte e

<sup>1</sup> Nga anglishtja: living-room — sallon.

dobët, përtokë, dinin etjen e Kinës për t'u bërë fuqi e madhe, dinin, gjithashtu, që armiqësia e Kinës së Mao Ce Dunit ndaj Bashkimit Sovjetik ishte e papajtueshme, natyrisht, jo për çështje ideologjike, se në këtë fushë pikëpamjet në thelb ishin të njëjta, por për sa u përket pretendimeve kufitare të njërit kundër tjetrit. Pra, të gjitha këto përbënin ato arsye thelbësore që imperializmi amerikan ia nderi dorën Kinës për ta tërhequr pranë vetes dhe këtë dorë e shtrënguan fort me të dyja duart Mao Ce Duni dhe Çu En Lai. Kështu ne pamë që të ndryshonin politika dhe strategjia kineze.

Tash Shtetet e Bashkuara të Amerikës u bënë miqesha e madhe e Kinës. Imperializmi amerikan, sipas propagandës kineze është dobësuar, është në rënie, nuk është më agresiv, kurse Bashkimi Sovjetik është një superfuqi imperialiste agresive e egër, që lufton për vendosjen e hegjemonisë botërore. Këto janë pozitë të përcaktuara aktualisht nga Kina dhe, për ta zhvilluar si duhet këtë politikë e këtë strategji, shohim një varg procesesh graduale. Kështu efektet e Revolucionit Kulturor dalngadalë filluan të zvogëloheshin dhe Mao Ce Duni nisi të luante politikën e përhershme të balancës brenda vendit. Pra, mbështeti elementët e rinj, të dalë nga ky «revolucion» grupin e «të katërve» siç e quajnë tashti Hua Kuo Feni e Ten Hsiao Pini, dhe, njëkohësisht, filloi të rehabilitonte disa elementë që i kishin likuiduar Revolucioni Kulturor dhe vetë Mao Ce Duni e, midis tyre, më të shkathtin, më aktivin, Ten Hsiao Pinin, armikun e vendosur të Revolucionit Kulturor e të grupit të të pestëve. (Kështu i duhet thënë «katërshes», se ky në fakt ishte grupi i Mao Ce Dunit.)

Pra, shohim që Ten Hsiao Pini të rehabilitohet. Kjo ishte ideja e Maos dhe e Çu En Lait, të cilët, për të realizuar planin e afrimit me imperializmin amerikan e me kapitalizmin botëror dhe që për një kohë relativisht të

shkurtër ta kthenin Kinën në një vend të madh kapitalist në botë, duhej të sillnin në fuqi njerëzit më të besuar të kësaj rruge, njerëzit më aktivë dhe armiq të elementëve që ngulnin këmbë në strategjinë kundër imperializmit amerikan.

Kështu Ten Hsiao Pini mori poste; ai u bë zëvendësi i Çu En Lait dhe, natyrisht, të dy së bashku punuan për forcimin e pozitave të tyre në ushtri. Për këtë qëllim ata kishin likuiduar që më parë Lin Biaon. Ten Hsiao Pini u bë shef i shtabit të ushtrisë dhe Jeh Çien Jini udhëhiqte ushtrinë. Kështu ushtria tash quhej se gjoja ishte në duart e Maos, por në fakt qe një vegël në duart e Çu En Lait, të Ten Hsiao Pinit dhe të Jeh Çien Jinit, kurse «katërshja», ose më mirë «pesëshja», kishte në dorë shtypin, radion, televizionin dhe asgjë tjetër. **Pra, njëri grup vepronte konkretisht, tjetri grinte fjalë.** Banda e Çu En Lait, e Ten Hsiao Pinit dhe e Jeh Çien Jinit vepronte intensivisht brenda në Kinë dhe në arenën ndërkombëtare për afrimin me borgjezinë kapitaliste të botës dhe me imperializmin amerikan.

Në Kinë ekzistonte një situatë e tillë ku dy grupe rivale përpiqeshin të merrnin fuqinë. Tash fuqinë, që po i ikte nga duart «katërshes» ose «pesëshes», kishin filluar ta merrnin Çu En Lai, Ten Hsiao Pini e të tjerë. Mao Ce Duni qëndronte edhe andej, edhe këtej, dhe nuk ishte cilësuar keq si «timonier i madh», pra «mbante timonin», por një timon që po e çonte Kinën në një oqean me dallgë, ku do të mbytej përgjithmonë.

Çu En Lai vdiq nga kanceri. Atëherë ishte momenti crucial: Do të vinte Ten Hsiao Pini në vendin e tij apo nuk do të vinte? Do të fitonte ky grup që ishte mëkëmbur apo grupi tjetër i «katërshes»? Dhe u bë ajo që u bë: «katërshja» u likuidua dhe fuqinë e mori Hua Kuo Feni, natyrisht, në mënyrë subversive e mori Ten Hsiao

Pini me ushtrinë e tij dhe Jeh Çien Jini, të cilët vendosën ato që dimë.

Për sa u përket çështjeve të politikës, gjithçka u bë e qartë. Kina u lidh me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe filloi tratativa të hapëta, pa maska, pa dorashka me të gjitha vendet borgjeze e kapitaliste, në unitet me borgjezinë reaksionare perëndimore. Ajo filloi të marrë hua të mëdha nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, nga Gjermania Perëndimore, nga Japonia, nga Franca, nga Anglia etj. Synimet e Kinës ishin që të merrte prej këtyre vendeve teknologji të përparuar, të ndërtonte një ushtri moderne, të realizonte orientimin që dha Çu En Lai sa ishte gjallë, sipas të cilit në fund të shekullit Kina duhej të arrinte nivelin e fuqive të mëdha botërore, domethënë të mos kishte më dy superfuqi në botë, por të bëheshin tri të tilla. Pas puçit kundër «katërshes» e ardhjes në fuqi të Hua Kuo Fenit, të Ten Hsiao Pinit dhe të Jeh Çien Jinit, ky plan filloi të vihej në zbatim dhe është në zhvillim të plotë.

Pra, aktualisht, shohim se janë krijuar tri pole në botë: poli amerikan, poli sovjetik dhe poli kinez. Dy pollet, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Kina, përpiqen të dobësojnë polin tjetër, Bashkimin Sovjetik. Për këtë gjë, përveç ndihmave kolosale, huave të mëdha, kthimit të saj në një vend kapitalist të udhëhequr nga një ideologji kapitaliste imperialiste, Kina adoptoi njëkohësisht edhe «teorinë», në qoftë se mund ta quajmë të tillë të «tri botëve». «Botën e tretë» ku përfshihen vendet që, në forma të ndryshme, sundohen pak a shumë nga dy superfuqitë, Kina e quan si forcën kryesore të lëvizjes drejt revolucionit dhe kjo forcë, sipas saj, duhet të ketë në udhëheqje Kinën. Këtë ajo nuk e thotë hapur, por e ka shprehur qartë derisa futi edhe veten në këtë «botë të tretë». Në këtë botë tri polesh Kina ideologjikisht vjen më e forcuar me teorinë pseudomarksiste të një aleance

të ngushtë të të gjitha vendeve të pazhvilluara me imperializmin amerikan.

Qëllimi i Kinës është që të marrë ndihma si nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ashtu edhe nga vendet e zhvilluara kapitaliste, dhe këto vende, veçanërisht ato të Evropës Perëndimore, domethënë «Evropën e Bashkuar» dhe Tregun e Përbashkët Evropian, t'i nxitë të fuqizohen, të bashkohen më ngushtë me imperializmin amerikan, tash miku i saj më i madh, sepse pa këtë nuk mund t'i bëhet ballë Bashkimit Sovjetik që gjoja kërcënon. Pra, hiqet sikur Bashkimi Sovjetik nuk ka tendenca lufte dhe hegjemonie kundër Kinës, por kundër Evropës Perëndimore. Prandaj Kina nxit bashkimin reaksionar të vendeve të Evropës Perëndimore, nxit NATO-n, fuqizimin e Tregut të Përbashkët Evropian, duke kërkuar prej tyre investime të mëdha. Marrjen e këtyre investimeve ajo e konsideron një ndihmë që u jep Kina këtyre vendeve, duke i lehtësuar nga barra e inflacionit dhe e krizës së madhe që i ka pllakosur.

Kjo aleancë, që gjoja duket si e dyfishtë, nuk është veçse një aleancë në mes Kinës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, kurse Evropa Perëndimore për Kinën është një potencial i dorës së dytë që duhet të bashkohet me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, natyrisht, edhe me Kinën, për t'i bërë ballë socialimperializmit sovjetik. Mirëpo një çështje e tillë mund të realizohet, në qoftë se Kina gjen budallenj në Evropën Perëndimore, që të luajnë qorrazi politikën e saj, domethënë edhe ta ndihmojnë Kinën, edhe të mbajnë mbi supet e tyre barrën e prangave dhe të zinxhirëve amerikanë, edhe të presin njëkohësisht marrëdhëniet ekonomike dhe politike të uljes së tensionit me Bashkimin Sovjetik. Por këtë gjë që kërkon Kina, nuk e ha «Evropa e Bashkuar», kjo dhëlpër plakë. **Edhe vetë Evropa përpiqet të bëhet një superfuqi, të shkëputet nga prangat amerikane, të bëhet një partnere**

e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, pale e Kinës po e po, dhe si partnere reaksionare të mund të bëjë një politikë të vetën përballë Bashkimit Sovjetik, përballë Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe përballë Kinës. Ja, pra, ku i ka synimet «Bashkimi Evropian», Tregu i Përbashkët dhe NATO-ja.

Kina, për ta fuqizuar më mirë aleancën antisovjetike me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, natyrisht, i drejtoi sytë, në radhë të parë, nga Japonia. Aktualisht politika kino-japoneze ka hyrë në «rrugë të mbarë» për përgatitjen e luftës së madhe botërore. Partneri kryesor në zhvillimin e industrisë, të ekonomisë dhe të ushtrisë kineze është bërë Japonia, në radhë të dytë vijnë Shtetet e Bashkuara të Amerikës, pastaj Gjermania Perëndimore e kështu me radhë.

Përveç kësaj, Kina me Japoninë u lidh edhe me një traktat, që në realitet është një marrëveshje e fshehtë ushtarake, dhe kjo u bë nën patronazhin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të cilave u leverdis një marrëveshje e tillë dhe do ta përdorin atë kundër rivalit të tyre në hegjemoni, Bashkimit Sovjetik, për dobësimin e këtij të fundit.

Kështu, duke bërë një përmbledhje, mund të themi se ardhja në fuqi e klikës reaksionare të Ten Hsiao Pinit dhe të Hua Kuo Fenit e shpejtoi ecjen e Kinës në rrugën e shndërrimit të saj në një fuqi të madhe imperialiste dhe në ndryshimin e aleancave ose në krijimin e aleancave të reja Kinë-Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Kinë-Japoni kundër Bashkimit Sovjetik. Për Kinën rëndësi ka që Evropa Perëndimore të bashkohet më ngushtë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, e ashtuquajtura botë e tretë të jetë nën ndikimin e Kinës. Por edhe sikur «bota e tretë» të jetë nën ndikimin e imperialistëve të tjerë, kjo nuk prish punë për Kinën, mjafton t'i pritët rruga depërtimit të influencës sovjetike në këto vende.

Në rivalitetet e në garë të shfrenuar me njëri-tjetrin punojnë amerikanët, kinezët, sovjetikët dhe qeveritë reaksionare kapitaliste të «Evropës së Bashkuar». Por të gjitha këto fuqi të errëta të reaksionit i bëjnë llogaritë sikur bota të jetë e ngrirë, ndërsa vetë këta, ashtu si në kohët e kaluara, para Luftës së Parë Botërore, para Luftës së Dytë Botërore, të jenë vetë zot e vetë shkop dhe të rregullojnë punët e popujve dhe të shteteve sipas qejfit dhe interesave të tyre. Ata në llogaritë dhe në veprimet që bëjnë e kanë zhdukur krejtësisht faktorin revolucion, faktorin luftë nacionalçlirimtare të popujve, kanë eliminuar kontradiktat në mes borgjezisë dhe proletariatit, në mes shteteve të varfra e shteteve të pasura, në mes popujve të një vendi dhe klikave reaksionare që sundojnë mbi këta popuj dhe të gjitha këto i kanë reduktuar në një kontradiktë. Kështu, për kinezët e vetmja kontradiktë e sotme është ajo që ekziston në mes Kinës e lidhur me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me Evropën Perëndimore, me Japoninë e me të gjitha vendet e tjera kapitaliste të zhvilluara kundër Bashkimit Sovjetik.

**Natyrisht, kjo skemë është jo vetëm krejtësisht reaksionare, por e gabuar dhe pa asnjë perspektivë. Bota po zhvillohet, popujt po zgjohen dhe po ngrihen në luftë. Sot shohim të zhvillohen ngjarje që shkojnë deri në luftë të armatosur.**

Të marrim Lindjen e Mesme, ku gjendja është mjaft e turbullt. Është e vërtetë se vendet arabe janë të ndara dhe imperializmi amerikan e socialimperializmi sovjetik po bëjnë përpjekje të mëdha që ta ruajnë këtë gjendje, por lëvizja zien dhe ajo gradualisht do të kthehet në cilësi. Ne shohim se në Iran ka dy muaj që populli proteston kundër regjimit dhe vritet nëpër rrugë, duke demonstruar kundër shahut. Regjimi i urryer i shahut, mikut të amerikanëve e të kinezëve, është në rrezik, pavarësisht se kush e mbështet. Fakt është se populli i

mjeruar është ngritur kundër shtypjes kapitaliste të jashme e të brendshme. Edhe në qoftë se kjo lëvizje nuk konkretizohet në arritjen e një republike demokratike përparimtare, prapëseprapë, siç e theksova më lart, gradualisht më vonë sasia do të kthehet në cilësi.

E njëjta gjë ndodh në vendet e Amerikës Latine e në Afrikë, ku mund të themi, gjithashtu, se nuk ka qetësi, në popull ka urrejtje kundër shtypësve e shfrytëzuesve.

Pra, po të kurdisësh aleanca në mes tri-katër poleve apo pesë fuqive të mëdha (në qoftë se mund ta konsiderojmë, dhe duhet ta konsiderojmë, edhe Japoninë një fuqi të madhe në botë), çështjet nuk do të shkojnë si në vaj dhe nuk do të zgjidhen si i duan këto. Ekzistojnë në mes tyre kontradikta të thella, të cilat do të thellohen akoma më tepër. Popujt e këtyre vendeve, lufta çlirimtare e revolucionare dhe vetë ambiciet e njërit e të tjetrit vend për dominim dhe për hegjemoni, do t'i prishin planet e imperialistëve.

Ambiciet e Kinës për t'u bërë superfuqi nuk kufizohen vetëm në fuqizimin e brendshëm të saj. Ajo ka qëllime të largëta, të dominojë botën, por aktualisht, tendenca e saj, e nxitur nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe nga shtetet evropiane, është që, mbasi të forcohet, pse të mos krijojë edhe ajo shtetet e bashkuara të Azisë ose komunitetin e bashkuar aziatik, ku të përmbledhë, natyrisht duke i zaptuar me luftë ose me diversion, Vietnamin, Korenë, Laosin, Kamboxhian, Tajlandën, Birmaninë dhe, më tej akoma, në qoftë se mund t'ia arrijë, të futet në një aleancë edhe me Indinë, siç bëri me Japoninë?!

Kështu një Kinë e madhe, me një potencial të madh njerëzor, ekonomik dhe ushtarak, mund t'u bëjë ballë të dyja superfuqive, ose të tria superfuqive të tjera, duke futur edhe Evropën brenda, pra, të bëjë ligjin raca e

verdhë mbi racën e bardhë dhe racën e zezë. Këto pikësynime kanë ekzistuar dhe ekzistojnë si tendenca politike në strategjinë socialimperialiste të Kinës.

Kina tok me Shtetet e Bashkuara të Amerikës do të përpiqen që Indinë, Birmaninë, Afganistanin dhe Pakistanin t'i kenë zona të tyre të influencës. India është një shtet i madh, i fuqishëm, me një potencial të madh njerëzor, por edhe ekonomik. Ajo mund të jetë më e zhvilluar nga Kina, pavarësisht se atje polarizimi në mes të pasurve dhe të varfërve, në mes maharaxhëve dhe pariave është më i theksuar. Ka mundësi që, në një zhvillim të ri të ardhshëm dhe me mbështetjen e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të fuqive të tjera imperialiste, si dhe të bllokut kino-japonez, të bëhet edhe India një superfuqi dhe të mbrojë borgjezinë e imperializmin nga socialimperializmi sovjetik. Me fjalë të tjera, ajo të bëhet një barrierë për të shpëtuar Lindjen e Mesme, e cila mund të kërcënohet nga socialimperializmi sovjetik.

Tash me ngjarjet që po ndodhin në Iran, shohim se sovjetikët po përpiqen të ringjallin hijen e traktatit të aleancës me këtë vend. Ata deklaruan: Në qoftë se ndokush prek Iranin me forca nga jashtë, atëherë Bashkimi Sovjetik do të ndërhyjë. Lindja e Mesme është një qendër lufte më e zjarrtë se çdo qendër tjetër, për arsye të kontradiktave të mëdha që ekzistojnë brendapërbrenda vetë shteteve arabe, shteteve arabe dhe Izraelit, shteteve arabe dhe imperializmit amerikan, shteteve arabe dhe Bashkimit Sovjetik, Bashkimit Sovjetik dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Bashkimit Sovjetik dhe Kinës.

Të gjitha këto kontradikta ekzistojnë për fushat e naftës të kësaj zone, pse kush ka energjinë, kush ka naftën, është më i fuqishëm, ai që e humbet këtë, dobësohet, por derisa e ka, do ta mbrojë me gjak dhe me luftë kundër atij që bën tentativa ta hedhë në dorë. Prandaj, në

qoftë se sovjetikët rrezikojnë botën me një luftë të tretë, ka mundësi që më parë nga çdo gjë Lindja e Mesme të jetë objektivi kryesor, se atje është nafta dhe se rezistenca atje është më e dobët.

Forcat e mëdha sovjetike brenda një kohe të shkurtër mund të pushtojnë më shpejt Iranin, Gjirin Persik, Arabinë Saudite dhe të dalin në Mesdhe, sesa të sulmojnë Evropën Perëndimore, ku do të hasin në një rezistencë shumë më të madhe e shumë më të organizuar. Në qoftë se mund të shprehemi me shifra, në Evropë ata do të gjejnë një rezistencë njëqind herë më të madhe se ç'mund të gjejnë në Lindjen e Mesme.

Kjo, mendoj unë, me pak fjalë është një pasqyrë e shkurtër e situatës ndërkombëtare. Në rast se Kina e Mao Ce Dunit do të kishte ecur në rrugën revolucionare, në rrugën marksiste-leniniste, ajo mund të luante një rol të madh pozitiv në botë. Kjo rrugë nuk është ndjekur kurrë as nga Mao Ce Duni, as nga ithtarët e tij, përkundrazi, ata kanë ecur në një rrugë borgjeze kapitaliste, gjë që u ka sjellë Kinës dhe botës shumë të këqija dhe rreziqe të mëdha për shpërthimin e një lufte të tretë botërore, këtë herë të një lufte atomike.

Gjithë imperialistët janë një murtajë e madhe për njerëzimin. Qëllimi për të cilin u shkruajt libri «Imperializmi dhe revolucioni» është të sqarohen këto situata, t'u thuhet popujve ç'mendon Partia jonë, ç'rreziqe u turren, si duhen shikuar këto probleme dhe me ç'mjete duhen zgjidhur.

## ANGLIA MBAN AKOMA TË BLOKUAR ARIN TONË TË GRABITUR NGA GJERMANIA NAZISTE

Ky është një problem i vjetër dhe procedura e kërkesës së tij nga ana jonë komisionit tripalësh, Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Francës dhe Anglisë, që u formua për të ndarë arin e grabitur në vendin tonë nga gjermanët, është një procedurë e gjatë që ekziston që në vitet e para të Çlirimit.

Ndarja e arit, natyrisht, u bë në mënyrë jo të drejtë nga ana e komisionit dhe në disfavorin tonë. Sidoqoftë, nga komisioni tripalësh, u caktuan për ne nja një mijë e dyqind kilogram ar. Por ky ar nuk na u dërgua, nuk u vu në dispozicion të shtetit shqiptar, për arsye se këtë shtet në vitet e para pas Luftës së Dytë Botërore as Shtetet e Bashkuara të Amerikës, as Anglia nuk deshën ta njihnin, por edhe Franca në atë kohë nuk kishte vendosur akoma marrëdhënie diplomatike me Qeverinë tonë që doli nga lufta. Sidoqoftë këto shtete kishin qëllime të tjera, që ky ar të mos na jepej neve.

Pikërisht në këtë kohë dy anije angleze u futën në ujërat tona, përballë Sarandës, ku u hodhën në erë nga minat që ishin vendosur prej gjermanëve në një largësi, nuk e di ekzakt, prej 2-3 miljesh. Në ato kohë ne nuk kishim as dragamina, as mjete për pastrimin e minave në ujërat tona. Nga e dinin aleatët këtë? Sigurisht mundet edhe nga jugosllavët, me të cilët ne ishim në

miqësi në ato kohë. Por interesat e jugosllavëve ishin të qartë, ata donin të kishin marrëdhënie shumë të mira me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe me shtetet e tjera fituese dhe nuk donin të digjnin jorganin për një plesht, nuk donin të interesoheshin për grabitjet që na ishin bërë dhe për të drejtat tona.

Sidoqoftë Anglia e bllokoi arin tonë. Kishte ajo të drejtë ta bllokonte a s'kishte të drejtë, kjo është çështje tjetër, por fakti është se ajo na e bllokoi arin dhe kërkoi reparacione nga ne për anijet që iu hodhën në erë dhe për nuk e di nja 50 marinarë që u vranë. Mirëpo ne nuk e pranuan një gjë të tillë, e hodhëm poshtë dhe atëherë ajo kërkoi të venim në gjyqin e Hagës.

Rregullat e këtij gjyqi ne nuk i njihnim, për këtë ne mbështeteshim te jugosllavët. Por tash Ministria jonë e Punëve të Jashtme na tregon se rregullorja e gjyqit të Hagës nuk lejon të zhvillohet një gjyq pa pëlqimin e të dyja palëve. Në rast se ne do të kishim refuzuar të venim në gjyqin e Hagës, Anglia nuk mund ta çonte çështjen në këtë gjyq, pse duhej pëlqimi i të dyja palëve për ngjarjen që ndodhi në kanalën e Korfuzit, pastaj të gjykohej kjo çështje. Mirë, ne vërtet nuk pranuan të venim, por pranuan që avokatët tanë t'i bënin gjyqit të Hagës dy pyetje: A ka të drejtë Shqipëria të ruajë ujërat e saj territoriale dhe a mban ajo përgjegjësi, në rast se anije të huaja futen pa pyetur në ujërat e saj territoriale dhe këtu u ngjet një aksident? Këto pyetje ne ia vumë këtij gjyqi. Kjo do të thotë se indirekt ne pranuan që të venim në gjyqin e Hagës.

Megjithatë gjyqi na dha neve të drejtë për sa i përket arit, por meqë hymë në të, atëherë nuk dimë se si u bë procedura dhe ai mori vendim që reparacionet që na kërkonte Anglia t'ia paguanim asaj. Ne e refuzuam, nuk e njohëm vendimin e gjyqit. Kjo ishte procedura. Prandaj ne nuk duhej të venim në gjyq.

nirë Përveç kësaj mbasi kaluan shumë vjet dhe Anglia kishte bllokuar arin tonë, Qeveria Shqiptare, nëpërmjet ambasadës sonë në Paris, hyri në marrëveshje dhe pazarllëqe me Anglinë, jo më jep kaq, jo të të jap aq. Sidoqoftë këto pazarllëqe bëheshin nëpërmjet bisedimesh gojore që s'kanë asnjë vlerë.

Mendoj se Ministria jonë e Punëve të Jashtme nuk bën studime për këto çështje. Në fjalimet tona ne duhet t'i drejtohemi Anglisë që të na zhblokojë arin dhe kështu kemi bërë. Mirëpo, kur i kërkon ministrit të Jashtëm situatën, ai jep versione, kurdoherë futje në pazarllëqe midis nesh dhe Anglisë, jo të kërkojmë kaq, jo të na japin aq, që për mua janë të papranueshme. Unë mendoj që ka një variant tjetër që na jep mundësi të mos kemi të bëjmë fare me Anglinë, po me një komision tripalësh, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Francën dhe Anglinë. Këto janë përgjegjëse për arin tonë dhe s'kanë të drejtë që ky ar të mos kthehet në Shqipëri, përkundrazi ai duhet të na kthehet dhe një procedurë të tillë me këtë komision tripalësh ne e kemi ruajtur. Janë studiuar dhe disa kërkesa të qeverisë italiane të asaj kohe, e cila donte të bëhej edhe ajo pjesëtare në këtë komision, por kjo kërkesë është hedhur poshtë. Është kërkuar nga komisioni tripalësh edhe mendimi i një specialisti gjykatës zviceran, që të përcaktonte nëse ky ar i përkiste Shqipërisë apo jo. Ky specialist dha mendim të favorshëm se kjo sasi ar duhet të kthehet në Shqipëri, por ky nuk u kthye. Edhe këtë procedurë ne e vazhduam me komisionin tripalësh.

Aktualisht ne duhet ta ruajmë këtë procedurë dhe të kërkojmë nga komisioni tripalësh që ari të na kthehet sa më parë, pse komisioni tripalësh nuk mund ta mbajë arin tonë. Në qoftë se ekzistojnë të tjera ligje që i japin të drejtë Anglisë të vërë dorë mbi këtë ar, apo ta bllokojë, Ministria jonë e Punëve të Jashtme as që i ka gërmuar dhe as që i di këto çështje. Prandaj porosita Minis-

trinë e Punëve të Jashtme që t'i shfrytëzojë këto çështje, se ndoshta ari mund të jetë depozituar në bankën e Londrës dhe atëherë Anglia në mënyrë arbitrare ka caktuar dëmshpërblimet dhe na e ka bllokuar arin e Qeverisë sonë në Londër. Mirëpo në parim ari nuk mund të jetë në dispozicion të qeverisë angleze, po në dispozicion të tri qeverive, prandaj këto të tria duhet ta kthejnë atë në vendin tonë.

Për sa u përket mosmarrëveshjeve në mes Shqipërisë dhe Anglisë, kjo është një çështje që nuk i përket komisionit tripalësh, po u përket dy vendeve tona, japim ose nuk japim ne dëmshpërblime, kjo s'ka të bëjë fare me kthimin e arit në drejtim të Shqipërisë.

Porosita, gjithashtu, që në fjalimin programatik që do të mbahet në sesionin e parë të legjislaturës së 9-të të Kuvendit Popullor, me rastin e formimit të Qeverisë, të deklarohet se ari i grabitur nga nazistët në Shqipëri duhet të na kthehet sipas vendimit të komisionit tripalësh dhe pikë.

Ministria jonë e Punëve të Jashtme nuk ka iniciativë, ajo nuk ka një plan studimi për këto probleme, jemi ne që i ngremë asaj probleme qoftë si ky i arit, qoftë problemi i dëmshpërblimeve nga Gjermania, qofshin çështjet që kemi pasur me Jugosllavinë, siç është problemi i ujërave. Shtabi i Ministrisë së Punëve të Jashtme nuk ka iniciativë. Vetë titullari i saj është i plogësht dhe i mungon kultura. Natyrisht ai ka në dikaster edhe specialistët, juristët, por këta nuk di t'i shfrytëzojë, prandaj ne vazhdimisht e nxitim në këtë drejtim dhe ai duhet të bëjë përpjekje të shumta për zgjidhjen e problemeve që ka përpara, pse Shqipëria ka marrëdhënie me botën e jashtme dhe ka shumë probleme të pazgjidhura, siç janë edhe ato me Greqinë, çështja që Greqia është në gjendje lufte me ne, çështja e kufijve, e piramidave, çështja e pasurive shqiptare në Greqi etj. Të

tëra këto probleme përbëjnë objekte të rëndësishme studimi nga ana e Ministrisë së Punëve të Jashtme që kanë lidhje me ligjet ndërkombëtare dhe me praktika ndërkombëtare. Mirëpo këto çështje ajo nuk i bën pa ia thënë ne, por edhe kur i studion, studimet i bën të çala. Kjo praktikë pune nga ana e saj duhet të marrë fund.

E SHTUNË

16 DHJETOR 1978

## KINA «U ÇLIRUA» NGA «BANDA E TË KATËRVE». PO NGA GJENDJA E SOTME KUR DO TË ÇLIROHET?

Gjendja në Kinë është e turbullt, masat punonjëse atje janë në lëvizje. Përveç dacibaove të ndryshme që po vihen nëpër mure pro Ten Hsiao Pinit, ndonjë kundër Maos, ndonjë tjetër me sulme indirekte edhe kundër Hua Kuo Fenit, shihen, gjithashtu, edhe dacibao që sulmojnë njëkohësisht si Hua Kuo Fenin edhe Ten Hsiao Pinin, në përgjithësi edhe regjimin aktual në Kinë, duke invokuar çështjen e gjendjes ekonomike jashtëzakonisht të vështirë për masat e gjera të popullit, mungesën e furnizimit me ushqime etj., etj.

Shokët e ambasadës sonë që merren me tregtinë kanë shkuar në Shanghai. Gjatë qëndrimit në këtë qytet, ata kanë parë me sytë e tyre se në mbrëmjen e datës 11 dhjetor turma prej disa mijëra njerëzish, kryesisht të rinj, drejtoheshin për në komitetin e partisë të këtij qyteti. Turma e revoltuar ishte grumbulluar para sheshit dhe kërkonte me këmbëngulje të dilnin udhëheqësit kryesorë. Demonstrata vazhdoi rreth dy orë. Ndërkohë, ndërsa demonstruesit hidhnin parulla, në muret e komitetit të partisë dhe në ndërtesat afër u vendosën dacibao. Në këto parulla e dacibao ndër të tjera thuhej:

«Qyteti i Shangait kërkon të dijë: Përse jeta e popullit shkon gjithnjë poshtë e më poshtë?».

«Kina sa u çlirua nga banda e të katërve. Po nga gjendja e sotme kur do të çlirohet?»

«Popull i Shangait, bashkohu për ta luftuar këtë gjendje! Ne kërkojmë demokraci, por së pari duam bukë, duam punë, duam shtëpi, duam të ndërtojmë familjet tona!»

«Ne jemi kundër bandës së të katërve, po, megjithëse kryetari Hua Kuo Fen dhe nënkryetari Ten Hsiao Pin duket sikur na përkrahin për zgjidhjen e problemeve tona, ata s'po bëjnë gjë», «Ç'na duhen solidarizimet, kur nuk kemi bukë, punë, shtëpi?»

«Udhëheqja lart ha e pi mirë, kurse ne po vdesim urie. Si mund ta durojmë këtë nivel të ulët jetese! Nuk jemi në gjendje ta ndryshojmë atë, prandaj duhet të bashkohemi e të luftojmë të gjithë, sepse revolta e disa familjeve nuk sjell ndryshime!», bërtiste turma.

Mbrëmja e 12 dhjetorit ishte një tragjedi. Ndërtesa e komitetit të partisë të Shangait ishte e rrethuar me policë. Nga komiteti i partisë jepej me altoparlante thirrja e Komitetit Qendror dhe e komitetit të partisë të Shangait dhe përsëritej se kërkesat e punonjësve do të zgjidheshin. Ndër të tjera, nga altoparlantet thuhej: «Shkoni nëpër shtëpitë tuaja, shkoni në punë, mos u bashkoni në revolta, problemet tuaja do t'i zgjidhim shumë shpejt. Modernizimi i vendit kërkon aktivizimin e të gjithë popullit!». Në kohën që disa nga grupet po largoheshin në mënyrë të organizuar, një turmë e madhe njerëzish, duke u drejtuar nga hyrja e komitetit të partisë, çau gardhin e policëve, bllokoi ndërtesën dhe, duke formuar një radhë njerëzish të vendosur njëri pas tjetrit, me zemërim të madh u përpoq të hiqte pllakatet metalike në hyrje të komitetit. Turma bërtiste: «Duhet të bashkohemi në revolucion! Rroftë revolucion!».

Personi që fliste në altoparlantin e komitetit të partisë, i tronditur hidhte parullat e mëparshme, duke për-

sëritur se «për zgjidhjen e kërkesave tuaja do të mbli-dhet Komiteti Qendror» e të tjera përralla. Kjo gjendje vazhdoi deri në orët e vona të natës. Nga hoteli shokët tanë dëgjuan se gjithë natën në rrugë kishte brohoritje, dëgjoheshin parullat: «Duhet revolucion! Rroftë revolucion!».

Në datën 13 dhjetor deri pasdite, kur u larguan shokët tanë nga Shanghai, para komitetit të partisë kishte vazhdimisht një qarkullim të dendur makinash dhe forcash të armatosura me ushtarë e policë. Me sa dukej pritej ndonjë demonstratë më e fuqishme. Shokët tanë i panë vetë me sytë e tyre këto ngjarje që u zhvilluan si në rrugët e qytetit afër hotelit ku ishin ata, ashtu edhe pranë komitetit të partisë që është në të njëjtën rrugë.

Kinezi që shoqëronte njerëzit tanë kësaj gjendjeje i dha një interpretim sikur gjoja po demonstronte rinia e revoltuar, që gjatë Revolucionit Kulturor qe dërguar në fshat dhe tani është kthyer e dëshiron të qëndrojë në qytet. Shumë nga të rinjtë kërkojnë t'u jepet punë, prandaj po zhvillojnë edhe demonstratën, tha shoqëruesi.

Kjo situatë në Shanghai, natyrisht, nuk është e vetmja. Në Kinë ekzistojnë papunësi dhe varfëri, tregu i zi e ka errësuar akoma më shumë gjendjen ekonomike të popullit. Ndërtimet e mëdha dhe turistët e huaj që do të vijnë me miliona në Kinë dhe që duan të ushqehen, natyrisht, do ta dobësojnë akoma më tepër gjendjen ekonomike të punonjësve kinezë, do ta demoralizojnë akoma më tepër jetën politike dhe morale të vendit.

**E HËNE**  
**18 DHJETOR 1978**

## **TYMI I BARDHË I ALEANCAVE NDËRIMPERIALISTE FSHEH RREZIQE TË MËDHA PËR NJERËZIMIN**

Më 16 tetor 1978 Kina e Hua Kuo Fenit dhe e Ten Hsiao Pinit, Kina revizioniste, tok me Shtetet e Bashkuara të Amerikës deklaruan se vendosën marrëdhënie diplomatike midis tyre. U realizua më në fund dëshira e zjarrtë e Mao Ce Dunit dhe e Çu En Lait për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike e miqësore të shumanshme me imperializmin më të egër të botës.

Natyrisht, për të arritur deri këtu u desh një kohë e gjatë, për arsye se duhej që Mao Ce Duni dhe Çu En Lai, në kohën e tyre, e më vonë Hua Kuo Feni e Ten Hsiao Pini të likuidonin të gjithë elementët që pengonin realizimin e kësaj dëshire të «timonierit të madh» Mao dhe të «kryetarit të nderuar» Çu.

Me pak fjalë, pas strategjisë së Maos, gjoja për të luftuar e për të demaskuar socialimperializmin sovjetik dhe imperializmin amerikan, u shpall Revolucioni Kulturor, u likuiduan shtabi i Liu Shao Çisë dhe gjithë partia, me tërë levat e saj, u krijua një kaos i madh në Kinë. Thonë se gjatë këtij kaosi u vranë 5 milionë veta, por kjo shifër nuk është e kontrolluar. Në këtë «revolucion» kryesori mbi kryesorët ishte vetë Mao Ce Duni. Banda e ashtuquajtur e të katërve ishte mjeti që përdori ai për ta propaganduar dhe për ta drejtuar Revolucionin Kulturor, me anën e të cilit likuidoi partinë, por jo organizmat

shtetërorë. Këta të fundit dhe ushtria u ruajtën nga Mao Ce Duni dhe nga Çu En Lai për të mbështetur Revolucionin Kulturor derisa t'ua arrinin qëllimeve të tyre të caktuara. Pastaj ata morën masa që forcat e Revolucionit Kulturor, domethënë nxënësit e studentët e paorganizuar që vepronin në rrëmujë, të ktheheshin nga kishin ardhur dhe, si me thënë, të vendosej qetësia, pse në Kinë kurrë nuk ka pasur as qetësi, as stabilitet. Por çështja është se Revolucioni Kulturor nuk favorizonte bazën politike të strategjisë së re të Mao Ce Dunit dhe të Çu En Lait, idenë e tyre të miqësisë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe me gjithë reaksionin botëror.

Prandaj gjatë fazës së rforcimit, «të stabilitetit» në Kinë, Çu En Lai ishte partizan i ruajtjes së organizmave shtetërorë ekzistues dhe jepte përshtypjen se këta organizma funksiononin me rendiment të kënaqshëm. Megjithatë, nuk ishte vetëm çështja e mbajtjes në këmbë të organizimit të dobët të Kinës në fushën administrative, shtetërore dhe ekonomike, që e preokuponte atë. Çu En Lai me njerëzit e tij manovronte që fytyra e Kinës të kthehej drejt një orientimi të ri, i cili do të shpallej më vonë. Ky ishte, si të thuash, objektivi i fshehtë i Çu En Lait. Për këtë ai kishte jo vetëm mbështetjen e Mao Ce Dunit, nën bajrakun e të cilit luftonte, por edhe mbështetjen e elementëve që udhëhoqën Revolucionin Kulturor, me të cilët bashkëjetoi gjatë gjithë Revolucionit Kulturor, që kur u fut në strofkën e tyre. Përrjashtim bënte vetëm Çen Po Taja, i cili u konsiderua si i panevojshëm në Byronë Politike dhe iu nxorën një mijë e një «argumente» (të falsifikuara a të vërteta ishin, ne asgjë nuk mund të afirmojmë për këtë), që të mos bënte pjesë në udhëheqje. Por, në udhëheqjen e Revolucionit Kulturor, elementi më i rrezikshëm për planet e ardhshme të Mao Ce Dunit dhe të Çu En Lait ishte, siç duket, Lin Biaoja, i cili udhëhiqte Ushtrinë Çlirimtare Kineze. Dihet se në

Kinë Ushtria Çlirimtare ka qenë kurdoherë ajo që bënte ligjin. Gjatë kohës së luftës apo pas luftës, ushtria, arma, dominonte mbi partinë. Gjatë Revolucionit Kulturor ushtria, të cilën e kishte në dorë Lin Biaoja, drejtpërdrejt ose tërthorazi, u bë mbështetja bazë e Mao Ce Dunit.

Gjatë kësaj kohe Lin Biaoja e ngriti në qiell në mënyrë skandaloze kultin e Mao Ce Dunit. Kjo propagandë për Maon aprovohej nga gjithë udhëheqja pa përjashtim. Orkestrimin, që e drejtonte Lin Biaoja, e mbështeste «katërshja», e reklamimin dhe e aprovonin edhe Çu En Lai dhe shokët e tij, të cilët, në të vërtetë, nuk besonin asgjë nga të gjitha këto gjëra që thuheshin për Maon, por punonin në heshtje e në konspiracion për ta likuiduar një situatë të tillë nën flamurin e vetë Mao Ce Dunit.

Përpunimi i Mao Ce Dunit bëhej nga Çu En Lai dhe ishte shumë i lehtë, për arsye se pikëpamjet e tij, si për momentin e kthesës së madhe politike, të kthesës në aleanca, në ideologji, në politikë, në ekonomi etj., puqeshin me ato të Mao Ce Dunit. Kjo shkaktoi edhe likuidimin e Lin Biaos. Me fjalë të tjera, në ushtri dolën elementë që ishin të Maos dhe të Çusë, që Revolucionin Kulturor nuk e honepsnin.

Kjo ishte kryesorja, këtu do të mbështeteshin Mao Ce Duni, Çu En Lai, Ten Hsiao Pini dhe Hua Kuo Feni.

Natyrisht, zhdukja e Lin Biaos u paraqit si në një roman policesk, rokambolesk dhe e pabesueshme në trajtat dhe në format me të cilat u shpall. Por, sidoqoftë, u likuidua pushteti i tij dhe u vendos një pushtet që favorizonte etapën e re që po përgatitej. Ishte e pamundur që kjo përgatitje të mos i binte në erë një pjese të udhëheqjes së partisë. (Me këtë nënkuptoj «katërshen».) Edhe kjo, domethënë «katërshja», vepronte në bashkëpunim me Mao Ce Dunit, i cili luante rolin e balancës midis dy

klaneve. Ai kurdoherë ishte hezitues, i lëvizshëm, i paqëndrueshëm, i pavendosur dhe i tillë mbeti derisa vdiq. Pra, Mao Ce Duni «katërshes» i kishte lënë, si të thuash, dorë të lirë të manipulonte mjetet e agjitacionit e të propagandës, të shkruante artikuj mbarë e mbrapsht, të gjithë të mbështetur gjoja në maocedunidenë dhe, nga ana tjetër, edhe Çu En Lai me shokët e tij bënë punën e tyre. Të dy grupet bashkëjetonin në divergjencja dhe në disharmoni të plotë, të dy grupet përgatitnin puçin, pse puçist ka qenë Mao Ce Duni, puçistë ishin dhe dishepujt e tij, si grupi i «katërshes» ashtu edhe ai i Çu En Lait.

Kështu, për grupin e Çu En Lait vihej detyra që kurdoherë me Maon në krye ta likuidonte grupin rival, ta hiqte atë nga rruga e Maos dhe vetë të bëhej grupi i plotfuqishëm e pastaj të zbatonte planin dhe programin e përcaktuar me kohë që para çlirimit nga Mao Ce Duni dhe Çu En Lai. Këtë program e këtë plan sekret e zbuloi shtypi amerikan, i cili kohët e fundit shkroi se në vitin 1949 Çu En Lai i kishte dërguar një letër sekrete konsullit të përgjithshëm amerikan në Pekin, me anën e së cilës kërkonte që Shtetet e Bashkuara të Amerikës ta ndihmonin Kinën pas çlirimit, sepse as idetë e Mao Ce Dunit, as ato të tijat nuk synonin ndërtimin e socializmit në Kinë, por miqësinë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Te këta të fundit do të mbështetej Kina dhe jo te Bashkimi Sovjetik i Stalinit.

Maoja po plakej, prandaj i duhej ta shpejtonte procesin e vënies së Kinës në rrugën e realizimit të dëshirës së tij të zjarrtë. Momenti kishte arritur, ishte pjekur. Pas likuidimit të Lin Biaos, u zbulua se Çu En Lai dhe Mao Ce Duni kishin hyrë me kohë në tratativa të fshehta me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Këto tratativa, siç dihet, u zhvilluan në fillim midis Çu En Lait dhe Kisingerit, pastaj zbriti në Pekin Niksoni, presidenti batak-

qi i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, i cili zhvilloi bisedime me Maon dhe me Çu En Lain, bisedime këto që përfunduan me Komunikatën e Shangait. Ç'ndodhi tjetër në këto bisedime, nuk u mor vesh, veçse në shtypin kinez filloi njëfarë zbutjeje kundrejt Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Por zhvillimi i ngjarjeve tregoi se autorët e marrëveshjes midis Kinës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës kishin vendosur që të largohej nga skena, me dashje ose pa dashje edhe e ashtuquajtura bandë e të katërve.

Me vullnet e me dashje, siç duket, «katërshja» nuk largohej nga pushteti. Elementët e saj nuk e propagandonin, siç dëshironin Mao Ce Duni dhe Çu En Lai, marrëveshjen kino-amerikane, e cila do të ishte me konsekuenca të rënda e të mëdha për vetë Kinën dhe për gjithë botën.

Por, natyrisht, gjatë kësaj kohe grupi i Çu En Lait u konsolidua dhe arriti të sillte në fuqi e t'i jepte poste të rëndësishme, deri atë të nënkryetarit të partisë, të zëvendëskryeministrit dhe të shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë, Ten Hsiao Pinit, «Hrushovit numër dy të Kinës», siç e ka cilësuar Mao Ce Duni, ose «kundërrevolucionarit monarkist», siç u vetëquajt ai në autokritikën që bëri përpara udhëheqjes së partisë gjatë Revolucionit Kulturor.

Në këtë mënyrë grupi i Çu En Lait po merrte në dorë gjithë pushtetin, me fjalë të tjera këtij grupi nuk i mbetej veçse të likuidonte politikisht dhe fizikisht, po të mundte, «katërshen», që kishte në dorë shtypin. Të gjithë organizmat e tjerë ishin në duart e grupit të Çu En Lait me Mao Ce Dunin në krye. Në Zyrën e Përgjithshme, që bënte ligjin në parti, ishte përgjegjës njeriu i Maos, që më vonë u bë i Hua Kuo Fenit e tash është zëvendësuar me elementin më besnik të këtij të fundit, pavarësisht se para Revolucionit Kulturor ishte akuzuar

si agjent i thjeshtë i sovjetikëve. Edhe pse Maoja ishte kryetar i partisë, një nga zëvendëskryetarët e saj ishte Ten Hsiao Pini. Ai kishte në dorë njëkohësisht edhe ushtrinë e gjithçka tjetër. Kjo do të bënte dhe bëri që të shpejtohej procesi i likuidimit të «katërshes».

Në fillim të këtij procesi, Çu En Lai vdiq. Automatikisht atij duhej t'ia zinte vendin Ten Hsiao Pini si kryeministër. Kjo s'ndodhi. Mao Ce Duni caktoi Hua Kuo Fenin kryeministër. «Katërshja», në pamundësi të vinte njerëzit e vet në këtë post, e pranoi këtë zgjidhje, që u konsiderua sikur ishte rekomanduar nga vetë Mao Ce Duni, i cili, në fakt, siç po thonë tani, në atë kohë nuk ishte në vete. Nga e gjithë kjo një gjë është e njohur botërisht: Hua Kuo Feni, duke u bërë kryeministër, e likuidoi përsëri Ten Hsiao Pinin, e riquajti këtë revizionist pas ngjarjeve të prillit në sheshin Tien An Men, ku grupi i Ten Hsiao Pinit lëshoi njerëzit e vet për të demonstruar gjoja për përvjetorin e vdekjes së Çu En Lait. Këta demonstrues, siç dihet, u sulmuan e u goditën nga milicia popullore, e cila thuhej se ishte nën drejtimin e «katërshes» e të Hua Kuo Fenit.

Mirëpo intrigat e pallatit vazhduan dhe Mao Ce Duni gjatë kësaj kohe vdiq. Kështu, Hua Kuo Feni «me një të goditur» likuidoi njerëzit e «katërshes», i arrestoi ata, u bë kryetar i partisë e kryeministër dhe solli përsëri në fuqi, sepse iu imponua, Ten Hsiao Pinin si zëvendëskryeministër dhe si shef të Shtabit të Përgjithshëm. Hy-më, pra, në një fazë të re të politikës kineze, në të cilën komploti i djathtë reaksionar proamerikan i Çu En Lait e i Mao Ce Dunit po futej në fazën e konkretizimit të dëshirave të të dy të vdekurve dhe të vendimeve të hapëta dhe të fshehta që ishin marrë midis Mao Ce Dunit e Çu En Lait, nga njëra anë, dhe Niksonit e Kisingerit, nga ana tjetër.

Kina tash shpалosi planin e ri strategjik, hapjen e

plotë drejt imperializmit amerikan, drejt fuqive të tjera imperialiste dhe borgjezisë kapitaliste botërore. Ajo ndërtoi, gjithashtu, edhe teoritë e saj shoqëruese të këtij plani, si teorinë e «botës së tretë» dhe të luftës kundër social-imperializmit sovjetik, duke e cilësuar këtë të fundit armikun më kryesor të njerëzimit. Kina i bëri thirrje gjithë botës të bashkohej pa dallim klase, pikëpamjesh, orientimesh: ajo braktisi kryekëput teorinë marksiste-leniniste dhe adoptoi një politikë të re koniunkturale, anti-marksiste.

Me Shtetet e Bashkuara të Amerikës lidhjet e Kinës kishin hyrë në rrugë të madhe. Nuk ishin vendosur as marrëdhënie diplomatike, as ishin shkëmbyer diplomatë dhe as ishte zgjidhur çështja e Tajvanit, por në Kinë kishin filluar të vinin grupe senatorësh, teknikësh, specialistësh, bankierësh, kreditorësh të ndryshëm amerikanë. Pra, nga të dyja anët allishveriset po shkonin në rrugë të mbarë dhe çdo gjë ecte me sukses, kurse me vendet e tjera kapitaliste Kina kishte arritur në një formulë *modus vivendi* për çështjen e Tajvanit dhe kishte vendosur prej kohësh marrëdhënie diplomatike. Tash, pas likuidimit të «katërshes» dhe marrjes së fuqisë në dorë, grupi i Hua-Tenit lëshoi kudo në botën kapitaliste emisarët e tij politikë, ekonomikë, ushtarakë të të gjitha armëve për të biseduar për kredi, për teknologji, për armatime të reja etj., etj. Kështu ngjau në radhë të parë me Japoninë, me Gjermaninë Perëndimore, me Francën, me Anglinë, me Tregun e Përbashkët Evropian, me një fjalë, me të gjitha shtetet kapitaliste.

Po ashtu udhëheqja antimarksiste kineze duhej të vendoste lidhje të plota me Jugosllavinë revizioniste dhe me Rumaninë gjithashtu revizioniste. Në zbatim të këtij orientimi të ri ajo preu marrëdhëniet ekonomike me Shqipërinë, preu kreditë, tërhoqi specialistët pa i prerë marrëdhëniet diplomatike dhe, pas këtij veprimi të po-

shtër, u lidh më hapur me Jugosllavinë. Krahas kërkesave për kredi bankare dhe shtetërore, për teknologji të përparuar dhe për armatime, Kina vazhdonte të propagandonte në Evropë e kudo në botë «rrezikun iminent sovjetik», «luftën» që Bashkimi Sovjetik do të deklaronte në Evropë kundër Evropës etj. Për t'u bërë ballë këtyre «situatave e ngjarjeve» ajo predikonte «bashkimin e Evropës», armatimin e saj, forcimin e Tregut të Përbashkët Evropian dhe që kjo «Evropë e Bashkuar» të bëhej një mike e ngushtë e mikes së saj të ngushtë, Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Domethënë Kina predikonte vasalitetin e «Evropës së Bashkuar» ndaj Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Po ashtu Kina ndërmori një ndërhyrje të pacipë në punët e brendshme të shteteve afrikane, të cilat i quante «botë e tretë» dhe, nën maskën e komunizmit, përpiquej të krijonte atje njëfarë influence politike, të hidhte bazat për veprimet e ardhshme ekonomike dhe ushtarake. Kjo veprimtari njëkohësisht kishte si objektiv të saj edhe pengimin e zhvillimit të tendencave ekspansioniste të socialimperializmit sovjetik, pra të ruante në Afrikë statukuonë, domethënë politikën neokolonialiste të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të Francës, të Anglisë dhe të racistëve të Afrikës së Jugut.

Ndërkohë brenda në Kinë vazhdonte lufta jo vetëm për demaskimin e «katërshes». Grupi i Ten Hsiao Pinit hyri në rivalitet me grupin e Hua Kuo Fenit dhe dukeshin qartë qëllimet e grupit të parë për të pasur plot-fuqishmëri brenda në vend. Me një fjalë, Teni dëshironte likuidimin e grupit të Huasë dhe të mbeturinave të «katërshes», të cilat duke ndërruar këmishë, këtë herë në favorin e Hua Kuo Fenit, ekzistonin akoma në udhëheqjen e partisë e të shtetit. Pra, Hua Kuo Feni përpiquej «të trashëgonte» Maon, kurse Ten Hsiao Pini ishte partizani i revanshit të hakmarrjes kundër Revolucionit Kulturor, kundër atij që e organizoi dhe e udhëhoqi

këtë revolucion, pra kundër Mao Ce Dunit. Kështu Ten Hsiao Pini e futi Kinën në një rrëmujë akoma më të madhe. Filluan kështu të dalin dacibao që atakonin edhe «katërshen», edhe Hua Kuo Fenin, edhe Maon dhe, herë tërthorazi e herë haptazi, ato mburrnin Ten Hsiao Pinin.

Dacibaot kërkonin rehabilitimin e të gjithë të dënuarve nga Revolucioni Kulturor, kërkonin që demonstrata e Tien An Menit të quhej një aksion revolucionar dhe jo kundërrevolucionar etj. Ato krijuan një situatë në favor të pushtetit të plotë të Ten Hsiao Pinit.

Natyrisht, të gjitha këto shkaktuan turbullira të mëdha, pse një shumicë e madhe kuadrosh u hodhën tej, ndërsa një shumicë tjetër e madhe kuadrosh të vjetër të reaksionit erdhën në fuqi dhe zunë postet që kishin më parë. Ata u bënë mbështetja kryesore e Ten Hsiao Pinit, gjë që e acaroi më tepër rivalitetin midis këtij dhe Huasë. Rrugë që do të merrte ky rivalitet, nuk ishte e mirë as për Hua Kuo Fenin, as për Ten Hsiao Pinin. Një situatë e tillë çonte edhe në demonstrata, siç ndodhi para një jave në Shangai, për të cilat kam shkruar.

Prandaj të dy grupet u përpoqën jo të pajtohen, pasi midis tyre nuk do të ketë pajtim, por të gjejnë një rrugë kompromisi, se për të tilla punë ata kanë lindur. Ky kompromis synonte ta qetësonte situatën brenda në Kinë, aq sa mund të qetësohet, dhe të krijonte besim tek aleatët e ardhshëm, që nga Japonia deri te Shtetet e Bashkuara të Amerikës, se në Kinë gjendja po stabilizohet dhe nuk ka rreziqe për investimet e tyre.

Në Jugosllavi e në Rumani pamë të shkonte Hua Kuo Feni. Siç e kam thënë edhe herë të tjera, udhëtimi i tij në këto vende kishte për qëllim të ndizte urat kundër Bashkimit Sovjetik dhe të provokonte një luftë në Evropë. Këtij qëllimi ai nuk ia arriti. Pas kthimit të Huasë në Pekin, Ten Hsiao Pini bëri hopin më të madh

diplomatik konkret. Ai shkoi në Japoni për të marrë pjesë në ceremoninë e shkëmbimit të instrumenteve të ratifikimit të traktatit të miqësisë dhe të bashkëpunimit reciprok. Kjo ishte një fitore e madhe e reaksionit racist kino-japonez. U zhdukën të gjitha mosmarrëveshjet dhe Japonia gjeti në Kinë një treg të madh, shumë të favorshëm, ndërsa Kina gjeti te Japonia një mike shumë të afërt ideologjike dhe politike me një industri të madhe dhe të zhvilluar. Afaristët e mëdhenj, bankierët, bonzët japonezë u vërsulën në Kinë dhe shoqëritë e shtetit japonez i akorduan asaj me miliarda dollarë kredi.

Por aleanca kino-japoneze përmban në vetvete një rrezik të jashtëzakonshëm, rrezikun e një lufte të tretë botërore midis Kinës e Japonisë, nga njëra anë, dhe Bashkimit Sovjetik, nga ana tjetër. Si Kina, ashtu edhe Japonia, kanë pretendime territoriale ndaj Bashkimit Sovjetik, synojnë ta likuidojnë forcën politike, ideologjike, ushtarake dhe ekonomike të tij dhe ta futin atë në strofken e vet, siç thonë ata, në Evropë, nën parullën «Azia aziatikëve», «Siberia aziatikëve», «Azia Qendrore e Bashkimit Sovjetik aziatikëve».

Prandaj ky traktat ka një rëndësi të jashtëzakonshme jo vetëm pse fuqizon Kinën me teknologji ushtarake dhe industriale moderne, por, njëkohësisht, **i hap Japonisë një treg të madh për eksportim mallrash dhe një burim të madh lëndësh të para, e shpëton atë nga kriza dhe e ndihmon që ajo ta shtypë akoma më shumë klasën punëtore japoneze, e cila që tash vuan nga një shtypje e tmerrshme.**

Pra, ideologjia antimarksiste e kinezëve doli aqik. Kina mori kredi të mëdha edhe nga vendet e tjera kapitaliste, aq sa gazeta franceze «Lë Mond» në njërin nga numrat e saj thotë se Franca po përfiton jashtëzakonisht dhe, në qoftë se nuk gabohem, shuma e kredive që do t'i akordojë Kinës për teknologji moderne, arrin deri në

60 miliardë franga. Por gazeta bën pyetjen: A do të jetë Kina në gjendje t'i paguajë këto kredi kaq të mëdha? Etja e saj për armatime, për teknologji, për fabrika, për siderurgji është e madhe, — dhe përmend një afarist anglez, i cili kishte vajtur kohët e fundit në Kinë për të biseduar për dhënie kredish dhe kishte thënë se të gjitha këto kredi të mëdha Kina duhet t'i paguajë, por ato nuk lahen me lepuj të ngrirë dhe me rosa pekineze. Prandaj, «Lë Mond» e këshillon qeverinë franceze që të jetë shumë e matur, se dhënia e ndihmës dhe e fitimeve që mund të nxjerrë Franca nga Kina, përveç karakterit politik që ka nga fakti se si do ta shikojë Bashkimi Sovjetik këtë ndihmë kaq të madhe që Perëndimi i jep Kinës, ka edhe karakter e pasoja ekonomike, pse një vit i keq bujqësor në Kinë do të bëjë që ajo të mos jetë në gjendje t'i lajë borxhet që po merr nga shtetet kapitaliste.

Të gjithë e dimë se Kina aktualisht ka ndryshuar politikë, ka ndryshuar strategji dhe po lidhet ngushtë e po hyn në rrethin e kapitalizmit botëror. Kështu ajo po bëhet një vend i varur nga kapitali i huaj amerikan, japonez, nga ai i Evropës Perëndimore, natyrisht, duke u bërë atyre koncesione të rënda, duke krijuar shoqëri të përbashkëta, duke skllavëruar popullin kinez dhe duke humbur lirinë dhe sovranitetin e vet të vërtetë.

Është e qartë se Kina përgatitet për luftë dhe nxit luftën botërore; pra, ajo ndodhet në radhët e kriminelëve. Por, që të përgatitet për luftë, e thashë edhe më lart, ajo armatohet në ethe me mjetet më moderne dhe fuqizon prapavijat e saj ekonomike.

Kina përpiqet të shkojë në luftë me aleanca të reja, të cilat, siç po duket, synojnë në krijimin e unitetit kino-japonez dhe kino-amerikan, pra, në krijimin e një blloku të madh luftarak për mbrojtjen nga influenza sovjetike të Azisë Lindore, po e po, por edhe të të gjithë Paqësorit e të Azisë Juglindore. Fillimi i kësaj aleance

synon konsolidimin e pozitive luftarako-ekonomike të Kinës, të Japonisë e të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në gjithë këtë pellg dhe pastaj ndarjen e tregjeve në mes tyre në gjithë Azinë. Kjo ndarje tregjesh, do të thotë ndarje e zonave të influencës dhe në këtë ndarje të tria këto shtete të fuqishme imperialiste, në mos sot, nesër, do të ndeshen patjetër, pse oreksi i tyre është i madh. Kryesoret në këto aleanca, aktualisht, janë Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Këto kohët e fundit, në njëfarë konklavi vaticanesk në Pekin dhe në Uashington, për javë të tëra është punuar për të arritur në konkluzione të favorshme për një aleancë kino-amerikane të padeklaruar, por reale. Më në fund, nga ky konklav disa javësh, midis Ten Hsiao Pinit e përfaqësuesit të zyrës amerikane në Pekin, si edhe midis Karterit dhe përfaqësuesit të zyrës kineze në Uashington, nga oxhaku i selisë perandorake kineze dhe nga Shtëpia e Bardhë e Uashingtonit, doli tym i bardhë. Në Pekin dhe në Uashington në të njëjtën ditë e në të njëjtën orë, Hua Kuo Feni dhe Karteri shpallën se u lidhën marrëdhënie diplomatike midis dy shteteve dhe u vendos shkëmbimi i ambasadorëve.

Duket se për çështjen e Tajvanit Shtetet e Bashkuara të Amerikës i bënë lëshime Kinës. Ato do të cedonin, ashtu siç ceduan, duke njoftuar se me vendosjen e lidhjeve diplomatike me Kinën do t'i shkëputnin lidhjet diplomatike me Tajvanin. Unë kam thënë se, **për të lidhur këto marrëdhënie diplomatike dhe për të vazhduar në rrugën e krijimit të një aleance, në mos të deklaruar, sekrete, çështja e Tajvanit nuk ka qenë një pengesë shumë serioze. Serioze kanë qenë sigurimet që Kina duhet t'u jepte Shteteve të Bashkuara të Amerikës.**

Këta njohën se në Kinë ekziston një qeveri legale dhe se Tajvani është pjesë përbërëse e saj. Ky ishte lëshimi që bënë Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ky lëshim,

natyrisht, ishte i nuancuar pse, pas Karterit, Vensi bëri disa «shpjegime» lidhur me Tajvanin, duke deklaruar se Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk do ta ndalojnë asnjëherë furnizimin e tajvanezëve me armë moderne, se do të ruajnë e do t'i zhvillojnë marrëdhëniet tregtare, se në vend të ambasadës do të kenë një mision diplomatik të shkallës së zyrës së ndërlidhjes, siç ekzistonte deri tash në Kinën kontinentale dhe se do të ruajnë me Tajvanin marrëdhëniet kulturore dhe miqësore.

Me fjalë të tjera, çështja e Tajvanit na doli një fyçkë. Në sipërfaqe duket sikur Kina pati satisfaksion. Por ky satisfaksion, medoemos i ka kushtuar asaj shtrenjtë, pse në prapaska ka marrë angazhime serioze në favor të zhvillimit të marrëdhënieve me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, u ka dhënë këtyre premtime për qëndrime joagresive ndaj Tajvanit, ndërsa ky i fundit do të vazhdojë gjendjen e të qenit i pavarur ose do të bëjë osmozën në ato momente që do ta gjejë të përshtatshme klika e Çan Kai Shisë dhe e djalit të tij, kur Kina të jetë tërësisht në duart e Guomindanit dhe të reaksionit kinez. Me fjalë të tjera, kur diktatura kapitaliste të ketë gjetur stabilizim të plotë në Kinë, atëherë çështja e Tajvanit është e zgjidhur, për arsye se regjimi i Çan Kai Shisë e tajvanezët nuk kërkojnë tjetër gjë, përveçse zhdukjen e komunizmit dhe të socializmit dhe vendosjen e kapitalizmit në Kinë. Pra, tash që po vendoset kapitalizmi në këtë vend, diferenca në mes ishullit dhe Kinës kontinentale gradualisht do të zvogëlohet dhe dalngadalë tajvanezët do të marrin në dorë fuqi të mëdha brenda në kontinentin kinez.

Për sa i përket çështjes së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, këto nuk humbasin gjëkafshë përderisa fituan në Kinën kontinentale, domethënë arritën të likuidonin atje mundësinë e zhvillimit të shoqërisë socialiste dhe të siguronin vendosjen e kapitalizmit, të siguronin,

pra, mundësinë e penetrimit të influencës së tyre politike, ekonomike dhe ushtarake. Them edhe ushtarake, pse Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë me Japoninë një Traktat ushtarak dhe, derisa kjo e fundit lidhi një traktat të miqësisë e të bashkëpunimit me Kinën, prapa krahëve, sigurisht, ka edhe klauzola ose nene të tjera që i lidhin me njëri-tjetrin. Vetë klauzolat e Traktatit Kino-Japonez thonë se që të dyja, Japonia dhe Kina, janë kundër hegjemonizmit të një shteti tjetër (kjo i referohet Bashkimit Sovjetik, pra janë kundër këtij).

Po ashtu Shtetet e Bashkuara me Kinën mund të kenë edhe marrëveshje sekrete ndërmjet tyre. Në qoftë se nuk kanë tash, mund ta bëjnë më vonë një gjë të tillë, kur të shohin se rreziku nga Bashkimi Sovjetik bëhet një kërcënim për to, dhe atëherë do të konsolidohet e do të deklarohet blloku kino-japono-amerikan.

Pra, u realizua ajo çka Niksoni tha publikisht përpara Çu En Lait në banketin zyrtar në Pekin, se Shtetet e Bashkuara të Amerikës do të përpiqeshin të ndërtonin një urë aq të madhe, saqë të kapërcente Atlantikun nga San-Franciskoja në sheshin Tien An Men. Kjo urë tash u ngrit dhe Karteri ftoi Ten Hsiao Pinin që të shkojë në Uashington nga fundi i janarit të vitit 1979. Ky e pranoi këtë «nder të madh» që i bëhet dhe me siguri vajtja e tij në Uashington do të bëjë një bujë të madhe, pse atje do të merren patjetër vendime të rëndësishme për zhvillimin e mëtejshëm të kësaj miqësie të përbindshme kino-amerikane, do të nënshkruhen traktate e protokolle të hapëta dhe të fshehta.

Të gjitha këto gjëra përbëjnë një kërcënim të madh për paqen në botë dhe rritin synimet e imperialistëve për rindarjen e botës. Është fakt se, aktualisht, Kina, me veprimet e saj në drejtim të Japonisë, të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të vendeve të tjera kapitaliste të zhvilluara, e ka dobësuar influencën e Bashkimit

Sovjetik revizionist dhe mund të themi se ky është në rrugën e një izolimi, gjë që e detyron të jetë vigjilent dhe të përgatitet intensivisht për luftë në shumë drejtime: në drejtimin evropian, në atë aziatik, por edhe në drejtimin e Lindjes së Mesme. Këto përbëjnë tri fronte kryesore, nga të cilat një mëngjes, papritur, Bashkimit Sovjetik mund t'i vijë rreziku.

Si do ta përballojë ai këtë rrezik? Ky është një problem që duhet vëzhguar. Në ç'mënyrë Bashkimi Sovjetik do t'i vazhdojë aleancat luftarake kundër këtij rrethimi, këtë do ta shohim. Aktualisht konstatojmë se, duke u kristalizuar këto aleanca imperialiste, duke u përgatitur për një luftë të re grabitqare botërore, të gjitha palët po përpiqen që ta evitojnë hëpërhë një konfliktacion botëror, derisa edhe njëri, edhe tjetri ta shohin se janë përgatitur si duhet.

Prandaj ekziston kjo periudhë kërcënuese dhe njëkohësisht false për bashkëpunim dhe ulje të tensionit. Imperializmi amerikan, që duket se është më i fortë, më i zhdërvjellët në aleanca dhe në ekspansionin e tij ekonomik, politik e ushtarak, përpiqet të mos i këputë urat me Bashkimin Sovjetik. Edhe ky, gjithashtu, në këtë situatë përpiqet që me Shtetet e Bashkuara të Amerikës të arrijë disa rezultate gjoja për uljen e tensionit ose për marrëveshjet SALT-2, të marrë sa më shumë kredi prej tyre dhe nga vendet e tjera aleate të tyre, të zbutë deri diku veprimet e veta kundrejt NATO-s dhe të konsolidojë pozitën e tij ushtarakë dhe politike në gjirin e Traktatit të Varshavës.

Sidoqoftë, këtë mund ta quajmë përsëri një fazë false të detantës, e cila u shërben përgatitjes dhe kristalizimit të mëtejshëm të aleancave dhe të përgatitjeve për luftë.

Unë mendoj se opinioni botëror e mbivlerëson Ten Hsiao Pinin me grupin e tij dhe ka arritur në përfundimin se ai do ta stabilizojë gjendjen në Kinë, do të bash-

kojë fraksionet, do të likuidojë kundërshtarët dhe do të ecë deri në njëfarë rruge bashkë me Hua Kuo Fenin, pastaj do ta likuidojë edhe këtë, edhe grupin e tij. Këtë përshtypje të lënë artikujt diplomatikë të gazetave të ndryshme të Evropës, si dhe komentet e agjencive të lajmeve. Po mendimi im është se **situata në Kinë nuk është stabilizuar dhe Ten Hsiao Pini nuk është në gjendje ta stabilizojë atë.**

Faktet tregojnë se në Kinë, edhe në kohën e Mao Ce Dunit, kur autoriteti i tij ishte i padiskutueshëm, bashkimi i deviacionistëve dhe uniteti i mendimit nuk ishin arritur kurrë, ata vetëm ishin tulatur. Zaten Mao Ce Duni nuk e lejonte bashkimin e grupeve dhe unitetin e mendimeve në vendin e tij. Ai e kishte parim «lulëzimin e njëqind luleve dhe konkurrimin e njëqind shkollave». Një pikëpamje e tillë filozofike dhe politike do të vazhdojë në Kinë dhe këto «shkolla», në të njëjtën kohë të fuqishme dhe të lëkundshme, në një koniunkturë të caktuar mund të bashkohen me Ten Hsiao Pinin, por në një koniunkturë tjetër mund ta braktisin atë dhe të mbështetin kundërshtarët e tij.

Unë jam i bindur se Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe diplomacia e lartë e të gjitha vendeve perëndimore, pavarësisht nga ç'thonë publikisht, e kanë parasysh faktin se Hua Kuo Feni është për vijën aktuale politike të Kinës, por me më shumë prurësi, kurse Ten Hsiao Pini kërkon shpejtimin e realizimit të kësaj vije imperialiste. Teni kërkon të realizojë me ngutje planin e Çu En Lait për ta bërë Kinën, medoemos dhe me çdo kusht, një superfuqi të barabartë me imperializmin amerikan dhe me socialimperializmin sovjetik.

Por, në arenën ndërkombëtare dhe në këtë pleksje luftërash për hegjemoni midis botës kapitaliste dhe asaj revizioniste, jo çdo gjë mund të shkojë sipas dëshirës së tri superfuqive. Duke lënë për një çast mënjanë rezis-

tencën dhe luftën e madhe të popujve kundër rrezikut të luftës, kundër dominimit të botës nga këto tri superfuqi imperialiste, në vendet e ndryshme kapitalisto-revizioniste ka edhe tendenca centrifugale, edhe tendenca unifikimi. Për sa u përket tri superfuqive, ato po përpiqen si e si të ruajnë aleatët e vet dhe t'i shtojnë ata, duke ia rrëmbyer njërit ose tjetrit.

Vetë këta «aleatë» me kreun e bllokut të tyre kanë kontradikta të thella, të cilat përbëjnë një stad të dytë që pengon realizimin e qëllimit kryesor të të tre të mëdhenjve. Jo të tërë janë për luftën ndër imperialiste. Disa janë për ruajtjen e statukuosë, pra janë për detantën midis superfuqive, për forcimin e fuqive të tyre ekonomike dhe ushtarake. Brenda në këto aleanca, si në atë të NATO-s, ashtu edhe në atë të Traktatit të Varshavës, si në Tregun e Përbashkët Evropian, ashtu edhe në KNER, ekzistojnë, pra, kontradikta të theksuara midis aleatëve. Këto kontradikta, duan apo nuk duan imperialistët amerikanë ose socialimperialistët sovjetikë, duan apo nuk duan gjermanët e Perëndimit, anglezët, francezët, polakët, rumunët, gjermanët e Lindjes, çekoslovakët e bullgarët, po thellohen vazhdimisht. Pikërisht këto kontradikta i thellon tendenca e përgjithshme e dominimit të të mëdhenjve, e shfrytëzimit nga ana e tyre të potencialeve ekonomiko-politike të aleatëve më të dobët në favorin e qëllimeve strategjike të tyre.

Pra do të krijohen fërkime të panumërta e të papritura; do të lindin kundërshtime lokale të armatosura.

Tendenca e Kinës, e kësaj superfuqie që po ngrihet në aleancë me Japoninë dhe me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, është që, duke nënshtruar Vietnamin, Laosin, Kamboxhian, Tajlandën e mundësisht edhe Birmaninë, të zgjerojë influencën e saj, ose të krijojë një bllok nën drejtimin e vet. Kjo dëshirë do të hasë në kundërshtimin e këtyre shteteve. Që tash ajo ka hasur në kundërshti-

min e Vietnamit. Si pasojë, midis Kinës dhe Vietnamit po ngjasin incidente të përgjakshme. Po kështu midis Vietnamit dhe Kamboxhias po bëhet luftë, kurse Ten Hsiao Pini që brodhi në Tajlandë, në Birmani, në Filipine, në Malajzi e në Singapor, nuk gjeti predispozicionin që shpresonte. Kështu, Japonia nuk punon për Kinën, por për dominimin e saj, punon për zona influence për vete në vendet që përmenda më lart dhe në vende të tjera, si në Australi e më tutje akoma. Përveç kësaj, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, pavarësisht nga miqësia që po krijohet midis Kinës dhe Japonisë, kanë planet e veta të mëdha strategjike, plane globale, planetare, ashtu siç i ka edhe Bashkimi Sovjetik.

Prandaj nuk është aq e lehtë as për Kinën, as për Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe as për Bashkimin Sovjetik që të mbajnë kurdoherë nën zgjedhën e tyre vende të tilla, si: Indinë, Pakistanin, Birmaninë apo Iranin. Ky grup vendesh ka në krye një borgjezi ende të fuqishme, me konceptet e veta dominuese, me një politikë koniunkturale të sajën për të përfituar sa më shumë sa nga njëri, aq edhe nga shteti tjetër imperialist, por që në të njëjtën kohë, veçanërisht në Indi, borgjësia në fuqi kujdeset që të mos angazhohet deri në grykë me njërin ose me tjetrën superfuqi. Influenca e Indisë, së afërmi e në një moment fuqizimi më të madh të potencialit të saj ekonomik e ushtarak, do të ndihet në gjithë këtë pellg dhe mund të arrijë deri në shtetet e Lindjes së Mesme.

Prandaj, në vija të përgjithshme, mund të themi se në situatat aktuale, tymi i bardhë i aleancave ndër imperialiste, fsheh rreziqe të mëdha për njerëzimin, për paqen botërore. Tendenca është që këto aleanca të konsolidohen më tej në përgatitjet për shpërthimin e një lufte të madhe botërore. Por ekziston edhe tendenca centrifugale kundër këtyre aleancave dhe, mbi të gjitha, ekzistojnë rezistenca dhe revolta e popujve që kërkojnë çlirim nga

zgjedha e kapitalit të brendshëm dhe e hegjemonisë së jashtme, si ajo amerikane, kineze, japoneze, sovjetike apo e ndonjë tjetër fuqie imperialiste.

Ne asistojmë, pra, në një fazë që mund ta quajmë kruciale, prirja e së cilës është një luftë e tretë botërore. Kjo fazë fillon me konsolidim aleancash të reja për rindarjen e botës nëpërmjet luftërash lokale. Në të njëjtën kohë shohim edhe kundërshtime, bile të rrepta, nga masat e gjera të popujve që luftojnë kundër shtypësve.

Si konkluzion, viti 1978 vërtetoi pikëpamjet e drejta marksiste-leniniste të Partisë sonë të Punës së Kinës dhe Mao Ce Dunit në realitet nuk ndërtonte socializmin, se Partia Komuniste e Kinës nuk ishte një parti marksiste-leniniste, se në Kinë mbretëronin kaosi dhe rrëmuja. Për të vendosur atje kapitalizmin, Hua Kuo Feni dhe Ten Hsiao Pini, në rivalitet e në grindje të heshtura dhe të hapëta me njëri-tjetrin, kanë hyrë në aleanca me kapitalizmin reaksionar botëror, me imperializmin amerikan, me atë japonez dhe të Evropës Perëndimore. Vija e tyre e përgjithshme është që Kina të bëhet një superfuqi imperialiste dhe të kundërshtojë socialimperializmin sovjetik. Udhëheqësit aktualë kinezë po bëhen luftënxitës, kundërrevolucionarë, pseudomarksistë dhe janë aktivë në të gjitha këto drejtime.

Partia jonë e demaskoi këtë vijë, i demaskoi këta njerëz, këto grupime, këtë parti dhe këtë pseudondërtim të socializmit dhe do të vazhdojë edhe paskëtaj të ndjekë me kujdesin më të madh zhvillimin e punës së tyre armiqësore ndaj njerëzimit dhe ndaj marksizëm-leninizmit.

**E ENJTE**  
**21 DHJETOR 1978**

## **POPUJT DHE PROLETARIATI DUHET TË BËHEN TË VETËDIJSHËM MBI ÇKA PO NGJET NË BOTË**

Siç kam thënë edhe më parë, lidhjet e Kinës me Shtetet e Bashkuara të Amerikës duhet ta kenë bishtin pas, një bisht të fshehtë. Ne dimë se në Komunikatën e Shangait, që u firmos nga Niksoni dhe nga Çu En Lai, thuhet se të dyja këto vende nuk do të luftojnë për hegjemoni. Kjo, natyrisht, nuk është e vërtetë, por një bluf nga ana e Shteteve të Bashkuara po e po, por edhe e Kinës. Në atë kohë kinezët i zbukuronin imperialistët amerikanë me lule dhe propagandonin se gjoja ata qenë zbutur dhe s'ishin më agresivë. Më vonë u duk se edhe Kina aspironte për hegjemoni.

Me fjalë të tjera, u bënë përpjekje për të mbuluar diellin me shoshë. Në Traktatin Kino-Japonez, siç dihet, çështja u përcaktua më tej. U theksua se të dy vendet janë kundër hegjemonizmit, gjë që do të thotë kundër socialimperializmit sovjetik, të cilin Kina e quan shtet imperialist hegjemon.

Pra, aleanca e përfunduar midis Pekinit dhe Tokios drejtohet kundër Bashkimit Sovjetik. Dimë, gjithashtu, se edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë me Japoninë një marrëveshje «mbrojtjeje» a «paqësore», ose siç e thonë, të bashkëpunimit reciprok, e të tjera e të tjera epitete që u vihen këtyre lloj traktateve. Në fakt marrëveshja amerikano-japoneze është një mburojë e këtyre dy shteteve imperialiste e militariste kundër hegjemonisë së Bashkimit Sovjetik.

zgjedha e kapitalit të brendshëm dhe e hegjemonisë së jashtme, si ajo amerikane, kineze, japoneze, sovjetike apo e ndonjë tjetër fuqie imperialiste.

Ne asistojmë, pra, në një fazë që mund ta quajmë kruciale, prirja e së cilës është një luftë e tretë botërore. Kjo fazë fillon me konsolidim aleancash të reja për rindarjen e botës nëpërmjet luftërash lokale. Në të njëjtën kohë shohim edhe kundërshtime, bile të rrepta, nga masat e gjera të popujve që luftojnë kundër shtypësve.

Si konkluzion, viti 1978 vërtetoi pikëpamjet e drejta marksiste-leniniste të Partisë sonë të Punës se Kina e Mao Ce Dunit në realitet nuk ndërtonte socializmin, se Partia Komuniste e Kinës nuk ishte një parti marksiste-leniniste, se në Kinë mbretëronin kaosi dhe rrëmuja. Për të vendosur atje kapitalizmin, Hua Kuo Feni dhe Ten Hsiao Pini, në rivalitet e në grindje të heshtura dhe të hapëta me njëri-tjetrin, kanë hyrë në aleanca me kapitalizmin reaksionar botëror, me imperializmin amerikan, me atë japonez dhe të Evropës Perëndimore. Vija e tyre e përgjithshme është që Kina të bëhet një superfuqi imperialiste dhe të kundërshtojë socialimperializmin sovjetik. Udhëheqësit aktualë kinezë po bëhen luftënxitës, kundërrevolucionarë, pseudomarksistë dhe janë aktivë në të gjitha këto drejtime.

Partia jonë e demaskoi këtë vijë, i demaskoi këta njerëz, këto grupime, këtë parti dhe këtë pseudondërtim të socializmit dhe do të vazhdojë edhe paskëtaj të ndjekë me kujdesin më të madh zhvillimin e punës së tyre armiqësore ndaj njerëzimit dhe ndaj marksizëm-leninizmit.

**E ENJTE**  
**21 DHJETOR 1978**

## **POPUJT DHE PROLETARIATI DUHET TË BËHEN TË VETËDIJSHËM MBI ÇKA PO NGJET NË BOTË**

Siç kam thënë edhe më parë, lidhjet e Kinës me Shtetet e Bashkuara të Amerikës duhet ta kenë bishtin pas, një bisht të fshehtë. Ne dimë se në Komunikatën e Shangait, që u firmos nga Niksoni dhe nga Çu En Lai, thuhet se të dyja këto vende nuk do të luftojnë për hegjemoni. Kjo, natyrisht, nuk është e vërtetë, por një bluf nga ana e Shteteve të Bashkuara po e po, por edhe e Kinës. Në atë kohë kinezët i zbukuronin imperialistët amerikanë me lule dhe propagandonin se gjoja ata qenë zbutur dhe s'ishin më agresivë. Më vonë u duk se edhe Kina aspironte për hegjemoni.

Me fjalë të tjera, u bënë përpjekje për të mbuluar diellin me shoshë. Në Traktatin Kino-Japonez, siç dihet, çështja u përcaktua më tej. U theksua se të dy vendet janë kundër hegjemonizmit, gjë që do të thotë kundër socialimperializmit sovjetik, të cilin Kina e quan shtet imperialist hegjemon.

Pra, aleanca e përfunduar midis Pekinit dhe Tokios drejtohet kundër Bashkimit Sovjetik. Dimë, gjithashtu, se edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë me Japoninë një marrëveshje «mbrojtjeje» a «paqësore», ose siç e thonë, të bashkëpunimit reciprok, e të tjera e të tjera epitete që u vihen këtyre lloj traktateve. Në fakt marrëveshja amerikano-japoneze është një mburojë e këtyre dy shteteve imperialiste e militariste kundër hegjemonisë së Bashkimit Sovjetik.

Pra, formohet kështu një rreth i mbyllur aleancash, bile edhe ushtarake, midis Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Japonisë dhe Kinës kundër Bashkimit Sovjetik. Këtë gjë fletushka «Pravda» e socialimperialistëve sovjetikë e cilësoi një NATO të Paqësorit. Dhe në të vërtetë ajo është NATO-ja e Paqësorit. Këtu, në mos legalisht, *de facto*, do të bëjnë pjesë edhe Indonezia me Filipinet. Tendencë kino-japono-amerikane është që, përveç bllokut të NATO-s në Evropë, të krijohet edhe një bllok luftarak kundër Bashkimit Sovjetik në Lindjen e Largme.

Këta e futin, pra, Bashkimin Sovjetik në mes dy fronteve ushtarake imperialisto-hegjemoniste. Sigurisht, Bashkimit Sovjetik i duhet ose të manovrojë ose të futet në një luftë planetare në të dy frontet. Kjo luftë imperialiste i duhet Bashkimit Sovjetik, por, që ta fitojë atë, ai duhet të likuidojë sa më parë njërin front për t'iu kthyer pastaj frontit më të rrezikshëm për të. Por aktualisht shohim se Bashkimi Sovjetik, megjithëse tregohet i shqetësuar për çka po ngjet në skakierën e madhe botërore diplomatike midis Shteteve të Bashkuara, NATO-s, Japonisë dhe Kinës kundër tij, në të vërtetë nuk është edhe aq i shqetësuar.

Pse nuk është aq i shqetësuar? Për arsye, mendoj unë, se e di që Kina në gjendjen që është sot, po u fut në një aventurë me Bashkimin Sovjetik, do të pësojë disfatën më të madhe. Kinës i duhet kohë ta ngrejë nivelin e ushtrisë së saj në atë të një ushtrie moderne që të jetë në gjendje të përballojë ushtrinë e revizionistëve sovjetikë. Kësaj ushtrie i nevojitet të ketë edhe prapavija të qeta dhe të forta, që aktualisht nuk i ka. Për të realizuar një gjendje të tillë duhet një kohë mjaft e gjatë, të paktën 10-15 vjet. Bashkimi Sovjetik gjatë këtyre 10-15 vjetëve, mendoj unë, do të manovrojë për të krijuar në botë sferat e tij të influencës, për të krijuar aleancat e veta e njëkohësisht për të krijuar situata të tilla që ale-

anca midis Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Kinës të mos forcohet, por të dobësohet.

Një nga këto aleanca është traktati i miqësisë dhe i bashkëpunimit që ai nënshkroi kohët e fundit me Vietnamin në përgjigje të rrezikut kino-japonez dhe kino-japono-amerikan. Traktati me Vietnamin do të thotë që gjithë Azia Juglindore të jetë nën saçin e forcave sovjetike, të bëhet një bazë e fuqishme ushtarake sulmi kundër Kinës, sidomos kundër pjesës më të populluar të saj, Kinës Juglindore. Me një fjalë Azia Juglindore të bëhet qendra e luftës së ardhshme kino-sovjetike.

Duhet të kemi parasysh se flota e Paqësorit e Bashkimit Sovjetik është një flotë detaro-luftarake e fuqishme. Ajo ka baza në Vietnam: në Hajfong e në Sajgon. Në këtë mënyrë ajo bëhet një forcë e rrezikshme edhe për flotën amerikane e për atë japoneze, sepse Kina, aktualisht, nuk ka një flotë të atillë që të jetë në gjendje ta përballojë flotën sovjetike, ndërsa flotat e dy shteteve aleate të Kinës mund të maten me flotën sovjetike, por ndeshja do të jetë e rreptë. Sidoqoftë, nga bazat e Vietnamit flota sovjetike është në gjendje ta godasë Kinën, përveç goditjeve që mund t'i bëjë nga kufiri tjetër i madh në Siberi, në Mongoli dhe në Sinkiang.

Me Traktatin Sovjeto-Vietnamez Laosi ndodhet në sferën sovjetike; Kamboxhia, në rast rreziku, likuidohet përnjëherë, edhe Tajlanda po ashtu. Kështu që rrethimi i Kinës nga ana e Bashkimit Sovjetik nga veriu, nga lindja dhe nga jugu është i realizueshëm. Dhe ne e dimë se Shtetet e Bashkuara të Amerikës asnjëherë nuk do të hyjnë në zjarr për t'ia nxjerrë gështenjat Kinës, por do të orvaten ta vënë këtë zjarr për t'ua nxjerrë gështenjat Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Edhe në rast të një konflikti midis Kinës e Japonisë nga njëra anë dhe Bashkimit Sovjetik nga ana tjetër, Shtetet e Bashkuara të Amerikës do të luajnë rolin e spektatorit dhe të ndihmë-

sit, sa të jetë e mundur më *discret*<sup>1</sup> të Kinës për ta nxitur këtë kundër Bashkimit Sovjetik, në mos për ta thyer, për ta dobësuar, po të jetë e mundur.

Por ne shohim se Bashkimi Sovjetik manovron me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ai tregohet sikur marrëveshja kino-amerikane nuk ia dëmton interesat. Kjo është në dukje, sepse në fakt interesat e tij dëmtohen, prandaj Bashkimi Sovjetik, duke thënë se marrëveshja ose lidhja e marrëdhënieve diplomatike me Kinën është një gjë e natyrshme, kërkon që Shtetet e Bashkuara të Amerikës të mbajnë qëndrime botërore një çikë më të përcaktuara. Por kurdoherë të mos harrojmë se Shtetet e Bashkuara të Amerikës, duke e njohur Kinën, i bënë asaj një lëshim në lidhje me çështjen e Tajvanit dhe aleatët e tyre panë se për interesat e vet të mëdhenj Shtetet e Bashkuara të Amerikës mund ta braktisin aleatin e tyre, të madh ose të vogël, siç bënë me Tajvanin, megjithëse duhet thënë që në të vërtetë Tajvanin ato nuk e kanë braktisur dhe vetë Kina nuk dëshiron që ta braktisin, por ta ndihmojnë.

Tajvani dhe Kina ecin në një rrugë, në rrugën pro-amerikane. Kina po borgjezohet, atje po vendoset kapitalizmi, që i ngjan kapitalizmit të Tajvanit. Natyrisht, kur piqen dy xhandarë, ç'muhabete mund të bëjnë? Patjetër që muhabete xhandarësh. Kur piqen dy kapitalistë, çfarë mund të bëjnë? Sigurisht, muhabete dhe marrëveshje kapitalistësh. Kështu që osmoza midis Tajvanit dhe Kinës do të bëhet, në mos sot, nesër, kur në kontinent, domethënë në Kinë, të jenë bërë transformime rrënjësore lidhur me vendosjen e kapitalizmit.

Nga ana tjetër Tregu i Përbashkët Evropian ose Evropa Perëndimore, shtetet që formojnë këtë «Evropë të Bashkuar», kanë tendencë që të bëjnë një politikë të ba-

<sup>1</sup> Frëngjisht — i matur, i rezervuar.

lancës midis Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Sovjetik. Aktualisht ky treg nuk rrezikohet drejtpërdrejt nga Bashkimi Sovjetik. Vetë Bashkimi Sovjetik do ta evitojë një gjë të tillë gjatë kësaj periudhe 10-15-vjeçare, kur Kina do të bëjë sforcë të mëdha për t'u armatosur dhe për të ndërtuar një ekonomi luftarake. Por në të njëjtën kohë do të bëjë orvatje të shumta që ta shfrytëzojë në favorin e tij situatën e turbullt dhe të pastabilizuar të Kinës.

Duhet të mendojmë se stabilizimi i situatës së brendshme në Kinë do të jetë mjaft i vështirë. E para, për arsye ekonomike, pse Kina po zhvillohet drejt një ekonomie kapitaliste luftarake dhe kjo nuk do ta përmirësojë gjendjen ekonomike dhe as atë politike të vendit. Pastaj në Kinë, siç e dimë, gjatë gjithë periudhave është zhvilluar një kapitalizëm me shumë fytyra, kaotik, me maska të ndryshme, me maska të çala dhe me një ideologji të bastarduar, gjë që ka lejuar «të lulëzojnë njëqind lule dhe të konkurrojnë njëqind shkolla». Pra, këto «njëqind shkolla» gjatë kësaj periudhe tranzitore do të vazhdojnë të konkurrojnë dhe të hyjnë midis tyre në konflikte politike, ekonomike dhe për pushtet, pse çështja e pushtetit në Kinë nuk është vendosur, klika të ndryshme, si ajo e Ten Hsiao Pinit dhe e Hua Kuo Fenit, aspirojnë ta shtien atë në dorë. Por, përveç këtyre, atje rrojnë edhe elementët e shëndoshë marksistë-leninistë, të cilët do ta shohin edhe vijën antimarksiste të Maos, edhe vijën reaksionare kapitaliste të këtyre që janë aktualisht në fuqi dhe, në një kaos të tillë, edhe këta do të përpiqen të konsolidojnë pozitën e tyre në revolucion. Ata do të shohin njëkohësisht edhe gjendjen shumë të rrezikshme në të cilën e kanë futur Kinën e tyre klika aktuale e Hua Kuo Fenit dhe e Ten Hsiao Pinit, domethënë në hallkat dhe në zinxhirët e imperializmit amerikan, të Japonisë militariste dhe të kapitalizmit botëror, në një konflagracion të

mundshëm edhe me një kapitalizëm tjetër të madh e të rrezikshëm, siç është Bashkimi Sovjetik. Me fjalë të tjera në Kinë, në mes të «njëqind shkollave», do të rritet edhe shkolla marksiste-leniniste, e cila në rrugë të drejtë do të fitojë terren dhe mund të kristalizohet një gjendje e shëndoshë, e cila me kohë do të marrë përpjesëtime të gjera.

E gjithë kjo situatë do të bëjë që të përfitojnë edhe amerikanët dhe reaksioni i brendshëm kinez, por edhe Bashkimin Sovjetik do ta çojë në kërkim aleancash aktuale, që do të ndiqet me transformime në aleanca më konkrete imperialiste, socialimperialiste. Do të shtohen kontraktat midis të gjitha këtyre shteteve që vijnë rrotull në vorbullën e planetit për të vendosur hegjemoninë e vet.

Pikërisht në këto situata klasa punëtore, e udhëhequr nga partitë e vërteta marksiste-leniniste, duhet të luajë një rol vendimtar. Është momenti i revolucioneve proletare, është periudha e kalbëzimit të imperializmit, i cili është dobësuar nga të katër anët dhe goditet, gjithashtu, nga të katër anët, ku më shumë e ku më pak, nga forca e proletariatit, nga forca e popujve që e gërryen dhe e dobëson. Kjo gërryerje dhe ky dobësim do të vijnë duke u shtuar dhe do të vërtetohet teza e Leninit se epoka aktuale është epoka e revolucioneve proletare.

Natyrisht, këto revolucione proletare nuk do të bëhen me një të rënë të trumbetës, por në bazë të situatave që krijohen, në bazë të rrethanave në çdo vend, në veçanti, dhe në botë, në përgjithësi. Vetëm se proletariati dhe popujt duhet të bëhen të vetëdijshëm mbi çka po ngjet, t'i kuptojnë mirë situatat, gjendjen politike, dhe të edukohen që brenda këtyre situatave në zhvillim të marrin rrugën e ndërgjegjshme për çlirimin e tyre. Me fjalë të tjera, të përgatiten për revolucionin.

Natyrisht, përgatitja për revolucion, nuk është diçka e lehtë, por një luftë e vazhdueshme me zigzage, me dis-fata e me fitore.

## DY VERSIONE TË NJË DEKLARATE

Lexova dy versione të një deklarate të këshilltarit presidencial të sigurimit kombëtar të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Brzezinski, lidhur me vendosjen e marrëdhënieve diplomatike amerikano-kineze. Versioni i parë është ai i Uashingtonit i transmetuar më 20 dhjetor nga agjencia amerikane e lajmeve, Asosiejtëd Pres dhe versioni i dytë, ai i Pekinit, i transmetuar më 21 dhjetor nga agjencia kineze e lajmeve HSINHUA.

Varianti i Uashingtonit ishte i shkurtër, konciz, fliste natyrisht sipas qejfit të vet dhe aq sa u duhej amerikaneve për konsum të jashtëm e të brendshëm. **Brzezinski thotë se këto marrëdhënie janë të rëndësishme, se vendosja e tyre e «pengon çdo përpjekje të Pekinit për pushimin me forcë të Tajvanit». Brzezinski shprehet kësh-tu: «S'kemi të bëjmë më me Kinën e vitit 1958».**

Ç'do të thotë kjo? Kjo do të thotë se zhvillimi i problemeve dhe i gjendjes në Kinë, në vitin 1958, duhet parë në lidhje me Bashkimin Sovjetik dhe me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Kemi të bëjmë, pra, me strategjinë «e madhe» kineze të asaj kohe, që ende, si me thënë, konsistonte në një unitet të dobët me hrushovianët, por prapë ishte «kundër imperializmit amerikan».

Në shënimet e Ditarit të atij viti gjenden përshtypjet e mia mbi ngjarjet e kohës. Në to unë kam lënë të kuptohet se ato kohë ishin momente kur midis Bashkimit

Sovjetik dhe Kinës po zhvilloheshin kontradikta, që më vonë do të merrnin karakter të theksuar. Sidoqoftë, edhe në bazë të atyre që kam shkruar në Ditar, del se momentet e vitit 1958 nuk ishin të përshtatshme për Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Me fjalë të tjera, Kina e vitit 1958 nuk e kishte kthyer fytyrën e saj sa dhe si duhej drejt Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Bile, siç raporton agjencia Asosiejted Pres, Brzezinski thotë më poshtë se «në krahasim me 20 vjet më parë, kur Kina u ballafaqua me Tajvanin lidhur me çështjen e ishujve përreth të kontrolluara prej tij, Pekini ka shfaqur për tetë vjet me radhë një dëshirë për t'u përshtatur me Perëndimin, në përgjithësi dhe, me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në veçanti».

Ç'do të thotë ky paragraf i dytë i deklaratës së Brzezinski?

Megjithëse në vitin 1978, kur u vendosën marrëdhëniet me Uashingtonin, Kina nuk ishte ajo e vitit 1958, prapë, edhe kur kishte një strategji prosovjetike dhe kundër imperializmit amerikan, ajo luante në të dyja tablotë, domethënë nuk ishte e sinqertë si ndaj Bashkimit Sovjetik të kohës së Stalinit, ashtu edhe më pas ndaj Bashkimit Sovjetik revizionist hrushovian. Në të dy rastet Kina lëkundej sa andej-këndej për të gjetur një rrugë të përshtatshme të «bashkekzistencës paqësore» me të dyja superfuqitë.

Natyrisht, në këta 20 vjetët e parë, për të cilët flet Brzezinski, Kina e Maos kishte shpresa të mëdha se hrushovianët do të mbështetnin kërkesat e saj në lidhje me Indinë, kërkesat në lidhje me ndihmat e mëdha ekonomike dhe sidomos në lidhje me dhënien e armës atomike. Megjithatë, ajo nuk e kishte me sinqeritet këtë çështje dhe Hrushovi, natyrisht, ishte dinak i madh e jo budalla. Ai i kuptonte veprimet e dyfishta të Maos që donte të mbante njërin dorë në bakllava dhe tjetrën në

revani. Prandaj gjatë kohës së «miqësisë» me Bashkimin Sovjetik, në këtë periudhë, Kina, siç thotë Brzezinski, «ka shfaqur për tetë vjet me radhë një dëshirë për t'u përshtatur me Perëndimin, në përgjithësi dhe, me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në veçanti».

Pra, kjo deklaratë e Brzezinski vërteton pikëpamjet e Partisë sonë të shprehura në Ditarin tim Politik për Çështje Ndërkombëtare, ku theksohen mungesat e parimeve në politikën e Mao Ce Dunit, të qeverisë dhe të Partisë Komuniste të Kinës dhe kryerja e veprimeve të paprincipita, të cilat u konkretizuan më vonë, në një strategji të re, të dyfishtë, kundër të dy superfuqive e që, pas Revolucionit Kulturor ose gjatë këtij revolucioni, rezultoi në një *volte-face*, siç thotë francezi, prej 180 gradësh drejt Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Brzezinski thekson se **njohja diplomatike e Republikës Popullore të Kinës nga ana e Shteteve të Bashkuara të Amerikës «bazohet mbi një gjykim politik rreth pikësnyimeve të Pekinit». «Dhe kjo, — vazhdon ai, — është disa herë më e rëndësishme se garancitë politike».**

Kjo është logjike, pse garancitë politike që kanë fituar Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe garancitë që Kina u ka dhënë këtyre, e kanë burimin në gjykimin politik të udhëheqjes aktuale kineze që sundon në Kinë.

**Me fjalë të tjera, udhëheqja kineze është në rrugën kapitaliste dhe, duke qenë në një rrugë të tillë, garancitë politike për Amerikën bëhen më të sigurta.**

Karteri është kritikuar nga opinioni amerikan, sidomos nga ai konservator, që përbën lobin e Çan Kai Shisë, sepse mori këtë vendim pa lejën dhe pa aprovimin e Senatit. Por Brzezinski ngre pretekstin se vendimi i presidentit është në interes të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe se administrata e Karterit «e ka deklaruar vazhdimisht, publikisht, se shkëmbimi i ambasadorëve me Kinën mbi bazën e parimeve të Komunikatës së

Shangait të vitit 1972, ishte pikësynimi i saj», komunikatë e cila është pranuar nga Senati Amerikan. Prandaj nga ana procedurale dhe konsensuale Karteri e di se nuk ka asnjë pengesë reale. Pengesat janë propagandistike. Ato nuk bëjnë asnjë dëm, përkundrazi, fitimet që korrën Shtetet e Bashkuara të Amerikës nga lidhjet diplomatike me Kinën janë shumë të mëdha.

**Pekini nga ana e vet, nëpërmjet agjencisë HSINHUA, më 21 dhjetor, deklaratën e Brzezinskiit e merr si mbrojtjen e një avokati amerikan që flet në favor të Kinës dhe që e vë veten, domethënë Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në një pozitë të atillë që nuk mund të bëjë ndryshe veçse të ndjekë ose t'i pranojë veprimet e Kinës.** HSINHUA-ja thotë se Brzezinski në fjalimin e tij ka thënë: «Po të flasim për një botë të ndryshuar, asnjë zhvillim nuk është më i rëndësishëm sesa normalizimi i marrëdhënieve amerikane me Kinën».

Pra, kinezët, me këtë frazë që kanë nxjerrë nga deklaratata e Brzezinskiit, i japin një rëndësi kolosale çështjes së Kinës e vendosjes së marrëdhënieve diplomatike me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe me fjalën e Brzezinskiit duan të thonë që, në rast se pranohet që bota po ndryshon, ishte absolutisht e domosdoshme të lidheshin marrëdhëniet me Kinën. **Kështu, «Kina është një fuqi, pa të cilën nuk mund të zhvillohet bota».**

Pse Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk e bënë më parë këtë gjest «për zhvillimin e botës»? Këtë nuk e thotë Kina e nuk e thotë as Brzezinski. **Por këtë e themi ne. Shtetet e Bashkuara të Amerikës luftuan dhe krijuan në Kinë një situatë të ndryshueshme në favor të tyre. Kjo situatë bëri të mundur realizimin e marrëdhënieve amerikano-kineze në favor të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.**

Agjencia kineze e lajmeve vë në dukje edhe këto fjalë të Brzezinskiit: «Ky vend (Kina) që përbën çerekun

e njerëzimit, është i vendosur të zhvillohet me shpejtësi e të luajë një rol aktiv në çështjet botërore dhe ne mendojmë se një Kinë e fortë dhe e sigurt mund të kontribuojë në stabilitetin ndërkombëtar».

Ç'do të thotë kjo? Nga ana e kinezëve do të thotë se i bëmë Shtetet e Bashkuara të Amerikës t'i vënë gishtin kokës dhe të mendojnë se pa Kinën «nuk mund të ndryshojë bota» dhe se Kina është çereku i botës.

Prandaj Shtetet e Bashkuara të Amerikës, sipas Kinës, paskan menduar se stabiliteti ndërkombëtar do të sigurohet me një Kinë të fortë, dhe kjo «Kinë e fortë» ka vendosur ta kthejë fytyrën e vet drejt Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Kjo do të thotë (dhe këtë s'e thonë haptazi as HSINHUA-ja, as Brzezinski) se Kina kërkon me shpejtësi të luajë një rol aktiv në çështjet botërore. Për ne kjo do të thotë, siç e kemi theksuar vazhdimisht, se Kina synon të bëhet superfuqi, duke u mbështetur në ndihmat ushtarake-teknike amerikane.

Sipas Brzezinskiit, gjë që e përsërit edhe HSINHUA-ja, lidhja e marrëdhënieve diplomatike me Kinën Popullore është «një arsye historike dhe jo një përfundim imediat taktik i presidentit amerikan». Shtetet e Bashkuara të Amerikës, pohon Brzezinski, bënë që «të konsultohen më nga afër mbi çështjet e interesit të përbashkët strategjik».

Vërtetohen mendimet tona që i kam shprehur në Ditarin tim Politik për Çështje Ndërkombëtare se shpejtimi i armatimit dhe i zhvillimit në teknologji i Kinës synon që ta kthejë atë në një superfuqi dhe aleate luftarake të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të Japonisë. Traktati i Kinës me Japoninë u nënshkrua, por s'është çudi që në këtë drejtim të jenë nënshkruar edhe marrëveshje sekrete me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Kina me këto i thotë Bashkimit Sovjetik se u krijua një bashkim armiqësor kundër tij.

Më poshtë HSINHUA-ja, citon këto ide të Brzezinski: «Në një kontekst të tillë, sigurimi ynë kombëtar varet nga dhënia e një drejtimi pozitiv këtij procesi të stuhishëm të zgjimit politik dhe rishpërndarjes së forcës në të gjithë botën».

Kina këtë e quan si një mendim real e të favorshëm të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Natyrisht, ajo nuk gabohet në këtë drejtim. Por kjo tregon, gjë që kuptohet, se imperializmi amerikan ka nevojë që, së toku me Kinën, të përballojë superfuqinë tjetër, Bashkimin Sovjetik. **Mbi të gjitha, imperializmi amerikan parashikon zgjimin politik të popujve të botës, i cili do t'i ngrejë këta në revolucion, prandaj Brzezinski thekson se është e nevojshme «të rishpërndajmë forcat në të gjithë botën».** Me fjalë të tjera, duhen krijuar aleanca të reja për të dominuar situatat e zhvillimit aktual të botës, «zhvillim», i cili sipas pikëpamjes sonë, s'është gjë tjetër veçse kalbëzimi i imperializmit dhe periudha e revolucioneve proletare.

**Pra, degjenerimi i Kinës është një nga faktorët që krijojnë paqëndrueshmëri në statukuonë e fuqive imperialiste, prandaj Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për të shtypur në të ardhmen popujt që zgjohen dhe që kërkojnë çlirim, u duhet më përpara të gjejnë një forcë reaksionare për t'u bashkuar.**

Brzezinski thotë që, në qoftë se Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk ndjekin një rrugë të tillë, «ne krijojmë pengesa artificiale për ndryshimet për hatër të statukuosë», dhe më tej shton: «Ne nuk do të bëjmë gjë tjetër veçse do të vetizolohemi dhe në mënyrë të dukshme do të rrezikohet dhe do të minohet sigurimi ynë kombëtar».

Pra, gjithë preokupimi i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të cilin udhëheqja kineze e vë në dukje, është sigurimi i tyre, sigurimi i imperializmit amerikan. Në

çdo gjë që bëjnë Shtetet e Bashkuara të Amerikës kurdoherë kanë parasysh sigurimin e tyre, dominimin e botës. Ato janë kundër statukuosë, ndërsa Kina predikon sikur kërkojnë statukuonë. Në fakt, me gojën e Brzezinski ato nuk e pranojnë statukuonë, përkundrazi, kërkojnë organizim, mobilizim dhe unitet të forcave reaksionare për të dominuar kundërshtarët e vet, në radhë të parë, popujt që ngrihen në revolucion, dhe fuqinë tjetër imperialiste, Bashkimin Sovjetik.

Brzezinski e shpreh këtë dhe HSINHUA-ja e vë në dukje, pse në këtë bazohet gjithë propaganda e saj. Ç'thotë Brzezinski? Ai shprehet kështu: «Argumenti i vazhdueshëm i rrezikut të aftësisë bërthamore sovjetike, në mënyrë të veçantë në Evropë, si dhe krijimi i forcave strategjike dhe konvencionale sovjetike nuk ka se si të mos merrin parasysh» dhe thekson: «Ne e ndiejmë se është e nevojshme që të përmirësojmë forcat tona bërthamore strategjike. Ne duhet të korrigjojmë ndieshmërinë e sistemit tonë të raketave ndërkontinentale me mbushje bërthamore».

Kjo, me fjalë të tjera, do të thotë açik se lidhjet diplomatike në mes Kinës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës kanë perspektiva imediate e të largëta dhe këto perspektiva u kundërvihen forcave strategjike bërthamore dhe konvencionale të Bashkimit Sovjetik që kërcënojnë njëkohësisht Kinën dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me një fjalë, kërcënojnë dominimin e botës prej tyre. Prandaj u krijuan këto lidhje, për të kaluar në një aleancë midis Kinës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Kjo e kënaq pa masë Kinën. Është ajo që kemi parashikuar ne se, duke u bërë aleate e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Kina i thotë Bashkimit Sovjetik: Me këtë aleancë ne bëhemi një forcë kolosale kundër teje.

Nga ana tjetër HSINHUA-ja përsërit fjalët e Brzezinski: «Shqetësimi ynë i dytë imediat ka të bëjë me



E MARTË  
26 DHJETOR 1978

## RRETH NGJARJEVE NË SHESHIN TIEN AN MEN

Sikurse bën të ditur agjencia HSINHUA, më 21 dhjetor gazeta «Zhenminzhibao» botoi një artikull me titull «Rroftë populli!», të shkruar nga një komentator që ishte «ftuar» në zyrat e redaksisë së gazetës.

Ky është fillimi i gënjeshtërs, pse komentatori «i ftuar» që shkruan një artikull të tillë, me siguri është një nga udhëheqësit kryesorë, në mos përfaqëson një grup udhëheqësish. Artikulli kërkon «të vërtetojë» ngjarjet historike, të cilat përpiqet «t'i vërë» në vendin e duhur dhe t'u japë rëndësinë që «meritojnë». Këtu çështja është për ngjarjet e prillit 1976 në sheshin Tien An Men. Sipas këtij artikulli, «zbulimi i së vërtetës rreth ngjarjeve të sheshit Tien An Men, është një provë e ligjit të pakundërshtueshëm se e vërteta nuk mund të fshihet kurrë».

Pra, e vërteta në këtë rast është se *l'émeute*<sup>1</sup> e Tien An Menit ditën e dëshmorëve dhe ditën e përvjetorit të vdekjes së Çu En Lait, qenka, siç thotë artikulli, një «veprim i madh masiv revolucionar që hodhi shkëlqimin e tij në gjithë Kinën» dhe se kjo ngjarje është «burim krenarie për kombin kinez, një ngjarje heroike në historinë e socializmit dhe një monument i pavdekshëm në

<sup>1</sup> Nga frëngjishtja — trazirë.

historinë e popullit kinez», bile «ai do të mbetet në histori së bashku me poemat emocionante revolucionare që u përhapën në të gjithë vendin».

Rrëmuja e Tien An Menit ishte një «luftë për jetë a për vdekje» për Kinën dhe, sipas këtij myteberi, fitoi jeta, pse u zhvilluan ngjarje revolucionare, të cilave tash-tu u është vënë titulli «Lëvizja e 5 prillit». Kjo «nuk ishte diçka e rastit», na thotë komentatori që nga zyrat e «Zhenminzhibaos», por ishte një «iniciativë e madhe e ndërmarre nga miliona revolucionarë». Pra këtu, si të thuash, nuk paska gisht Ten Hsiao Pini.

Në të vërtetë ngjarjet e Tien An Menit me siguri të plotë ishin organizuar nga klika e Ten Hsiao Pinit. Demonstruesit shkuan në Tien An Men në heshtje, pse ishte dita e dëshmorëve dhe, në qoftë se ata rezistuan, kjo i përngjiste rezistencës gandiste, domethënë ishte pasive. Kjo rezistencë pasive e këtyre mijëra vetave dhe jo milionave, siç thotë komentatori, do të kalonte në heshtje nëse elementët që ishin në fuqi në atë kohë, Hua Kuo Feni, Van Hun Veni e të tjerë do të kishin ruajtur gjakftohtësinë.

Pra, si ata që ishin në fuqi, si ata që e organizuan këtë trazirë, kishin qëllime puçiste dhe ky mund të quhet vetëm veprim puçist e asgjë tjetër. Kur quhet «trazirë» një marshim i heshtur i 10, 20 apo 100 mijë vetave në Tien An Men, ç'mund të quhen lëvizjet e masave popullore në Iran, që prej tre muajsh me radhë, ditë për ditë, po dalin nëpër rrugë, përlëshen me ushtrinë e shahinshahut, gjakosen, arrestohen dhe vriten?

Kina këto përlëshje të përgjakshme të popullit iranian, në të gjitha qytetet dhe jo vetëm në Teheran, as që i përmend fare. Përkundrazi, ajo merr në mbrojtje shahun dhe veprimet e përgjakshme të ushtrisë dhe të SAVAK-ut të shahut. Pra, për revolucionin në Kinë ka dy kuptime: trazirë quhet revolucion, ndërsa revolucion

kundër shahinshahut, këtij mbreti feudal, quhet «mungsë rregulli e disipline». Njerëzit që sundojnë sot në Kinë nuk kanë asnjë fije gjykimi marksist.

Që t'i japin kësaj ngjarje ngjyrën e fillimit të një revolucioni tjetër të madh, që është quajtur revolucioni i «katër modernizimeve», natyrisht, këta renegatë të marksizëm-leninizmit teorizojnë, duke thënë se «lëvizjet e mëdha politike i kanë rrënjët në jetën ekonomike dhe politike të shoqërisë dhe kërkesat shoqërore janë shkaqet e tyre», dhe me këtë zotërinjtë kinezë duan të vërtetojnë se prapa rrëmujës që u krijua në sheshin Tien An Men, nuk është dora e Ten Hsiao Pinit dhe e bandës së tij, por qenkej «vullneti i shprehur i popullit».

Këta udhëheqës revizionistë e kapitalistë thonë se kaloi ajo kohë kur në Kinë revolucioni shpërthente, «pse ashtu donin disa agjitorë». Revolucionin, bëjnë demagogji ata, e shpërthen shoqëria. Dhe, për ta ilustruar këtë, ata bëjnë përpjekje që thënie të Marksit e të Engelsit t'i shkëputin nga konteksti, t'i cungojnë e t'ua përshtatin arbitrarisht puçit dhe intrigave të një bande renegatësh antimarksistë që kërkojnë të konsolidojnë pushtetin e tyre të dalë nga puçi ushtarak. Sipas tyre likuidimi i bandës së «të katërve», likuidimi i Lin Biaos, që akuzohen se ia kanë sjellë të gjitha këto fatkeqësi Kinës, qenkan bërë me vullnetin e popullit dhe jo «me një të goditur», ashtu siç e paraqesin Hua Kuo Feni dhe Ten Hsiao Pini. Këta njerëz u likuiduan pikërisht me një të goditur dhe s'është aspak e vërtetë se ata i rrëzoi populli që u ngrit. Përkundrazi, deri në njëfarë shkalle, nga ana e jashtme, një gjëje të tillë mund t'i përshtatet Revolucionit Kulturor, gjatë të cilit Maoja u bëri thirrje miliona studentëve e nxënësve, të cilët u ngritën dhe sulmuan shtabet, sulmuan partinë dhe e likuiduan.

Edhe Revolucioni Kulturor ishte një aksion i ngritur përsëri nga agjitorët, prapa të cilëve, në fakt, qëndronte

Maoja, por në rrugë jo të drejtë, pse atakoheshin partia dhe proletariati. Në pamje të jashtme ky mund edhe të quhej një «revolucion», por jo puçi i Hua Kuo Fenit dhe as lëvizja e Tien An Menit.

Mua më duket se «banda e të katërve», siç e theksojnë edhe këta që janë sot në fuqi, e cilësoi veprimin masiv në sheshin Tien An Men si një incident politik kundërrevolucionar. Ky ka qenë një gjykim i drejtë, më serioz dhe ka një bazë. Por vetëm me këtë kuptim që u dha «katërshja» këtyre ngjarjeve, Ten Hsiao Pini dhe banda e tij nuk habiten. «Në qoftë se ata, — thotë banda e Ten Hsiao Pinit, — nuk do ta kishin zakon të shtrembëronin historinë në këtë mënyrë, ata nuk do të ishin bërë objekt i sulmeve të kësaj lëvizjeje dhe nuk do të ishin sjellë në mënyrë gjakatare, duke mashtruar popullin dhe duke shkaktuar gjakderdhje».

Nuk mungojnë të bëhen edhe disa përjashtime të heshtura, pse në krye të organizimit të shtypjes së përgjashme të këtij incidenti që thonë ata, ka qenë edhe vetë Hua Kuo Feni, tash kryetar i partisë, i cili tok me shokët e vet, të atëhershëm, «bandën e të katërve» duke vepruar nën flamurin e direktivat e Maos dhe duke u bazuar në shkrimet e tij, nxori milicinë. Edhe aktualisht çdo gjë bëhet duke u bazuar në shkrimet e Maos.

Pra, «Zhenminzhibaoja» thotë se «thelbi i ngjarjeve të sheshit Tien An Men ishte vajtimi për kryetarin e Këshillit të Shtetit, Çu En Lain dhe kundërshtimi ndaj bandës së të katërve». Kjo do të thotë se sheshi Tien An Men, sipas Ten Hsiao Pinit dhe Hua Kuo Fenit, u kthye në murin e lotëve të Jerusalemit, ku në ditën e të vdekurve njerëzit venë murmuritin lutje për Mesinë, rrëfeshen për fatkeqësitë që u kanë ndodhur dhe kërkojnë shërimin e plagëve shpirtërore nga forca hyjnore e perëndisë. Edhe ngjarjet e sheshit Tien An Men i përngajnë «revolucionit gandist», «revolucionit të heshtur».

Ky artikull vë në dukje se populli 800 milionësh kinez gjatë Revolucionit Kulturor kishte fituar eksperiencë të madhe për të bërë revolucion, mirëpo autori harron që këtë Revolucion Kulturor, të udhëhequr nga Mao Ce Duni, e bënë nxënës e studentë, të cilët marshonin drejt Pekinit dhe qendrave të qyteteve të tjera të Kinës duke hedhur slogane për shkatërrimin e grupit revizionist të Liu Shao Çisë dhe të Ten Hsiao Pinit, për të likuiduar partinë, për të likuiduar të gjitha organizatat e masave.

Kjo ngjarje e heshtur në sheshin Tien An Men, thuhet në artikullin e «Zhenminzhibaos», përfaqësonte vullnetin e madh të popullit, vullnetin revolucionar, dhe njerëzit shkonin atje për të nderuar «bërin e madh» të Kinës që përfaqësonte «të gjitha të mirat» e popullit kinez, që nga cilësitë e karakterit, të vullnetit, të qetësisë, të besnikërisë, të guximit etj., etj. Artikullshkruesi nuk harron të vërë në dukje që Çu En Lai, kur u sëmur rëndë, thirri pranë tij Ten Hsiao Pinin dhe e ngarkoi atë me punë në Komitetin Qendror, që bashkë me njerëzit e tij «të zbatonin vijën revolucionare» të shokut Mao Ce Dun, pavarësisht se ky e kishte quajtur Ten Hsiao Pinin revizionist dhe e kishte dënuar së bashku me grupin e tij, të zbatonin «mësimet e Maos», të studionin teorinë marksiste-leniniste, rekomandim, të cilin Mao Ce Duni s'e ka bërë kurrë, «të sigurojë stabilitet dhe unitet», që ai, gjithashtu, s'e ka bërë kurrë vetë dhe «të çojnë përpara ekonominë kombëtare», gjë që nuk e kanë zbatuar as Maoja, as Çu En Lai. Ky i fundit, tok me Li Hsien Nienin, kanë qenë artizanët kryesorë të ekonomisë në Kinë. Maoja ka mbretëruar si diktator, ai bënte siç mendonte vetë. Nga një politikë e tillë Kina mbeti pas dhe fajin nuk e ka «katërshja», por Mao Ce Duni, Çu En Lai dhe pasuesit e tyre.

Pra, grupi i ri i Hua Kuo Fenit dhe ai i Ten Hsiao

Pinit duhet t'i gjejnë një arsye, një ilaç, një gënjeshtër kësaj fatkeqësie të madhe që i ndodhi Kinës dhe për këtë e gjetën «kokën e turkut»: Lin Biaon dhe «katërshen». Unë nuk them se këta të fundit kanë qenë njerëz të mirë, por në radhë të parë s'ka qenë i mirë vetë Mao Ce Duni, pse të gjithë këta punonin nën drejtimin e Maos dhe ishte ky që goditi edhe Kao Ganin, edhe Pin De Huanë, edhe Pen Çenin, edhe Ten Hsiao Pinin, edhe Liu Shao Çinë, dhe të gjithë ata që sot po rehabilitohen.

Po a tha ndonjë fjalë Ten Hsiao Pini kur bëri panegjirëkun e Pin De Huasë me rastin e rehabilitimit të tij? Ai e ngriti atë në qiell, por nuk tha asnjë fjalë përse ky, Pin De Huaja, u dënua dhe u hoq. Vetëm në të kaluar e sipër tha se ishte dënuar e hequr nga intrigat e Lin Biaos. Po përse nga intrigat e Lin Biaos? Atë e hodhi tej Mao Ce Duni dhe në mënyrë jomarksiste mund të themi, në mënyrë brutale, duke ushtruar pushtetin e tij personal të pakufishëm. Sot interesat e Huasë e të Tenit kërkojnë që ata të mos i përmendin këto gjëra dhe të gjitha fajet e Çu En Lait e të Mao Ce Dunit t'ua hedhin vetëm «katërshes» dhe Lin Biaos, të cilët nuk ishin më të mirë se këta, por ishin të një stofi, të një stofi të vjetër, të ngrënë nga minjtë.

Kinezët nuk harrojnë të thonë se gjatë Revolucionit Kulturor ka pasur edhe njerëz të mirë që nuk i dinin qëllimet e këqija të «bandës së të katërve», që u mashtruan, dhe kështu, sipas tyre, u krijua «një rrymë e kundërt në revolucionin e madh proletar», i cili, thonë këta, ishte në rregull, po «i shkaktoi vuajtje popullit kinez», pse, kuptohet, goditi bandën reaksionare kapitaliste të Liu Shao Çisë e të Ten Hsiao Pinit me shokë.

Populli, thonë këta myteberë, vuajti shumë gjatë Revolucionit Kulturor. Natyrisht, populli kinez vuajti dhe nuk rronte në parajsë, por fajin nuk e kishte vetëm «banda e të katërve». Fajin kryesor e kishin Mao Ce

Duni me vijën e tij antimarksiste dhe gjithë partia, e cila udhëhiqej nga kjo vijë që nuk e bëri kurrë popullin të ecte në rrugën e vërtetë të socializmit dhe të rregullonte pak a shumë më mirë dhe progresivisht të ardhmen e tij.

Artikulli i «Zhenminzhibaos», natyrisht, nuk mungon të vërë në dukje se të gjithë ata që u akuzuan si armiq të klasës punëtore, si autoritete reaksionare etj., u persekutuan. Pra, gjithë veprimtaria gjatë Revolucionit Kulturor ishte vepër e «bandës së të katërve». Ajo persekutoi popullin, në kohën e saj, «mijëra njerëz akuzoheshin, arrestoheshin, burgoseshin, torturoheshin pa të drejtë».

Vihet re i njëjti stil që përdori Hrushovi kundër Stalinit. Vepra e Hrushovit, pra, nuk shkoi dëm. Tash ajo është ngritur në parim. Në Kinë, si një «arsye» e shëndoshë kundër «bandës së të katërve», përdoret akuza se ishte ajo që i solli fatkeqësinë popullit kinez, ndërsa tash «për të mirën e tij» erdhi në fuqi banda e Ten Hsiao Pinit, «e njeriut të vitit», siç e quajti shtypi amerikan, dhe ky do ta çojë Kinën në socializëm! Si do ta çojë? Natyrisht, thonë renegatët kinezë «në rrugën e Marksit, Engelsit, Leninit, Stalinit dhe të Mao Ce Dunit». Këtë të fundit ata nuk e harrojnë, sido që të gjithë janë kundër tij dhe s'bëjnë keq që janë kundër, pse Mao Ce Duni kurrë nuk ka qenë marksist dhe nuk mund të vihet kurrë krahas katër klasikëve. Mund të themi se Mao Ce Duni nuk ishte fashist, siç janë këta të sotmit. Ai ishte një demokrat borgjez revolucionar që nuk kuptonte nga çështja e marksizmit dhe gjithçka që ngjau nuk shkoi në drejtimin e ndërtimit të socializmit.

Me një tiradë të madhe, propagandisti i zellshëm i «Zhenminzhibaos», duke përdorur fraza dhe slogane marksiste që shërbejnë për të fshehur synimet revizioniste e kapitaliste, na përshkruan qëllimin e revolucionit socialist. Ai përdor fraza të tilla si «në vendet socialiste popujt janë zot», «demokracia socialiste është demokracia

më e gjerë dhe nuk mund të gjendet në asnjë vend borgjez», «socializmi mund të arrihet vetëm kur ekziston udhëheqja e proletariatit (që në Kinë nuk ka ekzistuar kurrë) dhe pararoja e saj» (që edhe kjo në Kinë nuk ka ekzistuar kurrë, por ka ekzistuar dhe vazhdon të ekzistojë pushteti personal). Në fakt, në Kinë ka një parti që quhet komuniste, por që nuk është aspak komuniste.

Në artikull «banda e të katërve» akuzohet se mban-te lidhje me borgjezinë brenda në parti. **Ekzistenca e borgjezisë brenda në Partinë Komuniste të Kinës është një e vërtetë e madhe.** Në fakt borgjezia brenda partisë ishte pjellë e Mao Ce Dunit, së cilës ai vetë me teorinë e tij të «dy vijave» e «të lulëzimit të njëqind luleve» dhe «të konkurrimit të njëqind shkollave», i kishte krijuar mundësi të vegjetonte dhe të drejtonte në parti. Kur kjo bëhej e rrezikshme për personin dhe për pushtetin e tij personal Maoja e likuidonte dhe jo me dorën e tij, por me të atyre që komandonte, që i bindeshin e që i gënjente. Në mes tyre kanë qenë edhe «katërshja», edhe Çu En Lai, por kanë qenë edhe miliona njerëz të tjerë që ndiqnin vijën e Mao Ce Dunit, sepse mendonin që kjo ishte një vijë marksiste-leniniste.

Në artikull thuhet edhe një *enormitet* i madh, se «socializmi bazohet në gjithë eksperiencën e kulturës kapitaliste». Pra, për Ten Hsiao Pinin kultura kapitaliste është çdo gjë, prandaj kjo duhet të inkuadrohet edhe në socializëm. Artikulli nuk bën asnjë dallim në kulturën kapitaliste, bile rrënjët e realizmit socialist i gjen pikërisht në këtë kulturë, pra në mentalitetin, në qëllimet e kapitalit e të kapitalistit, sepse dihet që kultura kapitaliste i shërben një rendi tjetër krejt të ndryshëm nga ai socialist. Në kulturën kapitaliste, natyrisht, ka disa gjëra përparimtare, që duhet medoemos t'i shikojmë me sy kritik, dhe kultura socialiste t'i adaptojë, në qoftë se janë për të adaptuar, por në asnjë mënyrë nuk mund

të merret gjithçka prej saj e ashtu siç është. Kurse demagogët, për të cilët e kam fjalën, nga zelli i madh që u ka hipur, harrojnë të fshehin ndjenjat e veta kapitaliste dhe padashur zbulojnë të vërtetën, duke nxjerrë «xhevahire» të tilla në shkrimet e tyre.

Vetë Ten Hsiao Pini ka pohuar dikur se ka qenë një ruajalist, një njeri që mbronte feudalizmin, kurse tash është kthyer dhe akuzon «katërshen» se të gjitha këto të këqija, siç janë akuzat e padrejta kundër njerëzve të pafajshëm, implikimi në fajësi jo vetëm i viktimave, por edhe i të afërmeve të tyre, i fëmijëve dhe i të njohurve të tyre etj., etj., bien erë feudalizëm.

Artikulli i «Zhenminzhibaos» pretendon se në kohën e «katërshes» punëtorët, fshatarët, ushtarët, intelektualët, që ishin të shtypur, menduan përgjigjen që duhej të jepnin, «me anë të një procesi të thellë krahasimi». «Ata, — sipas artikullit, — kuptuan se **vija e «bandës» ishte feudalizëm me maskë socialiste, kuptuan se «katërshja» mbante lart flamurin e kuq, duke pretenduar se ishte e majtë dhe revolucionare, ndërsa në fakt ishte shtypëse e popullit».** Autorët e artikullit harrojnë se ata nuk kuptuan asgjë dhe as nuk e morën mundimin ta kundërshtonin «bandën e të katërve» dhe ta denonconin atë si një klikë feudalësh, me Mao Ce Dunin në krye, perandorin e tyre.

Pastaj «Zhenminzhibaoja» dhe komentatori i saj «i ftuar» vënë pyetjen: «Ç'do të ndodhë në Kinë? A do të ecë Kina triumfalisht drejt qëllimit të katër modernizimeve të parashtruar nga Partia Komuniste e Kinës dhe udhëheqësi i saj, shoku Mao Ce Dun (megjithëse ai s'i ka përcaktuar asnjëherë «katër modernizimet»), apo do të lejohet banda e të katërve të shkatërrojë çështjen e revolucionit dhe ta kthejë Kinën socialiste në një humnerë gjysmëfeudale dhe gjysmëkoloniale?». Dhe japin përgjigjen se, sigurisht, Kina do të ecë drejt një revo-

lucioni tjetër të madh, revolucionit të «katër modernizimeve». Sipas tyre, **i tërë populli kinez e ka kuptuar tradhtinë e «katërshes» dhe «rrugën e drejtë marksiste-leniniste» të udhëheqjes aktuale. Ja ç'thonë: «Ky ishte problemi që shqetësonte të 800 milionë banorët e Kinës. Pa dyshim, Partia dhe populli ynë nuk do ta lejonin kurrë një regres të tillë. Nuk mund të kishte përgjigje tjetër ndaj bandës kundërrevolucionare të të katërve, përveçse revolucionit fitimtar në shkallë kombëtare. Ky ishte përfundimi në të cilin arriti populli në këto kushte të vështira».**

**Ç'faza bombastike dhe të gënjeshtërtat!**

Në artikull, thuhet se populli kinez do që më parë të fitojë revolucionin, socializmi në Kinë dhe pastaj revolucionin i madh botëror dhe ai do të kontribuojë për këtë. Në realitet as «banda e të katërve», as Mao Ce Dun, as udhëheqja aktuale nuk kanë menduar e nuk mendojnë për revolucionin në Kinë, pale për revolucionin botëror!

Artikulli kthehet përsëri te ngjarja e sheshit Tien An Men dhe e quan atë «gur vendimtar në histori» dhe jo vetëm në historinë e Kinës, por gjatë festivalit të Cingmingut, më 1976, ai «u bë edhe një herë qendër e vëmendjes botërore». Pra del se Tien An Meni na qenka qendra e vëmendjes botërore, kërthiza e botës dhe Kina «Perandoria e Mesit», perandoria në mes të perandorisë amerikane dhe asaj sovjetike. Me këtë përcaktim, «duke hedhur parulla revolucionare e duke kënduar Internacionalen në sheshin Tien An Men, populli i Pekinit, si dhe gjithë populli kinez», as më pak e as më shumë, «shprehën kërkesat dhe dëshirat e tyre, vullnetin dhe forcën e tyre si krijues të historisë, të cilët nuk mund t'i ndalte askush».

Ky «komentator» i «Zhenminzhibaos» thotë se «veprimtaria e bandës së të katërve gjatë një dekade ka kri-

juar dy kategori njerëzish në jetën politike të Kinës. Nga njëra anë qëndron një grup njerëzish që janë turpi i kombit, anëtarë të fraksionit kundërrevolucionar të bandës, dhe nga ana tjetër qëndrojnë revolucionarët, njerëzit e mirë», Ten Hsiao Pini dhe banda e tij, ose më mirë «lëvizja e madhe revolucionare masive, e cila ishte shprehje e aspiratave të partisë, të ushtrisë e të popullit, të mençurisë së popullit, të talentit të tij» etj., etj. (Këtë popull as nuk e peshojnë fare këta njerëz dhe ata që humbën davanë.)

«Banda e të katërve, thotë artikulli, kishte punuar me mjaft marifet sa që kishte uzurpuar poste drejtuese në parti dhe në shtet, pra edhe në Komitetin Qendror të Partisë të kryesuar nga shoku Mao Ce Dun». Kjo do të thotë se Mao Ce Duni ishte një leckë që s'peshonte fare, që hiqej prej hunde nga kush të vinte në fuqi. Kur ishin në fuqi njerëzit e «bandës», e tërhiqnin ata nga hunda, kur ishte Liu Shao Çia, e tërhiqte ai, por kurdoherë «Mao Ce Duni ishte frymëzuesi i madh i të gjitha luftërave të mira për socializmin». Këto janë absurditete, janë kontradikta që nuk hahen.

Por, thotë artikullshkruesi, «populli nuk u kushtoi vëmendje urdhrave të bandës, veptoi kundër udhëzimeve të saj për çdo gjë». Kjo s'është e vërtetë. Populli iu bind që ç'ke me të «bandës së të katërve» ose të të pestëve, me Mao Ce Dunin në krye, ose të të gjashtëve, edhe me Lin Biao në mes. «Autokratët fashistë që mendonin se pushteti është gjithçka, nuk kishin çfarë të bënin», thotë zëdhënësi i revizionistëve kinezë. «Ata nuk pranuan të lejonin popullin të vajtonte për kryetarin e Këshillit të Shtetit», por lejuan që kjo «bandë e të katërve» për 10-15 vjet me radhë të sundonte në Kinë.

Shiko ç'barazime po bëjnë: Armiku, thonë ata, dhe dinë të përdorin fraza, «hyri si krimbi në zemër të partisë dhe të shtetit» dhe «lufta nën diktaturën e proletarietit

u bë shumë e komplikuar». Por në fakt ajo nuk u bë «shumë e komplikuar», ose aspak e komplikuar, për arsye se në Kinë nuk ekzistonte diktatura e proletarietit, por një diktaturë personale, një diktaturë borgjeze kapitaliste, ku kishte njëqind rryma që luftonin midis tyre për të marrë pushtetin. Pra, krimbi kishte hyrë me kohë brenda në parti dhe në pushtet.

«Në veprimin e masave revolucionare në sheshin Tien An Men, thotë ky myteber, revolucionarët e vjetër proletarë (domethënë të gjithë kundërrevolucionarët që u rehabilituan), e treguan veten të denjë për besimin e madh që ka për ta populli dhe meriton të mbahet parasysh se një grup punëtorësh të rinj qëndruan në pararojë të luftës revolucionare, dhe ishin pararoja më e guximshme dhe më e vendosur». Në fakt, këta krerë të reaksionit, këta «revolucionarë të vjetër», as që u ndodhën fare në radhët e para të asaj demonstratë të heshtur në sheshin Tien An Men, as nuk lëshuan ndonjë lot për Çu En Lain. Vetë Ten Hsiao Pini ishte fshehur si një mi dhe, në vend që të dilte të luftonte edhe ai, u jepte urdhra njerëzve të tij si të vepronin. Kështu skenari rregullohet: «Banda e të katërve e gjeti veten të rrethuar nga i gjithë kombi dhe përdori dhunën kundërrevolucionare në shtypjen brutale të masave të paarmatosura»; dhe në këtë mënyrë ajo u çarmatos me një të goditur të zotit Hua Kuo Fen.

Pra, për këta renegatë lëvizja masive, gjoja revolucionare, në sheshin Tien An Men «hapi një faqe të re në histori, fillimin e periudhës së re të zhvillimit të revolucionit socialist dhe të ndërtimit socialist në Kinë». Pra, çka ishte bërë përpara, nuk ishte as fillimi, as mbairimi i revolucionit socialist. Këtë e pohojnë edhe vetë, natyrisht, për të ngritur kauzën e tyre. Por kauza e tyre është po aq e krimbur, sa dhe kauza e Mao Ce Dunit.

Dhe përsëri, për të mbështetur tezën e tyre të «ka-

tër modernizimeve», autorët e artikullit thonë se duhen lënë mënjanë politika dhe ideologjia. Për këtë më parë kanë folur Ten Hsiao Pini e të tjerë, bile çështjen e vënë në gojë të Mao Ce Dunit, i cili, thonë ata «i ka bërë thirrje herë pas here partisë ta kalojë theksin e saj nga lufta e stuhishme klasore e periudhës revolucionare, në prodhim e ndërtim dhe të dallojë e të zgjidhë drejt dy tipat e kontradiktave të ndryshme, për sa i përket natyrës së tyre, me qëllim që të bashkojë popullin e të gjitha kombësive të vendit për një betejë të re, betejën kundër natyrës, për zhvillimin e ekonomisë dhe të kulturës sonë, për të ndihmuar gjithë kombin që ta kalojë këtë periudhë kalimtare relativisht lehtë, për të konsoliduar sistemin tonë të ri dhe për të ndërtuar shtetin tonë të ri».

Kjo është porosia e Maos, të cilën që nga Çu En Lai, Ten Hsiao Pini, Liu Shao Çia, Pin De Huaja, Lin Biaoja e deri te këta që kanë ardhur në fuqi nuk e kanë vënë kurrë në zbatim, por tash që filloi kjo «periudhë e re e zhvillimit të socializmit», do ta zbatojnë.

Me këtë ata nxjerrin konkluzionin se «për arsye të ndryshme, ky ndryshim historik nga konsiderimi i lëvizjes politike si detyra qendrore në konsiderimin e zgjerimit të prodhimit si detyra qendrore, nuk është vënë me të vërtetë në jetë që prej më se 20 vjetësh. Ne kemi pësuar humbje të rënda për shkak të kësaj. Nuk u prek rëndë vetëm shpejtimi i zhvillimit të ekonomisë kombëtare dhe përmirësimi i nivelit të jetesës së popullit, por dhe konsolidimi i diktaturës së proletariatit dhe përmirësimi i sistemit politik në ekonominë socialiste. Kjo u ndie shumë në popull».

Ky është një konkluzion kritik, që këta njerëz i bëjnë vijës së Mao Ce Dunit. Kjo në fakt është e vërtetë, pse vija e Maos lëkundej nga njëri drejtim në tjetrin, nga drejtimi politik në atë ekonomik dhe nuk përqendrohej as te politika, as tek ekonomia, nuk i vinte ato në

raport të drejtë me njërin e me tjetrën, nuk vihej partia në drejtim, në udhëheqje. Këta që janë sot në fuqi në Kinë pretendojnë se do ta rregullojnë situatën. Por po këta njerëz, kur kanë qenë edhe më parë në fuqi, vepruan ashtu siç ka vepruar edhe Maoja. Të gjithë ata udhëhiqeshin nga pikëpamjet e Mao Ce Dunit dhe ky i likuidoi se nuk u bindeshin si duhej direktivave të tij. Këta donin që Kina të shkonte më me revan në rrugën kapitaliste, gjë që e ka thënë haptazi Liu Shao Çia në Kongresin e 8-të të Partisë Komuniste të Kinës. Edhe më vonë, e derisa vdiq, Mao Ce Duni e ka aprovuar këtë vijë, që i ka shkaktuar fatkeqësi të mëdha popullit kinez.

Por, siç thuhet sot, doli shpëtimtari Çu En Lai, i cili foli në kongres dhe në Asamblenë Kombëtare për «katër modernizimet», që do ta kthenin Kinën në fund të shekullit tonë në një fuqi të madhe. «Tashti, thotë artikullshkruesi, që kemi shpërrur bandën e të katërve (por kjo «bandë e të katërve» është 600 milionë, se po të ishte puna për 4 veta, çdo gjë do të ishte rregulluar me kohë dhe përfundimisht), burimet e popullit dhe të vendit tonë do të jenë në gjendje të arrijnë me shpejtësi këtë ndryshim të madh historik (që ka caktuar Çu En Lai) dhe populli ynë, do të tregojë zotësinë e tij për këtë zhvillim, se është ai që e bën historinë dhe se kjo histori do të jetë e gjerë, më e pasur, më e guximshme, dhe më e freskët, më e ndërgjegjshme dhe në mënyrë më të planifikuar e më sistematike».

Me fjalë të tjera, «ju kinezë, — thonë ata, — kini besim te ekipi i ri që ka ardhur dhe sundon në Kinë. Ne jemi besnikë të Marksit, të Engelsit, të Leninit, të Stalinit e të Mao Ce Dunit. Shoku Mao Ce Dun, — theksojnë, — i qëndronte besnik vijës «nga masat e për masat». Ai bënte një punë të mirë për përgjithësimin e përvojës së masave në luftë dhe brumoste në partinë tonë traditën dhe stilin e bukur të punës, domethënë respektimin, besimin dhe mbështetjen në masat».

**Kur ishte i tillë ky Mao Ce Dun dhe të gjithë punonin nën flamurin e tij, kur ka thënë kaq fjalë të bukura, përse nuk u realizuan këto?** Përse u dënuan banda e Kao Ganit, e Pin De Huasë, e Liu Shao Çisë, e të tjera e të tjera si këto? Kësaj është zor t'i japin një përgjigje njerëzit që ecin sot në Kinë në rrugën kapitaliste dhe që duan të fshihen nga populli, duke ruajtur deri diku autoritetin e Mao Ce Dunit, sepse u shërben për ta hedhur në gjiriz flamurin e tij dhe për të ngritur flamurin e tyre të zi, derisa Kina të bëhet një fuqi e madhe kapitaliste, me një diktaturë fashiste në krye.

Autori i artikullit të «Zhenminzhibaos» shkruan se Mao Ce Duni ka thënë: «Kinës i mungojnë shumë gjëra, por gjëja kryesore janë pavarësia dhe demokracia». Pra, tash këto vendit të tyre po ia sigurojnë zotërit e rinj me aleancën që bënë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me Japoninë dhe me gjithë reaksionin kapitalist botëror, nga po marrin kredi të panumërta me të cilat ndërtojnë gjoja socializmin. Kështu forcojnë «pavarësinë» dhe «demokracinë» që ka predikuar Mao Ce Duni. Tash në Kinë është ngritur edhe «muri i demokracisë», ku vlojnë dacibaot, të cilat janë karta të shkruara dhe të diktuar nga bandat. Kur vjen një bandë në fuqi, dacibaot janë në favorin e kësaj bande dhe kundër bandës tjetër, kurse kur rrëzohet ajo e vjen një bandë tjetër, është kjo e fundit që vë dacibaot e kështu me radhë.

Pra «muri i demokracisë» nuk është i demokracisë por është muri i bandave, njerëzit e të cilave shkruajnë mbarë e prapë për të diskredituar ata që dëshirojnë të diskreditojnë. Prandaj për çështjen e pavarësisë e të demokracisë s'është bërë asgjë në kohën e Maos, asgjë nuk bëhet aktualisht dhe asgjë nuk do të bëhet edhe më vonë. Përkundrazi, çështja e pavarësisë dhe e demokracisë në Kinë do të shkojë poshtë e më poshtë.

Mbeturinat e feudalizmit e të kapitalizmit burokratik

nuk janë zhdukur në Kinë. Këtë nuk mund ta fshehë udhëheqja aktuale kineze. Ten Hsiao Pini dhe Hua Kuo Feni e shohin veten që janë si mbi gjemba, që nuk i kanë konsoliduar akoma pozitën e tyre, dhe thonë se «këto të këqija është vështirë që të mposhten nga lufta spontane e masave. Duhet të bashkohet udhëheqja e partisë dhe të mbrohet nga shteti». Pra, këta dishepuj të Maos, që kurdoherë kanë dashur dhe duan «të lulëzojnë njëqind lulet» e «të konkurrojnë njëqind shkollat», tash flasin për bashkim në udhëheqje të partisë, bile ky bashkim duhet të mbrohet nga shteti, me fjalë të tjera partia duhet të jetë nën drejtimin e ushtrisë, të bëjë ashtu siç urdhëron ushtria.

Autori i artikullit dhe personat që qëndrojnë pas tij thonë: «Nga ana tjetër, populli, nën ndikimin e llojeve të ndryshme të ideologjisë joproletare, është i prirë për anarki dhe ultrademokraci, në qoftë se ai do të shkëputet nga udhëheqja e bashkuar e partisë dhe centralizmi demokratik». Me fjalë të tjera këta parashikojnë rreziqe të mëdha që u turren. Kështu njerëzit që paraqesin rrezik të vërtetë për ta, e që në mos sot, nesër, do të ngrihen si një forcë e madhe për t'i shkatërruar, akuzohen që përpara si elementë të prirë nga anarkizmi e nga ultrademokracia. Atyre u thuhet në formë kërcënimi që, në qoftë se shkëputen nga «udhëheqja e bashkuar e partisë dhe nga centralizmi demokratik», do t'i sjellin Kinës fatkeqësi të mëdha, prandaj paralajmërohen: Kini mendjen, mos lëvizni, tregojuni të bindur ndaj urdhrave dhe vendimeve që japim ne, klika në fuqi, sepse duhet të na mbështetni, ndryshe, ne do të mbrohemi me armët e shtetit. Në rast se në Kinë paraqiten lëvizje progresiste e revolucionare, këto, ne njerëzit në fuqi, i quajmë që tash anarki dhe ultrademokraci.

Pra, udhëheqja është kundër ultrademokracisë dhe, si pasojë, «muri i demokracisë» është muri i klikës së



nga ana e Partisë Komuniste të Kinës ishte Çu En Lai.

**Mao Ce Duni e dërgonte shpesh Çu En Lain me misionet politike dhe më të shumtën e kohës ky, Çuja, nuk luftonte, por, si me thënë, bënte politikën e jashtme të Kinës. Çu En Lai nuk kishte nën drejtimin e tij reparte që t'i udhëhiqte, ai ishte komandant pa reparte.** Udhëheqja e reparteve bëhej nga «zotërit e luftës», të vetëquajtur komunistë, dhe nga komandanti i përgjithshëm i tyre, Mao Ce Duni, kurse Çu En Lai luante rolin e politikanit dredharak dhe liberal në ekstrem. Ai ishte njeriu i kompromiseve dhe i ujdive. Në bazë të dokumenteve që ka botuar Departamenti i Shtetit Amerikan, shihet se Çu En Lai bënte vazhdimisht bisedime me përfaqësues të ndryshëm të Departamentit të Shtetit, me ambasadorin amerikan pranë Çan Kai Shisë, pse në atë kohë Shtetet e Bashkuara të Amerikës me konsujt e tyre në qytetë të ndryshme të Kinës njihnin Kinën e Çan Kai Shisë.

**Çu En Lai hynte e dilte në pallatin e Çan Kai Shisë, ku kishte kontakte me zyrtarë të lartë amerikanë, që nga ambasadori dhe deri te këshilltari ushtarak.** Afër çlirimit, nga muaji maj ose prill i vitit 1949, Çu En Lai i bëri propozime Departamentit të Shtetit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës që, pas fitores, ato ta ndihmonin Kinën të mëkëmbej. Ky propozim i Çu En Lait u bë nëpërmjet një misioni ushtarak dhe konsujve amerikanë në Nankin dhe në Tiencin. Ata i telegrafuan Departamentit të Shtetit kërkesën e kinezëve si dhe aprovimin e tyre për të. Siç del nga një libër i botuar, ku përfshihen këto dokumente, janë diskutuar edhe variante të ndryshme të kërkesës, sepse siç duket, dhe siç e vërtetojnë dokumentet, këtë kërkesë Çu En Lai e bënte fshehtëzi e në mënyrë sekrete. Amerikanët nuk thonë gjë, por ai për këtë mund të kishte aprovimin e Mao Ce Dunit, ose mund të mos e kishte, po ishte i sigurt se do ta merrte të nesërmen. Në këto dokumente një gjë thuhet hapur: Çu En Lai

ndërmjetësin që do t'i transmetonte mesazhin Departamentit të Shtetit Amerikan e kishte porositur që të mos e zinte në gojë emrin e tij dhe i kishte thënë që, në rast se kjo do të bëhej publike, ai, domethënë Çu En Lai, do ta refuzonte atë kategorikisht, do ta përgënjeshtrohte.

Libri mbi këtë problem, që ka botuar Uashingtoni, tregon një sërë peripecish dhe mendimesh të shkëmbyera midis presidentit, shefit të Departamentit të Shtetit dhe ambasadorit, konsujve dhe misionarëve amerikanë në Kinë. Aty tregohen me hollësi taktikat që ata duhej të përdornin me Çu En Lain. **Porositë që jepen në këtë libër e tregojnë Çu En Lain si një liberal të vërtetë.** Aty theksohet fare qartë se duhej të kishin kujdes me të, të mbaheshin afër dhe të studioheshin mirë veprimet dhe taktikat e tij. Çu En Lai ishte, pra, njeriu i Uashingtonit dhe këtë ai e theksoi kur dha mesazhin, duke thënë se Kina nuk mund të mbështetet te Bashkimi Sovjetik, po te Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Çuja ka thënë, gjithashtu, që, në rast se fitojnë idetë e Mao Ce Dunit, Kina nuk do të jetë komuniste, por një shtet me drejtim demokratik dhe që do të mbajë miqësi me Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Këto letra shkëmbimi në mes presidentit amerikan, Departamentit të Shtetit dhe nëpunësve të tij në Kinë, lënë të kuptohet, gjithashtu, edhe për ekzistencën e shumë vijave në Partinë Komuniste të Kinës dhe të pikëpamjeve të ndryshme të gjeneralëve ose të mareshalëve që komandonin korparmatat e Mao Ce Dunit. **Ato veçanërisht vënë në dukje se Mao Ce Duni nuk ishte veçse një centrist i një politike eklektike dyfaqëshe, i një politike prosovjetike e njëkohësisht edhe proamerikane.**

Në librin që boton Uashingtoni nuk thuhet se Mao Ce Duni ishte antisovjetik, por ne e dimë se ai kurdoherë ka qenë në kundërshtim me Kominternin dhe me organizimin e partisë dhe të ushtrisë. Pra, ai nuk ishte një stra-

**teg marksist-leninist në luftë dhe në organizimin e saj.** Ne dimë, gjithashtu, se afër tij kurdoherë qëndronin oficerë të lartë, gazetarë, shkrimtarë dhe shkencëtarë të dërguar nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Pra, ndjenjat dhe filozofia e tij afroheshin më tepër me Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Mao Ce Duni, me tërë kuptimin e fjalës, ishte një timonier pa parim, por që diti të manovronte në mes fraksioneve të ndryshme që ekzistonin në Partinë Komuniste të Kinës e në udhëheqjen e saj, si dhe në grupimet ushtarake me shtabet e tyre në krye. Këto grupime që kishin ambiciet dhe planet e veta, mbanin njëkohësisht lidhje me fraksionet e ndryshme në Partinë Komuniste të Kinës. Natyrisht, në një situatë të tillë, dëshirat, shijet dhe kërkesat e tyre ndryshonin vazhdimisht. E palëvizshme qëndronte vetëm çështja e çlirimit të Kinës nga pushtuesit e huaj. Megjithëkëtë, edhe kundër Çan Kai Shisë uniteti nuk u arrit kurrë dhe gjithçka tjetër ishte një politikë aventureske e plot kompromise, plot *suspense*, pse ndryshe mendonte Mao Ce Duni, ndryshe Çu Deja, ndryshe grupi i Lui Shao Çisë, ndryshe ai i Çu En Lait.

Nga të gjitha ngjarjet e zhvilluara del se Çu En Lai, si kompromisaxhi i vërtetë, si liberal, si njeri që shikonte të merrte drejtimin nga të frynte era, bënte herë lojën e njerit dhe herë të tjetrit, jo vetëm brenda në Kinë, por edhe jashtë saj. Kur e pyetën njëherë Napoleonin për Taleiranin, diplomatin djallëzor të perandorisë napoleoniane, ai u përgjigj: «Taleirani i përngjet një çorapeje të mëndafshtë mbushur me mut». Ky vlerësim mund t'i përshtatet fare mirë Çu En Lait. I tillë ishte edhe ai, një njeri, si me thënë, *brio* në bisedime, në kontakte, mjeshtër i kompromiseve, i dredhive, por një njeri i qelbur.

Në përgjithësi, Çu En Lai dinte të dallonte se nga anonte balanca në luftë dhe pas luftës. Mund të themi

se ai ka ndjekur, sipas mendimit të tij dhe me nuancat e tij, haptazi, por edhe fshehtazi, politikën e përgjithshme ëndërruese të Mao Ce Dunit. Çu En Lai kurdoherë është përpjekur t'i adaptohej kësaj politike dhe të konkretizonte, nën flamurin e Maos, pikëpamjet e veta, që Kina të mos bëhej një shtet socialist, që revolucioni në Kinë të mos shndërrohej në socialist, por të qëndronte në fazën e një revolucioni demokratiko-borgjez, që Kina të mos mbështetej te Bashkimi Sovjetik, por te Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe, më në fund, ajo të bëhej një fuqi e madhe botërore.

Këto ishin pikëpamjet e Çu En Lait. Por kjo ishte edhe politika e Mao Ce Dunit, me plot ëndërrime, me plot zigzage, me plot *suspense* dhe me veprime kaotike të pamatura e të pathëlluara, qoftë nga e majta, qoftë nga e djathta. Prandaj ai ishte një centrist i sëmurë.

Liu Shao Çia dhe grupi i tij, ku bënë pjesë Ten Hsiao Pini, Pen Çeni dhe disa të tjerë, na paraqiten sikur duhej të ishin më radikalë, më organizatorë dhe më konkretë në orientime sesa Mao Ce Duni. Ata, dhe veçanërisht Liu Shao Çia, i cili akuzohet nga Çu En Lai se nuk ishte i aftë të organizonte punën në qytete, luajtën njëfarë roli në luftën nacionalçlirimtare. Në fakt, organizimin e punës në qytete dhe të ekonomisë nuk e bënë si duhet as Çu En Lai, as Mao Ce Duni, por më mirë «e bëri» Liu Shao Çia. Pas çlirimit ky i imponoi Komitetit Qendror pikëpamjet e veta djathtiste, që mbështeteshin në vijat e përgjithshme të pikëpamjeve djathtiste të Mao Ce Dunit. Liu Shao Çia ishte një nga protagonistët e ruajtjes së kapitalizmit në Kinë. Për një kohë të gjatë, në kongreset e partisë, ai mbronte fshatarësinë e pasur e të mesme dhe ishte «kundër» vetëm ndaj borgjezisë kompradore.

Liu Shao Çia, tok me Mao Ce Dunin e me Çu En Lain, ishin për atë që socializmi në Kinë nuk mund të

ndërtohej menjëherë pas çlirimit ose disa vjet pas çlirimit, pra as nuk duhej të punohej në këtë drejtim. Sipas tyre socializmi do të ishte një shoqëri që do të vinte 40 ose 50 vjet pas çlirimit. Sidoqoftë, Liu Shao Çia dhe grupi i tij ishin më aktivë, më të gjallë dhe, nën parulla të përgjithshme, nën një vijë ideologjike dhe politike që synonte ta bënte Kinën një shtet demokratiko-borgjez, ku të sundonin edhe kapitalistët, edhe të ashtuquajturit komunistë, diti ta organizonte partinë dhe ta edukonte atë në frymën jomarksiste. Liu Shao Çia synonte ta kompaktësonte partinë në vijën që përcaktonin ai vetë tok me Maon. Me një fjalë, Partia Komuniste e Kinës pretendonte sikur ishte marksiste-leniniste, por në fakt nuk ishte e tillë, shtirej se ishte në miqësi me Bashkimin Sovjetik të kohës së Stalinit, por në fakt nuk ishte në miqësi me të.

Stalini dhe Partia Bolshevike e kanë parë drejt zhvillimin e vijës politike të Partisë Komuniste të Kinës. Edhe në dokumentet amerikane, që përmenda më lart, flitet që Çu En Lai dhe maoizmi mund të ishin një titizëm kinez.

**Pra, nuk ishte pa vend dhe pa baza, ajo që Stalini u kishte thënë Çu En Lait apo Mao Ce Dunit: Mos dëshironi të shkoni edhe ju te Titoja, të veproni si Titoja, me fjalë të tjera, të hidhni poshtë marksizëm-leninizmin dhe ta ndërtoni Kinën jo në rrugën e socializmit, por në rrugën e një demokracie borgjeze?** Dyshimin e tij Stalini ua shfaqti hapur udhëheqësve kinezë dhe kjo ishte arsyeja përse ai e la Mao Ce Dunitin pa e pritur për 8 ditë, kur ky vajti për herë të parë në Moskë. Që Stalini të mos e priste «udhëheqësin e madh» të Kinës dhe ta linte atë në pritje për 8 ditë të tëra, kjo donte të thoshte që ai kishte fakte e të dhëna se Mao Ce Duni nuk qëndronte në pozita marksiste-leniniste. Këtë rrjedh edhe mëria e Mao Ce Dunit për Stalinin, të cilën ai e shprehu në Mbledhjen e Moskës, ku tha se «Kur vajta te Stalini,

e ndieva veten si nxënësi i vogël përpara mësuesit, kurse tash, që piqemi me Hrushovin, jemi si shokë, jemi të barabartë».

Në udhëheqjen kryesore kineze, pas çlirimit, dukej sikur kishte unitet, mirëpo në fakt nuk ishte kështu. Në mes grupeve kryesore, atij të Mao Ce Dunit, Liu Shao Çisë dhe Çu En Lait u arrit në njëfarë ujdje për ndërtimin e Kinës, për orientimet kryesore politike, ideologjike dhe organizative të saj. Por, natyrisht, gjatë zbatimit të këtij farë programi, lindën edhe kontradikta. Njëra që njohim ne, është ajo për «hopin e madh» i cili u kritikua nga Pin De Huaja. Më përpara, Kao Gani, sekretar me rëndësi në provincën e Mançurisë, u dënua nga Komiteti Qendror për deviacion. Në qoftë se nuk gabohem, ai u hodh nga dritarja, pse akuzohej nga grupi i Mao Ce Dunit si prosovjetik. Si prosovjetik u akuzua edhe Pin De Huaja.

Me vdekjen e Stalinit e me ardhjen e hrushovianëve në fuqi në Bashkimin Sovjetik, në Kinë konstatojmë transformime të mëdha djathtiste. Në mes grupeve të ndryshme që formonin udhëheqjen e së ashtuquajturës Parti Komuniste të Kinës pati përsëri një përqendrim politik. Këto grupe i njihnin veprimet e hrushovianëve dhe qëndrimet e tyre të ardhshme kishin për qëllim të demaskonin leninizmin, të hidhnin baltë mbi Stalinin, duke e quajtur gjithë periudhën e udhëheqjes së Bashkimit Sovjetik nga ana e tij, si një periudhë terrori.

Kjo situatë, pra, çoi në unifikimin e mendimit midis grupeve në udhëheqjen kineze. Tek ata lindën shpresa të mëdha që Kina këtë herë mund të mbështetej te Bashkimi Sovjetik, sepse pikëpamjet e hrushovianëve ishin djathtiste, revizioniste, dhe u përshtateshin pikëpamjeve revizioniste, brauderiste të Maos, të Liu Shao Çisë dhe të Çu En Lait. Filluan kështu orientimet miqësore ndaj Bashkimit Sovjetik. Mirëpo gjatë kësaj kohe lindën edhe fërkime. Këto fërkime me Bashkimin Sovjetik, natyrisht,

krijuan fërkime edhe në udhëheqjen kineze, ku disa elementë aspironin të vazhdonin mbështetjen te hrushovianët, kurse disa të tjerë shikonin nga do të frynte era. Kishte, gjithashtu, edhe nga ata që pritinin me padurim të prishej uniteti i arritur midis të dy grupeve udhëheqëse revizioniste të Bashkimit Sovjetik dhe të Kinës, të shkaktohej përçarja dhe kështu politika kineze të orientohej drejt Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Po të thellohemi në këtë çështje, del se Liu Shao Çia duhet të ketë pasur prirjen për t'u mbështetur te Bashkimi Sovjetik hrushovian, pse disa të dhëna dhe shfaqje që mundëm t'i vinim re gjatë gjithë kësaj periudhe, tregojnë se grupi i Liu Shao Çisë dhe i Çu En Lait (këta në atë kohë bënë pjesë në të njëjtin grup), pa lënë jashtë edhe Mao Ce Dunin, pas vitit 1960 dhe Mbledhjes së 81 partive, synonin të vazhdohej përpjekja për të zhdukur polemikën midis nesh dhe Bashkimit Sovjetik hrushovian, që të arrihej në disa konkluzione të pranueshme për kundërshtimet jopolitike dhe joideologjike. Por materialet që filluan të botohen lidhur me gjendjen e marrëdhënieve midis Kinës dhe Bashkimit Sovjetik, tregonin se Kina, dhe veçanërisht Mao Ce Duni, panë se ëndrra e tyre që Bashkimi Sovjetik hrushovian të bëhej një aneks i politikës kineze, ose, si të thuash, një partner i barabartë, që të merrte vendime mbi çështje të politikës ndërkombëtare tok me Kinën, në ujdi dhe në harmoni me të, dhe asgjë të mos bënte pa pyetur Mao Ce Dunin, nuk u realizua. Këto bënë që Mao Ce Duni të ftohej me Hrushovin.

Maoja dëshironte të zinte vendin e Stalinit, të kishte epërsi në fushën e ideologjisë. Këtë ambicie nuk e lejonte dhe nuk e lejoi Hrushovi dhe këtu u bë prishja. Megjithatë, Liu Shao Çia nuk i humbi shpresat për unitetin me hrushovianët derisa edhe neve na propozoi, gjoja në emër të partisë së Koresë, të Indonezisë, të Zelandës së

Re etj. që të krijonim «një front antiimperialist edhe me revizionistët brenda». Me fjalë të tjera, Liu Shao Çia predikonte të shuhej polemika dhe Bashkimit Sovjetik të mos i vihej më etiketa revizionist, por të konsiderohej si një shtet që vazhdonte rrugën marksiste-leniniste dhe që ishte në luftë me imperializmin amerikan dhe me kapitalizmin botëror. Kjo gjë, natyrisht, nuk u arrit. Por **nuk u arrit as marrëveshja midis Liu Shao Çisë dhe Mao Ce Dunit dhe, meqenëse grupi i Liu Shao Çisë ishte më aktiv, ky grup nëpërmjet Pin De Huasë kishte hedhur në dorë të gjitha postet kyç të ushtrisë, nëpërmjet Çu En Lait ato të shtetit dhe të ekonomisë dhe, nëpërmjet Ten Hsiao Pinit dhe vetë Liu Shao Çisë, kishte në dorë partinë.**

Natyrisht, Maon e mënjanuan dhe ai u bë një *pantin*<sup>1</sup> i cili po e humbiste fuqinë, por po humbiste edhe nami i tij. Sedra e tij ishte e plagosur, prandaj si jomarksist që ishte, ai duhej të gjente njëfarë ekspedienti, njëfarë veprimi që ta likuidonte grupin e Liu Shao Çisë, i cili me të vërtetë dëshironte që Kina të bëhej një shtet revizionist, një shtet i madh kapitalist. Mendimin e Maos e përkrahu edhe Çu En Lai, prandaj «timonieri i madh» i hodhi zaret, likuidoi Pin De Huanë në ushtri, sepse e dinte që me anë të kësaj mund t'ia arrinte qëllimit, dhe solli kështu në fuqi Lin Biaon. Është Maoja, pra, që e solli Lin Biaon në pushtet. Kështu që nëpërmjet këtij ai siguroi ushtrinë dhe, duke mos pasur asgjë tjetër në dorë, përveçse një ndihmë hipotetike, në rast se fitonte, nga liberali Çu En Lai, Maoja u bëri thirrje rinisë dhe studentëve të hidheshin në Revolucionin Kulturor. Autoriteti i tij bëri që të ngriheshin me miliona njerëz. Pas kësaj Maoja mori vendimin që të sulmoheshin shtabet, domethënë të sulmohej grupi i Liu Shao Çisë, të likuidoheshin ky grup dhe fuqia e tij, pra partia, të likuidoheshin.

1 Frëngjisht — kukull.

shin organizatat e masave që ishin nën drejtimin e Liut. Ky ishte qëllimi i Mao Ce Dunit.

Revolucioni Kulturor, siç e kam thënë, nuk ishte as revolucion, as kulturor, as proletar, por një revoltë e dëshpëruar për rimarrjen e fuqisë nga Mao Ce Duni, i cili me anë të saj ia arriti qëllimit. I ashtuquajtur i revolucion proletar, ku proletariati jo vetëm nuk mori pjesë, por edhe u godit me hunvebinët, po merrte përpjesëtime të rrezikshme për pushtetin që ekzistonte në Kinë nën drejtimin e Mao Ce Dunit, prandaj kishte ardhur koha që Maoja të mendonte seriozisht se duhej t'i jepte fund këtij Revolucioni Kulturor kaotik, me përpjesëtime të rrezikshme dhe që manipulohej nga lloj-lloj njerëzish.

Ishte Mao Ce Duni ai që pas këtij «revolucion» solli në fuqi dhe në Byronë Politike të famshmen «katërshë», ku bënte pjesë edhe gruaja e tij, kurse në Byronë Politike edhe disa elementë revolucionarë, si: Kan Shen, Çen Po Taja e të tjerë. Përsëri autoriteti i Maos në përgjithësi, solli rregull në Kinë. Turbullirat gati morën fund, por kaosi vazhdonte sidomos në ekonomi, kurse partia, organet e pushtetit, organizatat e masave ishin të likuiduara dhe Mao Ce Dunit, për të pasur një mbështetje, iu desh t'i riorganizonte këto. Njëfarë riorganizimi u bë, duke e grumbulluar të gjithë fuqinë në komitetet e bashkuara, ku partia dhe pushteti u vunë nën drejtimin e ushtarakëve derisa, në disa momente kyç, ose më mirë me thënë, në një udhëkryq, Maoja me shokë arritën të ndërronin strategjinë, të ndërronin edhe taktikën.

Gjatë kësaj kohe Çu En Lai shpëtoi. Ai shpëtoi me dredhitë e tij, u bë si «sheshël» e Çian Çinit, Van Hun Venit dhe e të tjerëve. Çuja tregohej si besnik i Lin Biaos, tundte librin e kuq me citatet e Maos dhe ishte në radhët e para të demonstruesve që dogjën ambasadën angleze. Këtë veprim të tij «heroik» na e ka thënë Çu En Lai me gojën e vet.

Pas Revolucionit Kulturor çdo gjë u fut, si me thënë, në njëfarë «rregulli». Kështu, pra, të dy strategjitë e Mao Ce Dunit dështuan. E para ishte strategjia për ta futur Bashkimin Sovjetik nën drejtimin e tij. Mirëpo Hrushovi u afrua me imperializmin amerikan, ndërtoi një strategji revizioniste të tij, që e izolonte Kinën revizioniste. Dëshitimi i dytë që ai i strategjisë së Maos për luftën kundër revizionizmit sovjetik dhe kundër imperializmit amerikan, i cili po hynte në allishverishe të mëdha me Bashkimin Sovjetik. Pas këtyre dështimeve Mao Ce Duni mendoi të vepronte siç veproi Hrushovi. Ai u afrua me amerikanët, ndërsa ruajti armiqësinë me hrushovianët.

Në fillim të kësaj strategjie të re ne gjejmë kundërshtimet e reja në vijën revizioniste të udhëheqjes kineze. Këto kundërshtime Maos duhet t'i jenë bërë nga shefi i ushtrisë, Lin Biaoja, dhe nga elementët që ai thirri për të udhëhequr Revolucionin Kulturor, si: Kan Shen, Çen Po Taja, Çian Çini, Van Hun Veni e të tjerë. Tash manovrat e Çu En Lait do të fitonin përsëri. Më përpara u likuidua Çen Po Taja, i cili dukej njeri shumë i zgjuar dhe i vendosur në pikëpamjet e veta, që ishin në kundërshtim me dredhitë borgjezo-kapitaliste të Çu En Lait. Për personin e tij gjoja u gjetën dokumente të shumta që tregojnë se që më 1921 a 1922 na qenkish agjent i Guomindanit. Në atë kohë vetë Çu En Lai ishte bashkëpunëtor i ngushtë i Çan Kai Shisë, por e kaloi lumin. Tash duhej likuiduar kryesori, ai që kishte në dorë ushtrinë, Lin Biaoja. Njëpërmjet një mijë e një manovrave, të cilat ne i kemi shpjeguar dhe historia më vonë do t'i nxjerrë lakuriq, edhe Lin Biaoja e likuiduan në një mënyrë misterioze, duke e akuzuar si agjent të sovjetikëve.

Gjatë kësaj kohe, për të realizuar vijën e tij, domethënë miqësinë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe me kapitalizmin botëror dhe armiqësinë me Bashkimin Sovjetik, Çu En Lai i duheshin njerëz më të rinj dhe

më energjikë, i duhej një mbështetje e fortë, i duhej të kishte me vete ushtrinë. Në këtë drejtim ai manovroi shumë bukur: solli afër tij Ten Hsiao Pinin, «Hrushovin numër dy», siç e kishte cilësuar Maoja, bashkëpunëtorin më të ngushtë të Liu Shao Çisë. Që përsëri Mao Ce Duni që e rehabilitoi dhe e bëri Ten Hsiao Pinin nënkryetar të partisë dhe nënkryeministër, e lau krejt nga fajet e gjyqet dhe të tij dhe Teni nga kjo kohë, u bë një bashkëpunëtor i ngushtë, ekzekutues besnik i urdhrave të Çu En Lait.

**Çuja, pra, nën hijen e Mao Ce Dunit dhe me ndihmën e tij, përpiquej të grumbullonte dhe të kaliste ekipin e ri për kthesën që po bënte drejt Shteteve të Bashkuara të Amerikës.** Natyrisht, kthesa dhe grupimi i ri do të binin patjetër në kundërshtim me «katërshen», siç i quajné revizionistët, elementët që udhëhiqnin Revolucionin Kulturor. Në të vërtetë edhe këta të fundit nuk ishin marksistë-leninistë dhe as organizatorë e njerëz me tru në kokë, por elementë ambiciozë që donin të sundonin Kinën sipas mënyrës e pikëpamjeve të tyre. Kështu po ecej drejt një çarjeje të re në mes këtyre dy grupimeve dhe Mao Ce Duni mbante timonin, manovronte sa andej-këndej. Ai donte të afrohej me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe për këtë mbështeste Çu En Lait dhe Ten Hsiao Pinin; si kundërpeshë donte të mbante edhe elementët e Revolucionit Kulturor. Maoja mendonte se çdo gjë do të zgjidhej sipas trurit të tij të mençur!

Çu En Lai vdiq nga kanceri. Automatikisht duhej të vinte në vendin e tij si kryeministër Ten Hsiao Pini, që ishte përgatitur për këtë post. Teni ishte shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë dhe tok me Jeh Çien Jinin, nën flamurin e Maos, bënë ligjin në ushtri. Mirëpo ngjau diçka e kundërt: në vend që të emëronte Ten Hsiao Pinin Mao Ce Duni emëroi njëfarë Hua Kuo Feni, të cilin e kishte ministër të Sigurimit, dhe së ashtuquajturës «ka-

tërshë» iu imponua që ta mbështeste atë. Këta nuk e pëlqyen një zgjidhje të tillë, pse donin të drejtonin vetë, kishin caktuar vetë udhëheqjen, por iu bindën «timonierit të madh». Kështu, pra, Mao Ce Duni, jashtë çdo rregulli partie, sepse ai nuk ishte marksist-leninist, e caktoi Hua Kuo Fenin si zëvendësin e tij dhe deklaroi se «do të vdiste i qetë». Në të njëjtën kohë, për të vendosur një balancë të plotë, Ten Hsiao Pinin e rideklaroi si revizionist. Hua Kuo Feni dhe «katërshja» fituan këtu një betejë. Ten Hsiao Pini u diskreditua për së dyti.

Pra, në një periudhë të shkurtër pas vdekjes së Çu En Lait, gjatë kohës që Maoja e kishte humbur fare dhe ishte shastisur nga pleqëria, sundonin Hua Kuo Feni dhe «katërshja». Mirëpo njerëzit e grupit të Ten Hsiao Pinit dhe të Çu En Lait — komandantët e fuqishëm të ushtrisë, ishin për Ten Hsiao Pinin, prandaj me një puç ushtarak i rrëzuan të katër kundërshtarët e rinj, sollën përsëri Ten Hsiao Pinin në vendin që kishte, pa e bërë kryeministër, dhe morën masa të rrepta kudo. Kjo ishte një kthesë rrënjësore që po bënte Kina.

### **PLENUMI I 3-TË I KQ TË 11-TË TË PKK**

Më 23 dhjetor agjencia HSINHUA transmetoi komunikatën e Plenumit të 3-të të KQ të 11-të të Partisë Komuniste të Kinës.

Ky plenum është vazhdim i serisë së masave që janë marrë për konsolidimin e pushtetit të grupit djathtist-imperialist të Hua Kuo Fenit.

Ashtu si edhe Kongresi i 11-të, plenumi i 3-të u mblodh pasi imperializmi amerikan çeli dritën e gjelbër për Kinën. Kjo, si dhe mendimi se këto transformime që po bëhen në Kinë e kanë burimin në ujdinë kino-amerikane, mund të duken të çuditshme. Por faktet historike vërtetojnë që përpara se Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe shtetet e tjera kapitaliste të vinin në ujdi, në aleanca e në allishverishe të mëdha me Kinën, duhej që në këtë vend të bëheshin transformime rrënjësore nga e djathta. Ndryshe këto ngjarje nuk do të ndodhnin, në Kinë do të vazhdonte zhvillimi i situatave në po atë formë kaotike që kishte filluar që nga krijimi i Republikës Popullore, që kur ishte gjallë Mao Ce Duni, bile edhe më përpara, që gjatë luftës nacionalçlirimtare.

Kjo nuk do të thotë se me ndryshimin e situatave pas dënimit të Liu Shao Çisë dhe pas vdekjes së Mao Ce Dunit në Kinë u vendos stabiliteti politik, ideologjik dhe organizativ. Në asnjë mënyrë jo. Atje, deri në një revolucion proletar të vërtetë, ekzistojnë dhe do të vazhdojnë

të ekzistojnë kaosi, indisciplinimi, sabotimi dhe lufta për pushtet në mes fraksioneve të ndryshme.

Situata aktuale është rrjedhim i politikës së Çu En Lait, të cilën e aprovonte Mao Ce Duni qëkurse ishte gjallë, domethënë që nga koha kur të dy ata morën kontakte të fshehta me presidentin Nikson të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Kjo praktikë vazhdoi edhe pas vdekjes së tyre.

Pas marrjes së fuqisë nga Hua Kuo Feni dhe nga Ten Hsiao Pini, Kina nuk mund të lëkundej sa andej-këndej si në kohën e Maos. Ajo do të zbatonte strategjinë që kishin vendosur Mao Ce Duni dhe Çu En Lai, domethënë miqësi me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, e cila kishte filluar të realizohej me takimin që Mao Ce Duni dhe Çu En Lai bënë në Pekin me presidentin Nikson. Kjo miqësi dhe kjo vijë ishin hedhur në Kartën, Komunikatën, e Shangait, e cila përbënte pikën kulminante të strategjisë së re, miqësinë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, hapjen drejt Perëndimit, dhe shtypjen e çfarëdo lëvizjeje që do ta kundërshtonte këtë strategji. Prandaj gjatë gjithë kësaj kohe, deri në Plenumin e 3-të të KQ të 11-të, u zhvillua një luftë e rreptë, që kishte për qëllim të ruheshin pozitat e grupimeve të ndryshme në udhëheqje.

Mirëpo gjatë gjithë kësaj periudhe njëvjeçare, në qoftë se nuk gabohem, në udhëheqjen e partisë u zhvilluan luftime të brendshme. Kontradiktat në radhët e saj ishin të mëdha. Ten Hsiao Pini dhe grupi i tij përpiqeshin të merrnin plotësisht fuqinë në dorë, kurse Hua Kuo Feni nuk e lëshonte këtë. Në të njëjtën kohë, jashtë bëheshin përpjekje për ta paraqitur çështjen se në Kinë ngjiste një revolucion i ri, i përkohshëm, që konsistonte në demaskimin e «katërshes» dhe të Lin Biaos që tashmë qenë rrëzuar.

Në fakt, në Kinë, midis fraksioneve rivalë të ndry-

shme, në udhëheqje dhe jashtë saj, vazhdonte një luftë e ashpër. Kjo luftë pengonte stabilizimin brenda vendit dhe dëmtonte besimin e imperialistëve dhe të kapitalistëve të huaj, të cilëve iu hapën portat e Kinës dhe u kërkohehin kredi dhe investime të mëdha. Prandaj imperializmi amerikan, kandidati kryesor në këtë miqësi, me siguri kërkoi nga udhëheqja kineze që të vendoste në vend stabilitetin, sepse pa stabilitet nuk do të mund t'i jepte Kinës ndihmat ekonomike, patentat dhe nuk do të mund ta armatoste ushtrinë kineze. Mungesa e stabilitetit nuk do të lejonte të përfundohej as aleanca midis Kinës dhe Japonisë dhe, më vonë, as zbatimin e Kartës së Shangait, domethënë përfundimi i një aleance sekrete midis Kinës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Ndërkohë imperialistët amerikanë studionin se cilat ishin forcat që predominonin dhe mund ta stabilizonin situatën në Kinë. Ata zgjodhën Ten Hsiao Pinin, mikun e mikut të tyre të vjetër, Çu En Lait, dhe i dhanë mbështetje të hapët. Sigurisht, amerikanët influencuan edhe te grupi i Hua Kuo Fenit që ky t'i bënte lëshime, në mos të dukshme, indirekte grupit të Ten Hsiao Pinit.

Stabiliteti në Kinë duhej të vendosej me një kompromis në udhëheqje. Dhe kompromisi u arrit në mbledhjen e Plenumit të 3-të të Komitetit Qendror të 11-të të Partisë Komuniste Kineze.

Ku qëndron ky kompromis? Faktikisht **Ten Hsiao Pini e ka fuqinë në dorë, ai ka në dorë ushtrinë, ekonominë dhe partinë.** Për ta pasur partinë në dorë, qoftë edhe formalisht, u arrit në kompromis që ish-kryetari i Bashkisë, Vu Teh, ish-komandanti i Pekinit Çen Hsi Lien dhe ndonjë partizan tjetër i Hua Kuo Fenit të qëndronin në Byronë Politike, ndërsa Ten Hsiao Pini solli në këtë organ të lartë një numër të madh prej 5 ose 6 vetash, të gjithë njerëz të tij, që nga Ten Jin Çao, që është e veja e Çu En Lait, dhe deri tek ish-shefi i Zyrës së Përgjith-

shme në kohën e Liu Shao Çisë, Çen Jun Kan, të cilin Mao Ce Duni e akuzoi se ishte agjent i hrushovianëve.

Tash në Byronë Politike, edhe nga ana formale, Ten Hsiao Pini ka fuqinë në dorë, ka shumicën. Do të mbetet apo jo Hua Kuo Feni në postet që ka aktualisht, ky është një problem i kohës. Çështja është se gjatë kësaj periudhe Ten Hsiao Pini rehabilitoi të gjithë të njohurit, miqtë dhe bashkëluftëtarët e tij të persekutuar nga Mao Ce Duni dhe nga Revolucioni Kulturor, nga Lin Biaoja dhe nga «katërshja», që «i kanë shkaktuar Kinës të gjitha të këqijat», siç e thonë ata. Pra, ky plenum afirmoi rehabilitimin e plotë të të gjithë elementëve borgjezë, kapitalistë, reaksionarë, të cilët ishin shkarkuar ose diskredituar nga Revolucioni Kulturor. Të gjithë këta, pavarësisht nga mosha e kaluar, zunë postet e veta të mëparshme. Ky rehabilitim do të thotë rehabilitim i të gjithë aparatit të vjetër të kohës së Liu Shao Çisë e të Ten Hsiao Pinit. Në plenum nuk u shpall akoma rehabilitimi i Pen Çenit dhe i ndonjë tjetri, kurse Pin De Huaja u rehabilitua plotësisht e me triumf.

Çështja tjetër që u vendos në këtë plenum është se aktualisht gati mori fund lufta për demaskimin e «katërshes». Kjo do të thotë që mori fund lufta për demaskimin e Maos, të maoizmit dhe të gjithë adeptëve të tij. Në të vërtetë ajo mori fund vetëm në sipërfaqe, sepse lufta vazhdon dhe do të vazhdojë gjatë gjithë jetës, mbasi ata që besojnë te Mao Ce Duni dhe në politikën e tij gjoja marksiste, janë shumë dhe në mos sot, nesër, do të ngrihen të marrin revanshin kundër këtyre që aktualisht u morën fuqinë nga duart. Këtë çështje, pra, konfirmoi plenumi i 3-të dhe kjo synon që t'i japë të kuptojë popullit kinez se gjoja mbaruan persekutimet nga grupi në fuqi kundër kundërshtarëve të tij dhe, nga ana tjetër, për t'i thënë botës se në Kinë gjendja u stabilizua, u vendos qetësia dhe pushteti është konsoliduar. T'i thonë,

gjithashtu, popullit kinez dhe Perëndimit se çdo gjë: stili, metoda, politika, uniteti në udhëheqje, fraksionet etj., etj. në Kinë kanë ndryshuar, se gjendja në vend është stabilizuar. Në bazë të cilave norma është stabilizuar? Plenumi thotë në bazë të normave marksiste-leniniste (!). Kjo nuk është aspak e vërtetë. Përkundrazi, gjendja ka ardhur në normat kapitalisto-fashiste, por këto norma nuk kanë hedhur akoma rrënjët që dëshirojnë Ten Hsiao Pini dhe imperializmi amerikan. Ky i fundit shpreson se dora e fortë e Ten Hsiao Pinit dhe e grupit të tij do ta stabilizojë këtë situatë, në mos brenda vitit, brenda 5-6 vjetëve, duke mënjanuar ndonjë turbullirë të re.

Pra, Plenumi i 3-të i Komitetit Qendror të 11-të të PKK u karakterizua gjoja nga një unitet i plotë në parti dhe në udhëheqje, gjë që është një gënjeshtër e madhe, pse atje ekziston një rivalitet i ashpër në mes grupit të Hua Kuo Fenit dhe atij të Ten Hsiao Pinit.

Në këtë plenum çështja e demokracisë është ngritur si një normë me rëndësi të madhe. Thuhet se të gjithë kanë të drejtë të flasin, të kritikojnë cilindo qoftë, muret e dacibaove quhen «muret e demokracisë» etj. Veçse në Kinë, sipas këtij plenumi, dhe kjo është shkruar në tri komunikatat e botuara, duhet të mbretërojnë tri «jotë», të cilat konsistojnë në atë që «asnjeri nuk duhet të sulmohet për gabimet e tij», «kurrkujt nuk duhet t'i vihen epitete» dhe «nuk duhet të përdoret shkopi i madh». Pas gjithë kësaj, thonë se në Kinë është vendosur diktatura e proletariatit(!). E bukur diktaturë e proletariatit! Diktaturë fashiste me ngjyra liberale. Ku është parë që në një shtet që quhet socialist, ku udhëheq një parti gjoja marksiste-leniniste, ku ekziston gjoja diktatura e proletariatit, të lejohet një liberalizëm kaq i madh? Kush janë këta që ia predikojnë këto tri «jo» popullit dhe së ashtuquajturës Parti Komuniste të Kinës? Janë ata që likuiduan me një të goditur antidemokratike «katërshen»

e Lin Biaon, ata që po bëjnë kërdrinë aktualisht në Kinë, që po burgosin nga të katër anët, ata që kanë diskredituar në një mënyrë aq skandaloze Çian Çinin dhe të tjerë.

Çështja tjetër që konfirmoi ky plenum është se Kina do të ndjekë rrugën e «katër modernizimeve», të cilat në të vërtetë duan të thonë ndërtim i kapitalizmit në Kinë. Me ndihmën e kujt? Këtë kinezët nuk e thonë. Nuk zënë aspak në gojë litarin në shtëpinë e të varurit, pse Kina është varur te Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe te kapitalizmi botëror. Nuk përmendet aspak se Kina po futet deri në grykë në borxhe te kapitalizmi ndërkombëtar, por pretendohet që ajo gjoja do të ndërtohet me forcat e veta. Premtimet janë të bujshme: me forcat e veta dhe, duke ndjekur Ten Hsiao Pinin, Kina do të bëhet një shtet i fuqishëm socialist, të mos harrojmë, një shtet i një demokracie të vërtetë, të mos harrojmë, një popull që do të përparojë, do të lulëzojë dhe jeta e tij do të bëhet e begatshme! Të gjitha këto premtime grupi kapitalisto-fashist i Ten Hsiao Pinit ia bën popullit kinez, i cili, pikërisht kur po mbahej ky plenum dhe kur rreth tij ishin grumbulluar të gjithë miqtë dhe dashamirësit e Tinit, në Shangai e gjetkë demonstronte dhe kërkonte të dinte nëse do të marrin, apo nuk do të marrin fund mjerrimi i tij, mungesa e lirisë, e ushqimeve, e shtëpive. Njerëzit në Shangai thërritnin: «Rroftë revolucionin!». Pra, populli kërkon revolucion, kurse udhëheqja kërkon kundërrevolucion, qetësi, bindje, «disiplinë», «rregull», pse nga to e nga ndihma amerikane dhe ajo e kapitalizmit botëror, që me kamata të rënda vërshojnë në Kinë, gjoja do t'i vijë mirëqenia popullit kinez!

Plenumi i 3-të i Komitetit Qendror të 11-të, sipas komunikatës së botuar, trajtoi edhe probleme të politikës së jashtme dhe arriti në përfundimin se «politika e jashtme e partisë dhe e qeverisë ka qenë e drejtë dhe e suksesshme». Ky plenum, pretendon udhëheqja kineze, është

historik, pse «zgjidhi një numër problemesh të rëndësishme që i kishte lënë historia, si dhe çështjen e kontributit dhe të gabimeve të disa udhëheqësve të rëndësishëm». Kush ishin këta udhëheqës të rëndësishëm? Sigurisht, Mao Ce Duni. Por grupi i Ten Hsiao Pinit nuk guxon akoma ta përmendë me emër, sido që në «murin e demokracisë» kanë dalë edhe kritika kundër Maos. Nuk janë njerëz të thjeshtë ata që i bëjnë këto kritika, por është pikërisht aparati propagandistik i Ten Hsiao Pinit, i cili ka për qëllim demaskimin e plotë të Maos dhe ngritjen e kultit të Tenit.

Kështu ndodhi në Bashkimin Sovjetik me çështjen e Hrushovit, kështu po ndodh atje edhe me çështjen e Brezhnjevrit.

Plenumi i 3-të vendosi të forcojë «demokracinë» në jetën e partisë dhe në jetën politike të shtetit kinez duke krijuar një komision qendror për kontrollin e disiplinës. Detyra kryesore e këtij komisioni është që të vazhdojë rehabilitimin e plotë të reaksionit dhe likuidimin e çdo kundërshtari aktual. Në krye të këtij komisioni u vënë të gjithë ata elementë të rrëzuar nga Revolucioni Kulturor dhe miq të Ten Hsiao Pinit.

Sipas komunikatës, në këtë plenum u arrit një gjë «e bukur»: «Gjatë dy mbledhjeve pjesëmarrësit shprehën lirisht mendimin e tyre, duke u bazuar në marksizëm-leninizëm-maoedunidenë dhe folën lirisht». Kuptohet pse folën lirisht, sepse mbronin veten, mbronin pushtetin e tyre të reaksionit, të kapitalizmit. Komunikata thekson se «mbledhjet që u bënë, çuan me të vërtetë në një situatë politike, e cila karakterizohej si nga centralizmi, ashtu edhe nga demokracia, si nga disiplina, ashtu edhe nga liria, si nga uniteti i vullnetit, ashtu dhe nga liria personale e të menduarit dhe nga gjallëria, ashtu siç mësonte shoku Mao Ce Dun».

Mao Ce Duni të gjitha këto parime i kishte hedhur

tej. Ai kërkonte të bëhej vetëm çfarë donte vetë. Por atyre që janë sot në fuqi u duhet të thonë se veprojnë «ashtu siç mësonte shoku Mao Ce Dun», pse dinë edhe këta ta përdorin demagogjinë dhe të bëjnë të kundërtën e asaj që thonë. Si për çudi, kjo komunikatë thotë se brenda 10 muajve që erdhi në fuqi Ten Hsiao Pini, «janë arritur fitore të mëdha në revolucionin e rëndësishëm politik kombëtar për demaskimin dhe dënimin e Lin Biaos dhe të bandës së të katërve». Gjithashtu, sipas tyre «është rimëkëmbur dhe është forcuar më tej ekonomia kombëtare». Çfarë ekonomie kombëtare është forcuar? Në Kinë nuk po realizohet asgjë, atje ekziston uri, planet në industri dhe në bujqësi nuk realizohen, blihen drithëra buke me sasi kolosale nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës e gjetkë. Dhe të mos harrojmë se këtë ekonomi kombëtare e kanë drejtuar në kohën e tyre Çu En Lai, Li Hsien Nieni, Li Çiani, Ten Hsiao Pini, kur erdhi në fuqi. Të gjithë këta nuk mundën ose nuk ditën, s'ishin të zotët ta çonin ekonominë në rrugën që t'i jepte të paktën njëfarë kënaqësie relative popullit kinez.

Por mbi të gjitha, sipas komunikatës, plenumi theksoi se «Kina ka arritur suksese të reja të rëndësishme në krijimin e një fronti të bashkuar ndërkombëtar kundër hegjemonizmit dhe në zhvillimin e marrëdhënieve miqësore me të gjitha vendet e botës».

Është e qartë se Kina u rreshtua përfundimisht me shtetet kapitaliste dhe se ajo është e lidhur në miqësi me klikat reaksionare të këtyre shteteve. Politika aktuale kineze nuk ka të bëjë me miqësinë midis popullit kinez dhe popujve të botës, por është politikë e miqësisë midis klikës udhëheqëse kineze dhe klikave që sundojnë në «botën e parë», në «botën e dytë» dhe në «botën e tretë», siç i quan teoria kineze e «tri botëve».

Revizionistët kinezë shkojnë edhe më tej. Në komunikatën e plenumit ata thonë se «gjatë viteve të para pas

themelimit të Republikës Popullore dhe sidomos mbasi transformimi socialist përfundoi në vija të përgjithshme, shoku Mao Ce Dun herë pas here e udhëzonte partinë që ta përqendronte punën në ekonomi dhe në revolucionin teknik. Nën udhëheqjen e shokut Mao Ce Dun dhe të shokut Çu En Lai partia jonë bëri shumë për ndërtimin socialist dhe korri fitore të rëndësishme».

Këtu, lë që ka kontradikta të mëdha, se nuk u korrën fitore të rëndësishme, por **është gënjeshtër të thuhet se mbaroi ndërtimi i socializmit në Kinë**, siç pretendon kjo komunikatë. **Atje as ka filluar ndërtimi i socializmit, pale të ketë mbaruar**. Përkundrazi, tash në Kinë ka filluar ndërtimi i hapët i kapitalizmit.

Po përse ngjanë këto dështime të mëdha? Edhe kësaj çështjeje ia kanë gjetur ilaçin. Ky ilaç sipas klikës Hua-Ten është tradhtia e Lin Biaos dhe e «katërshes». Por komunikata e plenumit, megjithëse është kategorike, përsëri lë shteg për të justifikuar disfatat e ardhshme, duke theksuar se spastrimi i njerëzve të «katërshes» dhe të Lin Biaos nuk ka marrë fund, ai, pra, duhet të vazhdojë, pavarësisht se në fillim thuhet që «lëvizja dhe kritika kundër Lin Biaos dhe bandës së të katërve përfundoi në përgjithësi». Por, në fakt, kundërshtimet ndaj këtyre uzurpatorëve të fuqisë dhe varrmihësve të mirëqenies së popullit do të vazhdojnë edhe më vonë.

Tashti, thonë udhëheqësit kinezë, «është koha e përshtatshme të merret vendim për përfundimin e lëvizjes masive kombëtare për demaskimin e kritikën e Lin Biaos dhe bandës së të katërve, prandaj theksi të kalohet në punën e partisë dhe vëmendja e popullit t'i kushtohet modernizimit socialist».

Ky është një diktat që i imponohet Kinës nga fuqitë imperialiste e veçanërisht nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Imperializmi amerikan gjykon që, në rast se do të vazhdojë një veprimtari e një gjendje e tillë e Ten

Hsiao Pinit, në Kinë do të ngjasin turbullira të mëdha, partizanët e Mao Ce Dunit nuk do të shtypen kollaj dhe Ten Hsiao Pini do të krijojë pengesa që do t'i vënë në rrezik aleancat e Kinës me Amerikën, me Japoninë dhe me të gjithë partnerët e ndihmësit e tij të kapitalizmit botëror.

Prandaj në plenumin e 3-të ata e theksojnë këtë dhe e kuptojnë se partia duhet të ketë mbështetjen e siguri- mit dhe të ushtrisë, si partia e Titos, që pushteti ta ndihmojë partinë në konsolidimin e saj. Me fjalë të tjera, atje predikohet «uniteti» në parti nën diktaturën e kapitalit, nën diktaturën ushtarake.

E vetmja rrugëdalje për revizionistët modernë kinezë është që në Kinë të vërshojnë kapitalet e huaja. Ky vërshim ka filluar tashmë; rrjedhimet e tij do t'i shohim më vonë. Atje do të bëhet bujë për «ndërtime të mëdha», por këto ndërtime do të bëhen në favorin e kapitalizmit kinez, të shoqërive të mëdha aksionare, të bankave të huaja e të shoqërive shumëkombëshe. Popullit kinez do t'i jepen thërrime të vogla, sa për ta gënjer. Se kur do të zhgënjehet ky popull, kjo varet nga një punë e madhe politike revolucionare, marksiste-leniniste, që duhet të bëjë një udhëheqje e dalë nga populli, e mbështetur në traditat luftarake të popullit kinez. Por duhet të ketë njerëz dhe një parti të vërtetë, që t'i drejtojë në rrugë të drejtë këto tradita luftarake, të cilat nuk mund të nënvleftësohen.

Në plenum revizionistët kinezë folën edhe për një organizim «të ri» të ekonomisë. Ja ç'thuhet atje: «Plenumi theksoi se një nga të metat serioze në strukturën e drejtimit ekonomik të vendit është superpërqendrimi i autoritetit, prandaj është e nevojshme që ai të kalohet nga udhëheqja qendrore në organet e niveleve më të ulëta, në mënyrë që autoritetet lokale dhe ndërmarrjet industriale e bujqësore të kenë më shumë të drejta vendimi

në drejtim, duke u udhëhequr nga një planifikim i unifikuar shtetëror».

Kjo është politikë eklektike, që thotë se edhe duhet të shpërndahet drejtimi ekonomik dhe të unifikohet planifikimi shtetëror. Me fjalë të tjera, teorinë revizioniste të vetadministrimit këta si teori e maskojnë, por në praktikë e zbatojnë. Agjencia HSINHUA njofton se rreth Pekinit u formuan një varg qendrash agroindustriale, në të cilat u bashkuan 15 a 20 komuna. I gjithë ky organizim është bërë nën shembullin jugosllav të komplekseve agroindustriale që janë ngritur rreth Beogradit. Tash kinezët flasin haptazi se do të adaptojnë metodat e vetadministrimit jugosllav, por ata nuk do të mjaftohen vetëm me to. Për administrimin e industrisë ekzistuese dhe për atë që po ndërtojnë, do të adaptojnë edhe një sërë metodash të tjera kapitaliste, sipas vendeve që bëjnë investime në Kinë dhe sipas nevojave dhe ujdivë me shoqëritë e përbashkëta.

Në Plenumin e 3-të të Komitetit Qendror të 11-të udhëheqësit revizionistë kinezë thanë shumë «gjëra të bukura» e «xhevahire të çmueshme»! Ja ç'thonë ata në një vend: «Është e nevojshme që, nën udhëheqjen e centralizuar të partisë, të zgjidhet me vetëdije problemi i dallimit midis partisë, qeverisë dhe ndërmarrjeve dhe t'u jepet fund zëvendësimit të qeverisë me partinë dhe zëvendësimit të administratës së ndërmarrjes me atë të qeverisë; të bëhet një ndarje e detyruar midis niveleve të ndryshme, tipave të punës dhe individëve; të rriten përgjegjësia dhe autoriteti i organeve administruese dhe i personelit drejtues; të pakësohen numri i mbledhjeve dhe shkresat, me qëllim që të rritet efikasiteti i punës; të kryhet me vetëdije kontrolli, të jepen shpërblime dhe dënime; të ngarkohen dhe të shkarkohen njerëzit nga përgjegjësitë».

Gjithë ky orientim është një program i koklavitur,

i errët, i paprincipitë, eklektik, revizionist, kapitalist dhe aspak marksist-leninist. Për çdo drejtim, për çdo paragraf të komunikatës, mund të shkruhen libra të tërë që të komentojnë dhe të vërtetojnë se vija aktuale e Kinës, e vendosur nga ky plenum, përfaqëson pikërisht atë që kemi thënë vazhdimisht, se Kina po ecën në rrugën kapitaliste dhe është një vend revizionist socialimperialist.

**E PREMTE**  
**29 DHJETOR 1978**

## **KINA DHE JAPONIA**

Kina dhe Japonia janë dy vende të mëdha; njëra ka shtrirje të gjerë territoriale e popullsi shumë të madhe në numër, kurse tjetra, Japonia, është një vend me hapësirë shumë më të vogël nga ajo e Kinës, por me një popullsi të madhe, duke e krahasuar me raportin popullsi-territor në Kinë.

Të dy këto shtete fqinje gjatë historisë së tyre kanë pasur në shekuj edhe momente miqësie, por edhe momente luftërash e përpjekjesh për hegjemoni mbi njëra-tjetrën. Megjithatë, si Kina, edhe Japonia kanë pasur karakteristika të përbashkëta, sidomos në fushën e kulturës. Në Japoni, gjatë shekujve të kaluar, kultura kineze ka ushtruar një influencë të madhe. Atje ka hyrë dhe është pranuar hieroglifi kinez. Natyrisht, gjuha japoneze ndryshon nga ajo kineze, por, duke lexuar hieroglifet, kinezi mund ta kuptojë japonishten dhe anasjelltas, japonezët gjuhën kineze.

Duke studiuar historinë shekullore të këtyre dy vendeve, shohim se edhe në kohët tona, në shekullin e 19-të, në fillim të shekullit të 20-të e më vonë, Kina perandorake është sulmuar nga Japonia. Po ashtu Kina e Sun Jat Senit dhe e Çan Kai Shisë është okupuar nga Japonia, e cila ka gjetur tek ajo terren për ekspansion jetik. Më parë Japonia zaptoi Mançurinë, iu afrua Pekinit, pushtoi gj-

thë juglindjen e Kinës dhe gjatë Luftës së Dytë Botërore kaloi në Nankin, në Kanton e në ishujt Hajnan.

Ne i njohim ambiciet dhe veprimet e Japonisë militariste edhe ndaj Shteteve të Bashkuara të Amerikës, kur ajo kishte pushtuar gjithë Azinë Juglindore, që nga Indokina, Singapori, Malaja e Australia, sulmoi flotën amerikane në Pirl-Harbor dhe pastaj më vonë u detyrua të tërhiqej me disfatë, deri në shkatërrimin e plotë të saj.

Japonia ka qenë një objekt sulmi nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Nuk harrohen fjalët e Teodor Rusveltit, të presidentit të vjetër amerikan, që tha në ato kohë se kundër Japonisë duhej përdorur shkopi i madh, sepse Shtetet e Bashkuara të Amerikës shikonin tek ajo një rivale shumë serioze me ekspansionin e vet imperia- list në Paqësor dhe në Azinë e Largme.

Japonia, nga ana e saj, nën drejtimin e militaristëve dhe të Mikados, iu vu me të gjitha mjetet e mënyrat forcimit të pushtetit të vet, krijimit të një ushtrie të fortë, të një marine luftarake nga më të fuqishmet në botë dhe vendosjes brenda ishujve të Japonisë të një diktature të tmerrshme militariste. Kjo diktaturë e egër u forcua edhe më tepër pas likuidimit të flotës cariste në gjirin e Tiencinit dhe Japonia, natyrisht, e hodhi vështrimin te Bashkimi Sovjetik i konsoliduar pas Revolucionit Socialist të Tetorit. Në kohën kur kishte sulmuar Kinën, ajo bëri edhe një orvatje drejt Mongolisë, por atje hëngri një grusht të rëndë. Ushtria e Kuqe, nën udhëheqjen e Stalinit dhe nën drejtimin e Zhukovit, e detyroi Japoninë militariste të ishte prudente në drejtim të Bashkimit Sovjetik, për arsye se kishte përpara një fuqi të madhe ushtarake. Si pasojë, megjithëse ambiciet e saj drejt Vladivostokut, Siberisë dhe Koresë ishin shumë të mëdha, Japonia u zbraps.

Kështu që në Luftën e Dytë Botërore Japonia nuk

luftoi në të dy krahët dhe nuk e sulmoi Bashkimin Sovjetik. Ky e kuptoi këtë moment historik, i hoqi trupat nga Siberia e i çoi në frontin e Lindjes kundër hitlerianëve. Ky veprim shërbeu si një faktor me rëndësi për thyerjen e makinës luftarake naziste gjermane. Pas sulmit vendimtar amerikano-sovjetik Japonia u thye dhe nënshkroi Traktatin e paqes me fuqitë perëndimore, natyrisht me kushte jo të favorshme për të. Megjithatë, struktura e ushtrisë japoneze qëndroi e paprekur, Mikadoja qëndroi në krye dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës u përpoqën dhe ia arritën qëllimit që gjatë gjithë periudhës së pasluftës ta mbanin nën kontrollin e tyre Japoninë. Ato e fuqizuan atë si ushtarakisht, edhe ekonomikisht në mënyrë kolosale, aq sa Japonia ka arritur aktualisht të bëhet një superfuqi e superindustrializuar.

Gjatë Luftës së Dytë Botërore dihet se Kina e Çan Kai Shisë dhe e Mao Ce Dunit, në fillim në unitet e pastaj në përçarje, luftoi kundër japonezëve dhe në fund fitoi ushtria e Mao Ce Dunit, e cila e çliroi vendin nga pushtimi japonez. Kështu, midis të dy vendeve u vendos e u zhvillua një armiqësi e tillë, që dukej sikur s'do të kishte asnjë perspektivë pajtimi. Mirëpo më vonë, e sidomos aktualisht, pamë dhe po shohim më qartë se nuk ndodhi ashtu. Në vitin 1972 Kina lidhi marrëdhënie diplomatike me Japoninë dhe kjo mund të quhet si një faqe e re që hapet në historinë e marrëdhënieve midis dy vendeve, gjë që më vonë do të ketë konsekuenca të mëdha. Hapja diplomatike e Kinës me Japoninë, pas vitit 1972, duket qartë që ka qëllime antisovjetike.

Pra, Kina konkurroi me Bashkimin Sovjetik se kush do ta tërhiqte pas vetes Japoninë dhe fitoi, kurse Bashkimi Sovjetik nuk mundi dot të lidhej ngushtë me Japoninë kundër Kinës, e cila kishte marrë pozita të theksuara antihrushoviane, që dihet se ishin jo për çështje ideologjike, por për sundim botëror.

Sipas statistikave që janë bërë, agjencitë e lajmeve njoftojnë se që nga viti 1972 deri më 1978 numri i vizitorëve tregtarë japonezë që kanë vajtur në Kinë, është rritur nga 8 mijë në 30 mijë dhe numri i misioneve kinëze në Japoni vjen kurdoherë duke u rritur. Pra, jemi duke vënë re një zhvillim dhe një perspektivë zhvillimi të madh, që synon afrimin e mëtejshëm të Kinës me Japoninë. Siç duket, tenxherja ka gjetur kapakun. Kina është prapa, shumë prapa ekonomikisht dhe e pazhvilluar, por ka popullsinë më të madhe në botë. Atje jetojnë rreth 900 milionë banorë. Ajo akoma është e paeksploaruar dhe nuk njihet ekzaktësisht pasuria e madhe e burimeve energjetike të saj. Flitet se Kina ka 600 miliardë tonë qymyr, 50 miliardë tonë naftë, 60 miliardë metra kub gaz dhe shumë minerale të tjera të vlefshme. Ajo prodhon tungsten, është e dyta në botë për antimonin, e treta për kallajin dhe amiantin, e pesta për hekurin e kështu me radhë.

Në njoftimet që japin agjencitë e lajmeve, thuhet se nga shifrat e prodhimit, që njihen e që janë publikuar prej statistikave zyrtare, del se në vitin 1978 Kina do të prodhojë 500 milionë tonë qymyr, 150 miliardë kilovatorë energji elektrike, 28 milionë tonë çelique, 125 milionë tonë naftë, 310 milionë tonë drithëra etj.

Kjo është pasuria e Kinës, një pasuri kolosale, siç shikohet, por që duhet të vihet në shfrytëzim që të zhvillohet.

Shteti fqinj i saj, Japonia, ka një dinamizëm të çuditshëm dhe një potencial ekonomik industrial të pashtembullt. Atje jetojnë 115 milionë banorë, që janë grumbulluar të tërë në një sipërfaqe prej 360 mijë kilometrash katrorë. Japonia të gjitha lëndët e para i sjell nga jashtë dhe te Kina ajo gjeti partneren e saj të përshtatshme tek e cila t'i blejë këto lëndë të para, që i duhen për industrinë e vet dhe për të eksportuar atje

makineri, teknologji të re, armatime etj. Japonia, siç shënova më lart, mund të konsiderohet si vend i superprodhimit të madh dhe i industrializimit të madh; atje ka shoqëri shumëkombëshe me baza japoneze që janë nga më të rëndësishmet në botë, si: «Micui», «Micubishi», «Sumidomo», «Jasuba», «Nipon Stil» etj.

Kështu që të dy këto vende, Japonia dhe Kina, do të plotësojnë njëra-tjetrën. Japonia do t'i shesë Kinës teknologji moderne, armatime e makineri për ta fuqizuar atë, do të eksportojë atje materiale të industrializuara të cilësisë së lartë dhe do të marrë nga Kina lëndën e parë. Kështu avazi i aleancës së fundit të këtij viti, që u nënshkrua në mes Kinës dhe Japonisë, do të dëgjohet më pas. Kjo aleancë me rëndësi të madhe do ta forcojë edhe Kinën, por edhe Japoninë, e cila do të bëhet një fuqi imperialiste jashtëzakonisht e madhe dhe e rëndësishme, që do të tronditë jo vetëm Azinë, jo vetëm Bashkimin Sovjetik, por edhe imperializmin amerikan, e bile gjithë botën.

Tash marrëdhëniet midis Japonisë dhe Kinës janë zgjeruar shumë dhe portet kineze i kanë hapur të dy kanatet për japonezët. Kur Ten Hsiao Pini shkoi në Japoni, gjatë vizitës në një kombinat të prodhimit të automobilave (atje ka shumë kompani të tilla), tha: «Tash po e kuptoj ç'do të thotë çupë e bukur dhe çupë e përçmuar. Këtu, në Japoni, një punëtor ndërton 90 makina në vit, kurse në Kinë nuk arrin të ndërtojë një makinë».

Në tërë këtë ndërmarrje të madhe Kina kapitaliste, Kina imperialiste e Ten Hsiao Pinit, synon të zhvillohet në atë drejtim që është zhvilluar Japonia dhe me ndihmën e veçantë të saj.

Kina përpara fliste se nuk do të merrte kredi, tash kreditë që po merr ajo kanë hyrë në histori. Kredi Kina merr edhe nga bankat, edhe nga shtetet, edhe nga shoqëritë shumëkombëshe, edhe nga Hong-Kongu, edhe nga

Japonia, edhe nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, edhe nga Evropa Perëndimore; ajo e ka nderur dorën nga të katër anët.

Potenciali ekonomik i Japonisë është kolosal. Për këtë arsye Kina zgjodhi si partner kryesor në çështjet ekonomike Japoninë dhe i hapi dyert e tregut të saj krejtësisht për këtë shtet që ka një zhvillim me përmasa aq të mëdha, sa që tremb Perëndimin dhe amerikanët. Shihet qartë se monedha japoneze është nga më të fortat, bile dollari amerikan që vlerësohej 360 jenë japonezë më 1971 ose 300 më 1976, më 1978 ka zbritur në 200 jenë. Ja sa është nënvleftësuar dollari amerikan dhe sa është ngritur vlera e jenit japonez. Kuptohet se ky është rezultat i tregtisë së madhe që zhvillon Japonia me shumicën dërrmuese të prodhimeve që nxjerr.

Shkëmbimet e Kinës me Japoninë po shtohen vazhdimisht; sipas statistikave, nga 2 miliardë e 200 milionë dollarë që arrinte shuma e tyre në vitin 1974, u rrit në 4 miliardë e 100 milionë dollarë më 1976, në 5 miliardë e 100 milionë më 1977 dhe në vitin 1978 arriti afërsisht në 7 miliardë dollarë, siç thonë disa agjenci, dhe kjo pa-tjetër është e argumentuar. Pra, për Japoninë është krijuar një situatë shumë e favorshme në shkëmbimet tregtare, atje ka një përparim të madh teknologjik, ka përqindje më të vogël të të papunëve dhe një monedhë me një forcë jashtëzakonisht të zhvilluar.

Kina ka vendosur marrëdhënie të ngushta me Japoninë dhe merr prej saj kredi e teknologji moderne, me qëllim që edhe ajo në fund të shekullit të bëhet një fuqi e madhe. Pra, mund të merret me mend se ç'fuqi ekonomike do të bëhet Japonia gjatë kësaj kohe. Ajo do të superzhvillohet në atë mënyrë, që do të çuditë botën.

Prandaj jam i mendimit se jo vetëm sovjetikët, por edhe amerikanët i shqetëson një zhvillim dhe një «aleancë», një bashkim, i tillë kino-japonez. Megjithëse impe-

rialistët amerikanë aktualisht janë të fuqishëm dhe manovrojnë që një bashkim i tillë të mos ketë mundësi të zhvillohet në disfavor të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, prapëseprapë ata do ta shikojnë me vigjilencë të madhe këtë zhvillim.

Natyrisht, orientimi kryesor aktual, sipas mendimit tim, është konsolidimi i kësaj aleance dhe zhvillimi me ritme të shpejta i Kinës, njëkohësisht forcimi në mënyrë monstruoze i fuqisë ekonomike, ushtarake, i modernizimit e i teknologjisë së Japonisë dhe të dy këto shtete, si dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Sovjetik, natyrisht, do të ndeshen në konflikt për hegjemoni. Aleanca e Kinës me Japoninë mund të pasohet edhe nga një aleancë tjetër, aleanca kino-amerikane. Nuk dihet ç'do të nxjerrë udhëtimi i Ten Hsiao Pinit në Uashington, që është njoftuar se do të bëhet nga muaji janar i vitit 1979; nuk është çudi që vajtja e tij të konkludojë me një aleancë bashkëpunimi dhe miqësie. Kështu që Shtetet e Bashkuara të Amerikës lidhen me Japoninë dhe me Kinën me një aleancë, e cila bëhet, siç thoshte gjithë frikë «Pravda» për të kualifikuar aleancën në mes Kinës dhe Japonisë nën tutelën amerikane, se po «krijohet NATO-ja e Paqësorit».

Kjo, sigurisht, krijohet që tendencat e Kinës e të Japonisë për ekspansion t'u kundërvihen atyre të Bashkimit Sovjetik për ta dobësuar e për ta mundur këtë superfuqi. Mirëpo si do të zhvillohet ky ekspansion? Do të jetë një marshim i kësaj superfuqie të re ose i dy superfuqive në aleancë, duke pasur në krah edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, drejt Siberisë, drejt Bashkimit Sovjetik apo një marshim drejt rrugës së vjetër të pushtimit japonez, domethënë në Azinë Juglindore, të cilën ta bëjnë një domen të tyre që nga Indokina, Koreja dhe deri në Detin e Kuq, për të mbrojtur Lindjen e Mesme? Ekspansioni kino-japonez mund të orientohet

pa humbje të mëdha në këtë pellg dhe nëpërmjet disa luftërave të pjesshme ose diversioniste mund të jetë më i lehtë. Por interesat e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në këtë drejtim cenohen, gjithashtu, cenohen edhe interesat e Bashkimit Sovjetik, se edhe ky kërkon ta evitojë luftën në drejtimin e tij dhe t'i angazhojë luftimet jashtë territorit të vet, domethënë në Afrikë, në Gadi-shullin Arabik, në Pakistan, në Indi, po të ketë mundësi, edhe në Indokinë.

Pra ekspansioni kino-japonez, si rezultat i kësaj aleance ushtarake të ethshme, është një rrezik i madh, që do të shkaktojë një konflagracion, në mos botëror, të pjesshëm, duke kapur Lindjen e Lartme, Azinë Juglindore, ishujt e Paqësorit etj. Por një luftë e tillë nuk mund të imagjinohet pa implikimin e të gjitha shteteve imperialiste që janë futur në këtë krizë të madhe dhe që kërkojnë me çdo mënyrë të dalin prej saj, domethënë të mundin kundërshtarët e tyre dhe vetë të rindajnë botën.

Në këto situata kaq të turbullta për imperializmin, socialimperializmin dhe borgjezinë e madhe kapitaliste, një rëndësi të dorës së parë marrin sqarimi i popujve dhe ngritja e tyre në luftë, forcimi, krijimi, organizimi i partive marksiste-leniniste, revolucionare që duhet të udhëheqin revolucionin dhe luftën nacionalçlirimtare kundër shtypësve kapitalistë. Prandaj duhet ngritur lart emri i popullit trim iranian, i cili ka 3 muaj e më shumë që ditë e natë po lufton dhe vritet nëpër rrugët e Teheranit, Ispahanit, Tabrizit, «qyteteve të shenjta», duke bërë titur kundër shahut, kundër regjimit mesjetar dhe katil. Me dhjetëra mijë demonstrues në Marshad e gjetkë, çdo ditë, gjatë tërë kohës, bile edhe kur është vendosur shtetrrethimi, po goditen me ushtrinë. Zemërimi i popullit iranian ka ardhur duke u rritur dhe ka arritur kulmin. Gjithë Irani është mbërthyer nga grevat e këto

nuk janë greva të zakonshme, por të përgjakshme, ku vriten qindra e qindra veta dhe pas çdo të vrari ngrihen në këmbë me dhjetëra mijë të tjerë që kërkojnë rrëzimin e shahut.

Imperializmi amerikan ndodhet në vështirësi. Dy-tri herë Karteri ka folur haptazi për mbrojtjen e shahut; po kështu edhe krerët revizionistë sovjetikë, të cilët janë shprehur se, po të ndërhyhet në Iran, atëherë edhe Bashkimi Sovjetik do të marrë masa. Tash po dëgjojmë se dy aeroplanmbajtëse amerikane, «Libërejshën» dhe një tjetër, u nisën nga Japonia për në Gjirin Persik, gjoja për të mbrojtur dhe për të tërhequr qytetarët amerikanë, që janë rreth 40 mijë veta.

Brenda në Iran ekzistojnë trupa të CIA-s, trupa të Izraelit, të cilat mbrojnë pallatin e shahut, trupa të zgjedhura terroriste, por, megjithëkëtë, asgjë s'e pengon popullin të hidhet mbi to. S'ka rëndësi çështja se kush e udhëheq dhe e ngre popullin iranian në kryengritje për rrëzimin e regjimit mesjetar, barbar dhe të shitur tek imperializmi, të shahut të Persisë. Flitet se e udhëheqin sheikët e sektit mysliman shiitë; thuhet se e drejton nga Parisi njëfarë Ajatollah Khomeini ose Fronti Kombëtar, në qoftë se nuk gabohem, i cili vepron aktualisht në Iran.

Nga zhvillimi i demonstratave të mëdha në qytetet e Iranit, ku shohim çdo natë në televizor grushtet e popullit të mbledhura fort e të ngritura lart, themi se s'ka dyshim që kjo kryengritje është pozitive, pavarësisht se mund të jenë imamët që e nxitin. Edhe Stalini ka folur për imamët, për hanët e Afganistanit, dhe i ka mbrojtur ata. Ata hanër ishin, por Stalini ka folur mirë për ta, se luftuan me forcat angleze në grykat e maleve dhe i bënë hi; nga disa mijëra anglezë që ishin futur atje, vetëm 3 veta dolën gjallë nga Afganistani.

Kryesorja është se në Iran populli udhëhiqet nga ndjenja e urrejtjes kundër shahut. Ai është hedhur në

këto demonstrata se nuk i duron dot mjerimin, varfërinë, padrejtësitë, shtypjen dhe korrupsionin. Populli i Iranit është ngritur edhe kundër imperializmit amerikan që grabit pasuritë kolosale të burimeve të naftës iraniane, duke i lënë të zotët e këtyre pasurive në uri, në sëmundje, në injorancë. Kjo gjendje e shtyn popullin iranian të luftojë dhe të bëhet shembull për popujt e tjerë. Sidoqoftë, hoxhatolisllamët apo Ajatollah Khomeini e të tjerë janë elementë të borgjezisë kapitaliste liberale. Kjo duhet konsideruar pozitive, si një fitore kundër shahut dhe do të lërë gjurmë të thella në popullin iranian. Por atje nuk janë vetëm imamët e hoxhatolisllamët që udhëheqin, sepse ekzistojnë edhe elementë të tjerë, njerëz të partisë «Tudeh», prosovjetikë mund të themi, elementë pro Musadekut, socialdemokratit të vjetër. Atje ka gjithashtu, edhe marksistë-leninistë të partisë «Tufan». Kjo është një parti e re, por aktualisht ka një terren të përshatshëm për luftë, për të ngritur lart ndërgjegjen e popullit, për t'i treguar atij rrugën e drejtë, për ta bërë të ndërgjegjshëm për forcën e tij të pamposhtur, forcë e cila nuk mund të përmbahet as nga ushtria e shahut, as nga SAVAK-u, sigurimi i shtetit të tij, as nga luftanijet amerikane dhe as nga CIA. Pra, populli duhet të sqarohet dhe kjo pakënaqësi e madhe e tij të vihet në shërbim të revolucionit, të luftës nacionalçlirimtare, të jetë të paktën një parapërgatitje e luftërave të ardhshme, e revolucionit të ardhshëm. Dhe kështu do të jetë.

Influenca e luftës së popullit iranian ka depërtuar edhe në Turqi, ku po zhvillohen ndeshje të ashpra në mes demokratëve dhe konservatorëve. Atje luajnë një rol të madh elementët përparimtarë dhe demokratë, të cilët çdo ditë, që nga Stambolli e deri në Ankara e në qytete të tjera, me dhjetëra mijë, po ndeshen me organet policore e ushtarake.

Lufta e Iranit do të ketë influencë të madhe në të

gjitha Emiratet e Gjirit Persik, në Arabinë Saudite e në vendet e tjera, si në Siri e gjetkë, me një fjalë, në të gjithë Lindjen e Mesme, ku intrigat amerikane e sovjetike, tash edhe kineze, po bëjnë kërdrinë për të ruajtur statukuonë, domethënë shfrytëzimin dhe shtypjen e popujve.

Në gjithë këtë pëllg ka një situatë të favorshme revolucionare. Viti 1979 e gjen revolucionin në ngjitje, kurse imperializmin, socialimperializmin dhe kapitalizmin botëror të mbërthyer në një krizë të madhe, nga e cila është e zorshme të dalin. Udhëheqjet e tyre, ngaqë nuk mund të gjejnë dot mënyra drejtimi, mbytin revoltat e popujve me gjak, por revolucioni nuk mund të mbytet, ai fiton terren, ai marshon kurdoherë përpara.

E DIEL

31 DHJETOR 1978

## MBI GJENDJEN NDËRKOMBËTARE GJATË VITIT 1978

Nesër fillon viti i ri. Sot është dita e fundit e vitit 1978, pra mund të bëjmë një përmbledhje të gjendjes së strategjisë botërore në përgjithësi dhe të superfuqive në veçanti.

Imperializmi amerikan dhe socialimperializmi sovjetik, dy fuqi të mëdha bërthamore, vazhdojnë armatimin e tyre. Pavarësisht nga disa marrëveshje, që kanë nënshkruar dhe nga disa projekte SALT, që nuk po realizohen, fakt është se që të dyja këto superfuqi përpiqen të konsolidojnë pozitat e tyre botërore dhe t'i dalin përpara rrezikut të një lufte bërthamore. Natyrisht, këtë luftë, qoftë Bashkimi Sovjetik, qofshin Shtetet e Bashkuara të Amerikës, nuk e duan, por thellimi i krizës do ta krijojë një situatë të tillë. Në fillim lufta mund të jetë e zakonshme dhe më pas të kthehet në bërthamore.

Prandaj Bashkimi Sovjetik, përveç shtimit të armatimeve, nëpërmjet Traktatit të Varshavës dhe KNER-it, përpiqet të konsolidojë «aleancat» me vendet e «demokracisë popullore». Këto vende janë të pushtuara nga Bashkimi Sovjetik dhe prej tij konsiderohen si një *glacis*<sup>1</sup> midis tij dhe Evropës Perëndimore. Sot Bashkimi Sovjetik është një vend revizionist, socialimperialist. Atje nuk

1 Frëngjisht — ledh ndarës ndërmjet ndërluftuesve.

veprojnë ligjet e një shteti socialist. Pavarësisht nga fjalët që thonë, në Bashkimin Sovjetik sot dominojnë rusët, «rusët e bardhë». Pra në këtë vend nuk ekziston më dhe nuk mund të ekzistojë ai konsolidim i Bashkimit Sovjetik leninist-stalinian, nuk mund të ekzistojnë ai unitet dhe ajo kompaktësi përpara një lufte të re botërore, si ishte në luftën kundër hitlerianëve. Të gjitha republikat e Bashkimit Sovjetik nuk janë të qeta, bile, në kohë krize, mund që të mos shkojnë në unitet në luftë kundër një pushtuesi të mundshëm. Është revizionizmi ai që e shkaktoi këtë mundësi përçarjeje. Kjo është njëra anë.

Ana tjetër është se Bashkimi Sovjetik sot ndodhet përballë shumë rreziqeve, por sidomos përballë dy fronteve: frontit të Evropës Perëndimore, NATO-s, në unitet dhe në aleancë luftarake dhe ekonomike me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe në Lindje përballë frontit kino-japonez e prapa tyre profilohen përsëri Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Kështu që Bashkimi Sovjetik sot ndodhet në mes dy zjarresh, sidomos në Azi. Tash Kina po armatohet me shpejtësi të madhe, sigurisht për të sulmuar Bashkimin Sovjetik, kuptohet, në qoftë se do të vazhdojë kjo situatë, se ne mund të asistojmë edhe në një kthesë të politikës kineze ndaj Bashkimit Sovjetik, pra, në krijimin e një shtate kur çështjet nuk do të shkojnë siç paraqiten sot.

Por nënshkrimi i Traktatit Kino-Japonez dhe afrimi kaq i ngushtë i Kinës me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me vendet e tjera të Tregut të Përbashkët Evropian dhe me kapitalin botëror e bën më iminente rrezikshmërinë e luftës kundër Bashkimit Sovjetik në frontin aziatik. Prandaj këtij i duhet ta shpartallojë këtë front tani, kur ky akoma nuk është konsoliduar dhe nuk është bërë i rrezikshëm për shpërthimin e një lufte frontale. Për këtë Bashkimi Sovjetik mund të përfitojë nga gje-

ndja e dobët aktuale e Kinës, nga pamundësia e Shteteve të Bashkuara të Amerikës si dhe e vendeve të Evropës Perëndimore që të bëjnë ligjin kudo dhe të fillojë të grumbullojë rreth vetes së tij një numër shtetesh të lidhura me të në një formë ose në një tjetër, me qëllim që të mund të dominojë në shumë vende të botës, ashtu siç dëshirojnë edhe rivalët e tij.

Ne konstatojmë se Bashkimi Sovjetik përpiqet të futet në Afrikë, përpiqet të futet në Lindjen e Mesme, në Afganistan, në Pakistan, mundësisht dhe në Indi. Gjithashtu, aktualisht, ne vëmë re se lidhjet e Bashkimit Sovjetik me Vietnamin dhe me Laosin po forcohen. Kjo përbën një *glacis* tjetër sovjetik, por edhe pikë sulmi eventual kundër Kinës nga juglindja e Azisë së Largme.

Në kontinentin afrikan, pavarësisht nga fjalët që thuhet, por, po të studiohet imtësisht situata, del se qofshin Shtetet e Bashkuara të Amerikës, qoftë Bashkimi Sovjetik, qofshin edhe shtetet e «Evropës së Bashkuar» nuk janë në gjendje të investojnë aq sa duhet. Në Afrikë, në përgjithësi, «Evropës së Bashkuar» i duhet, sipas statistikave, të investojë të paktën 15 miliardë dollarë në vit, kurse ajo nuk mund të investojë veçse 3 miliardë. Në këtë kontinent më shumë investon Franca, e cila bën një politikë më të afërt me Afrikën e Zezë. Kjo vjen për shkak të lidhjeve të saj të vjetra koloniale me këto vende, të cilat propagandohen gjoja si lidhje kulturore, shoqërore, ekonomike etj. Dhe Franca ka tendencë që të influencojë në Tregun e Përbashkët Evropian dhe së toku të krijojë bllokun euroafrikan, se Afrika për ta është një kontinent me shumë rëndësi, me popullsi të paktë dhe me lëndë të para në sasi të pallogaritshme. Në përgjithësi Afrika është pak e shfrytëzuar, por megjithatë Afrika Jugore furnizon Evropën me shumë materiale, bile me materiale të rëndësishme strategjike.

Por çështja qëndron në atë se shkalla e investimeve aktuale të «Evropës së Bashkuar» është shumë e paktë, prandaj tendenca e shteteve që e përbëjnë këtë, është që të krijojnë lidhje midis Afrikës së Veriut dhe asaj të Jugut dhe të mos lejojnë që Bashkimi Sovjetik, por edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës të hedhin kthetrat e tyre në kontinentin afrikan. Një gjë e tillë bëhet shkak për lindjen e një konkurrence në mes të dyja superfuqive dhe shteteve të «Evropës së Bashkuar» të marra së toku dhe veç e veç.

Për sa u përket investimeve të Bashkimit Sovjetik në Afrikë, këto janë minimale, por tash së fundi ky ka filluar të futet ushtarakisht atje, kërkon baza detare, por ka ndërhyrë edhe me ushtri, si në Angola tok me kubanezët, në Etiopi dhe në Eritre, në Somali, në Aden e gjatë. Pra Bashkimi Sovjetik vepron në dy drejtime: për të krijuar *glacis*-in sovjetik dhe për ta përçarë këtë unitet luftarak që përgatitet dhe zhvillohet nga të dy krahët e tij. Një gjë e tillë Bashkimi Sovjetik do ta bëjë edhe në Evropë, edhe në Azinë e Vogël. Dhe në fakt e ka filluar këtë punë, megjithëse ka pasur dhe disfata. Sidoqoftë, aktualisht, për të një rëndësi të madhe strategjike merr Mesdheu, sepse nëpërmjet tij pengon NATO-n, mund të rrezikojë ushtrinë e këtij pakti në një konflikt me të, por njëkohësisht i pret rrugën mundësisë së «Evropës së Bashkuar» për një bashkim euro-afrikan.

Kështu që Bashkimi Sovjetik, nga ana e vet, duke u infiltruar me shumë mënyra, qoftë me investime, por këto, siç e vura në dukje, janë të pakta, qoftë me propagandë dhe me diversion, përpiqet që Sirinë, Irakun dhe Afganistanin t'i ketë të vetët, në mos plotësisht, por treçerek; çështja është që dhe këto të mos jenë të rrezikshme për të, por aleate të tij në një luftë kundër Lindjes, domethënë në një luftë kundër treshes Kinë, Japoni,

Shtete të Bashkuara të Amerikës, ose në gjithë këtë pellg, të mund të krijojë, duke kapërcyer Gjirin Persik duke kaluar në Pakistan e në Indi, një *glacis* të madh, me qëllim që të dobësojë rrethimin e vet.

Kurse Shtetet e Bashkuara të Amerikës nga ana e tyre përpiqen të financojnë dhe të armatosin Kinën për ta pasur atë kurdoherë si një faktor të rrezikshëm kundër Bashkimit Sovjetik që do të përpiqet të paktën «të mbrojë» perandorinë e vet, Siberinë, Mongolinë dhe Azinë Qendrore, ose «të përballojë» një sulmues, kuptohet, të fuqizuar me një potencial të madh ushtarak dhe ekonomik duke pasur përkrah edhe Japoninë militariste të superindustrializuar dhe të armatosur deri në dhëmbë.

Gjithashtu Shtetet e Bashkuara të Amerikës do të përpiqen që në konfliktet me Bashkimin Sovjetik të ruajnë Oqeanin Indian, t'i kenë Indinë dhe Birmaninë me vete dhe ta pengojnë infiltrimin e Bashkimit Sovjetik qoftë në Oqeani, qoftë nga toka në gjithë këtë rrip që të çon drejt Gjirit Persik dhe Azisë Qendrore.

Pra, aktualisht gjendja paraqitet e tillë: Përgatitjet për luftë po bëhen në ethe; shtetet imperialiste, në radhë të parë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Bashkimi Sovjetik dhe Kina po armatosen, midis tyre ka kontradikta, të cilat thellohen dhe, për të mos arritur në një luftë bërthamore të përgjithshme, nxitin luftëra lokale. Bashkimi Sovjetik përpiqet të arrijë një detantë me Tregun e Përbashkët Evropian dhe me NATO-n, përpiqet, gjithashtu, t'i zbutë kontradiktat me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, bën një politikë për çarjen e fronteve. Po ashtu Evropa, për të cilën Bashkimi Sovjetik përbën një rrezik të madh, nuk do që të digjet. Ajo është e gatshme të vërë të tjerët, sidomos frontin e lindjes kino-japonez, që të përleshet me Bashkimin Sovjetik dhe të nxjerrë për të gështenjat nga zjarri. Prandaj shohim që investi-

met dhe shkëmbimet tregtare në mes Tregut të Përbashkët Evropian dhe Bashkimit Sovjetik nuk pengohen, ato zhvillohen jo vetëm me Bashkimin Sovjetik, por edhe me aleatët e tij, me satelitët e Lindjes, pjesëtarë të Traktatit të Varshavës.

Kurse në Afrikë situata është akoma e papërcaktuar, për arsye se në shtetet afrikane, që janë «të lira» dhe «të pavarura», sundojnë klika të borgjezisë së madhe, sundojnë bajraktarë dhe feudalë të mëdhenj të lidhur, natyrisht, me ata që u japin më shumë. Dhe këta, në radhë të parë janë anglezët, francezët, gjermanoperëndimorët, amerikanët pastaj të tjerët, kurse Kina s'u jep gjë fare. Pra ajo i ka këmbët e shkurtra atje. Asaj i duhet shumë kohë që të futet në Afrikë. Në këtë pellg Kina luan rolin e pllakës së gramafonit për të gjithë. Ajo mbështet Shtetet e Bashkuara të Amerikës, mbështet «Evropën e Bashkuar» dhe u predikon këtyre që ta ndihmojnë atë me çfarë të mundin dhe Bashkimit Sovjetik të mos i japin kredi, që ta dobësojnë. Bile kinezët këtë e kanë deklaruar.

Prandaj situata aktuale, në pragun e Vitit të Ri 1979, mua më duket se është e mbushur me plot rreziqe, është e turbullt, por njëkohësisht është edhe revolucionare, se politika e të mëdhenjve imperialisto-revizionistë nuk është e pranueshme nga popujt, këta mbahen me forcë nën zgjedhën dhe nën diktatin e tyre. Popujt i kuptojnë intrigat, manovrat, strategjinë dhe taktikat e tyre dhe nuk rrinë me duar lidhur. Lëvizjet çlirimtare popullore po ngrihen, po shpërthejnë hapur, por ende janë të dobëta. Këto shpërthime mund të jenë momentale, mund të jenë të shkurtra, por prapë janë shpërthime, të cilat i shërbejnë dobësimit të fuqive të mëdha dhe pengojnë shpërthimin e një lufte të re botërore.

Në këtë drejtim ne duhet të punojmë, të luftojmë,

të zgjerojmë sa të jetë e mundur kontaktet me masat e gjera të popujve të botës. Duke u lidhur ngushtë me partitë marksiste-leniniste, me njerëzit përparimtarë dhe nëpërmjet tyre drejtpërdrejt me popujt e botës, ne t'u japim atyre mendimin e Shqipërisë socialiste dhe të Partisë së Punës të Shqipërisë.

glean in papers, to which I have a number of names the  
the market value of the property is about \$100,000  
approximately the value of the property is about \$100,000  
I have a number of papers.

TREGUESIT

**TREGUESI I LËNDËS****A**

*Afrika — nga zhvillimi politik e shoqëror. Planet dhe veprimtaria e imperialistëve dhe e revizionistëve në Afrikë — 88, 184, 196-197, 202, 238-239, 286-287, 385-386, 533, 608-609, 615-618*

*Afrimi, marrëveshjet dhe bashkëpunimi kino-amerikan — 5-6, 57, 64-65, 74-75, 104-105, 173-175, 182-183, 188-193, 230-231, 287-288, 299-300, 315-317, 346-347, 349-350, 387-388, 392, 394-395, 483-485, 504, 509-512, 516, 526-535, 537-542, 551-559, 617*

*Aleanca dhe rivaliteti amerikano-sovjetik — 183-184, 220-221, 286-287, 394, 405, 514, 545-549, 551-552*

*Aleancat politike dhe qëndrimi i revizionistëve kinezë ndaj tyre — 5-6, 11, 23-24, 35, 39-40, 138-139, 170-171, 174-177, 232, 320-321, 331-335, 384, 392, 398, 420-421, 473-474, 503, 511-512, 534-537, 546-548, 598-599*

*Ambasadat e RPSSH — 30, 103, 204-206, 305, 342-343, 370-373, 380*

*— në Kinë — 12, 14, 47, 233, 370-371, 391, 440, 523*  
*— në Vietnam — 3, 59-67*  
*— në Rumani — 211*  
*— në Francë — 203, 520*  
*— në Austri — 109-110*  
*— në Jugosllavi — 356-361*

*Anglia. Bllokimi i arit shqiptar nga qeveria angleze — 91, 196-197, 233-234, 252-253, 317, 350, 351, 385-386, 393-394, 518-521*

*Arbëreshët në Itali — 413, 433-434*

*Armatimi, armët, bërthamore; armatosja e fuqive imperialiste dhe revizioniste — 57, 177-178, 221, 300, 318, 350-351, 392, 416-417, 422-423, 557-558, 617*

*Azia — nga zhvillimi politik e shoqëror. Planet dhe veprimtaria e imperialistëve e revizionistëve në Azi — 56, 59, 88, 184, 220, 228, 283-291, 384-392, 395, 407, 420, 422-425, 438, 474-475, 504, 536-537, 547, 603-604, 614-615, 617*

**B**

Ballkani — probleme politiko-shoqërore të Ballkanit — 24, 39, 113-121, 135-143, 194, 197-198, 201-202, 208-215, 219-220, 227-228, 233, 235, 320, 384, 489

*Bashkimi Sovjetik në periudhën e Leninit dhe të Stalinit* — 75, 78, 95, 116, 123, 169-170, 185, 247, 251, 330, 427, 492-493, 502, 603

*Bashkimi Sovjetik socialimperialist*

— degjenerimi i jetës ekonomiko-shoqërore në BS — 95-96, 184-185, 427, 613-614

— strategjia globale dhe politika socialimperialiste sovjetike — 166-167, 174-175, 180, 183-184, 230-231, 241-242, 287-288, 392-393, 503, 511-512, 546-548, 609-610, 614-618

— politika hegjemoniste dhe e diktatit ndaj partive dhe vendeve revizioniste — 137, 142-143, 170-171, 487-491

— marrëdhëniet, kontradiktat me Kinën — 230-231, 299-300, 425, 504-505, 539-540, 546-547, 607-608

— marrëdhëniet me Vietnamin — 422-428, 430

— qëndrimet armiqësore kundër RPSSH — 23, 41, 91, 140-141, 401

Shih edhe: Aleanca dhe rivaliteti amerikan-sovjetik; Superfuqitë dhe sy-

nimet e tyre imperialiste. Përpjekjet e revizionistëve kinezë për ta shndërruar Kinën në superfuqi *Bloqet dhe flotat ushtarake imperialiste e revizioniste* — 7, 120, 286, 350-351, 393-394, 416-417, 540-542, 546-547, 610, 617-618

*Borgjezia. Borgjezia e re në vendet revizioniste* — 72, 89-90, 131-132, 134-135, 247-248, 307-308, 321, 329-330, 403, 442, 494-495, 498-499, 543

*Burokratizmi dhe lufta kundër tij* — 95-97, 452-453

**D**

*Demokracia në vendet imperialiste e revizioniste* — 76, 322-323, 330-331, 348-350, 366-369, 398-399, 438, 468-469, 474-475

*Diktatura e proletariatit* — 5, 15-16, 95-96, 185, 367-368, 468-469, 493-494, 502, 594-595

*Diplomacia e vendeve borgjeze e revizioniste* — 120-121, 204-205, 258-259, 345-347, 350, 360-361, 370-374, 541, 546, 553

**E**

*Egjipti — gjendja e brendshme dhe politika e jashtme e Egjiptit* — 305-312, 385-386

*Engels, Frederik* — 77, 95, 156, 273, 376, 378, 562

*Eurokomunizmi dhe lufta kun-*

*dër tij* — 246, 324-325, 401

*Evropa. «Evropa e Bashkuar» dhe qëndrimi i revizionistëve kinezë ndaj tyre* — 119-120, 142, 164-165, 175-176, 197, 199, 201-202, 228, 232, 259-260, 284-287, 350-351, 384-385, 397-398, 474, 512-516, 532-533, 548-549, 613-616, 618

**F**

*Fashizmi dhe fashistët e kohës së sotme; lufta kundër tyre* — 12, 25, 57-58, 80, 90, 100, 149-150, 326-327, 364-365, 384, 388, 390, 394, 399-400, 424-426, 444

*Feja në vende borgjeze e revizioniste. Vatikani* — 149-151, 162-163, 165-166, 364, 402-403, 429

*Franca, marrëdhëniet dhe kontradiktat e Francës me vendet e tjera* — 196-197, 233-234, 317, 385-386, 393-394, 403, 518, 520, 535-536, 615

*Fshatarësia në Kinë* — 74, 96-97, 107-108, 367-368, 480-482, 495-499

**G**

*Greqia*

— gjendja e brendshme dhe marrëdhëniet e saj me vendet e tjera — 198, 233-234, 319, 384

— marrëdhëniet me RPSSH — 521-522

**GJ****Gjermania**

— para dhe gjatë Luftës së Dytë Botërore — 91, 109-110, 396, 518

— RF e Gjermanisë — politika e jashtme; problemi i dëmshtëpërblimeve për RPSSH — 91, 109-111, 305-306, 314-316, 342, 350-351, 392-394, 410, 437, 521

**I**

*Imperializmi — strategjia globale, kontradiktat dhe kriza në gjirin e tij* — 82, 100, 141, 143-144, 175-176, 181-184, 186, 193, 220-221, 228, 247-248, 259-260, 346, 371-372, 381-382, 392, 399-401, 501-502, 539-540, 543, 609-610

*Internacionalja e Tretë Komuniste (Kominterni) dhe Kina* — 78, 115

*Italia — gjendja e brendshme dhe politika e jashtme e Italisë* — 150, 402-403, 491

*Izraeli — politika agresive kundër vendeve arabe* — 306-313, 384-386, 516, 610

**J**

*Japonia — politika e jashtme dhe marrëdhëniet e saj me Kinën* — 75, 174-178, 183, 287-288, 297, 314-315, 382, 392, 395-397, 407-408, 409-410, 415-416, 422-423, 473, 513, 534, 538-539, 547-548, 602-608

## Jugosllavia

- degjenerimi politik dhe ekonomik-shoqëror në Jugosllavi — 142-143, 165-168, 257-259, 269, 320, 445-453
  - agjenturë e imperializmit, politika demagogjike e sabotuese ndaj lëvizjeve nacionalçlirimtare e revolucionare të popujve — 123-124, 132-134, 136, 166, 197-198, 218-219, 258-259, 269, 302
  - lidhjet, bashkëpunimi me revizionistët kinezë dhe me vendet e tjera — 5-9, 124-125, 132-134, 145-146, 198, 214-215, 216-220, 233, 256-259, 269-270, 314, 320, 323, 360-361, 534-535
  - qëndrimet armiqësore, antishqiptare të revizionistëve jugosllavë në Kosovë dhe në krahinat e tjera me popullsi shqiptare në Jugosllavi — 135, 142, 357-361, 434
  - qëndrimet armiqësore kundër RPSSH — 124, 133-135, 145-146, 170, 356-361, 401, 413-414
- Shih edhe: Teoritë «vendet e paangazhuara» dhe «vendet në zhvillim», kritika kundër tyre

## K

- Kamboxhia* — gjendja e brendshme politike dhe konflikti i saj me Vietnamin — 54-57, 62, 66-67, 423, 547

*Kapitalizmi — kontradiktat dhe kriza në gjirin e tij* — 82, 182-183, 186, 231, 247-248, 259-260, 435-438, 575-576

«*Katërshja*» (banda e «katërshes») në Kinë — 280-281, 362-363, 367, 419, 440, 455, 458, 461-462, 471-472, 475-476, 480-481, 523, 526-531, 564-565, 567-570, 594-595

*Kina* — gjendja e brendshme dhe politika e jashtme revizioniste kineze

- gjendja e brendshme politike, ekonomike e shoqërore në Kinë — 9-10, 75-76, 96-97, 131-132, 149-151, 236-237, 299, 333-334, 348-349, 366-369, 387-391, 399-400, 435-438, 473, 475-477, 480-482, 499-500, 523-525, 549-550, 560-561, 575-576, 595-597

- strategjia globale, pozitat proimperialiste të Kinës dhe afrimi e bashkëpunimi i saj me qeveritë e klikat fashiste të vendeve të ndryshme — 7-8, 40-41, 56, 59, 90-91, 104-105, 128-129, 137-138, 175-181, 196-202, 214-215, 220-221, 228-229, 232-240, 260-261, 283-291, 298-300, 314-319, 345-347, 349-352, 364-365, 370-371, 380-387, 392-401, 437-438, 473-474, 508-512, 532-539, 618

- veprimtaria minuese e përçarëse e revizionistëve

kinezë ndaj luftërave çlirimtare e revolucionare të popujve — 59, 283-284, 420-421, 558-559

- qëndrimet jo të drejta ndaj emigracionit kinez — 141-142, 219-220, 420-421, 423

- marrëdhëniet dhe kontradiktat me revizionistët sovjetikë — 4-5, 34-35, 37-38, 90-91, 132-133, 138, 201-202, 221-222, 283, 285-286, 287, 292-293, 299-300, 320-321, 346, 410, 424, 437-438, 502-505, 526, 546-547

- afrimi e marrëdhëniet me revizionistët jugosllavë — 4-11, 25-27, 49, 119, 123-126, 130-142, 169, 194-202, 208, 214-215, 216-222, 223-228, 239-240, 256-259, 268-269, 293, 302, 323, 384, 473-474, 532-534

- marrëdhëniet me revizionistët rumunë — 26, 123, 131-142, 169-172, 194-195, 199-200, 208-214, 239-240, 256-259, 324, 384, 420, 473-474, 532-534

- marrëdhëniet me Vietnamin dhe konflikti kino-vietnamez — 59-68, 86-87, 106, 178-179, 212-213, 237, 283-291, 347, 383-384, 429-431, 515, 542-543

- qëndrimi ndaj konfliktit kamboxhiano-vietnamez — 55-58, 179, 283-284, 383, 426, 429-430, 515, 542-543

- marrëdhëniet me Japoni-

në, Traktati Kino-Japonez — 169-170, 173-184, 219, 237, 286-287, 289, 314, 351-352, 394-396, 407-408, 409-410, 415-417, 422-426, 429-430, 437, 473-474, 485, 513, 534-535, 543, 545-546, 602-608, 614

- qëndrimet armiqësore kundër PPSH e RPSSH — 12-13, 14-16, 20-27, 37, 41-42, 48-49, 79-80, 91, 105-108, 116-119, 123-124, 133-135, 140-141, 145-146, 199-200, 212-214, 224-226, 239-240, 279-280, 320, 323, 325-326, 335, 347, 383, 532-533

*Kina* — Partia Komuniste (revizioniste) e Kinës

- konfuzioni politik, ideologjik e organizativ në parti (vijat, komplotet, kontradiktat, lufta për pushtet) — 9-10, 21-27, 33-36, 57-58, 70-79, 96-97, 113-115, 248-250, 279-282, 326-327, 331-333, 349-351, 387-389, 417-421, 435-438, 439-444, 454-460, 461-463, 464-467, 468-479, 495-497, 500-502, 506-511, 526-541, 549-550, 561-576, 577-589, 590-601

- veprimtaria agjenturore e sabotuese kundër lëvizjes m-l ndërkombëtare — 147-148, 252-253, 271-273, 281-282, 324-326

*Klasa punëtore* — qëndrimi i revizionistëve kinezë ndaj rolit udhëheqës të saj — 74, 80-81, 186-187, 260-261, 321, 349-

-350, 390, 495-498, 550  
*Klasat dhe lufta e klasave. Trajtimi antimarksist i këtij problemi nga revizionistët kinezë* — 127, 321, 322-323, 367-

-368, 437-438, 442, 497-498, 531-533, 570-572

*KNER-i. Pozitat e revizionistëve kinezë ndaj tij* — 136-137, 139, 423, 542, 613

*Kolonializmi, neokolonializmi* — 132, 182-183, 283, 301-303

*Kontradiktat në vendet imperialiste e revizioniste* — 132, 142, 214-215, 231-232, 259-260, 287-288, 301, 307-308, 385, 399-401, 435, 514, 534, 539-540, 542-543, 551-552

*Koreja; pozitat revizioniste të udhëheqjes koreane* — 10-11, 163-164, 237, 293-298, 375-379, 396, 484-485

*Kosova dhe trojet e tjera me popullsi shqiptare në Jugosllavi* — 142, 146, 167, 214, 224-226, 269, 356-361, 411-414

*Kreditë imperialiste e revizioniste* — 52-53, 111-112, 133-134, 295, 299, 314, 316, 371-372, 379, 380-382, 384, 394-395, 407-408, 437, 450-451, 477-478, 532-533, 535-536, 606-607

## L

*Lenin, Vladimir Iliç* — 74, 77, 95, 121, 127, 130, 156, 178, 235, 243, 245, 251, 273, 323, 336, 349, 369, 376, 378, 461, 492, 550

*Lëvizja komuniste marksiste-leniniste ndërkombëtare*

— probleme të unitetit e të bashkëpunimit internacionalist në gjirin e lëvizjes marksiste-leniniste dhe lufta kundër shmangjeve e devijimeve nga parimet m-l — 147-148, 152-160, 242, 353-354, 400-401

— partitë marksiste-leniniste të Amerikës Latine — 328-336, 354

— Partia Komuniste e Brazilit — 263-267

— Partia Komuniste e Gjermanisë (m-l) — 28

— Partia Komuniste e Britanisë (m-l), lëkundjet dhe konfuzioni ideologjik i Rexh Bërçit — 154-159, 243-246, 251-253, 286, 271-280

— Partia Komuniste Revolucionare e Kilit, pozitat prorevizioniste kineze të Palacios — 153-154, 266, 339, 354

— Partia Komuniste Portugeze (e Rindërtuar) — 262-264

*Lëvizjet dhe luftërat nacionalçlirimtare e revolucionare të popujve* — 52-53, 144, 186-187, 301-302, 399-401, 486, 514-515, 543-544, 618-619

*Lindja e Mesme — politika dhe veprimet e fuqive imperialisto-revizioniste në këtë zonë* — 29, 201-202, 237, 242, 286-288, 298, 307-313, 384-386, 392, 397, 425, 486, 514-517,

539-540, 543, 608-609, 611-

-612, 615

*Lufta — shkaqet e shpërthimit të luftërave. Pozitat luftërxitëse të revizionistëve kinezë* — 120-121, 181-183, 230, 287-288, 308-309, 320-321, 383-384, 399, 485, 534-540, 616-618

## M

*Marksizëm-leninizmi*

— armë e busull për udhëheqje e veprim — 95-96, 102, 156, 303, 362, 399-400, 427-428, 463, 549

— veprimtaria armiqësore e revizionistëve kundër tij. Mbrojtja dhe zbatimi i m-l nga partitë marksiste-leniniste dhe PPSH — 34, 126, 180, 217, 246, 269, 277-278, 323, 376-379, 494-495, 503, 566, 573

*Marks, Karl* — 77, 95, 130, 156, 235, 273, 336, 376, 377, 378, 492, 562

*Maoedunideja — teori dhe praktikë antimarksiste. Qëndrimi i klikës së Ten Hsiao Pinit kundër Maos* — 71-81, 90, 113-114, 125-127, 163, 247-249, 258, 272-282, 294, 362-363, 387-388, 418-421, 435-436, 438, 439-444, 454-460, 462-463, 481-482, 528

*Ministria e Punëve të Jashtme e RPSSH* — 46-47, 305, 340, 519-522

*Ministria e Tregtisë së Jashtme e RPSSH* — 205

## N

*NATO — qëndrimet e revizionistëve kinezë ndaj saj* — 120, 136-137, 139, 200, 202, 234, 350-351, 393-394, 397-398, 489, 513, 540-542, 546, 608, 614, 616-617

## O

*Organizata e Kombeve të Bashkuara* — 38, 338-343, 345-347

## P

*Partia e Punës e Shqipërisë — lufta e saj kundër:*

— revizionizmit modern, jugosllav dhe sovjetik — 22-23, 33-34, 82, 101, 124-125, 139-141, 165-168, 246, 257-259, 261, 302-303, 401, 421, 485-486, 609-610

— revizionizmit kinez — 15-16, 22, 45-46, 81-82, 83, 88-90, 93, 124, 126-130, 139-140, 179-181, 185-186, 194-202, 238-239, 246-250, 254-255, 256-261, 281-282, 302-303, 326-327, 362-363, 401, 443-444, 544

*Partia e Punës e Shqipërisë — vija marksiste-leniniste e saj dhe solidariteti e marrëdhëniet me partitë marksiste-leniniste* — 28-29, 81, 84, 101-102, 135, 152, 160, 245-247, 262-267, 304, 324, 326-327, 335-336, 353-354, 619

*Partia Komuniste e Australisë (e ashtuquajtura m-l)* — 156-158, 244-245

*Partia Komuniste e Suedisë dhe ajo e Norvegjisë (të ash-tuquajtura m-l)* — 147-148

*Partitë komuniste marksiste-leniniste*

Shih: Lëvizja komuniste marksiste-leniniste ndërkom-bëtare

*Patriotizmi, patriotë* — 91-92, 411-412, 433-434

*Politika e jashtme e RPSSH*

— qëndrimet parimore m-l në marrëdhëniet me vendet e tjera — 23, 29-31, 52, 99, 105, 110-111, 140-141, 240, 338-344

— lufta kundër imperializmit, revizionizmit e reaksionit dhe përkrahja e lëvizjeve revolucionare e çlirimtare të popujve — 29, 53, 88-89, 93-94, 101, 139-141, 144, 181, 206, 242, 289-291, 301-304, 318-319, 399-401, 485-486, 543-544, 618-619

— forcimi i pozitës politike dhe rritja e autoritetit të RPSSH në botë. Miqtë e dashamirët për Shqipërinë — 17, 41, 51-53, 91-92, 98-102, 105, 116-117, 135, 139-140

— qëndrimi parimor m-l ndaj Kosovës dhe viseve të tjera me popullsi shqiptare në Jugosllavi — 30-31, 135, 224-226, 356-361, 411-414

— marrëdhëniet, kontradiktat me Kinën. Letra e KQ

të PPSH dhe e Qeverisë së RPSSH drejtuar KQ të PK të Kinës dhe qeverisë kineze — 13, 15-16, 17-19, 33, 35-43, 45-50, 70-71, 79-82, 83-84, 85-93, 98, 100, 103-108, 121, 170, 179-180, 353-354, 373-374, 543-544

— qëndrimet parimore ndaj Vietnamit e Kamboxhias — 3, 54-58, 59-60, 289-290, 430-431

— marrëdhëniet me shtetet fqinje — 30-31, 135, 341-342, 413-414, 521

*Propaganda dhe shtypi borgjezo-revizionist* — 20, 98-101, 123-124, 138, 143, 161-162, 169, 173-174, 232, 268-270, 271-282, 348-352, 381, 480-481, 560-576, 605

*Propaganda dhe shtypi në RPSSH. Propaganda për botën e jashtme* — 43, 85-86, 102, 194-202, 254-255, 256-259, 354, 430-431

## R

*Revizionizmi modern, vendet revizioniste*

— revizionistët modernë tradhtarë të marksizëm-leninizmit dhe armiq të popujve — 143-144, 180, 246, 261, 392-393, 427, 609-610

— marrëdhëniet e kontradiktat midis vendeve revizioniste — 123-144, 228, 261, 324-325, 542-543

— qëndrimet armiqësore ku-

ndër RPSSH — 91, 246-247, 261

*Revolucioni kinez. Revolucioni Kulturor në Kinë* — 56, 71-75, 113-122, 280-281, 333-334, 443, 455-456, 468-469, 471-472, 492, 493-499, 506-507, 509, 525, 526-529, 533-534, 561-566, 571-572, 585-587, 596-597

*Revolucioni socialist — rruga ngadhënjimtare e tij* — 127, 144, 182, 184-186, 304, 399-401, 426-427, 612

*Rumania; pozititat revizioniste të saj* — 131-138, 161-168, 170, 197-198, 208-210, 220, 233-234, 487-491, 534-535

## S

*Spiunazhi (agjenturat) borgjez e revizionist* — 91, 170-171, 179-180, 188-189, 248, 399

*Stalin, Josif Visarionoviç* — 27, 33, 34, 37-38, 75, 77, 78, 81, 95-96, 116, 130, 156, 175, 178, 219-220, 228, 235, 243, 245, 250, 251, 274-275, 369, 378, 404, 405, 443, 461, 465, 492, 502, 529, 552, 566, 582-583, 604, 610

*Superfuqitë dhe synimet e tyre imperialiste. Përpjekjet e revizionistëve kinezë për ta shndërruar Kinën në superfuqi* — 5, 120, 133, 143-144, 178-179, 182-183, 216, 228-229, 230-232, 285, 287-288, 292, 299-301, 380-382, 397-398, 437-438, 456, 469, 511-512, 515-516, 542-543, 552, 608-609

## SH

*Shovinizmi, shovinistët dhe lufta kundër tyre* — 37-38, 51, 56-57, 175-179, 226, 258-259, 300-302, 318, 382, 384, 426, 502, 515-516, 542-543, 558

*Shtetet e Bashkuara të Amerikës — strategjia globale, politika e luftës dhe e agresionit, hegjemonizmi amerikan* — 87, 174-175, 178, 220-221, 230-231, 299-300, 307-313, 315-318, 382, 392-397, 485, 501-502, 509, 511-512, 518, 538-539, 547-548, 556-557, 607-608, 610, 613, 616-617

Shih edhe: Afrimi, marrëveshjet dhe bashkëpunimi kino-amerikan; Aleanca dhe rivaliteti amerikan-sovjetik

## T

*Teoria e «tri botëve», kritika kundër saj* — 6-9, 39, 175-176, 194, 256-257, 294-295, 320-321, 331-332, 337, 437-438, 511-512

*Teoritë «vendet e paangazhuara» dhe «vendet në zhvillim», kritika kundër tyre* — 6-9, 132, 169, 218-219, 256-257

*Traktati i Varshavës* — 120, 136-137, 139, 198-200, 394, 487-490, 540-542, 613-614, 617-618

*Tregtia e jashtme e RPSSH — import-eksporti* — 28-32, 100, 111-112, 204-207, 255, 340-342

*Tregu i Përbashkët Evropian*

dhe qëndrimi i revizionistëve  
kinezë ndaj tij — 136-137, 139,  
198-199, 232-233, 316, 351-  
352, 373, 381-382, 384, 393,  
512-513, 533, 542, 548-549,  
614-615, 617-618

## U

Ushtria kineze. Pikëpamjet e  
revizionistëve kinezë lidhur me  
vendin dhe rolin e ushtrisë —  
9-10, 73-77, 115, 391, 419,  
426, 454-455, 470-471, 495-  
496, 505-506, 526-531, 580,  
587-588, 599

## T

Vendet arabe, gjendja e brendshme  
politike dhe veprimtaria  
e superfuqive në këtë rajon —  
305-313, 343, 385-386, 514-  
515

Vietnami. Gjendja e brendshme  
dhe politika e jashtme;  
konflikti vietnamezo-kambo-  
xhian dhe kino-vietnamez. Ma-  
rrëdhëniet me RPSSH — 3, 54-  
57, 59-67, 283-284, 289-290,  
422-428, 430, 547  
Vigjilencia revolucionare — 13,  
14, 142, 158, 227-228, 318-  
319

## TREGUESI I EMRAVE

### A

Alia, Ramiz — 14, 33, 34, 35, 38,  
45-48, 69, 70, 143, 152, 159,  
251-252, 254-255, 256, 260,  
264-265, 338, 353, 354, 430  
Alende, Salvador — 364  
Amazonas, Zhoao — 264  
Amin, Idi — 417  
Arruda, Dionis — 264-265  
Asad, Hafëz — 312  
Aust, Ernst — 28

### B

Balluku, Beqir — 24-25, 63,  
117-118, 119  
Begin, Menaem — 307, 310-312,  
343  
Berlinguer, Enriko — 325  
Buhnshtajn, Eduard — 156  
Bërç, Rexh — 154-159, 243-246,  
248, 251-253, 266, 271-280, 327  
Bogdanov, Aleksandër — 273  
Bonopart, Napolëon — 580  
Brezhnjev, Leonid — 138, 161-  
162, 168, 171-172, 208, 221,  
420, 462, 596  
Brzezinski, Zbignjev — 402,  
551-558  
Buda — 151, 167  
Buharin, Nikola — 273, 275  
Bulganin, Nikolai — 61  
Bush, Xhorxh — 372

### C

Cisi (perandresha) — 122

### Ç

Çabej, Eqrem — 413  
Çako, Hifo — 118, 119  
Çan Çun Çiao — 457  
Çan Kai Shi — 72-73, 75, 115,  
188-189, 192, 409, 461, 492,  
495, 538, 553, 578, 580, 587,  
602, 604  
Çausheku, Nikolae — 118, 132,  
135, 143, 161-168, 170-172, 199-  
200, 208-210, 219-220, 233,  
240, 284-285, 487-491  
Çen Hsi Lien — 417-418, 466,  
592  
Çen Ji — 441  
Çen Jun Kan — 583  
Çen Po Ta — 527, 587  
Çian Çin — 457, 466, 586, 587  
Çubrilloviq, Vaso — 226  
Çu De — 441, 580  
Çu En Lai — 24-25, 35, 64,  
106-108, 113-122, 138-139, 173,  
188-192, 280, 317, 418-419, 461,  
503-511, 526-534, 545, 563-576,  
577-589, 591-592, 597-598

### D

Darvin, Çarls — 126  
David — 103

De Rada, Jeronim — 433  
Desai, Morongi — 179  
Doikarut, Nikolae — 211  
Draga, Ferhat — 357  
Dubček, Aleksandër — 488  
Dume, Petrit — 118, 119  
Duncan, Çarls — 417

## E

Eçeveria, Rafael — 354  
Emam, Xhafar Sharif — 241

## F

Fam Van Dong — 442  
Fanfani, Amintore — 487, 491  
Fonten, Andre — 203  
Forlani, Arnaldo — 340-341, 347  
Franko, Françisko — 23  
Fukuda — 407, 409, 416, 422

## G

Gejt — 372  
Gën Biao — 9, 24  
Gierek, Eduart — 402  
Giom (Vilhelm I) — 227  
Gobino, Josef-Artur — 416  
Goliat — 103  
Gomulka, Vladislav — 402  
Gromiko, Andrei — 151

## H

Hoxha, Nexhmije — 152, 160  
Hekel, Ernst — 126-127  
Henderson — 240-241  
Hill, Eduard — 156-158, 244-245, 252  
Hirohito (Mikado) — 89, 178, 409, 417, 603-604  
Hitler, Adolf — 89, 109, 149, 229, 300, 396, 416

Ho Lun — 439  
Ho Shi Min — 67  
Hrushov, Nikita — 23, 33-34, 38, 41, 61, 78, 130, 151, 156, 248, 252, 385, 404-405, 420, 443, 469, 552, 566, 584, 587, 596  
Hua Kuo Fen — 9-11, 123-124, 128-143, 169-172, 194-202, 208-215, 216-222, 223-228, 238-240, 256-259, 268-270, 284-285, 293, 314-315, 324, 415-421, 439-444, 454-460, 465-467, 469-479, 526-544, 561-563, 590, 595  
Huan Hua — 170, 192, 317, 319, 345-347  
Huan, Tri — 65  
Hysein, Abdullah — 311-312

## I

Iden, Anton — 385

## J

Jan Shan Kun — 479  
Jao Ven Juan — 21  
Jeh Çien Jin — 9, 65, 461, 466, 510-511, 588  
Jeng Sari — 54, 65-66  
Jovanka — 358  
Jozef, Ferdinand — 227  
Jozef, Franc — 227

## K

Kapo, Hysni — 17-18, 34-35, 83  
Kan Shen — 479  
Kadar, Janosh — 489  
Kao Gan — 461, 501, 565, 574, 583  
Kardel, Eduard — 321-323, 355, 448-449, 452-453  
Karter, Xhimi — 168, 307, 310-

-312, 343, 394, 537-539, 553-554, 610  
Karriljo, Santiago — 211, 324, 325  
Kastro, Fidel — 267  
Kavo, Hulusi — 344  
Keon, Mikael — 189-190  
Këllezi, Abdyl — 24-25, 118  
Khomein, Ajatollah — 610-611  
Kim Ir Sen — 10-11, 163-164, 293-298, 375-379, 484-485  
Kisinger, Henri — 64, 174, 483, 508, 531  
Killab, Edmund — 189-191  
Konfuci — 121-122  
Krishti — 151  
Kryeziu, Ceno beg — 357

## L

Le Zuan — 422  
Lëfevrë (kardinali ~) — 150  
Lëfevr, Ferdinand — 325  
Li Çian — 597  
Li Hsien Nien — 108, 280, 284, 317, 437, 597  
Lin Biao — 271-273, 332-333, 418, 461, 480, 505, 510, 527-530, 562, 565, 570, 586-587, 597-598  
Liu Shao Çi — 35, 249, 389, 408, 441-442, 455, 459, 461, 462, 464-465, 477, 501, 504-506, 526, 564-566, 570, 574, 580-586  
Lo Ly Sin — 441  
Longo, Luixhi — 324  
Lula, Anastas — 155

## M

Malile, Reiz — 338  
Mao Ce Dun — 4-5, 70-82, 106-108, 113-122, 156-157, 177-178,

188-193, 248-250, 271-282, 326-327, 328-337, 439-444, 454-460, 465-467, 501-510, 526-534, 562-576, 578-589, 590-599  
Marshall, Xhorxh — 188  
Marshe, Zhorzh — 325  
Menci — 121  
Mikojan, Anastas — 41, 404-405  
Miniç, Millosh — 7-9  
Mobutu, Sese Seko — 40  
Musadek, Mohamed — 240, 611  
Musolini, Benito — 149

## N

Naser, Gamal Abdel — 385  
Ngo Din Diem — 62  
Ngjela, Kiço — 118, 119  
Nikolla (car ~) — 440  
Nikson, Riçard — 38, 64-65, 174, 193, 332, 365, 483, 508, 529-531, 539, 545, 591  
Nimani, Xhavit — 357, 360

## O

Ohab, Eduard — 402

## P

Pahlevi, Ashraf — 240, 241  
Pahlevi, Reza Muhamed — 240-242, 296  
Pajeta, Xhankarlo — 324  
Pak Çen Hi — 484  
Palacio, Horge 153-154  
Papa Pavli i 6-të — 149-151, 163  
Papa Xhovan — Pavli i 1-rë — 403  
Papa Xhovan — Pavli i 2-të — 402, 403  
Papa Piu i 12-të — 149  
Papa Xhovani i 23-të — 150  
Paskali, Odise — 433

Pen Çen — 464, 506, 565, 593  
Peterson, Roland — 147  
Pin De Huai — 501, 505-506,  
565, 574, 583, 585, 593  
Pinoçet, Augusto — 23, 153,  
354, 364-365  
Pol Pot — 64, 65-66  
Pü Min — 351

## R

Ralis, Dimitrios — 319  
Rusvelt, Teodor — 603

## S

Sadat, Anvar — 307, 309-312  
Sajfudin — 200, 418  
Saud, Ben Abdel Azis — 242,  
312  
Skënderbeu, Gjergj Kastrioti  
— 225, 433  
Snou, Edgar — 74, 116, 188  
Sonoda, Sundo — 407  
Strong, Ana Luiza — 188  
Suares, Mario — 264  
Sun Jat Sen — 387-388, 602

## SH

Shehu, Mehmet — 28, 30-31  
Shehu, Talat — 344  
Shmid, Helmut — 109, 167  
Shtraus, Johan — 109

## T

Taleiran, Charl Moris — 580  
Tanaka Kokuçi — 365  
Ten Hsiao Pin — 35, 121, 249,  
284, 383, 388-391, 407-408, 409-  
410, 415, 421, 435-438, 439-  
444, 454-460, 464-467, 469-  
479, 505-511, 526-544, 561-

-572, 596-599  
Ten Jin Çao — 592  
Tito, Josip Broz — 4-11, 124-  
125, 129-137, 141-143, 156,  
165-168, 171-172, 216-222, 223-  
226, 256-259, 268-270, 284-  
285, 293, 384, 445-453, 488-  
489  
Troçki, Leon — 126  
Truman, Harri — 190

## TH

Theodhosi, Koço — 118, 119

## U

Uillkoks, Viliams — 157

## V

Vandemejer — 188  
Van Dun Hsi — 466  
Van Hun Ven — 561, 586, 587  
Van Min — 115  
Van Tun Sin — 479  
Vens, Sajrus — 312  
Vishinski, Stefan — 402  
Vu Teh — 388, 417-418, 421,  
454-460, 466, 592

## Y

Y Khan — 12

## Z

Zadeja, Çesk — 412  
Zahedi (gjeneral ~) — 240

## ZH

Zhirengo, Louis — 341  
Zhukov, Geörgi — 603  
Zhyrke, Zhak — 325

## TREGUESI GJEOGRAFIK DHE I EMËRTIMEVE TË TJERA

### A

Aden — 616  
Afganistan — 178, 237, 397,  
438, 516, 610, 615-616  
AFP (agjencia e lajmeve ~)  
— 20, 467  
Algjeri — 267, 311, 312, 386  
Amerika Latine — 88, 328-336,  
354, 515  
Angolë — 616  
Ankara — 611  
Arabia Saudite — 308, 345,  
384-385, 397, 517, 612  
ASEAN (vendet ~) — 285, 287,  
395, 397, 425  
Asosiejted-Pres (agjencia e laj-  
meve ~) — 307, 352, 417, 551-  
552  
ATSH (agjencia e lajmeve ~)  
— 18-19, 20, 51, 85  
Athinë — 319  
Australi — 178, 395, 603  
Austri — 30  
Axherpres (agjencia e lajmeve  
~) — 161

### B

Belgjikë — 342  
Beograd — 130, 139, 167, 208,  
213, 216, 222, 223, 227, 235  
239, 314, 358, 360, 445, 600  
Berlin — 109

Bibla — 165-166  
Birman — 56, 284, 420, 515-517  
Bon — 110, 239  
Brioni (Jugosllavi) — 221, 235  
Bukuresht — 161-162, 171, 210-  
211, 213, 219, 239, 488, 491  
Bullgari — 197, 214-215, 225,  
233-234

### C

CIA — 240, 316, 372, 399, 402,  
610-611  
Cingming (Kinë) — 569  
Cisjordani — 309-310

### Ç

Çekosllovakia — 30, 197, 403,  
488, 490

### D

Deti Adriatik — 100, 260  
Deti i Kuq — 608  
Deti i Zi — 558  
Dien Bien Fu (Vietnam) — 62  
Durrës — 45, 69

### E

Emiratet e Gjirit Persik —  
309, 385, 612  
Eritre (Etiopi) — 558, 616

**G**

Gadishulli Arabik — 609  
 Gaza (rripi ~) — 309-310  
 Golan (Siri) — 309  
 Guomindan — 73, 366-367, 587

**GJ**

Gjiri Persik — 178, 237-238,  
 517, 610, 617

**F**

Filipine — 56, 237, 284, 384,  
 430, 546  
 Frans Pres (agjencia e lajme-  
 ve ~) — 464

**H**

Hagë — 519  
 Hajfong (Vietnam) — 547  
 Hajnan (ishujt ~, Kinë) —  
 603  
 Himalajë (malet ~) — 375  
 Hiroshimë (Japoni) — 177  
 Hong-Kong — 606-607  
 HSINHUA (agjencia e lajme-  
 ve ~) — 54, 100, 123, 211-  
 -212, 219, 268-269, 271, 283,  
 286, 348, 388, 409, 554, 556-  
 -558, 560, 590, 600  
 Huansi (Kinë) — 481  
 Hungari — 197, 403, 489

**I**

«Imperializmi dhe revolucioni»  
 (libri ~, Enver Hoxha) — 144,  
 152, 154, 160, 251-252, 264,  
 265, 271, 432, 461, 517  
 Indi — 178, 179, 237, 284, 318,  
 397-398, 438, 516, 543, 558,  
 609, 617

Indokinë — 61, 63-64, 318, 603,  
 608-609  
 Indonezi — 425, 546  
 Instituti i Studimeve Marksist-  
 te-Leniniste pranë KQ të  
 PPSH — 353  
 Intelixhens Servis — 251-253  
 Irak — 385, 616  
 Iran — 175, 178, 179, 237, 238,  
 240-242, 296, 298, 385, 397,  
 486, 514, 516-517, 561, 609-  
 -612  
 Ispahan (Iran) — 486, 609

**J**

«Jasuba» (shoqëria shumëkom-  
 mbëshe ~) — 606  
 Jemen — 308, 558  
 Jerusalem — 563  
 Jordani — 308-312

**K**

Kalabri (Itali) — 341  
 Kanada — 32, 157  
 Kanali i Korfuzit — 519  
 Kanton (Kinë) — 436, 603  
 Kaukaz (BS) — 385  
 KGB — 399  
 Kiansu (Kinë) — 481  
 Kili — 364-365  
 Kioto (agjencia e lajmeve ~)  
 — 383  
 Koreja e Jugut — 11, 237, 396,  
 484  
 Krakov (Poloni) — 402  
 Kubë — 267, 430, 489

**L**

Laos — 59, 63, 178, 179, 384,  
 515, 547, 558, 615  
 «Lë Mond» (gazeta ~) — 203,  
 535-536

**Liban — 308**

Libi — 312, 386  
 Londër — 239, 521  
 Lubjanë (Jugosllavi) — 167  
 Lufta e Dytë Botërore — 75,  
 87, 177-178, 226, 228, 514, 518,  
 602-604  
 Lufta e Parë Botërore — 228,  
 514  
 Lumi Jordan — 310  
 Lumi Mekong — 66

**M**

Malajë — 603  
 Malajzi — 384, 430  
 Mali i Zi — 224-226, 411-414  
 Mançuri — 583, 602  
 Maqedoni — 200, 224-226, 356-  
 -361, 411-414  
 Marok — 312  
 Marshad (Iran) — 609  
 Marrëveshja e Gjenevës e vitit  
 1954 për Vietnamin — 61-62  
 «Materializmi dhe Empiriokriti-  
 cizmi» (libri ~, V.I.Lenin) —  
 127  
 Mbledhja dhe marrëveshja e  
 Kemp-Dejvidit — 307, 310-311,  
 343  
 Mesdhe (zona ~) — 100, 260,  
 616  
 «Micubishi» (shoqëria shumë-  
 kombëshe ~) — 606  
 «Micui» (shoqëria shumëkom-  
 bëshe ~) — 606  
 Mongoli — 176, 178, 181, 301,  
 395, 547, 603, 617  
 «Monro» (doktrina ~) — 184  
 Moskë — 171, 221, 319, 484,  
 582-583  
 Mukden (Kinë) — 192

**N**

Nagasaki (Japoni) — 177  
 Nairobi — 417  
 Nankin (Kinë) — 436, 578, 603  
 Negevi (shkretëtira ~) — 310  
 «Nipon Stil» (shoqëria shumë-  
 kombëshe ~) — 606  
 Nju-Jork — 338, 341, 343  
 «Nodom Shinnum» (gazeta ~)  
 — 377, 378

**O**

Ohër (Jugosllavi) — 214  
 Oqeani Indian — 288, 290-291,  
 385, 558, 617  
 Oqeani (zona) Paqësor — 174,  
 177-178, 288, 290-291, 392, 395,  
 407, 536, 547, 603, 608

**P**

Pakistan — 9, 179, 237, 318,  
 397, 425, 438, 516, 615, 617  
 Palestinë — 311-312, 343  
 Paris — 610  
 Pekin — 20, 34, 169, 178, 222,  
 245-246, 371, 391, 408, 420,  
 436, 439, 440, 475, 483, 508,  
 529-530, 534, 537, 591, 602  
 «Perandoria Cin» (Kinë) —  
 121, 409  
 «Perandoria e Mesit» (Kinë) —  
 113, 569  
 «Perandoria Han» (Kinë) —  
 121  
 Phenian — 296, 376  
 Pirl-Harbor — 603  
 Pogradec — 69, 70, 160, 251  
 Poloni — 30, 167, 402-403, 489  
 Port-Artur — 315  
 Portugali — 262

«Pravda» (gazeta ~) — 546, 608  
Prespë (zona ~, Korçë) — 358  
Prishtinë (Jugosllavi) — 412

### Q

Qipro — 319

### R

Radio Kukësi — 411  
Radio Pekini — 173, 421  
Radio Tirana — 411  
Revolucioni i Madh Socialist i Tetorit — 251, 281  
Rojter (agjencia e lajmeve ~) — 20, 85, 188-192, 464  
Romë — 150, 240-241, 341

### S

Sajgon — 65  
SALT, SALT-2 — 394, 540, 613  
San-Francisko (SHBA) — 483, 539  
Sarajevë (Jugosllavi) — 223, 226-228  
Sarandë — 518  
SAVAK — 561, 611  
Seçuan (Kinë) — 442  
Serbi — 142, 226  
Siberi — 176, 178, 181, 301, 318, 395, 410, 416, 535, 547, 603-604, 608, 617  
Sinai (Egjipt) — 309  
Singapor — 284, 384, 430  
Sinkiang (Kinë) — 436, 547  
Siri — 308, 386, 612, 616  
Somali — 52, 616  
Sri Lankë — 9  
Stamboll — 611  
Suez (kanali ~) — 385

«Sumidomo» (shoqëria-shumë-kombëshe ~) — 606

### SH

Shangai (Kinë) — 64-65, 436, 523-525, 534, 595  
Shkup (Jugosllavi) — 167, 214, 235

### T

Tabriz (Iran) — 609  
Tajlandë — 56, 59, 384, 429, 515, 558  
Tajvan — 11, 237, 312, 396, 484-485, 507-508, 532, 537-539, 548, 551-552  
Tanzani — 417  
Tanjug (agjencia e lajmeve ~) — 145, 295, 315  
Taxhai (Kinë) — 481  
Teheran — 239-240, 561, 609  
Tibet (Kinë) — 397  
Tiencin (Kinë) — 578, 603  
Tiranë — 21, 98, 342  
Togo — 52  
Tokio — 409, 420  
Tonkin (gjiri ~) — 64  
«Tudeh» (partia ~) — 611  
«Tufan» (partia ~) — 611  
Turqi — 198, 226, 233, 319, 384, 385

### TH

«The Worker» (gazeta ~) — 243, 274

### U

Uashington — 100, 188, 191, 285-286, 307, 537, 539, 551-552, 579, 608  
Universiteti i Phenianit — 376-377  
Universiteti i Prishtinës — 411

### V

Venetik (Itali) — 403  
Vjenë — 109-110  
Vladivostok (BS) — 603

### Z

Zagreb (Jugosllavi) — 167, 235  
Zarë (Jugosllavi) — 225

Zelanda e Re — 56, 157  
Zvicër — 30, 342, 371-373, 379

### ZH

Zhenminzhibao (gazeta ~) — 56, 100, 211-212, 268-269, 271-274, 279-282, 348, 352, 362, 366-369, 418, 460, 480-481, 560-576

--- (---) ---  
--- ---  
--- ---  
--- ---  
---

--- ---  
--- ---  
--- ---  
--- ---  
---

LËNDA

1978

Faqe

1. — 3 korrik 1978. Ne mbrojmë kurdoherë të drejtën .....	3
2. — 3 korrik 1978. Oportunistë të paqëndrueshëm .....	4
3. — 7 korrik 1978. Përfundim logjik i tradhtisë kineze .....	12
4. — 8 korrik 1978. Asgjë s'na ka trembur e nuk do të na trembë .....	14
5. — 11 korrik 1978. Këtë situatë do ta kapërcejmë! .....	17
6. — 12 korrik 1978. Notë kineze e egër, shpifëse e shoviniste .....	20
7. — 13 korrik 1978. Në marrëdhëniet tregtare me jashtë në asnjë mënyrë nuk duhet të cenohet autoriteti i madh i Partisë dhe i shtetit tonë .....	28
8. — 13 korrik 1978. Le të hapim defterët! .....	33
9. — 14 korrik 1978. Të jemi kurdoherë me kokë të ftohtë e me zemër të zjarrtë .....	45
10. — 17 korrik 1978. Opinioni botëror është në favorin tonë .....	51
11. — 17 korrik 1978. Konfliktet të shëmtuara .....	54
12. — 19 korrik 1978. Bisedë e një zyrtari vietnamez me ambasadorin tonë .....	59
13. — 24 korrik 1978. Shënim .....	69

	Faqe
14. — 25 korrik 1978. Moment historik në marrëdhëniet me Kinën .....	70
15. — 30 korrik 1978. Kinezëve iu dha përgjigjja që meritonin .....	83
16. — 30 korrik 1978. Filloi jehona e letrës sonë	85
17. — 31 korrik 1978. Burokracia kineze .....	95
18. — 1 gusht 1978. Zëri i Shqipërisë socialiste të jetë një këmbanë e madhe për proletariatin e popujt e botës .....	98
19. — 2 gusht 1978. Interesim i jashtëzakonshëm për letrën tonë .....	103
20. — 3 gusht 1978. Shqipëria do të qëndrojë kurdoherë e lirë, e pavarur dhe sovranë .....	109
21. — 3 gusht 1978. Politika e Kinës në Ballkan	113
22. — 5 gusht 1978. Përse shkon Hua Kuo Feni në Rumani dhe në Jugosllavi? .....	123
23. — 6 gusht 1978. S'ka ç'flitet për litar në shtëpinë e të varurit .....	145
24. — 6 gusht 1978. Partitë nordike janë me kinezët .....	147
25. — 7 gusht 1978. Kinës së sotme, përkrah budizmit dhe maoizmit, i duhet edhe kristianizmi .....	149
26. — 9 gusht 1978. Mbi vërejtjet e shokëve të partive marksiste-leniniste për librin «Imperializmi dhe revolucioni» .....	152
27. — 10 gusht 1978. «Papa» Hua, kërkon të bëjë «koncil» me «kardinalët» Kim, Tito e Çausht	161
28. — 11 gusht 1978. Përse Hua Kuo Feni po e shtyn vizitën në Ballkan? .....	169
29. — 14 gusht 1978. Traktati Kino-Japonez i ka rrënjët tek imperializmi amerikan .....	173

	Faqe
30. — 15 gusht 1978. Dalin në dritë dokumente të fshehta .....	188
31. — 16 gusht 1978. Qëllime djallëzore të revisionistëve kinezë .....	194
32. — 19 gusht 1978. Andre Fonteni kërkon një intervistë .....	203
33. — 19 gusht 1978. Ambasadorët tanë të mërrren edhe me problemet e tregtisë .....	204
34. — 21 gusht 1978. Intriga politike të Kinës në Ballkan .....	208
35. — 23 gusht 1978. Hua Kuo Feni kokë më kokë me Titon në Beograd .....	216
36. — 25 gusht 1978. Bota të mos harrojë Sarajevën! .....	223
37. — 29 gusht 1978. Trekëndëshi i superfuqive	230
38. — 30 gusht 1978. Mao Ce Duni nuk mund të krahasohet me Stalinin .....	243
39. — 30 gusht 1978. Fytyra e vërtetë e Rexh Bërçit .....	251
40. — 31 gusht 1978. Të demaskojmë vizitën e Hua Kuo Fenit në Bukuresht dhe në Beograd .....	254
41. — 31 gusht 1978. Ide të tjera për artikullin mbi udhëtimin e Hua Kuo Fenit në Ballkan	256
42. — 31 gusht 1978. Probleme e taktika të disa partive marksiste-leniniste që duhen parë me vëmendje .....	262
43. — 31 gusht 1978. Ditirambe e gënjeshtër të shtypit kinez .....	268
44. — 4 shtator 1978. Shtrembërohet realiteti, mbrohet falsiteti .....	271

	Faqe
45. — <b>7 shtator 1978.</b> Strategjia e Kinës në Azinë Juglindore .....	283
46. — <b>12 shtator 1978.</b> Për të qeshur e për të qarë .....	292
47. — <b>22 shtator 1978.</b> Të aktivizojmë kërkesën për dëmshpërblimet nga Gjermania Federale .....	305
48. — <b>22 shtator 1978.</b> Tre politikanë dhe problemet e Lindjes së Mesme .....	307
49. — <b>24 shtator 1978.</b> Kina ecën si kali pa fre drejt imperializmit .....	314
50. — <b>26 shtator 1978.</b> Unitet në mendime midis revizionistëve kinezë e jugosllavë .....	320
51. — <b>29 shtator 1978.</b> Përse disa parti (m-l) të Amerikës Latine nuk i kuptojnë gabimet dhe fajet e Mao Ce Dunit .....	328
52. — <b>30 shtator 1978.</b> Ç'duhet të bëjë ministri ynë i Jashtëm në OKB .....	338
53. — <b>30 shtator 1978.</b> Fjalim demagogjik .....	345
54. — <b>1 tetor 1978.</b> Udhëheqja kineze po shet vendin në të katër anët e botës .....	348
55. — <b>5 tetor 1978.</b> Një konferencë me rëndësi të jashtëzakonshme .....	353
56. — <b>5 tetor 1978.</b> Shënim .....	355
57. — <b>6 tetor 1978.</b> Veprime flagrante të poshtira e armiqësore të titistëve ndaj vendit tonë .....	356
58. — <b>7 tetor 1978.</b> Kulti i Mao Ce Dunit duhet ulur vetëm nga pozitat e marksizëm-leninizmit .....	362
59. — <b>9 tetor 1978.</b> Veprime politike pa cipë të udhëheqjes kineze .....	364

	Faqe
60. — <b>10 tetor 1978.</b> Demokracia proletare në Kinë as ka ekzistuar, as ekziston .....	366
61. — <b>13 tetor 1978.</b> Kina po nxiton në qorrso-kakun kapitalist dhe një mëngjes do të thyejë qafën .....	370
62. — <b>14 tetor 1978.</b> Kim Ir Seni po e kthen veten në perëndi .....	375
63. — <b>17 tetor 1978.</b> Politika e «katër modernizimeve» — politikë superfuqie .....	380
64. — <b>21 tetor 1978.</b> Kina dhe fuqitë e tjera imperialiste .....	392
65. — <b>22 tetor 1978.</b> Një papë polak në krye të Vatikanit .....	402
66. — <b>23 tetor 1978.</b> Vdiq antishqiptari i egër Mikojan .....	404
67. — <b>23 tetor 1978.</b> Ten Hsiao Pini shkoi në Tokio .....	407
68. — <b>26 tetor 1978.</b> Aleanca kino-japoneze — aleancë imperialiste për dominimin e botës .....	409
69. — <b>27 tetor 1978.</b> Lidhur me marrëdhëniet tona me Kosovën .....	411
70. — <b>1 nëntor 1978.</b> Në vend të kultit të Maos po ngrihet kulti i Tenit .....	415
71. — <b>4 nëntor 1978.</b> Dy traktate që përgatitin luftën imperialiste .....	422
72. — <b>10 nëntor 1978.</b> Kina dhe Bashkimi Sovjetik janë armiq të popullit vietnamez .....	429
73. — <b>13 nëntor 1978.</b> Shënim .....	432
74. — <b>14 nëntor 1978.</b> Arbëreshët në Itali ruajnë me ngulm traditat dhe zakonet e origjinës së tyre .....	433

	Faqe
75. — <b>17 nëntor 1978.</b> Kapitalizmi në Kinë po rend me galop .....	435
76. — <b>22 nëntor 1978.</b> Në bazë të kundërrevolucionit kinez qëndron maocedunideja .....	439
77. — <b>23 nëntor 1978.</b> Titoja njih dhe pohon me gojën e vet falimentimin e regjimit të tij .....	445
78. — <b>24 nëntor 1978.</b> Në dallgët e luftës për pushtet .....	454
79. — <b>25 nëntor 1978.</b> Disa ide plotësuese për librin «Imperializmi dhe revolucioni» .....	461
80. — <b>30 nëntor 1978.</b> — Rrëmuje e madhe drejt së djathtës ekstreme .....	464
81. — <b>7 dhjetor 1978.</b> Rehabilitimi i gjithë reaksionit të zi .....	468
82. — <b>9 dhjetor 1978.</b> Koncepte antimarksiste që mbivlerësojnë fshatarësinë .....	480
83. — <b>12 dhjetor 1978.</b> Përpyetje për një aleancë të fortë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës .....	483
84. — <b>12 dhjetor 1978.</b> Rumaninë nuk mund ta shpëtojë as Kina, as Titoja, as Fanfani .....	497
85. — <b>13 dhjetor 1978.</b> Bilanc i tmerrshëm i një regjimi ku ka sunduar pushteti personal .....	492
86. — <b>16 dhjetor 1978.</b> Anglia mban akoma të bllokuar arin tonë të grabitur nga Gjermania naziste .....	513
87. — <b>16 dhjetor 1978.</b> Kina «u çlirua» nga «banda e të katërve». Po nga gjendja e sotme kur do të çlirohet? .....	523
88. — <b>18 dhjetor 1978.</b> Tymi i bardhë i aleancave ndër imperialiste fsheh rreziqe të mëdha për njerëzimin .....	526

	Faqe
89. — <b>21 dhjetor 1978.</b> Popujt dhe proletariati duhet të bëhen të vetëdijshëm mbi çka po ngjet në botë .....	545
90. — <b>23 dhjetor 1978.</b> Dy versione të një deklarate .....	551
91. — <b>26 dhjetor 1978.</b> Rreth ngjarjeve në she-shin Tien An Men .....	560
92. — <b>28 dhjetor 1978.</b> Çu En Lai në dokumente amerikane .....	577
93. — <b>28 dhjetor 1978.</b> Plenumi i 3-të i KQ të 11-të të PKK .....	590
94. — <b>29 dhjetor 1978.</b> Kina dhe Japonia .....	602
95. — <b>31 dhjetor 1978.</b> Mbi gjendjen ndërkom-bëtare gjatë vitit 1978 .....	613
Treguesi i lëndës .....	623
Treguesi i emrave .....	633
Treguesi gjeografik dhe i emërtimeve të tjera .....	637